



MUJORI

Përzgjedhje

IV

Mars - Prill
Maj - Qershor

*Përktheu
Atë Justin Anthimiadhi*

Botim i Manastirit të Hirshëm të Paraklitit
(Ngushëllimtarit)
Oropos-Atikë, Greqi, 2016

Titujt e origjinalëve: “Μηναῖον Μαρτίου”, “Μηναῖον Ἀπριλίου”,
“Μηναῖον Μαΐου”, “Μηναῖον Ἰουνίου”.

Dhuratë për vëllezërit tanë të dashur klerikë dhe psaltë
të Kishës së Shqipërisë

© Manastiri i Hirshëm i Paraklitit, Oropos-Atikë, Greqi

*Duhet të kihen gjithmonë parasysh Udhëzimet në fillimin e volumit të
parë, si p.sh. se “Në Leximet biblike të Dhiatës së Vjetër **mbajmë
qëllimisht, me vetëdije gabimet letrare që ajo ka**”.*

O shenjtorë të Perëndisë, ndërmjetoni për ata që bashkëpunuan me
shpirt dhe u lodhën për himnimin tuaj.

Me ndërmjetimet e shenjtorëve të tu, o Perëndi, mëshirona dhe
shpëtona. Amin.

Lejohet kopjimi i citimeve biblike, por të referohet burimi.

Ἐπιτρέπεται ἡ ἀντιγραφὴ τῶν βιβλικῶν παραπομπῶν μὲ μόνη τὴν ἀναφορὰ
τῆς πηγῆς.

Copyrighting of biblical quotes are permitted; it is necessary only to
reference the source.

Разрешается выписка библейских цитирований; необходимо сделать
ссылку на источник.

Rreth nevojës së këtij përkthimi

Himnologjia në Shqipëri përdor “përkthimin... nga Gërqishtja” që u bë “lirisht, pas kuptimit edhe jo fjalë pas fjale” (Kremtore, Parathënje). Por ka raste që u bë absolutisht lirisht. P.sh. Pas Ungjillit të Mëngjesores së shën Dhimitrit (Kremtore, fq. 273):

Origjinali

Εἰς τὰ ὑπερκόσμια σκηνώματα τὸ
πνεῦμά σου, Δημήτριε μάρτυς σοφέ,
Χριστὸς ὁ Θεὸς προσήκατο ἀνώμητον·
σὺ γὰρ τῆς Τριάδος γέγονας ὑπέρμαχος,
ἐν τῷ σταδίῳ ἀνδρείως ὑπεραθλήσας
ὡς ἀδάμας στερρός· λογχευθεὶς δὲ
τὴν πλευρὰν τὴν ἀκήρατόν σου, παν-
σεβάσμιε, μιμούμενος τὸν ἐπὶ ξύλου
τανυσθέντα εἰς σωτηρίαν παντὸς τοῦ
κόσμου, τῶν θαυμάτων εἵληφας τὴν
ἐνέργειαν, ἀνθρώποις παρέχων τὰς
ιάσεις ἀφθόνως. Διό σου σήμερον
τὴν κοίμησιν ἐορτάζοντες, ἐπαξίως
δοξάζομεν τὸν σὲ δοξάσαντα Κύριον.

Përkthimi i lirë,

sipas “Ikos tu Efratha”

Popullin na e mbro, Dëshmor i math
Shën Mitër, nga drithmat e tërmetit,
nga zia dhe murtaja, dhe shkeljet e
barbarëve.

Sqarojmë se ekzistojnë rreth 100 himne “aftomele”, d.m.th. “modele”, “kallëpe”, sipas të cilave psalen mijëra himne (“Prosomia”, “të Përngjashme”). “Ikos tu Efratha” është ndër më të vegjlit (ka 2 më të vegjël se ai) dhe përdoret pak, zakonisht në ditë paskremtore. Por shumica e himneve ishte kthyer në këtë “model”.

Në fushën letrare, përsëri ka fjalë jo të përshtatshme. P.sh. në himnin e mëparshëm shën Dhimitri kthehet në shën Mitri, edhe pse gjuha kishtare (dhe natyrisht himnologjia) nuk përdor emra përkëdhelës.

Ose: Miropururëset “nuk e gjetnë dot kufomën” e Jisuit (Kremtore, fq. 137). Askund në Bibël nuk karakterizohet kështu Krishti në varr, madje nuk përdoret as fjala “lipsan”, por vetëm “trupit” i Tij. As trupat e shenjtoreve nuk quhen “kufoma” dhe natyrisht as ai i Perëndilindëses (“kufomën ju ma varrosni”, fq. 70).

Ose: Në Përlëshoren e Fjetjes së Perëndilindëses shkruhet: “Në fjetjen tënde s’e neverite botën” (fq. 742), ndërsa origjinali thotë: “s’e braktise botën”.

Përkthimi i lirë disa herë ka katandisur në tekst të ri. P.sh. në Lavdërimet e shën Joan Theologut (fq. 244), sipas *O tu paradhoksu thavmatos*.

<i>Origjinali</i>	<i>Përkthimi i saktë</i>	<i>Përkthimi i lirë</i>
Θεολογίας τὰνάματα ἐπὶ τοῦ στήθους πεσὼν τῆς σοφίας ἐξήντηλῃσας καὶ τὸν κόσμον ἥρδευσας, Ἰωάννη πανάριστε, τῇ τῆς Τριάδος γνώσει τὴν θάλασσαν καταξηράνας τῆς ἀθεότητος, στῦλος γενόμενος καὶ νεφέλη ἔμψυχος καθοδηγῶν πρὸς τὴν ἐπουράνιον κληροδοσίαν ἡμᾶς.	Pasi re ¹ mbi gjoksin ² e urtësisë, ³ nxore ⁴ rrjedhat ⁵ e thelogjisë ⁶ dhe vadi-te ⁷ botën, ⁸ o Joan ⁹ i tërë-shkëlqyer; ¹⁰ me njohjen ¹¹ e Trinisë ¹² thave krejt detin ¹³ e ateizmit, ¹⁴ pasi u bëre ¹⁵ shtyllë ¹⁶ dhe re ¹⁷ e gjallë ¹⁸ duke na ¹⁹ udhëhequr ²⁰ drejt trashëgimisë ²¹ përmbiqiellore. ²²	Ç’është kjo çudi dhe kjo habi! Na e dërgoj Zot’ i Math, Shën Joanin prej qiellit [!?!], dele midis uj-qëve, po ay nuk u tremp aspak, bishat i bëri shqerra me bes’ e fe, botën e tërë, me predikim e ndroj. Sa vepra pa tregim, na ke bër’, o Ungjillor i Zotit Krisht. Pra atë e lushim sot, me brohori dhe mall.

D.m.th. vetëm një element (nr. 9) kaloi në përkthim. Ne në pak herë detyrohem të humbasim një pikë, rrallë dy, që t’i përshtatim në “modelet”.

Ndërkohë, ana letrare është çështje dytësore. Çfarë bëhet me thelogjinë, me dogmat e besimit dhe, në radhë të parë, me njohjen e Shkrimit të Shenjtë? P.sh. në Zbritësoret e Kryqit thuhet se Moisiu që kishte ndarë Detin e Kuq me shkopin e tij, “prapë e bashkoi, me një tjetër shkop” (fq. 211).

Nuk flitet askund për një tjetër shkop (Eks. kap. 14), nuk kishte dy shkopinj, madje shkopit i tij u bë i famshëm, meqë me këtë kreu shumë nga mrekuillitë e tij.

Dhe nëse shkopi i profetit kolosal, që ishte diçka materiale, nuk njihet mirë, Marjama, motra e tij, është tepër e njohur dhe përmendet shpesh; mirëpo në Zbritësoret e Perëndilindëses, përkthimi (gabimisht) nuk i drejtohet asaj, por Perëndilindëses, duke thënë: “Kujtimi yt, Mari Hyjlindëse, thirri çdo besnik këtu... Ti në krye dhe ne pas me valle dhe me timpane, dhe me këngë...” (fq. 747). Originali nuk lejon ngatërrim: Ishte Marjama që pas kalimit të Detit të Kuq doli përpara me timbane dhe pas asaj gratë, duke kënduar dhe vallëzuar (Eks. 15.20-21).

Më 30 janar (fq. 568) Tre Hierarkët e Mëdhenj, Vasili, Grigori dhe Joan Gojarti, “kalorësit e Orthodhoksëve” [!], përcaktohen si “të tre Apostujtë prej Dymbëdhjetëve”? Ata jetuan disa shekuj pas apostujve, s’mund të bëhet fjalë për metempsikozë-ide të feve lindore, që besojnë se njeriu lind dhe jeton mjaft herë, mundet edhe si dru, edhe si qen etj...

Në fq. 487: “Ne pra të ndriçuar thërresim: Krisht i Trinisë mëshirona”? Disa heretikë kishin concept të gabuar për Shën Trininë (Antitriaditet), por “Shën Katërshja” përbën një risi. Nga ana tjetër në Hyjninë Trinisore (Atin, Birin dhe Shpirtin e Shenjtë) nuk futet natyra njerëzore. Vetëm Personi i dytë i Saj u bë edhe njeri.

Në fq. 738 “u dëgjua zëri nga qielli”, d.m.th. zëri i Atit, gjatë Metamorfozës së Shpëtimtarit, i Cili e “lëçiti Bir më të dashurin”? Sa bij kishte Ati?

Për më tepër: P.sh. “Adhurimi i Vargonjve të shën Pjetrit” (fq. 522). Adhurimi ynë, në kundërshtim me ata që adhurojnë idhuj, i përket ekskluzivisht Hyjnisë, as shenjtorëve dhe, për më tepër, as materies. Atyre u japim nderim, respekt ose falje vetëm. Asnjëherë fjala “adhurim” nuk ka pasur një tjetër kuptim.

Nga ana e sasisë, pak himne (rreth 6%) nga pasuria e mrekullueshme qiellore ishin të përkthyer. P.sh. një nga të dy të kremtet e mëdha të shën Joan Pagëzorit (Prerja e kokës së tij, 29 gusht) ka vetëm një tropar.

Dhe natyrisht fjalori është i vjetër, dhe vështirëson sot kuptimin. P.sh. “Ne që u kthyem prej mospietitetit në pietet [...] dyke hedhur tej besën mospietoze të liklavdoreve” (Triodhi i Vogël, fq. 54).

Megjithatë, përkthimi ka vlerë si përpjekja e parë, meqenëse deri atëherë nuk ekzistonin përkthime në shqip.

Në lidhje me Tipikonin (rregulloren e shërbesave), psalti ishte në konfuzion, kur binin dy ose tri festa në të njëjtën ditë. P.sh. në këtë volum Tipikoni i Ungjillëzimit (25 mars) ka 21 raste!

Mendojmë se s' do të thuhet për përkthimin tonë se “hyri brenda, po doli përjashta” (Triodhi dhe Pesëdhjetorja fq. 242, në vend të Jonai “u kap, por nuk u shkllavërua” nga peshku i madh). Sigurisht, nuk pretendojmë se puna jonë është e përsosur, pra vërejtje dhe sugjerime janë të mirëpritura. Nga ana tjetër kemi konstatuar se në nisjen e punës sonë, d.m.th. në volumin I, ekzistojnë dobësi.

Shënojmë se është më e lehtë relativisht ta krijojmë që nga fillimi himnologjinë e një shenjtori, e cila nuk ekziston [p.sh. në këtë volum, kemi shkruar atë të shën Isidorës (1 maj) dhe të shën Joan Vladimirit (22 maj)], sesa ta përkthejmë saktësisht dhe absolutisht të përshtatur me “modele” - dhe kryesisht tropare dogmatike, “Triadike”, - pra me mund e lodhje! Herë pas here një tropar mund të na merrte treçerek ore!

Dhe në tropare dogmatike bëhej shpesh “akrobaci”, që të ruhej edhe saktësia letrare, si edhe muzika sipas metrit poetik (“tonik”), pa rënë në herezi. Nëse ekziston ndonjë gabim, nuk u bë me vetëdije, por na shpëtoi neve ose shtypshkronjës; pra, kërkojmë falje paraprakisht.



MË 9 TË TË NJËTIT MUAJ

Kujtimi i Dyzet Martirëve të mëdhenj e të shenjtë,
që u martirizuan në liqenin e Sevastisë.

Tipikon

1. Nëse bie në ditët e zakonshme të Triodhit para Kreshmëve të Mëdha:

Në Mbrëmësore, pas Qëndrimit të parë të Psaltirit (Lum ai njeri) Thirrtoret: 3 të shenjtorëve (në 6). Lavdi Martirët e konsideruan liqenin (kërkoje në Pasvargjet e Lavdërimeve, fq. 29). Tani Hyjlindësore ngjallësore (Shkoi hija e Ligjës). Hyrje. O dritë gazmore. Nëse do, thuaj Leximet e shën Gjergjit (23 prill, fq. 115). Pasvargjet: 3 të parat e Lavdërimeve (V'llezër, ejani që të himnojm' kërkoje në fq. 28) me Vargje në dy të fundit: Se na provove, o Perëndi, na flakërove si flakërohet argjendi; dhe Kaluam përmes zjarri dhe uji dhe na nxore në prehje. Lavdi O besnikë, le t'i mburrim (kërkoje në Pasvargjet, fq. 20). Tani Hyjlindësore ngjallësore (Zoti Krisht Bë-rësi). Përlëshorja e shenjtorëve dhe Hyjlindësore ngjallësore (Gabrieli kur të tha).

Në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmi 50, në vend të Litisë, Idhiomelet e Lavdërimeve (Një kor me dyzet pishtarë, fq. 28). Lavdi Profetikisht thërriste Davidi (kërkoje në Mëngjesore pas Psalmi 50, fq. 21). Tani Gjith' shpresën time e besoj te ti, o nën' e Perëndis', ruajmë nën strehën tënde. Trishenji. Përlëshorja e shenjtorëve.

Në Mëngjesore. Ndenjësoret dhe Ungjilli i shenjtoreve. Kanunet: i Hyjlindëses dhe i shenjtoreve (pa Irmoset e tyre). Pas Odes III, Ndenjësoret. Pas Odes VI, Kontaqi, Shtëpia dhe Sinaksari. Zbritësoret Ja gojën e çel tani. Dërgimësoret. Lavdërimet: 3 të parat (në 4). Lavdi si dhe Tani i tyre (O athloforët e Krishtit. Ty të lumërojmë; shih fq. 29). Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e shenjtoreve.

Në Liturgji (e Shën Joan Gojartit), Tipiket dhe nga Kanuni i shenjtoreve, Ode III dhe VI. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e shenjtoreve dhe e kishës. Kontaqi Mbrojtje e paturpëruar. Kungatore: Në kujtim të përrjetshëm.

2. Nëse bie të Shtunën e Shpirtrave:

Shërbesa e shenjtoreve psalet një ditë më parë, të premtën, së bashku me shërbesën e shën Theofilaktit.

3. Nëse bie të Dielën e të Lidhurit të Mishit ose të të Lidhurit të Djathit:

Të shtunën në Mbrëmësore. Thirrtoret: 4 ngjallësore, 3 të Triodhit dhe 3 të shenjtoreve. Lavdi i Triodhit. Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i shenjtoreve (O besnikë, le t' i mburrim; kërkoje në Pasvargjet, fq. 20). Tani i (Lavdisë së) Triodhit. Përlëshoret: ngjallësore, e shenjtoreve dhe Hyjlindësore ngjallësore (Gabrieli kur të tha).

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmi 50, Kanuni Triadik dhe, në vend të Litisë, Idhiomelet e Lavdërimeve të shenjtoreve (Një kor me dyzet pishtarë kërkoje në fq. 28). Lavdi si dhe Tani i Litisë së Triodhit. Himne Triadike. Trishenjtë. Përlëshorja e shenjtoreve. Në Mëngjesore. Ndenjësoret ngjallësore. Pas Polieleit (Psalmi 136) Ndenjësoret: e para e shenjtoreve (Yje që shkëlqeni fort; shih fq. 20) dhe ato pas Polieleit (Lavdi Le të mburrim tani xhevahir; shih fq. 21; Tani Strehën tënde të shpejt'; shih fq. 21). Bekimtoret. Ipakoia, Shkallesat dhe Proqimeni i Tingullit; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor të Triodhit. Kanunet: ngjallësor; i Triodhit dhe i shenjtoreve. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore. Ndenjësoret: e shenjtoreve, të Triodhit dhe Hyjlindësorja e tij. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Triodhit. Sinaksari i ditës dhe i Triodhit. Zbritësoret e Triodhit. Dërgimësoret: ngjallësore, të Triodhit dhe të shenjtoreve. Lavdërimet: 3 ngjallësore, 2 të Triodhit dhe 3 të parat e shenjtoreve (me Vargje në dy të fundit: Se na provove, o Perëndi, na flakërove si flakërohet argjendi; dhe Kaluam përmes zjarri dhe uji dhe na nxore në prehje). Lavdi i Triodhit. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji. Tipiket: 4 ngjallësore dhe 4 nga Ode VI e Triodhit. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e shenjtoreve dhe e kishës. Kontaqi i Triodhit. Kungatore: Lavdëroni (edhe Ngazëllohuni, o të drejtë).

4. Nëse bie të mërkurën ose të premten para së Dielës së të Lidhurit të Djathit:

Në Mbrëmësore, lexohet Qëndrimi i parë i Psaltirit (Lum ai njeri). Pas Proqimenit nëse do, thuaj Leximet e shën Gjergjit (fq. 115). Pasvargjet: 3 të parat e Lavdërimeve (V'llezër, ejani që të himnojm'; kërkoje në fq. 28, me Vargje në dy të fundit: Se na provove, o Perëndi, na flakërove si flakërohet argjendi; dhe Kaluam përmes zjarri dhe uji dhe na nxore në prehje). Lavdi O besnikë, le t'i mburrim (kërkoje në Pasvargjet fq. 20). Tani ngjallësor (O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë). Përlëshorja e shenjtoreve dhe Hyjlindësore ngjallësore (Gabrieli kur të tha).

Në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmi 50, në vend të Litisë, Idhiomelet e Lavdërimeve të shenjtoreve (Një kor me dyzet pishtarë; kërkoje në fq. 28). Lavdi Martirët e konsideruan liqenin (kërkoje në Pasvargjet e Lavdërimeve, fq. 29). Tani O portë e pakaluar (po aty). Trishenjtë. Përlëshorja. Në Mëngjesore Kanunet: i Hyjlindëses (shih fq. 382) dhe i shenjtoreve (pa Irmose). Zbritësoret: Ja gojën e çel tani. Lavdërimet: 3 të parat në 4 (V'llezër, ejani që të himnojm'; shih fq. 28). Lavdi dhe Tani i tyre (O athloforët e Krishtit; Ty të lumërojmë; shih fq. 29). Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja.

Në Liturgji. Tipiket dhe nga Kanuni i shenjtoreve, Ode III dhe VI. Kontaqi Mbrotjtje e paturpëruar. Kungatore: Në kujtim të përgjeshëm.

5. Nëse bie të shtunën para së Dielës së të Lidhurit të Djathit:

Të premten në Mbrëmësore, pas Qëndrimin të parë të Psaltirit (Lum ai njeri), Thirrtoret: 3 të shenjtoreve dhe 3 të oshënarëve. Lavdi i shenjtoreve. Tani ngjallësor (Shkoi hija e Ligjës). Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni. (Nëse do, thuaj Leximet e shën Gjergjit, shih fq. 115). Pasvargjet dhe Lavdi i oshënarëve. Tani O Zonjë, prit lutjet e shërbëtorëve të tu edhe çlirona ne nga çdo nevojë dhe pikëllim. Përlëshoret: e shenjtoreve, e oshënarëve dhe Hyjlindësorja e tyre.

Të shtunën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmi 50, në vend të Litisë, Idhiomelet e Lavdërimeve të shenjtoreve (Një kor me dyzet pishtarë; kërkoje në fq. 28). Lavdi Martirët e konsideruan liqenin (kërkoje në Pasvargjet e Lavdërimeve, fq. 29).

Tani O portë e pakaluar (po aty). Trishenjtë. Përlëshorja e shenjtoreve. Në Mëngjesore. Kanunet: i Hyjlindësës (shih fq. 382), i shenjtoreve (pa Irmoset) dhe i oshënarëve. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e oshënarëve dhe Ndenjësoret: e shenjtoreve dhe të oshënarëve me Hyjlindësoren e tyre. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtoreve. Sinaksari i ditës dhe i shenjtoreve. Dërgimësoret: e shenjtoreve dhe të oshënarëve. Lavdërimet: 3 të parat e shenjtoreve dhe 3 të oshënarëve. Lavdi si dhe Tani i shenjtoreve. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e shenjtoreve.

Në Liturgji (e Shën Joan Gojartit), Tipiket dhe nga Kanuni i shenjtoreve, Ode III dhe të oshënarëve Ode VI. Kontaqi Mbrojtje e paturpëruar. Apostulli i shenjtoreve dhe Ungjilli i oshënarëve. Kungatore: Në kujtim të përjetshëm.

6. Nëse bie të hënë e Javës së Parë të Kreshmëve të Mëdha:

Shërbesa transferohet dhe psalet një ditë më parë, pra psalet së bashku me shërbesën e së Dielës së të Lidhurit të Djathit, siç është në § 3.

7. Nëse bie të martën e Javës së Parë të Kreshmëve të Mëdha:

Të hënë në Mbrëmësore. Thirrtoret: 3 të Triodhit dhe 3 të shenjtoreve. Lavdi dhe Tani Hyjlindësore (Duke dashur unë) O dritë gazmore. Leximet e Triodhit. Pasvargjet e Triodhit. Tani përlëshojë. Gëzohu, o Hyjlindëse Virgjëreshë Hirplote etj.

Të martën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, në vend të Litisë, Idhiomelet e Lavdërimeve të shenjtoreve (Një kor me dyzet pishtarë; kërkoje në fq. 28). Lavdi Martirët e konsideruan liqenin (kërkoje në Pasvargjet e Lavdërimeve, fq. 29). Tani O portë e pakaluar (po aty). Trishenjtë. Përlëshorja e shenjtoreve. Në Mëngjesore, pas Perëndi është Zoti, Përlëshorja e shenjtoreve (2x) dhe Hyjlindësorja ngjallësore (Gabrieli kur të tha). Të gjitha sipas rendit të shenjtoreve. Kanunet: i Hyjlindësës (shih fq. 382) dhe i shenjtoreve (pa Irmoset). Zbritësoret Ja gojën e çel tani. Lavdërimet: 3 të parat e shenjtoreve (në 4). Lavdi si dhe Tani po të Lavdërimeve. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e shenjtoreve. Në Orët (e Thjeshta) Përlëshorja dhe Kontaqi i shenjtoreve. Pas Orës VI, Përlëshim. Në Orën IX, pas Lumërimeve: Kori qiellor etj. Besoj në një Perëndi. Urata: O Perëndi, lër, fal. Ati ynë. Se jotja është. Kontaqi i shenjtoreve. Mëshiro, o Zot (40x). O Perëndi, që adhurohesh. Më të nderuarën. Beko, o atë. Perëndia na dhembshuroftë. Tri

Metanitë e Mëdha. Trishenji. Mëshiro, o Zot (12x). Urata: O Trini e Tërëshenjtë, që je pushteti. Përlëshimi, dhe fillon Liturgjia e të Parashenjtëruarave:

Në Mbrëmësore, Thirrtoret: Idhiomeli i (Pasvargjeve të) Triodhit (2x), Martiriku, 3 Thirrtoret e Triodhit dhe 4 të shenjtorëve (Duke duruar të tanishmet; kërkoji në Mbrëmësoren e së djeshmes, fq. 19). Lavdi i tyre dhe Tani Kryqhyjlindësore e të njëjtit Tingull “Ote ek tu ksilu se”: Shqerra, kur mbi kryq të shihte ty,* qengjin e saj, Zotin me gozhdë të shpoheshe, me habi* po përlotej dhe me klithma thoshte: Biri im,* si po vdes, se do që të grisësh ti dorëshkrimin [Kol. 2.14]* e Adamit, dhe gjith’ njerëzinë ta çlirosh?* Ndaj unë lëvdoj mirësinë* dhe ekonomin’ tënde, o Krisht,* njeridashës si dhe zemërgjer’ Jisu. Hyrje me Ungjillin. O dritë gazmore. Leximet e Triodhit. Le të drejtohet. Bekimi i bukëve dhe Të pasurit janë varfëruar. Menjëherë Apostulli dhe Ungjilli i shenjtorëve dhe Liturgjia e të Parashenjtëruarave. Kungatore: Në kujtim të përjetshëm.*

8. Nëse bie të mërkurën e Javës së Parë ose të Dytë të Kreshmëve të Mëdha:

Të martën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 3 të Triodhit dhe 3 të shenjtorëve. Lavdi dhe Tani Kryqhyjlindësore e të njëjtit Tingull “Ote ek tu ksilu se”: Shqerra, kur mbi kryq të shihte ty,* qengjin e saj, Zotin me gozhdë të shpoheshe, me habi* po përlotej dhe me klithma thoshte: Biri im,* si po vdes, se do që të grisësh ti dorëshkrimin [Kol. 2.14]* e Adamit, dhe gjith’ njerëzinë ta çlirosh?* Ndaj unë lëvdoj mirësinë* dhe ekonomin’ tënde, o Krisht,* njeridashës si dhe zemërgjer’ Jisu. Nuk bëhet Hyrje. O dritë gazmore. Leximet, Pasvargjet, Lavdi dhe Tani, të gjitha nga Triodhi. Tani përlëshoje. Trishenji. Përlëshore e shenjtorëve dhe menjëherë Gëzohu, o Hyjlindëse Virgjëreshë Hirplote etj.*

Të mërkurën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, në vend të Litisë, Idhiomelet e Lavdërimeve të shenjtorëve (Një kor me dyzet pishtarë; kërkoje në fq. 28). Lavdi Martirët e konsideruan liqenin (kërkoje në Pasvargjet e Lavdërimeve, fq. 29). Tani O portë e pakaluar (po aty). Trishenji. Përlëshorja e shenjtorëve. Në Mëngjesore, pas Perëndi është Zoti, Përlëshorja e shenjtorëve (2x) dhe Hyjlindësore ngjallësore (Gabrieli kur të tha). Ndenjësoret, Ungjilli etj. të shenjtorëve. Kanunet: i Hyjlindësës (shih fq. 382) dhe i shenjtorëve. Zbritësoret Ja gojën e çel tani etj. Dhoksologjia e Madhe. Në Orët (e Thjeshta) Përlëshorja dhe Kontaqi i shenjtorëve. Pas Orës VI, Përlëshim. Në Orën IX, pas Lumërimeve: Kori qiellor

etj. Besoj në një Perëndi. *Urata*: O Perëndi, lër, fal. Ati ynë. Se jotja është. *Kontaqi i shenjtorëve*. Mëshiro, o Zot (40x). O Perëndi, që adhurohesh. Më të nderuarën. Beko, o atë. Perëndia na dhembshuroftë. *Tri Metanitë e Mëdha. Trishenjtë*. Mëshiro, o Zot (12x). *Urata*: O Trini e Tërëshenjtë, që je pushteti. *Përlëshimi dhe fillon Liturgia e të Parashenjtëruarave*:

Në Mbrëmësore, Thirrtoret: Idhiomeli i Triodhit (2x), Martiriku, 3 po të Triodhit dhe 3 të shenjtorëve në 4 (Duke duruar të tanishmet kërkoji në Mbrëmësoren e së djeshmes, fq. 19). *Lavdi* O besnikë, le t'i mburrim (kërkoje në Pasvargjet po në Mbrëmësoren e djeshme, fq. 20). *Tani* Duke dashur unë mizorisht (kërkoje në Thirrtoret e së djeshmes, fq. 19). *Hyrje me Ungjillin*. O dritë gazmore. *Leximet e Triodhit*. Le të drejtohet dhe menjëherë Apostulli dhe Ungjilli i shenjtorëve dhe Liturgia e të Parashenjtëruarave. *Kungatore*: Në kujtim të përgjeshëm.

9. Nëse bie të enjten e Javës së Parë e të Dytë të Kreshmëve të Mëdha:

Të mërkurën në Mbrëmësore, Thirrtoret: Idhiomeli (2x), Martiriku, 3 po të Triodhit dhe 4 të shenjtorëve. *Lavdi* si dhe *Tani* i shenjtorëve. *Hyrje*. O dritë gazmore. *Leximet*. Le të drejtohet dhe Liturgia e të Parashenjtëruarave. *Kungatore*: Shijoni.

Të enjten, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, në vend të Litisë, Idhiomeli e Lavdërimeve të shenjtorëve (Një kor me dyzet pishtarë; kërkoje në fq. 28). *Lavdi* Martirët e konsideruan liqenin (kërkoje në Pasvargjet e Lavdërimeve, fq. 29). *Tani* O portë e pakaluar (po aty). *Trishenjtë*. *Përlëshorja e shenjtorëve*. Në Mëngjesore, pas Perëndi është Zoti, Përlëshorja e shenjtorëve (2x) dhe *Hyjlindësore ngjallësore* (Gabrieli kur të tha). *Ndenjësoret, Ungjilli etj. të shenjtorëve*. *Kanunet*: i Hyjlindëses (shih fq. 382) dhe i shenjtorëve. *Zbritësoret* Ja gojën e çel tani etj. *Dhoksologjia e Madhe*. Në Orët (e Thjeshta) Përlëshorja dhe Kontaqi i shenjtorëve. *Pas Orës VI, Përlëshim*. *Në Orën IX, pas Lumërimeve*: Kori qiellor etj. Besoj në një Perëndi. *Urata*: O Perëndi, lër, fal. Ati ynë. Se jotja është. *Kontaqi i shenjtorëve*. Mëshiro, o Zot (40x). O Perëndi, që adhurohesh. Më të nderuarën. Beko, o atë. Perëndia na dhembshuroftë. *Tri Metanitë e Mëdha. Trishenjtë*. Mëshiro, o Zot (12x). *Urata*: O Trini e Tërëshenjtë, që je pushteti. *Përlëshimi, dhe fillon Liturgia e të Parashenjtëruarave*:

Në Mbrëmësore, Thirrtoret: Idhiomeli (i Pasvargjeve) (2x), Martiriku, 3 po të Triodhit (Thirrtoret) dhe 4 të shenjtorëve (Duke duruar të tanishmet; kërkoji në

fq. 19). Lavdi O besnikë, le t'i mburrim (kërkoje në Pasvargjet fq. 20). Tani Kryq-hyjlindësore e të njëjtit Tingull "Triúmeros anestis": Të pa e paqortueshmja, Krisht, kur ishe varur përmbi kryq* dhe thërriste* si nën' me vajtime thell':* O Biri im i ëmbël, o Zoti im, mos e lër* shërbyesen tënde, mos më braktis. Hyrje me Ungjillin. O dritë gazmore. Leximet. Le të drejtohet dhe menjëherë Apostulli dhe Ungjilli i shenjtoreve dhe Liturgia e të Parashenjtëruarave. Kungatore: Në kujtim të përgjeshëm.*

10. Nëse bie të premten e Javës së Parë të Kreshmëve të Mëdha:

Të enjten në Mbrëmësore, Thirrtoret: 3 të Triodhit dhe 3 të shenjtoreve. Lavdi dhe Tani Kryqhyjlindësore e të njëjtit Tingull, "Ote ek tu ksilu se": Shqerra, kur mbi kryq të shihte ty,* qengjin e saj, Zotin me gozhdë të shpoheshe, me habi* po përlotej dhe me klithma thoshte: Biri im,* si po vdes, se do që të grisësh ti dorëshkrimin [Kol. 2.14]* e Adamit, dhe gjith' njerëzinë ta çlirosh?* Ndaj unë lëvdoj mirësinë* dhe ekonomin' tënde, o Krisht,* njeridashës si dhe zemërgjer' Jisu. Nuk bëhet Hyrje. O dritë gazmore. Leximet, Pasvargjet, Lavdi dhe Tani, të gjitha nga Triodhi. Tani përlëshoje. Trishenjtë. Përlëshore e shenjtoreve dhe menjëherë Gëzohu, o Hyjlindëse Virgjëreshë Hirplote etj.*

Të premten në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, në vend të Litisë, Idhiomelet e Lavdërimeve të shenjtoreve (Një kor me dyzet pishtarë; kërkoje në fq. 28). Lavdi Martirët e konsideruan liqenin (kërkoje në Pasvargjet e Lavdërimeve, fq. 29). Tani O portë e pakaluar (po aty). Trishenjtë. Përlëshorja e shenjtoreve. Në Mëngjesore, pas Perëndi është Zoti, Përlëshorja e shenjtoreve (2x) dhe Hyjlindësore ngjallësore (Gabrieli kur të tha). Ndenjësoret, Ungjilli etj. të shenjtoreve. Kanunet: i Hyjlindësës (shih fq. 382) dhe i shenjtoreve. Zbritësoret Ja gojën e çel tani etj. Dhoksologjia e Madhe. Në Orët (e Thjeshta) Përlëshorja dhe Kontaqi i shenjtoreve. Pas Orës VI, Përlëshim. Në Orën IX, pas Lumërimeve: Kori qiellor etj. Besoj në një Perëndi. Urata: O Perëndi, lër, fal. Ati ynë. Se jotja është. Kontaqi i shenjtoreve. Mëshiro, o Zot (40x). O Perëndi, që adhurohesh. Më të nderuarën. Beko, o atë. Perëndia na dhembshuroftë. Tri Metanitë e Mëdha. Trishenjtë. Mëshiro, o Zot (12x). Urata: O Trini e Tërëshenjtë, që je pushteti. Përlëshimi, dhe fillon Liturgia e të Parashenjtëruarave:

Në Mbrëmësore, Thirrtoret: Idhiomeli (2x), 4 të shenjtoreve dhe 4 të shën Theodorit. Lavdi i shenjtoreve (O besnikë, le t'i mburrim; kërkoje në Pasvargjet fq. 20). Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës. Hyrje me Ungjillin.

O dritë gazmore. *Leximet*. Le të drejtohet dhe menjëherë Apostulli dhe Ungjilli i shenjtoreve dhe Liturgia e të Parashenjtëruarave. Kungatore: Në kujtim të përvetshëm. Në Himnin Akathist (I), Kontaqi i shën Theodhorit.

11. Nëse bie të shtunën e Javës së Parë të Kreshmëve të Mëdha:

Të premten në Mbrëmësore, Thirrtores: Idhiomeli (2x), 4 të shenjtoreve dhe 4 të shën Theodhorit. Lavdi i shën Theodhorit. Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. *Leximet*. Le të drejtohet dhe Liturgia e të Parashenjtëruarave. Kungatore: Shijoni. Në Himnin Akathist (I) Kontaqi i shenjtoreve (Si braktisët çdo ushtri; kërkoje në fq. 24).

Të shtunën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, në vend të Litisë, Idhiomelet e Lavdërimeve të shenjtoreve (Një kor me dyzet pishtarë; kërkoje në fq. 28). Lavdi Martirët e konsideruan liqenin (kërkoje në Pasvargjet e Lavdërimeve, fq. 29). Tani O portë e pakaluar (po aty). Trishenjtë. Përlëshorja e shenjtoreve. Në Mëngjesore, pas Perëndi është Zoti, Përlëshoret: e shenjtoreve, e shën Theodhorit dhe Hyjlindësorja e tij. Ndenjësoret: Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësoret e shenjtoreve; pas Stihologjisë së dytë, të shën Theodhorit. Pas Polieleit, të shenjtoreve. Shkallesat. Proqimeni dhe Ungjilli i shenjtoreve. Kamunet: i pari i Triodhit dhe i shenjtoreve. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e Triodhit dhe Ndenjësoret: e shenjtoreve dhe të Triodhit. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtoreve. Sinaksari i ditës dhe i Triodhit. Zbritësoret Ja gojën e çel tani (në Oden IV, Ti që rri midis lavdisë). Dërgimësoret: e shenjtoreve dhe të Triodhit. Lavdërimet: 3 të shenjtoreve dhe 3 të Triodhit. Lavdi si dhe Tani i shenjtoreve. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e shën Theodhorit.

Në Liturgji, Tipiket dhe Lumërimet: 4 nga Ode III e shenjtoreve dhe 4 nga Ode VI e Triodhit. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e shenjtoreve, e shën Theodhorit dhe e kishës. Kontaqi Mbrojtje e paturpëruar. Apostulli i Triodhit dhe Ungjilli i shenjtoreve. Kungatore: Në kujtim të përvetshëm.

12. Nëse bie të dielën e Javës së Parë ose të Dytë, ose të Tretë të Kreshmëve të Mëdha:

Të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtores: 4 të tingullit, 3 të Triodhit dhe 3 të shenjtoreve. Lavdi i Triodhit. Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i shenjtoreve

(Profetikisht thërriste Davidi; *kërkoje në Mëngjesore pas Psalmit 50, fq.21*). Tani: *të Dielën e parë ose të tretë: i (Lavdisë së) Triodhit, ndërsa të Dielën e dytë, Hyjlindësore ngjallësore (O çudi e re). Përlëshoret: ngjallësore, e shenjtorëve dhe Tani: të Dielën e parë ose të tretë, Përlëshoret e tyre në vend të Hyjlindësoreve, ndërsa të Dielën e dytë Hyjlindësore ngjallësore (Gabrieli kur të tha).*

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanuni Triadik dhe, në vend të Litisë së shenjtorëve, Idhiomelet e Lavdërimeve të tyre (Një kor me dyzet pishtarë; kërkoje në fq. 28). Lavdi i shenjtorëve O besnikë, le t'i mburrim (kërkoje në Pasvargjet e Mbrëmësore fq. 20). Tani: të Dielën e parë ose të tretë, i (Lavdisë së) Litisë së Triodhit, ndërsa të Dielën e dytë Hyjlindësore e të njëjtit Tingull: O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë, që nxore frytin e jetës; të lypim, ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me athloforët dhe me gjithë shenjtorët, që të mëshirohen shpirtrat tanë. Himne Triadike. Trishenjti. Përlëshorja: të Dielën e parë ose të tretë, Përlëshoret e tyre, ndërsa të Dielën e dytë Përlëshorja e shenjtorëve. Në Mëngjesore, Ndenjësore ngjallësore dhe pas Polieleit, Ndenjësoret (pas Polieleit) e shenjtorëve (të Dielën e tretë, në vend të Hyjlindësoreve së shenjtorëve, Ndenjësoerja pas Polieleit të së Dielës). Bekimtoret. Ipakoia, Shkallesat dhe Proqimeni i Tingullit. Kanunet: ngjallësor, i shenjtorëve dhe i Triodhit (të Dielën e tretë: vetëm i shenjtorëve dhe i Triodhit). Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore. Ndenjësoret: e Triodhit dhe të shenjtorëve. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Triodhit. Sinaksari i ditës dhe i Triodhit. Zbritësoret: të Dielën e parë ose të tretë: të Triodhit; ndërsa të Dielën e dytë, Ja gojën e çel tanë. Dërgimësoret: ngjallësore, e Triodhit dhe të shenjtorëve. Lavdërimet: të Dielën e parë ose të tretë: 2 ngjallësore, 3 të Triodhit dhe 3 të shenjtorëve, ndërsa të Dielën e dytë: 2 ngjallësore, 3 të shenjtorëve dhe 3 të Triodhit. Lavdi i Triodhit. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, të Dielën e parë ose të tretë, Antifonet e tyre, ndërsa të Dielën e dytë, Tipiket dhe Lumërimet: 4 ngjallësore dhe 4 nga Ode VI e shenjtorëve. Pas Hyrjes, Përlëshoret: të Dielën e parë ose të tretë, ngjallësore, e Triodhit, e shenjtorëve dhe e kishës, ndërsa të Dielën e dytë, ngjallësore, e shenjtorëve, e Triodhit dhe e kishës. Kontaqi Përlufteshës. Apostulli i shenjtorëve dhe Ungjilli i së Dielës. Kungatore: Lavdëroni, por të Dielën e tretë, U shënua mbi ne drita e fytyrës sate, o Zot. Aliluia. Pamë dritën, por të Dielën e tretë, O Zot, shpëto popullin tënd.

13. Nëse bie të hënën e Javës së Dytë ose të Tretë

të Kreshmëve të Mëdha:

Të dielën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 3 të Triodhit dhe 3 të shenjtorëve. Lavdi Martirët e konsideruan liqenin (kërkoje në Pasvargjet e Lavdërimeve, fq. 29). Tani Duke dashur unë mizorisht (kërkoje në Thirrtoret, fq. 19). Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i Madh. Pasvargjet: Idhiomeli (2x) dhe Martiriku. Lavdi (Profetikisht thërriste Davidi; kërkoje në Mëngjesore pas Psalmit 50, fq. 21). Tani Gjith' shpresën time (kërkoje në §1, në Mesnatë). Trishenjtë. Përlëshoret: e shenjtorëve, Lavdi dhe Tani Hyjlindësore ngjallësore (Gabrieli kur të tha). Përlëshim. (Gëzohu, o Hyjlindëse Virgjëreshë Hirplote etj. nuk psalen, sepse të nesërmen do të kryhet Liturgjia e të Parashenjtëruarave).

Të hënën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, në vend të Litisë, Idhiomelet e Lavdërimeve të shenjtorëve (Një kor me dyzet pishtarë; kërkoje në fq. 28). Lavdi Martirët e konsideruan liqenin (kërkoje në Pasvargjet e Lavdërimeve, fq. 29). Tani O portë e pakaluar (po aty). Trishenjtë. Përlëshorja e shenjtorëve. Në Mëngjesore, pas Perëndi është Zoti, Përlëshorja e shenjtorëve (2x) dhe Hyjlindësore ngjallësore (Gabrieli kur të tha). Ndenjësoret, Ungjilli etj. të shenjtorëve. Kanunet: i Hyjlindëses (shih fq. 382) dhe i shenjtorëve. Zbritësoret Ja gojën e çel tani etj. Dhoksologjia e Madhe. Në Orët (e Thjeshta) Përlëshorja dhe Kontaqi i shenjtorëve. Pas Orës VI, Përlëshim. Në Orën IX, pas Lumërimeve: Kori qiellor etj. Besoj në një Perëndi. Urata: O Perëndi, lër, fal. Ati ynë. Se jotja është. Kontaqi i shenjtorëve. Mëshiro, o Zot (40x). O Perëndi, që adhurohesh. Më të nderuarën. Beko, o atë. Perëndia na dhembshuroftë. Tri Metanitë e Mëdha. Trishenjtë. Mëshiro, o Zot (12x). Urata: O Trini e Tërëshenjtë, që je pushteti. Përlëshimi dhe fillon Liturgjia e të Parashenjtëruarave:

Në Mbrëmësore, Thirrtoret: Idhiomeli i Triodhit (2x), Martiriku, 3 po të Triodhit dhe 3 të shenjtorëve në 4 (Duke duruar të tanishmet; kërkoji në Mbrëmësoren e së djeshmes, fq. 19). Lavdi O besnikë, le t'i mburrim (kërkoje në Pasvargjet po në Mbrëmësoren e djeshme, fq. 20). Tani Duke dashur unë mizorisht (kërkoje në Thirrtoret e së djeshmes, fq. 19). Hyrje me Ungjillin. O dritë gazmore. Leximet e Triodhit. Le të drejtohet dhe menjëherë Apostulli dhe Ungjilli i shenjtorëve dhe Liturgjia e të Parashenjtëruarave. Kungatore: Në kujtim të përjetshëm.

**14. Nëse bie të martën e Javës së Dytë ose të Tretë
të Kreshmëve të Mëdha:**

Të hënë në Mbrëmësore. Thirrtores: 3 të Triodhit dhe 3 të shenjtoreëve. Lavdi dhe Tani Kryqhyjlindësore e të njëjtit Tingull “Ote ek tu ksilu se”: Shqerra,* kur mbi kryq të shihte ty,* qengjin e saj, Zotin me gozhdë të shpoheshe, me habi* po përlotej dhe me klithma thoshte: Biri im,* si po vdes, se do që të grisësh ti dorëshkrimin [Kol. 2.14]* e Adamit, dhe gjith’ njerëzinë ta çlirosh?* Ndaj unë lëvdoj mirësinë* dhe ekonomin’ tënde, o Krisht,* njeridashës si dhe zemërgjer’ Jisu. *Nuk bëhet Hyrje.* O dritë gazmore. *Leximet, Pasvargjet, Lavdi dhe Tani, të gjitha nga Triodhi.* Tani përlëshoje. *Trishenjtë. Përlëshore e shenjtoreëve dhe menjëherë* Gëzohu, o Hyjlindëse Virgjëreshë Hirplote etj.

Të martën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, në vend të Litisë, *Idhiomelet e Lavdërimeve të shenjtoreëve* (Një kor me dyzet pishtarë; *kërkoje në fq. 28*). Lavdi Martirët e konsideruan liqenin (*kërkoje në Pasvargjet e Lavdërimeve, fq. 29*). Tani O portë e pakaluar (*po aty*). *Trishenjtë. Përlëshorja e shenjtoreëve. Në Mëngjesore,* pas Perëndi është Zoti, *Përlëshorja e shenjtoreëve (2x) dhe Hyjlindësore ngjallësore* (Gabrieli kur të tha). *Ndenjësoret, Ungjilli etj. të shenjtoreëve. Kanunet: i Hyjlindësës (shih fq. 382) dhe i shenjtoreëve. Zbritësoret* Ja gojën e çel tani etj. *Dhoksologjia e Madhe. Në Orët (e Thjeshta) Përlëshorja dhe Kontaqi i shenjtoreëve. Pas Orës VI, Përlëshim. Në Orën IX, pas Lumërimeve:* Kori qiellor etj. Besoj në një Perëndi. *Urata:* O Perëndi, lër, fal. Ati ynë. Se jotja është. *Kontaqi i shenjtoreëve. Mëshiro, o Zot (40x).* O Perëndi, që adhurohesh. Më të nderuarën. Beko, o atë. Perëndia na dhembshuroftë. *Tri Metanitë e Mëdha. Trishenjtë. Mëshiro, o Zot (12x).* *Urata:* O Trini e Tërëshenjtë, që je pushteti. *Përlëshimi, dhe fillon Liturgjia e të Parashenjtëruarave:*

Në Mbrëmësore. Thirrtores: *Idhiomeli i Pasvargjeve (2x), Martiriku, 3 Thirrtores po të Triodhit dhe 4 të shenjtoreëve. Lavdi i shenjtoreëve* (Profetakisht thërriste Davidi; *kërkoje në Mëngjesore pas Psalmit 50, fq. 21*). Tani Kryqhyjlindësore e të njëjtit Tingull “Ote ek tu ksilu se”: Shqerra,* kur mbi kryq të shihte ty,* qengjin e saj, Zotin me gozhdë të shpoheshe, me habi* po përlotej dhe me klithma thoshte: Biri im,* si po vdes, se do që të grisësh ti dorëshkrimin [Kol. 2.14]* e Adamit, dhe gjith’ njerëzinë ta çlirosh?* Ndaj unë lëvdoj mirësinë* dhe ekonomin’ tënde, o Krisht,* njeridashës si dhe zemërgjer’ Jisu. *Hyrje me Ungjillin.* O dritë gazmore. *Leximet.*

Le të drejtohet dhe menjëherë Apostulli dhe Ungjilli i shenjtorëve, si dhe Liturgia e të Parashenjtëruarave. Kungatore: Në kujtim të përjetshëm.

15. Nëse bie të premten e Javës së Dytë të Kreshmëve të Mëdha:

Shërbesa është njësoj me shërbesën e së premtes së parë të Kreshmëve (§10), por në Thirrtoret e Mbrëmësore të së premtes: Idhiomeli (2x), 4 Martirike të Tingullit po nga Triodhi dhe 4 të shenjtorëve. Në Himnin Akathist (II) Kontaqi: Je mbjellës i Krijesës, Zot, ndaj bota të ofron porsì flijim, apark' prej natyrës, martirë shën hyjmbajtës; përmes lutjeve, përgjërimit të tyre, ruaj, o i mëshirshëm, në paqe shumë' të thellë Kishën tënde me ndërmjetimet, pra, të Hyjlindëses.

16. Nëse bie të shtunën e Javës së Dytë të Kreshmëve të Mëdha:

Të Premten në Mbrëmësore, Thirrtoret: Idhiomeli (2x), Martiriku, 4 Martirikë të Tingullit të javës dhe 4 të shenjtorëve. Lavdi i tyre. Tani Hyjlindësore ngjallësore e Tingullit (që po kalon). Hyrje. O dritë gazmore. Le të drejtohet dhe Liturgia e të Parashenjtëruarave. Kungatore: Shijoni. Në Himnin Akathist (II) Kontaqi i shenjtorëve.

Të shtunën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, në vend të Litisë, Idhiomelet e Lavdërimeve të shenjtorëve bashkë me Lavdi dhe Tani i tyre (Një kor me dyzet pishtarë etj., fq. 28). Trishenji. Përlëshorja e shenjtorëve. Në Mëngjesore, pas Perëndi është Zoti, Përlëshorja e shenjtorëve (2x) dhe Hyjlindësore ngjallësore (Gabrieli kur të tha). Ndenjësoret, Shkallesat etj. Kanunet: i Hyjlindëses («Popuj të gjithë, ejani dhe O e pacen etj. kërkoji në 30 janar, fq. 328) dhe i shenjtorëve. Pas Odes III dhe VI sipas Mujorit, Zbritësoret Ja gojën e çel tani. Më të nderuarën. Dërgimësoret e Mujorit. Lavdërimet: 3 të parat në 4. Lavdi dhe Tani, po i Lavdërimeve. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e shenjtorëve.

Në Liturgji, pas Hyrjes, Përlëshoret: e shenjtorëve dhe e kishës. Kontaqi Mbrojtje e paturpëruar. Apostulli dhe Ungjilli i shenjtorëve. Kungatore: Në kujtim të përjetshëm.



NË MBRËMËSORE

*10 Thirrtore: Idhiomeli i ditës (2x),
Martiriku, 3 po të Triodhit dhe
4 Idhiomelet e shenjtorëve:*

Ting. II I Joan Monakut

Duke duruar të tanishmet me trimëri, duke u ngazëlluar për të shpresuarat,¹ i thoshin njëri-tjetrit martirët e shenjtë: Mos vallë po zhvishemi nga kjo rrobë? Por hedhim tej njeriun e vjetër.² I egër është dimri, por e ëmbël Parajsa; e dhimbshme ngrirja, por i këndshëm shijimi; prandaj të mos përulemi, o bashkushtarë; le të durojmë pak, që të marrim kurorat e fitores nga Krishti Perëndi dhe Shpëtimtari i shpirtrave tanë.

(2x)

I të njëjtit

Duke i hedhur poshtë të gjitha rrobat, duke shkuar pa u trembur në liqen, i thoshin njëri-tjetrit martirët e shenjtë: Për hir të Parajsës që humbëm, le të mos mbajmë sot rrobë të prishshme; meqenëse u veshëm dikur për shkak të gjarprit prishës,³ le të zhvishemi tani për hir të ngjalljes së të gjithëve; le të shpërfillim një të ftohtë që kalon dhe le të urrejmë mishin, që të marrim kurorat e fitores nga Krishti Perëndi dhe Shpëtimtari i shpirtrave tanë.

I të njëjtit

Duke i parë torturat si dëfrime, duke vrapuar për në liqen të ftohtë si drejt së ngrohtës, martirët e shenjtë thoshin: Të mos druajmë stinë dimërore, që të shmangim Gjehenën e frikshme të zjarrit;⁴ u djegtë këmba, që të kërcejë përgjithmonë, ndërsa dora kulloftë, që të lartësohet drejt Zotit, dhe mos e kursefshim natyrën që vdes; preferofshim vdekje, që të marrim kurorat e fitores nga Krishti Perëndi dhe Shpëtimtari i shpirtrave tanë.

Lavdi *Të parin* (Duke duruar)

Tani *Hyjlindësore*
Ote ek tu ksilu se

Duke* dashur, unë mizorisht* nga veprat dhe punët e errëta⁵ u rrëmbeva, kështu* nxiva gjithë bukurin' e pagëzimit tim* edhe vesha stoli qortimi, terri; prandaj lyp,* o e tërë-paqortueshme, shpërndaji ti* retë e pasioneve që kam* dhe me petk paprishjeje vishmë*⁶ mua që u zhvesha dhe shpëtomë ti.

*Hyrje dhe Liturgjia
e të Parashenjtëruarave.*

*Ndërsa kur nuk ka Liturgji, në
Pasvargje psalim Idhiomelin e ditës
(2x) dhe Martirikun.*

Lavdi *I shenjtorëve*
Ting. Tërth. II

O besnikë, le t'i mburrim me ode këngësh athloforët, dyzet martirët, dhe le t'u thërrasim melodikisht duke thënë: Gëzohuni, o athloforët e Krishtit, Isih, Meliton, Irakli, Smaragdh, Dhomn, Evnoik, Ual, Vivian, Klaud dhe Prisk; gëzohuni, Theodhul, Eftih, Joan, Ksanth, Ilian, Sisin, Qirion, Agjia, Aet dhe Flav; gëzohuni, Akaq, Ekdhik, Lisimah, Aleksandër, Ilia, Kaudhidh, Theofil, Dhometian, Gaj i hyjshëm dhe Gorgon; gëzohuni, Eftih, Athanas, Qiril, Sakerdhon, Nikola, Ualer, Filoktimon, Sevirian, Hudhion dhe Aglai; duke pasur guxim para Krishtit Perëndisë tonë, o martirë të tërëkënduar, ndërmjetoni vazhdimisht tek ai, që të shpëtohen ata që festojnë me besim kujtimin tuaj të gjithënderuar.

Tani *Hyjlindësore*

O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë,^{6a} që nxore frytin e jetës; të lypim, ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me athloforët dhe me gjithë shenjtorët, që të mëshirohen shpirtat tanë.

Përlëshore
Ting. I

Të ardhhtë keq për dhimbjet e shenjtorëve, të cilët pësuan për ty,⁷ o Zot,

dhe shëro gjithë dhimbjet tona, o njeridashës, të lutemi.

Gëzohu, o Hyjlindëse Virgjëreshë
Hirplote *etj.*

Tri Metanitë e Mëdha dhe Përlëshim.



NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore
Ting. IV Epefanis símeron

Yje që shkëlqeni fort,* famëmëdhenj ju,* qiellin me nder, respekt,* të Kishës sonë përgjithnjë* dhe besimtarët i shndritni krejt,* dyzet martirë të hyjshëm të Krishtit Zot.

Lavdi *dhe Tani Hyjlindësore*

Prite lutjen tonë, se* nën strehën tënde,* e dëlirë, Virgjëreshë*, përikim ne dhe mos pusho* së ndërmjetuari te yt Bir,* që të shpëtojn' shërbëtorët e tu gjithnjë.

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore
Ting. IV O ipsothis en to stavró

O të çuditshmit fort* dyzet athloforë* të urtë, morët ju* përsipër dëshminë* me burrëri, qëndrim, guxim, përmes ujit si* edhe zjarrit,⁸ dhe në hapësir',*

në shpëtim dolët, morët pra* mbretë-
ri në qiej lart* porsì trashëgimtarë;*⁹
pareshtur lutuni për gjithë ne* që ju
himnojmë* dhe Krishtin e madhë-
rojm’.

Lavdi *dhe* Tani

Hyjlindësore

Që të të thurin himn,* gjithnjë të
kërkojnë,* Perëndilindëse,* me gaz
dhe nga zemra,* dhuroju shërbë-
torëve të tu përdëllim,* se thërresin
dhe të thonë ty:* Virgjëreshë e shenj-
të,* eja shpejt dhe na çliro* nga armiq
të padukshëm* dhe nga të dukshëm,
nga çdo kërcënim,* se je përkrahja,*
mbështetja dhe ndihma jon’.

Pas Polieleit, Ndenjësores

Ting. Tërth. I Ton sinánarhon Logon

Le të mburrim tani xhevahir shenj-
torësh ne,* grupin e dyzet martirëve
që u mblodhën hyjnisht,* që prej Zotit
u kurorëzuan si të urt’,* se në të ftohtë
akull, ngric’* dhe në zjarr fort u provu-
an, edhe kështu ushtarë* të tër’mbre-
tit Krisht¹⁰ u dëftuan dhe ndërmjetojnë
të shpëtohem.

Lavdi *dhe* Tani

Hyjlindësore

Strehën tënde të shpejt’, ndihmën,
përdëllimin tënd* te shërbëtori yt,
mua pra m’i trego, Zonjë ti,* zbuti

edhe dallgët e mendimeve që kam,*
meqë të kota janë krejt;* shpirtin tim
që ra, ma ngri, Hyjlindëse Virgjëre-
shë,* se e di unë mirë, mundesh t’i
bësh të gjitha lehtësisht sa ti do.^{10a}

Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV

Proqimeni Ting. IV

Kaluam përmes zjarri dhe uji dhe na
nxore në prehje.

Varg: Na flakërove si flakërohet ar-
gjendi.

Ungjilli. Psalmi 50.

Lavdi. Me ndërmjetimet e athloforëve.
Tani. Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.
Përdëllemë, o Perëndi. *Dhe Idhiomeli.*

Ting. II I Qiprian Monakut

Profetikisht thërriste Davidi te Psal-
met: “Kaluam përmes zjarri dhe uji
dhe na nxore në prehje”; dhe ju, o mar-
tirët e Krishtit, duke përmbushur thë-
nien me vetë punët, kaluat përmes
zjarri dhe uji dhe hytë në mbretërinë
e qiejve; prandaj ndërmjetoni, ju që
jeni dyzet atletë, të na dhurohet për-
dëllimi i madh.

Kanuni i shenjtoreve në 6 dhe

Triodhet në vendin e tyre.

Kanuni i shenjtoreve, që ka

Akrostihidhë pa Irmoset dhe

*Hyjlindësoret: “Këndoj kolonë
martirësh të hykurorezuar”.*

Poezi e Joan Monakut

Ting. II

Ode I

Irmosi: Dhefte lai

»Popuj të gjith', * ejani që t'i këndojm'
»Perëndis' *^{10b} pra Krishtit, që ka ndarë
»det dhe udhëhoqi popullin që e çliroi*
»nga zgjedha e Egjiptit, se u lëvdua
»fort.^{10c}

Kolonën psal* me shum' martirë të
Krishtit Jisu, * - kujtimit të dyzet shenj-
torëve përvit i bëj panair ngazëllues*
me këngë të hyfrymëzuara me lavdi.

Emër dhe grad' * dyzet martirët mo-
huan mbi dhé* dhe preferuan emrin
“i krishterë”,¹¹ me këtë në të lartat po
rrinë* tani të lavdëruar dhe ndërmje-
tojn' për ne.

Për Krishtin Zot* kishit urreyer dhe bo-
të, dhe mish, * u zhveshët pra nga rro-
ba e përkohshme dhe njeriu i vjetër²
së bashku, * kështu stoli që s'prishet
ju veshët⁶ me lavdi.

Hyjlindësore

Kush ka fuqi, * e Tërëshenjtë, siç e
meriton* me saktësi të flas' për zë-
nien tënde mbi logjikë, se linde në
mish ti* një Zot, që Shpëtimtar u
shfaq¹² për të gjithë ne.

Ode III

Irmosi: Steréoson imás

»**F**orcona, sigurona, o Zot, në ty, * pra
»ti që ke vrarë me dru mëkatin, *¹³
»edhe frikën tënde mbillna thell' * në
»zemrat tona, që të lavdërojnë ty.

Shpërfillën bukuri dhe trup, pasuri*
dhe jetë, ushtrinë, Dyzet martirët* me
lavdi; si trashëgim gjithnjë* fituan
Krishtin në vend të gjithçkaje pra.

Goditeshin me gurë fort, pa kursim*
me urdhër tiranësh Dyzet martirët,*
por me Shpirtin gurët zmbropseshin*
edhe qëllonin ata që k'të urdhër dhan'.

U fliste kundër teje, Ndërtues Zot,*
me buzë tiranësh satani gjarpër*
blasfemi,¹⁴ por përmes gurëve* ku-
ndër martirëve, thyhet në gojë ky.

Hyjlindësore

U bëre temjanic'¹⁵ ari për thëngjill*
hyjnor,¹⁶ o e vetmja gjithnjë e Virgjër,*
ma largo nga zemra duhmën pra,*
shpërnda aromë, e panusëruar krejt.

Irmosi: Steréoson imás

Forcona, sigurona

Ndenjësoe

Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon

Përmes martirizimit për Krishtin tim*
ishit mobilizuar, përdhé e shtrit'* në

gara armikun djall* dhe me punë përmbushët krejt* ju thënien e profetit, se pa frikë, me guxim* kaluat përmes zjarrit dhe ujit, dhe gjetët pra* jetën e amshuar porsì prehje,⁸ ndaj morët* kurora prej qiellit* dhe dëfreni me kor, ushtri* të patrupësh,* o zëmëdhenj;* ndërmjetoni te Zoti Krisht,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tuaj të shenjt' me mall.

Lavdi *dhe* Tani

Hyjlindësore

Më kujtohet Gjykimi dhe dridhem fort,* e kam frikë hetimin e ashpër tmerr,* vendimi më tremb komplet,* edhe druhem nga Ferr i zi,* nga vuajtja e zjarrit, nga terri në thellësi,*¹⁷ nga krimbi që s'fle⁴ dhe kërcëllitja e dhëmbëve.*¹⁷ Mjer'! Ç'të bëj kur frone do vendosen dhe libra* do hapen,¹⁸ dhe çdo veprim* do shqyrtohet dhe çdo sekret* do të dalë* në pah, o Zonj';* bëhu ndihmë ti atë çast* dhe mbrojtja ime e ngrohtë,* se ty të kam* shpresë un' shërbëtori yt i pavlefshëm krejt.

Ode IV

Irmosi: Isakíkoa Kírie tin akoín

»Dëgjova, o Zot, dëgjimin e ekonomisë sate, dhe të lavdërova, o i vetmi njeridashës.

Thoshin atletët: O të pabesë, jeni paranojakë duke sugjeruar dhuratën, shkakun e dëmit.

Përndjekësit e Krishtit si përgjigje ekspozonin ndaj shenjtoreve shpata të mprehta, bisha, zjarr dhe kryq.

Thoshin atletët: Është i frikshëm për ne zjarri i Gjehenës,⁴ po ky i tanishmi nuk na tremb, se është bashkëshërbëtori ynë.

Meqë shkëlqeni, o të lavdishëm, me anën e ndriçimit mendor të Krishtit, më udhëhiqni drejt rrezes hyjnore.

Hyjlindësore

Të përgjërrohemi, o e pacenuar, që zure pa farë Perëndinë, që të ndërmjetosh gjithmonë për shërbëtorët e tu.

Ode V

Irmosi: O tu fotós horigós

»**T**i, Zoti, dhënësi i dritës¹⁹ dhe endësi »i shekujve,²⁰ na udhëzo në dritën e »urdhrave të tu,²¹ sepse veç teje nuk »njohim tjetër Perëndi.²²

Për shkak të tërbimit paranojak të përndjekësve, atletët, që u dënuan të kalonin natën në akull përjashta, i psalnin himn falënderues Perëndisë.

Dyzet martirët e Krishtit, të ngazëlluar duruan ngrirjen e dhimbshme, duke

qëndruar në liqen, të forcuar në saje të shpresës së kurorave të hyjshme.

Dergjet i përqeshur përpara Dyzet martirëve të Krishtit gjarpri i mbytur, që më parë e kishte folenë në ujëra,²³ sepse iu hoq fuqia shkatërruese.

Hyjlindësore

Të thërrasim ty që linde Krishtin, Krijuesin e gjithçkaje.²⁴ Gëzohu, o e kulluar; gëzohu ti që na linde dritën; gëzohu, ti që mbajte Perëndinë e pa-nxënshëm.

Ode VI

Irmosi: En aviso ptesmaton

»Një avushë mëkatesh po më rre-
»thon,* ndaj thërras un' mirësinë të-
»nde që s'ka fund,* e cila s'gjurmëso-
»het dot;* lutem, nxirrmë nga prishja,
»o Zoti im.²⁵

E rrëmben nga të dymbëdhjetët me gaz* Judën aq mjeran i keqi nga fillimi djall*²⁶ dhe nga Edeni një njeri* të vithisur nga dyzetshja mizorisht.

I pacipi tërbohet fort me të drejt',* se si me kusarin²⁷ dhe Matthian²⁸ pra dikur,* kështu po shqyhet dhe tani* përmes ftesës së rojës tirani djall.

Meriton mendjelehti zi, qarje, lot,* se dështoi në të dyja jetët, humbi, ra,*

me zjarr u shkri dhe vajti ky,* emigroi drejt zjarrit që s'shuhet dot.¹⁸

Hyjlindësore

O e Virgjër, pa burrë ngjize në bark,* dhe përjetësisht e virgjër mbete dhe tregon* vërtet simbolet e Hyjnis'* së fëmijës edhe Perëndisë tënd.

Irmosi: En aviso ptesmaton

Një avushë mëkatesh

Kontaqi

Ting. Tërth. II Tin ipér imón

Si braktisët çdo ushtri tokësore, o kor* athloforësh i Jisuit, pas tij u ngjitët,* tok me Zotin në qiell, sepse, o të lumët ju,* si kaluat përmes zjarrit dhe* përmes ujit,⁸ keni korrur nder* dhe lavdi në qiell denjësisht,* o të Dyzet'; keni marr'* shum' kurora me çmim.

Shtëpia

Unë i pavyeri bie përmbys para atij që hipi në fron të pakufishëm,²⁹ që tendosi qiellin si lëkurë,³⁰ që mbështeti dheun³¹ dhe mblodhi ujërat në grumbullimet e tyre,³² që i bëri të gjitha nga mosqenia³³ dhe u jep të gjithëve frymë dhe jetë,³⁴ që pranon himnin e

kryeengjëjve dhe lavdërohet prej engjëjve,³⁵ dhe që i falen të gjithë, Krishtit të tërëpushtetshëm, Gatuesit dhe Perëndisë tonë, dhe ia sjell lutjen time, duke kërkuar hirin e fjalës, që të mund t'i himnoj edhe unë besërisht shenjtorët, që ai i tregoi fitimtarë, pasi u dha lavdi nga qielli dhe shumë kurora me çmim.

Sinaksari

Më 9 të të njëjtit muaj, kujtimi i Dyzet Martirëve të shenjtë e të mëdhenj, që u martirizuan në qytetin e Sevastisë.

Vargje: Ne të Dyzetët plotësojmë mungesën e pësimit tënd,/³⁶ pasi u thyem në këmbë, o Shpëtimtar.³⁷

Rreth së nëntës u dërrmuan këmbët e Dyzet burrave.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të shenjtë Urpasiani.

Vargje: O Urpasian, kafazi u bë karrocë zjarri,/ ndërsa llambadhet, qerre ngjitjeje.³⁸

Në të njëjtën ditë, kujtimi i shën Qesariut, vëllai i shën Grigor Theologut.

Vargje: Fjalimi i Grigorit para lipsanit të Qesariut/ frenon fjalët e gjuhës sime.

Në të njëjtën ditë, shenjtorët gjyshi, gjyshja, ati, nëna dhe dy fëmijë mbarojnë me shpatë.

Vargje: Me shpatë atletizoi fisi i të afërmve,/ kori i gjyshit-gjyshes, atinënë-fëmijë.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII

Irmosi: Ikonos hrisis

»Kur adhurohej një ikonë e artë në »fushën Dheira,³⁹ të Tre Djemtë e tu »shpërfillën urdhër tepër të pafe, dhe »kur u vunë brenda zjarrit, duke u fre- »skuar,⁴⁰ psalnin: I bekuar je, o Perë- »ndi i etërve tanë.⁴¹

Roja e të Dyzetëve u shtang kur pa kurorat dhe, si e zmbrapsi dashurinë për jetën, u bë me krahë falë dashurisë për lavdinë tënde që u shfaq, dhe së bashku me martirët psalte: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.⁴¹

Vritet sapo vrapoi drejt banjës shpirtshkatërruese miku i jetës, ndërsa krishtdashësi, pasi u bë rrëmbyesi i shkëlqyer i vizioneve, si në banjë pa-prishjeje, psalte së bashku me martirët: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.⁴¹

Meqenëse u ndez në arsyen e të Dyzetëve zjarr mendor, marrëzia shumë dredharake e të pabesëve digjej deri në fund, duke u shkrirë si një qiri,⁴²

ndërsa ty të psalej, o Krisht: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.⁴¹

O Krisht, sa shumë e gëzueshme dhe e hijshme është fuqia e Kryqit,⁴³ që me gjëra të kundërta thur kurora për Dyzet martirët; sepse, pasi kaluan ujë dhe zjarr,⁸ thërrisnin në paprishje: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.⁴¹

Hyjlindësore

Në malin Sina, Moisiu të parashikonte si ferrë që flakërohej⁴⁴ ty, o e kulluar, që mbajte pa djegie lavdinë e pakufishme të esencës së parrëfyeshme, e cila u bashkua me lëndën e mishit të një prej hipostazave të shenjtë, që është brenda saj.

Ode VIII

Irmosi: Ton en kamino tu pirós

»**A**të që zbriti në kamin', * që të ishte tok me Djemtë⁴⁵ e hebrejve, * Perëndinë që ktheu në vesë flakë dhe »zjarr, *⁴⁰ himnojeni vepra, se është »Zot, * përmblartësojeni k'të në gjithë jetët.⁴⁶

Sado që armiku nxiti të gjithë Krisjesën me mani kundër atletëve, u turpërua me çdo kusht, sepse të Dyzetët thërrasin pa pushim: Himnojeni dhe përmblartësojeni Krishtin në jetë.⁴⁶

O martirë, pasi u dërrmuat pa mëshirë në gjymtyrët e trupit tuaj për Krishtin dhe iu blatuat Perëndisë si holokaust i hyjshëm, gëzohuni me kore engjëjsh duke himnuar Krishtin në jetë.⁴⁶

Nëna perëndidashëse e fuqishme në mendje, kur ngriti mbi supe atë që lindi si fryt shpresëtarie, ia sjell martirëve si dëshmor, duke imituar shërbesën e Abrahamit.⁴⁷

Nëna krishtdashëse i thërriste birit krishtdashës: O bir, marsho drejt në rrugëtimin e jetës së pasosur, sepse nuk duroj të dalësh i dyti para Perëndisë që shpalli garën.

Triadik

Duke e menduar besërisht natyrën unike si në tre diej, që lidhen me njëri-tjetrin, ne veprat e himnojmë Dritën trihipostate si Zot dhe e përmblartësojmë në gjithë jetët.⁴⁶

Hyjlindësore

Ulu te lutjet tona, të shërbëtorëve të tu, o Perëndilindëse e mirë, dhe pusho shpejt sulmet e tmerreve dhe vrullet e ngasjeve, që të të nderojmë, o Zonjë e përmbibekuar.

Irmosi: Ton en kamino tu pirós

Atë që zbriti në kamin'

*Ode IX**Irmosi: Ton ek Theú Theón Logon*

»**T**a madhështojmë me një zë, o bes-
 »nikë, me himne* Fjalën e Perëndisë,
 »Zotin⁴⁸ Krisht,* që parrëfyeshëm mo-
 »ri për ne* mish nga Nëna e virgjër, e
 »shenjtë; vjen të rinovojë pra* krejt
 »Adam, që kur hëngri,⁴⁹ ra në prishje
 »mizorisht.

Pasi u zhveshët për Krishtin, ju që-
 lluan me gurë,* ngricën nga ajri e du-
 ruat fort,* ujin e akullt, gjymtim ju në
 trup,* dhe u dogjët prej zjarrit, ndaj
 shndritët brenda rrjedhjeve në lum'*
 si ndriçues me forcë, Dyzet martirë me
 lavdi.

Si shkop fuqie⁵⁰ hyjnore e kishit
 Kryqin⁴³, kështu pra* Dyzet atletët i
 thërrisnin tok* Krishtit Jisu: "Zot, me
 dorën tënde* triumfuese edhe të tër'-
 pushtetshme le të vëmë rreth*⁵¹ që
 të të madhështojmë me himn të gji-
 thë pa pushim".

Eashpër ishte e ftohta, ngrica që keq
 ju hoqët* padrejtësisht, e dhimbshme
 mpirja pra,* por sa e ëmbël Parajsa
 për ju,* se në tendat në qiell përherë⁵²
 ju ngroh gjiri abramian*⁵³ i patrikut,
 ndaj shkuat në prehje me lavdi dhe
 gaz.

Meqë fituat në gara, rrini pranë Tri-
 nisë* trihipostate, o atlet' tani,* dhe

ndërmjetoni t'i bëhet dhurim* botës
 paqja, dhe mbretit krishtdashës plot
 fitore, neve tok* falje si dhe shpëtim,
 o Dyzet martirë plot me nder.

Hyjlindësore

Gëzohu ti, o burimi i paprishjes, gë-
 zohu,* o re e lehtë,⁵⁴ gaz ki, o Parajs'*
 tepër e hijshme e Zotit Jisu,* ki gaz,
 krua shërimesh në shpirt, mal që pro-
 feti Daniel* pa,⁵⁵ gaz ki, mbretëresha
 e botës, virgjëreshë nën'.

*Irmosi: Ton ek Theú Theón Logon***T**a madhështojmë me një zë*Dërgimësore**Jinekes akutisthite*

Dyzet martirët, kor me nam* i Për-
 mbiperëndis' Trini,* meqë kish katër
 virtytet,*^{55a} garuan në zjarr e ajër,*
 ujë e dhé, i mundën pra* katër nga
 elementet;* me këngë të hyjnue-
 shme* le të himnohen, se kryen* luftë
 për Zotin e botës.

Hyjlindësore

Gëzohu, o Hyjlindëse* e qashtër,
 shpresë, mbrojtje je,* ki gaz, çlirimi
 nga nëma,*⁵⁶ gëzohu, nënë modeste*
 e Perëndis', qerre e shenjt',* ki gaz,
 shkallë⁵⁷ dhe portë,*⁵⁸ ki gaz, o re e

lehtë ti,*⁵⁴ gëzohu zgjidhja e Evës;* rithirrje je për Adamin.

Lavdërime (3 të parat në 4, ose në 6, d.m.th. bashkë me Idhiomelet)

Ting. Tërth. I Heris askitikón

V'llezër, ejani që të himnojm'* me lavdërime batalion martirik dhe trim;* u tret nga e ftohta dhe dogji plot me zell të përflakt'* ngricën e mashtrimit, grupi guximtar;* rreshtim si edhe ushtri* fort e hyjshme, dhe aleanc'* që s'thyhet, s'mposhtet,* luftëtare, mbështetje, pirg* është në besim* dhe për Kishën po ndërmjeton;* Dyzet martirët, kor i perëndishëm, që me fuqi* Krishtin lyp dhe përgjërohet që të dërgojë nga qielli* drejt shpirtave tanë* paqen edhe përdëllimin e madh^{58a} dhe faljen tok.

G'zohu, ti, o grupim me fuqi,* rreshtim i hyjshëm, triumfal, jeni kulla ju* për besën e mirë edhe ushtarët e Krishtit Zot,*¹⁰ rendi i pamposhtur dhe luftuesit* me plot qëndrueshmëri,* me guxim të pathyeshëm,* trima në shpirta,* dhe vërtet të hyjnueshmit;* jeni për Hyjnin'* fort të dashur, o kor hyjnor;* Dyzet martirë mbledhur tok, si do Perëndia Zot,* të barabartë në ndeshje, në mendje dhe në kurora pra,* kështu gjithnjë lutni* Krishtin që t'u japë shpirtave përdëllim të madh.^{58a}

Gaz ki, o tufë, korre triumf* dhe u dallove burrisht nëpër luftëra,* o yje, kaluat mes zjarrit edhe ngrirjes,⁸ ndërsa* shkritë ngrica uji, e shndërruat dhén'* në qiell, si dhe çdo gjë* e ndriçuat, ndaj ngrohuni* tani në gjirin* e patrikut shën Abraham*⁵³ dhe kërceni tok* me ushtritë e engjëjve;* Dyzet martirë, lule që lëshojnë të këndshmen er',* aromë krejt shpirtërore,⁵⁹ vërtet na keni mahnitur ju; për ne lypni Krishtin* të dhurohet përdëllimi i madh^{58a} për shpirtat tan'.

Idhiomele

Ting. I

Një kor me dyzet pishtarë, ushtria e tërë e grumbulluar perëndishëm, shkëlqeu bashkë me kreshmën me anën e arritjeve të nderuara, dhe shenjtëron dhe ndriçon shpirtat tanë.

Ting. II

Kush s'do ta përhimnojë korin e Dyzet martirëve? Sepse hynë trimërisht në ujin e liqenit dhe, të shtrënguar prej të ftohtit, i këndonin Zotit oden: Mos u inatos me ne në lumenj, o Zot, mos u inatos me ne,⁶⁰ o njeridashës; lehtëso barrën dhe hidhërimin e ajrit, sepse me gjakun tonë u lyen këmbët tona; dhe na fute, o Perëndi, në tendat e tua të amshuara,⁵² që të na ngrohë gjiri i patriarkut Abraham.⁵³

I njëjti

Ujiten besimtarët me kanën e së vërtetës nga gjakrat e tyre përmes zjarrit të torturave dhe ngrirjes së ujit; sepse iu sollën Krishtit Shpëtimtar, duke i kënduar, të dyzetët, ndërsa ishin një për sa u përkiste shpirtrave, por të shumtë nga trupat; dhe një nënë hyjnuse, pasi mori djalë krishtdashës mbi supe, i thoshte: Eja, o atlet, dhe garo së bashku me të mëparshmit.

Lavdi

Ting. Tërth. I I Joan Monakut

O athloforët e Krishtit, kreshmën e tërërespektuar e bëtë më të hijshme me anën e kujtimit të atletizmit tuaj të lavdishëm; sepse duke qenë dyzet, e shenjtëroni dyzetditëshin, meqë përmes ndeshjes suaj për Krishtin imituat pësimin shpëtimtar; prandaj, duke pasur guxim, ndërmjetoni që të arrijmë me paqe në ngjalljen e triditshme të Perëndisë dhe Shpëtimtarit të shpirtrave tanë.

Tani *Hyjlindësore*

Ty të lumërojmë, o Hyjlindëse e virgjër dhe të lavdërojmë ne besnikët siç të ka hije ty, qytetin e patundshëm dhe murin që s'çahet dot, mbrojtjen e pathyeshme dhe strehën e shpirtrave tanë.

Dhoksologjia e Madhe. Në Orët (e Thjeshta), Përlëshorja dhe Kontaqi i shenjtoreve. Bëjmë edhe Tri Metanitë e Mëdha. Nëse nuk psalet Dhoksologjia, në Pasvargje Idhiomeli (2x) dhe Martiriku i Triodhit.

Lavdi *I shenjtoreve*
Ting. II

Martirët e konsideruan liqenin si Parajsë, dhe të ftohtën si vapë, o Krisht Perëndi; nuk ua trembën mendimin kërcënimet e tiranëve, trimat nuk i patën frikë sulmet e torturave, sepse kishin Kryqin armë hyjnore; nëpërmjet tij triumfuan kundër armikut, si të pushtetshëm, prandaj dhe e morën dhe kurorën e Hirit.

Tani *Hyjlindësore*

O portë e pakaluar, e vulosur⁵⁸ misti-kërisht, Perëndilindëse e bekuar, e virgjër, pranoji lutjet tona dhe çoja Birit tënd dhe Perëndisë, që të shpëtojë përmes teje shpirtrat tanë.

*Është mirë t'i falemi etj.
dhe Tri Metanitë e Mëdha.*



NË MBRËMËSOREN E SË NJËJTËS DITË

*10 Thirrtore: Idhiomeli i ditës (2x),
Martiriku, 3 po të Triodhit
dhe 4 të shenjtoreve:*

Ting. II I Joan Monakut

Duke duruar të tanishmet me trimëri, duke u ngazëlluar për të shpresuarat,¹ i thoshin njëri-tjetrit martirët e shenjtë: Mos vallë po zhvishemi nga kjo rrobë? Por hedhim tej njeriun e vjetër.² I egër është dimri, por e ëmbël Parajsa; e dhimbshme ngrirja, por i këndshëm shijimi; prandaj të mos devijojmë, o bashkushtarë; le të durojmë pak, që të marrim kurorat e fitores nga Krishti Perëndi dhe Shpëtimtari i shpirtave tanë.

(2x)

I të njëjtit

Duke i hedhur poshtë të gjitha rrobat, duke shkuar pa u trembur në liqen, i thoshin njëri-tjetrit martirët e shenjtë: Për hir të Parajsës që humbëm, le të mos mbajmë sot rrobë të prishshme; meqenëse u veshëm dikur për shkak të gjarprit prishës,³ le të zhvishemi tani për hir të ngjalljes së të gjithëve; le të shpërfillim një të ftohtë që kalon dhe le të urrejmë mishin, që të marrim kurorat e fitores nga Kri-

shti Perëndi dhe Shpëtimtari i shpirtave tanë.

I të njëjtit

Duke i parë torturat si dëfrime, duke vrapuar drejt një liqeni të ftohtë si drejt së ngrohtës, martirët e shenjtë thoshin: Të mos druajmë stinë dimërore, që të shmangim Gjehenën e frikshme të zjarrit;⁴ u djegte këmba, që të kërcejë përgjithmonë, ndërsa dora kulloftë, që të lartësohet drejt Zotit, dhe mos e kursefshim natyrën që vdes; preferofshim vdekje, që të marrim kurorat e fitores nga Krishti Perëndi dhe Shpëtimtari i shpirtave tanë.

Lavdi

Ting. II I Qiprian Monakut

Profetikisht thërriste Davidi te Psalmet: “Kaluam përmes zjarri dhe uji dhe na nxore në prehje”; dhe ju, o martirët e Krishtit, duke përmbushur thënien me vetë punët, kaluat përmes zjarri dhe uji edhe hytë në mbretërinë e qiejve; prandaj ndërmjetoni, ju që jeni dyzet atletë, të na dhurohet përdëllimi i madh.^{58a}

Tani *Hyjlindësore*

Gjith’ shpresën time e besoj te ti, o nën’ e Perëndis’, ruajmë nën strehën tënde.

Hyrje me Ungjillin. Pas Le të drejtohet, menjëherë Apostulli dhe Ungjilli dhe Liturgjia e të Parashenjtëruarave. Kungatore: Në kujtim të përjetshëm.

CITIME

- ¹ Rom. 12.12
- ² Rom. 6.6; Ef. 4.22; Kol. 3.9
- ³ Gjen. 3.21
- ⁴ Matth. 5.22; 18.9; Mark. 9.43-48; Jak. 3.6
- ⁵ Rom. 13.12; Ef. 5.11
- ⁶ I Kor. 15.53-54
- ^{6a} Joan 15.1
- ⁷ Fil. 1.29
- ⁸ Ps. 65(66).12
- ⁹ Matth. 25.34
- ¹⁰ II Tim. 2.3
- ^{10a} Mark. 1.40
- ^{10b} Eks. 15.1
- ^{10c} Eks. 14.21-22 etj.
- ¹¹ Vep. 11.26
- ¹² I Tim. 3.16
- ¹³ I Petr. 2.24
- ¹⁴ Apok. 13.6
- ¹⁵ Hebr. 9.4
- ¹⁶ Is. 6.6
- ¹⁷ Matth. 8.12; 13.42,50; 22.13; 22.51; 25.30; Lluk. 13.28
- ¹⁸ Dan. 7.9-11
- ¹⁹ Jak. 1.17
- ²⁰ Hebr. 1.2
- ²¹ Is. 26.9
- ²² Is. 26.13
- ²³ Ps. 73(74).13
- ²⁴ Sirak 24.8; Joan 1.3
- ²⁵ Jona 2.7

- ²⁶ I Joan 3.8
- ²⁷ Lluk. 23.42
- ²⁸ Matth. 9.9; Mark. 2.14; Lluk. 5.27-28
- ²⁹ II Kron. 18.18; Is. 6.1; Ezek. 1.26; Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 32
- ³⁰ Ps. 103(104).2
- ³¹ Ps. 135(136).6
- ³² Gjen. 1.9
- ³³ Rom. 4.17
- ³⁴ Vep. 17.25
- ³⁵ Ps. 148.2; Tobit 38.7; Is. 6.2-3
- ³⁶ Kol. 1.24
- ³⁷ Joan 19.33
- ³⁸ IV[II] Mbret. 2.11
- ³⁹ Dan. 3.1
- ⁴⁰ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 26
- ⁴¹ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 28
- ⁴² Judith 16.15; Ps. 21(22).14; 57(58).9; 67(68).2; Is. 64.2
- ⁴³ I Kor. 1.18
- ⁴⁴ Eks. 3.2-5
- ⁴⁵ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 25
- ⁴⁶ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
- ⁴⁷ Gjen. 22.1-10
- ⁴⁸ Joan 1.1
- ⁴⁹ Gjen. 3.1-6
- ⁵⁰ Ps. 109(110).2
- ⁵¹ Urt. Sol. 5.16
- ⁵² Lluk. 16.9
- ⁵³ Lluk. 16.22
- ⁵⁴ Is. 19.1
- ⁵⁵ Dan. 2.34
- ^{55a} Urt. Sol. 8.7
- ⁵⁶ Gjen. 3.16-19
- ⁵⁷ Gjen. 28.12-17
- ⁵⁸ Jez. 44.1-4
- ^{58a} Num. 14.19 etj.
- ⁵⁹ II Kor. 2.15
- ⁶⁰ Abak. 3.8



MË 17 TË TË NJËTIT MUAJ

Kujtimi i shën Aleksit,
njeriu i Perëndisë.

NË MBRËMËSORE

Thirrto

Ting. I Panëfimi märtires

Të dimë njeri të Perëndis’*¹ si në emër, dhe në jet’,* se në virtytet shkëlqeve, si fitove përmbi dhé* varfëri pa masë* dhe mundim, dhe nëpërmjet çudive besimtarët i binde; përgjëroju Krishtit Zot,* të dhurohet përdëllim i madh,*^{1a} paqe, falje edhe hir për shpirtrat tan’.

Përmes dashurisë që freskon* çdo zjarrmi që flakëron,* me bes’ e shove, Aleks; ndërrove dhom’ me tjetër dhom’,* dhe kënaqësitë* krejt trupore ti me përngjasim hyjnor me engjëjt; ndaj përgjëroju Krishtit tok me ta,* të dhurohet përdëllim i madh,*^{1a} paqe, falje edhe hir për shpirtrat tan’.

Jeton i panjohur në shtrëngim,* o i urti shën Aleks,* përpara portës së prindërve fisnikë, shahesh ti* për vite me radhë* po prej shërbëtorëve të tu, ndërsa në vdekje u shfaqesh me çuditë që ti bën,* kur përzë frymët e ndyra larg* dhe shëron sëmundje helm të hidhura.

Lavdi *dhe* Tani

Hyjlindësore

Gëzohu, dëgjim i huaj krejt,* o e paqortueshme,* o dru hyjnor i hyjmbjellë i Parajsës, gaz ki ti;* ki gëzim, shfaqrosja* e demonëve dinakë, shpata me dy presa² që kokën e armikut ti e pret,* përmes lindjes sate, e dëlir’;* na rithirre ne, Mari, të huajit.

ose Kryqhyjlindësore

Ndërsa therjen tënde të padrejt’* e shikonte, Krishti im,* Zonja e virgjër vajtonte dhe thërriste: Biri im* fort i ëmbël, si pra* vuan ti padrejtësisht? Si vares mbi dru ti që mbi ujë vare çdo tok’?³ Mos më lër* mua vetëm, shërbëtoresh dhe* nënën tënde, o i plotmëshirshmi Zot.

Përlëshore

Ting. II Tahí prokatálave

Nga rrënja e famshme⁴ na ke mbirë me lavd dhe nam* dhe ke lulëzuar në qytet të shquar dhe mbretëror, i tërurti ti;* dhe kur gjithçka shpërfille* si të prishshme që ikin,* rende që të bashkoheshe me Krishtin Jisu Zot;* ndaj lypi atij për shpirtrat tanë, o shën Aleks.



NË MËNGJESORE

*Kanun, që ka Akrostihidhë:
 “Ty, njeriun e Perëndisë,
 do të të himnoj, o i lumur. Josif”.*

Ting. II

Ode I

Irmosi: En vithó katéstrose poté

»**M**bar’ ushtri e mbretit Faraon*
 »shtriu forca mbi çdo armë dhe ar-
 »mik,* thellë mbyti në det dikur.* Kur
 »u mishërua pra Fjala, fshiu mëkatin
 »e tërëqeq, dinak,* Zoti i lëvduar, se
 »u lavdërua plot me lavdërim.

O i urt’, përshkove rrugëtim* krejt të
 ngushtë,⁵ kishe jetë pa qortim,* oshë-
 nare,⁶ që në rini;* ngushtësin’ e me-
 ndjes ti ma zgjero, që të të himnoj ty
 që po qëndron,* o Aleks, në hapë-
 sirën e Parajsës me gëzim dhe lavd.

Ia kushtove tërë veten ti* Perëndisë,
 o i lum, kur botën le* si edhe mishin,
 deshe pra* në vend të thesarit që
 rrjedh,⁷ atë që qëndron në qiell,⁸ edhe
 në vend* të qytetit që të nxori ty, Si-
 onin e përjetshëm, shenjt.

Shterpësin’ e barkut nënor ti* e ke
 zgjidhur, kur u linde si profet* Samu-
 eli;⁹ kur zure pra* frikën e dëlirë për-
 brenda mitrës së zemrës, linde, i pasur
 fort,* shpirt shpëtimi¹⁰ përmes besës
 me virtyte të hyjnueshme.

Hyjlindësore

Të ka gjetur vetëm ty pa cen,* të dë-
 lirë mbi gjithçka që kishte bër’,*
 shkak ngjasimi me njerëzit,* Bir¹¹ i
 bashkëpafillim tok me Atin dhe Perë-
 ndinë, e Virgjër krejt;* gjithë gjenera-
 tat të himnojnë dhe të lumërojnë¹² ty.

Ode III

Irmosi: Eksínthisen i érimos

»**U** lulëzua si zambak* shkretëtira,¹³
 »Kisha e gjith’ kombeve që shterpë
 »ish,* me pranin’ tënde, Perëndia im;*
 »në të u sigurua zemra ime fort.^{13a}

Ty dashuri për qashtëri* po të shpo-
 nte, ndaj ndërrove nusëroren përmbi
 dhë* me q’elloren dhe ëndje gruaje*
 me përngjasim të ëmbël fort të en-
 gjëjve.

Rrëmujën tokësore ti* e le dhe sasi-
 në e parave,¹⁴ dhe u bërë pra* mërgim-
 tar në atdhe, o shën Aleks,* se imitoje
 varfërin’ e Krishtit¹⁵ tënd.

Me lot, përmbajtje dhe mundim,* atë
 i tërurtë, e kërkove fort të mirën ti,*
 kur të vinte ndriçim¹⁶ prej dituris’,*¹⁷
 t’i sillte zemrës sate papasionshmëri.

Hyjlindësore

Ai që lart s’e shohin dot* engjëjt,¹⁸
 pasi lindi nga ti, shfaqet poshtë si

njeri* i përsosur dhe përsëri fiton,* o Zonj' e pacenuar, botën që u prish.

Irmosi: Eksínthisen i érimos

U lulëzua si zambak

Ndenjëso

Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon

O i urtë, teksa shohim mendërisht* gjithë ne besimtarët, sa bëre ti,* mundimet dhe djersën pra,* shpirti mbushet me kataniks* dhe veten tonë nxisim me mallin në zemër, shpirt* për lavdërim, nderim, melodi të hyjnueshme,* o Aleks i lumur fort, për Zotin dhe mbretin* e çdo gjëje, ndërsa ty* po të mburrim me besë, himn,* të thërrasim,* o shërbëtor* Zoti: Ndërmjeto tek ai* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tënd fort të shenjt' me mall.

Lavdi

Ting. III Tin oreótita

Çdo bukuri mbi dhé* e ke braktisur tej,* o oshënar Aleks,* shkëmbeve pasurin'* që rrjedh⁷ me pasurin' që nuk shkon, por mbetet;⁸ të lëvdojmë* tok me tërë shenjtët ty,*¹⁹ bëjmë dhe panair me gaz* për kujtimin tënd hyjnisht* dhe kërkojmë të gjejmë ne,* o atë, përdëllimin e madh^{1a} dhe* ndjesën prej lutjeve të tua.

Tani *Hyjlindësore*

O e hyjhirshmja Zonj',* misteri që u bë* në ty ishte i madh,* plot frikë, pa shprehi,* s'kuptohet, se ke zënë dhe e mbajte në bark atë që* s'mbahet, por prej gjakut tënd* të panjollë me mish u vesh;* o e qashtra ti, atij* përgjëroju, gjithnjë lutju* si Birit tënd, që t'i mëshirojë* shpirtrat tanë, t'i shpëtojë.

ose Kryqhyjlindësore

Kur të shikonte lart* të ngrihesh përmbi kryq* si i dënuar, skllav,* ajo që ty, o Krisht,* të kish në bark, me kujë dhe me klithma vajtonte kështu:* Mjer'! Si nuk i erdhi keq* për ty turmës buk'shkelëse,* sado kishe dhembshuri* për këtë, i mëshirshëm fort,*²⁰ i vetmi pa mëkat ti;²¹ mos më lër* mua, të vetme në këtë dhé.

Ode IV

Irmosi: Elilithas ek Parthenu

»**K**e ardhur nga një e virgjër jo si »ndërmjetues, jo si engjëll, por vetë »Zoti,²² i mishëruar dhe më shpëtove »mua njeriun e tërë; pra ty të thërras: »Lavdi fuqisë sate, o Zot.

Durove skamjen duke u bërë lypsar si Llazari i vobektë,²³ sepse dashuria hyjnore e nxiste zemrën tënde, që e

donte me përmallim pasurinë qiellore,⁸ o i lumur.

Aspirove një jetë të thjeshtë pa shpërqendrim, duke ngrënë një herë në javë, o Aleks i tërëlumur, nga malli për shijimin që mbetet dhe që nuk rrjedh.

Meqenëse kërkoje ta bëje zemrën tempull Perëndie,²⁴ doje të rrije gjithmonë në shtëpinë e Hyjnënës, o i lavdishëm, dhe të soditje bukuritë qiellore.

Hyjlindësore

Oe Virgjër, të lyp, meqë i dhe gji dhënësit të qumështit, nginje tani me çdo dituri dhe kataniks të hyjshëm zemrën time që ka uri dhe që rënkon.

Ode V

Irmosi: Mesitis Theú

»**U** bëre ndërmjetës mes Perëndi-
»së dhe njerëzve, o Krisht²⁵ Perëndi,
»sepse nëpërmjet teje, o Zot, e kemi
»blatimin tonë nga natë paditurie
»tek Ati yt²⁶ i ndritshëm qysh në fillim.

Meqë e vaditje gjithmonë shpirtin tënd me rrëke lotësh të hyjnueshëm, kultivove kalli të njëqindfishtë²⁷ vërtet, që ruhet mirë për bujkun²⁸ e padekshëm.

U duke që imitoje mbi dhé sjellje të patrupësh, me anën e vetëpërmbajtjes sate hiperbolike dhe qëndrueshmërisë në lutje,²⁹ nëpërmjet së cilës u bëre dritë, o atë i admirueshëm.

Me zjarr lutjesh dogje materialin e mëkatit, o i urtë, ndërsa me qëndrime pa gjumë vure në amulli çdo epsh; dhe kur fjete, shkove drejt dritës së pa-perëndueshme.

Hyjlindësore

Ai që banon në dritë,³⁰ ndenji në mitrën tënde të shenjtë, o e kulluar, duke rifituar botën që humbiste në errësi paditurie; atij lyp t'i shkëlqejë të gjithë ata që të himnojnë.

Ode VI

Irmosi: En aviso ptesmaton

»**N**jë avushë mëkatesh po më rre-
»thon,* ndaj thërras un' mirësinë të-
»nde që s'ka fund,* e cila s'gjurmëso-
»het dot;* lutem, nxirrmë nga prishja,
»o Zoti im.^{30a}

Oe Virgjër, pa burrë ngjize në bark,* dhe përjetësisht e virgjër mbete dhe tregon* vërtet simbolet e Hyjnis'* së fëmijës edhe Perëndisë tënd.

Sado fshiheshe edhe përpiqueshe* të mos merrnin vesh se ishe tempulli

i gjall’* i Perëndisë,²⁴ të zbulon* Vajza pa dasmë, tenda e Krishtit Zot.

Si temjan u pranuan prej Perëndis’*³¹ lutjet³² që ti bëje, aromatizove pra* me jetën tënde mendjen ton’* përmes Hirit të Shpirtit, i lumi shenjt.

Sado s’doje, te vendi yt të kthen pas* të stolisur, o i lavdëruar, me një jet’* të hyjshme, atë, Krishti ty,* që u shmangeshe lavdeve që kalojn’.

Hyjlindësore

Zonjë pa cen, pashprehshëm prej teje lind,* si i rinovoi ligjet e natyrës krejt* Gatuesi i Gjithësis’,* edhe më hyjnizon me mëshir’ pa fund.

Irmosi: En aviso ptesmaton

Një avushë mëkatesh

Kontaqi

Ting. IV Epefanis símeron

Sot festojmë besërisht* të kremten plot nder* të të tërëpasurit* Aleks, prandaj le ta himnojm’,* t’i themi ne: Bukuri me hir* e oshënarëve ti je, gëzohu, shenjt.

Shtëpia

Kush do t’i lartësojë denjësisht dhe do t’i himnojë mjaftueshëm virtytet e tua të respektueshme, o Aleks hyj-

mendës? Mençurinë, durimin, butësinë, vetëpërmbytjen,³³ himnin pa pushim, keqtrajtimin e tejskajshëm dhe përulësinë pa masë, me anën e të cilave, pasi u bëre i barabartë me engjëj, ndërmjeton gjithmonë për mbarë botën; prandaj tani dëgjon nga tërë shpresëtarët, o oshënar: Bukuri me hir e oshënarëve ti je, gëzohu, shenjt.

Sinaksari

Më 17 të të njëjtit muaj, kujtimi i atit tonë oshënar Aleks, njeriu i Perëndisë.¹

Vargje: Meqë u quajte vetëm ti në tokë “Njeriu i Perëndisë”,¹/ vetëm ti do të kesh diçka të re dhe në qiell, o atë.

Në të shtatëmbëdhjetën, o Aleks, durove vdekje.

Në të njëjtën ditë rastisi bashkë edhe kujtimi i kërcënimit të frikshëm, që na goditi me njeridashje, pra i tërmetit, prej të cilit na çliroi jashtë çdo shprese Zoti njeridashës. Ndodhi në kohën e mbretit Konstandin.

Në të njëjtën ditë, martiri i shenjtë Pavël mbaron me zjarr për hir të ikonave të shenjta.

Vargje: Zelli i ikonave e dogji krejt Pavlin,/ për të cilin u ndez flakë furre për shkak të tyre.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të shenjtë Marini.

Në të njëjtën ditë, oshënar Theostirikti omologjet, mbaron në paqe.

Vargje: O Theostirikt, jepu besimtarëve ndërmjetimet e tua/ si mbështetje, ndonëse u shpërngule nga jeta.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona dhe shpëtona. Amin.

Ode VII

Irmosi: Antitheon próstagma

»Urdhër i kundërperëndishëm i një
»tirani të paligjshëm bëri që flaka të
»brambullonte lart,³⁴ ndërsa shtriu për
»Djemtë shpresëplotë vesën³⁵ e Shpir-
»tit Krishti, që është i bekuar dhe i për-
»mbilavdëruar.

Duke ndenjtur me qëndrueshmëri, o oshënar, para portës së lindësve, mbe-
te i panjohur tërësisht dhe pranoje
marrëzinë e shërbëtorëve, përqeshjen
e rëndë dhe shtrëngimin e varfërisë
së shumtë.

Pasi vrave³⁶ mentalitetin e mishit
tënd,³⁷ duke parë prindërit dhe duke
qenë i panjohur prej tyre, duroje
dhunën e natyrës, o oshënar, si dhe
poshtërimin e shërbëtorëve të tu të
panumërt që të shtrëngonin.

O çudi! Si mbete përgjithmonë i varfër
në pasuri përulësie pa kufi, o Aleks!
Si, o i tërurtë, durove të talleshe dhe
të përqesheshe prej shërbëtorëve të
tu, që e injoronin sjelljen tënde!

Hyjlindësore

O e tërëpaqortueshme, u bëre shër-
byese e një misterit³⁸ të madh, sepse
trupëzove Perëndi që na çliron nga të
këqijat e mëdha ne që të madhëroj-
më, o e kulluar, e bekuar e hyjhirshme.

Ode VIII

Irmosi: Káminos poté pirós

»Dikur një furrë në Babilonë i ndante
»energjitë me urdhër hyjnor, duke
»shkrumbuar kaldenjtë, ndërsa i veso-
»nte besimtarët³⁹ që psalnin: E bekoni
»gjithë veprat, Zotin.⁴⁰

Duke qenë më parë i panjohur te
lindësit, në kohën e largimit tënd u
zbulon misterin, duke u shfaqur për
lavdinë e Perëndisë tonë, o i lavdi-
shëm, i cili të lavdëroi shumë siç e
meritoje.

Zoti me zë të madh të shfaq në gjithë
Romën ty, thesarin që fshihej,⁴¹ o i
tërëpasur, që uleshe në trajtë të vobe-
kti, dhe që i pasuroje me dhurata shë-
rimesh gjithë sa të afroheshin me
besim.

Të parët e popujve dhe mbretërit, dhe priftërinjtë u mblodhën⁴² me she-një nga Perëndia që të të varrosnin; dhe soditën haptazi një shfaqje të madhe, duke u shastisur me çuditë që bëje, o oshënar, me fuqinë hyjnore të Shpirtit.

Hyjlindësore

Njeridashësi, duke na përtëritur ne që rrodhëm përmes shkëljes së vjetër,⁴³ u mishërua pa rrjedhje nga mitra jote e paprishur, o e Tërëpaqortueshme, dhe na çliroi të gjithë prej pri-shjes së mëkatit.

Irmosi: Káminos poté píros

Dikur një furrë

Ode IX

Irmosi: Anarhu jenítoros

»**B**ir prindi pa nisje, Perëndi dhe Zot »te ne u shfaq* me lavdi nga e Virgjra, »që të ndriçojë sot* gjith' të errësua- »rat⁴⁴ edhe të mbledh' në një* të shpër-ndarat;⁴⁵ ndaj madhështojmë Hyjlindë- »sen* e himnuar fort edhe me nam.

Lum ti, oshënar, u denjësove të sodi-tësh lavd* Perëndie,⁴⁶ ai të lëvdoi më në fund* me shkëlqim, se pan' dritë sa nuk shikonin dot,* si edhe me-

mecë e morën të folurin,*⁴⁷ i tërë-kënduari Aleks.

Uduke si diell teksa çoheshe i shtrirë ti* për varrim, rrezatoje krejt parado-ksalisht* vezullim shërimesh, dëboje çdo errësir* vesesh, dhe i digjje de-monët dhe shndritje fort* çdo hyj-mendës, atë oshënar.

Ishquari mes patrikësh, mbreti yn', krishtdashës fort,* hegjemonë, të rinj, pleq dhe kore murgjish bashk',* me sinjalizimin hyjnor janë mbledhur tok* që të të varrosin, o atë i lumur, ty,* shenjtërohen kur të prekin pra.

Aleks, u rrëmbeve në karrocën⁴⁸ e virtyteve* dhe, kur hipe, arrite të pre-hesh ku qëndrojnë* kore oshënarësh, patrikësh, martirësh tok* me apostujt edhe me gjithë të drejtët ti;* me këta kujto sa të nderojn'.

Hyjlindësore

Të sjellim, Hyjlindëse gjithnjë e virgjër, me gëzim* zërin e Gabrielit: Gëzohu,⁴⁹ krenari* oshënarësh, gaz ki, burim uji fort i gjall',*⁵⁰ gaz ki, ar' e pakultivuar, gëzohu ti,* zgjidhje e mallkimit⁵¹ dhe hare.

Irmosi: Anarhu jenítoros

Bir prindi pa nisje

Dërgimësore
O uranón tis astris

Çudi! Si pranë portës* së lindësve për shumë koh'* rrije si diamant, Aleks shenjt,* pa u përkulur në dhunim,* nga qarjet me vaj të nuses,* të prindërve, sipas të gjakut.

Hyjlindësore

O Virgjëreshë, linde* atë që bëri shekujt mbar',*⁵² që për Zot e kanë engjëjt,* lutju që të na shfaqë pra,* ne shërbëtorët e tu, si* kungues në vend të djathtë.⁵³

CITIME

¹ Gjyq. 13.6 etj.; II Tim. 3.17; II Petr. 1.21

^{1a} Num. 14.19 etj.

² Hebr. 4.12; Apok. 1.16; 2.12

³ Ps. 135(136).6; Jov 26.7-8

⁴ Tobit 5.14

⁵ Matth. 7.14

⁶ I Thes. 2.10

⁷ Ps. 61(62).11

⁸ Hebr. 10.34

⁹ I Mbret. [Sam.] 1.5-20

¹⁰ Is. 26.18

¹¹ Fil. 2.7

¹² Lluk. 1.48

¹³ Is. 35.1

^{13a} I Mbret. [Sam.] 2.1

¹⁴ Hebr. 12.1

¹⁵ Matth. 8.20; Lluk. 9.58

¹⁶ Is. 60.1

¹⁷ II Kor. 4.6

¹⁸ Is. 6.2

¹⁹ I Thes. 3.13

²⁰ Ps. 5.8; 68(69).14; 105(106).7,45

²¹ Joan 8.46

²² Is. 63.9

²³ Lluk. 16.20

²⁴ I Kor. 3.16; 6.19; II Kor. 6.16

²⁵ I Tim. 2.5

²⁶ Rom. 5.2; Ef. 2.18; 3.12

²⁷ Matth. 13.8; Mark. 4.8

²⁸ Joan 15.1

²⁹ Rom. 12.12; Kol. 4.2

³⁰ I Tim. 6.16

^{30a} Jona 2.7

³¹ Vep. 10.4

³² Ps. 140(141).2

³³ Gal. 5.22

³⁴ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 23

³⁵ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 26

³⁶ Kol. 3.5

³⁷ Rom. 8.6

³⁸ Kol. 1.25-26

³⁹ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 23-24

⁴⁰ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34

⁴¹ Kol. 2.3

⁴² Ps. 46(47).10

⁴³ Gjen. 3.2-6

⁴⁴ Is. 9.2; 42.16; Matth. 4.16; Lluk. 1.79

⁴⁵ Is. 11.12

⁴⁶ Is. 6.1; Joan 11.40; 12.41; Vep. 7.55

⁴⁷ Is. 35.5-6; 61.1; Matth. 11.5;

Lluk. 4.18; 7.22

⁴⁸ IV[II] Mbret. 2.11

⁴⁹ Lluk. 1.28

⁵⁰ Joan 4.10

⁵¹ Gjen. 3.16-19

⁵² Hebr. 1.2

⁵³ Matth. 25.32-33



MË 24 TË TË NJËJTIT MUAJ

E Parakremtja e Ungjillëzimit
(Evangjelizmoit) të Perëndilindësës
së Tërëshenjtë.

Tipikon

Shih Tipikonin e së nesërmes.



NË MBRËMËSORE

Thirrto

Ting. IV Os jeneon en mártisin

Një mister që ish fshehur krejt,*¹ i panjohur prej engjëjve,*² i besohet shën Gabrielit që po vjen* te ti, e vetme pa cen dhe pëllumbeshë plot bukuri³* dhe rithirrje e gjinis',* të thërret kryeengjëlli, o e Tërëshenjt':* Gaz ki dhe përgatitu ta pranosh në mitrën tënde, përmes fjale⁴ ti, Fjalën Zot, Perëndinë Krisht.

(2x)

U bë gati për ty, o Zot,* një pallat dritëprurës nur,* mitra e paprishur krejt e hybjijës pra;* eja në të, zbrit, si të të vijë keq për krijimin tënd* të luftuar prej zilis',* që i papastri rob e mban,*⁵ dhe e humbi keq* bukurin' e mëparshme edhe po pret zbritjen tënde shpëtimtare me ngazëllim dhe me padurim.

Zonjë e paqortueshme,* kryeengjëlli Gabriel* haptas do të vijë të të thërrasë ty:* Zgjidhja e nëmës,⁶ gëzohu, rimëkëmbje të rënësh je,*⁷ gaz ki, se prej Perëndis'* vetëm ti u përzgjedhe pra,* ki gaz, re e gjall'* dhe e shenjtë e Diellit;⁸ mikprit atë që nuk ka mish, që do që të rrijë brenda në barkun tënd.

Lavdi dhe Tani

Ting. II I Kozma Monakut

Gabrieli ungjillëzon te Hirplota sot: Gëzohu, o Vajzë e panusëruar dhe e pamartuar; mos u çudit nga pamja ime e huaj, as mos u frikëso, sepse jam kryeengjëll; një gjarpër e mashtroi Evën dikur;⁹ tani të ungjillëzoj harenë, dhe do të mbetesh e paprishur, dhe do të lindësh Zotin, o e pacenuar.

Hyrje. Leximet dhe Liturgjia e të Parashenjtëruarave.

Përlëshore Parakremto *Ting. IV*

Sot pararendja e haresë botërore nxit të këndojmë të parakremten, sepse ja ku vjen Gabrieli dhe do t'i thërrasë asaj: Gëzohu, o Hirplote, Zoti është me ty.

Nëse nuk bëhet Liturgji, në Pasvargjet: Idhiomeli i ditës (2x) dhe Martiriku.

*Lavdi dhe Tani i së kremtes, çfarëdo.
Gëzohu, o Hyjlindëse Virgjëreshë Hirplote
etj., dhe Tri Metanitë e Mëdha.*



NË MËNGJESORE

*Kanunet: Parakremtori dhe i Triodhit
në vendin e tij.*

*Kanuni Parakremtor (në 6)
Poezi e Gjergjit ose, sipas të tjerëve,
e Theofanit
Ting. IV
Ode I*

Irmosi: Thalasis to erithreon

»**F**ormonte* me duar Moisiu kryq, kë-
»shtu dhe populli,* i vjetri Izrael, me
»këmbë pra* të palagura Detin e
»Kuq*¹⁰ e shkeli, prishi dhe fuqin' e
»Amalikut nëpër shkretëtir'.¹¹

Gëzohu,* plot me hare, o botë, se e
ndien që vjen te ti* Jisui Zot, sepse
me dhembshuri* zbret nga qielli,¹²
zbret në ty,* dhe do të mishërohet ky
përbrenda barkut të së Virgjës Vajz'.

Ja te ti* ku po dërgohet kryeengjë-
lli i shenjt' hyjnor* i Perëndisë, mbre-
tit mbi çdo gjë,* të paralajmërojë
ardhjen* e tij, "Gëzohu" do thërrasë,
për rithirrjen e Adamit at'.

O shtambë* tepër e artë dritëpru-

rëse, stolisu ti* me hijeshi, që ma-
nën¹³ e jetës* ta mikpresësh, do vijë
te ti;* në ty do të banojë mbi natyrë
me një zë prej engjëlli.

E pastër,* në mitrën tënde ka për të
banuar Zoti Krisht,* që përgjithmonë
rri në qiejt¹⁴ lart,* sepse vjen që si
qiell ta bëj* esencën njerëzore, pasi
do të vishet me të qartazi.

Ode III

Irmosi: Uk en sofia

»**S**'mburremi fare* për fuqi, urtësi,
»as për pasuri,* por për ty,¹⁵ o urtësi*
»enipostate e Atit, o Krisht*¹⁶ njeri-
»dashës, se përveç teje s'ka tjetër
»shenjt'.¹⁷

O dhë që nxore* në mënyrë trishtu-
ese gjemba,⁶ lot* nga pasionet, pikë-
llim,* kërce, hidh valle, se bujku¹⁸ që
s'vdes* ja ku vjen tani të të nxjerrë
nga nëma⁶ ty.

Shtëllung' e hyjshme,* Virgjëreshë
pa njollë, gatitu ti:* Perëndia porsi
shi* mbi ty do zbresë,¹⁹ do thajë rrë-
ke* që ka rrjedhur, kur shkeljen bëri
gjinia jon'.

Vëllim²⁰ i hyjshëm,* hijeshohu, se
Fjala Hyjnore Krisht* përmes gishtit
atëror* në ty do shkruhet²¹ kur mish
do të marr',* duke zgjidhur shkeljen
që bëra pa mendje un'.

Kandil i artë, *²² mikprit zjarrin, Hyjninë, se kjo nga ti * do shkëlqejë vezullim, * do t'i dhurojë drit' botës; me të * terr i ligësisë son', faji, do zgjidhet krejt.

Irmosi: Uk en sofia

S'mburremi fare

Ndenjësores

Ting. III Tin oreótita

Tërë Krijesa sot * ka gaz, se engjëlli * "Gëzohu" të thërret, * "je e bekuar ti, * e tërëpaqortueshme, modeste, e pacenuar". * Pranga e mallkimit⁶ ra, * që na vuri stërati yn', * çdo tërbim i gjarprit djall *^{22a} shuhet sot, të thërresim pra: * Gëzohu, o Hirplote e virgjër, * linde ti Perëndinë tonë.

Lavdi dhe Tani

I njëjti

Ode IV

Irmosi: Eparhenta se idhusa

»**K**isha kur të pa ty, Diellin e drejt'si-
»së *²³ që të jesh ngritur përmbi kryq, *
»për hirin e saj pra, * mbeti e çuditur
»në vend; *²⁴ thërriste siç duhej fort: *
»Lavd fuqisë sate, o Zoti Krisht.

Misteri që u paracaktua qëmoti, para jetëve, fillon të shfaqet;¹ o tokësore

dhe qiellore, dëfreni së bashku²⁵ dhe bërtisni gëzueshëm.

O pallat i madh i Mbretit, hapi hyrjet e hyjshme të dëgjimit, sepse tashmë do të vijë Krishti, e vërteta,²⁶ dhe do të fushojë mes teje.

Çlirimtari, duke banuar në mitrën që s'njohu dasmë, do të shfaqet rimëkëmbës i rrëshqitjes së stërnës.⁹ Atij le t'i këndojmë: Lavdi fuqisë sate, o Zot.

Abakumi të paratha qëmoti mal të dendur me virtyte nga ku kishte për t'u shfaqur Perëndia²⁷ ynë, o e Virgjër e tërëpaqortueshme, e vetmja bukuria e njerëzve.

Ode V

Irmosi: Si Kirié mu fos

»**S**i dritë, Zoti im, * në mbar' botën
»ke ardhur ti, *²⁸ si shndritje e shenjtë,
»që nxjerr * nga padija e errët²⁹ sa të
»himnojnë me besim.

O shqerrë e panjollë, qengji i Perëndisë tonë nxiton të futet në mitrën tënde, duke ngritur mëkatet tona.³⁰

Purteka mistike pas pak le të lulëzojë, siç është shkruar, lule hyjnore, që na shfaqet nga rrënja e Jeseut.³¹

O Virgjëreshë, pasi u plehërove si hardhi me anën e zërit të engjëllit,

përgatitu për mbirjen e bistakut të pjekur dhe të pacenuar.

O Isaia, më i madhi ndër profetët, dëfre, sepse Virgjëresha që parathe, zë në bark³² engjëllin e vendimit të madh.³³

Ode VI

Irmosi: Thiso si meta fonís

»**D**o flijoj* me zë himnimi,³⁴ Kisha
»thërret te ti,* o Zot, sepse përmes
»gjakut,* që nga brinja jote për për-
»dëllim rrjedh,* u pastrua* nga çdo
»pisllek prej gjakrash demonësh kjo.

Ty të tha:* “Gëzohu”, kryeengjëlli Ga-
briel,* se pa shpjegim do të zësh ti*
brenda barkut tënd gazin që kish hu-
mbur,* o e Virgjër,* përmes mëkatit
Eva, stërnëna jon’.³⁵

Mos u tremb* aspak, o Vajzë, se s’e
djeg barkun tënd* ky zjarr i madh i
Hyjnisë,* të simbolizonte më parë
ferra* që qëmoti,* o e dëlir’, s’shkru-
mbohej, sado digjej.³⁶

Ty të pa,* o Zonjë, Danieli në Shpirt
si mal;* Gëzohu, o Virgjëreshë,* se
nga ti do pritet guri mendor krejt;*
do dërrmojë* statujat³⁷ e pashpirt të
demonëve.

O Hyjnën’,* te ti do vijë mbreti i pa-
qes³⁸ son’* t’i paqësojë³⁹ me ty pra,*

sa përmes këshille dinake gjarpri*⁹
u luftuan* dhe kanë humbur, Zonjë,
dhe vuajnë.

Irmosi: Thiso si meta fonís

Do flijoj me zë himnimi

Kontaqi

Ting. IV Epefanis símeron

Zure të bashk’fronshmin Zot,* të
bashkëqenshmin* tok me Atin, me
një zë* nga kryeengjëlli, madje* kur
erdhi Shpirti i Tërëshenjt’;* rithirrje
je e Adamit, Hyjlindëse.

Sinaksari

Më 24 të të njëjtit muaj, e Para-
kremtja e Ungjillëzimit të Perëndi-
lindëses së Tërëshenjtë; dhe kujtimi
i atit tonë oshënar Artemoni, episkop
i Selefkisë së Pisidhisë.

Vargje: Meqenëse Artemoni e hodhi
mishin si lëvozhgë,/ shkon drejt qiellit
duke mos pasur gjë nga toka.

Rreth të njëzet e katrës të priti Edeni,
o Artemon.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i hiero-
martirit të shenjtë Artemoni, presviter
i Laodhikisë.

Vargje: Pasi iku nga bota dhe iu afrua
Perëndisë,/ Artemoni thotë: Jam yti
dhe më shpëto.

Në të njëjtën ditë, oshënar Zaharia mbaron me paqe.

Vargje: Meqë ngjasove me Perëndinë në fuqi, pasi u largove nga dheu/ bëshesh bashkëtrashëgimtar me Bir Perëndie.⁴⁰

Në të njëjtën ditë, Tetë Martirët e shenjtë nga Qesaria e Palestinës mbarojnë me shpatë.

Vargje: E therën togun prej tetë personash, i cili ishte i Shpëtimtarit/ që më parë u rrethpre ditën e tetë.⁴¹

Në të njëjtën ditë, oshënar Martin thiveasi mbaron me paqe.

Vargje: Pasi arrite shumë mirë në pleqëri të mirë,⁴² kur vdiqe, u shtove tek etërit e vdekur,⁴³ o Martin.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII

Irmosi: O dhiasosas en piri

»**T**i që shpëtove në zjarr Djemtë e tu »abrahamianë dhe vrave kaldenjtë,⁴⁴ »të cilët padrejtësisht u ngritën kurth »të drejtëve,⁴⁵ o Zot i përmbihimnuar »i etërve tanë, je i bekuar.⁴⁶

O arkë mendore,⁴⁷ që ligjvënësi i vërtetë të deshi dhe ka për të bërë brenda teje fushim, mbushu me ngazëllim, sepse me anën tënde do të ripërtëritë të prishurit.

Një kor i hyjshëm profetik sikur ta ndiente, o Vajzë, mbiardhjen paqësore të Çlirimtarit mbi ty, të thërriste: Gëzohu, shpengimi i të gjithëve, gëzohu, shpëtimi i vetëm i njerëzve.

Mos u frikëso nga zëri, mos u shtang nga folësi; është shërbëtor Perëndie;⁴⁸ të erdhi që të të zbulojë mister të parrëfyeshëm për engjëj,² o Mari e bekuar pa dasmë.

Shikon Krijesën e tërë të skllavëruar⁴⁹ nga armiku, o Virgjëreshë, dhe shikon mirëdashësin që do që ta mëshirojë nga dhembshuria përmes teje; prandaj mos vazhdo më të kesh pabesim te fjalët e engjëllit.

Ode VIII

Irmosi: Hiras ekpetasas Dhaniil

»**D**uke* ngritur duart, Danieli mbylli »gojë të luanëve në grop*; »dhe shuan »forcën e zjarrit krejt* kur u ngjeshën »me virtyt Djemtë,* pra miqtë e shpre- »sëtaris',* tok duke thirrur me gaz: »Bekoni* ju gjithë veprat e Zotit, pra »Zotin ton'.⁵⁰

Hijeshohu, ti, pa njohje dasme, reja e lehtë⁸ e dritës, sepse ja ku do të shkëlqejë mbi ty nga lart Dielli i pa-perëndueshëm; do të fshihet thellë në ty për pak, por do të feksë në botë dhe do të shpërndajë errësirën e së keqes.

Shërbyesi i parë i engjëjve të lëshon zë ngazëllues, duke të lajmëruar qartazi, o e pacenuar, engjëllin e vendimit të madh,³³ se do të mishërohet prej teje nga mirësia; atij i thërrasim: Gjithë veprat, himnoni Zotin.⁵⁰

Si trëndafil i pastër livadhi, si zambak⁵¹ erëkëndshëm, pasi të kuptoi Zoti, gatuesi ynë, dëshiroi tani bukurinë tënde,⁵² o e kulluar, dhe do që të mishërohet nga gjakrat e tua, që të dëbojë nga mirësia erën e keqe të mashtrimit.

I përmbisubstancshmi, duke mos u larguar nga e djathta e Atit,⁵³ do të ngrejë banimin në ty, o e pacenuar, që të të vendosë në të djathtë e tij ty, si mbretëreshë,⁵⁴ të afërmen dhe të bukurën,⁵⁵ dhe të shtrijë të djathtë mbi ne, të gjithë të rënët, dhe të na shpëtojë.

Irmosi: Hiras ekpetasas Dhaniil

Duke ngritur duart, Danieli

Ode IX

Irmosi: Eva men to tis parakoís

»**E**va, nga sëmundja e mosbindjes⁹,
»mori keq* si banues brenda saj mall-
»kim,*⁶ por, o Hyjlindëse e virgjër,* ti,
»nëpërmjet lastarit të shtatzënis',*
»për botën e lulëzove bekimin krejt;*
»ndaj ne të gjithë të madhështojmë ty.

Fryt që kultivoi vdekjen shkatërruese* Eva e ka vjellë,⁶ por në ty* fryti shkaktar pavdekësie,* paprishjeje krejt, Krishti,⁵⁶ do mbijë pra;* o Zonjë, ky për ne është ëmbëlsi,* kur e himnojmë, të lëvdojmë ty.

Uli qiejt edhe zbrit⁵⁷ te ne, sepse tani* u gatit për ty, o Fjalë Krisht,* froni, pra mitra virgjërore;* në të do rrish si një mbret i bukur shum',* ta ngresh që nga rënia poshtë krijimin tënd,* se e gatove⁵⁸ me të djathtë, Zot.

Deshi bukurinë tënde,⁵² ndaj banon,* o e tërëpaqortueshme,* në mitrën tënde, ta çlirojë* gjininë njerëzore nga çdo shëmti* prej vesesh, stolin' e lashtë t'ia dhurojë ky;* duke iu falur, të lëvdojmë ty.

Fjalën qiellore ti, o e kulluar, vend* i pambjellë, prite me fjalim,*⁴ prite si grurin krejt frytdhënës* që mbin prej teje edhe ushqen çdo skaj* të botës me bukë njohjeje, ndaj dhe ne,* duke iu falur, të lëvdojmë ty.

Irmosi: Eva men to tis parakoís

Eva nga sëmundja e mosbindjes

Dërgimësore

Jinekes akutisthite

E tërëqashtë, të ofrojm'* përpara festës si blatim* përulësi, himne,

kreshmë,* dëlirësi, mençuri, lot* dhe dëshirim të pasur ne* për varfërinë, lutjen;* bashkëpunë, o Zonjë, pra* me ne, hidh syt' mbi të gjithë* me dhembshuri, o Hyjnënë.

Në Pasvargje, Idhiomeli (2x) dhe Martiriku.

Lavdi *dhe* Tani

Ting. IV

Një gjuhë që nuk e njohu dëgjoji Perëndilindësja, sepse i fliste krye-engjëlli fjalët e ungjillëzimit; prandaj, meqë pranoi besërisht përshëndetjen, të zuri ty, Perëndinë para jetëve; kështu edhe ne, duke u ngazëlluar, të thërrasim: O Perëndi që u mishërove pa ndryshim prej saj, fali botës paqe⁵⁹ dhe shpirtrave tanë përdëllimin e madh.⁶⁰

*Është mirë t'i falemi. Trishenjtë.
Përlëshorja. Tri Metanitë e Mëdha
etj.*

CITIME

¹ Rom. (14.24) 16.25; Ef. 3.3; Kol. 1.26

² I Petr. 1.12

³ Kënga 2.10,13

⁴ Lluk. 1.28-35

⁵ Ef. 6.12

⁶ Gjen. 3.16-19

⁷ Lluk. 2.34

⁸ Is. 19.1

⁹ Gjen. 3.4-7

¹⁰ Eks. 14.22,29

¹¹ Eks. 17.8-13

¹² Joan 3.13

¹³ Eks. 16.33; Hebr. 9.4

¹⁴ Ps. 2.4

¹⁵ I Mbret. [Sam.] 2.10; Jer. 9.23(22)

¹⁶ I Kor. 1.24,30

¹⁷ I Mbret. [Sam.] 2.2; II Mbret. [Sam.] 7.22

¹⁸ Joan 15.1

¹⁹ Gjyq. 6.37-38; Ps. 71(72).6

²⁰ Is. 8.1

²¹ Eks. 31.18; Ligji i Dytë 9.10

²² Eks. 25.30-37; 35.16; 38.13; 40.22; Num. 4.9; 8.2; Hebr. 9.2

^{22a} Gjen. 3.1-6

²³ Mal. 4.2 (3.20)

²⁴ Abak. 3.11

²⁵ Ps. 95(96).11; Is. 44.23; 49.13

²⁶ Joan 14.6

²⁷ Abak. 3.3

²⁸ Joan 3.19; 12.46

²⁹ Vep. 26.18

³⁰ Is. 53.7; Joan 1.29,36

³¹ Is. 11.1

³² Is. 7.14

³³ Is. 9.6

³⁴ Jona 2.10

³⁵ Gjen. 3.23-24; II Kor. 11.3

³⁶ Eks. 3.2-5

³⁷ Dan. 2.34-35

³⁸ Hebr. 7.2

³⁹ Ef. 2.17

⁴⁰ Rom. 8.17

⁴¹ Lluk. 2.21

⁴² Gjen. 15.15; I Kron. 29.28

⁴³ Gjyq. 2.10; IV[II] Mbret. 22.20; II Kron. 34.28, I Makk. 2.69; Vili dhe dragoi 1

⁴⁴ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 23-26

⁴⁵ Dan. 3.8-11

⁴⁶ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2

⁴⁷ Eks. 25.9-20; 38.1; Ligji i Dytë 10.2;
Ps. 131(132).8; Hebr. 9.4

⁴⁸ Hebr. 1.14

⁴⁹ Rom. 8.20

⁵⁰ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34

⁵¹ Kënga 2.1-2

⁵² Ps. 44(45).12

⁵³ Ps. 109(110).1; Matth. 22.44; Mark.
12.36; 16.19; Lluk. 20.42; Vep. 2.34

⁵⁴ Ps. 44(45).10

⁵⁵ Kënga 1.15; 2.10,13; 4.1,7; 6.4(3)

⁵⁶ Joan 6.50

⁵⁷ II Mbret. [Sam.] 22.10; Ps. 17(18).10;
143(144).5; Jov 38.37

⁵⁸ Gjen. 2.7

⁵⁹ Joan 14.27

⁶⁰ Num. 14.19 etj.



MË 25 TË TË NJËJTIT MUAJ

**Ungjillëzimi (Evangelizmoi) i së Tërëshenjtës, Perëndilindëses
dhe Gjithmonëvirgjrës Mari.**

Tipikon

1. Nëse bie të premten e Javës së Parë të Kreshmëve të Mëdha:

Të mërkurën në Mbrëmësore, Thirrtores: 6 të Triodhit dhe 3 Parakremtore (Një mister që ish fshehur krejt, fq. 40) në 4. Lavdi dhe Tani Parakremtor (Gabrieli ungjillëzon te Hirplota, fq. 40). Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e Triodhit. Le të drejtohet dhe Liturgia e të Parashenjtëruarave.

Në Pasdarkën e Madhe psalet pjesa e tretë e Kanunit të Madh.

Të enjten në Mëngjesore, pas Perëndi është Zoti, Përlëshorja Parakremtore (Sot pararendja e haresë, fq. 40) (2x). Ndenjësoret e Triodhit. Psalmi 50 (hima). O Perëndi, shpëtoje popullin tënd dhe bekoje trashëgimin tënd, vështroje. Stihologjia e 9 Odeve. Kanunet: Parakremtor dhe Triodhet e ditës në Odet e tyre. Pas Odes III, Ndenjësores Parakremtore (Tërë Krijesa sot ka gaz, fq. 42) (2x). Pas Odes VI, Kontaqi Parakremtor (Zure të bashk'fronshmin Zot, fq. 43) dhe Sinaksari. Më të nderuarën. Dërgimësore Parakremtore (E tërëqashtër, të ofrojm', fq. 45) (1x). Ty të ka hije dhe Dhoksologjia e Vogël. Pasvargjet: Idhiomeli i Triodhit (2x) dhe Martiriku. Lavdi dhe Tani Parakremtor (Një gjuhë që nuk e njohu, fq. 46). Është mirë t'i falemi. Trishenjtë. Përlëshore Parakremtore (Sot pararendja e haresë, fq. 40). Mëshiro, o Zot (40x). Lavdi dhe Tani. Më të nderuarën. Beko, o atë. Krishti Perëndia ynë, që është. O mbret qiellor, siguroji. Tri Metanitë e Mëdha dhe menjëherë Orët (e Thjeshta) me Përlëshoren dhe Kontaqin Parakremtor. Në Orën VI lexohet edhe Tropari i Profecisë dhe Profecia.

Në të njëjtën ditë (të enjten) Mbrëmësorja e Madhe dhe të Premten, Shërbesa e Mesnatës, Mëngjesorja dhe Liturgia.

Mbyllja

Në të njëjtën ditë (të premten) në Mbrëmësore, Thirrtores: të 3 të së kremtes (Duke të zbuluar ty, fq. 82), 3 të Kryeengjellit (Me pamje të ndritshme, fq. 98) dhe 4 të shën Theodorit. Lavdi i shenjtit. Tani Paskremtor (U dërgua prej qiellit kryeengjell, fq. 98). Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. (Nuk lexohen Leximet

e Triodhit). Pasvargjet e së kremtes (Në muajin e gjashtë u dërgua, fq. 85). Lavdi i shenjtit (kërkoje në të shtunën, në Pasvargjet e Lavdërimeve të tij). Tani i së kremtes (Sot ka ungjillëzime hareje, fq. 86). Tani përlëshojë, dhe menjëherë Përlufteshës gjenerale (ngadalë) dhe lexohet Stanca I e Himnit Akathist. Përsëri Përlufteshës gjenerale (shpejt). Trishenjtë. Përlëshoret: e së kremtes, e shenjtit dhe përsëri e së kremtes.

Të shtunën në Mëngjesore. Ndenjësoret: pas Stihologjisë së parë, të së kremtes (Arrin në Nazaret, fq. 87). Lavdi Gabrieli i thërret modestes, fq. 87. Tani (Së dëlirës Virgjërësh', fq. 87). Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësoret e shenjtit, por në vend të Hyjllindësore, Ndenjësore Parakremtore (Tërë Krijesa sot ka gaz, fq. 42). Kanunet: i së kremtes, i Kryeengjellit dhe një i shenjtit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtit. Ndenjësoret: një e Kryeengjellit, një e shenjtit dhe e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e së kremtes. Sinaksari i ditës dhe i Triodhit. Zbritësoret e së kremtes. Në vend të Më të nderurën, Ode IX e së kremtes [dhe e të tjerave]. Dërgimësoret: e para e së kremtes, e shenjtit dhe e dyta e së kremtes. Lavdërimet: 3 të së kremtes dhe 3 të shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani i së kremtes (Le të dëfrejnë qiejt; kërkoje pikërisht para Citimeve të 25-ës, fq. 96). Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e së kremtes.

Në Liturgji. Antifonet dhe Hyrtorja e së kremtes. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e së kremtes, e Kryeengjellit, e shenjtit dhe e kishës. Kontaqi Përlufteshës gjenerale. Apostulli i shenjtit dhe Ungjilli i ditës. Në vend të Të meriton, Zbritësorja e Odes IX e së kremtes. Kungatorja e së kremtes.

2. Nëse bie të shtunën (e shën Theodhorit) të Javës së Parë

të Kreshmëve të Mëdha:

Shërbesa e shën Theodhorit psalet më parë, të premten, si më poshtë:

Të enjten në Mbrëmësore. Thirrtores: 3 të Triodhit, 3 Parakremtore (Një mister që ish fshehur krejt, fq. 40) dhe 4 Idhiomelet e shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani Parakremtor (Gabrieli ungjillëzon te Hirplota, fq. 40). O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e Triodhit. Pasvargjet: Idhiomeli i Triodhit (2x) dhe Martiriku. Lavdi i shenjtit (kërkoje në Pasvargjet e Lavdërimeve të shenjtit). Tani Në muajin e gjashtë u dërgua (kërkoje në Pasvargjet e Mbrëmësore së Vogël të së kremtes, fq. 82). Përlëshoret: Parakremtore (Sot pararendja e haresë, fq. 40), e shenjtit dhe përsëri Parakremtore. Mëshiro, o Zot (40x). Lavdi dhe Tani. Më të nderuarën etj.

O Mbret qiellor, siguroji etj. *Tri Metanitë e Mëdha etj.* O Trini e Tërëshenjtë, që je pushteti. Emri i Zotit qoftë i bekuar. [Psalmi 33 dhe 144]. Përlëshim.

Të premten në Mëngjesore. Përlëshoret si në Mbrëmësore. Pas Stihologjisë së parë dhe të dytë, Ndenjësoret e Triodhit. Pas Stihologjisë së tretë, Ndenjësoret e shenjtit. Psalmi 50 (hima). O Perëndi, shpëtoje popullin tënd dhe bekoje trashëgimin tënd, vështroje. Stihologjia e 9 Odeve. Kanunet: Parakremtori dhe të dy të shenjtit. Në Odet që kanë Triodhet, lihen Kanunet e shenjtit dhe psalet Kanuni Parakremtor dhe Triodhet. Pas Odes III, Kontaqi Parakremtor (Zure të bashk'fronshmin Zot, fq. 43) dhe Ndenjësoret: e shenjtit dhe Parakremtore (Tërë Krijesa sot ka gaz fq. 42). Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtit dhe Sinaksari i ditës. Zbritësoret Ja gojën e çel tani. Më të nderuarën. Dërgimësoret: e shenjtit dhe Parakremtore. Lavdërimet: Idhiomeli i Triodhit (1x) dhe 3 të shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani Një gjuhë që nuk e njohu (kërkoje në fund fare të 24-ës, fq. 46). Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja Parakremtore. Mëshiro, o Zot (40x). Lavdi dhe Tani. Më të nderuarën. Beko, o atë. Krishti Perëndia ynë, që është i bekuar. O mbret qiellor, siguroji. *Tri Metanitë e Mëdha dhe menjëherë Orët (e Thjeshta).* Në Orën I dhe VI thuhet Përlëshorja dhe Kontaqi Parakremtor, ndërsa në III dhe IX, të shenjtit. Në Orën VI lexohet edhe Tropari i Profecisë dhe Profecia.

Në të njëjtën ditë (të premten) në Mbrëmësore. Thirrtoret: Idhiomeli i Triodhit (2x), Martiriku, 3 të së kremtes (Meqë i erdhi keq; kërkoji në Mbrëmësoren e Vogël, fq. 81) dhe 4 të shenjtit (3 Pasvargjet e Lavdërimeve në 4). Lavdi i shenjtit. Tani i së kremtes (Në muajin e gjashtë kryegjenerali; kërkoje në Thirrtoret e Mbrëmësorës së Vogël të së kremtes, fq. 81). Hyrja me Ungjillin. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e Triodhit. Le të drejtohet. Apostulli dhe Ungjilli i shenjtit dhe Liturgjia e të Parashenjtëruarave. Kungatore: Në kujtim të përjetshëm.

Në Mbrëmësoren e Madhe, pas Tani përlëshoje, Përlufteshës gjenerale (ngadalë) dhe Stanca I e Himnit Akathist. Përsëri Përlufteshës gjenerale (shpejt), Përlëshorja e së kremtes (3x) dhe Përlëshim.

Të shtunën, Shërbesa e Mesnatës, Mëngjesorja dhe Liturgjia.

Mbyllja.

Në të njëjtën ditë (të shtunën) në Mbrëmësore. Thirrtoret: 4 ngjallësore, 3 të së kremtes (Duke të zbuluar ty, fq. 82) dhe 3 të Triodhit. Lavdi i Triodhit. Tani i së kremtes (U dërgua prej qiellit kryeengjell, fq. 83). Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni

i ditës. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i Triodhit. Tani i së kremtes (Sot ka ungjillëzime hareje, fq. 86). Përlëshoret: ngjallësore, e Triodhit dhe e së kremtes.

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Kanunit Triadik, në Liti, Idhiomeli i parë i kishës. Lavdi i Triodhit. Tani i së kremtes (Gabrieli ungjillëzon te Hirplota, fq. 85). Himne Triadike. Trishenjtë. Përlëshorja e së kremtes. Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë, Ndenjësoret ngjallësore. Pas Stihologjisë së dytë, një ngjallësore dhe dy të së kremtes. Bekimtoret etj. Kanunet: ngjallësor; i së kremtes bashkë me Irmoset, dhe i Triodhit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore dhe Ndenjësoret e Triodhit, por në vend të Hyjlindësore, Ndenjësorja e së kremtes (U ul tani mbi dhë, fq. 89). Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Triodhit. Sinaksari i ditës dhe i Triodhit. Zbritësoret Ja gojën e çel tani; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Më të nderuarën dhe Ode IX [ngjallësore,] e së kremtes me Madhështimin [dhe e Triodhit]. Dërgimësoret: ngjallësore, e Triodhit dhe një e së kremtes. Lavdërimet: 2 ngjallësore, 3 të së kremtes dhe 3 të Triodhit. Lavdi i Triodhit. Tani E përmbibekuar. Dhoksologjia e Madhe dhe Litanja e Ikonave (bëhet këtu, ose në fund të Liturgjisë). Sot erdhi.

Në Liturgji. Antifonet e së kremtes, por në Hyrtoren e saj, Shpëtona..., që u ngjalle prej së vdekurish. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e së kremtes, e Triodhit dhe e kishës. Kontaqi Përlufteshës gjenerale. Apostulli dhe Ungjilli i Triodhit. Dhe Liturgjia e Shën Vasilit. Kungatore e së kremtes (Zgjodhi Zoti Sionin). Pamë dritën.

3. Nëse bie të dielën e parë (e Orthodoxosisë) të Kreshmëve të Mëdha:

Të premten në Mbrëmësore, Thirrtoret: Idhiomeli i Triodhit (2x), një prej Martirikëve, 3 Parakremtores (Një mister që ish fshehur krejt, fq. 40) dhe 4 të Triodhit (të shën Theodorit). Lavdi i Triodhit. Tani Parakremtor (Gabrieli ungjillëzon te Hirplota, fq. 40). Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e Triodhit. Le të drejtohet dhe Liturgjia e të Parashenjtëruarave.

Në Himnin Akathist, (Stanca I), Kontaqi Parakremtor (Zure të bashk'fronshmin Zot, fq. 43).

Të shtunën në Mëngjesore, pas Perëndi është Zoti, Përlëshoret: Parakremtores, e Triodhit, dhe përsëri Parakremtores. Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësoret e Triodhit (por pa Nekrosimin). Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësoret e Triodhit. Kanunet: Parakremtori dhe të dy të Triodhit. Pas Odes III, Kontaqi Parakremtor

dhe Ndenjësoret e Triodhit, por në vend të Hyjlindësore, Parakremtore (Tërë Krijesa sot ka gaz, fq. 42). Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Triodhit dhe Sinaksari i ditës si dhe i Triodhit. Zbritësoret Ja gojën e çel tani. Më të nderuarën. Dërgimësoret: e Triodhit dhe Parakremtore. Lavdërimet e Triodhit. Lavdi i Triodhit. Tani Parakremtor Një gjuhë që nuk e njohu (kërkoje në fund fare të 24-ës fq. 46). Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja Parakremtore.

Në Liturgji. Tipiket dhe nga Kanuni Parakremtor Ode III dhe nga i Triodhit Ode VI. Pas Hyrjes, Përlëshoret: Parakremtore, e Triodhit dhe e kishës. Kontaqi Parakremtor (Zure të bashk' fronshtmin Zot, fq. 43). Apostulli i Triodhit dhe Ungjilli i ditës. Liturgjia e Shën Joan Gojartit. Kungatore: Në kujtim të përgjeshëm. Pamë dritën.

Në të njëjtën ditë (të shtunën) në Mbrëmësore. Thirrtoret: 3 ngjallësore, 4 të së kremtes dhe 3 të Triodhit. Lavdi i Triodhit. Tani i së kremtes (U dërgua prej qiellit kryeengjëll, fq. 83). Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e së kremtes. Pasvargjet ngjallësore (ose ngjallësorja e parë dhe të së kremtes). Lavdi i Triodhit. Tani i së kremtes (Sot ka ungjillëzime hareje, fq. 86). Përlëshoret: ngjallësore, e Triodhit dhe e së kremtes.

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanuni Triadik dhe Litia e së kremtes. Lavdi i Triodhit. Tani i së kremtes (Gabrieli ungjillëzon te Hirplota, fq. 85). Himne Triadike. Trishenjtë. Përlëshorja e së kremtes. Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë, Ndenjësoret ngjallësore. Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësoret: një ngjallësore, Lavdi i së kremtes (Arrin në Nazaret, fq. 87), Tani gjithashtu i së kremtes (Tërë Krijesa sot ka gaz, fq. 87). Pas Polieleit të së kremtes, Ndenjësoret e së kremtes (Gabrieli i thërret modestes, fq. 87 dhe Së dëlirës Virgjëresh', fq. 87). Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat e Tingullit. Proqimeni i së kremtes (Ungjillëzoheni nga dita në ditë). Ungjilli i së kremtes. Ne që pamë ngjalljen. Psalmi 50 (hima) etj. të së kremtes. Kanunet: ngjallësor, i së kremtes bashkë me Irmoset dhe i Triodhit (edhe ai me Varg, por me Vargun: Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty). Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e Triodhit. Ndenjësoret e Triodhit dhe në vend të Hyjlindësore, e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e së kremtes. Sinaksari i ditës dhe i Triodhit. Zbritësoret e së kremtes. Në vend të Më të nderuarën, Ode IX e së kremtes (me madhështimin e saj). Dërgimësoret: ngjallësore, e Triodhit dhe një e së kremtes. Lavdërimet: 2 ngjallësore, 3 të së kremtes dhe 3 të Triodhit. Lavdi i së kremtes (Misteri i parajetshëm zbulohet, fq. 95). Tani E përmbi-

bekuar. *Dhoksologjia e Madhe dhe Litania e Ikonave* (bëhet këtu, ose në fund të Liturgjisë). Sot erdhi.

Në Liturgji, Antifonet e së kremtes. Hyrja e së kremtes, por Shpëtona..., që u ngjalle prej së vdekurish. Përlëshoret: ngjallësore, e së kremtes dhe e Triodhit. Kontaqi Përlufteshës gjenerale. Apostulli i Triodhit dhe Ungjilli i së kremtes. Liturgjia e Shën Vasilit. Në vend të Të meriton, Më ty gëzohet, o Hirplote. Kungatore [Lavdëroni, dhe] e së kremtes (Zgjedhi Zoti Sionin). Pamë dritën.

Mbyllja

Në të njëjtën ditë (të dielën) në Mbrëmësore, Thirrtoret: Idhiomeli (i Pasvargjeve të Triodhit) (1x), 3 Vargëzime të Triodhit, 3 të së kremtes (Duke të zbuluar ty fq. 82) dhe 3 të Kryeengjellit (Me pamje të ndritshme, fq. 98). Lavdi dhe Tani i Kryeengjellit (U dërgua prej qiellit kryeengjell, fq. 98). Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i Madh i Triodhit. Pasvargjet e së kremtes (Në muajin e gjashtë u dërgua etj., fq. 85). Lavdi dhe Tani i së kremtes (Sot ka ungjillëzime hareje, fq. 86 po aty). Përlëshorja e së kremtes (3x). Urtësi. Beko, o atë. Krishti, Perëndia ynë që është. O mbret qiellor, siguroji. Tri Metanitë e Mëdha dhe Përlëshimi i së kremtes.

4. Nëse bie të hënën e Javës së Dytë ose të Katërt të Kreshmëve të Mëdha:

Të shtunën në Mbrëmësore dhe të dielën në Mëngjesore nuk psalet shërbesa Parakremtores, psalet vetëm Triodhi.

Të dielën Mbrëmësorja e Madhe, dhe të hënën, Shërbesa e Mesnatës, Mëngjesorja dhe Liturgjia.

Mbyllja

Në të njëjtën ditë (të hënën) në Mbrëmësore (Nuk lexohet Psaltiri), Thirrtoret: 3 të së kremtes (Duke të zbuluar ty, fq. 82) dhe 3 të Kryeengjellit (Me pamje të ndritshme, fq. 98). Lavdi dhe Tani po i Kryeengjellit (U dërgua prej qiellit kryeengjell, fq. 98). Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. (Nuk lexohen Leximet e Triodhit). Pasvargjet e së kremtes (Në muajin e gjashtë u dërgua, fq. 85). Lavdi dhe Tani po i së kremtes (Sot ka ungjillëzime hareje, fq. 86). Trishenji. Përlëshorja e së kremtes (3x).

5. Nëse bie të martën e Javës së Dytë ose të Tretë, ose të Katërt, ose të Pestë, ose të Gjashtë të Kreshmëve të Mëdha:

Të dielën në Mbrëmësore. Thirrtoret: 7 të Triodhit dhe 3 Parakremtore (Një mister që ish fshehur krejt, fq. 40). Lavdi dhe Tani Parakremtor (Gabrieli ungjillëzon te Hirplota sot, po aty). Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i Madh i Triodhit. Pasvargjet: Idhiomeli i Triodhit (2x) dhe Martiriku. Lavdi dhe Tani Parakremtor (Një gjuhë që nuk e njohu; kërkoje në fund fare të 24-ës, fq. 46). Pas Trishenjtit: Gëzohu, o Hyjlindëse, Virgjëreshë Hirplote etj. Mëshiro, o Zot (40x). Lavdi dhe Tani. Më të nderuarën etj. O Mbret qiellor, siguroji etj. Tri Metanitë e Mëdha etj. O Trini e Tërëshenjtë, që je pushteti. Emri i Zotit qoftë i bekuar. [Psalmi 33 dhe 144]. Përlëshim.

Të hënë në Mëngjesore, pas Perëndi është Zoti, Përlëshorja Parakremtore (3x). Ndenjësoret e Triodhit. Psalmi 50 (hima). O Perëndi shpëtoje popullin tënd dhe bekoje trashëgimin tënd, vështroje. Stihologjia e 9 Odeve. Kanunet: Parakremtor dhe i Triodhit. Pas Odes III, Ndenjësorja Parakremtore. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Sinaksari Parakremtor. Më të nderuarën. Dërgimësorja Parakremtore (E tërëqashtë, të ofrojm' [2x], fq. 45). Ty të ka hije dhe Dhoksologjia e Vogël. Pasvargjet: Idhiomeli i Triodhit (2x) dhe Martiriku. Lavdi dhe Tani Parakremtor (Një gjuhë që nuk e njohu, fq. 46). Është mirë t'i falemi. Trishenjtë. Përlëshorja Parakremtore. Mëshiro, o Zot (40x). Lavdi dhe Tani. Më të nderuarën. Beko, o atë. Krishti Perëndia ynë, që është. O mbret qiellor, siguroji. Tri Metanitë e Mëdha dhe menjëherë Orët (e Thjeshta) me Përlëshoren dhe Kontaqin Parakremtor. Në Orën VI lexohet edhe Tropari i Profecisë dhe Profecia.

Në të njëjtën ditë (të hënë), Mbrëmësorja e Madhe, dhe të martën, Shërbesa e Mesnatës, Mëngjesorja dhe Liturgjia.

Mbyllja

Në të njëjtën ditë (të martën) në Mbrëmësore, (nuk lexohet Psaltiri) Thirrtoret: 3 të së kremtes (Duke të zbuluar ty, fq. 82) dhe 3 të Kryeengjëllit (Me pamje të ndritshme, fq. 98). Lavdi dhe Tani po i Kryeengjëllit (U dërgua prej qiellit kryeengjëll, fq. 98). Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Pasvargjet e së kremtes (Në muajin e gjashtë u dërgua, fq. 85). Lavdi dhe Tani po i së kremtes (Sot ka ungjillëzime hareje, fq. 86). Trishenjtë. Përlëshorja e së kremtes (3x).

**6. Nëse bie të mërkurën ose të enjten e Javës së Dytë, ose të Tretë,
ose të Katërt, ose të Gjashtë të Kreshmëve të Mëdha
(për të enjten e Javës së Katërt shih §14):**

Dy ditë më parë, pra të hënë ose të martën, përkatësisht, në Mbrëmësore, Thirrtoret: 3 të Triodhit dhe 3 Parakremtore (Një mister që ish fshehur krejt, fq. 40). Lavdi dhe Tani po Parakremtor (Gabrieli ungjillëzon te Hirplota sot, fq. 40). O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e Triodhit. Pasvargjet: Idhiomeli i Triodhit (2x) dhe Martiriku. Lavdi dhe Tani Parakremtor (Një gjuhë që nuk e njohu; kërkoje në Pasvargjet e Lavdërimeve Parakremtore, fq. 46). Pas Trishenjtë: Gëzohu, o Hyjlindëse, Virgjëreshë Hirplote etj. Mëshiro, o Zot (40x). Lavdi dhe Tani. Më të nderuarën etj. O Mbret qiellor, siguroji etj. Tri Metanitë e Mëdha etj. O Trini e Tërëshenjtë, që je pushteti. Emri i Zotit qoftë i bekuar. [Psalmi 33 dhe 144]. Përlëshim.

Një ditë më parë, pra të martën ose të mërkurën përkatësisht, në Mëngjesore, pas Perëndi është Zoti, Përlëshorja Parakremtore (Sot pararendja e hareshë [3x], fq. 40). Ndenjësoret e Triodhit. Psalmi 50 (hima). O Perëndi, shpëtoje popullin tënd dhe bekoje trashëgimin tënd, vështroje. Stihologjia e 9 Odeve. Kanunet: Parakremtor dhe i Triodhit. Pas Odes III, Ndenjësoja (Tërë Krijesa sot ka gaz [2x], fq. 42). Pas Odes VI, Kontaqi Parakremtor (Zure të bashk'fronshmin Zot, fq. 43) dhe Sinaksari. Dërgimësore Parakremtore (E tërëqashtër, të ofrojm', fq. 45). Ty të ka hije dhe Dhoksologjia e Vogël. Pasvargjet: Idhiomeli i Triodhit (2x) dhe Martiriku. Lavdi dhe Tani Parakremtor (Një gjuhë që nuk e njohu, fq. 46). Është mirë t'i falemi. Trishenjtë. Përlëshorja Parakremtore (Sot pararendja e hareshë, fq. 40). Mëshiro, o Zot (40x). Lavdi dhe Tani. Më të nderuarën. Beko, o atë. Krishti Perëndia ynë, që është. O mbret qiellor, siguroji. Tri Metanitë e Mëdha dhe menjëherë Orët (e Thjeshta) me Përlëshoren dhe Kontaqin Parakremtor. Në Orën VI lexohet edhe Tropari i Profecisë dhe Profecia.

Në të njëjtën ditë, pra të martën ose të mërkurën përkatësisht, në mbrëmje, Mbrëmësorja e Madhe dhe të nesërmen, pra të mërkurën ose të enjten, Shërbesa e Mesnatës, Mëngjesorja dhe Liturgjia.

Mbyllja

Në të njëjtën ditë (pra të mërkurën ose të enjten) në Mbrëmësore, Thirrtoret: 3 të së kremtes (Duke të zbuluar ty, fq. 82) dhe 3 të Kryeengjëllit (Me pamje të ndritshme, fq. 98). Lavdi dhe Tani po i Kryeengjëllit (U dërgua prej qiellit kryeengjëll;

po aty). Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. (Nuk lexohen Leximet e Triodhit). Pasvargjet e së kremtes (Në muajin e gjashtë u dërgua, fq. 85). Lavdi dhe Tani po i së kremtes (Sot ka ungjillëzime hareje, fq. 86). Trishenjtë. Përlëshorja e së kremtes (3x).

7. Nëse bie të premten e Javës së Dytë, ose të Tretë

të Kreshmëve të Mëdha:

Të mërkurën në Mbrëmësore. Thirrtoret: 6 të Triodhit dhe 3 Parakremtore (Një mister që ish fshehur krejt, fq. 40) në 4. Lavdi dhe Tani po Parakremtor (Gabrieli ungjillëzon te Hirplota sot, fq. 40). Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e Triodhit. Le të drejtohet dhe Liturgjia e të Parashenjtëruarave.

Të enjten në Mëngjesore, pas Perëndi është Zoti, Përlëshorja Parakremtore (Sot pararendja e haresë, fq. 40) (2x). Ndenjësoret e Triodhit (si zakonisht). Psalmi 50 (hima). O Perëndi, shpëtoje popullin tënd dhe bekoje trashëgimin tënd, vështroje. Stihologjia e 9 Odeve. Kanunet: Parakremtor dhe Triodhet. Pas Odes III, Ndenjësorja Parakremtore (Tërë Krijesa sot ka gaz, fq. 42). Pas Odes VI, Kontaqi Parakremtor (Zure të bashk' fronshmin Zot, fq. 43) dhe Sinaksari. Më të nderuarën. Dërgimësore Parakremtore (E tërëqashtë, të ofrojm' [1x], fq. 45). Ty të ka hije dhe Dhoksologjia e Vogël. Pasvargjet. Idhiomeli (2x) dhe Martiriku. Lavdi dhe Tani Parakremtor (Një gjuhë që nuk e njohu, fq. 46). Është mirë t'i falemi. Trishenjtë. Përlëshorja Parakremtore (Sot pararendja e haresë, fq. 40). Mëshiro, o Zot (40x). Lavdi dhe Tani. Më të nderuarën. Beko, o atë. Krishti Perëndia ynë, që është. O mbret qiellor, siguroji. Tri Metanitë e Mëdha dhe menjëherë Orët (e Thjeshta) me Përlëshoren dhe Kontaqin Parakremtor. Në Orën VI lexohet edhe Tropari i Profecisë dhe Profecia.

Të enjten në mbrëmje. Mbrëmësorja e Madhe dhe të premten, Shërbesa e Mesnatës, Mëngjesorja dhe Liturgjia.

Mbyllja

Në të njëjtën ditë (të premten) në Mbrëmësore, (nuk lexohet Psaltiri) Thirrtoret: 3 të së kremtes (Duke të zbuluar ty, fq. 82) dhe 3 të Kryeengjëllit (Me pamje të ndritshme, fq. 98). Lavdi dhe Tani po i Kryeengjëllit (U dërgua prej qiellit kryeengjëll; po aty). Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. (Nuk lexohen Leximet e Triodhit). Pasvargjet e së kremtes (Në muajin e gjashtë u dërgua, fq. 85). Lavdi dhe Tani po i së kremtes (Sot ka ungjillëzime hareje, fq. 86). Tani përlëshoje dhe menjëherë

Përlufteshës gjenerale (ngadalë) dhe lexohet Stanca (II ose III përkatësisht) e Himnit Akathist. Përsëri Përlufteshës gjenerale (shpejt). Trishenjtë. Përlëshorja e së kremtes (3x).

Të shtunën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Trishenjtë, në fund, Përlëshorja e së kremtes. Në Mëngjesore, pas Perëndi është Zoti, Përlëshorja e së kremtes (3x). Ndenjësoret e së kremtes si vijon: pas Stihologjisë së parë, Arrin në Nazaret, fq. 87, dhe Tërë Krijesa sot ka gaz (po aty). Pas Stihologjisë së dytë, Gabrieli i thërret modestes (fq. 87) dhe Së dëlirës Virgjërësh' (po aty). Kanunet: i së kremtes dhe i Kryeengjëllit. Pas Odes III, Ndenjësoret e Kryeengjëllit. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e së kremtes dhe Sinaksari i Kryeengjëllit. Zbritësoret e së kremtes. Në vend të Më të nderuarën, Ode IX e së kremtes (me Madhështimin e saj) dhe e Kryeengjëllit. Dërgimësoret dhe Lavdërimet e së kremtes. Lavdi dhe Tani Le të dëfrenjë qiejt (kërkoje pikërisht para Citimeve të 25-ës, fq. 96). Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e së kremtes.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e së kremtes. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e së kremtes, e Kryeengjëllit dhe e kishës. Kontaqi Përlufteshës gjenerale. Apostulli (kërkoje më 6 shtator) dhe Ungjilli (kërkoje më 8 nëntor) i Kryeengjëllit. Kungatore Zgjodhi Zoti Sionin. [dhe Ai që i bën engjëjt e tij frymë dhe shërbyesit e tij flakë zjarri, Aliluia]. Pamë dritën.

8. Nëse bie të shtunën e Javës së Dytë të Kreshmëve të Mëdha:

Të enjten në Mbrëmësore, Thirrtoret: 3 të Triodhit dhe 3 Parakremtore (Një mister që ish fshehur krejt, fq. 40). Lavdi dhe Tani po Parakremtor (Gabrieli ungjillëzon te Hirplota, fq. 40). O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e Triodhit. Pasvargjet: Idhiomeli i Triodhit (2x) dhe Martiriku. Lavdi dhe Tani Parakremtor Një gjuhë që nuk e njohu (kërkoje në Pasvargjet e Lavdërimeve, fq. 46). Pas Trishenjtë: Gëzohu, o Hyjlindëse, Virgjërëshë Hirplote etj. Mëshiro, o Zot (40x). Lavdi dhe Tani. Më të nderuarën etj. O Mbret qiellor, siguroji etj. Tri Metanitë e Mëdha etj. O Trini e Tërëshenjtë, që je pushteti. Emri i Zotit qoftë i bekuar. [Psalmi 33 dhe 144]. Përlëshim.

Të premten në Mëngjesore, pas Perëndi është Zoti, Përlëshorja Parakremtore (2x) etj. Psalmi 50 (hima). O Perëndi, shpëtoje popullin tënd dhe bekoje trashëgimin tënd, vështroje. Stihologjia e 9 Odeve. Kanunet: Parakremtor dhe Triodhet. Pas Odes III, Ndenjësorja Parakremtore. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Sinaksari Parakremtor. Më të nderuarën. Dërgimësorja Parakremtore. Ty të ka hije dhe Dhokso-

logjia e Vogël. Pasvargjet: Idhiomeli i Triodhit (2x) dhe Martiriku. Lavdi dhe Tani Parakremtor (Një gjuhë që nuk e njohu, fq. 46). Është mirë t'i falemi. Trishenji. Përlëshorja Parakremtoe (Sot pararendja e haresë, fq. 40). Mëshiro, o Zot (40x). Lavdi dhe Tani. Më të nderuarën. Beko, o atë. Krishti Perëndia ynë, që është. O mbret qiellor, siguroji. Tri Metanitë e Mëdha dhe menjëherë Orët (e Thjeshta) me Përlëshoren dhe Kontaqin Parakremtor. Në Orën VI lexohet edhe Tropari i Profecisë dhe Profecia.

Nuk bëhet Liturgjia e të Parashenjtëruarave.

Të premtën në mbrëmje, Mbrëmësorja e Madhe. Pas Tani përlëshoje, Përlufteshës gjenerale (ngadalë). Stanca II e Himnit Akathist. Përsëri Përlufteshës gjenerale (shpejt). Trishenji. Përlëshorja e së kremtes (3x).

Të shtunën, Shërbesa e Mesnatës, Mëngjesorja dhe Liturgjia.

Mbyllja

Në të njëjtën ditë (të shtunën) në Mbrëmësore, pas Psaltirit Thirrtoret: 4 ngjallësore, 3 të së kremtes (Duke të zbuluar ty, fq. 82) dhe 3 të Kryeengjellit (Me pamje të ndritshme, fq. 98). Lavdi i së kremtes (U dërgua prej qiellit kryeengjell, fq. 98). Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i Triodhit. Tani i së kremtes (Le të dëfrejnë qiejt; kërkoje pikërisht para Citimeve të 25-ës, fq. 96). Përlëshoret: ngjallësore dhe Parakremtoe (2x).

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, si zakonisht. Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë, Ndenjësoret ngjallësore. Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësoret: një ngjallësore dhe dy të së kremtes. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimeni i Tingullit. Kanunet: ngjallësor, i së kremtes (bashkë me Irmoset e tij) dhe i Triodhit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e Triodhit dhe Ndenjësoeja e Triodhit, por në vend të Hyjlindësore, Ndenjësoeja e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore. Sinaksari i ditës dhe i Triodhit. Zbritësoret Ja gojën e çel tani; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Më të nderuarën dhe Ode IX [ngjallësore dhe] e së kremtes (me Madhështimin e saj) [dhe të Triodhit]. Dërgimësoret: ngjallësore, e Triodhit dhe një e së kremtes. Lavdërimet: 2 ngjallësore, 3 të së kremtes dhe 3 të Triodhit. Lavdi i Triodhit. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Antifonet e së kremtes, por në Hyrtoren e saj, Shpëtona..., që u ngjalle prej së vdekurish. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e së kremtes, e

Triodhit (e shën Grigor Pallamait) dhe e kishës. Kontaqi Përlufteshës gjenerale. Apostulli dhe Ungjilli i Triodhit. Kungatore e së kremtes.

9. Nëse bie të Dielën e Dytë (të shën Grigor Pallamait)
të Kreshmëve të Mëdha:

Shërbesa e shën Grigorit psalet më parë, të shtunën, së bashku me shërbesën Parakremtore si më poshtë:

Të premten në Mbrëmësore, Thirrtoret: Idhiomeli i Triodhit (2x) një Martirik, 3 Parakremtore (Një mister që ish fshehur krejt, fq. 40) dhe të 3 të shën Grigorit (në 4). Lavdi i shën Grigorit. Tani Parakremtor (Gabrieli ungjillëzon te Hirplota, fq. 40). Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e Triodhit. Le të drejtohet dhe Liturgjia e të Parashenjtëruarave.

Në Himnin Akathist, (Stanca II), Kontaqet: Parakremtor (Zure të bashk'fronshmin Zot, fq. 43) dhe i shën Grigorit.

Të shtunën në Mëngjesore, pas Perëndi është Zoti, Përlëshorja Parakremtore, e shën Grigorit dhe përsëri Parakremtore. Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësoret e Triodhit (pa Nekrosimin). Pas Stihologjisë së dytë Arrin në Nazaret (2x) (kërkoje pas Stihologjisë së parë të së kremtes, fq. 87). Kanunet: Parakremtor dhe i shën Grigorit (ndërsa nga Ode VI shtohet edhe Tetraodhi i dytë i ditës pa Nekrosimet). Pas Odes III, Kontaqi Parakremtor (Zure të bashk'fronshmin Zot, fq. 43) dhe Ndenjësoret e shën Grigorit dhe Parakremtore. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e shën Grigorit dhe Sinaksari i ditës. Zbritësoret Ja gojën e çel tani. Më të nderuarën. Dërgimësoret: e shën Grigorit dhe Parakremtore. Lavdërimet e shën Grigorit (në 4). Lavdi i shën Grigorit (kërkoje në Pasvargjet e Mbrëmësorës së tij). Tani Një gjuhë që nuk e njohu (kërkoje në fund fare të 24-ës, fq. 46). Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja Parakremtore (Sot pararendja e haresë, fq. 40).

Në Liturgji, Tipiket dhe në Lumërimet, Ode III Parakremtore dhe VI e shën Grigorit. Pas Hyrjes, Përlëshoret: Parakremtore, e shën Grigorit dhe e kishës. Kontaqi Parakremtor (Zure të bashk'fronshmin Zot, fq. 43). Apostulli dhe Ungjilli i shën Grigorit (kërkoji më 13 nëntor). Dhe Liturgjia e Shën Joan Gojartit. Kungatore: Në kujtim të përhjetshëm.

Në të njëjtën ditë (të shtunën) në Mbrëmësore, Thirrtoret: 4 ngjallësore dhe 4 të së kremtes (Duke të zbuluar ty, fq. 82) në 6. Lavdi dhe Tani i së kremtes (U

dërgua prej qiellit kryeengjëll, fq. 98). *Hyrje*. O dritë gazmore. *Proqimeni i ditës*. *Leximet e së kremtes*. *Pasvargjet ngjallësore (ose ngjallësorja e parë dhe të së kremtes)*. *Lavdi dhe Tani i së kremtes* (Sot ka ungjillëzime hareje, fq. 86). *Përlëshoret: ngjallësore dhe e së kremtes (2x)*.

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanuni Triadik, Litia e së kremtes. *Himne Triadike*. *Trishenjtë*. *Përlëshorja e së kremtes*. Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë, *Ndenjësore ngjallësore*. Pas Stihologjisë së dytë, *Ndenjësoret: një ngjallësore*, *Lavdi Arrin në Nazaret*, fq. 87; *Tani Tërë Krijesa sot ka gaz*, fq. 87. Pas Polieleit, *Ndenjësoret (pas Polieleit) e së kremtes*. *Bekimtoret*. *Ipakoia dhe Shkallesat e Tingullit*. *Proqimeni i së kremtes* (Ungjillëzoheni nga dita në ditë, fq. 87). *Ungjilli i së kremtes*. Ne që pamë ngjalljen. *Psalmi 50 (hima) etj. të së kremtes*. *Kanunet: ngjallësor dhe i së kremtes (me Varg: E Përmbishenjtë Hyjlindëse shpëtona, bashkë me Irmose)*. Pas Odes III, *Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore*. *Ndenjësorja e së kremtes (2x)*. Pas Odes VI, *Kontaqi dhe Shtëpia e së kremtes dhe Sinaksari i ditës*. *Zbritësoret e së kremtes*. *Në vend të Më të nderuarën, Ode IX [ngjallësore dhe] e së kremtes (bashkë me Madhështimin e saj)*. *Dërgimësoret: ngjallësore dhe të dyja të së kremtes*. *Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të së kremtes*. *Lavdi i së kremtes* (Misteri i parajetshëm zbulohet, fq. 95). *Tani E Përmbibekuar*. Sot erdhi.

Në Liturgji, *Antifonet e së kremtes, por në Hyrtoren e saj*, Shpëtona..., që u ngjalle prej së vdekurish. *Përlëshoret: ngjallësore dhe e së kremtes*. *Kontaqi Përlufteshës gjenerale*. *Apostulli dhe Ungjilli i së kremtes dhe Liturgjia e Shën Vasilit*. *Në vend të Të meriton, Më ty gëzohet o Hirplote*. *Kungatore: [Lavdëroni dhe] e së kremtes (Zgjedhi Zoti Sionin)*. Pamë dritën.

Mbyllja

Në të njëjtën ditë (të dielën) në Mbrëmësore, *Thirrtoret: Idhiomeli i Pasvargjeve të Triodhit (1x)*, 3 *Thirrtoret po të Triodhit*, 3 të së kremtes (Duke të zbuluar ty, fq. 82) dhe 3 të *Kryeengjëllit* (Me pamje të ndritshme, fq. 98). *Lavdi dhe Tani po i Kryeengjëllit* (U dërgua prej qiellit kryeengjëll, fq. 98). *Hyrje*. O dritë gazmore. *Proqimeni i Madh i Triodhit*. *Pasvargjet e së kremtes* (Në muajin e gjashtë u dërgua, fq. 85). *Lavdi dhe Tani po i së kremtes* (Sot ka ungjillëzime hareje, fq. 86). *Përlëshorja e së kremtes (3x)*. Urtësi. Beko, o atë. Krishti Perëndia ynë, që është. O mbret qiellor, siguroji. *Tri Metanitë e Mëdha dhe Përlëshimi i së kremtes*.

**10. Nëse bie të hënën e Javës së Tretë ose të Pestë, ose të Gjashtë
të Kreshmëve të Mëdha:**

Të shtunën në Mbrëmësore. Thirrtoret: 4 ngjallësore, 3 Parakremtore (Një mister që ish fshehur krejt, fq. 40) dhe 3 të Triodhit. Lavdi Parakremtor (Gabrieli ungjillëzon te Hirplota, fq. 40). Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i Triodhit. Tani Një gjuhë që nuk e njohu (kërkoje në fund fare të 24-ës, fq. 46). Përlëshoret: ngjallësore, e Triodhit dhe Parakremtore.

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, si zakonisht. Në Mëngjesore, Kanunet: ngjallësor, Parakremtor dhe i Triodhit. Pas Odes III, Kontaqi Parakremtor (Zure të bashk'fronshmin Zot, fq. 43) dhe Ndenjësoret: 1 e Triodhit (e Diela e Katërt ka 2) dhe Parakremtore (Tërë Krijesa sot ka gaz [1x], fq. 42). Pas Ode VI, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore. Sinaksari i ditës dhe i Triodhit. Zbritësoret Ja gojën e çel tani; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor të Triodhit. Dërgimësoret: ngjallësore, e Triodhit dhe Parakremtore. Lavdërimet: a) të Dielën e dytë: 2 ngjallësore, 3 Parakremtore (Meqë i erdhi keq; kërkoji në Thirrtoret e Mbrëmësorës së Vogël të së kremtes, fq. 81) dhe 3 të Triodhit; b) të Dielën e katërt dhe të pestë: 4 ngjallësore dhe 4 Parakremtore (Meqë i erdhi keq; kërkoji në Thirrtoret e Mbrëmësorës së Vogël të së kremtes fq. 81). Lavdi i Triodhit. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji. Tipiket dhe Lumërimet: 4 të tingullit dhe 4 nga Ode VI Parakremtore. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, Parakremtore (Sot pararendja e hareshë, fq. 40), e Triodhit dhe e kishës. Kontaqi Parakremtor (Zure të bashk'fronshmin Zot, fq. 43). Apostulli dhe Ungjilli i Triodhit. Liturgjia e Shën Vasilit. Kungatore Lavdëroni. Pamë dritën.

Të dielën në mbrëmje, Mëngjesorja e Madhe dhe të hënën Shërbesa e Mesnatës, Mëngjesorja dhe Liturgjia.

Mbyllja

Në të njëjtën ditë (të hënën) në Mbrëmësore. Thirrtoret: 3 të së kremtes (Duke të zbuluar ty fq. 82) dhe 3 të Kryeengjëllit (Me pamje të ndritshme, fq. 98). Lavdi dhe Tani po i Kryeengjëllit (U dërgua prej qiellit kryeengjëll; po aty). Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Pasvargjet e së kremtes (Në muajin e gjashtë u dërgua fq. 85). Lavdi dhe Tani po i së kremtes (Sot ka ungjillëzime hareje, fq. 86). Trishenjti. Përlëshorja e së kremtes (3x).

11. Nëse bie të shtunën e Javës së Tretë të Kreshmëve të Mëdha:

Të enjten në Mbrëmësore, Thirrtoret: 3 të Triodhit dhe 3 Parakremtore (Një mister që ish fshehur krejt, fq. 40). Lavdi dhe Tani po Parakremtor (Gabrieli ungjillëzon te Hirplota, fq. 40). O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e Triodhit. Pasvargjet: Idhiomeli i Triodhit (2x) dhe Martiriku. Lavdi dhe Tani Parakremtor (Një gjuhë që nuk e njohu; *kërkoje në fund fare të 24-ës, fq. 46*). Pas Trishenjtit: Gëzo-hu, o Hyjlindëse, Virgjëreshë Hirplote etj. Mëshiro, o Zot (40x). Lavdi dhe Tani. Më të nderuarën etj. O Mbret qiellor, siguroji etj. O Trini e Tërëshenjtit, që je pushteti. Emri i Zotit qoftë i bekuar. [Psalmi 33 dhe 144]. Përlëshim.

Të premten në Mëngjesore, pas Perëndi është Zoti, Përlëshorja Parakremtore (Sot pararendja e haresë [2x], fq. 40). Ndenjësoret e Triodhit. Psalmi 50 (hima). O Perëndi, shpëtoje popullin tënd dhe bekoje trashëgimin tënd, vështroje. Stihologjia e 9 Odeve. Kanunet: Parakremtor dhe Triodhet. Pas Odes III, Ndenjësorja Parakremtore (Tërë Krijesa sot ka gaz [2x], fq. 42). Pas Odes VI, Kontaqi Parakremtor (Zure të bashk'fronshmin Zot, fq. 43) dhe Sinaksari. Dërgimësore Parakremtore (E tërëqashtër, të ofrojm' [1x], fq. 45). Ty të ka hije dhe Dhoksologjia e Vogël. Pasvargjet: Idhiomeli i Triodhit (2x) dhe Martiriku. Lavdi dhe Tani Parakremtor (Një gjuhë që nuk e njohu; *kërkoje në fund fare të 24-ës, fq. 46*). Është mirë t'i fa-lemi. Trishenjtë. Përlëshore Parakremtore (Sot pararendja e haresë, fq. 40). Mëshiro, o Zot (40x). Lavdi dhe Tani. Më të nderuarën. Beko, o atë. Krishti Perëndia ynë, që është. O mbret qiellor, siguroji. Tri Metanitë e Mëdha dhe menjëherë Orët (e Thjeshta) me Përlëshoren dhe Kontaqin Parakremtor. Në Orën VI lexohet edhe Tropari i Profecisë dhe Profecia.

Të premten në Mbrëmësoren e Madhe, pas Tani Përlëshoje, menjëherë Përlufteshës gjenerale (ngadalë) dhe lexohet Stanca (III) e Himnit Akathist si zakonisht. Përsëri Përlufteshës gjenerale (shpejt). Trishenjtë. Përlëshorja e së kremtes (3x).

Të shtunën Shërbesa e Mesnatës, Mëngjesorja dhe Liturgjia.

Mbyllja

Në të njëjtën ditë (të shtunën) në Mbrëmësore, Thirrtoret: 4 ngjallësore, 3 të Triodhit dhe 3 të së kremtes (Duke të zbuluar ty, fq. 82). Lavdi i Triodhit. Tani i së kremtes (U dërgua prej qiellit kryeengjell, fq. 98). Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i Triodhit. Tani i së kremtes (Sot ka ungjillëzime hareje, fq. 86). Përlëshoret: ngjallësore, e Triodhit dhe e së kremtes.

Të dielën, Shërbesa e Mesnatës, Mëngjesorja dhe Liturgjia psalet vetëm sipas Triodhit.

12. Nëse bie të Dielën e Tretë të Kreshmëve të Mëdha:

Të premten në Mbrëmësore, Thirrtoret: 6 të Triodhit dhe 4 Parakremtore (Një mister që ish fshehur krejt, fq. 40). Lavdi dhe Tani po Parakremtor (Gabrieli ungjillëzon te Hirplota, fq. 40). Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e Triodhit. Le të drejtohet dhe Liturgjia e të Parashenjtëruarave.

Në Himnin Akathist, (Stanca III), Kontaqi Parakremtor (Zure të bashk'fronshmin Zot, fq. 43).

Të shtunën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Trishenjtit në fund, Përlëshorja Parakremtore. Në Mëngjesore, pas Perëndi është Zoti, Përlëshorja Parakremtore (Sot pararendja e haresë [2x], fq. 40). Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësoret e Triodhit (pa Nekrosimin). Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësoret e së kremtes (Arrin në Nazaret [2x], fq. 87). Kanunet: Parakremtor dhe Tetraodhet (pa Nekrosimet). Pas Odes III, Ndenjësorja Parakremtore (Tërë Krijesa sot ka gaz [2x], fq. 42). Pas Odes VI, Kontaqi Parakremtor (Zure të bashk'fronshmin Zot, fq. 43) dhe Sinaksari. Dërgimësorja Parakremtore (E tërëqashtër, të ofrojm' [2x], fq. 45). Lavdërimet Meqë i erdhi keq, në 4 (kërkoji në Mbrëmësoren e Vogël të së kremtes, fq. 81). Lavdi dhe Tani Në muajin e gjashtë kryegjenerali (po aty). Ty të ka hije dhe Dhoksologjia e Vogël. Pasvargjet Pasi fluturoi poshtë zbret (kërkoje në Pasvargjet e Mbrëmësorës së Vogël, fq. 81). Lavdi dhe Tani Një gjuhë që nuk e njohu (kërkoje në fund fare të 24-ës, fq. 46). Është mirë t'i falemë. Trishenjtë. Përlëshorja Parakremtore.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja të zakonshme. Pas Hyrjes, Përlëshoret: Parakremtore dhe e kishës. Kontaqi Parakremtor (Zure të bashk'fronshmin Zot, fq. 43). Apostulli dhe Ungjilli i ditës. Kungatore: Ngazëllohuni, o të drejtë, në Zotin; të drejtëve u ka hije lavdërim; Aliluia. Pamë dritën.

Në të njëjtën ditë (të shtunën), në Mbrëmësore, pas Psaltirit, Thirrtoret: 3 ngjallësore, 3 të Triodhit dhe 3 të së kremtes (në 4). Lavdi i Triodhit. Tani i së kremtes (U dërgua prej qiellit kryeengjëll, fq. 83). Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e së kremtes. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i Triodhit. Tani i së kremtes (Sot ka ungjillëzime hareje, fq. 86). Përlëshoret: ngjallësore, e Triodhit dhe e së kremtes.

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmi 50, Litia e së kremtes (nuk psalet Kanuni Triadik). Lavdi i Triodhit. Tani i së kremtes. Pas Trishenjtit, Përlëshorja e së kremtes. Në Mëngjesore, Ndenjësoret: 2 ngjallësore dhe në vend të Hyjlindësoreve, Ndenjësoret e së kremtes (Arrin në Nazaret, fq. 87 dhe Tërë Krijesa sot ka gaz, fq. 87 përkatësisht). Pas Polieleit, Ndenjësoret: e Triodhit dhe të së kremtes. (Bekimtoret nuk thuhën). Përsëri dhe përsëri. Se i bekuar është emri yt. Ipakoia. Shkallesat e Tingullit. Proqimeni dhe Ungjilli i së kremtes. Ne që pamë ngjalljen. Psalmi 50 (hima). Lavdi Me ndërmjetimet e Hyjlindësës. Tani i njëjti. Përdëllemë, o Perëndi, dhe Idhiomeli i së kremtes. Kanunet: i Triodhit (Në fillimin e çdo Ode, thuhet Irmosi që është si Zbritësore në fund të çdo Ode. Në Troparet, Vargjet: Në troparin e parë pas Irmosit, Lavdi ngjalljes sate të shenjtë, o Zot; ndërsa në të tjerat, Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty) dhe i së kremtes (bashkë me Irmoset e tij). Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e Triodhit. Ndenjësoret: të Triodhit dhe në vend të Hyjlindësores, e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e së kremtes. Sinaksari i së kremtes dhe i Triodhit. Zbritësoret e së kremtes. Në vend të Më të nderuarën, Ode IX [e Triodhit dhe] e së kremtes (me Madhështimin e saj). Dërgimësoret: ngjallësore, e Triodhit dhe të së kremtes. Lavdërimet: 2 ngjallësore, 3 të Triodhit dhe 3 të së kremtes. Lavdi dhe Tani po i së kremtes (Misteri i parajetshëm zbulohet, fq. 95). Gjatë Trishenjtit të Dhoksologjisë së Madhe fillon dhe bëhet ceremonia e Kryqit. Në fund, Sot erdhi.

Në Liturgji, Antifonet e së kremtes. Hyrtorja Ungjillëzoheni nga dita në ditë shpëtimin e Perëndisë tonë; Shpëtona..., që u ngjalle prej së vdekurish. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e Triodhit dhe e së kremtes. Kontaqi Përlufteshës gjenerale. Në vend të Trishenjtit, Kryqit tënd i falemi. Apostulli i Triodhit dhe Ungjilli i së kremtes. Dhe Liturgjia e Shën Vasilit. Në vend të Të meriton, Më ty gëzohet o Hirplote. Kungatore: Zgjedhi Zoti Sionin. Pamë dritën.

Mbyllja

Në të njëjtën ditë (të dielën) në Mbrëmësore, Thirrtoret: 3 të së kremtes (Duke të zbuluar ty, fq. 82) dhe 3 të Kryeengjellit (Me pamje të ndritshme, fq. 98). Lavdi dhe Tani po i Kryeengjellit (U dërgua prej qiellit kryeengjell, fq. 98). Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i madh. Pasvargjet e së kremtes (Në muajin e gjashtë u dërgua, fq. 85). Lavdi dhe Tani po i së kremtes (Sot ka ungjillëzime hareje, fq. 86). Trishenjtë. Përlëshorja e së kremtes (3x).

13. Nëse bie të enjten e Javës së Katërt të Kreshmëve të Mëdha:

Të martën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 3 (të parat) e Triodhit dhe 3 Parakremtore (Një mister që ish fshehur krejt, fq. 40). Lavdi i Triodhit. Tani Parakremtor (Gabrieli ungjillëzon te Hirplota, fq. 40). O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e ditës. Pasvargjet: Idhiomeli i Triodhit (2x) dhe Martiriku. Lavdi i Triodhit. Tani Në muajin e gjashtë u dërgua (kërkoje në Pasvargjet e Mbrëmësorës së Vogël të së kremtes, fq. 82). Trishenjtë. Përlëshore Parakremtore (Sot pararendja e haresë, fq. 40). Mëshiro, o Zot (40x). Lavdi dhe Tani. Më të nderuarën etj. O Mbret qiellor, siguroji etj. Tri Metanitë e Mëdha etj. O Trini e Tërëshenjtë, që je pushteti. Emri i Zotit qoftë i bekuar. [Psalmi 33 dhe 144]. Përlëshim.

Të mërkurën në Mëngjesore, pas Perëndi është Zoti, Përlëshorja Parakremtore (Sot pararendja e haresë [2x], fq. 40). Ndenjësoret e Triodhit. Psalmi 50 (hima). O Perëndi, shpëtoje popullin tënd dhe bekoje trashëgimin tënd, vështroje. Stihologjia e 9 Odeve. Kanunet: Parakremtor dhe i ploti i Triodhit, por në Odet që kanë Triodhet, lihet Kanuni i Triodhit. Pas Odes III, Ndenjësoret: e Triodhit dhe në vend të Hyjllindësorës, Ndenjësorja Parakremtore (Tërë Krijesa sot ka gaz, fq. 42). Pas Odes VI, Kontaqi Parakremtor (Zure të bashk'fronshmin Zot, fq. 43) dhe Sinaksari. Dërgimësoret: e Triodhit dhe Parakremtore (E tërëqashtër, të ofrojm', fq. 45). Ty të ka hije dhe Dhoksologjia e Vogël. Pasvargjet: Idhiomeli i Triodhit (2x) dhe Martiriku. Lavdi i Triodhit. Tani Parakremtor (Një gjuhë që nuk e njohu; kërkoje në fund fare të 24-ës, fq. 46). Është mirë t'i falemi. Trishenjtë. Përlëshore Parakremtore (Sot pararendja e haresë, fq. 40). Mëshiro, o Zot (40x). Lavdi dhe Tani. Më të nderuarën. Beko, o atë. Krishti Perëndia ynë, që është. O mbret qiellor, siguroji. Tri Metanitë e Mëdha dhe menjëherë Orët (e Thjeshta) me Përlëshoren Parakremtore dhe në Orët I dhe VI me Kontaqin Parakremtor (Zure të bashk'fronshmin Zot, fq. 43), ndërsa në Orët III dhe IX, me Kontaqin e Triodhit; pas Lumërimeve, me të dy Kontaqet. Në Orën I, në vend të Hapat e mi drejtoji, psalim Kryqit tënd i falemi. Në Orën VI lexohet edhe Tropari i Profecisë dhe Profecia.

Në të njëjtën ditë (të mërkurën) në Mbrëmësoren e Vogël, meqenëse nuk bëhet Liturgjia e të Parashenjtëruarave në vigjiljen e së kremtes, Thirrtoret: jo Idhiomellet dhe Martiriku, por 3 Thirrtoret në vazhdim të Triodhit dhe të 3 të Mbrëmësorës së Vogël të së kremtes (Meqë i erdhi keq, fq. 81). Lavdi i Triodhit. Tani i Mbrëmësorës së Vogël (Në muajin e gjashtë kryegjenerali, fq. 81). O dritë gazmore. Proqimeni

i ditës. Leximet e Triodhit. Si Pasvargje, Idhiomelet e Triodhit dhe Martiriku (që janë në fillim të Mbrëmësore). Lavdi një i Triodhit. Tani një i së kremtes.

Në të njëjtën ditë (të mërkurën), Mbrëmësorja e Madhe dhe të enjten, Shërbesa e Mesnatës, Mëngjesorja dhe Liturgia.

Mbyllja

Në të njëjtën ditë (të enjten) në Mbrëmësore, Thirrtoret: 3 të së kremtes (Duke të zbuluar ty, fq. 82) dhe të 3 të Kryeengjëllit (Me pamje të ndritshme, fq. 98). Lavdi dhe Tani po i Kryeengjëllit (U dërgua prej qiellit kryeengjell, po aty). Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Pasvargjet e së kremtes (Në muajin e gjashtë u dërgua, fq. 85). Lavdi dhe Tani po i së kremtes (Sot ka ungjillëzime hareje, fq. 86). Përlëshorja e së kremtes (3x).

Të premten në Mëngjesore, psalet vetëm shërbesa e Triodhit dhe e Kryeengjëllit. (Psalet Qëmenatë mëngon, Aliluia; pra nuk psalet Përlëshorja e Kryeengjëllit). Kanunet: i Kryeengjëllit dhe i ploti i Triodhit, por në Odet që kanë Triodhet, lihet Kanuni i Kryeengjëllit. Pas Odes III, Ndenjësoret: e Triodhit, një e Kryeengjëllit dhe tjetra e Triodhit. Pas Odes VI, Kontaqi i Triodhit etj. Në Orët dhe në Lumërimet, Kontaqi po i njëjti. Pas Lumërimeve bëhet Falja e Kryqit, dhe kështu mbyllet e kremtja e Faljes së Kryqit. Mbrëmësorja dhe Liturgia e të Parashenjtëruarave si zakonisht.

14. Nëse bie të premten e Javës së Katërt të Kreshmëve të Mëdha:

Të mërkurën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 2 Idhiomelet e Triodhit, Martiriku dhe 3 Parakremtore (Një mister që ish fshehur krejt, fq. 40). Lavdi dhe Tani i Triodhit. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e Triodhit. Le të drejtohet dhe Liturgia e të Parashenjtëruarave.

Të enjten në Mëngjesore, pas Perëndi është Zoti, Përlëshorja Parakremtore (Sot pararendja e haresë [2x], fq. 40). Ndenjësoret e Triodhit. Psalmi 50 (hima). O Perëndi, shpëtoje popullin tënd dhe bekoje trashëgimin tënd, vështroje. Stihologjia e 9 Odeve. Kanunet: Parakremtor dhe Triodhet. Pas Odes III, Ndenjësores Parakremtore (Tërë Krijesa sot ka gaz, fq. 42) (2x). Pas Odes VI, Kontaqi Parakremtor (Zure të bashk'fronshmin Zot, fq. 43) dhe Sinaksari. Dërgimësore Parakremtore (E tërëqashtë, të ofrojm', fq. 45) (1x). Ty të ka hije dhe Dhoksologjia e Vogël. Pasvargjet: Idhiomeli i Triodhit (2x) dhe Martiriku. Lavdi dhe Tani Parakremtor

(Një gjuhë që nuk e njohu; *kërkoje në fund fare të 24-ës, fq. 46*). Është mirë t'i falemi. *Trishenjtë. Përlëshore Parakremtore* (Sot pararendja e haresë, *fq. 40*). Mëshiro, o Zot (40x). *Lavdi dhe Tani*. Më të nderuarën. Beko, o atë. Krishti Perëndia ynë, që është. O mbret qiellor, siguroji. *Tri Metanitë e Mëdha dhe menjëherë Orët (e Thjeshta) me Përlëshoren dhe Kontaqin Parakremtor*. Në Orën VI lexohet edhe Tropari i Profecisë dhe Profecia. Para Përlëshimit të Orës IX [dhe të Lumërimeve] bëhet falja e Kryqit të Çmuar kur psalen Kryqit tënd i falemi (3x) dhe Idhiomelet Ejani, o besnikë, le t'i falemi etj. Pastaj hiqet Kryqi i Çmuar dhe bëhet Përlëshimi.

Në të njëjtën ditë (të enjten) në mbrëmje, Mbrëmësorja e Madhe dhe të premtën, Shërbesa e Mesnatës, Mëngjesorja dhe Liturgjia.

Mbyllja

Në të njëjtën ditë (të premtën) në Mbrëmësore (Nuk lexohet Psaltiri), Thirrtoret: 3 të së kremtes (Duke të zbuluar ty, *fq. 82*) dhe 3 të Kryeengjëllit (Me pamje të ndritshme, *fq. 98*). *Lavdi dhe Tani po i Kryeengjëllit* (U dërgua prej qiellit kryeengjëll; po aty). Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Pasvargjet e së kremtes (Në muajin e gjashtë u dërgua, *fq. 85*). *Lavdi dhe Tani po i së kremtes* (Sot ka ungjillëzime hareje, *fq. 86*). Tani përlëshojë dhe menjëherë Përlufteshës gjenerale (ngadalë) dhe lexohet Stanca (IV) e Himnit Akathist si zakonisht. Përsëri Përlufteshës gjenerale (shpejt). *Trishenjtë. Përlëshorja e së kremtes* (3x).

Të shtunën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Trishenjtë, në fund Përlëshorja e së kremtes. Në Mëngjesore, pas Perëndi është Zoti, Përlëshorja e së kremtes (3x). Pas Stihologjisë së parë dhe të dytë, Ndenjësoret e së kremtes (nuk psalet Polielei si zakonisht në Mbylljet, pra as Ndenjësoret e tij). Kanunet: i së kremtes dhe i Kryeengjëllit. Pas Odes III, Ndenjësoret e Kryeengjëllit. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e së kremtes dhe Sinaksari i ditës. Zbritësoret e së kremtes. Në vend të Të meriton, Ode IX e së kremtes (me Madhështimin e saj) dhe e Kryeengjëllit. Dërgimësoret e së kremtes. Lavdërimet e së kremtes. *Lavdi dhe Tani* (Le të dëfrejnë qiejt; *kërkoje pikërisht para Citimeve të 25-ës, fq. 96*). Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e së kremtes.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e së kremtes. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e së kremtes, e Kryeengjëllit dhe e kishës. Kontaqi Përlufteshës gjenerale. Apostulli (*kërkoje më 6 shtator*) dhe Ungjilli (*kërkoje më 8 nëntor*). Të meriton. Kungatore Ai që bën engjëjt e tij frymë dhe shërbyesit e tu flakë zjarri, Aliluia. Pamë dritën.

15. Nëse bie të shtunën e Javës së Katërt të Kreshmëve të Mëdha:

Të enjten në Mbrëmësore, Thirrtoret: 3 të Triodhit dhe 3 Parakremtore (Një mister që ish fshehur krejt, fq. 40). *Lavdi dhe Tani po Parakremtor* (Gabrieli ungjillëzon te Hirplota, fq. 40). O dritë gazmore. *Proqimeni i ditës. Leximet e Triodhit. Pasvargjet: Idhiomeli i Triodhit (2x) dhe Martiriku. Lavdi dhe Tani* Një gjuhë që nuk e njohu (kërkoje në *Pasvargjet e Lavdërimeve Parakremtore*, fq. 46). *Trishenjtë. Përlëshore Parakremtore* (Sot pararendja e hareshë, fq. 40). Mëshiro, o Zot (40x). *Lavdi dhe Tani. Më të nderuarën etj. O Mbret qiellor, siguroji etj. Tri Metanitë e Mëdha etj.* O Trini e Tërëshenjtë, që je pushteti. Emri i Zotit qoftë i bekuar. [Psalmi 33 dhe 144]. *Përlëshim.*

Të premten në Mëngjesore, pas Perëndi është Zoti, Përlëshorja Parakremtore (Sot pararendja e hareshë, fq. 40) (2x). *Ndenjësoret e Triodhit. Psalmi 50 (hima).* O Perëndi, shpëtoje popullin tënd dhe bekoje trashëgimin tënd, vështroje. *Stihologjia e 9 Odeve. Kanunet: Parakremtor dhe i plotë i Triodhit, por në Odet që kanë Triodhet, lihet Kanuni i Triodhit. Pas Odes III, Ndenjësoret: të Triodhit dhe në vend të Hyjlindësore, e së kremtes (U ul tani mbi dhë, fq. 89). Pas Odes VI, Kontaqi Parakremtor (Zure të bashk'fronshmin Zot, fq. 43) dhe Sinaksari. Dërgimësoret: e Triodhit (Fotagojiku) dhe Parakremtore (E tërëqashtë, të ofrojm', fq. 45). Ty të ka hije dhe Dhoksologjia e Vogël. Pasvargjet: Idhiomeli i Triodhit (2x) dhe Martiriku. Lavdi dhe Tani Parakremtor (Një gjuhë që nuk e njohu; kërkoje në fund fare të 24-ës, fq. 46). Është mirë t'i falemi. *Trishenjtë. Përlëshorja Parakremtore* (Sot pararendja e hareshë, fq. 40). Mëshiro, o Zot (40x). *Lavdi dhe Tani. Më të nderuarën. Beko, o atë. Krishti Perëndia ynë, që është. O mbret qiellor, siguroji. Tri Metanitë e Mëdha dhe menjëherë Orët (e Thjeshta) me Përlëshoren dhe Kontaqin Parakremtor. Në Orën VI lexohet edhe Tropari i Profecisë dhe Profecia. Para Përlëshimit të Orës IX [dhe të Lumërimeve] bëhet falja e Kryqit të Çmuar kur psalen Kryqit tënd i falemi (3x) dhe Idhiomelet Ejani, o besnikë, le t'i falemi etj. Pastaj hiqet Kryqi i Çmuar dhe bëhet Përlëshimi.**

Në të njëjtën ditë (të premten) në Mbrëmësoren e Madhe, pas Tani Përlëshoje, menjëherë Përlufteshës gjenerale (ngadalë) dhe lexohet Stanca (IV) e Himnit Akathist. Përsëri Përlufteshës gjenerale (shpejt). *Trishenjtë. Përlëshorja e së kremtes (3x).*

Të shtunën, Shërbesa e Mesnatës, Mëngjesorja dhe Liturgjia.

Mbyllja

Shërbesa e shën Joanit të Shkallës psalet në Pasdarkë.

Në të njëjtën ditë (të shtunën) në Mbrëmësore, Thirrtoret: 4 ngjallësore, 3 të së kremtes (Duke të zbuluar ty, fq. 82) dhe 3 të Kryeengjëllit (Me pamje të ndritshme, fq. 98). Lavdi i së kremtes (U dërgua prej qiellit kryeengjëll, fq. 98). Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi dhe Tani Le të dëfrejnë qiejt (kërkoje pikërisht para Citimeve të 25-ës, fq. 96). Përlëshoret: ngjallësore dhe e së kremtes (2x).

Të dielën, Shërbesa e Mesnatës, si zakonisht. Në Mëngjesore, Ndenjësoret: ngjallësore dhe në vend të Hyjlindësoreve, Ndenjësoret e së kremtes (nuk psalet Polielei si zakonisht në Mbylljet, pra as Ndenjësoret e tij). Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimeni i Tingullit. Kanunet: ngjallësor, i së kremtes dhe i Kryeengjëllit. Pas Odes III, Ndenjësoret: e para e Triodhit dhe të Kryeengjëllit. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore dhe Sinaksari. Zbritësoret e së kremtes; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor të Triodhit. Më të nderuarën dhe Ode IX [ngjallësore,] e së kremtes [dhe e Kryeengjëllit]. Dërgimësoret: ngjallësore dhe të së kremtes. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të së kremtes (Kur nga apsidat në qiell fq. 94). Lavdi i Triodhit. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e së kremtes, por në Hyrje, Shpëtona..., që u ngjalle prej së vdekurish. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e së kremtes dhe e kishës. Kontaqi Përlufteshës gjenerale. Apostulli dhe Ungjilli i Triodhit dhe Liturgjia e Shën Vasilit. Në vend të Të meriton, Më ty gëzohet. Kungatore [Lavdëroni dhe] e së kremtes.

16. Nëse bie të dielën e Javës së Katërt të Kreshmëve të Mëdha:

Të premten në Mbrëmësore, Thirrtoret: 6 të Triodhit dhe 4 Parakremtore (Një mister që ish fshehur krejt, fq. 40). Lavdi dhe Tani Parakremtor (Gabrieli ungjillëzon te Hirplota; po aty). Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e Triodhit. Le të drejtohet dhe Liturgjia e të Parashenjtëruarave.

Në Himnin Akathist, (Stanca IV), Kontaqi Parakremtor (Zure të bashk' fronshmin Zot, fq. 43).

Të shtunën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Trishenjtit në fund, Përlëshorja Parakremtore (Sot pararendja e hareshë, fq. 40) (2x). Në Mëngjesore, pas Perëndi është Zoti, Përlëshorja Parakremtore (2x). Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësoret

e Triodhit (pa Nekrosimin). Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësorja e së kremtes (Arrin në Nazaret [2x], fq. 87). Kanunet: Parakremtor dhe Tetraodhet (pa Nekrosimet). Pas Odes III, Ndenjësorja Parakremtoe (Tërë Krijesa sot ka gaz [2x], fq. 42). Pas Odes VI, Kontaqi Parakremtor dhe Sinaksari. Dërgimësorja Parakremtoe (E tërëqashtë, të ofrojm' [2x], fq. 45). Lavdërimet Meqë i erdhi keq, në 4 (kërkoji në Mbrëmësoren e Vogël e së kremtes, fq. 81). Lavdi dhe Tani Në muajin e gjashtë kryegjenerali (po aty). Ty të ka hije dhe Dhoksologjia e Vogël. Pasvargjet (Pasi fluturoi poshtë zbret; kërkoji në Pasvargjet e Mbrëmësore së Vogël, fq. 81). Lavdi dhe Tani Një gjuhë që nuk e njohu (kërkoje në fund fare të 24-ës, fq. 46). Është mirë t'i falemi. Trishenjtë. Përlëshorja Parakremtoe.

Në Liturgji. Antifonet e zakonshme. Në Hyrje Ejani t'i falemi, Shpëtona..., o i çuditshëm. Pas Hyrjes, Përlëshoret: Parakremtoe (Sot pararendja e hareshë, fq. 40) dhe e kishës. Kontaqi Parakremtor (Zure të bashk'fronshmin Zot, fq. 43). Apostulli dhe Ungjilli i ditës. Kungatore Ngazëllohuni, o të drejtë, në Zotin; të drejtëve u ka hije lavdërim; Aliluia. Pamë dritën.

Shërbesa e shën Joanit të Shkallës psalet në Pasdarkë.

Në të njëjtën ditë (të shtunën) në Mbrëmësoren e Madhe (pas Psaltirit, si zakonisht) Thirrtoret: 4 ngjallësore dhe 6 të së kremtes (Duke të zbuluar ty, fq. 82). Lavdi dhe Tani i së kremtes U dërgua prej qiellit kryeengjëll (fq. 83). Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e së kremtes. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi dhe Tani i së kremtes (Sot ka ungjillëzime hareje, fq. 86). Përlëshoret: ngjallësore dhe e së kremtes (2x).

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50 (nuk psalet Kanuni Triadik), Litia e së kremtes. Pas Trishenjtë në fund, Përlëshorja e së kremtes. Në Mëngjesore, Ndenjësoret ngjallësore dhe në vend të Hyjlindësoreve, Ndenjësoret e së kremtes. Pas Polieleit (të së kremtes), Ndenjësoret e tij. Bekimtoe. Përsëri dhe përsëri. Se i bekuar është. Ipakoia dhe Shkallesat e Tingullit. Proqimeni dhe Ungjilli i së kremtes. Ne që pamë ngjalljen. Psalmi 50 (hima). Lavdi Me ndërmjetimet e Hyjlindësës. Tani i njëjti. Përdëllemë, o Perëndi dhe Idhiomeli (Gabrieli ungjillëzon te Hirplota, fq. 88). Kanunet: ngjallësor dhe i së kremtes (bashkë me Irmoset e tij). Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore, Ndenjësorja e së kremtes (U ul tani mbi dhë [1x], fq. 89). Pas Odes VI, Kontaqi, Shtëpia dhe Sinaksari i së kremtes. Zbritësoret e së kremtes. [Më të nderuarën dhe] Ode IX [ngjallësore dhe] e së kremtes (me Madhështimin e saj). Dërgimësoret: ngjallësore dhe

të së kremtes. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të së kremtes. Lavdi dhe Tani i së kremtes (Misteri i parajetshëm zbulohet, fq. 95). Sot erdhi.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e së kremtes, por në Hyrjen, Shpëtona..., që u ngjalle prej së vdekurish. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore dhe e së kremtes. Kontaqi Përlufteshës gjenerale. Apostulli dhe Ungjilli i së kremtes. Liturgjia e Shën Vasilit. Në vend të Të meriton, Më ty gëzohet. Kungatore [Lavdëroni dhe] e së kremtes. Pamë dritën.

Mbyllja

Në të njëjtën ditë (të dielën) në Mbrëmësore, Thirrtoret: Idhiomeli (i pari i Pasvargjeve të Triodhit), 3 të Triodhit, 3 të së kremtes (Duke të zbuluar ty, fq. 82) dhe 3 të Kryeengjëllit (Me pamje të ndritshme, fq. 98). Lavdi dhe Tani po i Kryeengjëllit (U dërgua prej qiellit kryeengjëll; po aty). Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i Madh i Triodhit. Pasvargjet: Idhiomeli (i dyti i Pasvargjeve të Triodhit) dhe të së kremtes (Në muajin e gjashtë u dërgua, fq. 85). Lavdi dhe Tani po i së kremtes (Sot ka ungjillëzime hareje, fq. 86). Trishenjtë. Përlëshorja e së kremtes (3x). Urtësi. Ai që është i bekuar. O Mbret qiellor siguroji. Tri Metanitë e Mëdha. Përlëshim i së kremtes.

17. Nëse bie të mërkurën e Javës së Pestë të Kreshmëve të Mëdha:

Të hënë në Mbrëmësore, Thirrtoret: 3 të Triodhit dhe 3 Parakremtore (Një mister që ish fshehur krejt, fq. 40). Lavdi dhe Tani Parakremtor (Gabrieli ungjillëzon te Hirplota sot; po aty). O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e Triodhit. Pasvargjet: 3 të Triodhit dhe pastaj të gjitha Thirrtoret sipas rendit alfabetik të Mbrëmësorës të së nesërmes të Triodhit (jo me Vargjet e tyre të së nesërmes, por me Varg: Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty). Tani përlëshoje. Trishenjtë. Gëzohu, o Hyj lindëse, Virgjëreshë Hirplote etj. Mëshiro, o Zot (40x). Lavdi dhe Tani. Më të nderuarën etj. O Mbret qiellor, siguroji etj. Tri Metanitë e Mëdha etj. O Trini e Tërëshenjtë, që je pushteti. Emri i Zotit qoftë i bekuar. [Psalmi 33 dhe 144]. Përlëshim.

Në Pasdarkën (e Vogël) psalet Kanuni i së Tërëshenjtës Mari nga Theotokari.

Të martën në Mëngjesore, pas Perëndi është Zoti, Përlëshore Parakremtore (Sot pararendja e haresë, fq. 40) (2x). Ndenjësoret e Triodhit. Psalmi 50 (hima). O Perëndi, shpëtoje popullin tënd dhe bekoje trashëgimin tënd, vështroje. Stihologjia

e 9 Odeve. *Kanunet: Parakremtor dhe Triodhet. Pas Odes III, Ndenjësores Parakremtores* (Tërë Krijesa sot ka gaz [2x], fq. 42). *Pas Odes VI, Kontaqi Parakremtor* (Zure të bashk'fronshmin Zot, fq. 43) dhe *Sinaksari. Dërgimësore Parakremtores* (E tërëqashtë, të ofrojm' [1x], fq. 45). Ty të ka hije dhe *Dhoksologjia e Vogël. Pasvargjet: Idhiomeli i Triodhit* (2x) dhe *Martiriku. Lavdi dhe Tani Parakremtor* (Një gjuhë që nuk e njohu; kërkoje në fund fare të 24-ës, fq. 46). Është mirë t'i falemi. *Trishenjti. Përlëshore Parakremtores* (Sot pararendja e haresë, fq. 40). Mëshiro, o Zot (40x). *Lavdi dhe Tani. Më të nderuarën. Beko, o atë. Krishti Perëndia ynë, që është. O mbret qiellor, siguroji. Tri Metanitë e Mëdha dhe menjëherë Orët* (e Thjeshta) me *Përlëshoren dhe Kontaqin Parakremtor. Në Orën VI lexohet edhe Tropari i Profecisë dhe Profecia.*

Në të njëjtën ditë (të martën) në mbrëmje, Mbrëmësorja e Madhe, dhe të mërkurën, Shërbesa e Mesnatës, Mëngjesorja dhe Liturgjia.

Mbyllja

Në të njëjtën ditë (të mërkurën) në Mbrëmësore. Thirrtoret: 3 të së kremtes (Duke të zbuluar ty, fq. 82) dhe *3 të Kryeengjëllit* (Me pamje të ndritshme, fq. 98). *Lavdi dhe Tani i Kryeengjëllit* U dërgua prej qiellit Gabrieli (po aty). *Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Pasvargjet e së kremtes* (Në muajin e gjashtë u dërgua, fq. 85). *Lavdi dhe Tani* Sot ka ungjillëzime hareje (po aty, fq. 86). *Përlëshorja e së kremtes* (3x).

Në Pasdarkën (e Vogël) psalet Kanuni i Madh [Kjo është më praktike, por më e saktë është që Kanuni i Madh të psalet të nesërmen në Mëngjesore, e cila do të zgjatet atëherë më shumë].

Të enjten në Mëngjesore. Vargjet: Qëmenatë mëngon; Aliluia në Tingullin e javës. Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësoret e Triodhit. Psalmi 50 (hima) [dhe Stihologjia e 9 Odeve]. Kanunet: Ode I dhe III të Kryeengjëllit dhe Irmosi. Përsëri dhe përsëri. Se ti je Perëndia ynë. Ndenjësoret e Kryeengjëllit. Ode IV e Kryeengjëllit dhe Triodhet (jo Kanuni i Madh). Odet V dhe VI të Kryeengjëllit dhe Irmosi. Përsëri dhe përsëri. Se ti je mbreti i pages. Kontaqi i Triodhit. Sinaksari i ditës dhe i Triodhit. Në vend të Odes VII, Lumërimet e Triodhit (me Varg: Mëshiro, o Perëndi, mëshiromë). Ode VIII e IX të Kryeengjëllit dhe Triodhet (jo Kanuni i Madh). Himnojmë, bekojmë dhe Irmosi i Odes VIII të Triodhit. Më të nderuarën. Irmosi i Odes IX të Triodhit, dhe Të meriton. Fotagojiku. Ty të ka hije dhe Dhokso-

logjia e Vogël etj. Pasvargjet e Triodhit. Lavdi dhe Tani Le të dëfrejnë qiejt (kërkoje pikërisht para Citimeve të 25-ës, fq. 96). Është mirë t'i falemi. Trishenjtë. Përlëshore Parakremtore (Sot pararendja e hareshë, fq. 40). Mëshiro, o Zot (40x). Lavdi dhe Tani. Më të nderuarën. Beko, o atë. Krishti Perëndia ynë, që është. O mbret qiellor, siguroji. Tri Metanitë e Mëdha dhe menjëherë Orët (e Thjeshta) me Përlëshoren e Kryeengjëllit dhe Kontaqin e Triodhit. Në Orën VI lexohet edhe Tropari i Profecisë dhe Profecia.

Në të njëjtën ditë (të enjten) në Mbrëmësore, Thirrtoret: Idhiomeli i Triodhit (2x) dhe Martiriku dhe 3 të Kryeengjëllit (Me pamje të ndritshme, fq. 98). Lavdi dhe Tani Në muajin e gjashtë u dërgua (kërkoje në Pasvargjet e tij, fq. 100). Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet: 2 të Triodhit dhe 1 (i dyti) i Kryeengjëllit (Fjalët e Urta 8.22-30). Le të drejtohet dhe Liturgjia e të Parashenjtëruarave. Kungatore Shijoni.

Shënim: “Në vitin 1881 e kremtja e Ungjillëzimit ra të mërkurën e Javës së Pestë të Kreshmëve të Mëdha, dhe u psal Kanuni i Madh sipas Vendimit Sinodik kështu: Të mërkurën, pas Përlëshimit të Mbrëmësorës së Mbylljes të së kremtes, menjëherë: I bekuar është dhe Pasdarka e Vogël. Pas Dhoksologjisë u psal Kanuni. Pas Odes IX, Irmosi. Trishenjtë. Kontaqi i Triodhit. Mëshiro, o Zot (40x). O Krisht Perëndi, që adhurohesh e lavdërohesh. E papikëluar etj. Të enjten, Mëngjesorja, Mbrëmësorja dhe Liturgjia e të Parashenjtëruarave u psalën pikërisht si më lart (Të enjten në Mëngjesore dhe në Mbrëmësore)”.

18. Nëse bie të enjten e Javës së Pestë (e Kanunit të Madh) të Kreshmëve të Mëdha:

Të martën në Mbrëmësore, 3 të Triodhit dhe 3 Parakremtore (Një mister që ish fshehur krejt, fq. 40). Lavdi dhe Tani po Parakremtor (Gabrieli ungjillëzon te Hir-plota sot; po aty). O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e Triodhit. Pasvargjet: 2 Idhiomelet e Triodhit, Martiriku dhe të gjitha Thirrtoret sipas rendit alfabetik të Mbrëmësorës të së nesërmes të Triodhit (jo me Vargjet e tyre të së nesërmes, por me Varg: Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty). Tani përlëshoje. Trishenjtë. Gëzohu, o Hyjlindëse, Virgjëreshë Hirplote etj. Mëshiro, o Zot (40x). Lavdi dhe Tani. Më të nderuarën etj. O Mbret qiellor, siguroji etj. Tri Metanitë e Mëdha etj. O Trini e Tërëshenjtë, që je pushteti. Emri i Zotit qoftë i bekuar. [Psalmi 33 dhe 144]. Përlëshim.

Në Pasdarkën (e Vogël) psalet Kanuni i Madh, dhe pas Trishenjtit, Kontaqi i tij.

Të mërkurën në Mëngjesore, pas Perëndi është Zoti, Përlëshore Parakremtore (Sot pararendja e haresë [2x], fq. 40). Ndenjësoret e Triodhit. Psalmi 50 (hima). O Perëndi, shpëtoje popullin tënd dhe bekoje trashëgimin tënd, vështroje. Stihologjia e 9 Odeve. Kanunet: Parakremtor dhe Triodhet. Pas Odes III, Ndenjësore Parakremtore (Tërë Krijesa sot ka gaz, fq. 42) (2x). Pas Odes VI, Kontaqi Parakremtor (Zure të bashk'fronshmin Zot, fq. 43) dhe Sinaksari. Dërgimësore Parakremtore (E tërëqashtër, të ofrojm', fq. 45). Ty të ka hije dhe Dhoksologjia e Vogël. Pasvargjet: Idhiomeli i Triodhit (2x) dhe Martiriku. Lavdi dhe Tani Parakremtor (Një gjuhë që nuk e njohu; kërkoje në fund fare të 24-ës, fq. 46). Është mirë t'i falemi. Trishenjtë. Përlëshore Parakremtore (Sot pararendja e haresë, fq. 40). Mëshiro, o Zot (40x). Lavdi dhe Tani. Më të nderuarën. Beko, o atë. Krishti Perëndia ynë, që është. O mbret qiellor, siguroji. Tri Metanitë e Mëdha dhe menjëherë Orët (e Thjeshta) me Përlëshoren dhe Kontaqin Parakremtor. Në Orën VI lexohet edhe Tropari i Profecisë dhe Profecia.

Në të njëjtën ditë (të mërkurën) në mbrëmje, Mbrëmësorja e Madhe dhe të enjten Shërbesa e Mesnatës, Mëngjesorja dhe Liturgjia.

Mbyllja

Në të njëjtën ditë (të enjten) në Mbrëmësore, Thirrtoret: 3 të së kremtes (Duke të zbuluar ty, fq. 82) dhe 3 të Kryeengjëllit (Me pamje të ndritshme, fq. 98). Lavdi dhe Tani po i Kryeengjëllit (U dërgua prej qiellit kryeengjëll; po aty). Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Pasvargjet e së kremtes (Në muajin e gjashtë u dërgua, fq. 85). Lavdi dhe Tani po i së kremtes (Sot ka ungjillëzime hareje, fq. 86). Trishenjtë. Përlëshorja e së kremtes (3x).

19. Nëse bie të premten e Javës së Pestë të Kreshmëve të Mëdha:

Të mërkurën në Mbrëmësore, 16 Thirrtoret (duke filluar nga Vargu: Në këtë rrugë që ecja): Idhiomeli i Triodhit (2x), Martiriku, (jo të tre në vazhdim), 10 (vetëm nga ato sipas alfabetit dhe 3 Parakremtore (Një mister që ish fshehur krejt, fq. 40). Lavdi dhe Tani Parakremtor (Gabrieli ungjillëzon te Hirplota sot; po aty). Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e Triodhit. Le të drejtohet dhe Liturgjia e të Parashenjtëruarave.

Në Pasdarkën (e Vogël) psalet Kanuni i Madh dhe, pas Trishenjtit, Kontaqi i tij.

Të enjten në Mëngjesore, Vargjet: Qëmenatë mëngon; Aliluia në Tingullin e javës. Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësoret e Triodhit. Psalmi 50 (hima) [dhe Stihologjia e 9 Odeve]. Kanunet: Ode I dhe III Parakremtor dhe Irmosi. Përsëri dhe përsëri. Se ti je Perëndia ynë. Ndenjësoerja Parakremtores (Tërë Krijesa sot ka gaz, fq. 42). Ode IV Parakremtor dhe Triodhet (jo Kanuni i Madh). Ode V dhe VI Parakremtor dhe Irmosi. Përsëri dhe përsëri. Se ti je mbreti i paqes. Kontaqi Parakremtor (Zure të bashk'fronshmin Zot, fq. 43). Sinaksari i ditës dhe i Triodhit. Lumërimet e Triodhit (me Varg: Mëshhiromë, o Perëndi, mëshiromë) dhe Ode VII, Ode VIII dhe IX Parakremtores dhe të Triodheve (jo Kanuni i Madh). Himnojmë, bekojmë dhe Irmosi i Odes VIII të Triodhit. Më të nderuarën. Irmosi i Odes IX të Triodhit dhe Të meriton. Dërgimësoerja Parakremtores (E tërëqashtë, të ofrojm' fq. 45). Ty të ka hije dhe Dhoksologjia e Vogël etj. Pasvargjet e Triodhit. Lavdi dhe Tani Një gjuhë që nuk e njohu (kërkoje në fund fare të 24-ës, fq. 46). Është mirë t'i falemi. Trishenjti. Përlëshore Parakremtores (Sot pararendja e haresë, fq. 40). Mëshiro, o Zot (40x). Lavdi dhe Tani. Më të nderuarën. Beko, o atë. Krishti Perëndia ynë, që është. O mbret qiellor, siguroji. Tri Metanitë e Mëdha dhe menjëherë Orët (e Thjeshta) me Përlëshoren dhe Kontaqin Parakremtor. Në Orën VI lexohet edhe Tropari i Profecisë dhe Profecia.

Në të njëjtën ditë (të enjten) në mbrëmje, Mbrëmësoerja e Madhe dhe të premtën, Shërbesa e Mesnatës, Mëngjesorja dhe Liturgjia.

Mbyllja

Në të njëjtën ditë (të premtën) në Mbrëmësores, Thirrtoret: 3 të së kremtes (Duke të zbuluar ty, fq. 82) dhe 3 të Kryeengjëllit (Me pamje të ndritshme, fq. 98). Lavdi dhe Tani po i Kryeengjëllit (U dërgua prej qiellit kryeengjëll; po aty). Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Pasvargjet e së kremtes (Në muajin e gjashtë u dërgua, fq. 85). Lavdi dhe Tani po i së kremtes (Sot ka ungjillëzime hareje, fq. 86). Pas Tani përlëshoje, psalet Si mori vesh porosinë (3x) dhe lexohet Stanca I e Himnit Akathist. Pastaj psalen Odet I dhe III të Kanunit (Ja gojën e çel tani). Pas Odes III, Përlufteshës gjenerale (ngadalë) dhe lexohet Stanca II. Odet IV, V, VI. Përlufteshës gjenerale (shpejt). Stanca III. Odet VII, VIII dhe IX. Përlufteshës gjenerale (shpejt).

Stanca IV. Përlufteshës gjenerale (shpejt). Trishenjtë. Përlëshore e së kremtes (Sot është nisja e shpëtimit tonë [3x]). Përlëshim.

Të shtunën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Trishenjtë në fund, Si mori vesh porosinë. Në Mëngjesore, pas Perëndi është Zoti, Si mori vesh porosinë (3x). Pas Stihologjisë (unike), 2 Ndenjësoret: I madhi Gabriel dhe Si komandant engjëjsh (kërkoji pas Odes III të Kryeengjëllit, fq. 101). Psalmi 50 (hima). Kanunet: i së kremtes dhe i Kryeengjëllit (i Kryeengjëllit deri në Oden V). Pas Odes III, Ndenjësore Arrin në Nazaret (kërkoje pas Stihologjisë së parë të së kremtes, fq. 87). Në Oden VI, VII, VIII dhe IX thuhet edhe Tetraodhet. Pas Odes VI, Kontaqi Përlufteshës gjenerale dhe Shtëpia Engjëlli kryetar u dërgua (fq. 91). Sinaksari i ditës dhe i Triodhit. Zbritësoret Ja gojën e çel tani. Më të nderuarën. Gjithë njerëzit. Dërgimësorja e Triodhit (2x). Lavdërimet Një mister që ish fshehur krejt (kërkoji në Thirrtoret e së Parakremtes, fq. 40) (në 4). Lavdi dhe Tani Një gjuhë që nuk e njohu (kërkoje në fund fare të 24-ës, fq. 46). Dhoksologjia e Madhe. Si mori vesh porosinë.

Në Liturgji. [Tipiket dhe Odet III dhe IV e Hyjlindësës ose] Antifonet dhe Hyrtorja e së kremtes. Në Hyrje, Ejani t'i falemi, Shpëtona..., o i çuditshëm. Pas Hyrjes, Si mori vesh porosinë. Kontaqi Përlufteshës gjenerale. Apostulli (kërkoje më 21 nëntor) dhe Ungjilli (kërkoje më 15 gusht në Mëngjes: "Në ato ditë Mariama u ngrit"). Në vend të Të meriton, Gjithë njerëzit. Kungatore Kupë shpëtimi. Pamë dritën.

Shënim: "Tipikoni i mëparshëm u rregullua kështu në vitin 1832, kur e kremtja e Ungjillëzimit ra të premtën e Javës së Pestë të Kreshmëve".

20. Nëse bie të shtunën e Javës së Pestë (e Himnit Akathist)

të Kreshmëve të Mëdha:

Të enjten në Mbrëmësore, Thirrtoret: 6 të Triodhit dhe 4 Parakremtore (Një mister që ish fshehur krejt, fq. 40). Lavdi dhe Tani po Parakremtor (Gabrieli ungjillëzon te Hirplota, fq. 40). Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e Triodhit. Le të drejtohet dhe Liturgjia e të Parashenjtëruarave.

Të premtën në Mëngjesore, pas Perëndi është Zoti, Përlëshorja Parakremtore (Sot pararendja e haresë [2x], fq. 40). Ndenjësoret e Triodhit. Psalmi 50 (hima). O Perëndi, shpëtoje popullin tënd dhe bekoje trashëgimin tënd, vështroje. Stihologjia e

9 Odeve. Kanunet: Parakremtor dhe Triodhet. Pas Odes III, Ndenjësorja Parakremtore (Tërë Krijesa sot ka gaz [2x], fq. 42). Pas Odes VI, Kontaqi Parakremtor (Zure të bashk'fronshmin Zot, fq. 43) dhe Sinaksari. Dërgimësorja Parakremtore (E tërëqashtër, të ofrojm' [1x], fq. 45). Ty të ka hije dhe Dhoksologjia e Vogël. Pasvargjet: Idhiomeli i Triodhit (2x) dhe Martiriku. Lavdi dhe Tani Parakremtor (Një gjuhë që nuk e njohu; kërkoje në fund fare të 24-ës, fq. 46). Është mirë t'i falemi. Trishenjtë. Përlëshore Parakremtore (Sot pararendja e haresë, fq. 40). Mëshiro, o Zot (40x). Lavdi dhe Tani. Më të nderuarën. Beko, o atë. Krishti Perëndia ynë, që është. O mbret qiellor, siguroji. Tri Metanitë e Mëdha dhe menjëherë Orët (e Thjeshta) me Përlëshoren dhe Kontaqin Parakremtor. Në Orën VI lexohet edhe Tropari i Profecisë dhe Profecia.

Në të njëjtën ditë (të premtën) në Mbrëmësoren e Vogël, (megenëse nuk bëhet Liturgjia e të Parashenjtëruarave në vigjiljen e së kremtes,) Thirrtoret: jo Idhiomeli i Triodhit dhe Martiriku, por 3 në vazhdim të Triodhit dhe 3 të Mbrëmësorës së Vogël të së kremtes (Meqë i erdhi keq, fq. 81). Lavdi dhe Tani i Mbrëmësorës së Vogël (Në muajin e gjashtë kryegjenerali, fq. 81). O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e Triodhit. Si Pasvargjet, Idhiomeli i Thirrtoreve (2x) dhe Martiriku. Lavdi një i Triodhit. Tani një i së kremtes. Përlëshorja e së kremtes (Sot është nisja [1x]).

Në të njëjtën ditë (të premtën) Mbrëmësorja e Madhe, dhe të shtunën Shërbesa e Mesnatës, Mëngjesorja dhe Liturgjia.

Shënim: “Sipas Tipikonit të Konstandinit, Stancat e Himnit Akathist psalen të nesërmen në Mëngjesore siç sqarohet menjëherë më pas. Por meqë shërbesa bëhet shumë e gjatë, për lehtësimin e popullit mundet të transferohen në Mbrëmësoren e Madhe: Pas Tani Përlëshoje (pa Pasdarkë), Si mori vesh porosinë (3x) dhe lexohen Stancat e Himnit Akathist. Përlufteshës gjenerale. Trishenjtë. Përlëshorja e së kremtes (3x). Përlëshim”.

Të shtunën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Litia. Pas Trishenjtë, Përlëshorja (Sot është nisja). Në Mëngjesore, pas Perëndi është Zoti, Përlëshorja (3x). Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësorë Arrin në Nazaret (2x), fq. 87. Pas Stihologjisë së dytë, Tërë Krijesa sot ka gaz (1x), fq. 87. Pas Polieleit, Gabrieli i thërret modestes (2x), fq. 87. [Së dëlirës Virgjërësh' psalet më vonë]. Shkallesat dhe i gjithë rendi i Ungjillit të Mëngjesit të së kremtes. O Perëndi, shpëtoje popullin tënd dhe bekoje trashëgimin tënd, vështroje etj. Pastaj Përlufteshës gjenerale

(ngadalë). *Stanca I. Përlufteshës gjenerale (argosíntomon). Stanca II. Kanuni i së kremtes (në 6). Pas Odes III, Përlufteshës gjenerale (shpejt). Stanca III. Përsëri dhe përsëri. Se ti je Perëndia ynë. Ndenjësoret U ul tani mbi dhë (fq. 89) si dhe Së dëlirës Virgjëreshë' (kërkoje pas Polieleit, fq. 87). Pas Odes VI dhe pas Zbritësore Varrimin tënd të triditshëm, Përlufteshës gjenerale (shpejt). Stanca IV. Përsëri dhe përsëri. Se ti je mbret i paqes. Kontaqi dhe Shtëpia e Triodhit. Sinaksari i ditës dhe i Triodhit. Pas Odes VIII dhe pas Zbritësore Vajzë dëgjo, në vend të Më të nderuarën, Ode IX. Dërgimësoret e së kremtes. Lavdërimet po të së kremtes (Kur nga apsidat në qiell, fq. 94). Lavdi dhe Tani i së kremtes (Misteri i parajetshëm zbulohet, fq. 95). Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja dhe Liturgjia.*

Mbyllja

Shërbesa e oshënares Maria Egjiptiane psalet në Pasdarkë.

Në të njëjtën ditë (të shtunën) në Mbrëmësore, pas Psaltirit, Thirrtoret: 4 ngjallësore, 3 të së kremtes (Duke të zbuluar ty, fq. 82) dhe 3 të Kryeengjëllit (Me pamje të ndritshme, fq. 98). Lavdi i Kryeengjëllit (U dërgua prej qiellit kryeengjëll, fq. 98). Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi dhe Tani Le të dëfrejnë qiejt (kërkoje pikërisht para Citimeve të 25-ës, fq. 96). Përlëshoret: ngjallësore dhe e së kremtes (2x).

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Trishenjtit në fund, Përlëshorja e së kremtes (Sot është nisja). Në Mëngjesore, Ndenjësoret ngjallësore dhe në vend të Hyjlindësoreve, Ndenjësoret e së kremtes. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimeni i Tingullit. Kanunet: ngjallësor, i së kremtes dhe i Kryeengjëllit. Pas Odes III, Ndenjësoret: e Triodhit dhe të Kryeengjëllit. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore. Sinaksari i ditës dhe i Triodhit. Zbritësoret e së kremtes; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor të Triodhit. Më të nderuarën dhe Ode IX [ngjallësore,] e së kremtes (me Madhështimin e saj) [dhe e Kryeengjëllit]. Dërgimësoret: ngjallësore dhe të së kremtes. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të së kremtes. Lavdi i Triodhit. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgjinë (e Shën Vasilit), Antifonet dhe Hyrtorja e së kremtes, por në Hyrje, Shpëtona..., që u ngjalle prej së vdekurish. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e së kremtes dhe e kishës. Kontaqi Përlufteshës gjenerale. Kungatore [Lavdëroni dhe] e së kremtes. Pamë dritën.

21. Nëse bie të Dielën e Pestë të Kreshmëve të Mëdha:

Shërbesa e oshënares shën Maria Egjiptiane psalet në Pasdarkë.

Të premten në Mbrëmësore, Thirrtoret: Idhiomeli i Triodhit (2x), Martiriku, dhe 3 të së kremtes Duke të zbuluar ty (fq. 82). Lavdi dhe Tani Misteri i parajetshëm zbulohet (kërkoje në Lavdërimet e së kremtes, fq. 95). Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e Triodhit. Le të drejtohet dhe Liturgjia e të Parashenjtëruarave.

Në mbrëmje, Himni Akathist si zakonisht. Kontaqi Parakremtor (Zure të bashk'fronshmin Zot, fq. 43).

Të shtunën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Trishenjtit në fund, Si mori vesh porosinë. Në Mëngjesore, pas Perëndi është Zoti, Si mori vesh porosinë (2x) dhe Përlëshorja Parakremtore (Sot pararendja e haresë, fq. 40). Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore Tërë Krijesa sot ka gaz (kërkoje në të kremten pas Stihologjisë së dytë [2x], fq. 87). Pas Stihologjisë së dytë Së dëlirës Virgjërësh' (kërkoje po aty pas Polieleit, fq. 87). Psalmi 50 (hima). Kanunet: i Akathistit (Ja gojën e çel tani) dhe Parakremtor («Formonte - Gëzohu*, fq. 41, me Varg: Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty). Në Odet që kanë Triodhet, lihet Kanuni Parakremtor. Pas Odes III, Kontaqi Parakremtor (Zure të bashk'fronshmin Zot, fq. 43) dhe Ndenjësore Parakremtore (Arrin në Nazaret; kërkoje në Stihologjinë e parë të së kremtes [2x], fq. 87). Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Triodhit. Sinaksari i ditës dhe i Triodhit. Zbritësoret Ja gojën e çel tani. Më të nderuarën. Dërgimësoret: e Triodhit dhe Parakremtore (E tërëqashtër, të ofrojm', fq. 45). Lavdërimet e Triodhit (ose kërkoji ato dhe në Thirrtoret Parakremtore: Një mister që ish fshehur krejt, fq. 40). Lavdi dhe Tani i Triodhit (ose kërkoje atë dhe në Pasvargjet e së kremtes: Një gjuhë që nuk e njohu; kërkoje në fund fare të 24-ës, fq. 46). Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja Parakremtore (Sot pararendja e haresë, fq. 40).*

Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanuni Parakremtor Ode III dhe VI. Pas Hyrjes, Përlëshoret: Si mori vesh porosinë, Parakremtore (Sot pararendja e haresë, fq. 40) dhe e kishës. Kontaqi Parakremtor (Zure të bashk'fronshmin Zot, fq. 43). Apostulli (kërkoje më 21 nëntor) dhe Ungjilli (kërkoje më 15 gusht në mëngjes: "Në ato ditë Mariama u ngrit"). Kungatore Kupë shpëtimi. Pamë dritën.

Në të njëjtën ditë, (të shtunën) në Mbrëmësoren e Madhe (pas Psaltirit, si zakonisht) Thirrtoret: 4 ngjallësore dhe të së kremtes (Duke të zbuluar ty, fq. 82) (në 6). Lavdi dhe Tani i së kremtes (U dërgua prej qiellit kryeengjëll, fq. 98). Hyrje.

O dritë gazmore. *Proqimeni i ditës. Leximet e së kremtes. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi dhe Tani i së kremtes* (Sot ka ungjillëzime hareje, fq. 86). *Përlëshoret: ngjallësore dhe e së kremtes* (2x).

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmi 50 (nuk psalet Kanuni Triadik), Litia e së kremtes. Pas Trishenjtit në fund, Përlëshorja e së kremtes. Në Mëngjesore, Ndenjësoret ngjallësore dhe në vend të Hyjlindësoreve, Ndenjësoret e së kremtes. Pas Polieleit (të së kremtes), Ndenjësoret e tij. Bekimtoret. Ipakoia dhe Shkallesat e Tingullit. Proqimeni dhe Ungjilli i së kremtes. Ne që pamë ngjalljen. Psalmi 50 (hima). Lavdi Me ndërmjetimet e Hyjlindësës. Tani i njëjti. Përdëllemë, o Perëndi dhe Idhiomeli Gabrieli ungjillëzon te Hirplota (fq. 88). Kanunet: ngjallësor dhe i së kremtes (bashkë me Irmoset). Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore, Ndenjësores e së kremtes (U ul tani mbi dhë [2x], fq. 89). Pas Odes VI, Kontaqi, Shtëpia dhe Sinaksari i së kremtes dhe i Triodhit. Zbritësoret e së kremtes. Në vend të Më të nderuarën, Ode IX [ngjallësore dhe] e së kremtes (me Madhështimin e saj). Dërgimësoret: ngjallësore dhe të së kremtes. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të së kremtes. Lavdi dhe Tani i së kremtes (Misteri i parajetshëm zbulohet, fq. 95). Sot erdhi.

Në Liturgji. Antifonet dhe Hyrtorja e së kremtes, por në Hyrje, Shpëtona..., që u ngjalle prej së vdekurish. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore dhe e së kremtes. Kontaqi Përlufteshës gjenerale. Apostulli dhe Ungjilli i së kremtes dhe Liturgjia e Shën Vasilit. Në vend të Të meriton, Më ty gëzohet. Kungatore [Lavdëroni dhe] e së kremtes. Pamë dritën.

Mbyllja

Në të njëjtën ditë (të dielën) në Mbrëmësore, Thirrtoret: Idhiomeli i Triodhit (të Pasvargjeve) (1x), 3 të Triodhit, 3 të së kremtes (Duke të zbuluar ty, fq. 82) dhe 3 të Kryeengjëllit (Me pamje të ndritshme, fq. 98). Lavdi dhe Tani po i Kryeengjëllit (U dërgua prej qiellit kryeengjëll, fq. 98). Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i Madh i Triodhit. Pasvargjet e së kremtes (Në muajin e gjashtë u dërgua, fq. 85). Lavdi dhe Tani po i së kremtes (Sot ka ungjillëzime hareje, fq. 86). Përlëshorja e së kremtes (3x). Urtësi. Krishti Perëndia ynë, që është i bekuar. O Mbret qiellor, siguroji. Tri Metanitë e Mëdha dhe Përlëshimi i së kremtes.



NË MBRËMËSOREN E VOGËL

*Thirrto**Ting. IV O eks ipsistu klithis*

Meqë i erdhi keq Bërësit për qenien* që krijoi, nga dhembshuria e tij u ep,* nxiton në mitrën e hybjijës* që të banojë,* kështu i shkon pranë krye-engjëlli* dhe i thot': Gëzohu, o hyhirplote Vajz',* tani me ty Perëndia është,* mos më ki frikë,* se jam kryegjeneral i mbretit Zot,* se gjete Hirin* që më parë stërnëna jote, pra Eva, e humbi krejt,*¹ do të zësh dhe do lindësh* të njëqenshmin tok me Atin lart.

"I ke të huaja pamjen, fjalën, thëniet* edhe lajmet", thotë Marjama tek engjëlli.* "Mos më mashtro, Vajzë pa burr' jam,* si do nxë unë* atë që s'mbahet; atë që s'munden dot* gjerësi në qiell ta mbajnë, pra barku im* si do ta nxërë?" Përgjigjet ky:* "Të të mësojë* kolibja abramiane, që Hyjni* që më përpara* e ka mbajtur;² kjo mitrën tënde të shenjt' hyjpranuese* paraikonizonte,* o e Virgjër, e bekuar fort.

Pasi tani në qytetin Nazaret pra* engjëll Gabrieli mbërriti, të përshëndet* ty, o i gjalli qytet frymor* i mbretit,³ Krishtit,* thërret: Gëzohu, je e bekuar ti,* hyhirplote, Zotin do kesh brenda

barkut tënd* të mishëruar, do rithërras'* ky përmes teje* nga dhembshuria drejt bukuris' së lasht'* mbar' njerëzinë;* është fryti i barkut tënd i pavdekshëm, hyjnor edhe* i bekuar, dhe botës* përdëllim të madh^{3a} i jep me ty.

Lavdi *dhe* Tani*Ting. I*

Në muajin e gjashtë kryegjenerali u dërgua drejt teje, Virgjëreshës dhe të kulluarës, që të të lajmëronte ty fjalën e shpëtimit⁴ dhe njëkohësisht të të thoshte: Gëzohu, o Hirplote, Zoti është me ty; do të lindësh Bir të parajetshëm nga Ati, i cili do ta shpëtojë popullin e vet⁵ nga paudhësitë e tij.

*Pasvargje**Ting. Tërth. IV O tu paradhoksu thávmatos*

Pasi fluturoi, poshtë zbret arkond fuqirash nga lart,*⁶ Gabrieli e përshëndet* Virgjëreshën dhe i thot':* O karrocë e pastër krejt* e Perëndisë, gëzohu; Zoti yt* përpara jete të zgjodhi për banim;*⁷ jam shërbëtor, të shpall* ty prani të Zotit tënd, ndaj jam këtu;* Zotin do ta lindësh dhe do mbe-tesh pa prishje.

Varg: Ungjillëzoheni nga dita në ditë shpëtimin e Perëndisë tonë.

Me habi i tha modestja Gabrielit: Pamja që ke* përse është e zjarrtë flak'?'*⁸ Ç'gradë ke si dhe ç'fuqi* kanë fjalët? Po lajmëron* bërjen fëmijë, por nuk kam burrë hiç,* ndaj qëndro larg, o njeri, mos më mashtro* si gjarpri tinëzar* më përpara Evën,⁹ pra stërnënë ton',* që na solli dëshpërim, dënim të gjithëve.

Varg: Këndojini Zotit një këngë të re.

Zonjë hyjpranuese dhe e kulluar, po vjen mbi ty* Perëndi, Tërëshenji Shpirt,* do të hijeshohesh ti* prej fuqis' së të Lartit Zot* dhe do të lindësh bir që do ruajë* krejt virgjërinë të palëkundur pra;* djalë pa mot është,* nuk ka gjenealogji,¹⁰ do shfaqet ky* të shpëtojë popullin,*⁵ kështu i miri do.

Lavdi *dhe* Tani

Ting. IV

Në muajin e gjashtë, u dërgua kryeengjëlli drejt një Virgjëreshe të dëlirë dhe, sapo i tha "Gëzohu", ungjillëzoi se do të dilte prej saj Çlirimtari; prandaj, meqë pranoi përshëndetjen, të zuri ty, Perëndinë e parajetshëm, që deshe me mirësi të pashprehur, të njerizoheshe për shpëtimin e shpirtave tanë.

Përlëshore

Sot është nisja

Përlëshim: Ai që për ne njerëzit dhe për shpëtimin tonë denjoi të mishërohet nga Shpirti i Shenjtë dhe Maria e virgjër, Krishti Perëndia ynë i vërtetë, me ndërmjetimet e Nënës së tij të pacenuar dhe krejt të papërlyer, Ungjillëzimin e së cilës kremtojmë, me fuqinë e Kryqit të çmuar...



NË MBRËMËSOREN E MADHE

Nuk lexohet Psaltiri.

Thirrtores

Ting. Tërth. II Olin apothémeni

Duke të zbuluar ty* haptas vendim para jete,*^{10a} Vajzë, Gabrieli vjen* dhe të përshëndet, thotë pra: Gëzohu ti,* dhë i pambjellë krejt,* ferrë e padjegur,*¹¹ thellësi ku nuk vështrohet dot, gëzohu, urë je,* që drejt qielloreve transferon,* gëzohu, shkall' e lartë shum'* që e pa Jakovi,¹² gëzo, dëfre* shtambë fort e shenjtë e manës,¹³ zgjidhje e mallkimit,¹⁴ ndjes',* rithirrje për Adamin ti,* Zoti është tok me ty.

(2x)

“Si njeri më dukesh ti”, * i thotë Vajza pa prishje* kryegjeneralit,⁶ “pra* fjal’ mbinjerëzore mbi mend më thua ti,* se the do jetë tok* Zot me mua, Perëndi,* do fushojë brenda mitrës sime; kështu më sqaro,* si një vend i gjerë do bëhem mjaft,* banesë shenjtërimi un’* për atë që mbi Keruvimet hip?*¹⁵ Mos më josh me fjalë mashtrimi, se s’njoh ëndje edhe epsh,* nuk di as dasmë, as burr’ aspak,* si do lind fëmijë, bir?

(2x)

“Mundet rendi natyror* kudo që do Perëndia”,* i patrupi tha drejt saj* “dhe realizohet çdo gjë përmbi njeri;* Vajzë e tërëshenjt’* dhe e paqortueshme,* fjalën time të vërtetë ta besosh”, në çast ajo* thirri: “Të më bëhet tani siç the,* do lind atë që nuk ka mish,* që do marr’ prej meje si hua mish,* që pors i vetmi i fortë lart ta ngrejë njerëzin’* në gradën që kish në lashtësi*¹⁶ duke u përzier me ne.”

(2x)

Lavdi *dhe* Tani*Ting. Tërth. II I Joan Monakut*

U dërgua prej qiellit kryeengjëll Gabrieli, që t’i ungjillëzonte Virgjëreshën zënien; dhe kur erdhi në Nazaret, mendohej me vete duke u çuditur për

mrekullinë, se si i pakonceptueshmi në më të lartat lind nga një e virgjër! Ai që ka qiellin si fron dhe nënkëmbëz dheun¹⁷ zihet në mitrën e një gruaje! Ai që nuk mundën dot ta vështrojnë engjëjt me gjashtë krahë¹⁸ edhe ata me shumë sy,¹⁹ deshi nga mirësia të mishërohet prej saj vetëm me anën e një fjale.²⁰ Kjo është Fjala e Perëndisë.²¹ Përse pra, rri dhe nuk i them Vajzës: Gëzohu, o Hirplote, Zoti është me ty; gëzohu, o e virgjër e kulluar, gëzohu, o nuse e panusëruar, gëzohu, o nënë e jetës,²² i bekuar është fryti i barkut tënd.

Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës dhe Leximet.

Këndimi i Gjenezës

(28.10-17)

Doli Jakovi nga pusi i betimit dhe shkoi në Harran, dhe gjeti një vend dhe fjeti aty, sepse perëndoi dielli. Dhe mori një nga gurët e vendit dhe e vuri nën kokën e tij edhe fjeti në atë vend edhe pa një ëndërr. Dhe ja, një shkallë e mbështetur në tokë, maja e së cilës arrinte në qiell dhe engjëjt e Perëndisë ngjiteshin dhe zbrisnin mbi të, ndërsa Zoti po mbështetej mbi të, dhe tha: “Unë jam Perëndia i Abrahamit, atit tënd dhe

Perëndia i Isaakut; mos ki frikë. Toka mbi të cilën ti fle mbi të, ty dhe farës sate do t'ia jap. Dhe do të jetë fara jote si rëra e dheut dhe do të shtrihet në perëndim dhe në jug, dhe në veri dhe në lindje. Dhe do të bekohen në ty dhe në farën tënde të gjitha fiset e tokës. Dhe ja, unë *do të jem* me ty, duke të ruajtur në çdo udhë ku do të ecësh. Dhe do të të kthej në këtë tokë, sepse nuk do të të braktis derisa të bëj gjitha ato që të thashë”. Dhe u ngrit Jakovi nga gjumi i tij dhe tha se “Është Zoti në këtë vend, kurse unë nuk e dija”. Dhe u frikësua dhe tha: “Sa i frikshëm qenka ky vend! Nuk është ky, veçse shtëpi Perëndie dhe kjo është porta e qiellit”.

Këndimi i profecisë së Jezekielit

(43.27- 44.4)

“Do të jetë që nga dita e tetë dhe më pas, do të bëjnë priftërinjtë mbi altarin holokaustet tuaja dhe ato të shpëtimit tuaj. Dhe do t'ju pranoj”, thotë Zoti. Dhe më ktheu drejt udhës së portës së jashtme të të Shenjtave që sheh nga lindja dhe ajo ishte e mbyllur. Dhe Zoti tha tek unë: “Kjo portë do të jetë e mbyllur, nuk do të hapet, dhe askush nuk do të kalojë nëpërmjet saj, se Zoti, Perëndia i Izraelit do të hyjë përmes saj dhe do të jetë e mbyllur, sepse ky prijës rri mbi

të, që të hajë bukë. Ai do të hyjë nga udha e portës së Elamit dhe nga udha e tij do të dalë”. Dhe më futi nga udha e portës, që ishte drejt veriut përballë shtëpisë. Dhe pashë, dhe ja plot lavdi ishte shtëpia e Zotit.

Këndimi i Fjalëve të Urta

(9.1-11)

Urtësia ndërtoi për vete shtëpi, dhe mbështeti shtatë shtylla. Theri viktimat e saj dhe përzjeu në kanë verën e saj dhe përgatiti tryezën e saj. Dërgoi shërbëtorët e saj duke ftuar me shpallje të lartë mbi kanë, duke thënë ajo: “Ai që është i metë le të kthehet tek unë”. Dhe atyre që ishin të varfër nga mendja u tha: “Ejani, hani bukën time dhe pini verën që ju kam përzier. Braktisni idiotësinë dhe do të rroni; dhe kërkoni urtësinë që të jetoni dhe që të arrini mençurinë me dije”. Ai që edukon të këqij do të marrë për vete çnderim, dhe duke kritikuar të pabesin do të qortojë veten e tij. Sepse kritikën për të pabesin janë plagë për atë. Mos kritiko të këqij, që të mos të të urrejnë; kritiko të urtin dhe do të të dojë. Jepi të urtit një shkak, dhe do të jetë më i urtë; bëj të ditur tek i drejti, dhe do të shtojë të pranojë. Fillim urtësie është frika e Zotit dhe mendim shenjtorësh është mençuria. Ndërsa dija e ligjit i përket mendjes

së mirë, sepse në këtë mënyrë do të jetosh shumë kohë dhe do të të shtohen vite jete.

*Në Liti Idhiomele
Ting. I I Bizantit*

Në muajin e gjashtë kryegjenerali u dërgua drejt teje, Virgjëreshës dhe të kulluarës, që të të lajmëronte ty fjalën e shpëtimit⁴ dhe njëkohësisht të të thoshte: Gëzohu, o Hirplote, Zoti është me ty; do të lindësh Bir të parajetshëm nga Ati, që do ta shpëtojë popullin e vet⁵ nga paudhësitë e tij.

I njëjti I Anatoliut

Në muajin e gjashtë u dërgua nga qielli kryeengjell Gabrieli në një qytet të Galilesë, në Nazaret, që t'i çonte Vajzës ungjillëzime hareje; dhe, si u afrua drejt saj, thirri duke thënë: "Gëzohu, o Hirplote, Zoti është me ty." Gëzohu, enë e natyrës së panxënshme, sepse atë që nuk e mbajtën qiej, e mbajti barku yt, o e bekuar; gëzohu, o modeste, rithirrja e Adamit, çlirimi i Evës, hareja e botës dhe ngazëllimi i gjinisë sonë.

I njëjti

U dërgua engjëlli Gabriel nga qielli prej Perëndisë drejt një Virgjëreshe të panjollshme, në qytetin e Galilesë,

në Nazaret, që t'i ungjillëzonte ngjizjen në mënyrë të huaj. U dërgua shërbëtor pa trup në një qytet të gjallë dhe portë mendore,²³ që të lajmëronte bashkëzbritjen e pranisë zotërore. U dërgua ushtar qiellor në pallatin frymor të lavdisë, që t'i përgatiste Ndërtuesit banesë pa mbarim. Dhe, sapo arriti tek ajo, thërriste: Gëzohu, o fron me pamje zjarri,²⁴ më e përmblavdëruar se ata me katër fytyra;¹⁹ gëzohu, o katedër mbretërore, qiellore; gëzohu, o mal i palatuar,²⁵ enë e tërëçmuar, sepse në ty banoi trupërisht tërë plotësia e Hyjnisë me mirëdashjen²⁶ e Atit të përjetshëm dhe me bashkëpunimin e Shpirtit të Shenjtë; gëzohu, o Hirplote, Zoti është me ty.

Lavdi dhe Tani

Ting. II I Kozma Monakut

Gabrieli ungjillëzon te Hirplota sot: Gëzohu, o Vajzë e panusëruar dhe e pamartuar; mos u çudit nga pamja ime e huaj, as mos u frikëso, sepse jam kryeengjell; një gjarpër e mashtroi Evën dikur;⁹ tani të ungjillëzoj harenë, dhe do të mbetesh e paprishur, dhe do të lindësh Zotin, o e pacenuar.

Pasvargje

Ting. IV

Në muajin e gjashtë, u dërgua kryeengjëlli drejt një Virgjëreshe të dëlirë

dhe, sapo i tha “Gëzohu”, ungjillëzoi se do të dilte prej saj Çlirimtari; prandaj, meqë pranoi përshëndetjen, të zuri ty, Perëndinë e parajetshëm, që deshe me mirësi të pashprehur të njerizoheshe për shpëtimin e shpirtave tanë.

Varg: Ungjillëzoheni nga dita në ditë shpëtimin e Perëndisë tonë.

Perëndilindësja dëgjoi një gjuhë që nuk e njohu, sepse i fliste Kryeengjëlli fjalët e ungjillëzimit; prandaj, meqë pranoi besërisht përshëndetjen, të zuri ty, Perëndinë e parajetshëm; ndaj edhe ne, duke u ngazëlluar, të thërrasim: O Perëndi që u mishërove pa ndryshim prej saj, fali botës paqe²⁷ dhe shpirtave tanë përdëllimin e madh.^{3a}

Varg: Këndojini Zotit një këngë të re. **J**a ku u shfaq tani rithirrja jonë; Perëndia bashkohet përmbi fjalë me njerëzit; me zërin e kryeengjëllit mashtrimi mpaket, sepse Virgjëresha pranon harenë; tokësoret u bënë qiell; bota u zgjidh nga nëma e lashtë.¹⁴ Le të ngazëllohet Krijesa dhe le të përhimnojë me zëra: O Bërës dhe çlirimtari ynë, o Zot, lavdi më ty.

Lavdi dhe Tani

I njëjti I Andrea Jerusalemasit

Sot ka ungjillëzime hareje, panair

virgjëror; të poshtmet bashkohen me të lartat, Adami ripërtëritet, Eva çlirohet nga dhimbja e parë¹⁴ dhe tenda e esencës sonë u bë tempull Perëndie falë hyjnizimit të brumit që u mor. O çudi! Mënyra e zbrazjes²⁸ është e panjohur, mënyra e zënies është e pashprehshme. Engjëlli i shërben mrekullisë; bark virgjëror mikpret Birin; Shpirti i Shenjtë dërgohet poshtë; Ati nga lart ka mirëdashje, dhe ndryshimi realizohet me vullnet të përbashkët. Si shpëtuam me të dhe përmes tij, tok me Gabrielin le t'i thërrasim Virgjëreshës: “Gëzohu, o Hirplote, Zoti është me ty”. Prej teje erdhi shpëtimi, Krishti Perëndia ynë,²⁹ i cili, pasi mori natyrën tonë, e risolli te vetja; atij përgjëroju që të shpëtohen shpirtat tanë.

Përlëshore

Ting. IV

Sot është nisja e shpëtimit tonë, edhe shfaqja e misterit të qëmotëshëm;³⁰ i Bir' i Perëndisë bëhet i bir' i Virgjëreshës, dhe Gabrieli ungjillëzon këtë gëzim; prandaj le t'i thërresim Hyjlindëses: Gëzohu, o Hirplote, Zoti është me ty.*

(3x)

Përlëshim: Kërkoje në fund të

Mbrëmësore së Vogël.

Sonte lexohet Pasdarka e Vogël.



NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësores
Ting. I Ton tafon su Sotir*

Arrin në Nazaret,* në qytet gjenerali* i madh i forcave të patrup,⁶ të njofton pra,* o Vajzë pa cenim, ty Mbretin e jetëve, Zotin³¹ pra;* thotë: Ki gëzim* Mari e tërëbekuar,* nuk kuptohet dot* dhe nuk shpjegohet çudia;* gjinin' e rithirre ti.

Lavdi *dhe* Tani
I njëjti

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësores
Ting. III Tin oreótita*

Tërë Krijesa sot* ka gaz, se engjëlli* “Gëzohu” të thërret,* “je e bekuar ti,* e tërëpaqortueshme, modeste, e pacenuar”.* Pranga e mallkimit¹⁴ ra,* që na vuri stërati yn',* çdo tërbim i gjarprit djall*⁹ shuhet sot, të thërresim pra:* Gëzohu, o Hirplote e virgjër,* linde ti Perëndinë tonë.

Lavdi *dhe* Tani
I njëjti

*Pas Polieleit, (Psalmi 44) Ndenjësores
Ting. IV Kateplaji Iosif*

Gabrieli i thërret* modestes që nga qielli:* “Gaz ki, se do nxësh në bark* të parajetshmin, Zotin Krisht,* që përmes fjalës ka bërë çdo skaj të botës”.*³² “Si do lind bir unë që burrë s'kam,”* tha Mariama se, “pjellori pa far’* kush e ka parë?”. Engjëlli shpjegoi,* i tha Hyjlindëses virgjëresh':* “Do vij’ te ti Shpirt,* do hijeshohesh* me fuqi nga i Larti”.

Lavdi *I njëjti*

Tani *I ngjashëm*

Së dëlirës Virgjëresh'* i çohet krye-engjëlli* Gabriel; i lajmëron* hare që s'shprehet dot aspak:* Pa far' do ngjizesh, s'do prishesh, sepse do lindësh* Bir, të parajetshmin Zot Perëndi,* do shpëtojë nga faji popullin;*⁵ dëshmon ai që më dërgoi të them:* “O e bekuar, gëzohu”.* Ti lind e virgjër* edhe pas lindjes* mbetesh prapë e virgjër.

*Shkallesat. Antifoni i Ting. IV.
Proqimeni Ting. IV*

Ungjillëzoheni nga dita në ditë shpëtimin e Perëndisë tonë.

Varg: Këndojini Zotit një këngë të re.

Ungjilli. Psalmi 50.

Lavdi. Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.
Tani. *I njëjti.*

Përdëllemë, o Perëndi. *Dhe Idhiomeli.*

Ting. II I Kozma Monakut

Gabrieli ungjillëzon te Hirplota sot: Gëzohu, o Vajzë e panusëruar dhe e pamartuar; mos u çudit nga pamja ime e huaj, as mos u frikëso, sepse jam kryeengjell; një gjarpër e mashtroi Evën dikur;⁹ tani të ungjillëzoj harenë, dhe do të mbetesh e paprishur, dhe do të lindësh Zotin, o e pacenuar.

Kanuni (në 6, pa Varg, përveç Lavdi si dhe Tani në dy troparet e fundit, si gjithmonë).

Ting. IV

Poezi e Joan Monakut

Ode I

Irmosi: Anikso to stoma mu

»Ja gojën e çel tani i frymëzuar prej
»Shpirtit³³ Shenjt* dhe këngë do t'i
»këndoj nënës së madhe mbi fron;*³⁴
»dhe do ta kremtoj* me valle buzë-
»qeshur;* me zë do ta shpall kudo
»zënien e saj me gaz.*

Davidi, stërati yt, t'i bjerë lirës³⁵ së Shenjtit Shpirt,* o Zonjë, që të këndojë për ty: Bijë, dëgjo*³⁶ lajmin engjëllor,* gazmor, zë për harenë,* që nuk shprehet³⁷ të njofton: Zotin do lindësh ti.

Engjëlli: Me gaz të thërras ty, ule veshin,³⁶ dhe ki kujdes pra ti,* njoftoj zënien e pafar' të Perëndisë, sepse* para Zotit tënd* ke gjetur hir, të cilin* askush tjetër s'gjeti ndonjëherë, e dëlir'.

Hyjlindësja: Fuqinë e fjalëve të tua si ta kuptoj, ta di;* ti qartazi thua si do bëhet ngjarja që the,* si do zë në bark* sado jam vajz' e virgjër,* si nëna e Bërësit tim do të bëhem pra?

Engjëlli: Më duket se po mendon, se unë me tinëzi të flas;* gëzohem se veten tënde ruan me siguri;* ki kurajë, Zonj';* se ku do Perëndia* mbarojnë me lehtësi paradoksalet krejt.³⁸

Zbritësore: Anikso to stoma mu

Ja gojën e çel tani

Ode III

Irmosi: Tus sus imnologus

»**O** Zonjë dhe nën' e Perëndisë, burim
»i pasosur jetësor,* ti siguroji gjith'
»ata që të këndojnë plot me zell* në
»zënien tënde kaq të shenjt', kurorë-
»zoji me çdo lavdi.^{39*}

Hyjlindësja: Shteroi arkond nga Juda,⁴⁰ erdhi pra koha⁴¹ kur Krishti, shpresa jon',* pritja e gjithë kombeve

do shfaqet,⁴⁰ por ti më sqaro,* si unë do ta lind atë, pasi jam Vajzë e virgjër krejt?

Engjëlli: Kërkon të mësosh prej meje, o Virgjëreshë, mënyrën e zënies,* por nuk shpjegohet dot, do hijeshohesh ti prej Shenjtit Shpirt,* do kryhet kjo me forcën e tij krijimtare shpëtuese.

Hyjlindësja: Kur priti stërnëna ime fjalën, mendimin e gjarprit,⁹ u flak tej,* jashtë shijimit aq të hyjshëm,¹ ndaj dhe unë frikë kam* se mos rrëshqas, më tremb pra përshëndetja jote e huaj fort.

Engjëlli: Jam një adjutant i Perëndis',⁴² u dërgova të lajmëroj vullnet* që ka Hyjnia, pse më druhash mua, që të trembem ty,* e Tërëpaqortueshme, pse frik' më ke, un' të druham ty.

Zbritësore: Tus sus imnologus

O Zonjë dhe nën'

Ndenjëso

Ting. Tërth. IV Avlón pimenikón

“U ul tani mbi dhé* Fjalë Perëndie”,^{*21} thërriste engjëlli,* kur i erdhi Vajzës.* “Ki gaz, o e bekuar, që vulën vetëm ti e ke ruajtur,* kur prite brenda mitrës të parajetshmin, pra Fjalën, Zotin Krisht,* që nga mashtri-

mi e shpëton si Zot* gjininë njerëzore”.

Lavdi *dhe* Tani

I njëjti

Ode IV

Irmosi: O kathímenos en dhoksi

»**T**i që rri midis lavdisë* përmbi fronin
»e hyjshëm,*^{42a} nga një re e lehtë*
»erdhe,⁴³ o Jisu i përjetëshëm,* dhe
»na shpëtove me dorën jetëdhënëse,*
»të thërresim pra nder dhe lavdi gjithënjë mbi ty.*

Hyjlindësja: Kam dëgjuar profetin që qëmoti paratha me hyjfrymëzim, se një virgjëreshë e hyjshme do të lindë Emanuelin;⁴⁴ dëshiroj shumë të njoh se si natyra e të vdekshmëve do pësojë përzierjen e Hyjnisë?

Engjëlli: Ferra që mbeti e padjegur, ndonëse priti flakë,¹¹ e kallëzoi hap-tas misterin e parrëfyeshëm që bëhet te ti, o Hirplote e panusëruar, sepse pas lindjes do mbetesh e dëlirë, gjithmonë e virgjër.

Hyjlindësja: O shpallës i së vërtetës, Gabriel, thuamë plotësisht me të vërtetë, duke feksur nga drita e Perëndisë të Tërëpushtetshëm: Si do të lind unë me mish Fjalën e patrups, ndonëse do të mbetet e pacenuar dëlirë-sia ime?

Engjëlli: Me ndrojtje, si shërbëtor, që-ndroj pranë teje si pranë Zonjës; me frikë, o Vajzë, trembem tani të të kup-toj; do të zbresë mbi ty⁴⁵ si shi mbi shtëllungë Fjala e Perëndisë, siku-ndër deshi nga mirësia.

Zbritësore: O kathimenos en dhoksi

Ti që rri midis lavdisë

Ode V

Irmosi: Eksesti ta simpanta

»**T**ë gjith' i habite ti me një çudi dhe
»një lavdi,* ti, o Virgjëresh' e pamartu-
»ar;* Zotin e jetës që⁴⁶ mbretëron lart
»në q'ell si një bir e mbajte në pëqi*
»dhe shpëtim që lartazi* u dhurove
»besnikëve.*

Hyjlindësja: Nuk mundem të kuptoj saktësinë e fjalëve të tua, sepse çudi u kryen shumë herë me fuqi hyjnore, simbole dhe shenja Ligjore, por asnjë-herë nuk lindi pa burrë një virgjëreshë.

Engjëlli: Çuditësh, o Virgjëreshë, sepse është e huaj mrekullia jote, meqë vetëm ti do pranosh në mitër Mbretin e të gjithave, që të mishërohet; dhe ty të paraikonizojnë thënie dhe enigma⁴⁷ profetësh, dhe simbolet e Ligjit.

Hyjlindësja: I panxëni në të gjitha dhe i pashikueshmi nga të gjithë⁴⁸ si do

të mundë të banojë në mitër virgjërore, që ai vetë gatoi? Dhe si unë do të zë Perëndi, Fjalën e bashkëpanisshëm me Atin¹ dhe Shpirtin?

Engjëlli: Meqenëse i premtoi stëratit tënd David, se nga fryti i barkut do të vendosë mbi fronin e mbretërisë së tij,⁴⁹ vetëm ty, bukurinë e Jakovit,⁵⁰ të zgjodhi si vendbanim të arsyeshëm.

Zbritësore: Eksesti ta simpanta

Të gjith' i habite ti

Ode VI

Irmosi: Evóise protipón

»**V**arrimin tënd* të triditshëm e para-
»skiconte qart'* duke thirrur,* kur në
»një peshk të madh lutej, o Jisu,* shën
»Jona profeti:*⁵¹ Mbret i forcave,⁵² prej
»prishjes më çliro.⁵³

Hyjlindësja: Me gaz hyjnor* jam e mbushur⁵⁴ që kur prita zërin tënd,* sa ke thënë,* me hare, Gabriel, se njofton gëzim,* lajmëron dëfrimin,* ngazëllimin e pafund dhe pa pushim.

Engjëlli: Te ti u dha,* o Hyjnënë, gëzimi hyjnor nga lart,* Gjithësia,* o Hyjnuse, "Gëzohu" ty të thërret,* sepse vetëm ti, nën'* u caktove për Birin e Perëndis'.

Hyjlindësja: Tani nga un'* u ndaloftë dënimi i Evës¹⁴ pra,* le të lahet* sot

përmes meje borxhi dhe huaja*⁵⁵ e tejlasht', me mua* të shpërblehet në fund me përpikëri.

Engjëlli: I dha premtim* Abrahamit stërat' Perëndia Zot,* se me farën* e tij kombet do kishin bekim⁵⁶ dhe hir;* mbushet sot premtimi* me ty, o e dëlira Hyjlindëse.

Zbritësore: Evóise protipón

Varrimin tënd të triditshëm

Kontaqi

Ting. Tërth. IV Ti ipermaho

Përlufteshës gjenerale këngët mundëse, si përhirim që e shpëtove prej tmerreve, qyteti yt po të përshkruan, o Virgjëreshë, po sikurse ke fuqi të paluftueshme, prej çfarëdo rreziku shpëtomë, se po të thërres: Gëzohu, o Nuse e panusëruar.*

Shtëpia

Engjëlli kryetar u dërgua nga qielli t'i thotë Hyjlindëses: "Gëzohu". Dhe duke të parë të trupëzohesh, o Zot, bashkë me zërin engjëllor çuditej e qëndronte duke i thirrur asaj kështu: Gëzohu ti, me anën e së cilës do të shkëlqejë gazi; gëzohu ti me anën e së cilës do të humbasë mallkimi.¹⁴ Gëzohu, o rithirrje e Adamit të rënë;

gëzohu, o shpërblim i lotëve të Evës. Gëzohu, o lartësi ku mendjet njerëzore nuk arrijnë të ngjiten dot; gëzohu, o thellësi ku edhe sytë engjëllorë e kanë të vështirë të shikojnë.

Gëzohu, se ti je fron i Mbretit; gëzohu, se ti mban atë që i mban të gjitha.⁵⁷

Gëzohu, o yll që tregon Diellin; gëzohu, o bark që trupëzon Hyjninë.

Gëzohu ti, më anën e së cilës përtërihet Krijesa; gëzohu ti, me anën e së cilës foshnjëzohet Krijuesi.

Gëzohu, o Nuse e panusëruar.*

Sinaksari

Më 25 të të njëjtit muaj, Ungjillëzimi (Evangjelizmoi) i së Tërëshenjtës, Perëndilindëses dhe Gjithmonëvirgjres Mari.

Vargje: Një engjëll i lajmëroi Virgjëreshës/ lajmëtarin e madh të vendimit të madh të Atit.^{9a}

Në njëzet e pesë, një engjëll i tha Marisë: Gëzohu.

E atij është lavdia dhe pushteti në jetë. Amin.

Ode VII

Irmosi: Uk elátrefsan

»**N**uk u faleshin krijesave hyjmendë-
»sit, por Krijëtarit⁵⁸ lart,* dhe kërcëni-
»min me zjarr* e shkelën me trimëri,

»psalnin me brohori:* Zot lavdi më ty;*
 »o Perëndi i etërve,* ti je vetëm i be-
 »kuar.^{59*}

Hyjlindësja: Duke njoftuar dritën e palëndët,⁶⁰ që do bashkohet me material trupi nga dhembshuria e shumtë, ungjillëzim të gëzueshëm, predikime të hyjshme, më thërret tani: Është i bekuar, o e Tërëkulluar, fryti i barkut tënd.

Engjëlli: Gëzohu, o Zonjë e virgjër; gëzohu, o e tërëdëlirë; gëzohu, o enë Perëndie; gëzohu, o kandil drite,⁶¹ rithirrja e Adamit, çlirimi i Evës, mal i shenjtë,⁶² shenjtërimi i shquar dhe nusërore pavdekësie.

Hyjlindësja: Mbiardhja e Shpirtit të Tërëshenjtë më pastroi shpirtin dhe më shenjtëroi trupin, më bëri tempull që mban Perëndi,⁶³ tendë të hyjstolisur, tempull frymor dhe nënë të dëlirë jete.²²

Engjëlli: Të shoh si llambadhe të shumëndritshme⁶¹ dhe nusërore⁶⁴ të hyjkrijuar; si një arkë e artë⁶⁵ prano tani dhënësin e Ligjit, o e Tërëpaqortueshme, i cili deshi nga mirësia ta çlirojë me anën tënde esencën e prishshme të njerëzve.

Zbritësore: Uk elátrefsan

Nuk u faleshin

*Dy Odet që vijojnë,
 kanë Akrostihidhë të brendshme
 alfabetike; e para të drejtë, e dyta
 të përmbysur.*

Ode VIII

Irmosi: Ákue kori Parthene

»Vajzë, dëgjo, Virgjëreshë me nam,*
 »se engjëlli shën Gabriel* të sjell ty
 »lajmë^{9a} gazmore prej Zotit Madh,*
 »gatitu për Perëndinë, Zotin Jisu,* se
 »prej teje jetëdhënësi po lind si një
 »njeri mbi dhé.*⁶⁶ Pra, të thërres me
 »gëzim: Që të gjitha* veprat e Zotit,
 »Jisunë bekojeni.^{67*}

Hyjlindësja: Kundërshtoi Virgjëresha:
 “Çdo mendim i vdekatarëve humbet
 duke hetuar paradokset që më thua;
 i mora vesh fjalët e tua, por po shta-
 ngem nga frika mos vallë më dërgon
 me mashtrim⁹ larg Perëndisë sikur-
 se Evën;¹ por ja që thërret: Bekojeni,
 gjithë veprat e Zotit, Zotin.⁶⁷

Engjëlli: Si përgjigje i thotë Gabrieli:
 Ja ku u zgjidh habia jote. Mirë the, se
 puna është e vështirë të argumento-
 het, prandaj, ti duke iu bindur fjalëve
 të buzëve të tua, mos dysho për fan-
 tazmë, por besojë si realitet, ndërsa
 unë thërras i gëzuar: Bekojeni, gjithë
 veprat e Zotit, Zotin.⁶⁷

Hyjlindësja: E paqortueshmja thotë
 prapë: Ky është ligj i dhënë nga Perë-

ndia për njerëzit, lindja të pasojë një dashuri të athët; nuk di absolutisht kënaqësi bashkëshorti, pra si thua se do të lind? Kam frikë mos flet me dredhi; por ja që thërret: Bekojeni, gjithë veprat e Zotit, Zotin.⁶⁷

Engjëlli: Engjëlli përsëri thërret: O e thjeshtë, fjalët që më thua janë për lindjen e zakonshme të njerëzve të vdekshëm; të premtoj Perëndinë e vërtetë të mishërohet prej teje, siç di ai përmbi fjalë dhe mendim, prandaj dhe thërras i gëzuar: Bekojeni, gjithë veprat e Zotit, Zotin.⁶⁷

Hyjlindësja: Më dukesh orator i së vërtetës, - u tërhoq Virgjëresha, - sepse erdhe si lajmëtar i gëzimit të përbashkët; meqenëse u pastrova në shpirt prej Shpirtit, le të bëhet tek unë fjala jote; le të fushojë tek unë Perëndia, të cilit po i thërras tok me ty: Bekojeni, gjithë veprat e Zotit, Zotin.⁶⁷

Zbritësore: Ákue kori Parthene

Vajzë, dëgjo, Virgjëreshë

(Në vend të Më të nderuarën)

Ode IX

Madhështim që përsëritet para çdo tropari:

Ungjillëzoje,* dhé, haren' e madhe,⁶⁸
himnoni, qiej, pra lavdin' e Zotit.⁶⁹

Irmosi: Os empsiho Theú kivotó

»Si një ark' zotërore me shpirt,*⁶⁵ as-
»pak pra* mos e prehtë dor'⁷⁰ pa be-
»së,* por gjithnjë Hyjlindëses t'i thonë
»fort me zërin* e engjëllit buzët e bes-
»nikëve,* duke psalur me ngazëllim
»pra:* O Hirplote, ti gëzohu, me ty është
»të Zoti Krisht.

Mbi mendim Perëndi zure ti,* i shma-
nge,* Vajzë, ligjet e natyrës,* ngaqë
iu shpëtove sa në lindje kanë nënat,*
edhe pse je kalimtare në natyr';* ndaj
dëgjon siç ty të ka hije:* O Hirplote,
ti gëzohu, me ty është Zoti Krisht.

Si buron, Virgjëresh', qumësht ti?*

Nuk mundet* që ta thotë gjuh' nje-
riu,* se shfaq, e dëlirë, gjë të huaj nga
natyra,* po mund kushte lindjeje ligjo-
re pra;* ndaj dëgjon siç ty të ka hije:*
O Hirplote, ti gëzohu, me ty është Zoti
Krisht.

Nëpër Shkrimin e Shenjt' misti-
kisht,* o nënë* e të Lartit, për ty fli-
tet;* pa Jakovi shkall' qëmoti që të
shëmbëllente,* kështu tha se është
bazë Zoti¹² kjo;* ndaj dëgjon siç ty të
ka hije:* O Hirplote, ti gëzohu, me ty
është Zoti Krisht.

Zjarr dhe ferrë treguan çudi* që shta-
ngte* Moisiun,¹¹ që i shfaqte* qart'
hyjnoret dhe kërkonte ta shikonte
fundin* e kohës, përmbushjen te një

e dëlir',* ndaj tha: Si Hyjlindëse të them:* O Hirplote, ti gëzohu, me ty është Zoti Krisht.

Danieli të tha mal mendor,*²⁵ dhe nënë* Perëndie Isaia,*⁴⁴ si lëmsh Gje-deoni ty të pa,⁴⁵ kurse Davidi* të tha shenjtërim,⁷¹ një tjetër portë²³ ty,* ndërsa të thërret Gabrieli:* O Hirplote, ti gëzohu, me ty është Zoti Krisht.

Zbritësore: Os empsiho Theú kivotó

Ungjillëzoje, dhé

dhe

Si një ark' zotërore me shpirt.

Dërgimësore

Tis mathitēs sinélthomen

Nga i Pushtetshmi Perëndi* dërgohet gjenerali* i forcave të engjëjve*⁶ tek e dëlira Vajzë,* t'i japë lajm për çudinë* që është e huaj dhe s'tuhet,* se bëhet foshnjë prej asaj* si njeri Perëndia pa farë hiç* dhe ripërtërit çdo gjini njerëzore;* ungjillëzoni, popuj pra,* ripërtëritje bote.

E ngjashme

Gëzohu, o Hyjlindëse,* çlirimi i mallkimit* stëratëror,¹⁴ Hyjnën' e thjesht',* ferrë¹¹ e gjallë, ki gaz;* gëzohu, fron¹⁵

dhe llambadhe;*⁶¹ ki gaz, shkallë¹² dhe portë,²³* karroc' hyjnore si dhe re* fort e lehtë;⁴³ gëzohu, gëzohu mal,*⁷² tempull edhe shtambë e artë krejt pra;*¹³ gëzohu, tendë⁷³ dhe tryez',*⁷⁴ zgjidhja e Evës ti je.

Lavdërime

Ting. I Ton uranion tagmaton

Kur nga apsidat në qiell me fluturim po zbret* shën Gabrieli dhe vjen* te Maria e virgjër,* pra në Nazaret, thërret: Bir do nxësh* më të lasht' prej Adamit, se* është Krijues i çdo gjëje⁷⁵ dhe çliron* çdokënd që "Gëzohu" të thërret.

(2x)

Kur tek e virgjra krejt, Vajza, solli ungjillëzim* prej q'ellit Gabrieli,* po thërriste: Gëzohu,* se do nxësh në bark atë që nga ti* mund të zihet, por bota dot* s'e mban; do shfaqesh shtatzënë ti me një Bir* Ati para Dri-tëprurësit.⁷⁶

Fjala e bashkëpërjetshme e Atit pa fillim* s'u nda nga më të lartat* dhe kur erdhi tani posht'.* Zbriti, sepse kish për ne dhembshuri* për rrëshqitjen ton',⁹ mori pra* ky varfërin' e Adamit edhe u vesh* me të huajën⁷⁷ me mirësi.

Lavdi *dhe* Tani

Ting. II I Theofanit

Misteri i parajetshëm zbulohet³⁰ sot dhe Biri i Perëndisë bëhet bir njeriu, që, pasi të marrë pjesë te më e keqja, të më përçojë më të mirën. U zhgënjye qëmoti Adami dhe, ndonëse e dëshiroi, nuk u bë perëndi.⁹ Perëndia bëhet njeri që Adamin ta bëjë perëndi. Le të dëfrejë Krijesa, le të kërcejë natyra, sepse një kryeengjell qëndron me frikë pranë një Virgjëreshe dhe sjell “Gëzohu-n”, të kundërtën e trishtimit. O Perëndia ynë, që u njerizove nga dhembshuria, lavdi më ty.

Dhoksologjia e Madhe

Në Liturgjinë (e Shën Joan Gojartit)

Antifonet:

Antifoni i parë

Varg a): O Perëndi, jepi gjykimin tënd mbretit dhe drejtësinë tënde birit të mbretit.

Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.

Varg b): Le të marrin përsipër malet paqe për popullin dhe kodrat drejtësi. Me ndërmjetimet.

Varg c): Ungjillëzoheni nga dita në ditë shpëtimin e Perëndisë tonë. Me ndërmjetimet.

Varg d): Iu betua Zoti Davidit për një të vërtetë dhe nuk do të pendohet.

Me ndërmjetimet.

Lavdi *dhe* Tani

Me ndërmjetimet.

Antifoni i dytë

Varg a): Do të zbresë si shi mbi shtëllungë dhe si pikë që pikon mbi dhé. Shpëtona, o i Bir i Perëndisë, që u mishërove për ne, ne që të psalim Aliluia.

Varg b): Shenjtëroi tendën e tij i Shumëlarti.

Shpëtona.

Varg c): Perëndia dukshëm do të vijë, Perëndia ynë, dhe nuk do të jetë i heshtur.

Shpëtona.

Varg d): Do të lindë në ditët e tij drejtësi dhe shumicë paqeje.

Shpëtona.

Lavdi *dhe* Tani

O i vetëmlindur Bir.

Antifoni i tretë

Varg a): Do të jetë emri i tij i bekuar në jetë.

Sot është nisja.

Varg b): Qoftë i bekuar Zoti, Perëndia i Izraelit, i vetmi që bën gjëra të çuditshme.

Sot është nisja.

Varg c): Qoftë i bekuar emri i tij në jetë dhe në jetën e jetës. Sot është nisja.

Hyrtores

Ungjillëzoheni nga dita në ditë shpëtimin e Perëndisë tonë. Shpëtona.

Pas Hyrjes, Përlëshorja dhe Kontaqi i së kremtes. Në vend të Të meriton, Ungjillëzo, o dhé, harenë; Si një ark'. Kungatore: Zgjodhi Zoti Sionin, e preferoi për banesë të tij, Aliluia. Pamë dritën. Përlëshimi (kërkoje në Mbrëmësoren e Vogël).

Idhiomel që psalet kur e kërkon Tipikoni.

Ting. Tërth. IV I Joan Monakut

Le të dëfrejnë qiejt dhe të ngazëllohet dheu,⁷⁹ sepse Biri i bashkëpërjetshëm, i bashkëpafillim dhe i bashkëfronshëm, pasi pati keqardhje dhe mëshirë njeridashëse, e zbriti veten në zbraze²⁸ sipas mirëdashjes dhe vullnetit atëror, dhe banoi në mitër virgjërore, që u parapastrua me anën e Shpirtit. O çudi! Perëndia është ndër njerëzit, i panxënshmi në mitër, i pamoçmi në kohë; dhe ja paradoksi: Edhe zënia është e pafarë, edhe boshatisja²⁸ e pashprehshme, edhe misteri kaq i madh, sepse Perëndia zbrazet²⁸ edhe

mishërohet, edhe gatuhet, pasi një engjëll i tha së kulluarës ngjizjen: Gëzohu, o Hirplote, Zoti është me ty, ai që ka përdëllimin e madh.^{3a}

CITIME

¹ Gjen. 3.21-24

² Gjen. 18.1-8; Hebr. 13.2

³ Ps. 47(48).3 etj.

^{3a} Num. 14.19 etj.

⁴ Vep. 13.26

⁵ Matth. 1.21; Joan 12.47

⁶ Jis. N. 5.14-15

⁷ Ps. 131(132).13

⁸ Ps. 103(104).4; Hebr. 1.7

⁹ Gjen. 3.1-6

^{9a} Is. 9.6

¹⁰ Hebr. 7.3

^{10a} Is. 25.1

¹¹ Eks. 3.2-5

¹² Gjen. 28.12-17

¹³ Eks. 16.33; Hebr. 9.4

¹⁴ Gjen. 3.16-19

¹⁵ IV [II] Mbret. 19.15; Jez. 10.1

¹⁶ Gjen. 1.27-30

¹⁷ Is. 66.1; Vep. 7.49

¹⁸ Is. 6.2

¹⁹ Jez. 1.6

²⁰ Lluk. 1.31

²¹ Joan 1.1

²² Gjen. 3.20

²³ Jez. 44.1-4; Gjen. 28.17

²⁴ Jez. 1.13-26

²⁵ Dan. 2.34-35

²⁶ Kol. 1.19

²⁷ Joan 14.27

²⁸ Fil. 2.6

²⁹ Vep. 4.12; I Thes. 5.9; Hebr. 2.10; 5.9

³⁰ Kol. 1.26

- ³¹ Ps. 144(145).13; I Tim. 1.17
³² Gjen. 1.1-24; Ps. 148.5
³³ Ps. 44(45).2; 118(119).131
³⁴ Ps. 44(45).2,10
³⁵ I Mbret. [Sam.] 16.23
³⁶ Ps. 44(45).11
³⁷ I Petr. 1.8
³⁸ Mark. 1.40
³⁹ I Petr. 5.4
⁴⁰ Gjen. 49.10
⁴¹ Gal. 4.4
⁴² II Kron. 18.18; Dan. 7.10
^{42a} IV[II] Mbret. 19.15; II Kron. 18.18.
 Is. 6.1; Jez. 1.13-26; 10.1;
 Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 32
⁴³ Is. 19.1
⁴⁴ Is. 7.14
⁴⁵ Gjyq. 6.37-38; Ps. 71(72).6
⁴⁶ Rom. 9.5
⁴⁷ Fja. Urt. 1.6
⁴⁸ Eks. 33.20
⁴⁹ II Mbret. [Sam.] 7.12; III [I] Mbret. 8.25;
 II Kron. 6.16; Ps. 131(132).11; Vep. 2.30
⁵⁰ Ps. 46(47).5
⁵¹ Matth. 12.40
⁵² Ps. 67(68).13
⁵³ Jona 2.7
⁵⁴ Ps. 15(16).11; Sirak 4.12; Is. 29.19;
 Vep. 2.28
⁵⁵ Matth. 6.12
⁵⁶ Gjen. 12.3; 22.18; 28.14; Ps. 71(72).17;
 Sirak 44.21
⁵⁷ Est. 4.17b; Ps. 94(95).4; Jov 9.19
⁵⁸ Rom. 1.25
⁵⁹ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2
⁶⁰ Joan 1.4,9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46
⁶¹ Eks. 25.30-37; 35.16; 38.13; 40.22;
 Num. 4.9; 8.2; Hebr. 9.2
⁶² Ps. 2.6 etj; II Petr. 1.18
⁶³ I Kor. 3.16; 6.19; II Kor. 6.16
⁶⁴ Ps. 18(19).6
⁶⁵ Eks. 25.9-20; 38.1; Ligji i Dytë 10.2;
 Ps. 131(132).8; Hebr. 9.4
⁶⁶ Varuk 3.38
⁶⁷ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
⁶⁸ Lluk. 2.10
⁶⁹ Ps. 68(69).35; 148.4
⁷⁰ II Mbret. [Sam.] 6.6
⁷¹ Ps. 131(132).8
⁷² Abak. 3.3; Dan. 2.34-35
⁷³ Eks. 25.8 etj. Ps. 45(46).5; Hebr. 9.2
⁷⁴ Eks. 25.29; 39.18; 40.20; Lev. 24.6;
 Hebr. 9.4
⁷⁵ Joan 1.3
⁷⁶ Ps. 109(110).3
⁷⁷ II Kor. 8.9
⁷⁸ Luk. 1.78
⁷⁹ Ps. 95(96).11; Is. 44.23; 49.13



MË 26 TË TË NJËJTIT MUAJ

Mbledhja e Kryeengjëllit Gabriel.

*Tipikon**Shiko Tipikonin e së djeshmes.*

NË MBRËMËSORE

*Thirrto**Tri të së kremtes (Duke të zbuluar ty, fq. 82) dhe tri të Kryeengjëllit:**Ting. I Panëfimi märtires*

Me pamje të ndritshme, engjëll shenjt,* Gabrieli qiellor,* pra Mendja shumë e madhe, duke parë dritësim* diellor të trefisht'* me rreshtimet qiellore erdhi tek e Virgjra edhe ungjillëzoi një mister* fort të frikshëm dhe hyjnor, të shenjt',* dhe për shpirtrat tanë ndërmjeton gjithnjë.

Misteri i madh, që ish më par'* i panjohur dhe mistik* përpara jetëve¹ dhe madje prej engjëjve, te ti* vetëm u besua,* dhe guxove, Gabriel, t'ia thuash së dëlirës së vetme kur në Nazaret erdhe,* lyp me të që t'u dhurohet hir,* përdëllim i madh^{1a} dhe paqe shpirtrave.

Me dritë i mbushur plot gjithnjë,*

bën vullnetin, urdhrat pra* të Perëndisë të Plotpushtetshëm, o shën Gabriel,* engjëll kryesues* me lavd, sa me mall po të nderojn', shpëtoji duke kërkuar pa pushim për shpirtrat tan',* t'u dhurohet përdëllim i madh,*^{1a} ndjesë, paqe si dhe hir prej Zotit tënd.

Lavdi *dhe* Tani*Ting. Tërth. II I Joan Monakut*

U dërgua prej qiellit kryeengjëll Gabrieli, që t'i ungjillëzonte Virgjëreshës zënien; dhe, kur erdhi në Nazaret, mendohej me vete duke u çuditur për mrekullinë, se si i pakonceptueshmi në më të lartat lind nga një e virgjër! Ai që ka qiellin si fron dhe nënkëmbëz dheun,² zihet në mitrën e një gruaje! Ai që nuk munden dot ta vështrojnë engjëjt me gjashtë krahë³ si dhe ata me shumë sy,⁴ deshi nga mirësia të mishërohet prej saj vetëm me anën e një fjale.⁵ Kjo është Fjala e Perëndisë.⁶ Përse, pra, rri dhe nuk i them Vajzës: Gëzohu, o Hirplote, Zoti është me ty; gëzohu, o virgjëreshë e kulluar; gëzohu, o nuse e panusëruar; gëzohu, o nënë e jetës,⁷ i bekuar është fryti i barkut tënd.

Hyrje. O dritë gazmore dhe Leximet.

Këndimi i Eksodit

(3.1-9)

Erdhi Moisiu në malin Horiv. Iu shfaq atij një engjëll Zoti në flakë zjarri nga ferra, dhe sheh se ferra digjet me zjarr, dhe ferra nuk shkrumbohej. Dhe tha Moisiu: “Duke kaluar, do të shikoj këtë vegim të madh, sepse nuk shkrumbohet ferra”. Dhe sapo pa Zoti se afrohet që të shikojë, i thirri Zoti nga ferra duke thënë: “Moisi, Moisi!” Dhe ai tha: “Ç’është?” Dhe ai tha: “Mos u afro këtu; zgjidhe sandalen nga këmbët e tua, sepse vendi në të cilin ti qëndron është tokë e shenjtë”. Dhe tha: “Unë jam Perëndia i atit tënd, Perëndi i Abrahamit dhe Perëndi i Isakut dhe Perëndi i Jakovit”. Dhe ktheu Moisiu fytyrën e tij anës, sepse druhej të vëzhgonte para Perëndisë. Dhe tha Zoti drejt Moisiut: “Duke parë pashë mundimin e popullit tim që është në Egjipt, dhe dëgjova klithmën e tyre nga shtypësit e punës, sepse e pashë vuajtjen e tyre, dhe zbrita që t’i çliroj ata nga dora e egjiptianëve, dhe që t’i nxjerr nga ajo tokë, dhe që t’i fut në tokë të mirë dhe të shumtë, në tokë që rrjedh qumësht dhe mjaltë”.

Këndimi i Fjalëve të Urta

(8.22-30)

Zoti më ndërtoi si fillimin e udhëve të tij në punët e tij. Para jete më the-

melei, në fillim para se të bënte tokën, dhe para se të bënte avushat, para se të dalin burimet e ujërave. Para se të mbështeten male dhe para gjithë kodrave më lind. Zot bëri vende dhe të pabanuara, dhe skajet e tokës që banohen nën qiell. Kur përgatiste qiellin, isha bashkë me të, edhe kur e caktonte fronin e tij mbi erëra, kur të fuqishme i bënte retë e sipërme, dhe kur i vendoste si të sigurta burimet e tokës nën qiell, dhe kur të forta i bënte themelet e tokës, isha pranë tij duke rregulluar. Unë *urtësia* isha ajo për të cilën ngazëllohej, dhe përditë dëfrehesha në faqen e tij në çdo kohë.

Pasvargje

Ting. Tërth. IV O tu paradhoksu thávmatos

Pasi fluturoi, poshtë zbret arkond fuqish që nga lart,*⁸ Gabrieli e përshëndet* Virgjëreshën e i thot’:* O karrocë e pastër krejt* e Perëndisë, gëzohu; Zoti yt* përpara jete të zgjodhi për banim;*⁹ jam shërbëtor, të shpall* ty prani të Zotit tënd, ndaj jam këtu;* Zotin do ta lindësh dhe do mbetesh pa prishje.

Varg: Ungjillëzoheni nga dita në ditë shpëtimin e Perëndisë tonë.

Me habi i tha modestja Gabrielit: Pamja që ke,* përse është e zjarrtë

flak’? *¹⁰ Ç’gradë ke, si dhe ç’fuqi* kanë fjalët? Po lajmëron* bërjen fëmijë, por nuk kam burrë hiç,* ndaj qëndro larg, o njeri, mos më mashtro* si gjarpri tinëzar* më përpara Evën,¹¹ pra stërnënën ton’,* që na solli dëshpërim, dënim të gjithëve.

Varg: Këndojini Zotit një këngë të re.

Zonjë hyjpranuese dhe e kulluar, po vjen mbi ty* Perëndi, Shpirt i Tërëshenjt’,* do të hijeshohesh ti* prej fuqis’ së të Lartit Zot* dhe do të lindësh bir që do ruajë* krejt virgjërinë të palëkundur pra;* djalë pa mot ësh-të* dhe pa gjenealogji,¹⁰ do shfaqet ky* të shpëtojë popullin,*⁵ kështu i miri do.

Lavdi *dhe* Tani

Ting. IV

Në muajin e gjashtë, u dërgua krye-engjëlli drejt një Virgjëreshe të dëlirë dhe, sapo i tha “Gëzohu”, ungjillëzoi se do të dilte prej saj Çlirimtari; pra ndaj, pasi pranoi përshëndetjen, të zuri ty, Perëndinë e parajetshëm, që deshe me mirësi të pashprehur të njerizoheshe për shpëtimin e shpirtave tanë.

Përlëshore

Ting. IV O ipsothís en to stavró

O gjeneral i çdo ushtrie në qiell,*⁸

gjithnjë të lutim ty* tër’ ne të padenjët:* Na ngri një mur rrethues përmes lutjesh që bën;* mbrona nën strehën e krahëve* të lavdis’ sate që s’ka lënd’,* ruajna; të falemi* dhe thërresim me besë:* Nga çdo rrezik çlirona ne pra ti,* si taksiark i Fuqive të sipërme.



NË MËNGJESORE

*Kanuni i Kryeengjëllit,
që ka Akrostihidhë: “Do ta himnoj
Gabrielin si të tërëmadh. Josif”.*

Ting. IV

Ode I

Anikso to stoma mu

Meqë je ti dritë jolëndore dhe e hyjnueshme* përmes pjesëmarrjes pa lënd’ me ndriçimin kulmor,* shndritma mendjen pra,* të lyp, o kryeengjëll,* që unë të të himnoj, o lajmëtar i madh.

Kërcime të hyjshme le të nisim me ngazëllime sot;* ta mburrim të parin e atyre që s’kanë trup,* krye Mendjesh është’;* ky lajmëroi gazin* që s’shprehet dhe zbriti mbi dhë mirësisht për ne.

Të kemi ty mbrojtës kaq të madh, përkrahës te Zoti yn’,* mbështetje

dhe mur ne që për ty mall kemi, besim,* o shën Gabriel,* shpëtona nga rreziqet,* nga dëmi i gjarprit, ne që të himnojmë ty.

Hyjlindësore

Të pa Gabrieli të dëlirë, të paqortueshme* në çdo gjë, të thirri ty sakaq shkëlqyer, o Zonj',* që nuk njohe burr',* "Gëzohu", je shpëtimi* i njerëzve, mburrja dhe lavdi i engjëjve.

Zbritësore: Anikso to stoma mu (shih një ditë më parë, fq. 88)

Ja gojën e çel tani

Ode III

Tus sus immologus

Kungove me dritë të palëndët, kështu ti vërtet pa lëndë je,* o Gabriel, shkëlqen pa lëndë, ndaj u duke drit' e dyt'* dhe shndrit përherë njerëzit që kanë lëndë dhe të himnojn'.

Meqë na zbulove, o i madhi ndër engjëjt, misterin¹ kaq të madh,* përmes të cilit ne nga dheu jemi ngritur tepër lart,* për lavdin madhështor u denjësove; fort të himnojmë ty.

Prej qiellit shfaqu mbi të gjithë, që çdo herë të kërkojm' me mall* dhe na pusho furtunën e shtrëngimeve

dhe ngasjeve,* që kundër nesh lëviz, o kryegjeneral, Gabriel me nam.

Hyjlindësore

O Vajzë, e dinte Gabrieli misterin qëmoti fort sekret,*¹ ndaj të thërriste atëher': Gëzohu, o pallat Zoti;* në të kur të banojë, do shpëtojë gjindjen me mirësi.

Zbritësore: Tus sus immologus

O Zonjë dhe nën'

Ndenjësove

Ting. I Ton tafon su Sotir

I madhi Gabriel,* që gjithnjë shfaqet kreu* i engjëjve, me ta i thërret këng' hyjnore* me gaz Trinisë;¹⁴ me besim që të gjithë me zë të madh* ta himnojmë pra* dhe me një mendje të pastër* ta lëvdojm' atë* në një mënyrë të vyer,* me shpirt dhe me ngazëllim.

Tjetër

Ting. IV O ipsothis en to stavro

Si komandant engjëjsh,* shërbyes të patrups,* misteri që është* vërtet mjaft i frikshëm,* që u caktua para jete,¹ o Gabriel,* të ishte besuar, lindje pra* që s'rrefehet, e Zonjës son';* ndaj kur përshëndetje ti* të dëlirën e virgjër,* "Gëzohu, o Hirplote" the; kë-

shtu* të lumërojnë* besnikët gjithnjë me gaz.

Ode IV

Tin aneksihnlaston

Qëndroje qëmoti, o Gabriel i admirueshëm, dhe e kënaqje me kungime hyjnore profetin Daniel, dhe i futje në Shpirt sqarimin e të panjohurave.¹⁵

Të përhimnojmë gëzueshëm me gjuhë balte ty, që je i zjarrtë nga natyra,¹⁰ me ndërmjetimet e tua të hyjshme, o Gabriel, çlirona nga zjarri që përgjithmonë flakëron.¹⁶

I veshur me stolinë hyjnore, që vezullon më shumë se dielli përmes lavdisë së parrëfyeshme, o gjeneral i shërbyesve,⁸ qëndron duke u ngazëlluar pranë Mbretit qiellor.¹⁷

Hyjlindësore

O e tërëpaqortueshme, meqenëse Gabrieli të kuptoi të pastruar të tërë falë Shpirtit, të thërret dukshëm: Gëzohu, o çlirimi i mallkimit¹⁸ dhe rithirrja e paraetërve.

Zbritësore: O kathimenos en dhoksi

Ti që rri midis lavdisë

Ode V

Eksesti ta sîmpanta

Duke feksur përmes kungimit me Mendjen e parë, u duke dritë e dytë, duke thirrur bashkë me rendet pa numërim të engjëjve:¹⁷ Shenjt Perëndi¹⁴ tërëkrijues, Bir i bashkëpafillim dhe Shpirt i bashkëfronshëm.

Pamja jote është e zjarrtë,¹⁰ bukuria, tepër e mahnitshme, që habit çdo mendje; lavdia e madhe, o Gabriel shumë i lartë, kryetar hyjnorësh të patrups, hijeshia e të gjithëve që të përhimnojnë besërisht.

Zaharia i hyjnueshëm, kur në kohën e temjanisjes të pa qëmoti që i qëndroje pranë, mbeti i shurdhër, sepse nuk i besoi lajmërimit tënd të frikshëm që the, o Gabriel¹⁹ kryegjeneral.⁸

Hyjlindësore

Meqë ishe tempull shenjtërimi, o e Tërëpaqortueshme, me anën e zërit të kryeengjellit Gabriel, linde Perëndinë e Tërëshenjtë, që prehet ndër shenjtore,²⁰ që i shenjtëron të gjithë²¹ dhe i nxjerr nga peripecitë.

Zbritësore: Eksesti ta sîmpanta

Të gjith' i habite ti

Ode VI

Tin thian taftin

S'ka forcë gjuhë e dheshme të të mburrë ty, o Mendje q'ellore, që po rrezaton ndriçim,* i llamburituri me shkëlqim* mbi mendje dhe mbi fjalë, nga drita e Hyjnis'.

O rreze fort e shkëlqyer, shndritje dielli edhe gjeneral shërbyesish⁸ si zjarr,¹⁰ rrëmbe* sa të himnojnë, nga veset terr* me ndërmjetimin tënd dritëprurës drejt Zotit.

Shpërndaji planet e kombeve²² dhe besën orthodhokse forcoje, skizmat na pusho në Kish',* o kryeengjell, me lutjet pra,* që bën drejt Krijimtarit të gjithë gjërave.

Hyjlindësore

Iu binde fjalës hyjnore që të tha ty Gabrieli, me mish pra linde Fjalën Zot që ish* para fillimit; dhe ky e nxjerr* nga marrëzia botën e palogjikshme krejt.

Zbritësore: Tin thian taftin

Këtë të kremte

*Nëse bie e shtunë ose e diel, thuaj
Kontaqin e së kremtes.*

Kontaqi

Ting. II Arhistrátije Theú

Gjeneral i Perëndis'* dhe shërbyes i

lavdit,* udhëzues njerëzor* dhe kryetar engjëjsh pa trup,* përdëllim të madh për ne kërko,* përfitim për shpirtin ton',* se je gjeneral i të pa-trupëve.⁸

Sinaksari

Më 26 të të njëjtit muaj, bëjmë Mbledhjen e kryeengjellit Gabriel, e cila u dha që nga fillimi dhe nga lart, sepse ai i shërbeu misterit hyjnor, përmbimendor dhe të parrëfyeshëm.

Vargje: Çdo mish nderon me nderim të përshtatshëm,/ o Fjalë, Mendjen që lëçiti mishërimin tënd.

Në të njëzet e gjashtë, Gabrieli grumbullon Krijesën për hir të himneve.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i 26 dëshmorëve, që u martirizuan në Goti, nga të cilët dy janë presviterë, Vathusi dhe Uirki me dy bij të tij dhe tri bija, dhe Arpili murg; ndërsa laikë janë Avipi, Agnasi, Riaksi, Igathraksi, Iskoï, Sila, Sijixi, Suirili, Seimvli, Thermi, Filji; dhe nga gratë, Ana, Alasa, Varisa, Moiko, Mamika, Uirko dhe Animaisa.

Vargje: Flakërojnë me zjarr po kaq shumicë martirësh,/ aq sa ditë ka sot muaji.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirëve të shenjtë Kodhrati, Theodhosi, Emanueli dhe 40 të tjerë në Lindje.

Vargje: O Kodhrat i lumur, të admiroj

për guximin!/ Si theresh i shtrirë burrërisht në kurriz!

Theodhosi që jetonte vetëm për Perëndinë,²³/ shkatërron për atë jetën me shpatë.

Emanueli thotë: Le të më derdhet me shpatë gjaku;/ për mua ai vlen vetëm sa një gotë.

Dyzet martirë përmes shpatës/ iu blatuan Perëndisë. Oh, ç'burrëri!

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Stefan Omologjeti, igumen i Triglisë.

Vargje: Stefani, punëtor i vreshtit hyjnor,/ pasi qëndroi para Perëndisë, le të marrë pagën e lodhjes.²⁴

Në të njëjtën ditë, lexohet një rrëfë një e dobishme e Malhit, murg që u robërua.

Vargje: Shih, o murg, ç'shpagim të keq merr/ çdo mosbindës, dhe korrigjohu.

Me ndërmjetimet e shenjtorëve të tu, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII

Uk elátrefsan

O i lavdishëm, dikur i lajmërove lindjen e Joanit Zaharisë, që rrinte brenda Tempullit të hyjshëm¹⁹ dhe i psalte Çlirimtarit dhe Perëndisë: O i përmbihimnuar, Zoti i etërve dhe Perëndi, je i bekuar.²⁵

Hijeshia e lavdishme e shtëpisë sate, shenjtëron shkëlqyeshëm shpirtra besimtarësh, o Gabriel, dhe nxit që të thërrasin me zë të madh: O i përmbihimnuar, Zoti i etërve dhe Perëndi, je i bekuar.²⁵

Duke feksur përmes pjesëmarrjes nga drita e parë mistikisht, o kryegjeneral,⁸ u duke si dritë e dytë me të vërtetë, që shkëlqen gjithmonë ata që këndojnë: O i përmbihimnuar, Zoti i etërve dhe Perëndi, je i bekuar.²⁵

Hyjlindësore

U dërgua Gabriel kryegjenerali, për të të lajmëruar hare, o Virgjërnënë e kulluar; me anën e saj ndaloi trishtimi, u sterilizua me të vërtetë nëma¹⁸ dhe lulëzoi bekimi te besëmirët përjetë.

Zbritësore: Uk elátrefsan

Nuk u faleshin

Ode VIII

Pedhas evajís en ti kamino

Të himnon i ngazëlluar me shërbesa të hyjshme një popull i hyjshëm, sepse, o kryegjeneral, përmbi mendje dhe fjalë i njofton me zë Virgjëreshës që është nga ne, Fjalën, shkakun për të gjitha, që mishërohet me veçorinë

tonë; prandaj të nderojmë në gjithë jetët.

O kryeengjëll, duke u bashkuar pa lëndë me Mendjen e madhe dhe të parë, me gojën tënde të zjarrtë këndon melodinë e frikshme, që këndojnë të gjitha koret e engjëjve:¹⁴ Zotin himnojeni, o vepra, dhe përmbilartësojeni në gjithë jetët.²⁶

I stolitur qartësisht me nderime hyjnore, lëviz nëpër qiellore dhe pastaj nëpër tokësore, duke përmbushur si i palëndët vullnetet hyjnore²⁷ të Krishtit, Perëndi i të gjithave, o Gabriel, kryetar engjëjsh, lavdia e atyre që të mburrin përherë në besë.

Fjala, duke dashur të komunikojë me mish me njerëzit sipas hipostazës, të dërgoi ty të vrapoje më parë dhe të përgatitje pallatin e hyjshëm, o Gabriel i hyjshëm, dhe të thërrisje: Zotin himnojeni dhe përmbilartësojeni në gjithë jetët.²⁶

Hyjlindësore

Le ta himnojmë Virgjëreshën e bekuar, si fronin e hijshëm të Mbretit,²⁸ si më të lartën se gjithë krijesat, me që i dha substancë të përmbisubstancshmit, i cili hyjnizoi vdekatarët përmes bashkimit më të mirë, dhe me lindje të parrëfyeshme dhe të huaj.

Zbritësore: Pedhas evajís en ti kamino

Djemat e dënuar

*Ode IX
Apas jijenís*

Rri me frikë pranë fronit të Hirit¹⁷ dhe shërben,²⁷ edhe shkëlqen* fort me derdhje drite pra,* që janë mbi mendim, edhe dukesh drit',* dhe hyjnizohesh perëndishëm, llamburit kësh-tu* sa me besë* të nderojnë, Gabriel,* gjeneral i hyjnueshëm dhe i madh.⁸

Dukesh qiell plot me yje prej dritës dhe shkëlqimit të Hyjnis'* teksa mban si gjeneral*⁸ në duar skeptër fort të shkëlqyeshëm,* dhe rend në mbarë tokën duke bërë përgjithnjë* çdo dëshirë* që ka Zoti,²⁷ dhe çliron* besëmirët nga sulme, peripeci.

Na freno furtunën, frikën që ngrihet prej barbarëve gjithnjë* kundër shërbëtorëve* të tu, pushoji skizmat e Kishës son';* himnuesve të tu dhuroju ndjesë fajesh, hir;* fali mbretit,* o shën Gabriel, trofe* nëpërmjet mbrojtjes sate të nxehtë zjarr.

O çift i lavdishëm edhe i bukur, Mihael dhe Gabriel,* pranë fronit të lavdis'* hyjnore rrini,¹⁷ pra, për të gjithë ne* kërkon ndjesë fajesh dhe çlirim nga çdo mundim,* jeni mbrojtës* si dhe

në të gjitha ju* mirësinë pasoni të Zotit Krisht.

Hyjlindësore

O Hyjnënë, vezullimi i lindjes sate feksi me ndriçim,* hijeshoi kozmosin* e tërë, shkatërroi dhe mbrojtësin* e errësirës,²⁹ e gjithëkulluar, krenari* engjëjsh pa trup* dhe shpëtim për çdo njeri,* që me zë pa pushim ty të lartëson.

Zbritësore: Apas jijenís

Gjithë njerëzit

*Nëse bie të shtunën ose të dielën,
thuaj Dërgimësoren e së kremtes,
dhe në Lavdërimet, troparet nga
e kremtja.*

CITIME

¹ Kol. 1.26

^{1a} Num. 14.19 etj.

² Is. 66.1; Vep. 7.49

³ Is. 6.2

⁴ Jez. 1.6

⁵ Lluk. 1.31

⁶ Joan 1.1

⁷ Gjen. 3.20

⁸ Jis. N. 5.14-15

⁹ Ps. 131(132).13-14

¹⁰ Ps. 103(104).4; Hebr. 1.7

¹¹ Gjen. 3.1-6

¹² Hebr. 7.3

¹³ Matth. 1.21; Joan 12.47

¹⁴ Is. 6.3

¹⁵ Dan. 8.16-26; 9.21-27

¹⁶ Mark. 9.44,46,48

¹⁷ II Kron. 18.18; Dan. 7.10; Lluk. 1.19

¹⁸ Gjen. 3.16-19

¹⁹ Lluk. 1.5-23

²⁰ Is. 57.15

²¹ Hebr. 2.11

²² Ps. 32(33).10

²³ Gal. 2.20

²⁴ Matth. 20.1-9

²⁵ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2

²⁶ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34

²⁷ Hebr. 1.14

²⁸ IV[II] Mbret. 19.15; II Kron. 18.18;

Is. 6.1; Jez. 1.13-26; 10.1; Dan. kap. 3
Lutja e Azarias 32

²⁹ Lluk. 22.53; Ef. 6.12





MË 23 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i martirit të madh, të shenjtë e të lavdëruar Gjergj Trofeprurësi.

Tipikon

1. Nëse bie brenda Kreshmëve të Mëdha:

Shërbesa e tij psalet të Hënën e Ndrishme (shih § 2).

2. Nëse bie të Hënën e Ndrishme:

Të dielën e Pashkës në Mbrëmësore. Thirrtoret: 4 ngjallësore (të Tingullit II) dhe 4 të shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit [II]. Hyrje me Ungjillin. O dritë gazmore. Proqimeni i Madh dhe menjëherë Ungjilli. Le të themi të gjithë etj. Pasvargjet: ngjallësore e para, dhe të Pashkës (Le të ngrihet Perëndia; Pashka hierore etj.). Lavdi i shenjtit. Tani Dit' e ngjalljes, Krishti u ngjall (3x). Lavdi Përlëshorja e shenjtit, Tani Hyjlindësore ngjallësore (Misteri i fshehur). Përlëshim dialogjikisht.

Të hënën, në Shërbesën e Mesnatës, shërbesa paskale dhe në vazhdim Litia e shenjtit. Lavdi i shenjtit. Hyjlindësore ngjallësore e të njëjtit Tingull (O çudi e re mbi gjithë çuditë qëmoti, se cili njohu ndër ne të ketë lindur pa burr' dhe të mbajë në pëqi atë që përmban tërë krijesën; është' vullnet Perëndie ai që lindi, të cilit, o e gjith' pastër,

meqë e mbajte në krahët e tu si foshnjë dhe meqë ke guxim përpara tij si nënë, mos pusho së luturi për ata që të nderojnë që të na mëshirojë dhe të shpëtojë shpirtrat tanë*). Krishti u ngjall (3x) dhe Përlëshim. Në Mëngjesore, pas Krishti u ngjall (10x), Përlëshorja e shenjtit dhe Hyjlindësore ngjallësore (Misteri i fshehur). Pas Paqësoreve, Shkallesat. Antifoni i parë Ting. IV. Proqimeni dhe Ungjilli i shenjtit. *Menjëherë* Ne që pamë ngjalljen (Nuk thuhet Psalmi 50), Lavdi Me ndërmjetimet e athloforit. Tani Me ndërmjetimet e Hyjlindësës. Përdëllemë, o Perëndi dhe Idhiomeli i shenjtit. O Perëndi, shpëto popullin tënd etj. Kanunet: i Pashkës dhe i pari i shenjtit. Në fund të çdo Ode, Zbritësorja e Pashkës, Krishti u ngjall (3x), Kur u ngrit Jisui, dhe Përsëri dhe përsëri etj. Pas Odes III, Ipakoia. Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtit dhe Ndenjësoret e tij, Tani e ngjashme: Gjithë kombet, ju ejani për himnim,* ta nderojmë ne nënën e Zotit Krisht,* t'i themi: Gëzohu ti,* fron me formë të zjarrtë je* për tërëmbretin Zot të gjithçkaje Jisun', ki gaz,* se je e vetmja Zonjë e botës, gëzohu pra,* o e pacenuar, enë që njollë nuk ke,* e ndritshme e Shën Trinis',* Atit, Birit dhe Shenjtit Shpirt,* o e virgjër* gjithnjë, Mariam* nuse e himnuar, e thjesht',* e zbukuruar si diell,* ki, Vajzë, gaz,* je hare për himnuesit e tu, ki gëzim. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Pashkës dhe Sinaksari i ditës. Ne që pamë ngjalljen (3x). Kur u ngrit (3x). Në vend të Më të nderuarën, Ode IX e Pashkës dhe e shenjtit (në Lavdi si dhe Tani me Madhështimet e Pashkës). Dërgimësoret: e Pashkës, e shenjtit dhe përsëri e Pashkës. Lavdërimet: 4 ngjallësore, 4 të shenjtit dhe 4 të Pashkës (Le të ngrihet Perëndia; Pashka hierore etj.). Lavdi i shenjtit. Tani Dit' e ngjalljes. Krishti u ngjall (3x) dhe Përlëshorja e shenjtit.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Krishti u ngjall, Ipakoia dhe Përlëshorja e shenjtit. Kontaqi i Pashkës. Sa u pagëzuat. Apostulli i shenjtit dhe Ungjilli i ditës. Në vend të Të meriton, Një engjëll i thërriste; Ndriçohu, ndriçohu. Kungatore e Pashkës [dhe Në kujtim të përjetshëm]. Krishti u ngjall. Përlëshim dialogjikisht.

3. Nëse bie të Martën ose të Mërkurën, ose të Enjten, ose të Shtunën e Nditshme:

Shërbesa e shenjtit kryhet si të Hënën e Nditshme, por, natyrisht, ndryshojnë Tingujt, Proqimenet e Mbrëmësore, Sinaksarët dhe në Liturgji Ungjilli i ditës. Gjithashtu në Mbrëmësore, nuk lexohet Ungjilli i së hënës, por lexohen Leximet e shenjtit.

4. Nëse bie të Premten e Ndritshme (Burimi Jetëdhënës*):

Të enjten në Mbrëmësore. Thirrtoret: 3 ngjallësore, 3 të Burimit dhe 4 të shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani [Lavdi] i Burimit. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni [i Madh] i Burimit. Leximet e shenjtit. Pasvargjet: ngjallësore e para dhe 3 të Burimit. Lavdi i shenjtit. Tani Dit' e ngjalljes. Krishti u ngjall (3x), Përlëshoret: Lavdi i shenjtit, Tani i Burimit, Ting. I: Kisha jote, o Hyjlindëse, u tregua Parajsë, duke buruar shërime si lumenj gjithmonë të gjallë; duke ardhur pranë saj besërisht, nxjerrim si nga burimi jetëpranues shëndoshje dhe jetë të përvetshme, sepse te Shpëtimtari Krisht që lindi prej teje, ti ndërmjeton që të shpëtohen shpirtrat tanë. Përlëshim dialogjikisht.

Të premten, në Shërbesën e Mesnatës. shërbesa paskale dhe në vazhdim, Litia e shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani i Burimit (kërkoje në Pentikostar, në Lavdinë e Pasvargjeve të Mbrëmësore të së enjtes). Në Mëngjesore. pas Krishti u ngjall (10x), Përlëshorja e shenjtit dhe e Burimit (shih më sipër). Pas Paqësoreve, Shkallesat. Antifoni i parë Ting. IV. Proqimeni dhe Ungjilli i shenjtit. Menjëherë Ne që pamë ngjalljen (3x) (Nuk thuhet Psalmi 50), Lavdi Me ndërmjetimet e athloforit. Tani Me ndërmjetimet e Hyjlindëses. Përdëllemë, o Perëndi dhe Idhiomeli i shenjtit. O Perëndi, shpëto popullin tënd etj. Kanunet: i Pashkës, i Burimit dhe i pari i shenjtit. Në fundin e çdo Ode, Zbritësorja e Pashkës, Krishti u ngjall (3x), Kur u ngrit Jisui, dhe Përsëri dhe përsëri etj. Pas Odes III, Ipakoia. Kontaqi i Pashkës, i shenjtit dhe Shtëpia e shenjtit. Ndenjësoret: të dyja të shenjtit dhe e Burimit. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Burimit dhe Sinaksari i ditës dhe i Burimit. Ne që pamë ngjalljen (3x). Kur u ngrit Jisui (3x). Në vend të Të meriton, Ode IX e Pashkës (me Madhështimet e saj), e Burimit dhe e shenjtit (me Vargjet e tyre, por Lavdi si dhe Tani me Madhështimet e Pashkës). Dërgimësoret: e Pashkës, e shenjtit, e Burimit. Lavdërimet: 2 ngjallësore, 3 të Burimit, 3 të shenjtit dhe 4 të Pashkës (Le të ngrihet Perëndia; Pashka hierore etj.). Lavdi i shenjtit. Tani Dit' e ngjalljes. Krishti u ngjall (3x). Përlëshoret: e shenjtit dhe e Burimit (Shih më sipër).

Në Liturgji. Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Krishti u ngjall, Ipakoia dhe Përlëshorja e Burimit dhe e shenjtit. Kontaqi: i Burimit dhe i Pashkës.

* Shënim: Përkthimi i saktë është "Jetëpritës", d.m.th. Perëndilindësja pranoi Jetën, Krishtin (Joan 11.25). Por e lamë si më sipër, për shkak të ngulitjes.

Sa u pagëzuat. *Apostulli i shenjtit, Ungjilli i ditës. Në vend të Të meriton, Një engjëll i thërriste; Ndriçohu, ndriçohu. Kungatore e Pashkës [dhe Në kujtim të përjetshëm]. Krishti u ngjall. Përlëshim dialogjikisht.*

5. Nëse bie të Dielën e Thomait:

Të shtunën në Mbrëmësore, pas Krishti u ngjall (3x), Psalmi Nistor (pa Ejani t'i falemi, si zakonisht deri në Mbylljen e Pashkës). Psaltiri (si zakonisht). Thirrtoret: 6 të Thomait dhe 4 të shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani i Thomait. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e shenjtit. Pasvargjet e Thomait. Lavdi i shenjtit. Tani i Thomait. Përlëshoret: e Thomait, e shenjtit dhe përsëri e Thomait.

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanuni Triadik. Litia: e Thomait dhe e shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani i Thomait. Himne Triadike. Trishenjtë. Përlëshorja e Thomait. Në Mëngjesore. Ndenjësoret: e shenjtit dhe, në vend të Hyjlindësoreve, të Thomait. Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV. Proqimeni i Thomait dhe menjëherë, Kanunet: i Thomait (me Varg: Lavdi ngjalljes sate) dhe i pari i shenjtit (me Varg si zakonisht: O shenjt i Perëndisë, ndërmjeto për ne). Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtit dhe Ndenjësoret e tij dhe një (nga Pas-kremtoret) e Thomait. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Thomait. Sinaksari i ditës dhe i Thomait. Zbritësoret e Pashkës; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor (I). Në vend të Më të nderuarën, Ode IX e Thomait dhe e shenjtit. I shenjtë është Zoti, Perëndia ynë (2x), Lartësoni Zotin. Dërgimësoret: e para e Thomait, e shenjtit dhe e dyta e Thomait. Lavdërimet: 3 të Thomait dhe 3 të shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani i Thomait. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e Thomait.

Në Liturgji. Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e Thomait dhe e shenjtit. Kontaqi i Pashkës. Apostulli i shenjtit dhe Ungjilli i Thomait. Në vend të Të meriton, Irmosi i Odes IX i Thomait (Ti llambadhen e shkëlqyer). Kungatore e Thomait [dhe Në kujtim të përjetshëm]. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.

6. Nëse bie të hënën e Thomait:

Të dielën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 2 të Thomait (dy të parat e Lavdërimeve të tij që u psalën në Mëngjesore, Ting. I) dhe 6 të shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani i Pentikostarit. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i Madh i Pentikostarit. Leximet e shenjtit. Pasvargjet e shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani i Thomait (Idhiomeli i parë

i Pasvargjeve të Mbrëmësore së tij të djeshme, Ting. IV). Përlëshoret: e Thomait, e shenjtit dhe përsëri e Thomait.

Të hënën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Litia e shenjtit, por Tani i Litisë së Thomait. Trishenjtë. Përlëshorja e shenjtit. Në Mëngjesore, Ndenjësoret e shenjtit dhe në vend të Hyjlindësoreve, Ndenjësoret e Thomait. Pas Polieleit, Ndenjësoret e shenjtit. Shkallesat. Antifoni i Parë i Ting. IV dhe Proqimeni i shenjtit. Ungjilli i shenjtit. Ne që pamë ngjalljen. Psalmi 50 (hima) etj. të shenjtit. Kanunet: i Thomait dhe i pari i shenjtit. Pas Odes III, Ndenjësoret e shenjtit dhe një e Thomait. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtit dhe Sinaksari. Zbritësoret e Pashkës. Më të nderuarën. Dërgimësoret: e shenjtit dhe një e Thomait. Lavdërimet e shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani i Thomait. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e shenjtit.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e Thomait, e shenjtit dhe e kishës. Kontaqi i Thomait. Apostulli dhe Ungjilli i shenjtit. Të meriton. Kungatore: Në kujtim të përgjeshëm. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.

7. Nëse bie të martën ose të mërkurën, ose të enjten, ose të premten e Thomait:

Shërbesat bëhen si më lart (§6), por në Mbrëmësore thuhet Kathizma (e përshtatshme) e Psaltirit, si dhe në Thirrtores, vetëm 6 të shenjtit.

8. Nëse bie të shtunën (d.m.th. në Mbylljen) e Thomait:

Të premten në Mbrëmësore, Thirrtores: 3 të Thomait dhe 5 të shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani i Thomait. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e shenjtit. Pasvargjet: 3 të Thomait. Lavdi i shenjtit. Tani i Thomait. Përlëshoret: e Thomait, e shenjtit dhe përsëri e Thomait.

Të shtunën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Litia e shenjtit, por Tani i Litisë së Thomait. Trishenjtë. Përlëshorja e Thomait. Në Mëngjesore, Ndenjësoret e shenjtit dhe, në vend të Hyjlindësoreve, Ndenjësoret e Thomait. Shkallesat. Antifoni i Parë i Ting. IV dhe Proqimeni i shenjtit. Ungjilli i shenjtit. Ne që pamë ngjalljen. Psalmi 50 (hima) etj. të shenjtit. Kanunet: i Thomait dhe i pari i shenjtit. Pas Odes III, Kontaqi i Thomait, Ndenjësoret e shenjtit dhe një e Thomait. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtit dhe Sinaksari. Zbritësoret e Pashkës. Në vend të Më të nderuarën, Ode IX e Thomait dhe e shenjtit. Zbritësorja

e Pashkës. Dërgimësoret: e para e Thomait, e shenjtit dhe e dyta e Thomait. Lavdërimet: 2 të Pentikostarit (ngjallësore), 3 të Thomait dhe 3 të shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani i Thomait. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e Thomait.

Në Liturgji. Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e Thomait, e shenjtit dhe e kishës. Kontaqi i Thomait. Apostulli dhe Ungjilli i shenjtit. Në vend të Të meriton, Irmosi i Odes IX i Thomait (Ti llambadhen e shkëlqyer). Kungatorja e Thomait [dhe Në kujtim të përjetshëm]. Krishti u ngjall.

9. Nëse bie të Dielën e Miropurësëve:

Të shtunën në Mbrëmësore. Thirrtoret: 3 ngjallësore, 3 të Miropurësëve dhe 4 të shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit (II) të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e shenjtit. Pasvargjet: ngjallësore e para dhe të Pashkës (Le të ngrihet Perëndia; Pashka hierore etj.). [Nëse kisha mban emrin e shenjtit: ngjallësorja e parë dhe Pasvargjet e shenjtit]. Lavdi i shenjtit. Tani [Lavdi] i Miropurësëve. Përlëshoret: e Miropurësëve (Kur zbritë te vdekja; dhe Bujari Josif), Lavdi i shenjtit dhe Tani i Miropurësëve (Grave miropurësë).

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanuni Triadik, Litia e Miropurësëve dhe e shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani [Lavdi] i Miropurësëve. Himne Triadike. Trishenjtë. Përlëshorja Kur zbritë te vdekja. Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë, Ndenjësorja e parë e Stihologjisë së parë të Miropurësëve. Lavdi Ndenjësorja e parë e shenjtit (Të gjithë, ejani me të bardha). Tani Hyjlindësorja e Stihologjisë së parë të Miropurësëve (Të gjitha përmbi mendim). Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësorja e parë e Stihologjisë së dytë të Miropurësëve. Lavdi Ndenjësorja e dytë e shenjtit (Nga një mall që vlon). Tani, Ndenjësorja e dytë e Stihologjisë së dytë të Miropurësëve. Pas Polieleit, Ndenjësorja e shenjtit (Tërë pasurinë dhe te të vobektë) dhe Ndenjësorja e tretë e Stihologjisë së dytë të Miropurësëve. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimeni i Tingullit. Kanunet: i Pashkës dhe një i shenjtit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtit dhe Ndenjësoret: të shenjtit dhe të Miropurësëve. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Miropurësëve. Sinaksari i ditës dhe i Miropurësëve. Zbritësoret e Pashkës; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Në vend të Më të nderuarën, Ode IX e Kanuneve. Dërgimësoret: e Pashkës, e shenjtit dhe e Miropurësëve. Lavdërimet: 3 ngjallësore, 3 të shenjtit dhe të Pashkës (Le

të ngrihet Perëndia; Pashka hierore etj.). *Lavdi i shenjtit*. Tani Dit' e Ngjalljes. *Dhoksologjia e Madhe*. Sot erdhi.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e Miropurëseve (Kur zbritë te vdekja; Bujari Josif; Grave miropurëse), e shenjtit dhe e kishës. Kontaqi i Pashkës. Apostulli i shenjtit. Ungjilli i Miropurëseve. Në vend të Më të nderuarën, Irmosi i Odes IX i Pashkës. Kungatore e Pashkës [dhe Në kujtim të përjetshëm]. Krishti u ngjall.

10. Kur bie brenda javës së Miropurëseve (deri të premten):

Shërbesat bëhen sipas Mujorit. Përlëshoret: Bujari Josif; Kur zbritë te vdekja, e shenjtit dhe Grave miropurëse. Në Mëngjesore. Më të nderuarën. Në fund të Dhoksologjisë, Përlëshorja e shenjtit. Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: të Miropurëseve, e shenjtit dhe e kishës. Kontaqi i Pashkës. Apostulli dhe Ungjilli i shenjtit. Të meriton. Kungatore: Në kujtim të përjetshëm. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.



NË MBRËMËSOREN E VOGËL

Thirrto

Ting. I Ton uranion tagmaton

Arriti shkëlqyeshëm pranvera e së Vërtetës dhe rinovon Krijesën me anën e diturisë shpresëplotë të Krishtit jetëdhënës; prandaj, pasi u ndriçua qartazi në mendje, atleti i Zotit shkeli marrëzinë e armiqve.

U mobilizove, o i urtë, te Mbreti i jetëve¹ dhe, meqë rrëzove të gjitha rreshtimet e të paudhëve, o Gjergj i trillumur çudibërës, u dallove atlet i qëndrueshëm përmes Hirit që t'u dha

prej Perëndisë;² prandaj ndërmjeto që të shpëtojme.

U shpërndan rrjedha shërimesh atyre që rendin pranë teje, o Gjergj i trillumur; dhe je përkrahës shpirttrash dhe trupash për ata që me besë të nxehtë vijnë te streha jote, o martir i admirueshëm i Krishtit, bukuria e athloforëve.

Lavdi Ting. I

O Gjergj, ushtari³ i Mbretit të madh,⁴ gëzohu dhe dëfre, sepse u bëre i pëlqyer te Perëndia;⁵ meqë i shpërfille të gjitha, gjete jetën e amshuar⁶ në

qiej, sepse trupi yt dëbon nga njerëzit
çdo sëmundje; Krishtin, pra, që aspi-
rove, ai të lavdëron, o i lum.

Tani *I së kremtes*

Pasvargje

Ting. II I kos tu Efrathá

Të lumtë, o Gjergj i trillumur, për nga-
zëllimin përmbi mendje, për të cilin u
denjësove prej Krishtit Ndërtues, si
martir ngaherë i fuqishëm.

Varg: I drejti si palmë do të lulëzohet
dhe si kedër në Liban do të shumë-
fishohet.

Gëzohu, o gjeneral i madh i atletëve,
përikja dhe muri i të gjithë besnikëve,
o bukurmundësi Gjergj.

Varg: I çuditshëm është Perëndia në
shenjtoret e tij.

Çliroje nga vështirësitë që tani e
ngacmojnë shpirtin tim të përulur, si
mbrojtës i shkëlqyer, o Gjergj, martir
i Krishtit.

Lavdi

Ting. IV I Anatoliut

Të gjitha kombet duartrokisni; le të
brohorasim për Perëndinë,⁷ Shpëtim-
tarin tonë; sepse, pasi u lartësua në
dru dhe zbriti në varr, plaçkiti Hadhin
dhe bashkëngriti të vdekurit që i

thërrisnin: Aliluia, aliluia, aliluia për
Krishtin që u ngjall.

Tani *I së kremtes*

Përlëshore

Ting. IV

Si çlirimtar i robërve.

Dhe i së kremtes



NË MBRËMËSOREN E MADHE

Pas Qëndrimit të parë të Psaltirit
(Lum ai njeri)

Thirrto

Ting. IV Os jeneon en mártisin

Athlofor Gjergj, të mburrim sot* si u
mblodhëm, sepse je trim* ndër mar-
tirët, meqë mbarove udhën drejt,*
ruajte besën, pranove pra prej Zotit
Krisht Perëndi* për fitoren tënde
çmim,* një kurorë;⁸ atij iu lut* të çliro-
hemi* nga çdo prishje dhe çdo rrezik
ne që festojmë besërisht kujtimin
tënd, që ka nder dhe respekt gjithnjë.

Me besim te morali yt* tepër trim,
rende si luan* për në atletizëm, duke
shpërfillur tej* trupin që kish për
t'u prishur; por tregove kujdes dhe

mend,* urtësi për shpirtin tënd* të paprishur; u ndeze, pra,* porsì ar në zjarr,*⁹ i pastruar shtat' herë¹⁰ me tortura çnjerëzore, të larmishme, o Gjergj i lum, athlofor i madh.

O shën Gjergj, o martir i madh,* bashkë me Shpëtimtarin Krisht* ke pësuar¹¹ ti, duke imituar pra* vdekjen e tij përmes vdekjes sate vullnetarisht, kështu* mbretëron me të¹² në lavd;* me porfir gjaku plot me hir* qenke veshur mir',* i stolisur me skeptër atletizmi dhe dallohesh me kurorë fitoreje në jet' pa mbarim.

Me pazmore besimi¹³ dhe* shtizë kryqi, o Gjergj zëmadh,* me mburojë Hiri rrethove veten mir',* edhe prandaj i pamposhtur prej armiqve u bëre ti;* triumfove si një trim,* fitimtar i hyjnueshëm* kundër rreshtave* të demonëve dhe kërcen me engjëj dhe kujdesesh, shenjtëron dhe shpëton besnikët që të kërkojnë.

Si një yll me ndriçim të madh,* porsì diell që po shkëlqen* lart në qiell të njohim, si margaritar* tepër të çmuar,¹⁴ diamant që vezullon, si bir dite¹⁵ ty* të lëvdohmë, si një trim* mes martirësh; ti luftëtar* për besnikët je* në rreziqe e sulme, pra të mburrim dhe kremtojm' kujtimin tënd, o Gjergj trofeprurës me çdo triumf.

Kur lundroj në det, kur marshoj,* ec në udhë, kur natën fle,* o i tërëlumuri Gjergj, kur gjumë s'kam,* ti më shpëto; denjësomë të veproj çfarë Zoti do,*¹⁶ që në ditë gjyqi pra* të gjej zgjidhje dhe falje, ndjes'* për paudhësi,* për sa kam bërë gjatë jetës sime unë që përik nën strehën dhe mbrojtjen tënde, o shenjtì im.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

U solle denjësisht sipas emrit tënd, o ushtar Gjergj, se, pasi ngrite mbi supë kryqin e Krishtit,¹⁷ kultivove tokën që u bë djerrë për shkak të mashtimit të djallit dhe, pasi çrrënjose fenë gjembore të idhujve, mbolle mirë hardhinë e besimit orthodhoks; prandaj buro shërime te besimtarët në gjithë rruzullin, dhe u tregove bujk i drejtë i Triadhës; të përgjërohemi, ndërmjeto për paqen e botës dhe për shpëtimin e shpirtave tanë.

Tani

I së kremtes

Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës dhe Leximet.

Këndimi i profecisë së Isaisë
(43.9-14)

Këto thotë Zoti: “Gjithë kombet u

mblodhën së bashku dhe do të mbli-
dhen arkondë nga ato. Kush do t'i njo-
ftojë këto? Ose *gjërat* që nga fillimi
kush do t'ju njoftojë? Le t'i sjellin dë-
shmitarët e tyre, dhe le të drejtohen,
dhe le të dëgjojnë, dhe le të thonë të
vërteta. Bëhuni dëshmitarët e mi dhe
unë dëshmitar”, thotë Zoti Perëndia,
“dhe fëmija im që zgjodha; që të njih-
ni dhe të besoni, dhe të kuptoni se
unë jam. Përpara meje nuk u bë Perë-
ndi tjetër dhe pas meje nuk do të jetë.
Unë Perëndia dhe veç meje nuk është
ndonjë që shpëton. Unë lajmërova
dhe shpëtova, talla dhe nuk ishte në
mes jush i huaj. Ju, dëshmitarë për
mua dhe unë, Zoti Perëndia, ende nga
fillimi dhe nuk ka njeri që të shpëtojë
nga duart e mia. Do të bëj, dhe kush
do ta kthejë mbrapsht këtë?”. Kështu
thotë Zoti, Perëndia, që ju çliron, i
Shenjt i Izraelit.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit

(3.1-9)

Shpirtrat e të drejtëve janë në dorë
Perëndie dhe nuk do t'i prekë torturë.
U dukën në sytë e të pamendëve se
vdiqën dhe u konsiderua keqtrajtim
dalja e tyre dhe ecja nga ne dërrmim,
por ata janë në paqe; sepse edhe në-
se para faqes së njerëzve do të ndë-
shkohen, shpresa e tyre është plot pa-

vdekësi; dhe pasi do të edukohen me
pak *mundime*, do të fitojnë mirëbërje
të mëdha, sepse Perëndia i provoi dhe
i gjeti të denjë për veten. Si ar në
shkritore i provoi ata dhe si holokaust
flijimi i pranoi ata; dhe në kohën e
shqyrtimit të tyre do të ndriçojnë, dhe
si shkëndija në kallam do të vrapojnë.
Do të gjykojnë kombe dhe do të su-
ndojnë popuj, dhe do të mbretërojnë
në ata Zoti ndër shekuj. Ata që kanë
besim në të do të kuptojnë të vërtet-
tën, dhe besimtarët me dashuri do të
qëndrojnë me durim pranë tij, sepse
ka hir dhe mëshirë ndër oshënarët e
tij dhe mbikëqyrje mbi të zgjedhurit e
tij.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit

(5.15-6.3)

Të drejtët jetojnë përjetë dhe në
Zotin është paga e tyre, dhe përkuj-
desja e tyre pranë të Shumëlartit. Për
këtë do ta marrin mbretërinë e hije-
shisë dhe kurorën e bukurisë nga
dorë Zoti, sepse me të djathtë do t'i
mbulojë dhe me krahun do t'i mbrojë.
Do të marrë si armatim zellin e tij dhe
do të mobilizojë me armë Krijesën për
mbrojtje armiqsh. Do të veshë si
korracë drejtësi, dhe do të veshë si
helmetë gjykim pa hipokrizi. Do të
marrë si mburojë të pamposhtur

oshënarí, dhe do të mprehë zemërim të prerë për shpatë; dhe do të bashkëluftojë me atë bota kundër të marrëve. Do të ecin suksesshëm në shënjestër predha rrufesh, dhe si nga një hark i plotë rrethi nga retë do të hidhen në shenjë, dhe nga zemërimi që hedh gurë do të hidhen breshëri të plota. Do të indinohet kundër tyre ujë deti, ndërsa lumenj do të përmytin papritur. Do t'u kundërvihet atyre erë fuqie dhe si stuhi do t'i ajrojë ata si grurë, dhe do të shkretojë gjithë dheun paligësi, dhe keqbërje do të përmbysë frone dinastish. Dëgjoni, pra, o mbretër, dhe bëhuni të mençur, mësoni, o gjykatës të anëve të dheut. Vëreni veshin, ju që sundoni shumicë dhe që jeni mburrur mbi turma kombesh, se ju dha nga Zoti sundimi dhe dinasti nga i Shumëlarti.

*Në Liti Idhiomele
Ting. I I Anatoliut*

Fitimtari i shkëlqyer Gjergj, në atletizmin e tij të lavdëruar, dëfren Fuqitë e sipërme; dhe, duke u ngazëlluar tani tok me to, organizon panair tokësor për besimtarët; dhe, si shërbëtor i Zotit,¹⁸ erdhi që të kremtojë bashkë me ne që u mblodhëm për hirin e tij; prandaj le ta nderojmë denjësisht atë, që ndërmjeton pa pushim te Perëndia

i të gjithave, që të na dhurohet përdëllimi i madh.^{18a}

I njëjti

Duke kultivuar më të mirat përmes arritjeve të fitoreve, lodhjet e fryteve të tua¹⁹ ia blatove Krishtit, o martir i tërëlumur Gjergj; pasi qëndrove me aspiratë me anën e besimit dhe zmbapse frikë nëpërmjet shpresës, falë dashurisë²⁰ i fitove qielloret, o i tërëfamshëm; ndaj, duke pasur guxim me lutje të mirëpritura,²¹ kërko për shpirtrat tanë paqen, falje mëkatesh²² dhe përdëllimin e madh.^{18a}

I njëjti

O Gjergj, ushtari³ i Mbretit të madh,⁴ gëzohu dhe dëfre, sepse u bërë i pëlqyer për Perëndinë;⁵ dhe, meqë i shpërfille të gjitha, gjete jetën e amshuar⁶ në qiej, sepse trupi yt dëbon nga njerëzit çdo sëmundje; Krishtin pra që aspirove, ai të lavdëron, o i lum.

Ting. IV

Ejani, o martirëdashës, t'i sjellim himnim melodik Krishtit, që u ngjall nga varri; sepse sot na lindi pranvera mendore duke çelur lule të logjikshme, kujtimi mbarëbotëror i Gjergjit,

martirit të madh e të urtë; shenjat e plagëve të tij duke i ripërtëritur, marrim burime shërimesh; le t'i lypim atij dhe tani, që të ndërmjetojë pa pushim te Krishti Shpëtimtar, që t'i dhurohet kozmosit paqe dhe shpirtrave tanë përdëllimi i madh.^{18a}

I njëjti I Anatoliut

Të gjitha kombet duartrokisni; le të brohorasim për Perëndinë,⁷ Shpëtimtarin tonë; sepse, pasi u lartësua në dru dhe zbriti në varr, plaçkiti Hadhin dhe bashkëngriti të vdekurit që i thërrisin: Aliluia, aliluia, aliluia për Krishtin që u ngjall.

I njëjti

Vure mbi kokën tënde kurorë lavdie,²³ o Gjergj kurorëprurës, sepse si Pavli thërret, armikun e padukshëm e prite qëndrueshëm duke e parë,²⁴ dhe u bërë fitimtar i mashtrimit të tij. Aliluia, aliluia, aliluia, për Krishtin që u ngjall.

I njëjti

Duke kërcyer së bashku, o martirëdashës, le t'i ofrojmë Krishtit këngë këngësh,²⁵ sepse atleti trim e vuri poshtë tiranin, duke i vënë stërkëmbëse; ndaj le të psalim të gjithë me zëra pa pushim: Lavdi, o Shpëtimtar, ngjalljes

sate të frikshme, përmes së cilës e shpëtove botën.

Lavdi

Ting. II I Joan Monakut

Utha vdekatarëve Solomoni: "Qepallat le të sinjalizojnë drejt",²⁶ sepse paratha se do të mëshirohet prej Krishtit Perëndi ai që sheh butësisht.²⁷ Meqë i dëgjove këto si të lehta, o Gjergj i shumëvuajtur, shkove pas mësimdhënies të Zotit dhe, kur iu dorëzove të paudhëve, durove, pasi i përbuze si të përdhosura orgjitë e mashtrimit; sepse trupi, që dorëzove për hir të dashurisë së Gatuesit, pritej mizorisht në çdo gjymtyrë; dhe më shumë, beljari i turpëruar i tëri plago-sej, duke të parë kurorëprurës tepër të gjallë; prandaj, duke banuar në avllitë e Zotit²⁸ tënd, bashkë me Fuqitë e sipërme, ndërmjeto, o athlofor, te Krishti, që të shpëtohen shpirtrat tanë.

Tani

I së kremtes

Pasvargje

Ting. IV O eks ipsistu klithís

Lëvdojnë popuj me psalme dhe me himne,²⁹ Gjergj, kujtimin tënd që këndohet kudo me zë;* si dritëprurës me hijeshi,* me hir shkëlqeu* dhe me

lavdi i stolisur,³⁰ ndaj tani* po kërcejn' rreshtimet e engjëjve; gjithashtu* duartrokasin për çmimin tënd* që more në gar'* apostuj tok me martirë; përhimnojn'* Krishtin, pra Zotin* Shpëtimtar Perëndi, që të lavdëroi; atij iu lut,* t'i shpëtojë, ndriçojë* shpirtrat tanë, o shenjtor i madh.

Varg: I drejti si palmë do të lulëzohet dhe si kedër në Liban do të shumëfishohet.

Me armatimin e Krishtit ishte veshur,*³¹ ndaj u gjete nga ata që s'të kërkonin³² ty;* për Krishtin ndizeshe, talleshe* ti me mashtrimin*⁴ shpirtshkatërrues të pseudohyjn's,* që i kot' ish. "Mobilizohem për Krishtin³ Mbret",* thërrisje drejt të paudhëve,* "as bisha, as zjarr,* as rrota, as thika, s'munden të më ndajn'* prej dashurisë* që kam unë për Zotin, pra Perëndinë³³ tim".* Atë lyp t'i shpëtojë,* t'i ndriçojë shpirtrat tanë, Gjergj.

Varg: Te shenjtorët që janë në tokën e tij, bëri mrekulli Zoti.

Shpërfille vegla torturash të larmi-shme,* plot mundime, mjet shtrembërimesh të frikshme tmerr,* kurorëprurës, o shën martir;* ti kreve udhë* shpresëtarie,⁸ pra me martirizim,* ndaj kurorëzojmë kujtimin tënd që shkëlqen* me lule këngësh, edhe me bes'* e përqafojmë* lipsanin tënd të

nderuar, o shenjtor;* si dritëprurës* pranë fronit të Krishtit dhe Perëndisë³⁴ rri;* atë lyp t'i shpëtojë,* t'i ndriçojë shpirtrat tanë, Gjergj.

Lavdi

Ting. IV I Studitit

Diamantin mendor të durimit, o vëllezër, le ta mburrim shpirtërisht, Gjergjin, martirin e kënduar, të cilin, kur ndizej për Krishtin, e farkëtuan rreze dhe e forcuan tortura, si dhe keqtrajtime të ndryshme i shkatërruan trupin që priset sipas natyrës; sepse malli fitonte mbi natyrën, duke bindur të dashuruarin që nëpërmjet vdekjes të shkonte drejt të dëshiruarit, Krishtit Perëndisë dhe Shpëtimtarit të shpirtrave tanë.

Tani

I së kremtes

Përlëshore

Si çlirimtar i robërve dhe mbrojtës i të vobektëve,³⁵ mjeku i të sëmurëve dhe përluftar i mbretërve, dëshmor i madh shën Gjergj trofeprurës, ndërmjeto përpara Krishtit Perëndi, të shpëtohen shpirtrat tanë.*



NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësores
Ting. I Ton tafon su Sotir*

Të gjithë, ejani* me të bardha të veshur,* si Perëndia do, të kremtojmë ne hirshëm,* se ja tani po lind prave e Hirit, edhe shndrit fort* mbi të tërë ne* ngjallja e Krishtit, dhe bashkë* po shkëlqen dita* drit'prurëse dhe gazmore* e Gjergjit, martir i madh.

Lavdi *dhe* Tani
I së kremtes

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësores
Ting. III Thias pisteos*

Nga një mall që vlon* për Zotin tonë* ishe ndezur zjarr,* ndaj burrërisht ti* mposhte arkat e mashtrimit, pohove pra* në stadium Krishtin, o trofeprurës Gjergj* i tërëlumur, martir i lëvdur fort;* lypi Krishtit Perëndisë, të na dhurohet hir* dhe ndjesë fajesh edhe përdëllim i madh.^{18a}

Lavdi *dhe* Tani
I së kremtes

*Pas Polieleit, Ndenjësores
Ting. IV Kateplaji Iosif*

Tërë pasurinë dhe* te të vobektë³⁶ besërisht,* kultivove që më par'*

farat e urdhrit zotëror*³⁷ dhe u shpërbleve me lavdin e Krishtit tonë,* o i lartësuar; ndaj me guxim* hyre në mundim, në të gjatën gar',* o Gjergj martir; u bërë pjesëmarrës* ti në pësimin e Zotit³⁸ tënd,* sado s'pëson ky;* në mbretërinë* e tij¹² je dhe për ne lyp.

Lavdi *dhe* Tani
I së kremtes

*Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV
Proqimeni Ting. IV*

I drejti si palmë do të lulëzohet dhe si kedër në Liban do të shumëfishohet.

Varg: I mbjellë në shtëpinë e Zotit, në oborret e Perëndisë do të lulëzojë.

*Ungjilli. Ne që pamë ngjalljen.
Psalmi 50.*

Lavdi. Me ndërmjetimet e athloforit. Tani. Me ndërmjetimet e Hyjlindëses. Përdëllemë, o Perëndi. *Dhe Idhiomeli.*

Ting. Tërth. II

Sot kozmosi i tërë vezullon nga rrezet e athloforit. Dhe Kisha e Krishtit, duke u zbukuruar me lule, të thërret ty, o Gjergj: O shërbyes i Krishtit dhe mbrojtës tepër i flaktë, mos pusho së ndërmjetuari për ne drejt Zotit.

*Kanunet: i Pashkës dhe të dy
të shenjtit:*

Ode I

Kanuni i parë, që ka Akrostihidhë:

*“Të himnoj nga malli, o Gjergj,
unë Davidi; se duhet pra”.*

Ting. I

Anastáseos imera

O ushtar, martir i Krishtit,³ sot ka shndritur më shumë* se dielli kujtimi yt me shkëlqimet nga çudit* që lëshon si rreze llamburitjeje nur* mbi tokën e tërë pra,* edhe feks, o dritëprurës Gjergj.

O atlet gladiator, me mijëra fitore, lavd,* jepmë që t'i këndoj himn triumfit, ndeshjes që si burr'* ke duruar, o i urtë, kur digjeshe* nga malli i Krishtit Zot,* se jetoje për të me gaz.³⁹

Si David i dytë, trim u shfaqe që në rini,* kishe të aftën dorë në luft', ndaj si Goliathin ky* kundërshtarin fort e mund edhe e rrëzon* me pre-dhat⁴⁰ e fjalëve,* o shenjt kurorëprurës Gjergj.

Hyjlindësore

Sa e bukur, e pashprehshme dhe e frikshme që është',* o Vajzë, lindja jote e huaj, se në gji ke Zot* të përsosur, e tavis me qumështin tënd;* dëgjim

krejt paradoksal,* nën'-mëndeshë por pa burrë.

Kanuni i dytë, që ka Akrostihidhë:

“O martir, vërtet je mbrojtës i flaktë”.

Poezi e Theofanit

Ting. II

En vithó katéstrose poté

Me besim të zjarrt' dhe dashuri* të kërkojmë, o kurorëprurës Gjergj,* o martiri i Krishtit tënd;* duke shndritur, rri pranë podiumit të respektuar të Mbretit Zot,*³⁴ që sundon mbi çdo gjë,⁴¹ ruajna me mbrojtjen, ndërmjetimin tënd.

Arë krejt fisnike ishe ti,* Gjergj, për Zotin,⁴² kultivoheshe me pun'* martirike, në arka pra* qiellore ty të depozitoi si pasuri të gjall' Krishti yt* që shpall gara, meqë triumfove kaq shkëlqyeshëm me lavd.

Ulëshove ti vullnetarisht,* o i tërë-lum, me forcë, me durim,* në mundime e ndeshje, Gjergj;* dhe, si shkatërrrore rreshtim të egër tiranësh, bëhesh ndërmjetës shenjt* për të gjithë sa të ftojnë dhe kërkojnë ndërmjetimin tënd.

Si fitove tashmë, o zëmadh,* jet'⁴³ të lumur, që në Krishtin fshihet,⁴⁴ Gjergj,* për të cilën luftove fort,* deri dhe në gjak,⁴⁵ kërko për të gjithë sa

të himnojnë me bes', shpëtim* nga çdo lloj peripecie, o atlet dhe athlofor me nam.

Hyjlindësore

O Hyjnënë, mbajte ti në bark* Fjalën qiellore, qiell krejt mendor* pra je, se përmes Fjalës Krisht* çdo gjë u krijua,⁴⁶ dhe toka bashkë me qiejt,⁴⁷ sa ekzistojn' përtej;* ndërmjeto pra me guxim, që të shpëtojmë ne që të himnojm'.

Zbritësore: Anastáseos imera

Dit' e ngjalljes

Ode III

Kanuni i parë

Dhefte poma píomen

Ranë bashkë me shkëlqim të fort'* tok me ngjalljen e Krishtit kujtimi me çdo lavd* i shërbëtorit të tij;* të mbledhur, besnikë, pra në të,* me gaz ta kremtojmë ne.

Ki dëfrim, o qiell dhe ti dhé,*⁴⁸ male, kodra të tëra me gaz kërceni ju,*⁴⁹ se rrjedhë plot me çudi* nga lart na hedh si shi shenjti yn',* martir, athlofor Gjergji.

Toka, çdo fis njerëzor tani* tok ushtri engjëllore dhe qiell kanë gaz,*⁴⁸ se komandanti shenjtor* i Krishtit, shën

Gjergji, po shkon lart,* nga toka drejt qiejve.

Hyjlindësore

O Mariam, dëfre me ngazëllim,* sado shpata ta shpoi dje zemrën ty përtej*⁵⁰ nga Kryqi që Biri yt* pësoi, por lind nga varri ky* si prej nusëroreje.⁵¹

Kanuni i dytë

Eksínthisen i érimos

Meqë shkëlqen fort me kuror'* atletizmi, sa të ftojnë me besim, o lavdiplot* dhe i lum, duke lutur Perëndin'* Shpëtues Zot, çliroji nga nevojat mbar'.

Me rreze fort të pasura* i shkëlqyer nur, o i tërurtë, flake mjegullën* e pasioneve dhe topitjen ton'* të errët, nga ne që me besë të lëvdojm'.

Në shpresë po mbështetteshe* dhe fortifikoheshe me dashuri, besim,⁵² o Gjergj,* me fuqinë e Krishtit mburreshe,*⁵³ mashtrimin idhujtar e hodhe ti përdhé.

Hyjlindësore

E Tërëshenjtë linde ti* Krishtin që s'kish mish, as nisje, para botës ish* tok me Atin, dhe shndrit çdo cep në dhé;* me besë të lëvdojmë, o Hyjlindëse.

Zbritësore: Dhefte poma piomen

Eni pini ujë

Ndenjësore

Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon

Me arritje në sjellje si shpresëtar,* si e mposhte mashtrimin e pabesis',* ke shkelur përdhé furin',* kundër-shtarin e lig; sepse,* me zell hyjnor i ndezur në mendje, e shove krejt* shfrenimin ateist të tiranëve; prite pra* si shpërblim torturash denjësisht ti kurorën,* o Gjergj athlofor, kështu* në sëmundje, shërime jep,* edhe mbrojtje* te çdo besnik;* ndërmjeto te Zoti yt Krisht* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tënd fort të shenjt' me mall.

Lavdi

U shpërndave të gjithëve pasurin'* tokësore, martir Gjergj, me urtësi,* fitove si trashëgim* pasuri qiellore⁵⁴ ti,* përmes mundimit tënd; se me kryqin pa cen aspak* fortifikove veten edhe turpërove keq* me këtë tërbimin e tiranëve; ndaj pra* te sa të kërkojnë, jep,* nëpërmjet përgjërimit tënd,* hir shërimesh,*⁵⁵ dhurim hyjnor;*⁵⁶ ndërmjeto te Zoti yt Krisht* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tënd fort të shenjt' me mall.

Tani

I së kremtes

Ode IV

Epí tis thias filaqís

Sa shumë e tejkaloi Aleksandra, mbretëresha e tanishme, mbretëreshën e mëparshme të Jugut, o i urtë, sepse u habit dhe vrapoi drejt mençurisë sate,⁵⁷ prandaj qëndron bashkë me ty, o martir, si mbretëreshë në të djathtën e Perëndisë.³⁰

Duke mos duruar qortimet e fjalëve të tua, besëkeqi urdhëron mjerisht, të qëllohesh në gojë,⁵⁸ por, o Gjergj, ndonëse goditej, ajo buçiste si cimbal duke thirrur: Perëndi i vetëm⁵⁹ dhe jo i gënjeshtërt⁶⁰ është Krishti.

O mik autentik i Krishtit,⁶¹ kampion i tij, ndriçues i tërëshkëlqyer i kozmosit,⁶² yll tepër i shndritshëm, kandil - thesar i madh, rojë i pafjetur i atyre që të nderojnë, ruajna, o martir Gjergj.

Hyjlindësore

Ja, dhe ke lindur, o e dëlirë, dhe je e virgjër njëkohësisht; çudi vërtet shumë e habitshme, e frikshme, e huaj ta dëgjosh! Sepse duke mbajtur në kraharonin tënd Perëndinë, tërëmbretin, i jep gji si foshnjë Krishtit ushqyes, o Vajzë.

*Kanuni i dytë
Elilithas ek Parthenu*

Himnojmë luftërat e tua, o Gjergj i tërëlumur, me anën e të cilave vithise objektet e idhujve dhe asgjësive gjithë mashtrimin e demonëve, o i tërëkënduar.

Qetësoje turbullimin e ngasjeve dhe të rreziqeve dhe dëbo çdo ndikim të demonëve nga ata që të himnojnë ty, si ushtar i Krishtit,³ o i admirueshëm.

Linde si ylli i agimit⁶³ me trimërinë e shpirtit dhe mbështetjen e besimit,⁶⁴ duke flakur furtunën e mashtrimit dhe duke shpëtuar ata që të himnojnë, o Gjergj.

Hyjlindësore

O Virgjëreshë, ke lindur shpëtim esencial, që me mirësi të pasur⁶⁵ dhe butësi nga natyra shpëton njeriun dhe rigatuan ikonën⁶⁶ e prishur.

Zbritësore: Epí tis thias filaqís

Nga fron' i qellit, o profet

Ode V

Kanuni i parë

Orthrisomen orthru vatheos

Duke kërcyer, o Kishë, duartrokit në mënyrë festive ngjalljen e nderuar të Krishtit dhe transferimin e tanishëm

të athloforit dhe psal, sepse ranë bashkë dy të mira.

Gliqeri i mirë, kaun e të cilit e risolle në jetë çuditërisht, e lavdëron mrekullinë tënde të huaj, o Gjergj, burim çudish, ndërsa ti ia ofrove atë Zotit tënd si flijim të gjallë.⁶⁷

Që të himnoj lavdinë tënde, mbushma gojën me himnim,⁶⁸ o Gjergj, duke hijeshuar edhe mendjen, sepse shpirti im do të ngazëllohet kur do psalë për ty.⁶⁹

Hyjlindësore

O e përmbikulluar, si je mëndeshë dhe e virgjër përmbi logjikë? Habitem për misterin tënd të frikshëm; ndaj, duke nderuar lindjen tënde, të falemi, o e Tërëshenjta ime.

*Kanuni i dytë
O fotismós*

Meqë ke guxim martirik ndaj Zotit, kërko me gatishmëri shpëtim për ata që të himnojnë, duke i çliruar nga sëmundja shpirtërore me anën e lutjeve të tua, o dëshmor athlofor Gjergj i tërëlumur.

Duke kërcyer si martir me kore engjëllore, dhe duke qenë i mbushur me lavdinë e pavdekshme dhe të lumur, o kurorëprurës, ata që rendin te streha

jote rrëmbeji nga çdo shtrëngatë dhe turbullim.

Çlirona prej çdo nevoje si përdëllyes, duke zhdukur lëkundjet e shumë-llojshme të mëkatit dhe të rreziqeve, duke pranuar përgjërimet e Gjergjit, shërbyesit tënd, o Krisht.

Hyjlindësore

Borxhin e Evës paranënë⁷⁰ e lave ti, o Hyjnënë, kur linde Shpëtimtarin e botës,⁷¹ që u vesh me mish prej teje; ndaj të gjithë të lumërojmë, o Virgjëreshë hirplote, e tërëpaqortueshme.

Zbritësore: Orthrísomen orthru

Mëngoni menatë

Ode VI

Kanuni i parë

Katílthes en tis katotatis

Ja ku një dallëndyshe me hijeshi* për ty mbush çuditërisht hirin që ka pranvera, o popull, pra Gjergj i shenjt';* si do Zoti Krisht*, të ka mbledhur, ndaj të gjithë gëzohuni me të.

Durove torturim të frikshëm llahtar,* keqtrajtime; i mendove për Zotin shijim,⁷² o i lavdëruari shenjt,* psalje pra me zë* dhe në rrotë bubullimë dëgjoheshin⁷³ lutjet.

Dëfre, kërce, o kor atletësh, tani,* meqë ju në panair gjetët si kryetar Gjergjin; kini gaz me atë* në mënyrë pra* davidiane, sepse kjo është dita e Zotit.⁷⁴

Hyjlindësore

Dhe lind, dhe virgjëreshë je përsëri* si më parë; lindja është e frikshme, o Vajz' e panusëruar dhe nën',* dhe nuk thuhet dot;* lind mbi mendje të mbi-kohshmin si foshnjë porsì ne.

Kanuni i dytë

En aviso ptesmaton

Mbi logjikë, natyrë edhe mendim* janë çmimet dhe fitoret, o i tërëlum,* shën Gjergj martir, këndohen pra* përgjithmonë në skajet e rruzullit.

Anëtar në ushtri qiellore lart,* o i lum, u bërë dhe sheh aq sa mundet ti* pranin' hyjnore, ndaj shpëto* sa me besë dhe mall të nderojnë ty.

Perëndis' iu kushtove me çdo mënyr';* llamburitjet e çudivë i pranon, martir* i tërëlum, u ndan kështu* nevojtarëve shumë dhurata, Gjergj.

Hyjlindësore

Te ti që s'ke aspak cen, përik tani,* më shpëto, më ruaj përmes ndër-

mjetimit tënd,* se mundesh sa do,⁷⁵ meqë je* nënë Zoti, që mundet dhe bën sa do.

Zbritësore: Katilthes en tis katotatis

Kur zbritë gjer në fund

Kontaqi

Ting. IV O ipsothis en to stavro

I kultivuar drejt* prej Zotit,⁴² u shfaqe* ti bujk i çmuar fort* i shpresëtarisë,* për veten mbloodhe duajt e virtyteve pra;* korr me gaz, si mbolle ti me lot;*⁷⁶ si garove me gjak, ke marr'* Krishtin, o shën Gjergj martir,* athlofor trofeprurës;* me ndërmjetimin tënd të flaktë krejt* jep te të gjithë* ndjes' fajesh edhe çlirim.

Shtëpia

Duke aspiruar Gjergji, ushtar i madh, Krishtin³ mbret, që vuri shpirtin e tij për jetën e botës,⁷⁷ nxiton të vdesë për të, sepse, duke pasur në zemër zell të hyjshëm, ai e ofroi veten e tij; atë, pra, edhe ne le ta përhimnojmë me besë si mbrojtësin tonë të zjarrtë, sepse është shërbëtor i lavdëruar i Krishtit,¹⁸ i cili imiton qartazi Zotin e vet⁷⁸ dhe kërkon prej tij që t'u japë të gjithëve ndjes' fajesh edhe çlirim.

Sinaksari

Më 23 të të njëjtit muaj, kujtimi i martirit të madh, të shenjtë e të lavdëruar Gjergj Trofeprurësi.

Vargje: Gjergji që pret armiq në luftë,/ pritët vullnetarisht me shpatë nga armiq.

Në të njëzet e tretën, bakër preu qafën e Gjergjit.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të shenjtë Ualeri.

Vargje: Kokën e shenjtë të Ualerit e preu me shpatë/një kokë e mbrapshtë, xhelati.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirëve të shenjtë Anatoli dhe Protoleoni, gjeneralë.

Vargje: Kur perëndoi Anatoli me prerjen e kokës,/ pa dritën mëngjesore mendore të Zotit.

Pritet martiri i Krishtit Protoleoni,/ duke iu besuar Krishtit, si luani fuqisë së tij.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të shenjtë Athanasi nga magjistarët.

Vargje: Athanasi magjistar gjeti si ilaç të huaj/ për shpirtin e sëmurë prerje koke.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të shenjtë Gliqer bujku.

Vargje: O bujk Gliqer, unë e gjykoj në

mënyrë të përshtatshme/ grykën tënde si tokë, ndërsa shpatën si parmendë.

Në të njëjtën ditë, shenjtorët Donati dhe Therini nga Butrinti mbarojnë me shpatë.

Vargje: O Therin, pasi u korre nga shpata tok me Donatin,/ bëhuni të dy duaj të çuditshëm Perëndie.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i neomartirit të shenjtë Gjergj qiprioti.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i neomartirit të shenjtë Llazar bullgari.

Me ndërmjetimet e shenjtorëve të tu, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII

Kanuni i parë

O Pedhas ek kaminu

Dëshiroj që të përhimnoj të çuditshmet e tua dhe përsëri druham, sepse, kur dua t'i numëroj, do të gjenden të shumëfishuara më shumë se rëra,⁷⁹ ndaj prano këtë himn të vogël të shkurtër, o atlet.

Nuk ka as tokë, as det, as qytet, as shkretëtirë ku të mos burojnë vërtet me bollëk si oqean krojet e mrekullive të tua, o martir, sepse emri yt i çuditshëm këndohet në tërë dheun.⁸⁰

Ushtria e engjëjve habitet me atletizmin tënd, o gjeneral, ndërsa Mbreti

i engjëjve, i çuditur me ty, dëshiroi bukurinë tënde,⁸¹ o martir; prandaj të denjësoi të mbretërosh së bashku me të¹² përgjithmonë.

Hyjlindësore

O tendë e hyjndërtuar⁸² dritëplotë, kandil i gjithartë,⁸³ shtambë,⁸⁴ arkë,⁸⁵ tempull i hyjbanuar,⁸⁶ shkop që nxore lastar në mënyrë të huaj,⁸⁷ nënë pa burrë, ruajna ne shërbyesit e tu, o Vajzë me shumë epitete.

Kanuni i dytë

Antítheon próstagma

O martir i lavdishëm, duke imituar Zotin tënd,⁷⁸ shkove vullnetarisht drejt ndeshjes; dhe, pasi more fitore, u bërë rojë e Kishës së Krishtit, duke e ruajtur atë përherë me anën e mbrojtjeve të tua.

Si martir i pamposhtur, si athlofor, si përluftar i paluftueshëm i besimit, bëhu tani kullë e patundur për lavdëruesit e tu, duke na rrethuar me mur përmes përgjërimeve të tua, o Gjergj i tërurtë.

Me urtësi kultivove farën e hyjshme dhe e shumëfishove,³⁷ duke vaditur me rrjedhat e gjakrave të tua, me zëllin e lodhjeve dhe me torturat e njëpasnjëshme, përmes të cilave shove arrogancën e tiranëve, o i lumur.

Hyjlindësore

Mbetë e virgjër dhe pas lindjes, sepse linde Perëndi që i ushqen të gjithë, i cili u bë njeri nga mëshira e patregueshme dhe nga dhembshuria e shumtë, o e kulluar; atij tani lypi që të shpëtojme të gjithë ne.

Zbritësore: O Pedhas ek kaminu

Tre Djemat midis flakës*Ode VIII**Afti i kliti*

Pasi mblodhëm himne, si lule erë-këndshme, të Psaltirit të hyjrymëzuar, si prej një tjetër Parajse, ejani të thurim për martirin kurorë të shkëlqyer, të pleksur me këngë, sepse triumfoi duke rrëzuar pushtetin e satanit.

Eja, o melodist, i pari i profetëve, thuaj: Ai i drejti që lulëzoi si feniks,⁸⁸ kush është dhe ç'është? Është Gjergji shumë kryelartë, pemë me fruta të ëmbla vërtet, që ushqen zemrat.

Eja, shfaqu, shpejt arri, pranona, duke u kujdesur gjithmonë për ne, të vegjlit e tu, si shqiponjë me krahë të artë, pasi t'i shtrish krahët e tu,⁸⁹ sepse është mirë të prehem nën hijen tënde.⁹⁰

Hyjlindësore

Shih Virgjërëshën që parathe, o profet; mbretëresha dhe zonja zuri pa farë dhe si nënë lind⁹¹ Tërëmbretin, ndonëse mbeti e tërëpaprishur. Është mister i huaj lindja jote, o Vajzë!

*Kanuni i dytë**Káminos poté píros*

O kurorëprurës Gjergj, me ndërmjetimet e tua pusho vrullin e vuajtjeve, pësimeve, rreziqeve dhe rasteve të trazuara, si dhe simptoma sëmundjesh, intriga demonësh dhe sulme keqdashësish.

Duke feksur sinqerisht me dritën e tërë të Trinisë, o i tërëlumur, si martir i pamposhtur, si përluftar shpresëtarie dhe si fitimtar i hyjkurorëzuar, shpëtoji me ndërmjetimet e tua ata që të nderojnë, o banor i qiellit.

Duke u shquar në mënyrë të larmishme me kurorë mendore dhe i stolitur me rreth dhe skeptër mbretëror, si dhe i veshur me porfir të ngjyrosur nga gjaku yt, o i lumur, mbretëron bashkë me mbretin¹² e Fuqive.⁹²

Hyjlindësore

O nënë e virgjër, linde atë që lindi pa mot nga Ati dhe shkëlqeu para jetëve,

që i bëri të gjitha, të dukshmet dhe të padukshmet;⁴⁶ prandaj të gjithë kombet të lavdërojmë si Perëndilindëse.

Zbritësore: Afti i kliti

Dita m'e shkëlqyer

Ode IX

Fotizu, fotizu

O male, pikoni të ëmblën vesë dhe ti mal* kaq i shenjt',⁹³ në mënyrë* të veçantë pra kërce,* ki gaz tani, vallëzo hijesisht,* se gjete si rojë të fuqishëm* të madhin Gjergj trofeprurësin.

Himnojnë, bekojnë, tani thërrasin me një zë* gjithë fiset dhe kombet:⁹⁴ Pra gëzohu, Shpëtimtar,* je ngazëllim për besnikët e tu;* gaz ki dhe ti, mburrje athloforësh,* i admiruar fort, Gjergj martir.

Goditje dhe rrahje me nerva, shqyerje, dhunim* dhe këpucë me gozhdë,* gropën e gëlqeres tok* edhe pësimet e tjera nderoj,* rrotën e puth, o martir i Krishtit,* e lumëroj atletizmin tënd.

Dhimitër martir tok me Gjergjin me lavdi, të dy* jeni shumë të mirë,⁹⁵ mos pushoni kurrë pra* që ju ta

mbroni këtë vend gjithnjë,* mijëra të tëra ngasjesh, tmerresh* largoni⁹⁶ dhe i dëboni tej.

Hyjlindësore

Lavdi, bukuri dhe stoli për besimtarët je* dhe shpëtimi i botës,* dhe shijimi engjëllor,* nëna e tërëdëlir' e Krishtit,* Zotit; sa rendin, e Tërëshenjtë,* në strehën tënde, ti ruaji.

Kanuni i dytë

Anarhu jenitoros

Lyp Zotin tënd pa pushim për ne që të himnojmë ty,* si martirin e Krishtit, dëbues frymësh pra* djallëzore, si fitimtar mbi tiranët ti,* rojë i pafjetur dhe mbrojtës me plot fuqi,* që nuk turpëroresh, o i lum.

Medaljet e garave t'i ka dhuruar pasurisht* Zoti i Gjithësis',⁴¹ me të rri³⁴ me plot guxim* martirik dhe me ngazëllim, o i lum tri her';* ndaj, për sa të ftojnë, kujdesu kur të kërkojnë,* ruaji dhe mbroji, o atlet.

Të fshehu krejt toka, teksa të pranoi qielli,*⁹⁷ për ty qartas u hap porta e Parajsës⁹⁸ lart,* me hare të madhe atje, athlofor martir,* rri edhe lëviz ti; ndaj, sa të himnojnë me bes',* ruaji me ndërmjetimin tënd.

Hyjlindësore

Hyjlindëse, tenda e dëshmisë⁸² që kish brenda shtamb' *⁸⁴ edhe pllaka,⁹⁹ të paraikonizonte ty, * siç e arta arkë;⁸⁵ sepse si këto, dhe ti * në bark mbajte Fjalën pa nisje kur merrte mish, * pra, o Vajzë e kulluar krejt.

Zbritësore: Fotizu, fotizu

Një engjëll

dhe

Ndriçohu, ndriçohu

*Dërgimësore**Tis mathitës sinélthomen*

Pranvera shndriti fort për ne, * pra ngjallja e shkëlqyeshme * me hir të Zotit, na drejton * nga toka lart te Pashka * në qiell; bashkë me të feks * edhe kujtimi plot nder * me rrezatim i Gjergjit shenjt * dhe të tërëlavdisëm; le ta kremtojm' * hijesisht, të bëhemi ne të denjë * për hir hyjnor nga Krishti Zot * dhe Shpëtimtar çli-rues.

*Dhe e së kremtes**Lavdërimë**Ting. II Ote ek tu ksilu se*

Pasi * e kremtuam gjithë ne * ngjall-jen e lëvduar, festive me hijeshi plot,

me gaz, * ejani që panairin ngazëllues fort * të martirit Gjergj ta kremtojmë prapë; këtë ne * ta kurorëzojm' me lule pranverore pra, * se është i pampo-shtur; me lutjet * që bën do të marrim çlirimin * e mëkateve dhe të trishti-meve.

Gjithë * veten ti e solle pra * si një holokaust të plotë, të gjallë⁶⁷ edhe frymor, * si flijim të mirëpritur dhe të pastër¹⁰⁰ krejt * tek ai që të dha ty je-të, i tërëlumur; * ndaj u bëre ndërmje-tues i përflaktë zjarr, * o martir, çliron nga furtuna * gjithë sa me bes' të himnojnë * dhe të ftojnë, o Gjergj, athlofor i madh.

Farën, * fjalën që në shpirtin tënd * të pastruar thellë e vure, e kultivove me zell, * e shumëfishove³⁷ me mu-ndim, atletizim, * e kurseve në depo me urti lart në qiell, * gjete pra shiji-min e paprekshëm, o i lum, * je mbu-shur tani me këtë, Gjergj; * ndaj, sa të himnojnë me besë * përmes ndër-mjetimit tënd, shpëtoji ti.

O shenjt, * athlofor i Krishtit Zot, * sa në sulm, nevoja të ndryshme, peripeci janë, ti, * përmes ndërmjetimit tënd, shpëto si dhe çliro, * dëbo tutje topitje shkatërruese shpirti, * që mundon edhe tmerron, si dhe kërko për ne * hir dhe përdëllim,¹⁰¹ të shpëtojmë, *

që me gaz t'i mburrim të gjitha* garat e nderuara që kreve, Gjergj.

Lavdi

Ting. Tërth. I I Theofanit

Lindi pranvera, ejani të dëfrejmë; shkëlqeu ngjallja e Krishtit, ejani të ngazëllohem; u dëftua kujtimi i athloforit që hijeshon besimtarët; prandaj, o kremtimdashës, ejani që të bëjmë panair për të mistikisht; sepse ai, si ushtar³ i mirë, guxoi burrisht kundër tiranëve dhe i turpëroi, duke u bërë imitues i pësimit të Krishtit Shpëtimtar; nuk pati mëshirë për enën e vet të baltë,¹⁰² por e farkëtoi atë të zhveshur, duke e alternuar me tortura; atij le t'i thërrasim: O athlofor, përgjërohu që të shpëtohen shpirtrat tanë.

Tani

Dit' e ngjalljes

Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e shenjtorit. Jepet dhe vaji i shenjtë nga kandili i shenjtorit.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Kontaqi i Pashkës. Apostulli dhe Ungjilli i shenjtorit. Të meriton. Kungatore: Në kujtim të përjetshëm.

CITIME

¹ I Tim. 1.17

² Rom. 15.15; II Tim. 1.9

³ II Tim. 2.3

⁴ Matth. 5.35; Ps. 47(48).3

⁵ Gjen. 5.22,24; 6.9; Ps. 55(56).14; 114(115).9; Sirak 44.16; Rom. 14.18; II Kor. 5.9; Hebr. 11.5

⁶ Matth. 19.16 etj.

⁷ Ps. 46(47).2

⁸ II Tim. 4.7-8

⁹ Urt. Sol. 3.6

¹⁰ Ps. 11(12).7

¹¹ Rom. 8.17

¹² II Tim. 2.12

¹³ I Thes. 5.8

¹⁴ Matth. 13.46

¹⁵ I Thes. 5.5

¹⁶ Matth. 7.21; 12.50; Mark. 3.35; Joan 7.17; 9.31; Ef. 6.6; Hebr. 10.36; 13.21; I Joan 2.17

¹⁷ Matth. 16.24; Mark. 8.34; 10.21; Lluk. 9.23

¹⁸ Rom. 1.1; I Kor. 7.22; Gal. 1.10; Ef. 6.6; Fil. 1.1; Kol. 4.12; Jak. 1.1; II Petr. 1.1; Juda 1

^{18a} Num. 14.19 etj.

¹⁹ Ps. 127(128).2

²⁰ I Joan 4.18

²¹ Fja. Urt. 15.8

²² I Joan 2.2; 4.10

²³ I Petr. 5.4

²⁴ Hebr. 11.27

²⁵ Kënga e Këngëve

²⁶ Fja. Urt. 4.25

²⁷ Fja. Urt. 12.13

²⁸ Ps. 64(65).5; 133(134).1; 134(135).2

²⁹ Kol. 3.16

³⁰ Ps. 44(45).10,14

³¹ Ef. 6.11,13

³² Is. 65.1; Rom. 10.20

³³ Rom. 8.35,39

³⁴ III [I] Mbret. 17.1; 18.15; IV[II] Mbret. 3.14; 5.16

³⁵ Jov 29.12

- ³⁶ Ps. 111(112).9; II Kor. 9.9
³⁷ Matth. 13.1-8; Mark. 4.3-8; Lluk. 8.5-8
³⁸ Fil. 3.10
³⁹ Gal. 2.20
⁴⁰ I Mbret. [Sam.] 17.4-51; 21.9; 22.10;
 Sirak 47.4
⁴¹ I Kron. 29.11; Urt. Sol. 12.16
⁴² I Kor. 3.9
⁴³ I Tim. 6.12,19
⁴⁴ Kol. 3.3
⁴⁵ Sirak 4.28; II Makk. 13.14
⁴⁶ Joan 1.3; Kol. 1.16
⁴⁷ Gjen. 1.1 etj.
⁴⁸ Ps. 95(96).11; Is. 44.23; 49.13
⁴⁹ Ps. 113(114).4-6
⁵⁰ Lluk. 2.35
⁵¹ Ps. 18(19).6
⁵² I Kor. 13.13
⁵³ Ef. 3.16
⁵⁴ Matth. 6.20; 19.21; Mark. 10.21;
 Lluk. 12.33; 18.22
⁵⁵ I Kor. 12.9
⁵⁶ Jak. 1.17
⁵⁷ II Kron. 9.1-6; Matth. 12.42; Lluk. 11.31
⁵⁸ Vep. 23.2
⁵⁹ Judith 16.2; Ps. 150.5
⁶⁰ Tit. 1.2
⁶¹ Joan 15.14-15; Jak. 2.23
⁶² Fil. 2.15
⁶³ Jov 11.17
⁶⁴ I Thes. 3.2
⁶⁵ Rom. 2.4
⁶⁶ Gjen. 1.26-27; 5.1; 9.6; Urt. Sol. 2.23;
 Sirak 17.3
⁶⁷ Rom. 12.1
⁶⁸ Ps. 70(71).8
⁶⁹ Ps. 70(71).23
⁷⁰ Gjen. 3.6
⁷¹ Joan 4.42; I Joan 4.14
⁷² IV Makk. 7.22; 16.19
⁷³ Ps. 76(77).19
⁷⁴ Ps. 117(118).24
⁷⁵ Mark. 1.40; Fil. 4.13
⁷⁶ Ps. 125(126).5
⁷⁷ Joan 10.15-18
⁷⁸ I Kor. 11.1; Ef. 5.1
⁷⁹ Ps. 138(139).18
⁸⁰ Ps. 8.2,10
⁸¹ Ps. 44(45).12
⁸² Eks. 25.8; 26.20;
 Ps. 45(46).5; 131(132).5; Hebr. 9.2
⁸³ Eks. 25.30-37; 35.16; 38.13; 40.22;
 Num. 4.9; 8.2; Hebr. 9.2
⁸⁴ Eks. 16.33; Hebr. 9.4
⁸⁵ Eks. 25.9-20; 38.1; Ligji i Dytë 10.2;
 Ps. 131(132).8; Hebr. 8.4
⁸⁶ Jez. 44.1-4
⁸⁷ Num. 17.23; Hebr. 9.4
⁸⁸ Ps. 91(92).13
⁸⁹ Ligji i Dytë 32.11
⁹⁰ Jez. 17.23
⁹¹ Is. 7.14
⁹² Ps. 67(68).13
⁹³ Ps. 2.6 etj.; II Petr. 1.18
⁹⁴ Ps. 116(117).1
⁹⁵ Kisht. 4.9
⁹⁶ Ligji i Dytë 32.30
⁹⁷ Vep. 3.21
⁹⁸ Gjen. 3.24
⁹⁹ Eks. 31.18; 34.1-4,28; Ligji i Dytë 4.13;
 5.22(19); 9.9-11; 10.1-4
¹⁰⁰ Lev. 1.3; 17.4; 22.19,21 etj.; Is. 56.7
¹⁰¹ I Tim. 1.2; II Tim. 1.2; Tit. 1.4; II Joan 3
¹⁰² II Kor. 4.7



MË 24 TË TË NJËJTIT MUAJ
Kujtimi i nënës sonë oshënare
Elisabeta çudibërëse.

NË MBRËMËSORE

*Thirrtores: 3 të së kremtes (ose
të Triodhit) dhe 3 të shenjttores:*

Ting. Tërth. IV I mártirés su Kírie

Meqë durove lodhjet ti të asketizmit, more hir të flakësh* sëmundje shpitrash edhe trupash, nënë modeste, edhe të dëbosh* frymë¹ pra në Shpirtin Hyjnor, dhe i mbron* gjithë sa trishtohen; ndaj për tërë ne* kërko me ndërmjetimin tënd çdo shërim, shëndet edhe përdëllim të madh.^{1a}

Onën' e admirueshme Elisabeta, pluhuri nga varri* që nxjerr lipsani yt dhuron shikim te të verbrit si edhe shërim* në sëmundje të larmishme, edhe ndihm'* te sa me besim afrohen dhe të ftojn';* kërko me ndërmjetimin tënd për të gjithë ne përdëllim të madh,^{1a} shëndet.

Ke praktikuar dhembshurin', besimin orthodhoks dhe dashurinë* për Zotin² dhe të afërmin,³ ndaj Hiri Hyjnor i Shenjtit Shpirt u preh* brenda teje,⁴ e hyjлумëruara* nën' Elisabetë krejt e thjeshtë pra;* prandaj me ndërmje-

timin tënd jepna përdëllim, paqe, hir edhe shëndet.

Lavdi *dhe* Tani
I së kremtes

[Nëse bie brenda Triodhit:

Lavdi *dhe* Tani *Hyjlindësore*
Ting. II Ote ek tu ksilu se

Çfarë* të të sjell i mjeri un',* Zonj' e botës, veçse burimet e lotëve dhe rrëfim* për ato që tashmë bëra; por me syrin tënd* mbikëqyr ti me butësi nga lart dobësinë* shpirtërore që më skllavëron, o Vajzë, zgjidh* rrjetat e pasioneve që kam;* unë shërbëtori yt, lutem,* më çliro nga mjegulla që më pushton.

ose Kryqhyjlindësore

O Krisht,* kur të shihte ty të jesh* ngritur përmbi drurin e Kryqit ajo që të lindi ty* pa përvojë burri, qante hidhur, thoshte k'shtu:* Biri im fort i ëmbël, pse e le nënën vetëm,* o ndriçim i paafrueshëm i Atit tënd* para çdo fillimi? Nxito pra* dhe lëvdohu, që të lëvdohen* sa lëvdajn' hyjnisht pësimin tënd hyjnor.]

*Pasvargje të së kremtes (ose
të Triodhit)*

Përlëshore
Ting. Tërth. IV

Ti, o nënë, pikërisht u tregove si kora e Zotit,⁵ e more pra kryqin tënd dhe pasove krejt Zotin Krisht⁶ dhe vepra shfaqe për mësim⁷ që të shkujdesemi për trup, sepse ky kalon, dhe të kujdesemi për shpirt, se është i pavdekshëm; pra shpirti yt po gëzohet tok me engjëjtë, Elisabetë, nën' e shenjtë, me nam të madh.*



NË MËNGJESORE

*Kanunet: i së kremtes dhe
i shenjttores:*

Poezi e Josifit
Ting. Tërth. IV

Ode I
Armatilatin Faraó

Elisabetë, më rrethon shtrëngatë veshesh, anekënd tundem keq* brenda shpirtit unë* prej trazirës së mendimeve; me lutjen tënde ti* më drejto në limanin e qetë krejt të vullneteve* të Jisuit,⁸ që ty të të himnoj.

Si u stolise me hir virgjëror, o e hyjlum me lavde gjithnjë,* Fjala, Zot i pastër,* u martua me ty që i vrave veset,⁹ ndoqe pra* që fëmijë ti gjurmët e tij¹⁰

jet'prurëse plot shkëlqim,* se asketizoje me saktësi.

Nga lidhja tokësore u shkëpute larg, u ngjite pra, o e thjesht',* pas mallit për Krishtin;*¹¹ përmes kreshmës shkrive çdo mentalitet që mishi ka;*¹² me durim ke qëndruar fort në virtyt, lutje¹³ dhe mundim,* ndaj u denjësove të bësh çudi.

Hyjlindësore

Etërëpaqortueshme, që linde përmbi mendje Krishtin Jisu,* Fjalën e pandarë* kurr' nga Ati Perëndi, të dëshironte plot me zjarr* dashurie e famshmja Elisabetë, u bë kështu* enë Shpirti, që shndriste në virtyt.

Ode III
Uranias apsidhos

Lart në qiell banove në dhoma drit'-prurëse* si u bëre nuse e zgjedhur për të pushtetshmin Zot;* lumenj shërimesh buron,* që thajnë rryma pësimesh,* nënë oshënare edhe çudibërëse.

Meqë kishe zili Moisiun,¹⁴ Ilian¹⁵ tok,* si ata për kohë të gjat' kalove, modeste ti,* me kreshmë, dhe prisje pra* buk' qiellore¹⁶ vegimesh* urtësisht me Hirin e Shpirtit Hyjnor, o nën'.

Një zbulesë e hyjshme përpara zë-

nies në bark* iu dha nënës sate rreth jetës që do kaloje ti* me çdo virtyt, me shkëlqim,* nëpërmjet Shpirtit të Shenjtë,* o Elisabetë, o vajzë me plot lavdi.

Hyjlindësore

Meqë të aspiroi Elisabeta me bes'* ty të vetmin tempull të pastër të virgjërisë pra,* gëzohet, sepse u soll* te Biri yt e lavdishme,* me kushtim të ndoqi, o e paqortueshme.¹⁷

Irmosi: Uranias apsidhos

»Perëndi që apsidë bëre në q'ell si »çati,*¹⁸ ti që je ndërtues i Kishës,¹⁹ »mirë më siguro* në dashurinë që ke;* »je maja e çdo dëshire,* njeridashës, »edhe mbështetja për çdo besnik.

Ndenjëso

Ting. III Thias písteos

Me hyjfrymëzim* Elisabetë,* ty të admirojm',* se ke duruar* lodhjet e vetëpërmbytjes; ke marrë pra* ti hir papasionshmërie edhe shëron* çdo lloj sëmundjesh, çdo akt djallëzor e flak,*¹ përgjëroju Krishtit Zot, Perëndisë Shpëtimtar,* të na dhurohet përdëllim i madh,^{1a} ndjesë.

Dhe e së kremtes

[Nëse bie brenda Triodhit:

Lavdi dhe Tani Hyjlindësore

Oe Virgjër, je* tendë e hyjshme*²⁰ për Krisht Fjalën Zot,* e vetmja pa cen;* ke mbi engjëjt epërsi në dëlirësi;* i ndyrë jam më shumë se gjithë njerëzit,* plot me mëkate mishore,²¹ pastromë pra,* me rrëke të ndërmjetimeve pranë Birit tënd;* më jep ti përdëllimin e madh,^{1a} o e thjesht'.

ose Kryqhyjlindësore

Shqerra e panjoll'* e Fjalës, Zotit,* Virgjërnëna Zonj'* e pacenuar,* duke parë që po varej mbi kryq ai,* të cilin e lulëzoi pa dhimbje krejt,* siç bëjnë nënat, thërriste me klithmë, vaj:* Mjer', o Biri im, si vuan, se do që të shpëtosh* njeriun nga pasione mjaft të turpshme²² ti.]

Ode IV

Si mu isklís Kírie

Me lutjen tënde vrave një gjarpër të tmerrshëm, dragoin,²³ pasi më parë me pushtet hyjnor dërrmove të gjitha intrigat e të ligut, dhe e dhe për ushqim egërsirash²⁴ dhe shpendësh të çdo lloji, o Elisabetë, duke e lavdëruar Zotin e të gjithave.²⁵

Meqë kishe zili sjelljet e burrave të hyjnueshëm, me fuqi prej Perëndisë përshkove dyzet ditë duke mos marrë asnjë ushqim,^{14,15} por kalove me agjërim duke vrarë me shumë urtësi kryengritjet e mishit dhe duke ngjallur shpirtin, o nënë modeste e hyjfrymëzuar.

Hyjlindësore

Oe tëradmirueshme, vetëm ti mban në mitër Perëndi që mishërohet, atë që u jep të gjithëve ekzistencë, të cilin e dëshiroi me shpirt Elisabeta kur u fejua me të në Shpirt, o Hyjlindëse e virgjër, çudia e engjëjve dhe trauma e demonëve.

Ode V

Ina ti me aposo

Thave rrëketë e mëkatit me derdhjet e lotëve dhe përmes Hirit e ndalove rrjedhën për shumë kohë të gjakrave të grave shpresëtare që të erdhën²⁶ veç e veç, o Elisabetë, oshënare e tërëfamshme.

Për vite me radhë²⁷ refuzove marrjen e bukës, o e lavdëruar, duke pastruar shpresëtarisht shpirtin me mundime vetëpërmbytjeje dhe duke fituar gjendjen pa trup të të patrupëve, o Elisabetë, krenaria e oshënareve.

Meqë i besove Krishtit me çdo mënyrë gjithë mendjen tënde, nga një anë e soditje me sytë e mendjes dhe të zemrës, dhe nga ana tjetër për tre vjet nuk pe qiell, por dhë, si e krijuar prej dheut,²⁸ o e hyjlavdëruar.

Hyjlindësore

Je më superiore nga fuqitë e sipërme, meqë kishe në bark Fjalën e bashkëpafillim dhe të bashkëpërjetshëm të Atit, o Virgjëreshë. E feksur me llamburitjet e tij, hyjprurësja shpërbëri mjegullën e pasioneve.

Ode VI

Ilásthiti' mi Sotír

Mëshirën e Perëndis'* meqë dëshiroje, o e thjeshtë, ta tërhiqje me mund* përmes asketizmit, shmange marrjen e vajit ti,* që fëmijë; gjete* me arritjet, lodhjet, prehje, gaz.

Ekishe jetën shkëlqim,* stolisej përmes virtyteve, dhe vdekja jote me drit'* kish feksur hyjnisht përmes çudish, dhe demonë larg* flaku,¹ dhe shpërndau* dimër vesesh me të shenjtin hir.

Me zhveshjen e mishit tënd* e mundje dhe ngricën, dhe të ftohtët, dhe duroje me forc'* dhe dashje të dje-gurit e diellit; shpresat ti* ngrohtësis'

së lartë* ia mbështetje, nënë plot me lavd.

Hyjlindësore

E pacenuar, në bark* e zure të para-kohshmin dhe kështu e linde në mish* atë që nuk kish trup nga natyra, me qumësht ti* mëndje, o Hyjnënë* pra, ushqyesin e çdo gjëje.

Irmosi: Ilásthítí mi Sotír

»Jan' shum' mëkatet që kam,* ndaj
»le të të vijë keq, o Zot, për mua; lu-
»tem, më nxirr* nga fundi i vrereve,
»sepse thirra fort te ti*^{28a} dhe dëgjomë
»mua,* Perëndia i shpëtimit tim.^{28b}

Kontaqi i së kremtes (ose Martiriku i Triodhit)

Sinaksari

Më 24 të të njëjtit muaj, kujtimi i oshënares Elisabeta çudibërëse.

Vargje: O Fjalë e Perëndisë, Elisabeta, pasi la tokën,/ të sodit si nusja e mirë²⁹ ty dhëndrin e mirë.

Më njëzet e katër, Elisabeta iku për në qiell.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të shenjtë Sava Stratilati.

Vargje: Kur u duk Sava si martir i Krishtit i mbytur në lumë,/ mbyti frymë të frikshme mashtrimi.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirëve të shenjtë, shtatëdhjetë ushtarëve që besuan nëpërmjet Savës të shenjtë dhe mbaruan me shpatë.

Vargje: Nëse do të numërosh kokat që u prenë me shpatë,/ do të gjesh shtatëdhjetë burra të vrarë.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirëve të shenjtë Pasikrati dhe Valentini.

Vargje: Pasikrati, kur u pre, fitoi pushtet,/ duke i nxjerrë Valentinit frikën e shpatës.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirëve të shenjtë Efsevi, Neoni, Leonti, Longini dhe katër të tjerë.

Vargje: Numrin e barasvlefshëm të tetë martirëve,/ tetë herë e presin në mënyrë të barabartë.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i neomartirit të shenjtë rrobaqepës Duka.

Me ndërmjetimet e shenjtorëve të tu, o Krisht Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII

Pedhes Evreon

Fitove mendim perëndidashës, sepse jetove bashkë me engjëj, me agripni të zjarra dhe duke psalur me gati-shmëri: I bekuar je, o Zot Perëndi, në jetë.

Zgjat një dorë ndihmë dhe jepua shëndetin atyre që vrapojnë drejt

lipsanit tënd, dhe i afrohen me besim, o mbështetje e murgeshave, o Elisabetë hyjprurëse.

Duke kryer mrekulli shumë të mëdha, dhe duke u treguar shërbyese e Zotit, o Elisabetë modeste, shkove tani tek ai, duke psalur së bashku me oshënarët: O Perëndi, je i bekuar.

Hyjlindësore

Shih, o Virgjëreshë, trishtimin tim që solli shumica e të këqijave të mia, dhe rrëmbemë nga zjarri i Gjehenës³⁰ mua që thërras: I bekuar është, o e Tërë-dëlirë, fryti i barkut tënd.³¹

Ode VIII

Eptaplasios káminon

Ata që i afrohen kutisë së lipsaneve të tua, marrin besërisht përherë përgjigjen e gjithë kërkesave, sepse të lavdëron dhe të madhështon përherë Perëndia,³² i cili pranoi luftërat e tua të nderuara; atij i thërret pa pushim: O priftërinj bekon, popull përmbilartësoni në gjithë jetët.

Meqenëse ndriçove sytë e zemrës në Shpirt, ia dhe shikimin atij që erdhi me besim te lipsanet e tua, sepse u pasurove nga Krishti me dhënien e pakursyer të shërimeve;¹ atij, o oshënarë, i thërret: O priftërinj bekon, popull përmbilartësoni në gjithë jetët.

Si diell i ndritshëm linde mbi dhé, duke shkëlqyer me virtyte të shenjta, o e tërëthjeshta Elisabetë, dhe duke lëshuar predhat e mrekullive të tua të hyjnueshme; ata që marrin pjesë në to thërrasin: O Djem bekon, priftërinj përhimnoni, popull përmbilartësoni në gjithë jetët.

Hyjlindësore

O Virgjëreshë e pacenuar, e linde trupmbajtës dhe kishe në kraharor Jisunë Zot, që i mban të gjitha³³ me shenjë të tërëfuqishme; prandaj të përhimnojmë si nënë Perëndie, duke thirrur me himnim: O priftërinj bekon, popull përmbilartësoni në gjithë jetët.

Irmosi: Eptaplasios káminon

»**E** dogji furrën shtatë her’* në Kalde
 »një tiran i saj* me mani për Djemtë*
 »që nderonin Perëndin’;*³⁴ por kur të
 »shpëtuar krejt* i pa nga një fuqi më
 »e fort’,* thirri ky kështu:* Po Çlirim-
 »tarin Ndërtues* o Djem, ju e beko-
 »ni,*³⁵ priftërinj, e himnoni,* ju po-
 »pull, lartësoni atë për gjithë jetët.

Ode IX

Éfrikse pasa akoi

Ke aspiruar ta shikosh* pastër bukurin’ mendore të dhëndrit tënd,* ndaj i thërrisje ti* me ngrohtësi: Ku fle

edhe ku kullot?³⁶ Në ty do prehem dhe me hijeshin' tënde gaz do kem,* dhe do dëfrehem fort,* mirësinë tënde do madhështoj unë.

O mrekulli! Si shfaqet qart'* pas varrimit dhe vendosjes për shumë koh'* në varr lipsani yt,* i shtrirë, i paprishur dhe plot me hir,* që shndrit me shenja dhe çudi,³⁷ u jep besimtarëve* përditë rrjedhje pra* me shërime, me bekime dhe shenjtërim.

Kishe në shpirt ti mençuri,* butësi³⁸ të hyjshme, besë pa shtrembërim,* përlulesi, shpresë* dhe dashuri³⁹ hyjnore; qëndroje fort* në agripni me lutje¹³ pranë Zotit tënd Perëndi,* Elisabetë pra,* me shkëlqime prej andej mjaft ndriçoheshe.

Hyllindësore

O Shpëtimtar, kursemë ti,* që u linde dhe e mbajte pa prishje dot* pas lindjes lindësen,* kur do të rrish për gjyqin e punëve*⁴⁰ që bëra, mos m'i vë re ti mëkatet dhe fajet pra* si i përmbimirë,* o i butë, njeridashës, mëshirëplot.

Irmosi: Ëfrikse pasa akoí

»**F**rika ka zënë çdo dëgjim* nga denjimi i pashprehshëm i Zotit Krisht;* »pra, si i Larti krejt* vullnetarisht zbret

»deri në trup, pasi* u bë njeri prej bar- »ku virgjëror dhe pa cen aspak;* pra- »ndaj Hyllindësen* e panjollshme, ne »besnikët e madhërojm'.

*Dhe të tjera të së kremtes
(ose të Triodhit).*

CITIME

¹ Matth. 10.8; I Kor. 12.9,28

^{1a} Num. 14.19 etj.

² Ligji i Dytë 6.5; 10.12; 30.6; Matth. 22.37; Mark. 12.30; Lluk. 10.27

³ Lev. 19.18 etj.; Matth. 22.39 etj.

⁴ I Petr. 4.14

⁵ Gjen. 1.26-27; 5.1; 9.6; Urt. Sol. 2.23; Sirak 17.3

⁶ Matth. 16.24; Mark. 8.34; 10.21; Lluk. 9.23

⁷ Matth. 5.19; Vep. 1.1

⁸ Ps. 106(107).26-30

⁹ Gal. 5.24

¹⁰ I Petr. 2.21

¹¹ I Kor. 6.17

¹² Rom. 8.6-7

¹³ Vep. 1.14; 2.42; Rom. 12.12; Kol. 4.2; I Tim. 5.5

¹⁴ Eks. 34.28; Ligji i Dytë 9.9,18

¹⁵ III [I] Mbret. 19.8

¹⁶ Eks. 16.4; Ps. 77(78).24; 104(105).40; Joan 6.31-32

¹⁷ Ps. 44(45).15

¹⁸ Gjen. 1.7; Is. 40.22

¹⁹ Ef. 2.20.21

²⁰ Eks. 25.8 etj.; Ps. 45(46).5; 131(132).5; Hebr. 9.1-2

²¹ Juda 23

²² Rom. 1.26

- | | |
|---|---|
| ²³ Apok. 12.9 | ³¹ Lluk. 1.42 |
| ²⁴ Ps. 73(74).14 | ³² Ps. 90(91).15 |
| ²⁵ I Kron. 29.11; Urt. Sol. 12.16 | ³³ Hebr. 1.3 |
| ²⁶ Lluk. 8.43-44 | ³⁴ Dan. 3.19 |
| ²⁷ Vep. 18.20 | ³⁵ Dan. 3.31-33 |
| ²⁸ Gjen. 2.7; Jov 10.9 | ³⁶ Kënga 1.7 |
| ^{28a} Jona 2.2 | ³⁷ Eks. 7.3 etj. |
| ^{28b} I Kron. 16.35; Ps. 17(18).47; 50(51).14;
87(88).2 | ³⁸ Gal. 5.22; Ef. 4.2; Kol. 3.12 |
| ²⁹ Kënga 6.1 | ³⁹ I Kor. 13.13 |
| ³⁰ Matth. 5.22; 18.9; Mark. 9.43,45,47 | ⁴⁰ Dan. 7.9-10. Matth. 25.31-46 |



MË 25 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i apostullit dhe ungjillorit të shenjtë Marku.

Tipikon

1. Nëse bie të hënën para së Dielës së Palmave:

Të dielën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 7 të Triodhit dhe 3 (të dytat) të ungjillorit. Lavdi i ungjillorit. Tani Hyjlindësore (sipas Triúmeros anestis Hristé: U denjësove, o Virgjëresh e qashtër dhe e vetmja nën* Perëndie,* për karizma të mëdha,* se linde në mish një prej Trinisë, Krishtin Zotin* që jetë jep pra për shpëtimin ton’). Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i Madh i Triodhit. Pasvargjet: Idhiomeli i Triodhit (2x) dhe Martiriku. Lavdi i ungjillorit. Tani Hyjlindësore (sipas O tu paradhoksu thavmatoes: O hyjnuse virgjëreshë, ki gaz, gaz ki, shpresë për ne,* për besnikët, gëzohu pra,* je për botën ti pastrim,* nga çdo dhimbje, ankth na çliron* ne shërbëtorët e tu, gëzohu Zonj’,* rrëzim i vdekjes, o Vajzë ti gëzo,* Parajs’ që jetë sjell,* ndihmë je për sa të ftojë, ngazëllo,* ki gaz mal i shenjt’,¹⁰ shtëpi hyjnore për Zotin). Përlëshorja e ungjillorit dhe Hyjlindësorja e ditës. Mëshiro, o Zot (40x) etj. të të dielave të Kreshmëve të Mëdha.*

Të hënën në Mëngjesore, pas Perëndi është Zoti, Përlëshorja e ungjillorit (2x) dhe Hyjlindësorja ngjallësore (Ti që ndërmjetove). Ndenjësoret e Triodhit. Menjëherë Psalmi 50 (hima), O Perëndi, shpëtoje popullin tënd dhe bekoje trashëgimin tënd, vështroje. Stihologjia e 9 Odeve. Kanunet: i ungjillorit dhe Triodhet. Pas Odes III, Ndenjësores e apostullit dhe Hyjlindësore (sipas Tahí prokatálave: O Zonjë, prano ti shpejt lutjet që ty të ofrojm’, blatoji këto te Biri yt edhe Perëndia, o e panjollshmja Vajz’;* nga çdo rrezik, nevojë* sa te ti rendin, ngriji,* kurthet dhe arrogancat e armiqve të pafe,* që kundër nesh armatosen, mposhti, e pastër krejt). Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e ungjillorit dhe Sinaksari. Zbritësoret Ja gojën e çel tani. Më të nderuarën. Dërgimësoret e ungjillorit dhe Hyjlindësore: Ti, o kështjell’ e florinjte, me dymbëdhjetë fortesa, o fron i ndritshëm si dielli, ku rri si Mbret i madh Krishti. Ti, o çudi e mahnitshme, si mban e i jep gji Zotit?** *Lavdërimet: Idhiomeli i Triodhit (1x) dhe 3 Lavdërimet e ungjillorit. Lavdi i ungjillorit. Tani O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë, që nxore frytin e jetës; të lypim, ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me apostullin dhe me gjithë shenjtorët, që të mëshirohen shpirtat tanë. Dhoksologjia e*

Madhe. Përlëshorja e apostullit. Mëshiro, o Zot (40x). Lavdi dhe Tani. Më të nderuarën. Beko, o atë. Krishti Perëndia ynë, që është i bekuar. O mbret qiellor, siguroji; dhe menjëherë Orët (e Thjeshta) me Përlëshoren dhe Kontaqin e ungjillorit.

*Në të njëjtën ditë (të hënën) në Mbrëmësore. Thirrtoret: 6 të Triodhit dhe 4 të ungjillorit (të djeshmet, 3 të dytat në 4). Lavdi i ungjillorit. Tani Hyjlindësore: O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë, që nxore frytin e jetës; të lypim, ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me apostullin dhe me gjithë shenjtorët, që të mëshirohen shpirtrat tanë. *Hyrje me Ungjillin. O dritë gazmore. Leximet e Triodhit. Le të drejtohet. Apostulli dhe Ungjilli i ungjillorit. Liturgia e të Parashenjtëruarave. Kungatore: Në gjithë dheun.**

2. Nëse bie të martën para së Dielës së Palmave:

Të hënën në Mbrëmësore. Thirrtoret: 3 të Triodhit dhe 3 (të dytat) të ungjillorit. Lavdi i ungjillorit. Tani (sipas Olin apothémeni: Zonjë me gjakftohtësi rrëshqita keq dhe u bëra* robi i tiranit djall* me mashtrim; përiki i mjeri pra te ti,* Vajzë e Tërëshenjt',* te mëshira jote* e çuditshme shumë dhe te lutja jote fort e ngrohtë*;* më çlirë, Hyjnuse, nga çdo shtrëngim,* nga ngasje, dhe shpëtomë ti* e tërëpacen, nga çdo sulm dhe vrull* satanik, kështu të të falem ty me mallëngjim e shpirt,* të të lëvdoj, të të përhimnoj,* të të madhëroj me zell). O dritë gazmore. *Leximet e Triodhit. Pasvargjet: Idhiomeli i Triodhit (2x) dhe Martiriku. Lavdi i ungjillorit. Tani Hyjlindësore:* O Zonjë, prit lutjet e shërbëtorëve të tu edhe çlirona ne nga çdo nevojë dhe pikëllim. *Përlëshorja e ungjillorit. Hyjlindësorja e ditës. Mëshiro, o Zot (40x) etj. të Triodhit.**

Të martën në Mëngjesore, pas Perëndi është Zoti, Përlëshorja e ungjillorit (2x) dhe Hyjlindësorja ngjallësore (Ti që ndërmjetove). Ndenjësoret e Triodhit. Pas Psalmi 50 (hima), O Perëndi, shpëtoje popullin tënd dhe bekoje trashëgimin tënd, vështroje. Stihologjia e 9 Odeve. Kanunet: i ungjillorit dhe Triodhet. Pas Odes III, Ndenjësores e ungjillorit dhe Hyjlindësore (sipas Tahí prokatálave: O Zonjë, prano ti shpejt lutjet që ty të ofrojm', blatoji këto te Biri yt edhe Perëndia, o e panjollshmja Vajz',* nga çdo rrezik, nevojë* sa te ti rendin ngriji,* kurthet dhe arrogancat e armiqve të pafë,* që kundër nesh armatosen, mposhti, e pastër krejt). *Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e ungjillorit dhe Sinaksari. Zbritësoret Ja gojën e çel tani. Më të nderuarën. Dërgimësoret e ungjillorit dhe Hyjlindësore: Ti, o kështjell' e florinjte, me dymbëdhjetë fortesa, o fron i ndritshëm si dielli, ku rri si Mbret i madh Krishti. Ti, o çudi e mahnitshme, si mban e i jep gjë Zotit?* *Lavdërimet:***

Idhiomeli i Triodhit (1x) dhe 3 Lavdërimet e ungjillorit. Lavdi i ungjillorit. Tani: O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë, që nxore frytin e jetës; të lypim, ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me apostullin dhe me gjithë shenjtorët, që të mëshirohen shpirtrat tanë. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e ungjillorit. Mëshiro, o Zot (40x). Lavdi dhe Tani. Më të nderuarën. Beko, o atë. Krishti Perëndia ynë, që është i bekuar. O mbret qiellor, siguroji; dhe menjëherë Orët (e Thjeshta) me Përlëshoren dhe Kontaqin e ungjillorit.

Në të njëjtën ditë (të martën) në Mbrëmësore. Thirrtoret: Idhiomeli i Pasvargjeve të Triodhit (2x), Martiriku, 3 Thirrtoje po të Triodhit dhe 4 të ungjillorit (të djeshmet, 3 të parat në 4). Lavdi i ungjillorit. Tani Kryqhyjlindësore (sipas Triimeros anestis: Të pa e paqortueshmja, Krisht, kur ishe varur përmbi kryq* dhe thërriste* si nën' me vajtime thell':* O Biri im i ëmbël, o Zoti im, mos e lër* shërbyesen tënde, mos më braktis). Hyrje me Ungjillin. O dritë gazmore. Leximet e Triodhit. Le të drejtohet. Apostulli dhe Ungjilli i ungjillorit. Liturgjia e të Parashenjtëruarave. Kungatore: Në gjithë dheun.*

3. Nëse bie të mërkurën para së Dielës së Palmave:

Të martën në Mbrëmësore. Thirrtoret: 3 të Triodhit dhe 3 (të dytat) të ungjillorit. Lavdi i ungjillorit. Tani Kryqhyjlindësore (sipas Triimeros anestis Hristé: O Krisht, kur të shikonte mbi kryq të kryqëzoheshe ajo* që të lindi,* po thërriste me vajtim* si nën': Fëmija im, Zoti im, Bir fort i ëmbël,* si ti duron pësim të turpshëm pra?). O dritë gazmore. Leximet e Triodhit. Pasvargjet: Idhiomeli i Triodhit (2x) dhe Martiriku. Lavdi i ungjillorit. Tani Kryqhyjlindësore (sipas O tu paradhoksu thávmatos: «O çudi paradoksale krejt, mister i frikshëm, guxim* arrogant!», Vajz' e virgjër tha,* sapo ty të pa ajo,* që pa dhimbje të kish në bark* çuditërisht, midis dy kusarëve* në kryq të varesh. Me lot thërriste k'shtu:* «Mjerë, o Biri im* kaq i dashur, si të ngul mbi dru plot tmerr,* frikshëm, populli i keq, mosmirënjohës shumë'»). Përlëshorja e ungjillorit dhe Hyjlindësorja e ditës. Mëshiro, o Zot (40x) etj. të Triodhit.*

Të mërkurën në Mëngjesore. pas Perëndi është Zoti, Përlëshorja e ungjillorit (2x) dhe Hyjlindësore ngjallësore (Ti që ndërmjetove). Ndenjësoret e Triodhit. Pas Psalmit 50 (hima), O Perëndi, shpëtoje popullin tënd dhe bekoje trashëgimin tënd, vështroje. Stihologjia e 9 Odeve. Kanunet: i ungjillorit dhe Triodhet. Pas Odes III, Ndenjësorja e ungjillorit dhe Hyjlindësore (sipas Tahi prokatálave:

O Zonjë, prano ti shpejt lutjet që ty të ofrojm', * blatoji këto te Biri yt edhe Perëndia, o e panjollshmja Vajz', * nga çdo rrezik, nevojë* sa te ti rendin, ngriji, * kurthet dhe arrogancat e armiqve të pafe, * që kundër nesh armatosen, mposhti, e pastër krejt). *Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e ungjillorit dhe Sinaksari. Zbritësoret* Ja gojën e çel tani. Më të nderuarën. *Dërgimësoret e ungjillorit dhe Hyjlindësore*: Ti, o kështjell' e florinjhtë, me dymbëdhjetë fortesa, o fron i ndritshëm si dielli, ku rri si Mbret i madh Krishti. Ti, o çudi e mahnitshme, si mban e i jep gji Zotit. * *Lavdërimet: Idhiomeli i Triodhit (1x) dhe 3 Lavdërimet e ungjillorit. Lavdi i ungjillorit. Tani*: O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë, që nxore frytin e jetës; të lypim, ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me apostullin dhe me gjithë shenjtorët, që të mëshirohen shpirtrat tanë. *Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e ungjillorit. Mëshiro, o Zot (40x). Lavdi dhe Tani*. Më të nderuarën. Beko, o atë. Krishti Perëndia ynë, që është i bekuar. O mbret qiellor, siguroji; dhe menjëherë Orët (e Thjeshta) me Përlëshoren dhe Kontaqin e ungjillorit.

Në të njëjtën ditë (të mërkurën) në Mbrëmësore. Thirrtoret: Idhiomeli i *Pasvargjeve (2x), Martiriku, 3 Thirrtoreset të Triodhit dhe 3 (të parat) të ungjillorit. Lavdi i ungjillorit. Tani Hyjlindësore (sipas Triúmeros anestis Hristé*: U denjësove, o Virgjëresh' * e qashtë dhe e vetmja nën' * Perëndie, * për karizma të mëdha, * se linde në mish një prej Trinisë, Krishtin Zotin* që jetë jep pra për shpëtimin ton'). *Hyrje me Ungjillin*. O dritë gazmore. *Leximet e Triodhit*. Le të drejtohet. *Apostulli dhe Ungjilli i ungjillorit. Dhe Liturgjia e të Parashenjësuarave. Kungatore*: Në gjithë dheun.

4. Nëse bie të enjten para së Dielës së Palmave:

Të mërkurën në Mbrëmësore. Thirrtoreset: 6 të Triodhit dhe 4 të ungjillorit (3 të dytat në 4). *Lavdi i ungjillorit. Tani (sipas Olin apothémeni*: Zonjë me gjakftohtësi* rrëshqita keq dhe u bëra* robi i tiranit djall* me mashtrim; përiki i mjeri pra te ti, * Vajzë e Tërëshenjt', * te mëshira jote* e çuditshme shumë dhe te lutja jote fort e ngroht', * më çliro, Hyjnuse, nga çdo shtrëngim, * nga ngasje, dhe shpëtomë ti, * e tërëpacen, nga çdo sulm dhe vrull* satanik, kështu të të falem ty me mallëngjim e shpirt, * të të lëvdoj, të të përhimnoj, * të të madhëroj me zell). *Hyrje. O dritë gazmore. Leximet e Triodhit. Le të drejtohet dhe Liturgjia e të Parashenjësuarave.*

Të enjten në Mëngjesore. pas Perëndi është Zoti, Përlëshorja e ungjillorit (2x). Tani ngjallësore (Ti që ndërmjetove). *Ndenjësoreset e Triodhit. Pas Psalmit 50*

(hima), O Perëndi, shpëtoje popullin tënd dhe bekoje trashëgimin tënd, vështroje. *Stihologjia e 9 Odeve. Kanunet: i ungjillorit dhe Triodhet. Pas Odes III, Ndenjë-sorja e ungjillorit dhe Hyjlindësore (sipas Tahî prokatálave: O Zonjë, prano ti shpejt lutjet që ty të ofrojm', * blatoji këto te Biri yt edhe Perëndia, o e panjollshmja Vajz', * nga çdo rrezik, nevojë* sa te ti rendin, ngriji,* kurthet dhe arrogancat e armiqve të pafe,* që kundër nesh armatosen, mposhti, e pastër krejt).* *Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e ungjillorit dhe Sinaksari. Zbritësoret* Ja gojën e çel tani. Më të nderuarën. *Dërgimësoret e ungjillorit dhe Hyjlindësore:* Ti, o kështjell' e floringjtë, me dymbëdhjetë fortesa, o fron i ndritshëm si dielli, ku rri si Mbret i madh Krishti. Ti, o çudi e mahnitshme, si mban e i jep gji Zotit.* *Lavdërimet: Idhiomeli i Triodhit (1x) dhe 3 Lavdërimet e ungjillorit. Lavdi i ungjillorit. Tani O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë, që nxore frytin e jetës; të lypim, ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me apostullin dhe me gjithë shenjtorët, që të mëshirohen shpirtrat tanë. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e ungjillorit. Mëshiro, o Zot (40x). Lavdi dhe Tani. Më të nderuarën. Beko, o atë. Krishti Perëndia ynë, që është i bekuar. O mbret qiellor, siguroji; dhe menjëherë Orët (e Thjeshta) me Përlëshoren dhe Kontaqin e ungjillorit.*

Në të njëjtën ditë (të enjten) në Mbrëmësore. Thirrtores: Idhiomeli i Pasvargjeve (2x), Martiriku, 3 Thirrtores po të Triodhit dhe 4 të ungjillorit (të djeshmet, 3 të parat në 4). Lavdi i ungjillorit (Ejani ta mburrim të gjithë; kërkoje në Pasvargjet e tij, fq. 153). Tani O Zonjë, prit lutjet e shërbëtorëve të tu edhe çlirona ne nga çdo nevojë dhe pikëllim. Hyrje me Ungjillin. O dritë gazmore. Le të drejtohet. Menjëherë Apostulli dhe Ungjilli i ungjillorit (ose Lexim nga Ungjilli i tij: të Mërkurën e Javës së 15-të të Mattheut: Mark. 6.7-13); dhe Liturgjia e të Parashenjësuarave. Kungatore: Në gjithë dheun.

5. Nëse bie të premtën para së Dielës së Palmave:

Të enjten në Mbrëmësore. Thirrtores: 3 të Triodhit dhe 3 (të dytat) të ungjillorit. Lavdi i ungjillorit. Tani Kryqhyjlindësore (sipas Triimeros anestis Hristé: O Krisht, kur të shikonte mbi kryq të kryqëzoheshe ajo* që të lindi,* po thërriste me vajtim* si nën': Fëmija im, Zoti im, Bir fort i ëmbël,* si ti duron pësim të turpshëm pra?). O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e Triodhit. Pasvargjet: Idhiomeli i Triodhit (2x) dhe Martiriku. Lavdi i ungjillorit. Tani Kryqhyjlindësore (sipas O tu paradhoksu thavmatoes: «O habi paradoksale krejt, mister i frikshëm, guxim* arrogant!», Vajz' e virgjër tha,* sapo ty të pa ajo,* që pa dhimbje të kish në bark* çuditërisht, midis*

dy kusarëve* në kryq të varesh. Me lot thërriste k'shtu:* «Mjerë, o Biri im* kaq i dashur, si të ngul mbi dru plot tmerr,* frikshëm, populli i keq, mosmirënjohës shumë'»). *Përlëshorja e ungjillorit. Hyjlindësorja e ditës. Mëshiro, o Zot (40x) etj. të Triodhit.*

Të premten në Mëngjesore. pas Perëndi është Zoti, *Përlëshorja e ungjillorit (2x) dhe Hyjlindësorja ngjallësore* (Ti që ndërmjetove). *Ndenjësoret e Triodhit. Pas Psalmit 50 (hima),* O Perëndi, shpëtoje popullin tënd dhe bekoje trashëgimin tënd, vështroje. *Sthologjia e 9 Odeve. Kanunet: i ungjillorit dhe Triodhet. Pas Odes III, Ndenjësores e ungjillorit dhe Hyjlindësore (sipas Tahi prokatálave:* O Zonjë, prano ti shpejt lutjet që ty të ofrojm', * blatoji këto te Biri yt edhe Perëndia, o e panjollshmja Zonj', * nga çdo rrezik, nevojë* sa te ti rendin, ngriji,* kurthet dhe arrogancat e armiqve të pafe,* që kundër nesh armatosen, mposhti, e pastër krejt). *Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e ungjillorit dhe Sinaksari. Zbritësoret* Ja gojën e çel tani. Më të nderuarën. *Dërgimësoret e ungjillorit dhe Hyjlindësore:* Ti, o kështjell' e florinjte, me dymbëdhjetë fortesa, o fron i ndritshëm si dielli, ku rri si Mbret i madh Krishti. Ti, o çudi e mahnitshme si mban e i jep gjë Zotit.* *Lavdërimet: Idhiomeli i Triodhit (1x) dhe 3 Lavdërimet e ungjillorit. Lavdi i ungjillorit. Tani* O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë, që nxore frytin e jetës; të lypim, ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me apostullin dhe me gjithë shenjtoret, që të mëshirohen shpirtrat tanë. *Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e ungjillorit. Mëshiro, o Zot (40x). Lavdi dhe Tani. Më të nderuarën. Beko, o atë. Krishti Perëndia ynë, që është i bekuar. O mbret qiellor, siguroji; dhe menjëherë Orët (e Thjeshta) me Përlëshoren dhe Kontaqin e ungjillorit.*

Në të njëjtën ditë (të premten) në Mbrëmësore. Thirrtoret: Idhiomeli i Triodhit (2x), të 4 të shën Llazarit dhe 4 të ungjillorit (të djeshmet, 3 të parat në 4). Lavdi i ungjillorit. Tani [Lavdi] i Triodhit. Hyrje me Ungjillin. O dritë gazmore. Leximet e Triodhit. Le të drejtohet. Apostulli dhe Ungjilli i ungjillorit dhe Liturgjia e të Parashenjtëruarave. Kungatore: Në gjithë dheun.

6. Nëse bie që nga e shtuna e Llazarit deri të Hënën e Javës së Ndrishme:

Shërbesa transferohet dhe psalet të Martën e Javës së Ndrishme, sipas § 7.

7. Nëse bie të Martën ose të Mërkurën, ose të Enjten, ose të Shtunën e Ndrishme:

Në Mbrëmësoren (e djeshme), Thirrtoret: 4 ngjallësore dhe 4 të ungjillorit (3 të parat në 4). Lavdi i ungjillorit. Tani i Pentikostarit (Hyjlindësore dogmatike e

Tingullit). Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i Madh. Pasvargjet: i pari ngjallësor dhe 4 të Pashkës (Le të ngrihet Perëndia; Pashka hierore etj.). Lavdi i ungjillorit. Tani Dit' e ngjalljes, Krishti u ngjall (3x). Përlëshoret: Lavdi i ungjillorit, Tani Hyjlindësore ngjallësore (Ti që ndërmjetove). Përlëshim dialogjikisht.

Në Mëngjesore, pas Krishti u ngjall (10x), Përlëshorja e ungjillorit dhe Hyjlindësore ngjallësore (Ti që ndërmjetove). Pas Paqësoreve, menjëherë Kanunet: i Pashkës dhe i ungjillorit. Në fund të çdo Ode, Zbritësorja, Krishti u ngjall (3x), Kur u ngrit dhe Përsëri dhe përsëri etj. Pas Odes III, Ipakoia dhe Kontaqi i Pashkës. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e ungjillorit dhe Sinaksari. Ne që pamë ngjalljen (3x). Kur u ngrit (3x) etj. Në vend të Më të nderuarën, Ode IX e Pashkës [dhe e ungjillorit]. Dërgimësoret: e Pashkës, e ungjillorit dhe përsëri e Pashkës. Lavdërimet: 3 ngjallësore, 3 të ungjillorit dhe 4 të Pashkës (Le të ngrihet Perëndia; Pashka hierore etj.). Lavdi i ungjillorit. Tani Dit' e ngjalljes. Krishti u ngjall (3x).

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Krishti u ngjall. Ipakoia e Pashkës dhe Përlëshorja e ungjillorit. Kontaqi i Pashkës. Sa u pagëzuat. Apostulli i ungjillorit. Ungjilli i ditës. Një engjëll i thërriste; Ndrìçohu, ndrìçohu. Kungatore e Pashkës [dhe Në gjithë dheun]. Përlëshim dialogjikisht.

8. Nëse bie të Premten e Ndrìtshme (Burimi Jetëdhënës):

Të enjten në Mbrëmësore. Thirrtoret: 3 ngjallësore, 3 të Burimit dhe 4 të ungjillorit (3 të parat në 4). Lavdi i ungjillorit. Tani [Lavdi] i Burimit. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i [Madh i] Burimit. Pasvargjet: ngjallësore e para dhe 3 të Burimit. Lavdi i ungjillorit. Tani Dit' e ngjalljes, Krishti u ngjall (3x). Përlëshoret: Lavdi i ungjillorit, Tani i Burimit, Ting. I: Kisha jote, o Hyjlindëse, u tregua Parajsë, duke buruar shërime si lumenj gjithmonë të gjallë; duke ardhur pranë saj besërisht, nxjerrim si nga burimi jetëpranues shëndoshje dhe jetë të përjetshme, sepse te Shpëtimtari Krisht që lindi prej teje, ti ndërmjeton që të shpëtohen shpirtrat tanë. Përlëshim dialogjikisht.

Të premten në Mëngjesore, pas Krishti u ngjall (10x), Përlëshorja e ungjillorit dhe e Burimit. Paqësoret dhe menjëherë Kanunet: i Pashkës, i Burimit (me Varg: E Përmbishenjta Hyjlindëse, shpëtona) dhe i ungjillorit. Në fund të çdo Ode, Zbritësorja e Pashkës, Krishti u ngjall (3x), Kur u ngrit Jisui, dhe Përsëri dhe përsëri etj. Pas Odes III, Kontaqi i Pashkës, i ungjillorit dhe Shtëpia e tij. Ndenjësorja e ungjillorit dhe e Burimit. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Burimit dhe

Sinaksari i ditës dhe i Burimit. Ne që pamë ngjalljen (3x). Kur u ngrit (3x). Në vend të Të meriton, Ode IX e Pashkës, e Burimit dhe e ungjillorit (me Vargjet e tyre, por në Lavdi si dhe Tani, me Madhështimet e Pashkës). Dërgimësoret: e Pashkës, të shenjtit dhe e Burimit. Lavdërimet: 2 ngjallësore, 3 të Burimit, 3 të ungjillorit dhe 4 të Pashkës (Le të ngrihet Perëndia; Pashka hierore etj.). Lavdi i ungjillorit. Tani Dit' e ngjalljes. Krishti u ngjall (3x). Dhe Përlëshoret e ungjillorit dhe e Burimit.

Në Liturgji. Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Krishti u ngjall. Ipakoia e Pashkës dhe Përlëshorja e Burimit dhe e ungjillorit. Kontaqi: i Burimit dhe i Pashkës. Sa u pagëzuat. Apostulli i ditës dhe Ungjilli i ungjillorit. Një engjëlli i thërriste; Ndriçohu, ndriçohu. Kungatore e Pashkës [dhe Në kujtim të përvetshëm]. Përlëshim dialogjikisht.

9. Nëse bie të Dielën e Thomait:

Të shtunën në Mbrëmësore. Thirrtoret: 6 të Thomait dhe 4 të ungjillorit (3 të parat në 4). Lavdi i ungjillorit. Tani i Thomait. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Pasvargjet e Thomait. Lavdi i ungjillorit. Tani i Thomait. Përlëshoret: e Thomait, e ungjillorit dhe përsëri e Thomait.

Të dielën në shërbesën e Mesnatës, pas Psalmi 50 dhe Kanunit Triadik, Litia e Thomait. Himne Triadike. Trishenjtë. Përlëshorja e Thomait. Në Mëngjesore. Ndenjësoret e Thomait. (Nuk psalen Bekimtoret). Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV dhe Proqimeni i Thomait. Kanunet: i Thomait dhe i ungjillorit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e ungjillorit. Ndenjësorja e ungjillorit dhe një Pas-kremtore e Thomait. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Thomait. Sinaksari i ditës dhe i Thomait. Zbritësoret e Pashkës; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Në vend të Më të nderuarën, Ode IX e Kanuneve. Dërgimësoret: I shenjtë është Zoti (2x). Lartësoni Zotin; e para e Thomait, e ungjillorit dhe e dyta e Thomait. Lavdërimet: 3 të Thomait dhe 3 të ungjillorit. Lavdi i ungjillorit. Tani i Thomait. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e Thomait.

Në Liturgji. Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e Thomait dhe e ungjillorit. Kontaqi i Thomait. Apostulli i ungjillorit dhe Ungjilli i Thomait. Në vend të Të meriton, Irmosi i Odes IX i Thomait (Ti llambadhen e shkëlqyer). Kungatorja e Thomait [dhe Në gjithë dheun]. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.

10. Nëse bie të hënën e Thomait:

Të dielën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 2 të Pentikostarit dhe 6 të ungjillorit. Lavdi i ungjillorit. Tani i Pentikostarit. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni [i Madh] i Pentikostarit. Pasvargjet e ungjillorit. Lavdi i ungjillorit. Tani i Thomait (Lavdi i Litisë së Thomait, Ting. Tërth. IV). Përlëshoret: e ungjillorit dhe e Thomait.

Të hënën në Mëngjesore, Kanunet: i Thomait dhe i ungjillorit. Pas Odes III, Ndenjësoret e ungjillorit dhe një e Thomait. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e ungjillorit dhe Sinaksari. Zbritësoret e Pashkës. Më të nderuarën. Dërgimësoret: e ungjillorit dhe një e Thomait. Lavdërimet e ungjillorit. Lavdi i ungjillorit. Tani i Thomait. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e ungjillorit.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e Thomait, e ungjillorit dhe e kishës. Kontaqi i Thomait. Apostulli dhe Ungjilli i ungjillorit. Të meriton. Kungatore: Në gjithë dheun. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.

11. Nëse bie të martën ose të mërkurën, ose të enjten, ose të premten e Thomait:

Shërbesat bëhen si më lart (§10), por në Mbrëmësore thuhet Kathizma (e zakonshme) e Psaltirit, si dhe në Thirrtores, vetëm 6 të ungjillorit.

12. Nëse bie të shtunën (d.m.th. në Mbylljen) e Thomait:

Të premten në Mbrëmësore, Thirrtoret: 3 të Thomait dhe 3 të ungjillorit. Lavdi i ungjillorit. Tani i Thomait. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Pasvargjet: 3 (Idhiomele) të Thomait. Lavdi i ungjillorit. Tani i Thomait. Përlëshoret: e Thomait, e ungjillorit dhe përsëri e Thomait.

Të shtunën në Mëngjesore, Kanunet: i Thomait dhe i ungjillorit. Pas Odes III, Kontaqi i Thomait, Ndenjësoret e ungjillorit dhe një e Thomait. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e ungjillorit dhe Sinaksari. Zbritësoret e Pashkës. Në vend të Më të nderuarën, Ode IX e Thomait dhe e ungjillorit. Dërgimësoret: e para e Thomait, e ungjillorit dhe e dyta e Thomait. Lavdërimet: 3 të Thomait dhe 3 të ungjillorit. Lavdi i ungjillorit. Tani i Thomait. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e Thomait.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e Thomait, e ungjillorit dhe e kishës. Kontaqi i Thomait. Apostulli dhe Ungjilli i

ungjillorit. Në vend të Të meriton, *Irmosi i Odes IX i Thomait* (Ti llambadhen e shkëlqyer). *Kungatore e Thomait* [dhe Në gjithë dheun]. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.

13. Nëse bie të Dielën e Miropurëseve ose të të Paralizuarit:

Të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 4 ngjallësore, 3 të së kremtes dhe 3 të ungjillorit. Lavdi i së kremtes. Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Pasvargjet: ngjallësore e parë dhe të Pashkës (Le të ngrihet Perëndia; Pashka hierore etj.). Lavdi i ungjillorit. Tani [Lavdi] i së kremtes. Përlëshoret: a) të Dielën e Miropurëseve: Kur zbritë te vdekja; Bujari Josif. Lavdi i ungjillorit, Tani Grave miropurëse; b) të Dielën e të Paralizuarit: ngjallësore, Lavdi i ungjillorit, Tani Hyjlindësore ngjallësore (Ti që ndërmjetove).

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50 dhe Kanunit Triadik, Litia e Miropurëseve ose e të Paralizuarit (në rastin e të Paralizuarit: Tropari i parë i Litisë së kishës, Lavdi dhe Tani i të Paralizuarit). Himnet Triadike. Trishenjtë dhe Përlëshorja: a) të Dielën e Miropurëseve, Bujari Josif; b) të Dielën e të Paralizuarit, e ungjillorit. Në Mëngjesore, Kanuni i Pashkës dhe i ungjillorit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e ungjillorit dhe Ndenjësores: a) të Dielën e Miropurëseve: Ndenjësoerja e parë e Miropurëseve, Ndenjësoerja e parë e ungjillorit dhe Ndenjësoerja e dytë e Miropurëseve; b) të Dielën e të Paralizuarit: Ndenjësoerja e parë e ungjillorit dhe të të Paralizuarit. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e së kremtes. Sinaksari i ditës dhe i Pentikostarit. Zbritësoret e Pashkës dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Në vend të Më të nderuarën, Ode IX e Kanuneve. Dërgimësoret: e Pashkës, e ungjillorit dhe e së kremtes. Lavdërimet: 4 ngjallësore, 4 të ungjillorit dhe të Pashkës (Le të ngrihet; Pashka hierore etj.). Lavdi i së kremtes. Tani Dit' e ngjalljes. Dhoksologjia e Madhe. Sot erdhi.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret e së kremtes [a) të Dielën e Miropurëseve: Kur zbritë te vdekja; Bujari Josif; Grave miropurëse; b) të Dielën e të Paralizuarit: Le të dëfrejnë qielloret], e ungjillorit dhe e kishës. Kontaqi i Pashkës. Apostulli i ungjillorit dhe Ungjilli i së kremtes. Në vend të Të meriton, *Irmosi i Odes IX*. *Kungatore e Pashkës* [dhe Në gjithë dheun]. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.

14. Nëse bie të hënën ose të martën, ose të mërkurën, ose të enjten, ose të premten pas së Dielës së Miropurëseve:

Në Mbrëmësore. Thirrtoret: 3 të Miropurëseve dhe 3 të ungjillorit. Lavdi i ungjillorit. Tani i Miropurëseve. [Të dielën në Mbrëmësore bëhet Hyrje dhe psalet Proqimeni i Madh. Në ditët e tjera nuk bëhet Hyrje dhe psalet Proqimeni i ditës]. Pasvargjet dhe Lavdi, të ungjillorit. Tani i Miropurëseve. Përlëshoret: Bujari Josif; Kur zbritë te vdekja; e ungjillorit dhe Grave miropurëse.

Në Mëngjesore. Kanunet: i Miropurëseve dhe i ungjillorit. Pas Odes III, Ndenjësoret: e ungjillorit dhe të Miropurëseve. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e ungjillorit dhe Sinaksari. Zbritësoret e Pashkës. Më të nderuarën. Dërgimësoret: e ungjillorit dhe e Miropurëseve. Lavdërimet: e ungjillorit. Lavdi i ungjillorit. Tani i Miropurëseve. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja Grave Miropurëse.

Në Liturgji. Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: të 3 të Miropurëseve, e ungjillorit dhe e kishës. Kontaqi i Miropurëseve. Apostulli dhe Ungjilli i ungjillorit. Të meriton. Kungatore: Në gjithë dheun. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.

15. Nëse bie të shtunën (d.m.th. në Mbylljen) e Miropurëseve:

Në Mbrëmësore. Thirrtoret: 3 të Miropurëseve dhe 3 të ungjillorit. Lavdi i ungjillorit. Tani [Lavdi] i Miropurëseve. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Pasvargjet: ngjallësore (Paskremtore e para) dhe të ungjillorit. Lavdi i ungjillorit. Tani [Lavdi] i Miropurëseve. Përlëshoret: Bujari Josif; Kur zbritë te vdekja, Lavdi i ungjillorit, Tani Grave miropurëse.

Në Mëngjesore. Kanunet: i Miropurëseve dhe i ungjillorit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e Miropurëseve. Ndenjësoret: e ungjillorit dhe të Miropurëseve. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e ungjillorit dhe Sinaksari. Zbritësoret e Pashkës. Më të nderuarën. Dërgimësoret: e ungjillorit dhe e Miropurëseve. Lavdërimet: 3 ngjallësore (Paskremtore) dhe 3 të ungjillorit. Lavdi i ungjillorit. Tani [Lavdi] i Miropurëseve. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e ungjillorit.

Në Liturgji. Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: Bujari Josif; Kur zbritë te vdekja; Grave miropurëse, e ungjillorit dhe e kishës. Kontaqi i Miropurëseve. Apostulli dhe Ungjilli i ungjillorit. Të meriton. Kungatore: Në gjithë dheun. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.



NË MBRËMËSORE

Thirrto

Ting. I Ton uranion tagmaton

Me dinjitet ta himnojmë, besnikë, mbrojtësin* e Kishës së Egjiptit,* që ka shkruar fjalime* mjaft hyjnore, t'i thërrasim: O Mark,* me mësimet, i urtë, dhe* me ndërmjetimin tënd gjithë ne na drejto* në të qetën jetë, pa vorbull.

Bashkudhëtari¹ i enës së zgjedhur² ishe ti* dhe tok me të përshkove* mbarë Maqedoninë;* kur në Romë vajte, shpjegues ti* fort i ëmbël i Petros³ shenjti* u shfaqe, dhe në Egjipt, si garove drejt* sipas Zotit, fjete, Mark i urt'.

I plehërova ti shpirtrat e djegur dhe pa fryt,* me shndritjet e Ungjillit,* që të dendura binin* si bor' e dobishme, ndaj tok me ne* plot gaz Aleksandria sot* bën panair për kujtimin tënd dhe të mburr,* dhe i falet, Mark, lipsanit tënd.

Të tjera

Ting. i njëjtë Panëfimi märtires

E pive përroin me shijim,*⁴ o i tërë-lumi Mark,* dhe nga Edeni sulmove

si një lumë⁵ famëmadh* paqeje, dhe mbushje* përmes rrjedhjeve të predikimit ungjillor faqen e mbar' dheut⁶ dhe vaditje krejt* tërësit' e Kishës sonë ti* plot me dogma të hyjfrymëzuara.

Dikur Moisiu mu në det,* o Mark i kënduar fort* dhe i tërurtë, egjiptianët zhyti,⁷ ndërsa ti* që nga oqeani* gjënjeshhtar i ngrite lart me forcën e atij që me mish u erdhi;⁸ dhe me krah të lart'*⁹ punët që me dorë vetë bën',* pra statujat, i rrafshoi Zoti Krisht.

Meqë, o shën Mark, i hyjshëm je,* merrje pjesë në ndriçim* nga Shenjti Shpirt, ndaj u bëre shpirtëror¹⁰ i tëri ti,* o i gjithëpasur;* dhe tani i kthyer je pa epje drejt Hyjnisë dhe me shkëlqimet fort të lumura* hyjnizohesh përmes Hirit pra,* gjen përmbushjen e misterit me përball.

Lavdi Ting. Tërth. II

Uderdh hiri në buzët e tua,¹¹ o Mark apostull, dhe je bërë barí i Kishës së Krishtit, duke i mësuar dhentë e lo-gjikshëm¹² që të besojnë në Trininë e bashkëqenshme në një Hyjni.

Tani

I së kremtes

[Nëse bie brenda Triodhit:

Tani *Hyjlindësore*

Cili s'do të të lumërojë, o Hyjlindëse Virgjëreshë? Cili s'do të përhimnojë lindjen tënde të kulluar? Se biri yt i vetëmlindur që shkëlqeu prej Atit¹³ pa mot, gjith' ai lindi prej teje së pastres i mishëruar pa tregim; duke qenë prej natyre Perëndi dhe duke u bërë për ne njeri prej natyre, i pandarë në dy fytyra, por i njohur me dy natyra pa përzier. Atij lutju, o Zonj' e lumur, të mëshirohen shpirtrat tanë.*]

Pasvargje

Ting. I Panëfimi mártires

Ihyjurti Mark, u bërë ti* pendë shkruesi të urt',*³ të shpejtë,¹⁴ duke e shkruar me hyjfrymëzim nga lart* si u mishërua* Krishti, dhe me forcë duke thënë fjalë jete¹⁵ të pambarim; me përgjërimin tënd* lyp të shkruhen në të¹⁶ sa himnojn'* dhe nderojn' kujtimin tënd që ka lavdi.

Varg: Në gjithë dheun doli zëri i tij dhe në skajet e botës fjalët e tij.

OMark fort i famshëm, Krishtin tënd* e ungjillëzove ti,* përshkove pra kozmosin si diell¹⁷ dhe me rrezatim* prej besimit tonë* zhduke çdo terr edhe çdo vërshim politeizmi; kështu tani lyp, përgjëroju ti,* t'u dhurohet përdëllim i madh*^{17a} edhe paqe shpirtave prej Zotit tënd.

Varg: Qiejt tregojnë lavdi Perëndie.

Të gjithë sa kishin marrëzi* pabesie pa kufi*¹⁸ më parë, u predikove dhe dëbove me shkëlqim* të fjalimit tënd ti* errësirën e egjiptianëve,¹⁹ apostull hyjpredikues dhe i pasur fort;* lyp tani për shpirtrat tanë pra* t'u dhurohet përdëllim i madh,^{17a} paqe.

Lavdi *Ting. Tërth. IV*

Ejani ta mburrim të gjithë me psalme dhe himne²⁰ Markun, predikuesin e mistagogjisë qiellore dhe hyjfolësin e Ungjillit; sepse ai u dallua si lumi i Parajsës⁵ mendore, duke ujitur arat shpirtërore me shira qiellore dhe duke i shfaqur frytdhënëse për Krishtin Perëndinë, i cili u jep të gjithëve, me ndërmjetimet e tij, faljen dhe përdëllimin e madh.^{17a}

Tani

I së kremtes

[Nëse bie brenda Triodhit:

Tani *Hyjlindësore*

Virgjëresh' e panusëruar, që zure trupërisht Perëndinë pa tregim; nën' e Perëndisë së lartë, prit lutjet e shërbëtorëve të tu, o e gjithëpanjollëshme; ti që u fal të gjithëve paqësim mëkatesh; prit lutjet tona tani dhe lutju që të shpëtohen shpirtrat tanë.*]

Përlëshore

Ting. III

O apostull i shenjt' dhe ungjillor Mark, lutju Zotit ton' Jisu Krisht, t'u falë shpirttrave tanë ndjesën e mëkateve.*

Lavdi *dhe* Tani

I së kremtes

[Nëse bie brenda Triodhit:

Lavdi *dhe* Tani *Hyjlindësore*

Ti që ndërmjetove për shpëtimin e gjindjes son', të përhimnojme, o Hyjlindëse Virgjëreshë, se duke denjuar pësimin e Kryqit me trupin që mori prej teje Biri yt dhe Perëndia ynë, na çliroi prej prishjes si njeridashës.*]



NË MËNGJESORE

Kanunet: i së kremtes me Irmoset në 8 dhe i ungjillorit në 6.

Kanuni i ungjillorit

Poezi (me sa duket) e Theofanit

Ting. I

Ode I

Su i tropeuhos dheksiá

Markun hyjshikues e lëvdoj,* kërktoj, lyp Hirin e Shpirtit për frymëzim,* që të më dëbojë përmes dritës larg*

panjohuri; dhe pasuri* fort të hyjshme të urtësisë²¹ të më dhurojë ky.

Me ndriçim të Hirit shndrite fort,* o Shpëtimtar, Fjala e Perëndisë Zot,* folësin e hyjshëm, sepse je shkaktar* i çdo të mire dhe në bot'* e dërgove të na ungjillëzonte pranin' tënde.

Ke mësuar prej Petros së urt',* prej tij pra si pasuri more birësim,*³ dhe kështu u shfaqe udhëzues, Mark* i famshëm, i mistereve* që ka Krishti, dhe bashk'trashëgimtar i lavdis' së tij.

Hyjlindësore

Mbi një re të virgjër krejt u ul*²² ai që ka mbytur egjiptianët thell'* brenda detit,⁷ dhe u erdhi përsëri* egjiptianëve,⁸ edhe* përmes Markut, nga çdo mashtrim dhe kurth i çliroi ky.

Ode III

O monos idhós

Shërbyesi yt, Marku, o Krisht,* të predikoi urtësi*²³ enipostate duke shkëlqyer fort* nga llamburitjet e tua; shpa-lli pra,* o Zot, se u shfaq ajo* nëpër botë dhe u jep* jetë²⁴ edhe ndriçim gjithë njerëzve.

Kur priti rrëkenë e urtis'* që rrjedh gjithnjë, i mbushi plot* si lum i bujshëm anët e kozmosit* me drit' hyj-dijeje Marku; shfaq i se* është e vër-

tetë krejt* parathënia, meqë ish* dëshmitar okular, njeridashës Zot.

Pas Petros, i urtë, shkoje ti,*³ formë pra Ungjillin tënd* me urtësi si nxënës i tij, sepse* ti dritë thelogjie korre plot,* more edhe shpalle pra,* fort me zë të lart' prani* Perëndie në mish, o apostull Mark.

Hyjlindësore

I hipur më parë në pëqi* të virgjër, tunde çdo altar* demoniak në dhen' e Egjiptit ti,*⁸ por e dërgove pastaj apostullin* Mark, t'i urtësonte, Krisht,* të gjith' me misterin tënd* të hyjnueshëm, të mishërimit tënd.

[Irmosi: O monos idhós

»**I** vetmi që dobësinë njeh* të thelbit
»njerëzor, o Krisht,* dhe dhembshu-
»risht e more si formë ti,* më ngjesh
»me forcë nga lart²⁵ që të thërras:*
»Je i shenjtë, Perëndi,* Zoti i lavdisë
»je,*²⁶ mirësi që nuk imagjinohet dot.]

Kontaqi i së kremtes

Ndenjësoret

Ting. I Ton tefon su Sotir

U ngjit në lartësi* të virtyteve, Marku,* i hyjshmi, dhe lëçiti me zë bullimash* misteret madhështore,

dogma, të cilat dhurojn' shpëtim,* predikuesi* hyjnor; ndaj lypim me besë:* O i tërëlum,* nga çdo ngushtim në rreziqe* dhe faje çlirona ne.

Lavdi

Ting. IV Epefanis símeron

Si një yll të madh të ka,* o i lavdishëm,* Kisha, ndaj po ngazëllon* me hijeshi prej rrezeve* të mësimdhënies që dhe; thërret:* Ki gaz, apostull i lumur i Zotit Krisht.

Tani I së kremtes

[Nëse bie brenda Triodhit:

Tani Hyjlindësore

O Perëndilindëse,* të përhimnoj-më,* se ke lindur Zotin Krisht,* që na shpëtoi nga çdo faj* edhe na ngriti te qielli* me shoqërinë* e engjëjve të patrup.]

Ode IV

Oros se ti háríti

O i urtë, në tërë dheun doli zëri yt, dhe me forcë në skajet e botës fuqia e fjalëve, duke shpallur si Davidi²⁷ shpëtimin dhe rigatimin tonë.

Apostulli i urtë shkëlqeu si rrufe në rruzull,²⁸ o Shpëtimtar, duke ungjillëzuar harenë e së vërtetës i shndritur

nga dritëderdhja që llamburit perëndishëm, për shpëtimin dhe rigatimin tonë.

Këmbët e tua u zbukuruan profetkisht, o i hyjzënë, sepse na ungjillëzove hapur paqen²⁹ përmbi mendim, e cila u shfaq përmes mishit³⁰ nëpër anët e dheut për shpëtimin dhe rigatimin tonë.

Hyjlindësore

Nga dhembshuria Fjala, hipur në re²² virgjërore, pasi i marrosi mendimet dhe vendimet hyjluftuese të egjiptianëve, i prishi me anën e mësimdhënieve të Markut të hyjnueshëm për shpëtimin dhe rigatimin tonë.

Ode V

O fotisas ti elampsi

Pikove ëmbëlsi shpresëtarie me fjalën tënde, pasi u shfaqe qartas nëpërmjet Hirit të Diellit mendor, si mal³¹ i hyjshëm që ndriçoheshe me rreze nga çdo anë, o Mark i hyjzënë e i tërëlmur.

Dole nga shtëpia e Zotit si burim dhe zemrat e djerra i vadit bollshëm me rrymat e Shpirtit, duke i mësuar të sjellin fryt³² në vend të pafrytshmërisë, o apostull.

Ti u bëre bir i Petros³ së madh dhe, duke feksur përgjithmonë nga mësim-

dhëniet e tij, ndriçove shpirtat e atyre që me ty komuniknin, o Mark, apostull i Zotit.

Hyjlindësore

U shfaqe tek egjiptianët, pasi linde nga një Virgjëreshë si njeri, o Krisht,⁸ ti që shkëlqeve para krijimit prej Atit;³³ për hir të tyre e krezmove Markun, që i udhëzonte urtësisht duke u mësuar mistere me njohje hyjnore.

Ode VI

Ekiklosen imás

Vithise vetullën e të paudhëve,* o Zot,³⁴ e poshtërove keq* arrogancën³⁵ egoiste, meqë ti* shfaqe* triumfues Mark apostullin* me forcën tënde, rimëkëmbja je për të dobëtit.

Eshpalle Bërësin e Gjithësisë ti* me fjalë, o shën Mark me lavd,* si kurorë shprese, ndaj e kemi ne* rrethin* përmbi kokë për lavdi tani,* ky u gatua në natyrën e trupit si njeri.

Të udhëzoi në mistere qartësisht* shën Petro Korifeu³ pra,* që të shkruash drejt Ungjillin tër'hyjnor,* pasi* të tregoi shërbëtor Hiri,* se na përhape, o i famshmi ti, drit' hydjijeje.

Hyjlindësore

Kur foshnjë dole nga Hyjnëna virgjëresh',* Egjiptin që më parë ish*

brenda territ, e ndriçove krejt, o Zot,*⁸ pasi* i përdhose perëndit' e tij,*³⁶ o njeridashës, me mësimet e Markut hyjfolës.

[Irmosi: Ekiklosen imás

»Avusha më e fundme na rrethoi³⁷
»keq,* dhe nuk ka çlirimtar³⁸ askund,*
»na menduan dele ne për therje³⁹ pra,*
»o Zot,* Perëndi, shpëtoje popullin*
»që ke,⁴⁰ se forcë, rimëkëmbje je për
»të dobëtitt.]

Kontaqi

Ting. II Ta ano zitón

Apostull shën Mark* me nam dhe i kënduar je,* si more nga lart* të shenjtin Hir nga Shpirti Zot,* i shpërbëre thurjet e oratorëve dhe rrjetove mir'* gjithë kombet, i solle tok* te Zoti, kur shpalle fort Ungjillin hyjnor.

Shtëpia

Përderisa ishte nxënës i korifeut të apostujve³ dhe së bashku me të predikove Bir Perëndie, Krishtin, i sigurove mbi gurin⁴¹ e së vërtetës ata që lëkundeshin nga mashtrimi; në të, pasi të më sigurosh edhe mua, drejtoji hapat⁴² e shpirtit tim, që, duke u çli-ruar nga kurthet e armikut, të të la-
vdëroj pa pengesë; sepse të gjithë

i ndriçove, o Mark i urtë, kur shpalle fort Ungjillin hyjnor.

Sinaksari

Më 25 të të njëjtit muaj, kujtimi i apostullit dhe ungjillorit të shenjtë Mark.

Vargje: Kur zvarrisnin përdhé Markun vrasësit e ndyrë,/ nuk e dinin se po e dërgonin atë në qiej.

Më njëzet e pesë, të çmendur e tërhiqnin përtokë Markun.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i Përrurimit të kishës së nderuar të korifeut të apostujve, shën Petros të tërëfamshëm, e cila është pranë Kishës së Madhe fort të shenjtë.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë ndër shenjtorë Makedhoni, patriark i Konstandinopojës.

Vargje: Pasi u largove, o Makedhon, nga froni i prishshëm,/ himnon Hyjninë bashkë me Serafimet⁴³ dhe Fro-net.⁴⁴

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martires së shenjtë Niqi.

Vargje: Ai që akordon çmime fitoreje,/ i jep Niqit të prerë çmime fitoreje si fitimtare.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i tetë shenjtorëve oshënarë-martirë dhe anakoretë.

Vargje: Presin së bashku qafat e tetë burrave,/ që u zbutën nën zgjedhën tënde, o Fjalë.⁴⁵

Me ndërmjetimet e shenjtoreve të tu, o Krisht Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII

Se noitín Theotoke

I ndezur prej shkëlqimeve hyjnore, dërgon reciprokisht e mistikisht reflektime vezullimesh, o Mark i tërëlumur; sepse predikove Fjalë të mishëruar,⁴⁶ Perëndinë pa mish, të himnueshëm dhe të përmbilavdishëm të etërve.⁴⁷

O Gjithëbërës, pasi armatose nxënësin hyjfolës me fuqi hyjbërëse, e bëre këtë çudibërës; sepse largoi sëmundje dhe shëroi lëngata,⁴⁸ duke të predikuar ty, Perëndinë e himnueshëm dhe të përmbilavdishëm.

Meqë kishe si udhëheqës kryetar in e korit të nxënësve, Petron³ e hyjnueshëm, u dallove imituesi i tij,⁴⁹ sepse sistemeve gjithë tërësinë e Kishës, duke predikuar Perëndinë e himnueshëm të etërve,⁴⁷ o i lavdëruar.

Hyjlindësore

Ti vetë ngrite përmendore në Egjipt, shkrimin e Ungjillit tënd, për të lindurin nga Hyjnëna pa mbjellje, duke

shkuar pas thënieve të Isaia⁵⁰ o i tërëfamshëm, duke njoftuar Perëndinë e himnueshëm dhe të përmbilavdishëm.

Ode VIII

En kamino pedhes

E predikove, o i lavdëruar, Krishtin, Fjalën që lindi prej Atit para tërë jetëve, që veshi natyrën e njerëzve; dhe thërrisje: Gjithë veprat, bekojeni Zotin dhe përmbilartësojeni në gjithë jetët.⁵¹

E mburre, o i lavdëruar, Krishtin që dha veten si shpërblës⁵² të mëkatit tonë, dhe ringriti të rënët; dhe thërrisje: Gjithë veprat, bekojeni Zotin dhe përmbilartësojeni në gjithë jetët.⁵¹

Duke iu bindur mësimdhënies së Petros, o Mark³ i urtë, Ungjillin e nderuar ua hartove me germa tërë urtësi besimtarëve, që thërrasin: Gjithë veprat, bekojeni Zotin dhe përmbilartësojeni në gjithë jetët.⁵¹

Hyjlindësore

Virgjëresha, duke mbajtur Emanuelin si foshnjë, mbërriti tek egjiptianët.⁸ Iu dërgua atyre si yll fort ndriçues Marku, duke thirrur: Gjithë veprat, bekojeni Zotin dhe përmbilartësojeni në gjithë jetët.⁵¹

[Irmosi: En kamino pedhes

»Në furrë Djemtë e Izraelit⁵³ si në
»shkritore shkëlqenin me bukurinë e
»shpresëtarisë më shumë se ari,⁵⁴
»duke thënë: Gjithë veprat e Zotit, be-
»kojeni Zotin dhe përmbilartësojeni
»në gjithë jetët.^{51]}

Ode IX

Tipon tis agnís lohias su

Meqë* në burimin e pacen* plot drit'
tridiellore shkove, hyjshfaqës Mark,*
më dëlirësisht* dhe më fuqishëm shi-
jon me gaz* hyjnizim përmbi mendje
si dhe kërcen* bashkë me engjëj
gjithnjë* dhe pa pushim, fort i hyjnue-
shëm.

Meqë* pjesëmarrës në mësim,*
në predikim të shenjt' të Petros u bë-
re ti,*³ shëtit dhe lëviz* me të në te-
ndat në qiell lart,* o i lumi hyjfolës,
dhe tok me të* po ndërmjeton për
gjith' ne,* o Mark apostull, ungjillor
me nam.

Dritën* e trefisht' që bëhet një* dhe
në mënyr' unike ndahet sërish dhe
shtang,* mbushur me besim e predi-
kove, i urti Mark,* duke feksur prej
lavdit të Shenjtit Hir,* ndaj ty gjithnjë
të lypim:* Përherë përgjëroju ti për
ne.

Hyjlindësore

Erdhi* tek egjiptianët pra* si fo-
shnjë,⁸ kur mish mori Zoti i lavdit
Krisht*⁵⁵ nga një virgjëresh'* hyjnën'
e pastër, ndërsa u dha* hierark si dhu-
ratë, apostulli,* Marku i respektuar*
nga Zoti, që himnojmë madhërisht.

[Irmosi: Tipon tis agnís lohias su

»Barrën* tënde të kulluar ja* si tip
»e dha një ferr' e zjarrtë që s'digjej
»dot;*⁵⁶ kërkojmë tani* të shuash
»furrën e ngasjeve,* se ajo egërsohet
»keq kundër nesh,* që të të madhë-
»shtojmë* gjithmonë pa pushim, Hyj-
»lindëse.]

Dërgimësore

Fos analioton Loje

Upasurove me hirin* e birësimit prej
Petros*³ apostull, ndaj je i pari* që e
hartove Ungjillin,* o shën Mark, për
egjiptianët, kështu ndriçon ti* dhe
botën mbarë përmes tij.

Dhe e së kremtes

[Nëse bie brenda Triodhit:

Hyjlindësore

Ti, o kështjell' e florinjte, me dymbë-
dhjetë fortesa, o fron i ndritshëm si

dielli, ku rri si mbret i madh Krishti; ti, o çudi e mahnitshme, si mban dhe i jep gjë Zotit?*

Lavdërime

Ting. I Panëfimi märtires

Të mburret prej nesh ndriçuesi* i Egjiptit që shkëlqen,* dhe predikues i Fjalës, i tërurti famëmadh,* shkruesi i hyjshëm* i Ungjillit, Marku të lëvdohet përmes këngësh e melodish të shenjta; ndërmjeton* pranë Krishtit t'u dhurohet hir,* përdëllim i madh^{17a} dhe paqe shpirtave.

Ndriçove fort tërë dheun, Mark,* si u bërë shkruesi* që shkrove dogmat hyjnore të Jisuit, o shenjtor,* ngjalljen e nderuar,* ngjitjen për tek Ati dhe më parë mishërimin, pësimet e atij të hyjshme mjaft* dhe, i tërurtë, kështu tërheq* kombet për në dijen e vërtetë⁵⁷ pra.

Apostull i Zotit tonë, Mark,* kishe qen' pasuesi* i bindur pas Petros,³ pra pasi e shfaqë bindjen ti* te doktrina e tij,* i shkëlqeve popujt, e ndriçove mendjen e egjiptianëve me Hir nga Shenjti Shpirt,* gjithashtu e zbu-kurove krejt* dhe qytetin e atyre me stoli.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

Uderdh hiri në buzët e tua,¹¹ o Mark apostull, dhe je bërë barí i Kishës së Krishtit, duke i mësuar dhentë e logjikshëm që të besojnë në Trininë e bashkëqenshme në një Hyjni.

Tani *I së kremtes*

[*Nëse bie brenda Triodhit:*

Lavdi *Hyjlindësore*

O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë,⁵⁸ që nxore frytin e jetës; të lypim, ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me apostullin dhe me gjithë shenjtorët, që të mëshirohen shpirtat tanë.]

Në Liturgji, Apostulli dhe Ungjilli i tij [ose Ungjilli nga vetë Ungjilli i tij: E mërkura e javës së 15-të të Mattheut (Mark. 6.7-13)]. Kungatore: Në gjithë dheun.

CITIME

¹ Vep. 12.25; Kol. 4.10; II Tim. 4.11; Fil. 24

² Vep. 9.15

³ I Petr. 5.13

⁴ Ps. 35(36).9

⁵ Gjen. 2.10

⁶ Gjen. 2.6

⁷ Eks. 14.27 etj.

⁸ Matth. 2.14

⁹ Eks. 32.11 etj.

¹⁰ Gal. 6.1

¹¹ Ps. 44(45).3

- ¹² Vep. 20.28
¹³ Joan. 1.14,18; 3.16,18; Hebr. 1.3;
 I Joan 4.9
¹⁴ Ps. 44(45).2
¹⁵ Joan 6.68
¹⁶ Apok. 13.8; 21.27
¹⁷ Ps. 18(19).6-7
^{17a} Num. 14.19 etj.
¹⁸ Rom. 5.20
¹⁹ Eks. 10.21; 14.20; Urt. Sol. 17.2,17; 18.4
²⁰ Ef. 5.19; Kol. 3.16
²¹ Rom. 11.33
²² Is. 19.1
²³ I Kor. 1.24,30
²⁴ Joan 6.33; 10.28; 17.2; Vep. 17.25
²⁵ Lluk. 24.49
²⁶ I Mbret. [Sam.] 2.2; II Mbret. [Sam.] 7.22;
 I Kor 2.8
²⁷ Ps. 18(19).5
²⁸ Ps. 76(77).19; 96(97).4; Matth. 24.27;
 Lluk. 17.24
²⁹ Naum 2.1(1.15); Is. 52.7; Rom. 10.15
³⁰ I Tim. 3.16; I Joan 4.2
³¹ Amos 9.13; Joel 3(4).18
³² Matth. 3.8
³³ Hebr. 1.3
³⁴ Fja. Urt. 24.36 (Mas. 30.13); Is. 10.12
³⁵ Fja. Urt. 29.23; Osea 7.10
³⁶ Kol. 2.15
³⁷ Jona 2.6
³⁸ Gjyq. 18.28; Ps. 49(50).22; 70(71).11;
 Is. 5.29; Dan. 11.45
³⁹ Ps. 43(44).23
⁴⁰ Ps. 27(28).9
⁴¹ Matth. 16.18
⁴² Ps. 39(40).2; 118(119).133
⁴³ Is. 6.2-3
⁴⁴ Kol. 1.16
⁴⁵ Matth. 11.29
⁴⁶ Joan 1.14
⁴⁷ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 28
⁴⁸ Matth. 4.23; 9.35; 10.1
⁴⁹ I Thes. 1.6
⁵⁰ Is. 19.19
⁵¹ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
⁵² Matth. 20.28; Mark. 10.45
⁵³ Dan. 3.21
⁵⁴ Urt. Sol. 3.6
⁵⁵ I Kor. 2.8; Jak. 2.1
⁵⁶ Eks. 3.2-5
⁵⁷ I Tim. 2.4; Tit. 1.1
⁵⁸ Joan 15.1





MË 1 TË TË NJËTIT MUAJ

Kujtimi i profetit të shenjtë Jeremia dhe i oshënares Isidora*, e marrë për Krishtin.

NË MBRËMËSORE

*Thirrtores të profetit
Ting. Tërth. IV
Kirie i qe kritirio*

O Zot, e njohe para se të gatuhej, e shenjtërove si një profet,* qëkurse do lindej nga mitra,* Jeremian¹ e lavdishëm fort,* se paranjohe vërtet* lirinë në moral që kish;* me ndërmjetimet e tij shpëtona,* si i mirë, njeri-dashës Zot.

* Poezi e përkthyesit

O Zot, sado u hodh në balt' Jeremia² i lavdëruar, ky mendërisht* po ndiente një erë të këndshme,* si të ishte në Parajsën lart,* në njërën tendë të saj,* kështu duronte lehtësisht;* me ndërmjetimet e tij shpëtona,* si i mirë, njeri-dashës Zot.

Zot, edhe pse po shprehte qarje, vajtime, lot shërbëtori yt,³ si profet,* gëzimin tënd shën Jeremia* s'e veniti,⁴ o Krisht Perëndi;* se e bashkoi me ty* ky shpirtin me mall dhe kështu* gjithnjë i mbushur ish me harenë* shpirtërore që nuk ka rrëfim.

Të oshënares Të ngjashme

O Zot, i shfaqe Pitirunit përmes engjëllit një yll të lavdishëm fort,* që ish fshehur me aftësinë:* Isidorën,

me talent të madh,* por që nga ti s'u fsheh dot,*⁵ se the: çdo gjë që kryejnë* për dashurin' tënde dhe të gjindjes,* sado fshehtas bëhet, del në pah.⁶

Nuk qe e mundur që e virgjra, o Zot Krisht, të rrezatonte posht' nën shininik,* por mbi kandilmbajtëse;⁷ pra kjo* na ndriçon ne lart nga qielli,* në Kishën që triumfon,* se veçori të tillë ka* përlësia, e ngre njeriun*⁸ në shkëlqimin e shenjtoreve.⁹

O Zot, të jemi mirënjohës nga zemra, se na zbulove të fshehurën,* që mbante kurorë lavdie,*¹⁰ të mbuluar nën kukul, shami,* aq të leckosur mjerrisht* për hir të dashurisë' për ty,* ndaj u shërbente me gaz si skllave* motrave me sjellje krejt të vrazhd'.

Lavdi *I profetit*
Ting. II

Jeremia profeti i Savaothit keqtrajtohej nga bashkatdhetarët¹¹ e tij të korruptuar nga ana morale dhe fetare,¹² duke simbolizuar Krishtin, i cili nuk mban mëri për ne mëkatarët. Meqë për atë tashmë ikën pasqyrat e jetës tokësore, e sheh faqe më faqe¹³ dhe ngazëllohet pranë tij.

Tani *I së kremtes*

Pasvargje të së kremtes

Lavdi *I oshënares*
Ting. I

E lumur je, o Isidorë; more nga dora e Zotit kurorën e bukur¹⁴ dhe të dyfishtë: për asketizimin dhe martirizimin tënd të pagjakshëm; ushtrimi i marrëzisë sate për Krishtin është përmbinjerëzor, një tip monakal ndër më të vështirët: të shtiresh si mëkatar ose i çmendur dhe të përbuzesh prej mëkatarëve dhe budallenjve; prandaj përulemi para durimit dhe zgjuarsisë sate.

Tani *I së kremtes*

Përlëshore e profetit
Ting. II

Jeremi profet i shenjtë, që të kremtojmë me besë, ndërmjeto përpara Zotit të shpëtohen shpirtat tanë.*

Lavdi *E oshënares*
Ting. Tërth. I Ton sinánarhon Logon

Veshe petk marrëzie, o e tërurta ti,* që ta mashtroje beljarin me manovrimet plot takt* që ndërmerrije, Isidora, shembull në durim,* sepse garoje me fuqi,* duke vdekur me martirizim të pagjakshëm përdit';* ty të

lypim, o virgjëreshë, mos resht aspak të ndërmjetosh për ne.

Tani *I së kremtes*



NË MËNGJESORE

*Kanunet: i së kremtes dhe
të shenjtoreve:*

Ode I

Kanuni i profetit

Ting. Tërth. IV

Igrán dhiodhefsas

Të kish paranjohur në bark nënor* para se të bëheshe, dhe të shenjtëroi krejt* Zoti, dhe të leu si profet ty* për kombet,¹ kur thoshe: Zotit le t'i këndojm'.¹⁵

Ai që më parë gjithçka e di* parapa lëvizjet e mendimit tënd, o profet,* dhe ty të cakton si udhëzues* për kombin, o Jeremi, pra hyjshfaqës shenjt.

Pasi e pastrove syrin mendor* nga të gjitha njollat mishërore, re si dëshmor* me reputacion për të vërtetën,* i shumëdashur prej Bërësit tënd, profet.

Hyjlindësore

Kur Fjalën e Atit linde në mish,* si fushoi brenda teje mbi mendje dhe koncept,* Virgjëresh' Hyjlindëse, u shfaqe* mbizotëruese mbi çdo krijesë ti.

*Kanuni i oshënares,
që ka Akrostihidhë: "O Isidora,
më dhuro mua hir të të himnoje. Ju".
Tingulli dhe Irmosi i njëjtë*

O yll, virgjëreshë që fort shkrepstin,* si pleh i konsiderove gjërat që admiron* bota mbarë: pasurinë, famën,* pushtetin, epshet, pas Pavlit, apostullit.¹⁶

Ia dhe veten Krishtit, prandaj i le* gjithë tokësoret, duke dashur që ta fitosh,* meqë është Shpëtimtari, mi-ku,* vëllai ynë, gjithçka për të gjithë ne.¹⁷

S'e gjete askund ngushëllimin ti,* as mbështetjen gjatë asketizmit mbinjerëzor,* ndërsa çdo i marrë tjetër kishte* për shoqëri a favor, ndonjë besimtar.

Hyjlindësore

I mjerë jam unë, o Virgjëresh',* ti përrulësi më jep, këtë pra virtyt të madh,* përmes ndërmjetimit të shenjtore,* pra Isidorës së virgjër me plot durim.

*Ode III**I profetit: Si i to steréoma*

Edhe para lindjes, Zot,* e shenjtërove profetin tënd,*¹ pastaj atë* po ti e dërgove* udhëzues të humburish.

Në buzët e tua pra* Hiri i Shpirtit banesë kish,*¹⁸ ndaj si kandil* për ndriçim të shfaqti* për sa janë në terr¹⁹ të zi.

Meqë s'e duronte dot* aromën tënde të mirë krejt* popull i keq,* i balt', Izraeli,* të burgos brenda gropës ty.²

Hyllindësore

Siç deshi me mirësi,* u shoqërua me njerëzit* Bir²⁰ pa fillim,* mbi çdo qenie, Zoti,* përmes teje, o e pacen.

I oshënares I ngjashëm

Dhuratë për Kishën je,* ti na mëson se atje ku ka* dhe element* njerëzor, atje pra* mundësi shtrembërimi ka.

Oaz dhe fryt në Egjipt,* në errësirë ke qenë ti,* me lulëzim* para Perëndisë,* edhe pse fshiheshe me art.

Radhitesh me nder në kor,* që virgjëresha të urta²¹ tok* formojnë, se* mençurisht shkëmbeve* tokësoret me qiellin.

Hyllindësore

Askush nuk zhgënjehet dot,* kur ndihmë, o Vajzë, të kërkon,* askush nuk humb,* kur të ka ty mbrojtje,* se je nëna e Krishtit Zot.

Irmosi: Si i to steréoma

»**T**i je përforcim për ne* që po përikim »te ti, o Zot;*²² je drit' për sa* janë errë-suar;*²³ ndaj dhe shpirti im të him-non.

*Ndenjësores e profetit**Ting. I Ton tapon su Sotir*

Të hedh në baltë ty,*² o i urtë, që mbroje* të drejtat, po ky popull i pa-udhë,¹² s'deshte* të ndiente kundërmim hyjdijeje;²⁴ hidhur vajtove ti*³ për të, kur u kap nga robërues barbarë,* të pabesë dhe* të dhunshëm në skllavëri larg,*²⁵ i lumi profet i madh.

*Lavdi I oshënares**I ngjashëm*

Endoqe si model,* oshënare e virgjër,* atë që bëri Krishti, kur zbriti mbi tokë* dhe mori trajtë shërbëtori,²⁶ madje përmbi kryq u ngul;* o sa "marrëzi"* përlulesie ekstreme* edhe dashuri* për ne vërtet pra të marrët,* ndaj thoshe: Lavdi më ty.

Dhe e së kremtes

*Ode IV**I profetit: Isakikoa Kírie*

Shkëlqimi i përmbindritshëm i Shpirtit të Tërëshenjtë dhe Hyjnor kur shkrepiti në zemrën tënde, bëri që t'u shfaqej atyre që ishin në errësirë.²³

Oi hyjzënë i lumur, meqenëse u duke më i dhembshuri nga të gjithë profetët, denjësomë për dhembshuri mua të dëshpëruarin, për shkak të pasioneve të shumta.

Meqenëse ti u bërë ndërmjetues i shkëlqimit hyjnor dhe zbulues, me ndërmjetimet e tua qetësoje shtrëngatën tejet të trazuar të jetës sime.

Hyjlindësore

Pasi gjeti Perëndia tërë dijen e saktë të shkencës, ia dha tani Izraelit të dashur,²⁷ dhe na shndriti prej teje, o Virgjëreshë.

I oshënares I ngjashëm

Me durimin tënd fitove shpirtin tënd, o e tërurtë, sepse besove absolutisht dhe shkove me saktësi pas fjalëve zotërore.²⁸

Është realizuar në ty thënia e Shkri-meve, dhe u evidentove si e para, ti që dukesh e fundit²⁹ dhe e parëndësishme.

Dhe, megjithëse pas vdekjes s'ka më fuqi dhe rrezik mëkati,³⁰ përulësia jote zgjati dhe më vonë, se na shteroi lipsanin tënd.

Hyjlindësore

Ushfaqe, o e Tërëkulluar, kryetarja e korit të vajzave³¹ të virtytshme, duke pranuar përulësisht vullnetin hyjnor,³² dhe na lindi Perëndinë.

*Ode V**I profetit: Fótison imás*

OKrisht, si rufe e dërgove profetin tënd, Jeremian tepër të hyjshëm, që të të lajmëronte ty, dritën,³³ tek ata që ishin në terr.

OJeremi, Zoti yt me paranjohjen e tij të tregoi në kohët e duhura³⁴ si shigjetë të zgjedhur, të fshehur në kukurë.³⁵

Oprofet i lavdëruar, duke pasur veshë të pastër mendjeje, u denjësove të dëgjosh Shpirtin kur të fliste.

Hyjlindësore

Misteri i së Virgjërës është i madh dhe i frikshëm, sepse Perëndisë, që për-mes saj u duk njeri mbi tokë,²⁰ i dha gji si nënë.

I oshënares I ngjashëm

Rend të ndërmjetosh për ne pranë Hyjnisë, o e shenjtë, si kundërpeshë për padrejtësinë tënde, që nuk na le lipsanin tënd.

Oe marrë e tërurtë, nuk dimë cili vend pasurohet me lipsanin tënd, por jemi të sigurt se qielli nderohet me shpirtin tënd.

Me hijeshi thoshin të marrë për hir të Krishtit: Po shkoj të tallem me botën, e cila mendon se tallet me mua. O kundërvënie e të kundërtave!

Hyjlindësore

U duke më e lartë se engjëjt për shkak të dëlirësisë dhe të përlësisë sate, prandaj prapa teje vrapuan³⁶ murgeshat, vajzat³¹ e jetës engjëjllore.

Ode VI

I profetit: Ávisos amartión

Kur zgjerove gojën ti* shpirtërisht,³⁷ tërhoqe dritën dhe hirin* me mbushulli,³⁸ profet hyjmentës; ndaj, si u mbushe plot,* te të gjithë që dëshironin u ke dhënë të kungonin* dhe ata³⁹ po ashtu shkëlqim hyjnor.

Kur pe detin tokësor* që të ngrihej⁴⁰ nga shtrëngatat prej ngasjesh,* e dëshirove fundin e marshimit të largët ti* dhe burimin që do gufonte si lumë

lot, të vajtonte* popullin tënd të mjerrë hidhërisht.⁴¹

Paradekloroje ti* mistikisht, hyjfolës, vdekjen e Krishtit,* të Çlirimtarit, se e lartësoi si qengj në dru* mirëbërësin e krijesës, sovranin e mbarë jetës,*⁴² popull i paligj i judenjve pra.

Hyjlindësore

Fjala që pa trup u lind* para jetëve nga Ati, ka lindur* në kohë mishërisht prej teje, o e dëlira Zonj',* dhe si paratha Jeremia qëmoti, do të jetojmë* ne poshtë hijes së tij patjetër.⁴³

I oshënares I ngjashëm

Asnjëherë s'do të mund* të rrëfejë dhe as të imagjinoj dot* bollëkun e thesarit të durimit që pate ti,* kur shërbeje në situata të lodhshme me mund për trupin* dhe shpirtin, nën' e fortë si hekur.

Hoqe djersë pa kufi* nëpërmjet asketizimit të ashpër* edhe me punën tënde pranë furrës së hirtë ti;* por, o nënë, malli që kishe për Krishtin Jisu ta fshinte* djersën, që fikte çdo mundim në zjarr.

Rrecka kishe veshur ti,* por kukuli yt shkëlqente më tepër* se çdo kurorë mbreti në shikimin e ndritshëm

fort* dhe të kthjellët, të shenjtëruar që kishte shën Pitiruni;* duke t'u falur, të lëvdoi ty.

Hyjlindësore

Rri mbi kraharorin tënd,* porsi mbi fron më të gjerë se qiejt,* ai që mishërisht u bë si ne, duke marrë trup* përmes teje, o e panjollshme, o nuse e tërëshenjtë,* nëna e shkakut të shpëtimit tim.⁴⁴

Irmosi: Ávissos amartiôn

»**M**ë trazon avush', stuhi* nga mëkatet dhe nga shkelje të rënda* dhe po »më shtyjnë dhunshëm mu në fund »dëshpërimi thell';* mirëpo, o kapi- »ten, shtrihe pra dorën tënde të fortë,* »siç ti ia shtrive Petros,⁴⁵ më shpëto.

Kontaqi i së kremtes

Sinaksari

Muaji maj, që ka 31 ditë. Dita ka 14 orë dhe nata 10 orë.

Më 1 të të njëjtit muaj, kujtimi i profetit të shenjtë Jeremia.

Vargje: Shpirtra të ngurtësuar dhe të huaj nga frika hyjnore/ vranë me gurë Jeremian e hyjshëm.

Në të parën e majit, vranë me gurë Jeremian.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i oshënares Isidora, e marrë për Krishtin.

Në dhë e përqeshi e zgjuara satanin,/ tani po jeton vërtet si e lumur.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atletizmit të hieromartirit të shenjtë Vatas persiani.

Vargje: Pasi ia prenë kokën me shpatë,/ Vatasi arriti vajtjen siç duhej në vendet e qiellit.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të shenjtë Filozofi.

Vargje: O i lumur, o mik i urtësisë, u shfaqte vërtet filozof/ për hirin e emrit dhe të veprimtarisë.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë ndër shenjtore Panaret i Pafosit.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i neomartirëve oshënarë Efthimi, Ignati dhe Akaqi.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i neomartirit të shenjtë Akaqi (tjetër).

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Nikifori, nga Hiosi.

Me ndërmjetimet e shenjtoreve të tu, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII

I profetit: Pédhes evreon

Duke parë tani, o profet, jo më në

shpresë tashmë, por të përmbushen realisht parathëniet e tua, thërret: I bekuar je, o Zot Perëndi, përjetë.⁴⁶

U tregove instrument hyjnor drejtuar nga dora e Ngushëllimitarit, duke folur zëra qiellorë dhe duke kënduar: I bekuar je, o Zot Perëndi, përjetë.⁴⁶

Duke shkruar vajtimet, o profet,³ nuk e venite ngazëllimin e hyjshëm,⁴ me të cilin që foshnjë u bashkërrite, duke thirrur fuqishëm: I bekuar je, o Zot Perëndi, përjetë.⁴⁶

Hyjlindësore

Si dëshirove nga mirësia të futeshe në mitër virgjëreshe, duke dashur të shpëtosh njerëzit,⁴⁷ këtë çudi ua mësove qartë profetëve që thërrisnin: I bekuar je, o Perëndi, përjetë.⁴⁶

I oshënares I ngjashëm

Ti u bërë për engjëjt dhe njerëzit, o Isidorë, si teatër,⁴⁸ ndonëse jeta jote ishte fshehur më Krishtin;⁴⁹ aftësia jote na habit, prandaj të mburrim ne.

Ëmbëlsohet dhe krenohet Nili, sepse vaditi jetën e barabartë me engjëjt, që lulëzoi me pjellori në vendin e tij; dhe dëshmi për këtë është e madhja.

Të admirojmë dhe të nderojmë, o e hekurt në mundim, e fortë në besim,

e ndezur në dashuri, e patundur në durim, o triumfuesja e të Kryqëzuarit.

Hyjlindësore

Është e drejtë të të himnojmë ty të himnuarën, se i dhe trup të patrupit, jetën vetë jetës, qumësht ushqyesit, o urë mes njerëzimit dhe Hyjnisë.

Ode VIII

I profetit: Nikitë tiranu qe flogós

Hipe në qiej i gëzuar, o Jeremi i hyjfrymëzuar, dhe bashkë me të patrup vjen përquark fronit të të Tërëmbretit, duke kënduar: E bekoni, o vepra, Zotin dhe e përmbilartësoni në jetë.⁵⁰

Meqenëse u tregove pasqyrë dritërrrezatuese, u dërgon reflektime atyre që dëshirojnë, duke shkëlqyer nga pishtari i rrezes hyjnore⁵¹ dhe duke kënduar: E bekoni, o vepra, Zotin dhe e përmbilartësoni në jetë.⁵⁰

Pasi u shfaqe predikues i shenjtëruar shpresëtarie, o Jeremi i tërëfamshëm, demaskove pafuqinë e ateizmit, duke kënduar: E bekoni, o vepra, Zotin dhe e përmbilartësoni në jetë.⁵⁰

Hyjlindësore

O Hyjnënë, esencën time e pritë prej teje Jetëdhënësi dhe e pastroi nga

njollat e mëparshme; prandaj ne, veprat, e bekojmë Zotin dhe e përmbilartësojmë në jetë.⁵⁰

I oshënares I ngjashëm

Himnojmë sjelljen tënde, o emërmadhe; na mësove se ndryshe shikon Perëndia dhe ndryshe njerëzit; i pari shikon zemrën, ndërsa të jashtmen të dytët⁵² që nuk psalin: E bekoni, o vepra, Zotin dhe e përmbilartësoni në jetë.⁵⁰

I marrë për Krishtin ishte Pavli,⁵³ dhe e imitove ti,⁵⁴ prapë siç tha, duke pasur dhe parzmorë besimi dhe dashuri;⁵⁵ dhe nëse Esteri e kishte kurorën mbretërore si rreckë,^{55a} mbulesa jote e lekosur që kurorë e perëndishme, ndaj në qiell shkëlqen.

Mirë na argumentove, o hyjnjohe, se shumë që janë të urtë sipas tyre,⁵⁶ janë të marrë, ndërsa disa që ngjajnë me të meta, janë të mençur, sepse dinë të psalin: E bekoni, o vepra, Zotin dhe e përmbilartësoni në jetë.⁵⁰

Hyjlindësore

Na shpëto, o bijë e Mbretit,⁵⁷ nga peripetitë dhe rreziqet, me lutjet e Isidorës dhe të virgjërëshave të tjera që shkojnë pas teje,³¹ duke psalur: E bekoni, o vepra, Zotin dhe e përmbilartësoni në jetë.⁵⁰

Irmosi: Nikité tiranu që flogós

»**M**undën një tiran⁵⁸ dhe flak'⁵⁹ me »hirin tënd Tre Djemtë, që me forcë* »mbanin porosit' e tua besërisht⁵⁸ dhe »me zemër thërrisinin: * Gjithë veprat, »Zotin bekojeni, mbilartësojeni.⁵⁰

Ode IX

I profetit: Kirios Theotokon

Lum ti, se u përzjeve* me të lartën dritë* përmes lavdisë, shkëlqimit të madh të Hyjnis';* mbi dhé zbulimet e saj i pate fuqishëm ti.

Arrite në burimin* e pacen që nxjerr plot* shkëlqime, ndaj, o i hyjfyrmëzuar ti,* mbarimin që dëshiroje e rroke qartësisht.

Na denjëso të gjithë* ne që e himnojmë* kujtimin tënd, ta shijojmë shkëlqimin me lavd,* që po gëzon, Jeremi shenjt, hyjnisht ti lart tani.

Hyjlindësore

Besojmë lindjen tënde* të pacen, o Zonjë,* prandaj të dimë liman shpëtimtar dhe kështu* të lypim prej çdo rreziku që të çlirohemi.

I oshënares I ngjashëm

Oratorí s'kam fare,* shtangem si ia ngjite* mendimin tënd dashurisë për

Krishtin Jisu,* që lehtësonte mundi-
met; si të të lavdëroj?

Na jep, o e tejskamur* dhe mjerisht
e zbathur,* nga pasuria e Hirit që ke,
meqë je* në gjirin abramian me Llaza-
rin e vobekt'.⁶⁰

Ja ku kalove zjarrin,* flakën e mundi-
mit,* nëpërmes ujit të djersës dhe lo-
tëve tok* nga dashuria për Zotin; të
nxori në shijim.⁶¹

Hyllindësore

U shfaq, o Virgjëreshë,* Isidora që
vjen* pas teje, porsi dhuratë e vyer
nga lart,* të cilën na e dhuroi Ati i
dritave.⁶²

Irmosi: Kirios Theotokon

»**H**yllindëse të themi,* të pohojmë ne
»që* shpëtuam, o e kulluar e virgjër,
»me ty;* me koret e të patrupve të ma-
»dhështojmë tok.

Dërgimësore

E profetit

Jinekes akutísthite *(poezi e përkthyesit)*

Vajtove popullin, profet,*³ që nga Si-
oni ikte larg* në internimin²⁵ e frik-
shëm,* kur shkatërrohej qyteti;*⁶³ ke
qenë pesimist në jet',* por tani nga-
zëllohesh ti* brenda qytetit qiellor,*

Jeruselemit të lartë*⁶⁴ me Izraelin e
Zotit.⁶⁵

E oshënares E ngjashme

Siç oshënari Pitirun* kish thënë pre-
rë, qartësisht:* Të tjerat ishin të ma-
rra,* e mençur ishte ti vetëm,* sado i
flisnin keq për ty;* thënia e shën An-
donit del,* meqë këto së urtës pra* i
thoshin: Ti ke të meta,* ndërsa të
gjitha ne fare.

Dhe e së kremtes

Pasvargjet e së kremtes

Lavdi *I profetit (poezi e përkthyesit)*
Ting. Tërth. II

O profet i madh dhe i dhembshur,
shpirti yt u ngushtua⁶⁶ nga hidhërimet
për popullin tënd, i cili nuk u bindej
këshillave të tua⁶⁷ të urta, si mëkatar
i papenduar para të Plotfuqishmit;
ndërmjeto për ne, të pendohemi⁶⁸ me
besim, të duam armiqtë, sipas she-
mbullit tënd,⁶⁹ dhe nga vendi i rebe-
limit të mëkatit të kthehemi në Jeru-
salemin e ri.⁷⁰

Tani *I së kremtes*

CITIME

¹ Ps. 138(139).13-16; Jer. 1.5

- ² Jer. 45(38).6
³ Jer. 7.29; Vajtime 1.1
⁴ Jer. 15.16; 40(33).9,11; Varuk 4.23,36
⁵ Hebr. 4.13
⁶ Ps. 36(37).6; Matth. 6.4; 10.26;
 Mark. 4.22; Lluk. 8.17; 12.2; I Kor. 4.5
⁷ Matth. 5.15; Mark. 4.21; Lluk. 11.33
⁸ Matth. 23.12; Lluk. 14.11; 18.14
⁹ Ps. 109(110).3
¹⁰ I Petr. 5.4
¹¹ Jer. 36(29).27; 39(32).2; 40(33).1;
 44(37).15-16,21; 45(38).6
¹² Jer. 1.16 etj.
¹³ I Kor. 13.12
¹⁴ Urt. Sol. 5.16
¹⁵ Eks. 15.1,21
¹⁶ Fil. 3.7-8
¹⁷ Ef. 1.23
¹⁸ Ps. 44(45).3; Sirak 21.16
¹⁹ Rom. 2.19
²⁰ Varuk 3.38
²¹ Matth. 25.2
²² Ps. 17(18).3; 70(71).3
²³ Is. 9.2; Matth. 4.16; Lluk. 1.79; Rom. 2.19
²⁴ II Kor. 2.14
²⁵ Varuk 1.9
²⁶ Fil. 2.7
²⁷ Varuk 3.37
²⁸ Lluk. 21.19
²⁹ Matth. 19.30; 20.16; Mark. 10.31;
 Lluk. 13.30
³⁰ Rom. 6.7
³¹ Ps. 44(45).15
³² Lluk. 1.38
³³ Joan 1.4,9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46
³⁴ I Tim. 6.15
³⁵ Is. 49.2
³⁶ Kënga 1.4
³⁷ Ps. 118(119).131
³⁸ Ps. 80(81).11
³⁹ Urt. Sol. 7.13
⁴⁰ Jer. 6.22-23
⁴¹ Jer. 9.1-2; Vajtimet 2.11,18
⁴² Vep. 3.15
⁴³ Varuk 1.12; Vajtimet 4.20
⁴⁴ Hebr. 5.9
⁴⁵ Matth. 14.31
⁴⁶ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2
⁴⁷ I Tim. 2.4
⁴⁸ I Kor. 4.9
⁴⁹ Kol. 3.3
⁵⁰ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
⁵¹ Urt. Sol. 7.26
⁵² I Mbret. [Sam.] 16.7
⁵³ I Kor. 4.10
⁵⁴ I Kor. 4.16; 11.1
⁵⁵ I Thes. 5.8
^{55a} Est. 4.17ö
⁵⁶ Rom. 11.25; 12.16
⁵⁷ Ps. 44(45).10-11
⁵⁸ Dan. 3.17-18
⁵⁹ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 26
⁶⁰ Lluk. 16.22
⁶¹ Ps. 65(66).12
⁶² Jak. 1.17
⁶³ Jer. 52.13-14
⁶⁴ Gal. 4.26; Hebr. 12.22
⁶⁵ Gal. 6.16
⁶⁶ Varuk 3.1
⁶⁷ Jer. 18.18 etj.
⁶⁸ Jer. 3.12 etj.
⁶⁹ Jer. 15.11
⁷⁰ Apok. 3.12; 21.2



MË 2 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i transferimit të lipsanit të atit tonë ndër shenjtoreë
Athanasit i Madh, patriark i Aleksandrisë.

*Tipikon***1. Nëse bie nga e Hënë e Madhe deri në Pashkë:**

Shërbesa transferohet dhe psalet në fillimin e Javës së Ndrutshme. Në ditët e para të Javës së Ndrutshme psalet shërbesa e shën Gjergjit dhe e shën Markut, nëse Tipikoni i transferon po në ditët e para të Javës së Ndrutshme. Por nëse 2 maj bie të Hënën ose të Martën e Ndrutshme, atëherë shërbesa e shën Athanasit psalet pikërisht atë ditë, ndërsa shërbesa e shën Gjergjit dhe shën Markut shtyhen nga një ditë më pas.

2. Nëse bie të Hënën e Ndrutshme:

Të dielën e Pashkës në Mbrëmësore, pas Krishti u ngjall (10x) dhe Paqësoreve, Thirrtoret: 4 ngjallësore (të Tingullit II) dhe 4 të shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit (II). Hyrje me Ungjillin. O dritë gazmore. Proqimeni i Madh dhe menjëherë Ungjilli. Le të themi të gjithë etj. Pasvargjet: ngjallësore e para, dhe të Pashkës (Le të ngrihet Perëndia; Pashka hierore etj.). Lavdi i shenjtit. Tani Dit' e ngjalljes, Krishti u ngjall (3x), Përlëshorja e shenjtit dhe Hyjlindësorja ngjallësore (Ti që ndërmjetove). Përlëshim dialogjikisht.

*Të hënën, në Shërbesën e Mesnatës, shërbesa paskale dhe në vazhdim Litia e shenjtit, d.m.th. Tropari i parë i shenjtit të kishës. Lavdi i Litisë së shën Athanasit. Tani Hyjlindësore ngjallësore: Pa farë prej Shpirtit Shenjt pas vullnetit t' Atit zure të Birin e Perëndis' që lindi prej Atit pa nënë para jetëve; e linde për ne trupërisht pa atë, dhe e rrite si foshnjë; prandaj mos pusho së ndërmjetuari që të shpëtohen shpirtat tanë prej rreziqeve. * Krishti u ngjall (3x) dhe Përlëshim. Në Mëngjesore, Krishti u ngjall (10x), Përlëshorja e shenjtit dhe Hyjlindësorja ngjallësore (Ti që ndërmjetove). Pas Paqësoreve, menjëherë Kanunet: i Pashkës në 4 dhe i shenjtit në 4. Në fundin e çdo Ode, Zbritësorja e Pashkës, Krishti u ngjall (3x), Kur u ngrit Jisui, dhe Përsëri dhe përsëri. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtit dhe Ndenjësoret: e shenjtit, Lavdi dhe Tani O bukuri me nam, o virgjëri pa cen, o drit' e diellit,*

o hën' e qiellit; shën Gabrieli kur të pa, çuditej dhe të thërriste: Se si të të lavdëroj, o Mari, o Hyjlindëse, ç'këngë të këndoj për ty, nuk e di dhe kërkoj më kot; pra them sikundër jam porositur: Gëzohu, Virgjëreshë Hirplote.* *Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Pashkës dhe Sinaksari*. Ne që pamë ngjalljen (3x). Kur u ngrit (3x). Në vend të Më të nderuarën, Ode IX e Pashkës dhe e shenjtit (por në Lavdi si dhe Tani, me Madhështimet e Pashkës). Dërgimësoret: e Pashkës, e shenjtit dhe përsëri e Pashkës. Lavdërimet: 4 ngjallësore, 4 të shenjtit dhe 4 të Pashkës (Le të ngrihet Perëndia; Pashka hierore etj.). Lavdi i shenjtit. Tani Dit' e ngjalljes. Krishti u ngjall (3x) dhe Përlëshorja e shenjtit.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Krishti u ngjall, Ipakoia e Pashkës dhe Përlëshorja e shenjtit. Kontaqi i Pashkës. Sa u pagëzuat. Apostulli i shenjtit dhe Ungjilli i ditës. Në vend të Të meriton, Një engjëll i thërriste; Ndriçohu, ndriçohu. Kungatore e Pashkës [dhe Në kujtim të përjetshëm]. Në vend të Pamë dritën, Krishti u ngjall. Në vend të Emri i Zotit, Krishti u ngjall (3x shpejt në Ting. II). Përlëshim dialogjikisht.

3. Nëse bie të Martën ose të Mërkurën, ose të Enjten, ose të Shtunën e Ndrishme:

Shërbesa e shenjtit kryhet sikundër bie dhe të Hënën e Ndrishme. Por natyrisht, ndryshojnë Tingujt, Proqimenët e Mbrëmësoreve, Sinaksarët dhe në Liturgji Ungjilli i ditës. Gjithashtu në Mbrëmësore nuk lexohet Ungjilli.

4. Nëse bie të Premten e Ndrishme (Burimi Jetëdhënës):

Të enjten në Mbrëmësore, Thirrtoret: 3 ngjallësore, 3 të Burimit dhe 4 të shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani [Lavdi] i Burimit. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i [Madh i] Burimit. Pasvargjet: ngjallësore (Paskremtore) e para dhe 3 të Burimit (ose të shenjtit, nëse kisha mban emrin e tij). Lavdi i shenjtit. Tani Dit' e ngjalljes, Krishti u ngjall (3x), Përlëshorja e shenjtit dhe e Burimit, Ting. I: Kisha jote, o Hyjlindëse, u tregua Parajsë, duke buruar shërime si lumenj gjithmonë të gjallë; duke ardhur pranë saj besërisht, nxjerrim si nga burimi jetëpranues shëndoshje dhe jetë të përjetshme, sepse te Shpëtimtari Krisht që lindi prej teje, ti ndërmjeton që të shpëtohen shpirtrat tanë. Përlëshim dialogjikisht.

Të premten, në Shërbesën e Mesnatës, shërbesa paskale dhe në vazhdim Litia e shenjtit, d.m.th. Tropari i parë i shenjtit të kishës. Lavdi i Litisë së shën Athanasit.

Tani Hyjlindësore ngjallësore: Pa farë prej Shpirtit Shenjt pas vullnetit t' Atit zure të Birin e Perëndis', që lindi prej Atit pa nënë para jetëve; e linde për ne trupërisht pa atë, dhe e rrite si foshnjë; prandaj mos pusho së ndërmjetuari që të shpëtohen shpirtat tanë prej rreziqeve. * Krishti u ngjall (3x) dhe Përlëshim. *Në Mëngjesore*. Krishti u ngjall (10x), Përlëshorja e shenjtit dhe Hyjlindësore ngjallësore (Ti që ndërmjetove). *Pas Paqësoreve, menjëherë Kanunet*: i Pashkës, i Burimit (me Varg: E Përmbishenjtë Hyjlindëse, shpëtona) dhe i shenjtit. *Në fundin e çdo Ode, Zbritësorja e Pashkës*, Krishti u ngjall (3x), Kur u ngrit Jisui, dhe Përsëri dhe përsëri. *Pas Odes III, Kontaqi i Pashkës, dhe i shenjtit me Shtëpinë e tij. Ndenjësorja e shenjtit dhe e Burimit. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Burimit dhe Sinaksari i ditës dhe i Burimit. Ne që pamë ngjalljen (3x). Kur u ngrit Jisui (3x). Në vend të Të meriton, Ode IX e Pashkës, e Burimit dhe e shenjtit (por në Lavdi si dhe Tani, me Madhështimet e Pashkës). Dërgimësoret: e Pashkës, e shenjtit, e Burimit. Lavdërimet: 2 ngjallësore, 3 të Burimit, 3 të shenjtit dhe 4 të Pashkës (Le të ngrihet Perëndia; Pashka hierore etj.). Lavdi i shenjtit. Tani Dit' e ngjalljes. Krishti u ngjall (3x) dhe Përlëshorja e shenjtit dhe e Burimit.*

Në Liturgji. Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Krishti u ngjall. *Ipakoia e Pashkës dhe Përlëshoret e Burimit dhe e shenjtit. Kontaqi i Pashkës. Sa u pagëzuat. Apostulli i shenjtit, Ungjilli i ditës. Në vend të Të meriton, Një engjëll i thërriste; Ndriçohu, ndriçohu. Kungatore e Pashkës [dhe Në kujtim të përjetshëm]. Në vend të Pamë dritën, Krishti u ngjall. Në vend të Emri i Zotit, Krishti u ngjall (3x shpejt në Ting. II). Përlëshim dialogjikisht.*

5. Nëse bie të Dielën e Thomait:

Të shtunën në Mbrëmësore, pas Krishti u ngjall (3x), Psalmi Nistor (pa Ejani t' i falemi, si zakonisht deri në Mbylljen e Pashkës). (Psaltiri si zakonisht). Thirrtoret: 6 të Thomait dhe 4 të shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani i Thomait. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Pasvargjet e Thomait. Lavdi i shenjtit. Tani i Thomait. Përlëshoret: e Thomait, e shenjtit dhe përsëri e Thomait.

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmi 50, Kanuni Triadik. Litia e Thomait. Lavdi i Litisë së shenjtit. Tani i Litisë së Thomait. Himne Triadike. Tri-shenjtë. Përlëshorja e Thomait. Në Mëngjesore, Ndenjësoret, vetëm të Thomait. Polielei i Thomait dhe Ndenjësorja e tij (2x). Shkallesat. Antifoni i parë Ting. IV dhe Proqimeni i Thomait. Kanunet: i Thomait dhe i shenjtit. Pas Odes III, Kontaqi

dhe Shtëpia e shenjtit dhe Ndenjësorja e shenjtit dhe një (Paskremtore) e Thomait. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Thomait. Sinaksari i ditës dhe i Thomait. Zbritësoret e Pashkës; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Në vend të Më të nderuarën, Ode IX e Thomait dhe e shenjtit. I shenjtë është Zoti, Perëndia ynë (2x), Lartësoni Zotin. Dërgimësoret: e para e Thomait, e shenjtit dhe e dyta e Thomait. Lavdërimet: 3 të Thomait dhe 3 të shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani i Thomait. Dhokso-logjia e Madhe. Përlëshorja e Thomait.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e Thomait dhe e shenjtit. Kontaqi i Pashkës. Apostulli i shenjtit dhe Ungjilli i Thomait. Në vend të Të meriton, Irmosi i Odes IX i Thomait (Ti llambadhen e shkëlqyer). Kungatore e Thomait [dhe Në kujtim të përjetshëm]. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.

**6. Nëse bie të hënë ose të martën, ose të mërkurën, ose të enjten,
ose të premten pas së Dielës së Thomait:**

Në Mbrëmësore, (Psaltiri si zakonisht, përveç Mbrëmësore të së dielës si zakonisht). Thirrtoret: 3 të Thomait dhe 3 të shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani i Thomait. Të dielën bëhet Hyrja, O dritë gazmore dhe Proqimeni i Madh. Në ditët e tjera nuk bëhet Hyrja, lexohet O dritë gazmore dhe psalet Proqimeni i ditës. Pasvargjet e shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani i Thomait. Përlëshoret: e Thomait, e shenjtit dhe përsëri e Thomait.

Në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Litia e shenjtit, d.m.th. Tropari i parë i Litisë së shenjtit të kishës. Lavdi i Litisë së shenjtit. Tani i Litisë së Thomait. Përlëshorja e shenjtit. Në Mëngjesore, Ndenjësoret e shenjtit dhe në vend të Hyjlindësoreve, Ndenjësoret e Thomait. Ne që pamë ngjalljen. Psalmi 50 (hima). Kanunet: i Thomait dhe i shenjtit. Pas Odes III, Kontaqi i Thomait dhe Ndenjësoret: e shenjtit dhe një e Thomait (ajo pas Polieleit). Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtit dhe Sinaksari. Zbritësoret e Pashkës. Më të nderuarën. Dërgimësoret: e shenjtit dhe një e Thomait. Lavdërimet e shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani i Thomait. Dhokso-logjia e Madhe. Përlëshorja e shenjtit.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e Thomait, e shenjtit dhe e kishës. Kontaqi i Thomait. Apostulli dhe Ungjilli i shenjtit. Të meriton. Kungatore: Në kujtim të përjetshëm. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.

7. Nëse bie të shtunën (d.m.th. në Mbylljen) e Thomait:

Të premten në Mbrëmësore, Thirrtoret: 3 të Thomait dhe 3 të shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani i Thomait. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Pasvargjet: ngjallësorja (Paskremtore) e parë (Lutjet tona...) dhe të 3 të shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani i Thomait. Përlëshoret: e Thomait, e shenjtit dhe përsëri e Thomait.

Të shtunën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Litia e shenjtit, d.m.th. Tropari i parë i Litisë së shenjtit të kishës. Lavdi i Litisë së shenjtit. Tani i Litisë së Thomait. Trishenjtë. Përlëshorja e Thomait. Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë, Ndenjësoret Paskremtore. Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësoret: të dyja të shenjtit dhe një e Thomait. Ne që pamë ngjalljen. Psalmi 50 (hima). Kanunet: i Thomait dhe i shenjtit. Pas Odes III, Kontaqi i Thomait dhe Ndenjësorjet: e shenjtit dhe një e Thomait. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtit dhe Sinaksari. Zbritësoret e Pashkës. Në vend të Më të nderuarën, Ode IX e Kanuneve. Dërgimësoret: e para e Thomait, e shenjtit dhe e dyta e Thomait. Lavdërimet: 2 ngjallësore (Paskremtore), 3 të Thomait dhe 3 të shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani i Thomait. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e Thomait.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e Thomait, e shenjtit dhe e kishës. Kontaqi i Thomait. Apostulli dhe Ungjilli i shenjtit. Në vend të Të meriton, Irmosi i Odes IX i Kanunit të Thomait (Ti llambadhen e shkëlqyer). Kungatore e Thomait [dhe Në kujtim të përjetshëm]. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.

8. Nëse bie të Dielën e Miropurëseve ose të të Paralizuarit, ose të Samaritanes, në të cilën nuk psalen himnet Paskremtore të Mespentikostisë, për hirin e shërbesës së shenjtit:

Të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 4 ngjallësore, 3 të Pentikostarit dhe 3 të shenjtit. Lavdi i Pentikostarit. Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Pasvargjet: ngjallësorja e parë e Tingullit dhe të Pashkës (Le të ngrihet Perëndia; Pashka hierore etj.) [ose të shenjtit, nëse kisha mban emrin e tij]. Lavdi i shenjtit. Tani i Pentikostarit. Përlëshoret: a) të Dielën e Miropurëseve: Kur zbritë te vdekja; Bujari Josif, Lavdi i shenjtit, Tani Grave miropurëse; b) të Dielat e tjera: Përlëshoret ngjallësore. Lavdi Përlëshorja e shenjtit. Tani Hyjlindësore ngjallësore (Ti që ndërmjetove).

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50 dhe pas Kanunit Triadik, të Dielën e Miropurëseve: Litia e tyre, Lavdi i Litisë së shenjtit, Tani [Lavdi] i Litisë së Miropurëseve. Në të Dielat e tjera, pas Kanunit Triadik, Tropari i parë i Litisë së shenjtit të kishës. Lavdi i Litisë së shenjtit. Tani i Litisë së Pentikostarit. Himne Triadike. Trishenjtë. Përlëshoret: a) të Dielën e Miropurëseve Bujari Josif; b) të Dielat e tjera, Përlëshorja e shenjtit. Në Mëngjesore, Ndenjësoret vetëm të Pentikostarit. Bekimtoret. Ipakoia, Shkallesat dhe Proqimeni, të Tingullit. Kanunet: i Pashkës dhe i shenjtit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtit dhe Ndenjësorja e tij dhe e Pentikostarit. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Pentikostarit. Sinaksari i ditës dhe i Pentikostarit. Zbritësoret e Pashkës; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Në vend të Më të nderuarën, Ode IX e Kanuneve. Dërgimësoret: e Pashkës, e shenjtit dhe e Pentikostarit. Lavdërimet: 4 ngjallësore, 4 të shenjtit dhe të Pashkës (Le të ngrihet Perëndia; Pashka hierore etj.). Lavdi i Pentikostarit. Tani Dit' e ngjalljes. Dhoksologjia e Madhe. Sot erdhi.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: a) të Dielën e Miropurëseve: Kur zbritë te vdekja; Bujari Josif; Grave miropurëse, e shenjtit dhe e kishës; b) të Dielën e të Paralizuarit: ngjallësore, e shenjtit dhe e kishës; c) të Dielën e Samaritanes: ngjallësore, e Mespentikostisë, e shenjtit dhe e kishës. Kontaqi i Pashkës. Apostulli i shenjtit dhe Ungjilli i së dielës. Në vend të Të meriton, Zbritësorja e Odes IX. Kungatore e Pashkës [dhe Në kujtim të përjetshëm]. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.

9. Nëse bie në Javën pas së Dielës së Miropurëseve, ose pas të të Paralizuarit (përveç Mbylljeve të tyre):

Në Mbrëmësore, Thirrtoret: 3 të së kremtes dhe 3 të shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani i së kremtes. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Pasvargjet e shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani i së kremtes. Përlëshoret: e së kremtes, (d.m.th. ngjallësore), e shenjtit dhe Hyjlindësore po ngjallësore (Ti që ndërmjetove). Të Dielën e Miropurëseve në mbrëmje, Përlëshoret: Bujari Josif; Kur zbritë te vdekja, Lavdi i shenjtit, Tani Grave miropurëse.

Në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Litia e shenjtit, d.m.th. Tropari i parë i shenjtit të kishës. Lavdi i shenjtit. Tani i së kremtes. Trishenjtë. Përlëshorja e shenjtit. Në Mëngjesore, Ndenjësoret e shenjtit dhe në vend të Hyjlindësoreve, Ndenjësoret e së kremtes. Ne që pamë ngjalljen. Psalmi 50 (hima). Kanunet: i së

kremtes dhe i shenjtit. Pas Odes III, Kontaqi i së kremtes dhe Ndenjësoret: e shenjtit dhe e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtit dhe Sinaksari. Zbritësoret e Pashkës. Më të nderuarën. Dërgimësoret: e shenjtit dhe e së kremtes. Lavdërimet e shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani i së kremtes. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e shenjtit.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e së kremtes, e shenjtit dhe e kishës. Kontaqi i së kremtes. Apostulli dhe Ungjilli i shenjtit. Kungatore: Në kujtim të përjetshëm. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.

10. Nëse bie të shtunën (d.m.th. në Mbylljen) e Miropurëseve:

Të premten në Mbrëmësore, Thirrtoret: 3 të së kremtes dhe 3 të shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani i së kremtes. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Pasvargjet: ngjallësorja e parë (Paskremtore) dhe të shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani [Lavdi] i së kremtes. Përlëshoret: Bujari Josif; Kur zbrite, Lavdi i shenjtit, Tani Grave miropurëse.

Të shtunën në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Litia e shenjtit, d.m.th. Tropari i parë i shenjtit të kishës. Lavdi i shenjtit. Tani i së kremtes. Trishenji. Përlëshorja e shenjtit. Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë, Ndenjësoret e së kremtes. Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësoret: të dyja të shenjtit dhe një i së kremtes. Kanunet: i së kremtes dhe i shenjtit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e së kremtes dhe Ndenjësoret: e shenjtit dhe e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtit dhe Sinaksari. Zbritësoret e Pashkës. Më të nderuarën. Dërgimësoret: e shenjtit dhe e së kremtes. Lavdërimet: 3 të së kremtes dhe 3 të shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani i së kremtes. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e shenjtit.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: Bujari Josif; Kur zbrite te vdekja; Grave Miropurëse, e shenjtit dhe e kishës. Kontaqi i së kremtes. Apostulli dhe Ungjilli i shenjtit. Kungatore: Në kujtim të përjetshëm. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.

11. Nëse bie të martën (d.m.th. në Mbylljen) e të Paralizuarit:

Të hënë në Mbrëmësore, Thirrtoret: 3 të së kremtes dhe 3 të shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani [Lavdi] i së kremtes. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Pasvargjet e shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani [Lavdi] i së kremtes. Përlëshoret: e së

kremtes (ngjallësore). Lavdi i shenjtit. Tani Hyjlindësore ngjallësore (Ti që ndërmjetove).

Në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Litia e shenjtit, d.m.th. Tropari i parë i shenjtit të kishës. Lavdi i shenjtit. Tani i së kremtes. Trishenjtë. Përlëshorja e shenjtit. Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë, Ndenjësoret: e shenjtit dhe Hyjlindësore, e ngjashme: Virgjëreshë je, tendë e hyjshme* ti për Fjalën Zot,* e vetmja pa cen,* epërsin' në qashtërsi e ke mbi engjëjt,* i ndyrë jam më shumë' se gjithë njerëzit,* plot me mëkate mishore, pastromë pra,* me rrëqe të ndërmjetimeve pranë Birit tënd;* më jep ti përdëllimin e madh, o e thjeshtë'. Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësoret e shenjtit dhe Hyjlindësore, e ngjashme: Mbrojtje që s'sulmohet dot* për nevojtarët,* ndërmjetim i gatshëm je* për sa shpresojn' në ty, o Zonj',* prej çdo rreziku çliromë ti,* mos më shpërfill pra, se je për të gjith' ndihmë. Kanunet: i së kremtes dhe i shenjtit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e së kremtes dhe Ndenjësoret: e shenjtit dhe e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtit dhe Sinaksari. Zbritësoret e Pashkës. Më të nderuarën. Dërgimësoret: e shenjtit dhe e së kremtes. Lavdërimet e shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani [Lavdi] i së kremtes. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e shenjtit.*

Në Liturgji. Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e së kremtes (ngjallësore), e shenjtit dhe e kishës. Kontaqi i së kremtes. Apostulli dhe Ungjilli i shenjtit. Kungatore: Në kujtim të përjetshëm. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.

12. Nëse bie të mërkurën e Mespentikostisë:

Të martën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 3 të së kremtes dhe 3 të shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani i së kremtes. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e së kremtes. Pasvargjet e së kremtes. Lavdi i shenjtit. Tani i së kremtes. Përlëshoret: e së kremtes, e shenjtit dhe përsëri e së kremtes.

Të mërkurën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Litia e shenjtit, d.m.th. Tropari i parë i Litisë së shenjtit të kishës. Lavdi i shenjtit. Tani një i së kremtes. Përlëshorja e shenjtit. Në Mëngjesore, Ndenjësoret e shenjtit dhe në vend të Hyjlindësoreve, Ndenjësoret e së kremtes. Kanunet: të dyja të së kremtes dhe i shenjtit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtit. Ndenjësoret e shenjtit dhe (e dyta) e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e së kremtes. Sinaksari i ditës dhe i së kremtes. Zbritësoret e së kremtes (Detin e mpikse). Në vend të Më të nderuarën, Ode IX e Kanuneve. Dërgimësoret: e së kremtes, e shenjtit dhe për-

sëri e së kremtes. Lavdërimet: 3 të së kremtes dhe 3 të shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani i së kremtes. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e së kremtes.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret e së kremtes dhe e shenjtit. Kontaqi i së kremtes. Apostulli i shenjtit dhe Ungjilli i së kremtes. Në vend të Të meriton, Zbritësorja e Odes IX. Kungatore e së kremtes [dhe Në kujtim të përjetshëm]. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.

13. Nëse bie në ditët Paskremtore të Mespentikostisë **(përveç së Dielës së Samaritanes):**

Në Mbrëmësore, Thirrtoret: 3 të së kremtes dhe 3 të shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani i së kremtes (të premtën në mbrëmje, Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës që po kalon: Si të mos admirojmë). Hyrje. O dritë gazmore. Proqimëni i ditës. Pasvargjet e shenjtit (të premtën në mbrëmje, e para ngjallësore dhe të shenjtit). Lavdi i shenjtit. Tani i së kremtes. Përlëshoret: e së kremtes, e shenjtit dhe përsëri e së kremtes.

Në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Litia e shenjtit, d.m.th. Tropari i parë i Litisë së kishës. Lavdi i shenjtit. Tani një i së kremtes. Trishenjtë. Përlëshorja e shenjtit. Në Mëngjesore, Ndenjësoret: e shenjtit dhe në vend të Hujlindësoreve, të së kremtes (por të shtunën, pas Stihologjisë së parë, Ndenjësoret e Pentikostarit. Pas Stihologjisë së dytë, të dyja Ndenjësoret e shenjtit dhe një e së kremtes). Ne që pamë ngjalljen. Psalmi 50. Kanunet: një i së kremtes dhe i shenjtit. Pas Odes III, Ndenjësores e shenjtit dhe një i së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtit dhe Sinaksari. Zbritësoret e së kremtes (Detin e mpikse). Më të nderuarën. Dërgimësoret: e shenjtit dhe e së kremtes. Lavdërimet e shenjtit (të shtunën, tri të Pentikostarit dhe tri të shenjtit). Lavdi i shenjtit. Tani i së kremtes. Dhoksologjia e Madhe dhe Përlëshorja e shenjtit.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e së kremtes, e shenjtit dhe e kishës. Kontaqi i së kremtes. Apostulli dhe Ungjilli i shenjtit. Kungatore: Në kujtim të përjetshëm. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.



NË MBRËMËSORE

*Thirrtores**3 të së kremtes dhe 3 të shenjtit:**Ting. IV Os jeneon en mártisin*

Ke duruar përndjekje ti* dhe pësove rreziqe, sulm,* oshënar hyjfolës, o Athanas i Madh,* derisa flake mashtrimin ateist të Ariosit* dhe prej pabesis' së tij* grigjën tënde e ruajte,* se orthodhoksisht* dogmatise që Biri, Shpirti janë të njëqenshëm tok me Atin, meshtar i fortlum, i shenjt i at'.

Feksi të errësuarit*¹ drita e predikimit tënd,* shkele dhe mashtrimin e plotë, Athanas,* dhe rrezikoje për besën si barí i vërtetë ti;* si themel që s'tundet dot,* je për Kishën e Krishtit, baz',² i kënduar fort;* prandaj prajemi mbledhur edhe të nderojmë me gëzim, dhe psalim melodikisht në kujtimin tënd.

Çdo virtyt praktikove drejt,* shenjt i hyjfrymëzuar mjaft,* me zell, këmbëngulje, dhe u krezmove ti* përmes vajosjes së shenjt' prej Shpirtit,³ qartas u bëre pra,* o i hyjshëm, një meshtar* dhe vërtet një barí, ushtar,* mbrojtës për besim;* ndaj kujtimin tënd mbarë Kisha e lëvdon dhe e kremton hyjnisht, edhe Shpëtimtarin e lavdëron.

Lavdi

Ting. Tërth. II I Gjermanoit patriark

Le të himnojmë të gjithë hierarkun e Krishtit, Athanasin, sepse asgjësoi tërë mësimet e Ariosit dhe shpall fuqishëm në mbarë botën pushtetin e Trinisë së Shenjtë, një Perëndi në tre Persona të pandarë; atij dhe i ndërmjeton për ne që besërisht kremtojmë kujtimin e tij.

Tani

*I së kremtes**Në Liti*

Lavdi

Ting. III I Gjermanoit patriark

Trumbeta e madhe e Kishës, Athanas i shumëvujturi fitimtar, e mbledh sot Kishën për dëfrim. Me gëzim të gjithë ne, o besnikë, le të shkojmë të presim panairin e bariut të mirë,⁴ duke lavdëruar me himne lodhjet e tij të hyjshme, që falë ndërmjetimeve të tij të marrim prej Krishtit Perëndi përdëllimin e madh^{4a}.

Tani

*I së kremtes**Pasvargje**Ting. Tërth. I Heris askitikon*

G'zohu, në çdo virtyt je kanun,* atle-
tizove për besimin fuqishëm krejt;* e
mbyte porsi me nerva me fjalën tënde
plot nder* pra kakodoksinë e Ariosit;*
na shpall dhe mëson një forc'* të
Hyjnisë, e përcakton* në tri substa-
nca,* vetëm nga mirësia thjesht* i ka
sjellë kjo* në të qenët të gjitha tok,*
sa duken edhe sa mendojmë, o atë;
na sqaron* sa nuk kuptojmë ne leht'⁵
në Krijesën që bëri Fjala Zot;* pra lyp
Krishtin tonë,* të dërgojë përdëllimin
e madh^{4a} te shpirtrat tan'.

Varg: Goja ime do të flasë urtësi dhe
studimi i zemrës sime mençuri.

G'zohu, je për patrikët themel,* tru-
mbet' me zë të ëmbël, mendje me
lavd, me nam,* dhe gjuhë e mprehtë
shpatë,⁶ je sy i kthjellët⁷ gjithnjë,*
qartësi në dogma dhe përpikëri,* barí
i vërtetë ti* dhe kandil plot me dritë-
sim,* satër që lëndën* mbarë të here-
zive pret* dhe e djeg me zjarr*⁸ pra
prej Shpirtit; je shtyllë ti,* që nuk rrë-
zohet, pìrg i palëkundur; ke shpallur
fort* forcën e përmbisubstancshme
të Shën Trinisë; pra lyp atë* si dhe
përgjëroju* të dhurohet përdëllimi i
madh^{4a} te shpirtrat tan'.

Varg: Priftërinjtë e tu, o Zot, do të ve-
shin drejtësi dhe oshënarët e tu do të
ngazëllohen.

G'zohu, sepse vërtet disponon* si
emër jetën pa mbarim, mburrësh me
këtë;* si turtull i bukur bashkë me
zogj të shenjtë me hir* për në qielloret
fluturove lart* nga dheu; atje dëfren*
re martirësh⁹ me plot nderim,* atje
ka dritë* që askurrë nuk perëndon,*
ngazëllim pa fund* duket haptas si
dhe shkëlqim* shenjtorësh,¹⁰ dhe
rreshtime qiellore edhe një zë* shumë
i hyjshëm dëgjohet nga sa kremtoj-
në,¹¹ dhe Krishti Zot* atje tok me ta
rri,* dhe dhuron, jep përdëllimin e
madh^{4a} në botën mbar'.

Lavdi

Ting. III I Gjermanoit patriark

Përsëri Nili rrjedhartë dhe sinonimi i
pavdekësisë na erdhi me ngjitje të
mira¹² përmes kujtimit të përvitshëm,
dhe përmyt me derdhje rrëkearta të
pavdekësisë; dhe duke furnizuar me
ushqim ambrozie, na mëson me anën
e të hyfjolurit të lartë, që t'i falemi
pushtetit të pandarë të Triadhës; dhe
me mësimdhënie hyjnore si det, ujit
bollshëm mendjet e besimtarëve dhe
ndërmjeton për shpirtrat tanë.

Tani

I së kremtes

Përlëshore

Ting. III Thias písteos

Si u bëre shtyll' * Orthodhoksie, * ke mbështetur fort * Kishën² me dogma * prej Hyjnisë, Athanas hierark, sepse * e predikove të njëqenshëm Birin tok * me Atin, dhe turpërove Ariosin; * atë oshënar, pra lut Krishtin Perëndi- në Zot, * të na dhurojë përdëllim të madh^{4a} me hir.

Dhe i së kremtes



NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësove
Ting. III Thias pisteos*

Armatose fort * Kishën me dogma * të hyjnueshme * orthodhoksie * dhe kosite herezi me mësimin tënd; * e kreve udhën e shpresëtarisë drejt, * si Pavli ruajte besën, prandaj të pret * ty, i fortkënduar, rreth drejtësie dhe kuror' *¹³ për lodhjet dhe mundimet, që i hoqe, at'.

Lavdi *dhe* Tani
I së kremtes

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësove
Ting. IV Epefanis símeron*

Si një yll pa perëndim, * edhe pas vdekjes, * përgjithmonë me shkëlqim *

prej dogmës sate tërësin' * e orthodhoksëve po ndriçon, * o Athanas mist hyjnoresh, i urti shenjt.

Lavdi *dhe* Tani
I së kremtes

*Kanunet: i Pashkës dhe i shenjtit.
Zbritësoret e Pashkës.*

*Kanuni i shenjtit
Ting. III
Ode I
Asomen to Kirio*

Meqenëse fitoi lavdi të pavdekshme në Kishë në saje të fjalëve të hyj- frymëzuara, le të nderojmë të gjithë siç i ka hije Athanasin, të cilin e lartë- soi edhe pas vdekjes Krishti Perëndia, si shërbëtorin e vet.

Pasi e zgjate mendjen në thellësi te- orie në Shpirtin e Shenjtë, o atë hyj- mist, hulumtove pasurinë e fjalëve të hyjshme dhe pasurove botën.

Ata që dimërojnë në oqean mashtri- mi, o atë, si një pishtar i ngritur i mēsi- meve hyjnore, i drejton përherë drejt limanit¹⁴ të Hirit me anën e qetësisë së fjalëve të tua.

Hyjlindësore

Të himnojmë, o Virgjëreshë e kulluar, karrocë keruvike,¹⁵ prej nga lindi Pe-

rëndia, sepse vetëm ti u bërë burim paprishjeje, që u gufon të gjithëve jetë,¹⁶ prej të cilit duke nxjerrë, marrim shërime.

Ode III

Estereothi i kardhia mu

Me rrufetë e fjalëve të tua, o hierark, errësive doktrinën e verbër të Ariosit, duke u bërë syri¹⁷ i shpresëtarëve.

Meqë celebrove për Krishtin, në Hir u veshe me rrobën e së vërtetës deri në këmbë,¹⁸ e cila u end nëpërmjet mundimeve dhe djersës sate, o oshënar.

Si komandant i rreshtimit të hyjmbledhur,¹⁹ preve aleancën që luftonte kundër Perëndisë, pasi u armatose me thikën e Shpirtit.²⁰

Hyjlindësore

Përgjëroju që të shpëtojmë, o Hyjlindëse, që pranove në mitrën tënde Perëndi, dhe e linde të mishëruar atë, i cili i nxori njerëzit nga prishja.

Kontaqi i së kremtes

Ndenjëso

Ting. III Tin oreótita

Si hierark besnik* qortove herezi,* tërë mashtrimin bosh,* dhe predikove ti* Orthodhoksin'; në botë shpa-

lle dogma, ku njohim vetëm* nga natyra një Hyjni* të njëqenshme dhe pa trazim* në Persona, në Trini;* ndaj të mbledhur, o Athanas,* kujtimin tënd kremtojmë me besë,* o shpresëtar i madh dhe atë.

Lavdi dhe Tani

I së kremtes

Ode IV

Isakikoa tin akoín su

O atë oshënar, duke pasur në zemrën tënde burimin e jetës,¹⁶ vadite mbarë rruzullin.²¹

O atë oshënar, në mishin tënd plotësive pësimet e Zotit²² për hir të Kishës së tij.

O atë oshënar, duke u përndjekur nga ateistët, dëbove nga grigja jote mashtrim arianist.

Hyjlindësore

O nënë e pacenuar, e bekuar, Virgjëreshë e dëlirë, shpëtoji nga çdo nevojë ata që të himnojnë.

Ode V

Tin sin irinin dhos imín

Drejtësi mësoni ju që banoni në dhé,²³ duke u edukuar me fjalët e Athanasit, sepse u dëftua me anën e

besimit goja e Fjalës që është para jetëve.

Pasi u shfaqë pirg i pamposhtur i Kishës së Krishtit, Perëndisë tonë, o i lumur, bëre të kalbeshin të gjitha makinacionet e Ariosit.

O Zot, me përgjërimit e hierarkut tënd, dërgona poshtë si shpërblim dhembshuritë e tua dhe bëna të vyer për mbretërinë tënde si i dhembshur.

Hyjlindësore

Le të përhimnojmë atë që mbiu prej Davidit, sepse zuri në bark Birin e Perëndisë dhe e lindi në mish, e cila dhe pas lindjes mbeti Virgjëreshë e dëlirë.

Ode VI

Evóisa en stenagmís

O i lumur, Kishën e Krishtit e përpu-nove me të vërtetë për parajsë, pasi mbolle rrënjësisht në të fjalën shpresëtare²⁴ dhe preve gjembat e herezive.

O hyjprurës, u tregove Nil mendor, lumë i Hirit, frytdhënës në mësimdhënie shpresëplota te besnikët, duke i ujitur të gjithë dhe duke i mëkuar anët.

Hyjlindësore

Përhimnojmë nënën e pacenuar, Virgjëreshën pas lindjes, që mbajti në bark Fjalën që s'e nxë asgjë, të bashkëpërjetshme me Atin dhe Shpirtin.

Kontaqi

Ting. II Tis ton ematon su

Dogmat e Orthodhoksisë i mbolle ti,* çrrënjose gjembat e besës së rreme bosh* dhe shumëfishove far' bese²⁴ drejt,* o oshënar, përmes shiut të Shenjtit Shpirt,* prandaj lavdërojmë kujtimin tënd.

Shtëpia

Besimtarë, le të mburrin sot me këngë kujtimin tejet festiv të Athanasit, sepse ky nëpërmjet dogmave të së vërtetës mposhti Ariosin mashtrues, Evnomin së bashku me Savelin, dhe ua dorëzoi zjarrit të amshuar, që të bëhen shkrumb,²⁵ sepse blasfemuan padrejtësisht kundër mishërimit të Shpëtimtarit, që e paralajmëruan të gjithë profetët, prandaj lavdërojmë kujtimin e tij.

Sinaksari

Më 2 të të njëjtit muaj, kujtimi i transferimit të lipsanit të atit tonë ndër shenjtore Athanasi i Madh, patriarch i Aleksandrisë.

Vargje: O Athanas, ku transferohesh?
Mos vallë të dërgojnë/ përsëri në
internim, edhe pse je i vdekur?
Në të dytën, lipsani i Athanasit doli
nga varri.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirëve
të shenjtë, Esperit dhe Zoia, bashkë-
shorte e tij, si dhe i fëmijëve të tyre,
Qirjako dhe Theodhuli.

Oshënar Jordan çudibërësi mbaron në
paqe.

Vargje: Ndonëse rrodhe në gji toke, o
Jordan,/ derdh andej një jordan mre-
kullish.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o
Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII *Tris Pedhes en kamino*

Pasi e përpunove zemrën si koshere
të mirash, na buron ëmbëlsi Ortho-
dhoksie, të cilën, kur e vjelim, thër-
rasim: I bekuar je, o Perëndi i etërve
tanë.²⁶

Nuk u frikësove nga pushteti i ate-
istëve, o oshënar, por, duke u mbushur
me guxim shpresëplot në shpirt, thër-
rrisje: I bekuar je, o Perëndi i etërve
tanë.²⁶

Duke qenë i pandarë nga Shpirti, o
oshënar, e mbajte të papjesëtueshëm

predikimin e Trinisë, duke thirrur: I
bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.²⁶

Hyjlindësore

Linde prej një Virgjëreshe si të pël-
qeu, o Zot, dhe e çlirove nga prishja
jetën tonë; prandaj thërrasim: I be-
kuar je, o Perëndi i etërve tanë.²⁶

Ode VIII *Ton eks anarhu tu Patrós*

Utregove qartazi i pavdekshëm në-
përmjet realitetit, pasi i fole kozmosit
dogmat e pavdekësisë, prandaj dhe
ne së bashku me engjëjt Krishtin e
himnojmë, e bekojmë dhe e përmbi-
lartësojmë në gjithë jetët.²⁷

Pasi dogmatise me besën e mirë
Triadhën si të bashkësubstancshme,
kritikove edhe besimin e keq të Sa-
velit me të Ariosit; prandaj, meqenë-
se u larguam nga mpleksjet e tyre
të kundërta, Krishtin e himnojmë, e
bekojmë dhe e përmbilartësojmë në
jetë.²⁷

Hyjlindësore

O besimtarë, atë që banoi në barkun
e nënës së virgjër dhe lindi prej saj
në mënyrë të parrëfyeshme, dhe për-
sëri pas lindjes e ruajti atë Virgjë-
reshë, Krishtin, si Perëndi të vërtetë,

e himnojmë, e bekojmë dhe e përmbilartësojmë në jetë.²⁷

Ode IX

Se akatáflekton vaton

Si praktikisht ashtu edhe logjikisht e tregove shpirtin tënd pasqyrë pa njollë të Perëndisë,²⁸ në rruzull shkëlqen shfaqjet hyjnore, o i tërëlum.

U dallove trumbetë me zë të qartë dijeje, o hyjmendës, duke ngritur me fjalë burrërie mendimet tona kundër burrave kundërshtarë të Perëndisë.

Të madhështojmë me himne ty, të dëftuarin me të vërtetë kanë urtësie, që na vadit²⁹ me pijen jodehëse të shpresëtarisë.

Hyjlindësore

Ne besimtarët të madhërojmë ty, o Perëndilindëse e kulluar, që zure në bark Fjalën e panxënshme dhe e linde në mish pa shpjegim.

Dërgimësore

Ting. III O uranón tis astris

Me himn të madhështojmë,* o lavdi i Kryepriftëris',* mburrje e pavdekësisë,* Egjipti të ka rritur ty;* për besëmirët je mbrojtës,* pasi Ariosin mposhte.

Lavdërime

Ting. IV Os jeneon en mártisin

Gjithë lëndët e herezis'* digjen si shkarpë, o i lum,* me doktrinën tënde të zjarrtë, Athanas;* në thellësi të kuptimeve, ushtria që s'bindej dot,* se besonte në gabim,* mbytet,³⁰ o oshënar i madh;* por stoliset nur* përdit' Kisha e shpresëtarëve nëpërmjet dogmave të tua dhe të nderon me një zë të madh.

(2x)

Me shkëlqimin e fjalëve* të hyjnueshme që ti the,* gjithë Kisha, o oshënar, stoli po vesh,* me zbukurimet e besës hijeshohet shkëlqyeshëm* dhe nderon detyrimisht,* Athanas shenjt, kujtimin tënd* të kremtueshëm,* o lavdi priftërinjsh dhe predikues i mahnitshëm i besimit, o luftëtar i Trinisë Zot.

Me purtekën e dogmave* bishat, ujqit mendorë, larg* i dëbove prej Kishës³¹ së Jisuit Zot* dhe e rrethove me mur fortifikimi, i urtë fort,* dhe e shfaqe pa cenim* dhe pa plagë te Krishti yt;*³² hierark i madh,* lyp atë të çlirohen nga rreziqet edhe prishja sa kremtojnë kujtimin tënd besërisht me nder.

Lavdi *Ting. III*

Lavdinë e madhe të priftërinjve, Athanasin ngadhënjimtar të pamposh-tur, le ta mburrim në mënyrë të hyj-shme, sepse ai, pasi preu kolonat e herezive me fuqinë e Shpirtit, ngriti në kozmosin mbarë trofetë e Ortho-dhoksisë, duke numëruar besërisht misterin e Trinisë për shkak të veço-risë së Personave; dhe prapë, duke i bashkuar pa përzier në një, për shkak të identitetit të esencës, dhe duke theologuar keruvikisht, ndërmjeton për shpirtrat tanë.

Tani

*I së kremtes**Dhoksologjia e Madhe.*

Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanuni i së kremtes Ode III, dhe i shenjtit Ode VI. Apostulli dhe Ungjilli i shenjtit. Kungatore: Në kujtim të përjetshëm.

*CITIME*¹ Rom. 2.19² I Tim. 3.15³ Vep. 10.38; I Joan 2.20⁴ Joan 10.11,14^{4a} Num. 14.19 etj.⁵ II Petr. 3.16⁶ Ps. 44(45).2⁷ Matth. 6.22; Lluk. 11.34⁸ Matth. 3.10; Lluk. 3.9⁹ Hebr. 12.1¹⁰ Ps. 109(110).3¹¹ Ps. 41(42).5¹² Ps. 83(84).6¹³ II Tim. 4.7-8¹⁴ Ps. 106(107).23-30¹⁵ Jez. 1.13-26¹⁶ Joan 4.14¹⁷ Jov 29.15¹⁸ Eks. 25.6 etj.¹⁹ Jis. N. 5.14²⁰ Ef. 6.17²¹ Gjen. 2.6²² Kol. 1.24²³ Is. 26.9²⁴ Matth. 13.3-23; Mark. 4.3-20; Lluk. 8.5-15²⁵ Matth. 3.12; Lluk. 3.17²⁶ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 28²⁷ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34²⁸ Urt. Sol. 7.26²⁹ Fja. Urt. 9.2-5³⁰ Eks. 14.27-28³¹ Vep. 20.29³² Ef. 5.27

MË 5 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i martires së madhe
e të shenjtë Irini e lavdëruar.

NË MBRËMËSORE

Thirrtores

3 të së kremtes dhe 3 të shenjtore:

Ting. I Panëfimi mártires

Modeste, u veshe me mantel* të shkëlqyer, që u skuq* me gjakun tënd si me purpur, e stolitur bukur krejt* rende lart drejt Mbretit* dhe Ndërtuesit të Gjithësis¹ që aspirove; prej tij vërtet, o triumfuese, * për fitoren more ti kuror', * o martire, mbretëron me të² tani.

Durove sulm zjarri, përvëlim, * shqyerje kudo në trup* ti, o e thjeshtë e gjithëfamshme, se shikoje lart, * pra ku ka shpërblime, * që i bëri gati Krishti³ vetëm për ata që me nxehtësi e dëshiruan fort, * porsi dhëndrin⁴ plot me bukuri* shpirtërore, dhe që kanë mall për të.

Të joshi, Irini plot me lavd, * dashuria për Jisun', * urreve hyjni të kombeve, statuja të pashpirt, * dhe e ngrite veten* qartazi si lapidar⁵ hyjdijeje për sa të shikonin, se atletizove drejt, * e mbarove udhën, ruajte* pa cenim besimin,⁶ athlofore ti.

Lavdi *dhe* Tani

I së kremtes

Pasvargjet e së kremtes

Përlëshore

Ting. IV Tahí prokatálave

Martire Irini e thjeshtë, e madhe ti je, * arkondin e paqes⁷ e ke gjurmësuar, me aprovimin e Perëndis'; * more emrin e paqes* dhe u shfaqe me plot lavd, * nga kurthet e armikut mëçurisht ti u shmange, * garove si vajz' e urtë; paqen kërko për ne.

Dhe e së kremtes



NË MËNGJESORE

Kanunet: i së kremtes dhe

i shenjtore, që ka Akrostihidhë:

*“Me lutjet e tua, mbulomë,
o martire Irini”.*

Ting. IV

Ode I

Ásomé si, Kírie

Meqenëse je, o Krisht, kurora e athlofores, me ndërmjetimet e saj, dhuroji botës paqe⁸ dhe lavdi të pafishkur⁹ atyre që të himnojnë.

Qëndron pranë dhëndrit⁴ tënd, o Irini emërmadhe, duke shkëlqyer me lavdi virgjërie dhe duke u stolisur me bukurinë e dëshmisë sate.

Përgjëroju dhëndrit⁴ tënd, o Irini hyj-mendëse, që të bëhet i butë me Kishat, dhe t'u japë faljen e mëkateve atyre që të himnojnë.

Hyjlindësore

Përmby fjalë e konceptim linde pa-shprehshëm Fjalën Perëndi, që u bë mish¹⁰ dhe u shfaq¹¹ sipas nesh, o Virgjëreshë e shenjtë.

Ode III

Tokson dhinatón isthénise

Ndjeve* ti aromën, miron pra* që u zbraz¹² edhe aromatizoi planetin fort* dhe me hir, ndaj me krah' u bëre* për dëshirën e tij, vajz' me lavd.

Kishe* si përkrahës, aleat*¹³ Perëndinë Zot, e tërurta vajz', në atletizim;* ndaj, pasi u kurorëzove,* mposhte krejtësisht tiranët ti.

Kullë* e patundur për virtyt,* gjithashtu banesë shpresëtarie u bëre ti* edhe strehë për burrëri dhe* mençuri,¹⁴ o e lavdishme fort.

Hyjlindësore

Rrodhi,* o e pacenuar fort,* deri te

ti vdekja, sepse u ndal kur sulmoi kjo* tët Bir; nisje pavdekësie,* o e Virgjër, ne të quajmë.

Irmosi: Tokson dhinatón isthénise

»**H**arku* i të fortëve u tret* dhe të »dobësuarit janë ngjeshur me plot »fuqi,*¹⁵ ndaj në Zotin u sigurua* »zemra ime¹⁶ pa u tundur dot.

Ndenjëso

Ting. I Ton tafon su Sotír

O Krisht, e virgjra Vajz'* me nxitim tejkaloi* të gjitha pra sa duken, se ke bukurinë,* e cila e plagosi;¹⁷ ndaj hijeshinë e saj të plot'* tok me trupin kjo* ia dorëzoi torturës,* t'ia shfarosnin krejt* ndëshkimet; o Zot, e fute* lart në nusërore⁴ ti.

Lavdi dhe Tani

I së kremtes

Ode IV

Tis sis epí tis jis parusias

Ai që të jepte si çmim paqen,⁸ ti që ke emër sinonim me paqen, duke të parë të luftosh për atë, të mbushi me moral burrëror dhe fuqi, o martire.

Nëpërmjet gatishmërisë tepër të fortë kapërceve plogështinë e femrës, dhe me qëndrueshmëri kritikove

ata që i shërbenin mashtrimit, o martire e tërëlumur.

Tregove durim tepër të perëndishëm dhe hodhe poshtë arrogancën e tiranëve, duke i thirrur dhëndrit⁴ tënd: Lavdi fuqisë sate, o Zot.

Me himnime të paheshtura dhe me lutje bekove Zotin, o hyjmentdëse, dhe drejt tij vrapove lart, që të shikoje lavdinë e pashprehshme.

Hyjlindësore

Oe tërëkulluar, të ngazëlluar ne që shpëtuam me anën tënde, ty të brohorasim me zë hareje: Gëzohu, o Virgjëreshë e tërëthjeshtë; gëzohu, o Perëndilindëse e gjithëhimnuar.

Ode V

Ton fotismón su Kírie

Oe lavdëruar, me mentalitet tepër burrëror pohoje fuqishëm Perëndinë e të gjithave; ndërsa me fjalë të qëndrueshme, i turpërove kundërshtarët, o athlofore.

Dëshiroje të shkoje pas gjurmëve të pësimit të Krishtit¹⁸ dhe, duke e imituar, e ndiqje me ngrohtësi,¹⁹ duke atletizuar së tepërmi në beteja për hirin e Zotit, o e tërëpasur.

Reshte martirësh ia blatove Krishtit, o e lavdëruar, duke i futur me të

vërtetë në mistere me urtësinë dhe theologjinë tënde, si dhe me fjalën e Hirit.²⁰

Hyjlindësore

Duke depërtuar në misterin e zënies dhe të lindjes sate hyjnore e të pashprehshme, të bekojmë me tërë devotshmërinë, o Perëndilindëse e tërëhimnuar.

Ode VI

Evóise protipón

Engrite lart* rënien poshtë të Evës²¹ stërnënë, ti* athlofore,* si vithise fuqin' e armikut djall* dhe me hir të shenjtë* ia rrëzove atij përdhë vetullën.²²

Meqë kishe,* o Irini, qëndrimin e fortë, ti* si një trime* shpirtërisht dole kundër tiranëve,* dhe prej Perëndisë* Krisht ke marrë kurorë fitoreje.

Me gjakun tënd* gjatë martirizimit, e bërë krejt* më të hijshme* bukurinë pa cen të natyrës ti,* kur me forc' pësove* lloj-lloj garash, martire e virgjër krejt.

Hyjlindësore

Tërthorazi* Hyjshikuesi shfaqti misterin tënd,* shtatzëninë,* kur pa se ferra ndizej, por s'digjej dot,*²³ e

gjithmonëvirgjër,* e dëlirë dhe Perëndilindëse.

Irmosi: Evóise protipón

»Varrimin tënd* të triditshëm e para-
»skiconte qart'* duke thirrur,* kur në
»një peshk të madh lutej, o Jisu,* shën
»Jona profeti:*²⁴ Mbret i forcave,^{24a}
»prej prishjes më çliro.²⁵

Kontaqi

Ting. IV O ipsothis en to stavró

Nusen e Krishtit ne* të gjithë himnojmë* që prej së vdekurish* u ngjall edhe frikshëm* me shenja e lëvdoi Perëndia yn' Zot,* se kjo bukurvirgjëreshë vajz'* grup të madh të pabesësh* e tërhoqi në besim* edhe mori nga Zoti* pra emrin e krishter',^{25a} se engjëlli* nga Penelopi,* Irini e quajti.

Shtëpia

Meqenëse, o modeste e tërëkënduar, e lavdëruar, që foshnjë u dogje prej dashurisë së dhëndrit Krisht,⁴ rende si drenushë e etur te burimet²⁶ që rrjedhin gjithmonë; dhe, pasi e ruajte veten tënde në atletizëm, hyre si nuse e ndritshme, e zgjedhur, e stolisur dhe e zbukuruar²⁷ në dhomën vërtet të paprishshme të Ndërtuesit tënd, dhe

u duke e kurorëzuar, kur prite si ar nga dhëndri i paprishshëm, çmimin e fitores së garës sate.

Sinaksari

Më 5 të të njëjtit muaj, kujtimi i martires së madhe e të shenjtë Irini.

Vargje: Pasi vdiqe me shpatë dhe jetove në mënyrë të huaj,/ vdiqe përsëri me paqe, o Irini.

Ndonëse u pre, Irini u zgjua/ dhe vdiq në të pestën.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atletizimit të martirëve të shenjtë Neofiti, Gai dhe Gajani. Dhe mbledhja e tyre kryhet në kishën e respektuar dhe të nderuar të Anargjendëve të lavdëruar dhe çudibërës, Kozma dhe Damian, që është në vendin e Darios.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë ndër shenjtorë Efthimi i Madhitit.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i përrurimit të kishës së Perëndilindëses së Përmbishenjtë në vendin e Qiros.

Me ndërmjetimet e shenjtorëve të tu, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII

Avramiei poté

Duke qëndruar e kurorëzuar pranë fronit të Zotit²⁸ tënd, o e thjeshtë, rua-

ji rreth e rrotull ata që thërrasin besërisht: O Perëndi i etërve tanë, i bekuar je.²⁹

Udenjësove, o martire Irini e admirueshme, të kërcesh rreth e rrotull në tenda qiellore, duke thirrur: O Perëndi i etërve tanë, i bekuar je.²⁹

Meqë dëshiroje të arrije bukurinë e të dashuruarit tënd, o Irini, durove dhimbje mundimesh, duke thirrur: O Perëndi i etërve tanë, i bekuar je.²⁹

Hyjlindësore

Duke ndjekur besërisht thënien e buzëve të tua, të lumërojmë, o Hyjnënë,³⁰ duke i thirrur Birit tënd: O Perëndi i etërve tanë, i bekuar je.²⁹

Ode VIII

Pedhas evajís

Atletizove me trimëri, o Irini e lumur, dhe i mposhte tiranët, duke pasur fuqinë e paluftueshme të Zotit tënd, të bashkëpunonte e bashkëvepronnte me ty; dhe thërrisje: Himnojeni Zotin dhe përmbilartësojeni në gjithë jetët.³¹

O Irini e tërëlavdëruar, si një vashë e plagosur nga dashuria,¹⁷ shkove pas dhëndrit tënd,³² duke mbajtur në mishin tënd pësime të tij³³ dhe duke kënduar: O vepra, Zotin himnojeni dhe përmbilartësojeni në gjithë jetët.³¹

Durimi yt në tortura, o Irini kurorëprurëse e lavdëruar, përqeshi ata që ndiqnin kotësinë dhe ateizmin; ndërsta ti psalje besërisht: O vepra, Zotin himnojeni dhe përmbilartësojeni në gjithë jetët.³¹

Hyjlindësore

Urtësia e Perëndisë, mjeshtërja e të gjithave,³⁴ kur fushoi në barkun tënd, o nënë e virgjër, ndërtoi shtëpinë e saj³⁵ të logjikshme dhe të gjallë, dhe shpëtoi botën që thërriste: O vepra, Zotin himnojeni dhe përmbilartësojeni në gjithë jetët.³¹

Irmosi: Pedhas evajís

»**D**jemat* e dënuar për t'u djegur, »prej zjarrit i ka shpëtuar lindj' e Zotit »Krisht, si simbol në lashtësi;*³⁶ dhe »si një veprim tani,* dhe tërë botën »po e mbledh për këng' e lavdërim:* »Himnojeni ju veprat e Zotit* dhe e »lartësoni përmbi të gjitha jetët.^{31*}

Ode IX

Eva men to tis parakoís

O e bukurvirgjër, që lart po kërcen me gaz* rreth të dashuruarit, kërko* paqen për botën, o Irini,* dhe faljen e mëkateve, shkeljeve,* për sa besërisht festojnë kujtimin tënd* të tërëhyjshëm dhe që sjell shkëlqim.

Brenda nusërores të fushoi Krishti Zot* si martire dhe të virgjër ty* me virgjëreshat dhe ushtritë,* grupimet e dëshmorëve; dhe atje* gëzon, e lavdishmja kurorëprurëse;* të lumërojm', Irini, gjithë ne.

Hapi dyert qiellore edhe shpirtin tënd* të panjollë krejt e priti lart* Mbreti i vetëm i gjithçkaje,* Zot drejtësie edhe arkond është,* Irini, që emër paqeje mban hyjnisht;* të lumërojmë që të gjithë ne.

Hyjlindësore

O e tërëpacenuar, pranë Birit tënd* ke guxim që kurrë s'turpëron;* e Tërëshenjtë, lyp atë pra* t'u japë gjithë Kishave një mendje,* dhe paqe³⁷ le të dhurojë në botën mbar',* që të të madhështojmë gjithë ne.

Irmosi: Eva men to tis parakoís

»**E**va nga sëmundja e mosbindjes³⁸
»mori keq* si banues brenda saj mall-
»kim,*³⁹ por, o Hyjlindëse e virgjër,*
»ti, nëpërmjet lastarit të shtatzënis',*
»për botën e lulëzove bekimin krejt;*
»ndaj ne të gjith' të madhështojmë ty.

Dërgimësore

Jineqes akutísthite

O bukurvirgjëreshë vajz',* martire, të forcoi* Kryqi i Krishtit, Zotit tënd;*

çdo arrogancë tiranësh,* trime, në gar' e mposhte pra,* o Irini e urtë fort,* o emërmadhe, more ti* në ndeshje çmim për fitoren;* me mall të mburrim, për ne lyp.

Dhe e së kremtes

Pasvargjet e së kremtes. Dhe të tjera si zakonisht.

CITIME

¹ Sirak 24.8

² II Tim. 2.12

³ I Kor. 2.9

⁴ Matth. 9.15; 25.6,10; Mark. 2.19-20; Lluk. 5.34-35; Joan 3.29; Apok. 21.2,9; 17-20

⁵ Gjen. 35.14

⁶ II Tim. 4.7

⁷ Is. 9.6

⁸ Joan 14.27

⁹ I Petr. 5.4

¹⁰ Joan 1.14

¹¹ I Tim. 3.16

¹² Kënga 1.3

¹³ II Mbret. [Sam.] 22.3 etj.

¹⁴ Urt. Sol. 8.7

¹⁵ I Mbret. [Sam.] 2.4

¹⁶ I Mbret. [Sam.] 2.1

¹⁷ Kënga 2.5

¹⁸ I Petr. 1.11

¹⁹ I Petr. 2.21

²⁰ Lluk. 4.22; Vep. 14.3; 20.32

²¹ Gjen. 3.2-6

²² Fja. Urt. 24.36 (Mas. 30.13); Is. 10.12

²³ Eks. 3.2-5

²⁴ Matth. 12.40

^{24a} Ps. 67(68).13

²⁵ Jona 2.7

^{25a} Vep. 11.26; 26.28; I Petr. 4.16

²⁶ Ps. 41(42).2

²⁷ Ps. 44(45).10

²⁸ III [I] Mbret. 17.1; 18.15;

IV [II] Mbret. 3.14; 5.16

²⁹ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 28

³⁰ Lluk. 1.48

³¹ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34

³² Kënga 1.4

³³ Gal. 6.17

³⁴ Urt. Sol. 7.21

³⁵ Fja. Urt. 9.1

³⁶ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 25

³⁷ Joan 14.27

³⁸ Gjen. 3.3-6

³⁹ Gjen. 3.16-19



MË 8 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i apostullit dhe ungjillorit të shenjtë Joan Theologu;
dhe i atit tonë oshënar Arseni i Madh.

Tipikon

1. Nëse bie në Pashkë ose të Hënën e Ndrishme:

Shërbesa transferohet të Mërkurën ose të Enjten e Ndrishme (që të psalen më parë shërbesat e mëparshme të shenjtorëve të mëdhenj, që transferohen këtu nga Kreshma e Madhe) sipas §2.

2. Nëse bie të Martën ose të Mërkurën, ose të Enjten, ose të Shtunën e Ndrishme:

Në Mbrëmësore, Thirrtoret: 4 ngjallësore, 3 të ungjillorit dhe 3 të oshënarit. Lavdi i ungjillorit. Tani (ngjallësor) i Pentikostarit. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i Madh. Leximet e ungjillorit. Pasvargjet: ngjallësore e para (e Pentikostarit) dhe të Pashkës (Le të ngrihet Perëndia; Pashka hierore etj.), (ose të ungjillorit, nëse kisha mban emrin e tij). Lavdi i ungjillorit. Tani Dit' e ngjalljes. Krishti u ngjall (3x), Përlëshoret: e apostullit, e oshënarit dhe Hyjlindësorja ngjallësore (Gëzohu, o der' e Zotit). Përlëshim dialogjikisht.

Në Shërbesën e Mesnatës, shërbesa paskale, në fund Litia e përbashkët e ungjillorit dhe e oshënarit. Tani Hyjlindësore: Nga çdo lloj rreziku ruaji shërbëtorët e tu, o Hyjlindëse e bekuar, që të të lavdërojmë ty, shpresën e shpirttrave tanë. Krishti u ngjall (3x) dhe Përlëshim. Në Mëngjesore, pas Krishti u ngjall (10x), Përlëshoret: e ungjillorit, e oshënarit dhe Hyjlindësorja ngjallësore (Gëzohu, o der' e Zotit). Pas Paqësoreve, menjëherë Shkallesat dhe i gjithë rendi i Ungjillit të apostullit të Mëngjesit (që lexohet nga Dera e Bukur). Ne që pamë ngjalljen (3x), (nuk lexohet Psalmi 50) dhe menjëherë Lavdi Me ndërmjetimet e apostullit. Tani Me ndërmjetimet e Hyjlindësës. Përdëllemë, o Perëndi dhe Idhiomeli. O Perëndi, shpëto popullin tënd dhe beko trashëgimin tënd, vështroje. Kanunet: i Pashkës, i ungjillorit dhe i oshënarit. Në fundin e çdo Ode, Zbritësorja e Pashkës, Krishti u ngjall (3x), Kur u ngrit Jisui, dhe Përsëri dhe përsëri. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e ungjillorit dhe Ndenjësoret. Tani Hyjlindësore sipas Tin sofian qe Logon: Urtësinë dhe Fjalën e zure ti brenda barkut pa farë, pa djegie krejt;* e linde për rruzullin* sundimtarin e*

Gjithësis’; * mban në pëqi atë që në dorë çdo gjë e mban, * pra Krijimtarin si dhe ushqyesin botëror; * ndaj e Tërëshenjtë, Virgjëreshë të lutem, * kur unë do rri kundrejt * faqes së Krijimtarit tim, * të shpëtohem * nga çdo mëkat; * Zonj’ e pastër dhe virgjëresh’ * atëher’ ndihmë dhe mbrojtje * ti më dhuro, * sepse, o e himnuar, mundesh të bësh sa do. *Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Pashkës dhe Sinaksari. Në vend të Më të nderuarën, Ode IX e Pashkës, 2 troparet e ungjillorit (me Vargun e tij) dhe e oshënarit (por Lavdi dhe Tani me Madhështimet e Pashkës). Dërgimësoret: e Pashkës, e ungjillorit, e oshënarit dhe përsëri e Pashkës. Lavdërimet: 4 ngjallësore, 3 të ungjillorit, 1 e oshënarit (me Vargjet në dy të fundit: a) Në gjithë dheun doli zëri i tij dhe në skajet e botës fjalët e tij; dhe b) E çmuar është para Zotit vdekja e oshënarëve të tij); dhe të Pashkës (Le të ngrihet Perëndia; Pashka hierore etj.). Lavdi i ungjillorit. Tani Dit’ e ngjalljes. Krishti u ngjall (3x) dhe Përlëshorja e ungjillorit.*

Në Liturgji. Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Krishti u ngjall, Ipakoia, Përlëshoret: e ungjillorit dhe e oshënarit. Kontaqi i Pashkës. Sa u pagëzuar. Apostulli dhe Ungjilli i ungjillorit. Në vend të Të meriton, Një engjëll i thërriste; Ndriçohu, ndriçohu. Kungatore e Pashkës [dhe Në gjithë dheun]. Në vend të Pamë dritën, Krishti u ngjall. Në vend të Emri i Zotit, Krishti u ngjall (3x shpejt në Ting. II). Përlëshim dialogjikisht.

3. Nëse bie të Premten e Ndrishme (Burimi Jetëdhënës):

Të enjten në Mbrëmësore. Thirrtoret: 3 ngjallësore, 3 të Burimit Jetëdhënës dhe 3 të ungjillorit në 4. Lavdi i ungjillorit. Tani [Lavdi] i Burimit. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i Madh. Leximet e ungjillorit. Pasvargjet: ngjallësore e para (e Pentikostarit) dhe 3 të Burimit (ose të ungjillorit, nëse kisha mban emrin e tij). Lavdi i ungjillorit. Tani Dit’ e ngjalljes. Krishti u ngjall (3x), Përlëshoret: e ungjillorit, e oshënarit dhe e Burimit, Ting. I: Kisha jote, o Hyjlindëse, u tregua Parajsë, duke buruar shërime si lumenj gjithmonë të gjallë; duke ardhur pranë saj besërisht, nxjerrim si nga burimi jetëpranues shëndoshje dhe jetë të përjetshme, sepse te Shpëtimtari Krisht që lindi prej teje, ti ndërmjeton që të shpëtohen shpirtat tanë. Përlëshim dialogjikisht.

Të premtën, në Shërbesën e Mesnatës, shërbesa paskale, në fund Litia e për-bashkët e ungjillorit dhe e oshënarit. Tani i së kremtes (kërkoje në Pentikostar; në Lavdinë e Pasvargjeve të Mbrëmësore të së enjtes). Në fund Krishti u ngjall (3x). Në Mëngjesore, pas Krishti u ngjall (10x), Përlëshorja e ungjillorit dhe e

Burimit. Pas Paqësoreve, menjëherë Shkallesat dhe i gjithë rendi i Ungjillit të ungjillorit të Mëngjesit (që lexohet nga Dera e Bukur). Ne që pamë ngjalljen (3x), (nuk lexohet Psalmi 50) dhe menjëherë Lavdi Me ndërmjetimet e apostullit. Tani Me ndërmjetimet e Hyjlindëses. Përdëllemë, o Perëndi dhe Idhiomeli. O Perëndi, shpëto popullin tënd dhe bekoje trashëgimin tënd, vështroje. Kanunet: i Pashkës, i Burimit (me Varg: E Përmbishenjtë Hyjlindëse, shpëtona) dhe i ungjillorit. Në fundin e çdo Ode, Zbritësorja e Pashkës, Krishti u ngjall (3x), Kur u ngrit Jisui, dhe Përsëri dhe përsëri. Pas Odes III, Kontaqi i Pashkës. Kontaqi dhe Shtëpia e ungjillorit. Ndenjësoret: e ungjillorit, e oshënarit dhe e Burimit. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Burimit dhe Sinaksari i ditës dhe i Burimit. Ne që pamë ngjalljen (3x). Kur u ngrit Jisui (3x). Në vend të Më të nderuarën, Ode IX e Pashkës, e Burimit dhe e ungjillorit (por Lavdi dhe Tani me Madhështimet e Pashkës). Dërgimësoret: e Pashkës, e ungjillorit, e oshënarit dhe e Burimit. Lavdërimet: 2 ngjallësore, 3 të Burimit, 3 të ungjillorit dhe 4 të Pashkës (Le të ngrihet Perëndia; Pashka hierore etj.). Lavdi i ungjillorit. Tani Dit' e ngjalljes. Krishti u ngjall (3x).

Në Liturgji. Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Krishti u ngjall, Ipakoia dhe Përlëshoret: e Burimit, e ungjillorit dhe e oshënarit. Kontaqi i Pashkës. Sa u pagëzuat. Apostulli dhe Ungjilli i ungjillorit. Në vend të Të meriton, Një engjëll i thërriste; Ndriçohu, ndriçohu. Kungatore e Pashkës [dhe Në gjithë dheun]. Në vend të Pamë dritën, Krishti u ngjall. Në vend të Emri i Zotit, Krishti u ngjall (3x shpejt në Ting.II). Përlëshim dialogjikisht.

4. Nëse bie të Dielën e Thomait:

Të shtunën në Mbrëmësore. Thirrtoret: 6 të Thomait dhe 3 të ungjillorit në 4. Lavdi i ungjillorit. Tani i Thomait. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e ungjillorit. Pasvargjet e Thomait. Lavdi i ungjillorit. Tani i Thomait. Përlëshoret: e Thomait, e ungjillorit, Lavdi i oshënarit, Tani përsëri i Thomait.

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmi 50, Kanuni Triadik, Litia e Thomait dhe e përbashkët e ungjillorit dhe e oshënarit. Lavdi i ungjillorit. Tani i Thomait. Trishenjtë. Përlëshorja e Thomait. Në Mëngjesore. Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësores e Thomait (2x). Pas Stihologjisë së dytë dhe Polieleit, Ndenjësoret e ungjillorit, por, në vend të Hyjlindësoreve, Ndenjësoret e Thomait. Shkallesat. Antifoni i parë Ting. IV dhe Proqimeni i Thomait. Kanunet: i Thomait (me Varg: Lavdi ngjalljes sate), i ungjillorit (me Vargun e zakonshëm: O apostull i Krishtit)

dhe i oshënarit (me Vargun e zakonshëm: O oshënar i Krishtit). Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e ungjillorit. Ndenjësoret: e ungjillorit, e oshënarit dhe, në vend të Hyjlindësore, një Paskremtores. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Thomait dhe Sinaksari i ditës dhe i Thomait. Zbritësoret e Pashkës; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Në vend të Më të nderuarën, Ode IX e Kanuneve. I shenjtë është Zoti, Perëndia ynë (2x). Lartësoni Zotin. Dërgimësoret: e para e Thomait, e ungjillorit, e oshënarit dhe e dyta e Thomait. Lavdërimet: 3 të Thomait dhe 3 të ungjillorit. Lavdi i ungjillorit. Tani i Thomait. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e Thomait.

Në Liturgji. Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e Thomait, e ungjillorit dhe e oshënarit. Kontaqi i Pashkës. Apostulli i ungjillorit. Ungjilli i Thomait. Në vend të Të meriton, Zbritësorja e Odes IX e Thomait (Ti llambadhen e shkëlqyer). Kungatore e Thomait [dhe Në gjithë dheun]. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.

5. Nëse bie të hënë ose të martën, ose të mërkurën, ose të enjten, ose të premten pas së Dielës së Thomait:

Shërbesa psalet sipas Mujorit së bashku me Paskremtores e Thomait. Të dielën në mbrëmje, nuk lexohet Psaltiri, dhe Proqimeni është i Madh. Kanunet: i Thomait, i ungjillorit dhe i oshënarit. Zbritësoret e Pashkës. Në Liturgji, Kontaqi i Thomait. Apostulli, Ungjilli dhe Kungatore të apostullit.

6. Nëse bie të shtunën (d.m.th. në Mbylljen) e Thomait:

Në Mbrëmësore. Thirrtores: 3 të Thomait, 3 të ungjillorit dhe 2 të oshënarit. Lavdi i ungjillorit. Tani i Thomait. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e ungjillorit. Pasvargjet: e para ngjallësore (Paskremtores) dhe të ungjillorit. Lavdi i ungjillorit. Tani i Thomait. Përlëshoret: e Thomait, e ungjillorit, e oshënarit dhe përsëri e Thomait.

Në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Litia e përbashkët e ungjillorit dhe e oshënarit. Lavdi i ungjillorit. Tani i Thomait. Trishenjtë. Përlëshorja e ungjillorit. Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë, Ndenjësores Paskremtores. Pas Stihologjisë së dytë dhe Polieleit, Ndenjësores e ungjillorit dhe, në vend të Hyjlindësoreve, Ndenjësores e Thomait. Shkallesat. Antifoni i parë Ting. IV. Proqimeni dhe Ungjilli Mëngjesor i ungjillorit. Ne që pamë ngjalljen. Psalmi 50

(hima). Kanunet: i Thomait, i ungjillorit dhe i oshënarit. Pas Odes III, Kontaqi i Thomait. Ndenjësoret: e ungjillorit, e oshënarit dhe një Paskremtore. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e ungjillorit dhe Sinaksari. Zbritësoret e Pashkës. Në vend të Më të nderuarën, Ode IX e Kanuneve. Dërgimësoret: e para e Thomait, e ungjillorit, e oshënarit dhe e dyta e Thomait. Lavdërimet: 2 ngjallësore (Paskremtore), 3 të Thomait dhe 3 të ungjillorit. Lavdi i ungjillorit. Tani i Thomait. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e Thomait.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e Thomait, e ungjillorit dhe e oshënarit. Kontaqi i Thomait. Apostulli dhe Ungjilli i ungjillorit. Në vend të Të meriton, Zbritësorja e Odes IX e Thomait (Ti llambadhen e shkëlqyer). Kungatore e Thomait [dhe Në gjithë dheun]. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.

7. Nëse bie të Dielën e Miropurëseve ose të Samaritanes:

Të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 4 ngjallësore, 3 të së kremtes dhe 3 të ungjillorit. Lavdi i ungjillorit. Tani [Lavdi] i së kremtes. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e ungjillorit. Pasvargjet: ngjallësorja e parë e Tingullit dhe të Pashkës (Le të ngrihet Perëndia; Pashka hierore etj.). [Ose të ungjillorit, nëse kisha mban emrin e tij]. Lavdi i ungjillorit. Tani [Lavdi] i së kremtes. Përlëshoret: a) të Dielën e Miropurëseve: Bujari Josif; Kur zbritë, e ungjillorit, Lavdi i oshënarit, Tani Grave Miropurëse; b) të Dielën e Samaritanes: e së kremtes (ngjallësore), e ungjillorit, Lavdi i oshënarit, Tani i Mespentikostisë.

Të dielën në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanuni Triadik, Litia e së kremtes dhe e përbashkët e ungjillorit dhe e oshënarit. Lavdi i ungjillorit. Tani [Lavdi] i së kremtes. Himnet Triadike. Trishenji. Përlëshoret: a) të dielën e Miropurëseve, Bujari Josif; b) të Dielën e Samaritanes, e ungjillorit. Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë, Ndenjësoret e së kremtes. Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësoret: e para e së kremtes, e ungjillorit dhe e dyta e së kremtes. Pas Polieleit, Ndenjësores e ungjillorit dhe Tropari i tretë i Stihologjisë së dytë të së kremtes. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimeni i Tingullit. Kanunet: i Pashkës, i ungjillorit dhe i oshënarit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e ungjillorit dhe Ndenjësoret: e ungjillorit, e oshënarit dhe të së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e së kremtes. Sinaksari i ditës dhe i së kremtes. Zbritësoret

e Pashkës; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Në vend të Më të nderuarën, Ode IX e Kanuneve. Dërgimësoret: e Pashkës, e ungjillorit, e oshënarit dhe e së kremtes. Lavdërimet: 4 ngjallësore, 4 të shenjtoreve dhe të Pashkës (Le të ngrihet Perëndia; Pashka hierore etj.). Lavdi i ungjillorit. Tani: a) të dielën e Miropurësëve, Dit' e ngjalljes; b) të dielën e Samaritanes, i së kremtes. Dhoksologjia e Madhe. Sot erdhi.

Në Liturgji. Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: a) të dielën e Miropurësëve: Kur zbritë; Bujari Josif; Grave Miropurësë, e ungjillorit, e oshënarit dhe e kishës; b) të dielën e Samaritanes: e së kremtes (ngjallësore), e Mespentikostisë, e ungjillorit, e oshënarit dhe e kishës. Kontaqi i Pashkës. Apostulli i ungjillorit. Ungjilli i së kremtes. Në vend të Të meriton, Zbritësorja e Odes IX e Pashkës. Kungatorja e Pashkës [dhe Në gjithë dheun]. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.

8. Nëse bie në Javën pas së Dielës së Miropurësëve ose të të Paralizuarit, ose të Samaritanes (përveç Mbylljeve të tyre):

Në Mbrëmësore, Thirrtoret: e ungjillorit dhe të oshënarit. Lavdi i ungjillorit. Tani [Lavdi] i së kremtes. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e ungjillorit. Pasvargjet e ungjillorit. Lavdi i ungjillorit. Tani [Lavdi] i së kremtes. Përlëshoret: a) në Javën pas Miropurësëve: Bujari Josif; Kur zbritë; e ungjillorit, Lavdi i oshënarit, Tani Grave Miropurësë; b) në Javët e tjera: e së kremtes (ngjallësore), e ungjillorit, Lavdi i oshënarit, Tani Hyjlindësorja ngjallësore (Gëzohu, o der' e Zotit).

Në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Litia e përbashkët e ungjillorit dhe e oshënarit. Lavdi i ungjillorit. Tani [Lavdi] i së kremtes. Trishenjtë. Përlëshorja e ungjillorit. Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë, Ndenjësoret e së kremtes. Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësoret: e ungjillorit dhe, në vend të Hyjlindësorës, e së kremtes. Pas Polieleit, Ndenjësoret: e ungjillorit dhe një e së kremtes. Shkallesat. Antifoni i parë Ting. IV, Proqimeni dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor i ungjillorit. Ne që pamë ngjalljen. Psalmi 50 (hima). Kanunet: i së kremtes [ose i Pashkës], i ungjillorit dhe i oshënarit. Pas Odes III, Ndenjësoret: e ungjillorit, e oshënarit dhe një e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e ungjillorit. Sinaksari. Zbritësoret e Pashkës. Më të nderuarën. Dërgimësoret: e

ungjillorit, e oshënarit dhe e së kremtes. Lavdërimet: e ungjillorit dhe e oshënarit. Lavdi i ungjillorit. Tani [Lavdi] i së kremtes. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e ungjillorit.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e së kremtes, e ungjillorit, e oshënarit dhe e kishës. Kontaqi i së kremtes. Apostulli dhe Ungjilli i ungjillorit. Të meriton. Kungatore: Në gjithë dheun. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.

9. Nëse bie të shtunën (d.m.th. në Mbylljen) e Miropurësëve ose të Samaritanes:

Të premten në Mbrëmësore, Thirrtoret: 3 të së kremtes, 3 të ungjillorit dhe 2 të oshënarit. Lavdi i ungjillorit. Tani [Lavdi] i së kremtes. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e ungjillorit. Pasvargjet: e para e Pentikostarit dhe të ungjillorit. Lavdi i ungjillorit. Tani i së kremtes. Përlëshoret: a) të shtunën pas Miropurësëve: Bujari Josif, Kur zbritë; i ungjillorit, Lavdi i oshënarit, Tani Grave miropurësë; b) të shtunën pas Samaritanes: e së kremtes (Lëçitjen gazmore), e ungjillorit, Lavdi i oshënarit, Tani Hyjlindësorja ngjallësore (Gëzohu, o der' e Zotit).

Të shtunën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmi 50, Litia e përbashkët e ungjillorit dhe e oshënarit. Lavdi i ungjillorit. Tani i së kremtes (Lavdi i Litisë). Trishenjti. Përlëshorja: a) të shtunën pas Miropurësëve: Kur zbritë; b) të shtunën pas Samaritanes: e ungjillorit. Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë, Ndenjësoret ngjallësore (Paskremtores). Pas Stihologjisë së dytë dhe Polieleit, Ndenjësoret e ungjillorit dhe, në vend të Hyjlindësoreve, Ndenjësoret e së kremtes. Shkallesat. Antifoni i parë Ting. IV, Proqimeni dhe i gjithë rendi i Ungjillit të ungjillorit. Ne që pamë ngjalljen. Psalmi 50 (hima) etj. të ungjillorit. Kanunet: i së kremtes, i ungjillorit dhe i oshënarit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e së kremtes. Ndenjësoret: e ungjillorit, e oshënarit dhe e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e ungjillorit. Sinaksari. Zbritësoret e Pashkës. Më të nderuarën. Dërgimësoret: e ungjillorit, e oshënarit dhe e së kremtes. Lavdërimet: 2 ngjallësore (Paskremtores) dhe 4 të ungjillorit bashkë me të oshënarit. Lavdi i ungjillorit. Tani i së kremtes. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e ungjillorit.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: a) të shtunën pas Miropurësëve: Bujari Josif; Kur zbritë; Grave miropurësë; e

ungjillorit, e oshënarit dhe e kishës; b) të shtunën pas Samaritanes: e së kremtes (Lëçitjen gazmore), e ungjillorit, e oshënarit dhe e kishës. Kontaqi: a) në Mbylljen e Miropurëseve, i së kremtes; b) në Mbylljen e Samaritanes, i Pashkës. Apostulli dhe Ungjilli i ungjillorit. Të meriton. Kungatore: Në gjithë dheun. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.

10. Nëse bie të Dielën e të Paralizuarit:

Të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 4 ngjallësore, 2 të së kremtes dhe 4 të ungjillorit. Lavdi i ungjillorit. Tani [Lavdi] i së kremtes. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e ungjillorit. Pasvargjet: ngjallësorja e parë e Tingullit dhe të Pashkës (Le të ngrihet Perëndia; Pashka hierore etj.). (Ose të ungjillorit, nëse kisha mban emrin e tij). Lavdi i ungjillorit. Tani [Lavdi] i së kremtes. Përlëshoret: ngjallësore, e ungjillorit, Lavdi i oshënarit, Tani Hyjlindësorja ngjallësore (Gëzohu, o der' e Zotit).

Të dielën në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanuni Triadik, Litia e përbashkët e ungjillorit dhe e oshënarit. Lavdi i ungjillorit. Tani [Lavdi] i së kremtes. Trishenjtë. Përlëshorja e ungjillorit. Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë, Ndenjësoret e së kremtes. Pas Stihologjisë së dytë dhe Polieleit, Ndenjësoret e ungjillorit dhe, në vend të Hyjlindësoreve, Ndenjësoret e së kremtes. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimeni i Tingullit. Kanunet: i Pashkës, i ungjillorit dhe i oshënarit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e ungjillorit, dhe Ndenjësoret: e ungjillorit, e oshënarit dhe e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e së kremtes. Sinaksari i ditës dhe i së kremtes. Zbritësoret e Pashkës; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Në vend të Më të nderuarën, Ode IX e Kanuneve. Dërgimësoret: e Pashkës, e ungjillorit, e oshënarit dhe e së kremtes. Lavdërimet: 3 ngjallësore, 3 të së kremtes dhe të Pashkës (Le të ngrihet Perëndia; Pashka hierore etj.). Lavdi i ungjillorit. Tani [Lavdi] i së kremtes. Dhoksologjia e Madhe. Sot erdhi.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e së kremtes (ngjallësore), e ungjillorit, e oshënarit dhe e kishës. Kontaqi i Pashkës. Apostulli i ungjillorit. Ungjilli i së kremtes. Në vend të Të meriton, Zbritësorja e Odes IX. Kungatore e Pashkës [dhe Në gjithë dheun]. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.

11. Nëse bie të martën (d.m.th. në Mbylljen) e të Paralizuarit:

Në Mbrëmësore, Thirrtoret: 3 të së kremtes, 3 të ungjillorit dhe 2 të oshënarit. Lavdi i ungjillorit. Tani [Lavdi] i së kremtes. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e ungjillorit. Pasvargjet e ungjillorit. Lavdi i ungjillorit. Tani [Lavdi] i së kremtes. Përlëshoret: e së kremtes (ngjallësore), e ungjillorit, Lavdi i oshënarit, Tani Hyjlindësorja ngjallësore (Gëzohu, o der' e Zotit).

Në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Litia e përbashkët e ungjillorit dhe e oshënarit. Lavdi i ungjillorit. Tani [Lavdi] i së kremtes. Trishenjtë. Përlëshorja e ungjillorit. Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë, Ndenjësoret Paskremtores. Pas Stihologjisë së dytë dhe Polieleit, Ndenjësoret: e ungjillorit dhe Paskremtores. Shkallesat. Antifoni i parë Ting. IV. Proqimeni dhe Ungjilli i ungjillorit. Ne që pamë ngjalljen. Psalmi 50 (hima) etj. të ungjillorit. Kanunet: i së kremtes, i ungjillorit dhe i oshënarit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e së kremtes. Ndenjësoret: e ungjillorit, e oshënarit dhe e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e ungjillorit dhe Sinaksari. Zbritësoret e Pashkës. Më të nderuarën. Dërgimësoret: e ungjillorit, e oshënarit dhe e së kremtes. Lavdërimet: 3 të ungjillorit dhe e oshënarit. Lavdi i ungjillorit. Tani i së kremtes. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e ungjillorit.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e së kremtes (ngjallësore), e ungjillorit, e oshënarit dhe e kishës. Kontaqi i së kremtes. Apostulli dhe Ungjilli i ungjillorit. Kungatore: Në gjithë dheun. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.

12. Nëse bie të Mërkurën e Mespentikostisë:

Në Mbrëmësore, pas Qëndrimit të parë të Psaltirit (Lum ai njeri), Thirrtoret: 4 të së kremtes, 3 të ungjillorit dhe 3 të oshënarit. Lavdi i ungjillorit. Tani i së kremtes. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet: 2 të së kremtes dhe 1 i ungjillorit. Pasvargjet e së kremtes. (ose një e së kremtes dhe të ungjillorit, nëse kisha mban emrin e tij). Lavdi i ungjillorit. Tani i së kremtes. Përlëshoret: e së kremtes, e ungjillorit, e oshënarit dhe përsëri e së kremtes.

Në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Litia e përbashkët e ungjillorit dhe e oshënarit. Lavdi i ungjillorit. Tani një i së kremtes. Trishenjtë. Përlëshorja e së kremtes. Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë dhe të dytë, Ndenjësoret e ungjillorit dhe, në vend të Hyjlindësoreve, Ndenjësoret e së kremtes. Pas Polieleit,

Ndenjësoret: e ungjillorit dhe një e së kremtes (Ndenjësoerja e parë pas Odes III). Shkallesat. Antifoni i parë Ting. IV. Proqimeni dhe Ungjilli i ungjillorit. Ne që pamë ngjalljen. Psalmi 50 (hima) etj. të ungjillorit. Kanunet: 2 të së kremtes dhe i ungjillorit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e ungjillorit, Ndenjësoerja e ungjillorit dhe e dyta e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e së kremtes. Sinaksari i ditës dhe i së kremtes. Zbritësoret e së kremtes (Detin e mpikse). Në vend të Më të nderuarën, Ode IX e Kanuneve. Dërgimësoret: e së kremtes, e ungjillorit, e oshënarit dhe përsëri e së kremtes. Lavdërimet: 3 të së kremtes dhe 3 të ungjillorit. Lavdi i ungjillorit. Tani i së kremtes. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e së kremtes.

Në Liturgji. Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e së kremtes, e ungjillorit dhe e oshënarit. Kontaqi i së kremtes. Apostulli i ungjillorit dhe Ungjilli i së kremtes. Në vend të Të meriton, Zbritësoerja e Odes IX e së kremtes. Kungatore e së kremtes [dhe Në gjithë dheun]. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.

13. Nëse bie në ditët Paskremtore të Mespentikostisë **(përveç së shtunës dhe së Dielës së Samaritanes):**

Shërbesat bëhen sipas Mujorit (së bashku me Paskremtoret). Kanunet: një i së kremtes, i ungjillorit dhe i oshënarit. Zbritësoret e së kremtes (Detin e mpikse). Në Liturgji, Kontaqi i së kremtes, Apostulli dhe Ungjilli i ungjillorit. Kungatore: Në gjithë dheun.

14. Nëse bie të shtunën pas Mespentikostisë:

Në Mbrëmësore. Thirrtoret: e ungjillorit dhe të oshënarit. Lavdi i ungjillorit. Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës që po kalon (Si të mos admirojmë). Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e ungjillorit. Pasvargjet: Paskremtori i parë dhe të ungjillorit. Lavdi i ungjillorit. Tani i së kremtes. Përlëshoret: e së kremtes, e ungjillorit, e oshënarit dhe përsëri e së kremtes.

Në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmi 50, Litia e përbashkët e ungjillorit dhe e oshënarit. Lavdi i ungjillorit. Tani një i së kremtes. Trishenjtë. Përlëshorja e ungjillorit. Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore Paskremtore (ngjallësore). Pas Stihologjisë së dytë dhe Polieleit, Ndenjësoret e ungjillorit dhe, në vend të Hyjlindësoreve, Ndenjësoret e së kremtes. Shkallesat. Antifoni i parë Ting. IV. Proqimeni dhe Ungjilli i ungjillorit. Ne që pamë ngjalljen. Psalmi 50

(hima) etj. të ungjillorit. Kanunet: i së kremtes, i ungjillorit dhe i oshënarit. Pas Odes III, Ndenjësoret: e ungjillorit, e oshënarit dhe një e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e ungjillorit dhe Sinaksari. Zbritësoret e Pashkës. Më të nderuarën. Dërgimësoret: e ungjillorit, e oshënarit dhe e së kremtes. Lavdërimet: 3 Paskremtore (ngjallësore) dhe 3 të ungjillorit. Lavdi i ungjillorit. Tani i së kremtes. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e ungjillorit.

Në Liturgji. Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e së kremtes, e ungjillorit, e oshënarit dhe e kishës. Kontaqi i së kremtes. Apostulli dhe Ungjilli i ungjillorit. Kungatore: Në gjithë dheun. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.

15. Nëse bie në Mbylljen e Mespentikostisë:

Në Mbrëmësore. Thirrtoret: 4 të së kremtes dhe 3 të ungjillori në 4. Lavdi i ungjillorit. Tani i së kremtes. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e ungjillorit. Pasvargjet e së kremtes. Lavdi i ungjillorit. Tani i së kremtes. Përlëshoret: e së kremtes, e ungjillorit, e oshënarit dhe përsëri e së kremtes.

Në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Litia e përbashkët e ungjillorit dhe e oshënarit. Lavdi i ungjillorit. Tani një i së kremtes. Trishenjti. Përlëshorja e së kremtes. Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë dhe të dytë, Ndenjësoret e ungjillorit dhe, në vend të Hyjlindësoreve, Ndenjësoret e së kremtes. Pas Polieleit, Ndenjësoerja e ungjillorit dhe, në vend të Hyjlindësoreve, Ndenjësoerja e parë e së kremtes pas Odes III. Shkallesat. Antifoni i parë Ting. IV. Proqimeni dhe Ungjilli i ungjillorit. Ne që pamë ngjalljen. Psalmi 50 (hima) etj. të ungjillorit. Kanunet: të dy të së kremtes dhe i ungjillorit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e ungjillorit. Ndenjësoret: e ungjillorit, e oshënarit dhe (e dyta) e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e së kremtes dhe Sinaksari. Zbritësoret e së kremtes (Detin e mpikse). Në vend të Të meriton, Ode IX e Kanuneve. Dërgimësoret: e së kremtes, e ungjillorit, e oshënarit dhe përsëri e së kremtes. Lavdërimet: 3 të së kremtes dhe 3 të ungjillorit. Lavdi i ungjillorit. Tani i së kremtes. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e së kremtes.

Në Liturgji. Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e së kremtes, e ungjillorit dhe e oshënarit. Kontaqi i së kremtes. Apostulli dhe Ungjilli i ungjillorit. Kungatore e së kremtes [dhe Në gjithë dheun]. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.



NË MBRËMËSORE

*Pas Qëndrimit të parë të Psaltirit
(Lum ai njeri)*

*Thirrto
Të ungjillorit*

Ting. I Ton uranion tagmaton

Shkroi Ungjillin e Krishtit¹ si folës fort i madh* misteresh Perëndie,* që jan' lart, dhe shikues* pamjesh² dhe zbulimesh³ që s'shprehen dot,* biri i Zevedeut⁴ pra;* dhe na mësoi kështu të theologojm'* Atin, Birin dhe të Shenjtin Shpirt.

Harpa, kitara e këngëve qiellore krejt* që luan Zoti, goja* me frym'zim Perëndie,* shkruan pra mistere edhe këndon* ëmbël këngën e këngëve.*⁵ Lëviz dhe buzët si korda, gjuhën si tast,* ndërmjeton që të shpëtohem.

Me gjuhën si bubullimë,⁶ po na thërrret gjithnjë* me forc' sekretet, fjalën* e urtisë së Zotit,*⁷ o i dashur nga Hyjnia,⁸ thërrret* duke hapur ti buzët shpesh:* Në fillim Fjala qe;⁹ ndaj si pishtar ndriçon* çdo njeri për dijen e Zotit.¹⁰

Të oshënarit

*Ting. Tërth. IV O tu paradhoksu
thávmatos*

Mendjen si e fekse, shën Arsen, me

lot porsi me burim,* po pastroheshe pa lakim* dhe me Perëndinë Zot* shoqëroheshe, shfaqeshe* ti me shkëlqimin si shtyllë drite plot* me rrezatim prej besimit si pishtar;* o krenari me lavd* për monakët, ruaji tani të gjith'* përmes përgjërimeve të tua, oshënar.

O hyjmentës at' Arsen, duke kërkuar fort Perëndin',*¹¹ duke dashur të feksje krejt* besërisht me vezullim* dritëdhënës prej tij, e le* mbarë shkëlqimin e postit famëmadh* si dhe oborrin e perandorit ti;* trashëgimin që s'vdes* e ke marrë dhe tani me Krishtin rri,* je i vyer që të lumërohesh prej Hyjnis'.

Më shumë se gjithë njerëzit duke she ti plot me mend* dhe me dije, me çdo virtyt* i stolisur krejtësisht* dhe i plotë me çdo lavdi* mbi dhé, por digjeshe nga një zell hyjnor,* kishe dëshirën për sa nuk shprehen dot;* ndaj ike në Egjipt,* ku jetove si asket, dhe si shkëmbim* more peshë lavdi¹² dhe nder që s'rrëfëhet kurr'.

Lavdi

*Ting. II I Gjermanoit
sipas të tjerëve i Bizantit*

Birin e bubullimës,⁶ themelin e fjalëve të hyjshme, kryetarin e theologjisë dhe të parin predikues të urtësisë së

vërtetë të dogmave të Perëndisë, të dashurin Joan⁸ dhe të virgjrit, ne, gjinia e njerëzve, le ta lavdërojmë siç i ka hije; sepse ai, duke pasur brenda vetes pa mbarim Hyjninë, tha: “Në fillim ishte Fjala.” Dhe përsëri foli për pandashmërinë e Birit nga Ati dhe pastaj për barazinë me esencën e Atit,⁹ duke na treguar me anën e tij orthodhoksinë e Triadhës së Shenjtë; dhe të njëjtin na e tregoi si bërës¹³ bashkë me Atin dhe se sjell jetë dhe dritë¹⁴ të vërtetë. O çudi që shtang dhe mahnit! Sepse, duke qenë plot me dashuri, u bë i përplotë edhe me theologji, me lavdi, nder¹⁵ dhe besë, duke qenë themeli i besës sonë pa mangësi, nëpërmjet së cilës, le të arrijmë të mirat e amshuara në ditën e Gjykimit.

Tani

I së kremtes

Hyrje. O dritë gazmore.

Proqimeni i ditës dhe Leximet

Këndimi i Letrës së parë katolike të Joanit

(3.21-4.6)

Dhjakë: Le të vëmë re. Urtësi. Le të vëmë re [dhe në të dy të tjerat e mëpasshme].

Lexuesi:

Të dashur, nëse nuk na akuzon zemra jonë, kemi guxim te Perëndia, edhe çfarëdo që të lypim, e marrim nga ai, sepse ruajmë porositë e tij, dhe bëjmë ato që pëlqejnë para atij. Edhe kjo është porositë e atij: Të besojmë në emrin e Birit të tij, Jisu Krisht, dhe të duam njëri-tjerin, siç na dha porosi. Edhe ai që ruan porositë e tij mbetet tek ai dhe ai te ky, dhe nga kjo e njohim se mbetet te ne, nga Shpirti që na dha. Të dashur, mos i besoni çdo shpirti, por provoni shpirtat nëse janë nga Perëndia, sepse shumë pseudo-profetë kanë dalë në botë. Nga kjo e njihni Shpirtin e Perëndisë: Çdo shpirt që pohon se Jisu Krishti ka ardhur në mish, është nga Perëndia. Edhe çdo shpirt që nuk pohon se Jisu Krishti ka ardhur në mish, nuk është nga Perëndia; dhe ky është *shpirti* i antikrishtit, për të cilin keni dëgjuar se vjen, dhe që tashmë është në botë. Ju fëmijë, jeni nga Perëndia, dhe i keni mundur ata; sepse ai që është ndër ju është më i madh se ai që është në botë. Ata prej botës janë; prandaj prej botës flasin dhe bota i dëgjon ata. Ne jemi nga Perëndia; ai që njeh Perëndinë, na dëgjon, ai që nuk është nga Perëndia nuk na dëgjon.

Këndimi i Letrës së parë katolike
të Joanit

(4.11-16)

Të dashur, nëse na deshi kështu Perëndia, edhe ne kemi detyrë ta duam njëri-tjetrin. Asnjë s'e ka parë Perëndinë ndonjëherë. Nëse duam njëri-tjetrin, Perëndia mbetet te ne dhe dashuria e tij është e përsosur te ne. Nga kjo e njohim se mbetemi tek ai, dhe ai te ne, sepse na ka dhënë nga Shpirti i tij. Edhe ne kemi parë dhe dëshmojmë se Ati dërgoi Birin, Shpëtimtar të botës. Ai që të pohojë se Jisui është Biri i Perëndisë, Perëndia mbetet tek ai, dhe ai te Perëndia. Edhe ne e kemi njohur dhe e kemi besuar dashurinë që ka Perëndia ndër ne. Perëndia është dashuri; dhe ai që mbetet në dashuri, mbetet në Perëndinë dhe Perëndia në atë.

Këndimi i Letrës së parë katolike
të Joanit

(4.20-5.5)

Të dashur, në thëntë ndonjë se dua Perëndinë, dhe urren vëllanë e tij, është gënjeshtar; sepse ai që s'do të vëllanë, të cilin e ka parë, si mund të dojë Perëndinë të cilin s'e ka parë? Edhe këtë porosi e kemi prej tij, që ai që do Perëndinë, të dojë edhe të vëllanë. Kushdo që beson se Jisui është

Krishti, ka lindur prej Perëndisë; dhe kushdo që do atë që e ka lindur, do edhe atë që ka lindur prej tij. Nga kjo e njohim se duam të bijtë e Perëndisë, kur duam Perëndinë dhe ruajmë porositë e tij. Sepse kjo është dashuria e Perëndisë, të ruajmë porositë e tij. Edhe porositë e tij nuk janë të rënda. Sepse çdo gjë që ka lindur prej Perëndisë e mund botën, dhe kjo është fitorja që mundi botën: besimi ynë. Cili është ai që mund botën, veç atij që beson se Jisui është i Biri i Perëndisë?

*Në Liti Idhiomele
Ting. I I Gjermanoit*

Lumenj thelogjie nga goja jote e çmuar buruan,¹⁶ o apostull; prej këtyre Kisha e Perëndisë, duke u vaditur, i falet orthodhoksisht Trinisë së bashkesencshme; kërkoji asaj edhe tani, o Joan Theolog, të përforcohen dhe të shpëtohen shpirtat tanë.

*I njëjti I të njëjtit
ose, sipas të tjerëve, i Andrea Pirit*

Bima e dëlirësisë, miroja erëkëndshme, sërish na lindi në këtë festë, që t'i thërrasim: Ti që re mbi kraharorin zotëror⁸ dhe që i hodhe si shi botës fjalën, o Joan apostull, që e ruajte Virgjëreshën¹⁷ si beben e syrit, kërko për ne nga Krishti përdëllimin e madh.^{17a}

I njëjti

Si shikues i mistereve të parrëfyeshme,² thërrisje duke gjëmuar, se Fjala e parajetshme ishte në fillim pranë Perëndisë dhe ajo ishte Perëndi,⁹ o Joan apostull, mik kraharori⁸ dhe i singertë i Krishtit, kënaqësia e Trinisë, mbështetja e patundur e Efesit dhe e Patmosit,¹⁸ ndërsa për ne ndihmë; ndërmjeto, o Theolog i tërë-lumur, që të çlirohet nga armiq besë-këqij mendorë dhe shqisorë populli që e kryen gjithnjë besërisht kujtimin tënd.

Ting. II I Theofanit

Majën e apostujve, trumbetën e theologjisë, gjeneralin shpirtëror, që ia nënshtroi botën Perëndisë, ejani, o besnikë, ta lumërojmë, Joanin e kënduar, i cili zhvendoset nga dheu dhe s'largohet prej tij, por rron dhe pret ardhjen e dytë të frikshme të Zotit.¹⁹ Përgjëroju që ta presim pa dënim, ne që me dëshirë të madhe kryejmë kujtimin tënd, o mik mistik i kraharorit të Krishtit.

*I oshënarit**Ting. Tërth. II*

O atë oshënar, në gjithë tokën doli zëri²⁰ i arritjeve të tua, prandaj në qiej gjete shpërblim²¹ për lodhjet e

tua; asgjësove batalionet e demonëve, arrite brigadat e engjëjve, jetën e të cilëve e kishe zili në mënyrë të paqortueshme; duke pasur guxim para Zotit, kërko paqe për shpirtrat tanë.

Lavdi

Ting. IV I Bizantit

Kur re në kraharorin e Krishtit Mësu-es, gjatë darkës së Zotit, o nxënës i dashur,⁸ atje njohe të parrëfyeshmet, edhe u gjëmove⁶ të gjithëve zërin qiellor: Në fillim ishte Fjala, dhe Fjala ishte pranë Perëndisë, dhe Fjala ishte Perëndi,⁹ drita e vërtetë që ndrit çdo njeri që vjen në botë, Krishti²² Perëndia dhe Shpëtimtari i shpirtrave tanë.

Tani

*I së kremtes**Pasvargje**Ting. II Ote ek tu ksilu se*

Fundin* e urtisë, ejani,* ta kurorë-zojmë me himne të perëndishme të gjith',* o besnikë, të lavdishmin dhe të dashurin,*⁸ pra shkrimtarin e dogmave të Orthodhoksisë,* se ai kumboi "Në fillim ish Fjala Zot";*⁹ ndaj u shfaq si zë bubullimash,*⁶ se për botën shkroi Ungjillin* plot me urtësi Joani famëmadh.

Varg: Në gjithë dheun doli zëri i tij dhe në skajet e botës fjalët e tij.

Qartas* dhe vërtet miku i madh* i Mësuesit Krisht u shfaqe, se re mbi gjoksin e tij,*⁸ nga ku nxore dogma urtësie, dhe me to* pasuron kozmosin e tërë, porsi hyjfolës* Perëndie, ndaj tani, duke i mbajtur fort* Kisha e hyjihshme e Krishtit* ngazëllohet edhe dëfrehet,* o Joan i virgjër, ungjillor me nam.

Varg: Qiejt tregojnë lavdi Perëndie.

Ki gaz,* Theolog me të vërtet* dhe gëzohu bir fort i dashur i nënës së Zotit tënd,* se, kur rrije pranë Kryqit të Jisuit Krisht,* ke dëgjuar një zë hyjnor nga Zoti, i cili* ty të thirri: “Ja ku është nëna jote pra”;*¹⁷ ndaj të lumërojmë të gjithë* denjësisht, se ishe apostull* i hyjnueshëm, i dashur dhembshurisht.

Lavdi

Ting. Tërth. II I Joan Monakut ose, sipas të tjerëve, I Leon Mjeshtrit

O apostull i Krishtit, ungjillor Joan, duke u bërë njohës i të parrëfyeshmeve, dogmat e pathëna të urtësisë na i kumtove,⁶ duke e shpallur fuqishëm te besimtarët këtë: “Në fillim ishte”;⁹ dhe duke e përjashtuar tjetrën: “Nuk ishte”; pra i zmbrespse fjalët

e heretikëve duke u shfaqur mik kraharori i dashur,⁸ si Isaia me zë shumë të madh dhe Moisiu²³ Perëndishikues;²⁴ meqë ke guxim para Perëndisë, lutju shumë për shpirtrat tanë.

Tani

I së kremtes

Përlëshore

E apostullit

Ting. II

O apostull i dashur i Krishtit Perëndi, nxito, çliro një popull të pambrojtur; të pranon të gjunjëzohesh, ai që denjoi t'i biesh mbi kraharor;⁸ atij përgjërroju, o Theolog, që të shpërndajë re kombesh këmbëngulëse, duke kërkuar për ne paqen dhe përdëllimin e madh.^{17a}

E oshënarit

Ting. Tërth. I Ton sinánarhon Logon

Mençurisht u largove nga të pëlqeshmet,* o oshënar, pasi more si Abrahami i madh* një zbulesë²⁵ dhe u shfaqe imitues ti* engjëjsh me jetën tënde pra,* o Arsen hyjprurës me urti të vërtetë, shndrite* dhe me fjalë praktike; lyp pa pushim që të na përdëllehen shpirtrat.

Dhe i së kremtes



NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësores
të së kremtes*

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësores
Ting. Tërth. IV
Tin sofian qe Logon*

Meqë kishe guxim porsi nxënës ti,* kishe rënë mbi gjoksin e Krishtit tënd* dhe pyete: Kush është* pra tradhtari yt, o Jisu?*. Dhe meqë kishe qenë i dashur,⁸ apostull shenjt,* te ti ky u tregua përmes bukës qartësisht;*²⁶ ndaj u bëre njohës i mistereve gjithnjë,* në botën e tër' mëson* mishërimin e Fjalës Zot,*²⁷ i lëvduar* dhe theolog;* ndërmjeto te Zoti yt Krisht,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tënd fort të shenjt' me mall.

Lavdi

I njëjti

Tani

I së kremtes

*Pas Polieleit, Ndenjësores
Ting. IV Tahí prokatálave*

Besnikë, kujtimin e apostullit ta nderojm',* sepse i ndriçon të gjithë, pasi

erdhi në tërë anët e botës sot,* se u dallua si mik* i Jisuit⁸ Çlirues* dhe theolog vërtet ky në Ungjill, u buron pra* shërime atyre që e mburrin me lavdërim.

Lavdi

I njëjti

Tani

I së kremtes

*Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV
Proqimeni Ting. IV*

Në gjithë dheun doli zëri i tij dhe në skajet e botës fjalët e tij.

Varg: Qiejt tregojnë lavdi Perëndie.

*Ungjilli (nga Dera e Bukur). Ne që
pamë ngjalljen. Psalmi 50.*

Lavdi. Me ndërmjetimet e apostullit. Tani. Me ndërmjetimet e Hyjlindëses. Përdëllemë, o Perëndi. *Dhe Idhiomeli.*

Ting. II I Theofanit

Majën e apostujve, trumbetën e theologjisë, gjeneralin shpirtëror, që ia nënshtroi botën Perëndisë, ejani, o besnikë, ta lumërojmë Joanin e kënduar, i cili zhvendoset nga dheu dhe s'largohet prej tij, por rron dhe pret ardhjen e dytë të frikshme të Zotit.¹⁹ Përgjëroju që ta presim pa

dënim, ne që me dëshirë të madhe kryejmë kujtimin tënd, o mik mistik i krahavorit të Krishtit.

Kanunet (shih Tipikonin)

Ode I

Kanuni i ungjillorit

Peozi e Theofanit (ose, sipas të tjerëve, e Joan Monakut).

Ting. Tërth. IV

Armatilatin Faraó

Si i pastruar, ishe dashur fort prej Dritës më të skajshme, Joan;* me guxim në shpirt pra* ishe prehur përmbi gjoksin e tij⁸ dhe e nxore ti,* o apostull i urtë, jashtë avushës së urtësis'* dritën e hydijes²⁸ që na shpëton.

Theologove kur gjëmove⁶ përmbi mend, i dashur prej Krishtit Zot:*⁸ Në fillim ish Fjala,* jeta¹⁴ krejt enipostate dhe ish pranë Lindësit;* Perëndi ishte Fjala⁹ dhe mish u bë Fjala,²⁷ edhe pse* mbeti Perëndi pa ndryshim aspak.

Hyjlindësore

Gjithnjë përikim ne nën strehën tënde edhe zmrapsim çdo turbullim* dhe stuhi në ngasje,* o e pacenuar, e dëlirë, ndaj kërkojmë pra* të na nxjerrësh tani përmes lutjes sate të hyjshme krejt,* se në thellësi fajesh ramë keq.

I oshënarit I njëjti

Duke iu bindur porosisë zotërore, shën Arsen, e le pas* çdo lavd pasurie*²⁹ mbretërore, si shën Moisiu,³⁰ pra ligjvënësi,*^{30a} si u shmange nga njerëzit,^{30b} dhe banon tok me engjëjt lart* dhe me ta në qiell dëfren gjithnjë.

Ushmange, o Arsen, nga zhurmat, se burim mëkatesh janë këto;* gjuhën e përmbajte* përmes heshtjes si me fre;³¹ në qetësi pa turbullim* pra e ruajte mendjen, kështu u bëre për Shenjtin Shpirt* një shtëpi³² me plot nder, me dinjitet.

Hyjlindësore

Pra gjenerat' pas gjenerate³³ thanë gjëra të lavdishme për ty,*³⁴ që në bark e mbajte* Perëndinë Fjalë, mbe-te e kulluar, ti Mari,* o Hyjlindëse, ndaj ne të gjithë të lartësojmë ty,* që pas Zotit je mbrojtja jonë ti.

Zbritësore: Anastáseos imera

Dit' e ngjalljes

Ode III

I ungjillorit: O stereosas kat' arhás

Prej peshkatarësh, peshkatar* për vdekatarët³⁵ u bëre,* theolog, Joan i urtë; s'kurseve* lidhjen atërore edhe tokësore, ndoqe⁴ pra* me dashuri hyjnore* Fjalën Jisu, Zotin tonë Krisht.

Syrin e shpirtit, Theolog,* meqë e kishe pastruar,* pe të fshehtin lavd të madh pra të Fjalës,* Bir të Atit Perëndi, të vetëmlindurin e tij;*²⁷ përmes të cilit çdo gjë* qart' u krijua¹³ në Shenjtin Shpirt.

Hyjlindësore

O Virgjëreshë, që në bark* e kishe Zotin, te ti vij,* rend në mbrojtjen tënde edhe shkarkohem* nga çdo influenc' e keqe e armikut dhe shpëtoj,* se lyp ti; u çlirofsha* dhe në të ardhmen nga çdo ndëshkim.

E oshënarit I njëjti

O atë, rrecka krejt pa vler',* e trashë e varfërisë,* imituese e Zotit,³⁶ mbulonte* luksin e mëparshëm të stolisë, o Arsen, kështu* të siguronte veshjen* që ka lavdi³⁷ të pashprehshme dot.

U bëre triumfues, at',* nëpërmjet përrulësisë,* me një zemër të dërrmuar,³⁸ kur ndihmën,* o Arsen, nga Perëndia prite dhe i theve krejt* sulmet që sillnin frymë* papastërtie, keqdashëse.

Hyjlindësore

Më lart ti nga çdo Keruvim* dhe Serafim u tregove,* o Hyjlindëse, se ti vetëm prite* Perëndi të pacenuar brenda barkut, e dëlir',* o e panjollë; me himn* të lumëron çdo besnik me hir.³⁴

Zbritësore: Dhefte poma piomen

Eni pini ujë

Ndenjësore

E ungjillorit: Tin sofian qe Logon

Meqë re përmbi gjoksin⁸ e urtësis',*⁷ e mësove krejt dijen e Fjalës Zot;* kumtove me hyjshmëri:* "Në fillim ishte Fjala",⁹ Krisht;* e shkrove bukur lindjen pa kohë i pari ti,* dhe shpalle te çdokush mishërimin e Perëndis';*²⁷ ndaj me gjuhë joshe, kape kombe në rrjetë,*⁴ dhe Hirin e Shenjtit Shpirt* e mëson në çdo anë drejt,* o apostull* dhe Theolog,* ndërmjeto te Zoti yt Krisht,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tënd fort të shenjt' me mall.

E oshënarit E ngjashme

Si i shmange poderet e botës ti,* qetësisht po jetoje, vrave kështu* pasionet,³⁹ edhe i dhe* krahë mendjes drejt Perëndis';* u bëre shtyllë zjarri,⁴⁰ ndriçim i të gjithëve,*⁴¹ që të nderojmë, ndërsa me shirat e lotëve* ishe plehëruar, dhe u shfaqe si pemë* me fryte të shumta, shenjt,* në avllitë e Zotit⁴² tënd,* o hyjmentës, Arsen i madh;* ndërmjeto te Zoti yt Krisht,* të na dhurojë ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tënd fort të shenjt' me mall.

*Dhe i së kremtes**Ode IV**I ungjillorit: Si mu ishtë Kirie*

Zoti të quajti bir bubullime,⁶ të denjësoi të gjëmosh në Shpirt, se lindja e tij prej Atit është mistike, hyjnore dhe e pakonceptueshme; prandaj, o Theolog, lavdërojmë me melodi kujtimin tënd gjithëfestiv.

O apostull, ti u ngrite në lartësi virtutesh, ti e pe haptazi Fjalën e vetëmlindur të shkëlqente në mish²⁷ fuqishëm me lavdi,⁴³ dhe të ulej pa fillim në gji atëror,⁴⁴ dhe u denjësove të dëgjosh zë Prindi që i dëshmonte birërinë.⁴⁵

Hyjlindësore

Unë, shërbëtori yt i pavlefshëm, o e Tërëpaqortueshme, mos u turpërofsha duke përikur tani te përkrahja jote, sepse ty të kam mbrojtje pranë Perëndisë dhe mur të paluftueshëm; më ty do të shijoj edhe qetësinë e ardhshme dhe do të arrij jetën e hyjnueshme.

I oshënarit I njëjti

Ti, o atë Arsen, u duke dhunues natyre,⁴⁶ ti ia nënshtrove totalisht pasionet mendjes sunduese,⁴⁷ duke e urdhëruar gjumin si shërbëtor; prandaj

dhe thërrisje në agripni gjatë tërë netëve: Lavdi fuqisë sate, o njeridashës.

Ti, o oshënar, atë Arsen, e kërkoje me mall Perëndinë,⁴⁸ kur u shfaq, e dëshirove akoma më shumë dhe, si u bëre i tëri hyjpamës me anën e pastriimit, komunikove me të dëshiruarin dhe, me anë të bashkimit, e njohe më të Lartin përmbi çdo konceptim.

Hyjlindësore

Ti je krenaria e besnikëve, o e panusëruar, je mbrojtje, je edhe strehë të krishterësh, mur dhe liman, sepse çon lutje te Biri yt, o e tërëpapërlyer, dhe shpëton nga rreziqe ata që me besë dhe dëshirë të njohin si Hyjlindëse të kulluar.

Zbritësore: Epí tis thias filaqís

Nga fron' i q'ellit

*Ode V**I ungjillorit: Ina ti me aposo*

Kur pe në errësirën e botës të shkëlqejë drita⁴⁹ e pamotshme dhe, pasi u përzjeve me mallin dhe u bëre ndriçues shpresëtarie, shkëlqeve fiset e kombeve shumëfarëshe me dritë teologjike, o Joan.

Pasi njohe saktësisht se Ligji i hijes⁵⁰ u dha nëpërmjet Moisiut, ndërsa Hiri

i hyjshëm na u bë me anën e Krishtit⁵¹
Perëndi, me gjuhë theologe ungjillë-
zove Hyjninë e tij, o bir i dashur i bubu-
llimës.⁶

Hyjlindësore

Ti për mua je strehë dhe pushtet,
dhe mbështetje, dhe mur i paçarë, o
e Tërëdëlirë, dhe ty të thërras: Natë e
ditë ruajmë nga çfarëdolloj dëmi që
sulmon nga beljari, që të të lavdëroj
me besë dhe mallëngjim.

I oshënarit I njëjti

E zbrapse përmes besës ndërmje-
tuesin e shkeljes së parë të Adamit,⁵²
të parëgatuarit, sepse i dije mirë dre-
dhitë e armikut; prandaj, duke kërcyer
në lëndinë të pacenuar shijimi, për-
gjëroju Krishtit Zot.

E mohove veten tënde, o Arsen, si
shtype çdo epsh dhe, kur kryqin tënd⁵³
e mbajte⁵⁴ mbi supe dhe aspirove
Krishtin, u bërë denjesisht bashkë-
trashëgimtari i tij⁵⁵ në qiej.

Hyjlindësore

Duke pasur guxim nënor para Birit
tënd, o e Tërëkulluar, të përgjërohemi
të mos e shpërfillësh përkujdesjen
tonë farefisnore, sepse ne të krishte-
rët të vëmë para Zotit vetëm ty si zbu-
tje dashamirëse.

Zbritësore: Orthrísomen orthru vatheos

Mëngoni menatë dhe eni

Ode VI

I ungjillorit: Ávisos amartión

Pa dikur simbolikisht* Isaia një
thëngjill zjarri hyjnor,* që përmes tij
në buzë u pastrua,⁵⁶ u bë i denj* për
profet; por, o Joan, ti u dallove mbi
gjoks, mik Fjale*⁸ i Perëndis' që mori
mish,²⁷ i lum.

O Joan i lum, u shfaq* Fjala, si u
trupëzua, e cila* qëndron e vetëm-
lindur brenda gjirit të Atit Zot;* kjo si
mik të dashur⁸ ty të ka shpjeguar pa
mish, se fare* s'e pa ndonjë askurrë
Perëndin'.⁴⁴

Hyjlindësore

Linde, Virgjëreshë ti,* o Hyjlindëse
e tërëhimnuar,* Jisunë, reflektimin e
lavdisë së Atit⁵⁷ lart,* ndrite shpirtin
tim pra; sa mbanin fort hirin tënd dhe
vërtet ty* të kan' pasuar, zbrapsën
fjal' kote.

I oshënarit I njëjti

Vrave me shpresëtar,* me mungesë
vesesh,⁵⁸ mentalitetin* e mishit,⁵⁹
s'preferove pasuri tokësore pra;*
aspiroje, atë Arsen, oshënar shenjt,

trashëgiminë* lart, që ka Krishti; deshe ta shijosh.

Rrije natën drejt në këmb',* derisa të ndalte dielli lutjen,* pra paralajmëronte se, pas lodhjes në jet' mbi dhé* plot mundime, do të të fekste shkëlqimi që s'krahahet,* që del nga Dielli mendor, Arsen.

Hyjlindësore

Duke pasur dhembshuri* ti që linde Fjalën që do të mirën,* shpëtona, nga peripeci të dhunshme, të tmerrshme ne,* se ty vetëm, Zonjë e tërëkulluar, ne besimtarët* mbrojtje të paluftuar të kemi.

Zbritësore: Katilthes en tis katotatis

Kur zbritë gjer në fund

Kontaqi i ungjillorit

Ting. II Ta megalia su parthene

Kush, o i virgjër, do tregojë sakt' madhërimin tënd,* se po buron mrekulli, gufon dhe shërime plot,* dhe gjithnjë ndërmjeton ti për shpirtrat tan'* si mik i Krishtit⁸ edhe Theolog.

Shtëpia

Është e guximshme dhe e pakapshme të mësosh lartësitë qiellore dhe të hulumtosh thellësitë e detit. Sikur-

se pra s'është e mundur aspak t'i numërosh yjet⁶⁰ dhe rërën e bregut⁶¹ të detit, po ashtu nuk je i aftë dot të flasësh për Theologun; sepse me shumë kurora e kurorëzoi Krishti, të cilin e deshi dhe në kraharorin e të cilit ra, dhe hëngri bashkë në darkën mistike, si mik i Krishtit⁸ edhe Theolog.

Sinaksari

Më 8 të të njëjtit muaj, kujtimi i apostullit të shenjtë, të lavdëruar dhe ungjillor, mik, i dashur, që ra mbi gjoks, dhe të virgjrit Joan Theologu, d.m.th. mbledhja e pluhurit të shenjtë, pra e manës, që buron prej varrit të tij.

Vargje: Jo ushqim, por shërim u shpërndan njerëzve/ mana e varrit tënd, o mist i Zotit.

Në të tetën bëjnë stolisjen me trëndafil të varrit të birit të bubullimës.⁶

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Arseni i Madh.

Vargje: Donte të jetonte fshehtazi Arseni,/ i cili patjetër që nuk na shpëtoi, edhe pse vdiq.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII

I ungjillorit: Theú singatávasin

Me gatishmëri dole nga pranga e materies, o i gjithëlumur, si shoqërues

Perëndie dhe, pasi u bërë lajmëtar thelogjie të hyjfrymëzuar, na mësove të thërrasim: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.⁶²

Ar dhe pasuri si kashtë i llogarite, o i gjithëlumur, dhe, përmes energjisë hyjnore, kashta u bë flori për ty që thelogoje Ndërtuesin dhe psalje: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.⁶²

Shpirti i Shenjtë që del prej Atit⁶³ pa fillim dhe merr prej teje⁶⁴ në mënyrë të pandarë, o Fjalë e vetëmlindur e Perëndisë,⁶⁵ u lajmëroi apostujve të thërrasin: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.⁶²

Hyjlindësore

Me shtatzëninë tënde të parrëfyeshme, na denjësove për gjëra të frikshme e të papërshtatshme, o Perëndilindëse; prandaj më çliro nga dënimi i frikshëm, dhe më denjëso për harenë e patregueshme, që të të himnoj përherë ty, të shumëhimnuar.

I oshënarit I njëjti

O atë Arsen, durove duhmën e keqe, duke shlyer dëmin e aromave të mëparshme dhe, pasi u bërë miro erëkëndshme e Krishtit⁶⁶ me kungimin e Hirit, thoshe: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.⁶²

Ufute me trup në furtunën hyjnore,⁶⁷ o atë Arsen, dhe, si mësove mistikisht më Krishtin dijen e Atit të pafillim dhe të Shpirtit, përhimnove Njësinë në Trini, duke thirrur: I bekuar je, o Perëndi i etërve.⁶²

Triadik

Duke theloguar, të shpallim orthodhoksisht Zot të gjithçkaje dhe Atë të një të vetmi Bir të vetëmlindur, dhe dimë një Shpirt të drejtë, të bashkëmbirë dhe të bashkëpërvetshëm që del prej teje.⁶³

Zbritësore: O Pedhas ek kaminu

Tre Djemat midis flakës

Ode VIII

I ungjillorit: Eptaplasios káminon

Kujtimi yt i tërëlavdëruar, o ungjillor i Hyjnisë së Jisuit, si i hijshëm dhe solemn i shkëlqeu Kishës, duke lëshuar erë miroje të perëndishme; ndaj ne besnikët këndojmë të gëzuar: O Djem, bekojeni; priftërinj, përhimnoveni; popull, përmbilartësojeni Krishtin përjetë.

Duke pasur si kryetar të korit Theologun, o Krisht, që thelogoheste prej tij, të shpallim ty Perëndi tok me Atin dhe Shpirtin dhe, duke himnuar me

ngazëllim, thërrasim: O Djem, bekojeni; priftërinj, përhimnojeni; popull, përmbilartësojeni Krishtin përjetë.

Hyjlindësore

Oe tërëpaqortueshme, ke lindur Fjalë Perëndi⁹ që u trupëzua; atij përgjëroju që të më çlirojë nga zjarri, sepse ja tërë jeta ime u konsumua, pasi u skllavërua e gjitha në mëkate të frikshme; ndaj te ti, o Virgjëreshë, përik unë mjerani dhe të thërras ty Hirploten.

I oshënarit I njëjti

Me rrjedhat e lotëve, o Arsen, shove plotësisht me forcë flakërimin shpirtshkatërrues të kënaqësive dhe djetigien ndëshkuese të Gjehenës; por, që të shpëtojmë dhe ne nga të dyja, mos pusho së përgjëruari Shpëtimtarin e botës Krisht,⁶⁸ që e bekojmë në gjithë jetët.

Edogje për veten furrën e kataniksit shtatë herë më shumë se kaminën e Babilonës,⁶⁹ o oshënar; duke u freskuar në të⁷⁰ me ndriçimin e Hirit, thërrisje: Bërësin dhe Çlirimtarin, o Djem, bekojeni; priftërinj, përhimnojeni; popull, përmbilartësojeni Krishtin përjetë.

Triadik

Hyjninë e trindritshme, që shkëlqen

lavdi unike nga një natyrë trihipostate, Lindësin pa fillim, Fjalën e njëmbirë me Atin dhe Shpirtin e njëqenshëm dhe që bashkëmbretëron, o Djem, bekojeni; priftërinj, përhimnojeni; popull, përmbilartësojeni Krishtin përjetë.

Zbritësore: Afti i kliti

Dita m'e shkëlqyer

Ode IX

I ungjillorit: Eksesti epí tuto o uranós

Kur rrinte pranë Kryqit të Zotit Krisht*, iu besua Hyjlindësja e Virgjër dhe e dëlir',*¹⁷ se ish instrument i kulluar krejt* thelogjie, nxënësi* më i dashur⁸ si dhe i virgjër ky.* Tani po lumërohet* siç duhet, se ish mbrojtës* i Zonjës¹⁷ sonë që nuk ka qortim.

Joan i lum, i pastri e deshi fort* denjësisht jetën tënde të thjeshtë, që s'kish djallëzi,* se mbi dhë jetove si engjëll ti* dhe si vëlla të mori ty,* kur të lajmëroi si djalë, bir* të nënës së vet, Zonjës* Hyjlindëses;¹⁷ me të ne* ju lumërojmë që të gjithë tok.

Hyjlindësore

M'u bëj si parg shpëtimi, o e dëlir',* duke zmbraur kolona demonësh, largo çdo mori* ngasjesh dhe rrezikesh, si edhe sulm* pasionesh tutje shporri ti,* dhe ma jep lirinë e pastër

krejt,* dhe më dhuro bollëkun* e Hirit dhe karizma,* dhunti të hyjshme, dhe çdo mirësi.

I oshënarit I njëjtë

Pasi u denjësua simbolikisht,* shtat-zënin' e së Virgjës e pa Moisiu në ferr'* që po flakërohej⁷¹ si figurim* i saj; u mrekullua pra* hyjshikuesi, por ti në vegim* me Shpirtin u bashkove* i tëri; me form' zjarri* u shfaqe, o Arsen; të lumërojm'.

Të lindi Krishti dritë që s'perëndon,* dhe të priti gëzimi në qiej, se solle me zell* jetën tënde pa njollë, meqë ti* kujtoje vdekjen pa pushim* edhe e studioje, ndaj denjësisht* i korre frytet, çmimet,* për lodhjet që ke hequr,* Arsen i tërëlumur, oshënar.

Hyjlindësore

U shfaqe nënë Zoti, e Virgjra ti* mbi natyrë, kur linde me trup atë, Fjalën e mir',* që nga zemra Ati e nxori⁷² pra,* përpara gjithë jetëve,* se ishte dhe është gjithnjë i mir';* pra e konsiderojmë* se është dhe tani mbi* çdo trup, megjithëse ka veshur trup.

Zbritësore: Fotizu, fotizu

Një engjell i thërriste

dhe

Ndriçohu, ndriçohu

*Dërgimësore e ungjillorit
Tis mathitës sinélthomen*

Theologove si gjënim*⁶ se Fjala ishte në fillim,* pran' Perëndisë Fjala ish* dhe Perëndi ish Fjala,*⁹ se, o apostull Joan shenjt,* mbi gjoksin zotëror re*⁸ dhe prej andej burim jete* plot me thelogji pate nxjerrë ti,* Theolog i lumur, kështu vadit krejt* Krijesën mbarë⁷³ me bollëk,* ndaj ajo të lëvdon ty.

E oshënarit E njëjtë

Duke iu bindur, shën Arsen,* o oshënar dhe atë,* ligjit të hyjshëm zotëror,* le tërë botën²⁹ mbrapa,* pra kryqin tënd ti e more,* shkove me gaz pas Krishtit*⁵³ dhe vigjiloje n'agjërim,* lot dhe qëndrim çdo natë në këmbë ti,* o hyjmentës, me qetësi dhe lutje;* ndaj u bashkove me Trinin'* e Shenjtë përmes tyre.

Dhe e së kremtes

*Lavdërime të ungjillorit
Ting. Tërth. IV O tu paradhoksu
thávmatos*

O Joan i lum, i urtë krejt, e pate me mbushulli* dashurin' zjarr për Krishtin tënd,* dhe më shumë nga nxënësit* pra u deshe⁸ dallueshëm* nga Fjala tërëshikuese⁷⁴ hyjnisht,* që gjithë bo-

tën gjykon me drejtësi,* se u ndriçove krejt* si në trup edhe në shpirt me pastërti,* bukuri dëlirësie, i hyjlumi shenjt.

Le ta përhimnojmë ne me këngë shpirtërore tani* shërbëtorin e Krishtit ton',* shën Joanin ungjillor,* lulëzim virgjërie ish,* si dhe banesë mikpritëse me hir* dhe e nderuar virtytesh, gjithashtu* vegël urtie ky,* tempull Shpirti, goja me shkëlqim të madh,* hir dhe sy plot me ndriçim i Kishës së Zotit.

Nxore çurkat e thelogjisë, teksa re ti me mall* përmbi gjoksin⁸ e urtësis',*⁷ dhe vadite rruzullin⁷³, o Joan i shkëlqyeshëm,* me diturin' e Trinis', kur thave krejt* det ateizmi; u bëre shtyllë pra* dhe re frymore tok,* na drejton⁴⁰ të gjithë ne në trashëgim* qiellor në Mbretërinë e Jisuit Zot.

I oshënarit I ngjashëm

Veten e largove, o Arsen, nga bota plot turbullim* dhe drejt skajit mbietokësor* qenke ngjitur, o i lum,* kape të dëshiruarën* me të vërtetë, se aspirove fort* vetë burimin e çdo të mire ti;* ndaj përmes saj shkëlqen,* o hyjmentës; dhe me ndërmjetimin tënd,* o i ndritshëm, na rrëmbe prej fajit tonë sterr'.

Lavdi *Ting. Tërth. IV*

O ungjillor Joan, i barabartë me engjëjt, i virgjër, Theolog i hyjmësuar, e shpalle orthodhoksisht te bota brinjën e pacenuar, që buronte ujë dhe gjak,⁷⁵ brenda të cilit pasurojmë shpirtat tanë me jetën e amshuar.

Tani *I së kremtes*

Dhoksologjia e Madhe

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret e së kremtes, e ungjillorit dhe e kishës. Apostulli dhe Ungjilli i ungjillorit. Kungatore: Në gjithë dheun.

CITIME

¹ Rom. 1.16 etj.

² Apok. 1.10-11

³ Apok. 1.1

⁴ Matth. 4.21-22; 10.2; Mark. 1.19-20; 3.17; 10.35; Lluk. 5.9-11

⁵ Kënga e Këngëve

⁶ Mark. 3.17

⁷ Lluk. 11.49; Rom. 11.33; I Kor. 1.21; 2.7; Ef. 3.10

⁸ Joan 13.23-25; 21.7,20

⁹ Joan 1.1

¹⁰ II Petr. 3.18

¹¹ II Kron. 14.4 etj; Hebr. 11.6

¹² II Kor. 4.17

¹³ Joan 1.3

¹⁴ Joan 1.4

¹⁵ Ps. 8.6

¹⁶ Joan 7.38
^{17a} Num. 14.19 etj.
¹⁷ Joan 19.27
¹⁸ Apok. 1.9
¹⁹ Joan 21.22-23
²⁰ Ps. 18(19).5
²¹ Matth. 5.12; Lluk. 6.23,35
²² Joan 1.9
²³ Eks. 33.11
²⁴ Eks. 33.23
²⁵ Gjen. 12.1
²⁶ Joan 13.26
²⁷ Joan 1.14
²⁸ II Kor. 4.6
²⁹ Matth. 19.21
³⁰ Eks. 2.15; Hebr. 11.34-37
^{30a} Eks. 34.32; Joan 1.17 etj.
^{30b} Is. 52.11; II Kor. 6.17
³¹ Jak. 1.26
³² I Kor. 3.16; 6.19
³³ Lluk. 1.48
³⁴ Ps. 86(87).3
³⁵ Matth. 4.19
³⁶ Matth. 8.20; Lluk. 8.3; 9.58
³⁷ Sirak 6.29,31; 45.7; 50.11
³⁸ Ps. 50(51).19
³⁹ Kol. 3.5
⁴⁰ Eks. 13.21; 14.24
⁴¹ Fil. 2.15
⁴² Ps. 51(52).10; Osia 14.7
⁴³ Matth. 17.2; Mark. 9.3; Lluk. 9.29;
Joan 1.14

⁴⁴ Joan 1.18
⁴⁵ Matth. 17.5; Mark. 9.7; Lluk. 9.35
⁴⁶ Matth. 11.12; Lluk. 16.16
⁴⁷ Ps. 50(51).14
⁴⁸ II Kron. 15.12 etj.
⁴⁹ Is. 9.2; Matth. 4.16; Joan 1.5
⁵⁰ Kol. 2.17; Hebr. 10.1
⁵¹ Joan 1.17
⁵² Gjen. 3.1-6
⁵³ Matth. 16.24; Mark. 8.34; Lluk. 9.23
⁵⁴ Lluk. 14.27; Joan 19.17
⁵⁵ Rom. 8.17
⁵⁶ Is. 6.6-7
⁵⁷ Hebr. 1.3
⁵⁸ Kol. 3.5
⁵⁹ Rom. 8.6-7
⁶⁰ Gjen. 15.5; 22.17
⁶¹ Gjen. 13.16; 22.17; 32.12
⁶² Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2
⁶³ Joan 15.26
⁶⁴ Joan 16.14
⁶⁵ Joan 1.14,18; 3.16,18; I Joan 4.9
⁶⁶ II Kor. 2.15
⁶⁷ Eks. 20.21; Sirak. 45.5
⁶⁸ Joan 4.42; I Joan 4.14
⁶⁹ Dan. 3.19,22
⁷⁰ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 26
⁷¹ Eks. 3.2-5
⁷² Ps. 44(45).2
⁷³ Gjen. 2.6
⁷⁴ II Makk. 9.5
⁷⁵ Joan 19.34





MË 9 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i profetit të shenjtë Isaia dhe i martirit të shenjtë Kristofori.

NË MBRËMËSORE

Thirrtoje të profetit

Ting. IV Édhokas simíosisin

Pasi u pastrua nëpërmjet thëngjillit hyjnor plot tmerr* Isaia i madh me lavd,* ngaqë i kulluar ish* dhe i pasur tepër* me virtyte, sheh shndritjen e Hyjnisë, profeci* për mishërim Zoti i besohet drejt,* caktohet predikues,¹ paralajmëron kombet për shpëtim*² në të ardhmen, si dhe me të* ardhjen, shfaqjen e hyjshme³ tok.

Kur pastrove mendjen, Isaia i admirueshëm,* instrument i suksesshëm krejt* i Shpirtit u bëre ti,* që i binin engjëjt* bukur përgjithnjë, pra duke këmbyer melodi* hyjnisht, siç duhej, o i kënduar fort;* vështroje Perëndin' të ulej përmbi fronin e ngritur lart* dhe hyjnore të mësoje drejt*¹ dhe ndriçoheshe, o profet.

Kur pe qartë një pushtet Trinie tri-hipostate, shenjt,* që me zë trishenjtor gjithnjë* ajo lart lëvdohej pra,* që nga Serafimet* e patrup, të hyj-

shme, u bëre mist, i lumi shenjt* dhe t'u besua hir profetik¹ hyjnor,* ndaj, o i mrekullueshëm, kremtojm' kujtimin tënd krejt të shenjt'* dhe të sjellim te Krishti Zot* si ndërmjetës ty fuqiplot.

Të martirit

Ting. I Ton uranion tagmaton

Arritjet e Kristoforit ejani t'i nderojm';* buron përmes këtyre* për ne hirin që po rrjedh* pa pushim nga Jetëdhënësi Krisht,* se martiri me burrëri,* kur mbi armiq triumfoi, ka marr' pushtet* përmbi dhimbjen, djallin⁴ dhe veset.

Gufon burime çudish edhe jep shërim, çlirim,* nga gjith' epidemitë* dhe rreziqet, rrufetë* pluhuri që prej lipsanit tënd del;* populli yt në kërcënim,* që të shpëtojë gjithnjë nga çdo dëm, të lyp,* triumfues Kristofor me nam.

Për nga pësimi që hoqe, i shumëvuajtur,* kujtimi yt i shenjtë* nxjerr arom' trëndafilash* si pranverë plot freski, o martir;* përmes garave që ke bër',* të pafuqishmit, fajtorët marrin shëndet* dhe himnojnë Krishtin dhënë, Zot.

Lavdi *I martirit*

Ting. IV I Joan Monakut

Kisha e Perëndisë, e stolisur me

guaskën e gjakut të martirizimit tënd, lëshon rreze diellore, o Kristofor triumfues; sepse, pasi e armatose veten me Kryqin dhe preferove me gatishmëri vdekjen për Krishtin, u rreshtove trimërisht përballë të huajit dhe, si turpërove të gjitha dredhitë e të paligjve, u duke ushtar ngadhënjimtar i Krishtit;⁵ prandaj të përgjërohemi, o bukuria e martirëve, meqenëse ke guxim, ndërmjeto që të shpëtojnë shpirtrat tanë.

Tani *I së kremtes*

Pasvargjet e së kremtes

Lavdi *I martirit*

Ting. IV I Anatoliut

Ejani, tërësi e shpresëtarëve, le të formojmë kor shpirtëror dhe të ndërtojmë me himne athloforin e Krishtit Perëndi, Kristoforin e lavdishëm; sepse sot lindi si yll i mëngjesit dhe shkëlqen mendjen e besnikëve, të cilët, me besë dhe mallëngjim, e kremtojnë kujtimin e tij të respektuar.

Tani *I së kremtes*

Përlëshorja e profetit

Ting. II

Isai profet i shenjtë, që të kremtojmë me besë, ndërmjeto përpara Zotit të shpëtohen shpirtrat tanë.*

Lavdi *I martirit*

Ting. IV Tahí prokatálave

Qëndron pranë Zotit⁶ dhe Mbretit të qiejve⁷ lart,* i bukur për shkak stolie gjaku, o Kristofor; i shumëkënduar je;* bashkë me kor martirësh* edhe engjëjsh këndon tok* një melodi të frikshme, trishenjtorë;¹ shpëtoji,* përmes përgjërimit tënd, shërbyesit e tu, shenjt.

Tani *I së kremtes*



NË MËNGJESORE

Kanunet: i së kremtes dhe të shenjtoreve:

Poezi e Theofanit

Ode I

I profetit

Ting. IV Ásomé si Kírie

Ndriçomë, o Zot, Perëndia im, dhe drejtomë me përpikëri dhe hijeshi, që ta mburr panairin e lavdëruar dhe të nderuar të profetit të hyjshëm.

Trumbeta hyjfolëse e Isaías, pasi kumboi mbi dhé, bashkëthirri bijtë e Kishës, që të kremtojnë kujtimin e tij.

Meqenëse pasionet e trupit ia nënshtrova qartas mendimit të shpirtit, o

hyjprurës, u denjësove të vëzhgosh lavdinë e të Tërëfuqishmit.¹

I martirit Ingjashëm

Ejani sot të gjithë, o krishtprurës hyjmendës, të përhimnojmë besërisht kujtimin e Kristoforit, martirit të së vërtetës.

Luftove burrërisht kundër mashtrimit dhe shkele kërcënimeve të tiranëve, i forcuar prej fuqisë së Kryqit, o dëshmor athlofor.

Hyjlindësore

Isaia i lavdëruar, o e Tërëpacenuar, duke parashikuar, të paralajmëroi ty Perëndilindësen si shkop, dhe njëkohësisht, si lule, Fjalën që mishërohej⁸ prej teje.

Ode III

I profetit: Tokson dhinatón isthénise

Tërë* shndritjen që prej Shpirtit vjen,* e pranove, ndaj parathe misterin që s'shprehet dot,* pra të ekonomisë së Fjalës,* o profet i lavdëruar fort.

Shndritjen* e shpresëtarisë ti* e tregove, pasi në lartësi qiellore pra* ishe ngritur dhe ke qortuar* pafuqi të kotë të idhujve.

Guri* i tejçmuar, Zoti Krisht,* në Sion si gur qosheje⁹ do lidhë mbar' koz-

mosin;* ky do lindë, profetizoi* Isaia emërmadh me lavd.

I martirit Ingjashëm

Duke* u gëzuar, o martir* athlofor, shijoje atë që deshe ngaherë fort,* si durove çdo dhimbje, meqë,* si me arm,' me Kryqin mbroheshe.

Mishi* pritej me tortura keq,* ndër-sa shpirti yt i hydashur studionte çdo shijim,* Kristofor, të Mbretërisë,* se ushqehej ky me dashuri.

Hyjlindësore

Lindi* mishërisht e Virgjra Vajz'* Krishtin Jetëdhënës dhe Shpëtimtarin e shpitrave.* Ja përmbushje vërtet gjen thënia* e profetit Isaia shenjt.³

Irmosi: Tokson dhinatón isthénise

»**H**arku* i të fortëve u tret,* dhe të »dobësuarit janë ngjeshur me plot »fuqi,*¹⁰ ndaj në Zotin u sigurua* ze- »mra ime¹¹ pa u tundur dot.

Ndenjësove E profetit

Ting. III Thias písteos

O profet plot lavd,* shën Isaia,* meqë zë hyjnor* ti ke dëgjuar,* denjësisht kështu pranove prej Zotit hir*¹ dhe parathe të vërtetat me predikim,* si dhe qortove tiranët ligjshkelësit;*¹²

u sharrove pra me sharrë prej druri
edhe rri* me Krishtin; për shërbyesit
e tu lutju.

Lavdi *I martirit*

Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon

Zvarranikun e keq djall qysh në fillim*¹³ e ke shkelur kur zhveshe terrin e zi* të padijes, o martir* Kristofor, fitimtar i madh,* pasi fitove njohjen e shpresëtarisë ti,* se mendja jote digjej prej zellit hyjnor; kështu,* çdo vrull ateist idhujsh e shove dhe prite* kurorën krejt denjësisht* si shpërblim pra për luftërat,* gjithashtu jep* shërime plot;* ndërmjeto te Zoti yt Krisht,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tënd fort të shenjt' me mall.

Tani *I së kremtes*

Ode IV

I profetit: Tis sis epí jis

U lartësove drejt majës së virtytit, komunikove me pastërti me të dëshiruarin dhe psalje gëzueshëm: Lavdi fuqisë sate, o Zot.

T'u besua hir profetik, o Isaia, dhe u tregove banesë e hyjshme Perëndie, dhe u denjësove për tenda qiellore me lavdi pa cen.

The që përtëriteshin ishuj,¹⁴ duke

thënë si me enigma për Kishat e kombeve¹⁵ që do të mbusheshin me Shpirt hyjnor, o i lavdishëm, duke u bërë mist të parrëfyeshmesh.

I martirit I ngjashëm

More, o martir, trashëgiminë e qiejve, pasi luftove mbi dhé për Krishtin, dhe shove burrërisht mashtrimin besëkeq të idhujve.

Gjarpri të ofronte "atentatin" e grave, si dikur Adamit paraatë,¹⁶ por u turpërua, sepse humbi duke sajuar leqe kundër vetes.

Hyjlindësore

Isaia i hyjshëm predikoi: Na u dha fëmijë prej profeteshës,¹⁷ i cili lindi para dhimbjeve të lindjes¹⁸ së Perëndilindësës, pushteti i të cilit u bë mbi supe.¹⁹

Ode V

I profetit: Ton fotismón su Kírie

O hyjfolës, meqë shikoje misterin e fshehur që nga fillimi,²⁰ na e deklarove vendimin e lashtë²¹ të ekonomisë së të Tërëllartit për ne.

O Zot, burimi i përhershëm i pësimeve të tua na lan tërësisht nga pasionet, sepse erdhe si Shpëtimtar, siç na mësoi profet Isaia.²²

I martirit Ingjashëm

Me anën e ndriçimit të besës, zure për jetë popuj²³ qartësisht dhe shpërbëre maninë e tiranëve ateistë, duke u veshur me energjinë nga lart.²⁴

Meqenëse preferove qartazi shijimin e qiejve më shumë se të tokës, duroje me qëndrueshmëri dhimbje torturash, duke u forcuar nga Kryqi, o Kristofor i urtë.

Hyjlindësore

Isaia të sheh, o Zot, të ulur mbi re të kulluar, te nëna e tërëhimnuar, dhe të vithisësh fuqishëm statujat e drunjta të egjiptianëve.²⁵

*Ode VI**I profetit: Evóise protipón*

Përmes Shpirtit* u formua, prandaj Isaia pa* të shkëlqente* mbi një fron zotërimi i lavdit pra,* që po përhimnohej* nga një zë trishenjtor,¹ meqë ish Trini.

Me tmerr ia sjell* gojës sate thëngjillin një Serafim,* si e mori* me një mashë, kështu mistikisht të bën* një profet të shenjtë* Perëndie Zot, o Isaia, ty.¹

Meqë shikon* qartë realizimin e thënieve* që kish thënë,* mendërisht Isaia me engjëjt tok* ka gaz; me kër-

cime* e lëvdon Zotin që profeci përmbush.

I martirit Ingjashëm

Imposhti krejt* gjith' pushtetet, demonët, martiri trim,* pasi bëri* mundje, jo kundër gjaku a mishi ky,*²⁶ sepse përforcohej* me fuqi të padukshme prej Birit Zot.

Oathlofor,* hijesisht deshe majën që dëshirojm',* ndaj nuk ndieje* dhimbje, ndërsa po rripeshe, se gjithnjë* e mbështetje mendjen* te Jisui yt Zot, ndihmës plot fuqi.

Hyjlindësore

Të Virgjërën Vajz',* duke parë të zërë në bark me mish* dhe të lindë* trupërisht Fjalën, Birin e Perëndis',* ka hare, gëzohet* Isaia³ tani, i lëvduari.

Irmosi: Evóise protipón

»**V**arrimin tënd* të triditshëm e para-
»skiconte qart'* duke thirrur,* kur në
»një peshk të madh lutej, o Jisu,* shën
»Jona profeti:²⁷ * Mbret i forcave,²⁸
»prej prishjes më çliro.²⁹

*Kontaqi**Ting. II Tin en presvies akímiton*

Pasi e more karizmën e profecisë,* profet martir, hyjpredikues Isaia,*¹ në

tërë botën, te gjithë njerëzit* me zë të madh ke shpallur ti mishërimin zotëror:* Ja ku Virgjëresha do të jet' shtatzën'.³

Shtëpia

Meqenëse jam i tëri i vdekur dhe kam buzë të papastra,¹ o Krisht, si do të të sjell himn të vyer? Mirëpo, duke ditur dhembshurinë tënde, se shpëton ata që me besë të vijnë afër, ofroj fjalë prej buzësh të ndotura, sikurse dikur ofroi edhe ajo vejushë dy të hollat,³⁰ dhe bie në gjunjë, duke të thirrur: Ndriçoje mendjen time, o Zot, që të them së bashku me profetin tënd: Ja ku Virgjëresha do të jet' shtatzën'.³

Sinaksari

Më 9 të të njëjtit muaj, kujtimi i profetit të shenjtë dhe të lavdëruar Isaia.

Vargje: Ai që pa Bir nëne pa farë,¹/ si u sharrua, pa Bir Ati pa fillim.

Dhe Isaia, shikuesi³¹ i të ardhshmeve, u sharrua me dorë në të nëntën.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të shenjtë Kristofori.

Vargje: Unë Kristofori, të pashë ty Kristoforin,/ të flijuar për Krishtin Perëndi, përmes shpatës.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirëve të shenjtë Epimahu dhe Gordhiani.

Në të njëjtën ditë, martiret e shenjta Kalinika dhe Akilina, të cilat falë shën Kristoforit besuan te Krishti, mbarojnë si u depërtuan në hell nga këmbët deri te supet.

Vargje: Satani ka përsëri një gosti të re:/ Mashtuesit kalojnë në hell dy gra.

Martiri i shenjtë oshënar Nikolla i Ri në Vunen, mbaron me shpatë.

Vargje: O Nikolla, more kurorë të dyfishtë,/ si oshënar dhe atlet i Zotit.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII

I profetit: Avramiei poté

Duke parë Isaia se do të na vinte çlirimi i Shpëtimtarit,²² thirri: Do vijë Perëndia i bekuar i etërve tanë.³²

Isaia u vesh dhe me hir profecie, dhe me kurorë martirizimi, duke thirrur: Fuqia dhe himnimi im është Perëndia³³ i bekuar i etërve.³²

O profet i mahnitshëm, vure norma shpresëtarie dhe ligje sjelljeje, me anën e gjuhës hyjmbajtëse, duke thirrur: O Perëndi i etërve, je i bekuar.³²

I martirit Ingjashëm

Kristofori, duke vrapuar me durim në udhën e dëshmisë, vjen përqark në

tenda qiellore, duke thirrur: O Perëndi i etërve, je i bekuar.³²

Kristofori shoi flakën e pabesisë nëpërmjet vesës³⁴ së shpresëtarisë dhe thërriste me himne: O Perëndi i etërve tanë, je i bekuar.³²

Hyjlindësore

O Isaia, duke parë lindjen mbi natyrë të virgjërisë dhe shkëlqimin e dëlirësisë,³ thirr: O Perëndi i etërve tanë, je i bekuar.³²

Ode VIII

I profetit: I en Vaviloni Pedhes

Tani ngazëllohet me hare Isaia i lavdëruar, i veshur me këmishën e gëzimit porsi dhëndër³⁵ dhe, duke shijuar dëfrim të hyjnueshëm, thotë së bashku me engjëjt: Bekojeni, ju veprat e Zotit, Zotin.³⁶

Ata që u ndanë më parë nga Perëndia, duke u mashtruar prej fjalëve të demonëve, me të drejtë dëbohen nga toka e shenjtë, të mjerët, sipas zërave të profetit, dhe tani nuk mundën të psalin: Bekojeni, ju veprat e Zotit, Zotin.³⁶

Pasi lanë mashtrimin, turmat e kombeve rendën drejt dritës së hyjshme³⁷ dhe u përshtatën me trashëgiminë e Krishtit, siç thoshte qëmoti

Isaia, dhe tani duke himnuar këndojnë: Bekojeni, ju veprat e Zotit, Zotin.³⁶

I martirit Ingjashëm

Dallga e manisë idhujtare, duke u përplasur me arrogancë, u thye falë rezistencave të forta kundërshtuese të martirëve, që preferuan rreziqe për Krishtin dhe i këndojnë: Bekojeni, ju veprat e Zotit, Zotin.³⁶

Meqë u veshe bukur tani me mantel mbretëror, që u ngjyros prej gjakrave të tua, o martir Kristofor i pamposhtur, kërcen tok me kore engjëjsh dhe këndon me ta për Ndërtuesin tënd: Bekojeni, ju veprat e Zotit, Zotin.³⁶

Hyjlindësore

Vajza nënë-virgjëreshë, përqafon si foshnjë Fjalën që u jep të gjithëve jetën³⁸ dhe i bëri të gjitha,³⁹ siç tha më parë Isaia, i cili thërriste i ngazëlluar: Bekojeni, ju veprat e Zotit, Zotin.³⁶

Irmosi: I en Vaviloni pedhes

»**T**re Djemtë në Babilonë,* me një »zell qiellor të përdjegur* tiranin s'e »përfillën aspak.*⁴⁰ E shkelën zjarrin »burrërisht* edhe të vesuar prej q'ell- »it* të këndonin⁴¹ me zë të madh:* »Zotin, ju të gjitha krijesat e Zotit, bek- »kojeni.^{36*}

*Ode IX**I profetit: Eva men to tis parakoís*

Rri me gaz pran' podiumit të Sunduesit* të Fuqive⁶ edhe po dëfren,* o i hyjzënë, me lavdinë* që ka, dhe pasurohesh përmes frytit* të besës që kishe, o i kënduar fort;* i lum, të lumërojmë gjithë ne.

Ju që doni që tani të nxirrni një dhunti* profetike dhe ndriçuese,* le t'i afrohemi me mall mjaft* të fortë, librit të Isais' profet,* sepse ky u zhyt përbrenda hyjdijes thell';* dhe do të mbushemi me lavd hyjnor.

Meqë Isaia i hyjmbajtur po shkëlqen* qartësisht prej Shpirtit që ndriçon,* i feks të gjithë që kremtojnë* kujtimin tënd të hyjshëm, me plot nderim,* sepse ndërmjeton të gjejnë shpëtim dhe hir* me hijeshinë ngazëlluese.

I martirit Ingjashëm

Pasi more ti kurorë të shkëlqyeshme* si një fitimtar, o Kristofor* fort i kënduar, mbretëron pra* me Zotin⁴² që të dha në tortura forc',* të dha dorë jetëprurëse posht' të vësh* djallin, që nga fillimi ish i keq.¹³

Kur u lave hijesisht me gjak martiri ti,* i përmbilavdishëm, fekse nur,* ndërsa tani me vrap u fute,* martir,

në nusërore të virgjërish* me nder, tok me Dhëndrin;⁴³ paqe për kozmosin* edhe shpëtim kërkoji pa pushim.

Hyjlindësore

O Hyjnënë dhe Hyjnuse, në pëqi e mban* ti thëngjillin krejt mendor, që pa*¹ me trajtën tonë të bashkohej,* profeti Isaia, pra Krishtin Zot,* që botës shpëtim i dhuron, që të gjithë pra* së bashku ne të madhërojmë ty.

Irmosi: Eva men to tis parakoís

»**E**va nga sëmundja e mosbindjes¹⁶
 »mori keq* si banues brenda saj mall-
 »kim,*⁴⁴ por, o Hyjlindëse e virgjër,*
 »ti, nëpërmjet lastarit të shtatzënis,*
 »për botën e lulëzove bekimin krejt;*
 »ndaj gjithë ne të madhështojmë ty.

*Dërgimësorja dhe Pasvargjet e së kremen-
 tes dhe të tjera si zakonisht.*

*CITIME*¹ Is. 6.1-9² Is. 49.6³ Is. 7.14⁴ Matth. 10.1; Mark. 6.7; Lluk. 10.19⁵ II Tim. 2.3⁶ III [I] Mbret. 17.1; 18.15;

IV [II] Mbret. 3.14; 5.16

⁷ Tobit 13.11⁸ Is. 11.1⁹ Is. 28.16

- ¹⁰ I Mbret. [Sam.] 2.4
¹¹ I Mbret. [Sam.] 2.1
¹² Is. 5.8 etj.
¹³ Apok. 12.9
¹⁴ Is. 41.1; 45.16
¹⁵ Rom. 16.4
¹⁶ Gjen. 3.1-6
¹⁷ Is. 8.3
¹⁸ Is. 66.7
¹⁹ Is. 9.6
²⁰ Kol. 1.26
²¹ Is. 25.1
²² Is. 35.4
²³ Lluk. 5.10
²⁴ Lluk. 24.49
²⁵ Is. 19.1
²⁶ Ef. 6.12
²⁷ Matth. 12.40
- ²⁸ Ps. 67(68).13
²⁹ Jona 2.7
³⁰ Mark. 12.42; Lluk. 21.2
³¹ II Mbret. [Sam.] 24.11; I Kron. 21.9;
Amos 7.12
³² Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2
³³ Ps. 117(118).14
³⁴ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 25-26
³⁵ Is. 61.10
³⁶ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
Is. 51.4; 60.2
³⁸ Is. 57.15; Joan 6.33; Vep. 17.25
³⁹ Joan 1.3
⁴⁰ Dan. 3.17-18
⁴¹ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 26-27
⁴² II Tim. 2.12
⁴³ Matth. 25.10
⁴⁴ Gjen. 3.16-19



MË 15 TË TË NJËTIT MUAJ

Kujtimi i atit tonë oshënar
Pahomi i Madh.

NË MBRËMËSORE

*Thirrtoret: 3 të së kremtes dhe 3 të
oshënarit:*

Ting. Tërth. II Olin apothëmeni

Tërë përmallimin tënd* e lartësove drejt Zotit,* si le çdo kënaqësi* të mbidheshme, që vjen e shkon,¹ i urtë krejt,* o Pahom; veten pra* ia besove Krishtit tënd* dhe pastroheshe me çdo mjet asketizmi, shfaqeshe* pra që rezistojë me plot durim* në djegiet e pasioneve,* edhe ke kaluar martirizim* të ndërgjegjes thellë, hyjmendës, more porsi fitimtar* çmim dhe kurorë që s'vyshket kurr',*² ty të lavdërojmë ne.

Pasi e largove tej* mbulesën, peshën e trashë* që ka trupi, nëpërmjet* teoris' praktike dhe mposhte epsh mishor,* me Hyjni, oshënar* atë, u bashkove* prej andej me vezullim, shkëlqime, hir hyjbërës ti* shndritje, feksje³ dhe hyjnizoheshe* si deshe vetë, ngriheshe* lart drejt më së mirës; kështu tani,* meqë, o hyjmendës, i lumur je në Krishtin, me guxim* fort

përgjëroju për shpirtrat tan',* që të mëshirohemi.

O Pahom i pasur fort,* kur mbi çdo ndjenjë u ngrite,* o i lum, me Zotin ti* kishe shoqëri, kur nga mishi dole jasht';* me mendim më të lart',* i frenove veset,*⁴ dhe tërbimet e demonëve, o i nderuar krejt,* i dërrmove edhe i shkele posht';* në tendat qiellore ti* po qëndron tani, prej andej kujto* gjithë sa nderojnë kujtimin tënd, o atë oshënar,* se ke guxim para Krishtit tënd,* që të mëshirohemi.

Lavdi *Ting. IV*

O atë, shkretëtira të lulëzoi si zambak⁵ që, nga praktikimi i virtyteve, lëshon erë të mirë për të gjithë, dhe që është i hijshëm për shkak të urtësisë që vjen nga teoria, sepse të djalhta i kishe të dyja⁶ duart e tua; dhe meqenëse pate sukses në të përsosurën, pasi fitove votën më të mirë për hir të fjalës dhe jetës sate, nga punët dhe besimi, u bërë i pëlqyer te Krishti Perëndi;⁷ përgjëroju atij, o Pahom i hyjzënë, që dhe ne të jemi të pëlqyer prej tij, dhe bashkë me ty të arrijmë trashëgimin suprem.

Tani *I së kremtes*

Pasvargjet e së kremtes

Lavdi *Ting. Tërth. IV*

Turmat e murgjve të nderojnë ty, profesorin, o Efthim, ati ynë, sepse nëpërmjet teje ne mësuam të ecim në udhë vërtet të drejtë;⁸ i lum je, se i shërbeve Krishtit,⁹ dhe triumfove mbi fuqinë e armikut,¹⁰ o shok engjëjsh, që banon në të njëjtën tendë me oshënarë dhe të drejtë; tok me ta ndërmjeto te Zoti, që të mëshirohen shpirtrat tanë.

Tani *I së kremtes*

Përlëshore e oshënarit

Ting. Tërth. I Ton sinánnarhon Logon

Utregove barí i kryebariut Krisht;^{*11} dhe tufë murgjish drejt mandrës në qiell, atë Pahom,^{*} ke drejtuar; prej andej mësove mistikisht^{*} skimën e duhur për asket^{*} dhe pastaj, o shenjt, këtë atyre ua mësove;^{*} ngazëllon dhe tani në qiell dhe tok me ta kërcen në tendat lart.

Dhe e së kremtes



NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së zakonshme,
Ndenjësoret e së kremtes*

*Kanunet: i së kremtes dhe i oshënarit,
i cili ka Akrostihidhë:*

“I thur siç duhet himnimin Pahomit”.

Poezi e Theofanit

Ting. II

Ode I

En vithó katéstrose poté

Meqë kam besim në mirësin’^{*} pra të sjelljes sate, gati unë jam,^{*} siç ia vlen psal himnimin tënd;^{*} mendjen time, o Pahom i shkëlqyer, i mrekullueshëm, rrezato^{*} përmes përgjërimit tënd me llamburitjet dritëdhënëse.

Ipushtuar, at’, prej dashuris’^{*} fort të nxehtë, zjarr, për papasionshmëri,^{*} vyshke shkaqet e veseve^{*} që ka materia, ndaj zotërove tër’ dritësimin autentik^{*} të Hyjnisë, se prej dashurisë more krah’, i lumur krejt.

Mbushe batalionin qiellor^{*} me një gaz të madh, kur njohe Bërësin^{*} e Krijesës së tërë¹² ti;^{*} se kur vigjiloje si një rojtar, e mësove forcën që s’shprehet dot^{*} që ky ka, dhe njohe dogmën e besimit, o hyjprurës shenjt.

Hyjlindësore

Edëllirë, na u shfaqe ti^{*} më e lart’ se çdo krijim që duket dhe^{*} që nuk duket, meqenëse^{*} linde Krijimtarin e mishëruar në mitrën tënde vullnetarisht;^{*} ndërmjeto përkrah tij me guxim, të na shpëtohen shpirtrat tan’.

Ode III
Eksínthisen i érimos

Drejt ujit rende, oshënar,* si dre,¹³ pagëzimi fort i shenjtë të spërkati ty* dhe kështu u vesove përmes tij,* pa masë zemra jote mori ëmbëlsi.

S'duronin dot, o oshënar,* batalionet dashakeqe kur të shihnin me fuqi* të ushtroheshe në asketizim,* të ngrinin rrjetë ngasjesh, o hyjprurës shenjt.

Fitove shenjtërim në jet',* o Pahom, u bëre pra ligjvënës i asketëve,* kryetar që ia sillje Krishtit Zot,* o atë i kënduar shumë, o zëmadv.

Hyjlindësore

Ushtangën, e dëlirë krejt,* batalionet e patrup, dhe zemrat e gjith' njerëzve* u tmerruan në lindjen tënde, pra* me besë të nderojmë si Hyjlindëse.

Irmosi: Eksínthisen i érimos

»**U** lulëzua si zambak* shkretëtira,⁵
»Kisha e gjith' kombeve që shterpë
»ish,* me pranin' tënde, Perëndia
»im;* në të u sigurua zemra ime fort.¹⁴

Ndenjësore

Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon

Si vadite me lotët e tu si shi* shpirtin tënd pasurisht, korre me bollëk* kallirin e frytshëm krejt* të virtyteve, atë

shenjt* i urtë, dhe u bëre barí, ndaj ushqeje mir'* në gjelbërim¹⁵ ushtrimi mjaft tufa asketësh ti* dhe, si u largove me lavdi, nder nga jeta,* me korret e etërve* u radhite, Pahom, kështu* të thërrasim* të gjithë ne: Ndërmjeto te Zoti yt Krisht,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tënd fort të shenjt' me mall.

Dhe e së kremtes

Ode IV

Elilithas ek Parthenu

Sa guvernator i mirë¹⁶ i sistemit monakal u bëre, o Pahom! Sepse, nëpërmjet vizionit, more orakull për të ngritur shkolla virtyti, o atë i tërurtë.

Kur pranove lavdinë e Shpirtit të Shenjtë, u bëre yll tepër i ndritshëm, duke shkëlqyer me anën e Hirit për të gjithë sa udhëhoqe në limane shpëtimi, përmes mësimdhënieve të tua.

Jeta jote, o Pahom hyjmbajtës i tërë-lumur, u bë kanuni tepër i saktë i monakëve; sipas tij sillen tani ata që shkojnë pas dogmave të tua të hyjnueshme, o atë.

Duke u plagosur nga malli i Zotit, shove absolutisht përmes vetëpërmbytjes majmërinë e mishit, o Pahom; dhe jetën tënde të plotë e dedikove si flijim tejet erëkëndshëm.¹⁷

Hyllindësore

Të gjithë shpresëtarët të njohin ty, o Zonjë Perëndilindëse, si liman shpëtimi dhe mur të palëkundur, sepse me ndërmjetimet e tua ti çliron nga rreziqet shpirtrat tanë.

*Ode V
Mesitis Theú*

Falë dashurisë së Perëndisë, komunikove me mësimdhëniet e Shpirtit dhe, i ndriçuar prej tyre, pushtove majën e virtutit, pasi e shkarkove nga pasionet gjendjen e shpirtit.

O Zot, të sjellim si përgjërues asketin tënd, duke kërkuar përmes tij të shkëlqejmë prej ndriçimit të Hirit dhe të ruhemi përherë me anën e armatimit tënd.

Meqenëse e forcove mendjen tënde me ruajtjen e porosive, o Pahom, hovin e mishit e vyshke me vetëpërmbajtjen tënde, dhe u dallove barí rreshtimi të hydashur.

Hyllindësore

Përgjëroju Birit tënd dhe Zotit, o Virgjëreshë e kulluar, që t'u dhurojë çlirim paqësor të robëruarve¹⁸ nga peripécia kundërshtare, sepse te ti kanë besim.

*Ode VI**En aviso ptesmaton*

Sheke tërë intrigat e frymëve* prishëse, se ishe veshur me fuqi nga lart,* nga Zoti, dhe rrethoheshe* si me mur pra, prej Kryqit të çmuar, at'.

Mençurisht preferove sa mbeten krejt,* jo ato që shkojnë, dhe durove çdo mundim* të asketizmit, oshënar,* kujdestar pra për shpirtra u bëre ti.

Si u bëre i varfër në shpirt,¹⁹ o at',* pasuri që s'shprehet, pra shijim në qiej lart* ke grumbulluar; ky nuk vdes,* as pasohet, s'kalon kurrë, por qëndron.

Hyllindësore

Oe Virgjër, pa burrë ngjize në bark,* dhe përjetësisht e virgjër mbete dhe tregon* vërtet simbolet e Hyjnis'* së fëmijës edhe Perëndisë tënd.

Irmosi: En aviso ptesmaton

»**N**jë avushë mëkatesh po më rrethton,* ndaj thërras un' mirësinë tënde që s'ka fund,* e cila s'gjurmësohet dot;* lutem, nxirrme nga prishja, »o Zoti im.²⁰

*Kontaqi**Ting. II Ta ano zitón*

Ndriçues i madh* u shfaqe anembanë²¹ ti,* e bëre qytet* me turma shkretëtirën pra;* kryqëzove veten,²² si ngri-te kryqin tënd²³ mbi sup, trete drejt* trupin tënd me asketizim;* edhe pa ndërprerje ndërmjeton për të gjith'.

Sinaksari

Më 15 të të njëjtit muaj, kujtimi i atit tonë oshënar Pahomi i Madh.

Vargje: Pahomi, duke holluar majmërinë e mishit,/ grumbullonte për shpirtin dhjam para zhvendosjes.

Më pesëmbëdhjetë e ngritën prej këtij Pahomin.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar, Akili, mitropolit i Larisë.

Vargje: Flet Larisa për arritjet e tua të huaja, o atë,/ duke mbajtur kujtimin tënd, ndonëse vdiqe.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Barbar Mirovliti.

Vargje: Nxjerrja e miros nga varri yt, o atë,/ të tregon jo barbar, por fisnik.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII

Antítheon próstagma

Meqenëse veshe fuqinë e Zotit, shkele si dhé kënaqësinë e pshore të jetës, duke u goditur nga mallëngjimi

i jetës pa cen; në të tani more pjesë, duke ndenjur bashkë me kore engjëjsh, o atë.

Kur fitove zemër tepër të pastër,²⁴ u denjësove të vëzhgosh²⁵ të padukshmin nga të gjithë;²⁶ si rrjedhojë, u bëre sipas premtimit²⁴ i lumur, o atë, duke himnuar mirëbërësin e përmblavdëruar.

Duke pasur mendje orthodhokse, shpalle Njësi të trinumëruar, Trini të bashkëqenshme; dhe na mësove mishërimin e frikshëm të Fjalës, duke himnuar të Gjithmonëvirgjrën si Perëndilindëse.

Hyjlindësore

Të kuptojmë si të shenjtën e të shenjtëve, sepse vetëm ti mbajte në bark Perëndi të pandryshueshëm, o Virgjëreshë e panjollshme, nënë e panusëruar; sepse na burove paprishjen të gjithëve ne besëmirëve, me lindjen tënde hyjnore.

Ode VIII

Káminos poté

Sipas urdhrit hyjnor prej engjëllit mësove mistikisht normat e urta të asketëve, o i urtë; me to tani nginjemi ne të ushqyerit me shpresëtari dhe thërresim: Bekojeni Zotin, gjithë ju vepra.²⁷

Mënyra e asketizimit tënd, o i tërur-të, duke shkëlqyer si rrufe me shndritje më madhështore, lindi për të gjithë ne²⁸ që thërrasim besërisht për hirin e Ndërtuesit: Bekojeni Zotin, gjithë ju vepra.²⁷

O Krisht, ti që linde para jetëve përmbi mendje nga Ati i palindur, duke të besuar Pahomi i lavdishëm, të predikoi ashtu si dhe Shpirtin e Tërëshenjtë, duke ditur një natyrë dhe Hyjni të Triadhës.

Hyjlindësore

Ne besnikët të quajmë, o Hyjnënë e virgjër, portë drite,²⁹ sepse linde përmbinatyrshëm reflektimin e Atit,³⁰ i cili u bashkua me majmërinë e mishit, o e tërëdëlirë; atë e himnojmë si Zot të gjithë veprat.²⁷

Irmosi: Káminos poté pirós

»**D**ikur një furrë në Babilonë i ndante »energjitë me urdhër hyjnor, duke »shkrumbuar kaldenjtë, ndërsa i ve- »sonte besimtarët³¹ që psalnin: Be- »kojeni Zotin, gjithë ju vepra.²⁷

Ode IX

Anarhu jenítoros

Pasi me llambadhe Hiri, o Pahom, shkëlqeve nur,* pranë Zotit qëndron³²

si shërbyesi besnik* dhe shijon lavdinë hyjnore që s'prishet dot* lart në qiej, ndaj festën tënde me plot nderim,* me gëzim e madhështojmë ne.

Nga dora e djathtë jetëprurëse dhe me fuqi* për ty, si fitimtar, një kuro-rë,³³ o Pahom,* është thurur; sa e himnojnë kujtimin tënd* me lavdi tani denjësoji të gjejnë ndjes'* për mëkatet, i kënduar fort.

Tani që korr frytet e mundimeve të tua ti,* o Pahom, po shijon ngazëllim përmbi mendim;* duke ndërmjetuar, lyp Krishtin që të shpëtojn'* nxënësit e tu, që tani të lëvdojnë ty,* o i admirueshmi shën oshënar.

Hyjlindësore

Oe tërëpaqortueshme, kur prite, si shtëllung',* shiun mbiqielloor³⁴ brenda barkut tënd pa cen,* na e linde; se ambrozinë ai dhuron* te sa e himnojnë me besë dhe shpallin fort* se Hyjlindëse pa njollë je.

Irmosi: Anarhu jenítoros

»**B**ir Prindi pa nisje, Perëndi dhe Zot »te ne u shfaq* me lavdi nga e Virgjra, »që të ndriçojë sot* gjith' të errësu- »arat³⁵ edhe të mbledh' në një* të »shpërndarat;³⁶ ndaj madhështojmë »Hyjlindësen* e himnuar fort edhe me »nam.

Dërgimësore
O uranón tis astris

Kur jetën engjëllorë* e dëshirove, o
Pahom,* në shkreti largove veten,*³⁷
mposhte pasionin mishëror;*³⁸ i bara-
bartë u shfaqe* me engjëjt ti, o hyj-
mbajtës.

Dhe e së kremtes.
Pasvargjet e së kremtes dhe të tjera si
zakonisht.

CITIME

¹ I Kor. 7.31; I Joan 2.17

² I Petr. 5.4

³ Eks. 34.29-35; II Kor. 3.13

⁴ IV Makk. 1.3-30; 2.24; 3.1; 6.31; 16.1

⁵ Is. 35.1

⁶ Gjyq. 3.15; 20.16

⁷ Gjen. 5.22,24; 6.9; 24.40; Sirak 44.16

⁸ Is. 40.3; Matth. 3.3; Mark. 1.3; Lluk. 3.4

⁹ Rom. 6.18-19; 14.18

¹⁰ Kol. 2.15

¹¹ I Petr. 5.4

¹² Joan 1.3; Kol. 1.16

¹³ Ps. 41(42).2

¹⁴ I Mbret. [Sam.] 2.1

¹⁵ Ps. 22(23).2

¹⁶ IV Makk. 7.1

¹⁷ Eks. 29.18; Ef. 5.2 etj.

¹⁸ Is. 61.1

¹⁹ Matth. 5.3; Lluk. 6.20

²⁰ Jona 2.7

²¹ Fil. 2.15

²² Gal. 5.24

²³ Matth. 10.38; 16.24; Mark. 8.34; 10.21;
Lluk. 9.23

²⁴ Ps. 50(51).12; Matth. 5.8

²⁵ Is. 6.5

²⁶ Eks. 33.20; Joan 1.18

²⁷ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34

²⁸ Ps. 76(77).19; 96(97).4; Matth. 24.27;
Lluk. 17.24

²⁹ Jez. 44.2-4

³⁰ Hebr. 1.3

³¹ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 23-24

³² III [I] Mbret. 17.1; 18.15;
IV [II] Mbret. 3.14; 5.16

³³ Urt. Sol. 5.16; Is. 62.3

³⁴ Gjyq. 6.37-38; Ps. 71(72).6

³⁵ Is. 9.2; 42.16; Matth. 4.16; Lluk. 1.79

³⁶ Is. 11.12

³⁷ Ps. 54(55).8

³⁸ IV Makk. 7.18,22



MË 21 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i mbretërve të mëdhenj, të shenjtë, të lavdëruar, të hyjkurorëzuar dhe të barabartë me apostujt Konstandini dhe Elena.

Tipikon

1. Nëse bie të shtunën (d.m.th. në Mbylljen) e Thomait:

Të premten në Mbrëmësore, Thirrtoret: 4 të Thomait dhe 3 të shenjtorëve në 4. Lavdi i shenjtorëve. Tani i Thomait. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e shenjtorëve. Pasvargjet e Thomait. Lavdi i shenjtorëve. Tani i Thomait. Përlëshoret: e Thomait, e shenjtorëve dhe përsëri e Thomait.

Të shtunën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmi 50, Litia e shenjtorëve, por Tani i Litisë së Thomait. Trishenjtë. Përlëshorja e Thomait. Në Mëngjesore, Ndenjësoret e shenjtorëve dhe, në vend të Hyjlindësoreve, Ndenjësoret e Thomait. Shkallësat. Antifoni i parë i Ting. IV, Proqimeni dhe Ungjilli i shenjtorëve. Ne që pamë ngjalljen. Psalmi 50 (hima) etj. të shenjtorëve. Kanunet: i Thomait dhe i shenjtorëve. Pas Odes III, Kontaqi i Thomait, Ndenjësoret: e shenjtorëve dhe një e Thomait. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtorëve dhe Sinaksari. Zbritësoret e Pashkës. Në vend të Më të nderuarën, Ode IX e Kanuneve. Dërgimësoret: e para e Thomait, e shenjtorëve dhe e dyta e Thomait. Lavdërimet: 2 të Pentikostarit (ngjallësore), 3 të Thomait dhe 3 të shenjtorëve. Lavdi i shenjtorëve. Tani i Thomait. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e Thomait.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e Thomait, e shenjtorëve dhe e kishës. Kontaqi i Thomait. Apostulli dhe Ungjilli i shenjtorëve. Në vend të Të meriton, Irmosi i Odes IX i Thomait (Ti llambadhen e shkëlqyer). Kungatorja e Thomait [dhe Në gjithë dheun]. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.

2. Nëse bie të Dielën e Miropurësoreve ose të të Paralizuarit, ose të Samaritanes, ose të të Verbrit:

Të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 3 ngjallësore, 3 të së kremtes dhe 4 të shenjtorëve. Lavdi i shenjtorëve. Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e shenjtorëve. Pasvargjet: ngjallësore e para dhe të Pashkës (Le të ngrihet Perëndia; Pashka hierore etj.).

[Nëse kisha mban emrin e shenjtoreve: ngjallësorja e parë dhe Pasvargjet e shenjtoreve]. Lavdi i shenjtoreve. Tani i së kremtes. Përlëshoret: a) të Dielën e Miropurëseve: Kur zbrite te vdekja; Bujari Josif. Lavdi i shenjtoreve, Tani Grave miropurëse; b) të Dielën e të Paralizuarit: ngjallësore (Le të dëfrejnë qielloret), Lavdi i shenjtoreve, Tani Hyjlindësore ngjallësore (Ti që linde për ne prej Virgjëreshës); c) të Dielën e Samaritanes: ngjallësore (Lëçitjen gazmore), Lavdi i shenjtoreve, Tani Përlëshorja e Mespentikostisë; d) të Dielën e të Verbrit: ngjallësore (Fjalën e panisëshme), Lavdi i shenjtoreve, Tani Hyjlindësore ngjallësore (Ti që linde për ne prej Virgjëreshës).

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmi 50, Kanuni Triadik, Litia: a) të Dielën e Miropurëseve, Litia e tyre dhe e shenjtoreve. Lavdi i shenjtoreve. Tani [Lavdi] i Miropurëseve; b) të Dielat e tjera, Litia e shenjtoreve. Tani [Lavdi] i së kremtes. Himne Triadike. Trishenji. Përlëshorja: a) të Dielën e Miropurëseve, Kur zbrite te vdekja; b) të Dielat e tjera, e shenjtoreve. Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë, Ndenjësorja e parë e Stihologjisë së parë të së kremtes. Lavdi Ndenjësorja e parë e shenjtoreve. Tani Hyjlindësorja e Stihologjisë së parë të së kremtes. Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësorja e parë e Stihologjisë së dytë të së kremtes. Lavdi Ndenjësorja e dytë e shenjtoreve. Tani Ndenjësorja e dytë e Stihologjisë së dytë të së kremtes. Pas Polieleit, Ndenjësorja e shenjtoreve dhe Ndenjësorja e tretë e Stihologjisë së dytë të së kremtes. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimeni i Tingullit. Kanunet: i Pashkës [të Pentikostarit] dhe i shenjtoreve. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtoreve dhe Ndenjësoret: e shenjtoreve dhe e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e së kremtes. Sinaksari i ditës dhe i së kremtes. Zbritësoret e Pashkës, por të Dielën e të Verbrit, Zbritësoret e Analipsit (Shpëtimtar Perëndi); dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Në vend të Më të nderuarën, Ode IX e Kanuneve. Dërgimësoret: e Pashkës, e shenjtoreve dhe e së kremtes. Lavdërimet: 3 ngjallësore, 3 të shenjtoreve dhe të Pashkës (Le të ngrihet Perëndia; Pashka hierore etj.). Lavdi i shenjtoreve. Tani i së kremtes, por të Dielën e Miropurëseve, Dit' e Ngjalljes. Dhoksologjia e Madhe. Sot erdhi.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore (të Dielën e Miropurëseve edhe: Bujari Josif; Grave miropurëse; ndërsa të Dielën e Samaritanes, edhe Përlëshorja e Mespentikostisë), të shenjtoreve dhe e kishës. Kontaqi i Pashkës. Apostulli i shenjtoreve. Ungjilli i së kremtes. Në

vend të Të meriton, Zbritësorja e Odes IX e Pashkës (ose e së kremtes, siç përcakton Pentikostari). Kungatore e Pashkës [dhe Në gjithë dheun]. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.

3. Nëse bie në javën pas së Dielës së Miropurësive ose të të Paralizuarit, ose të Samaritanes ose të të Verbrit (përveç Mbylljeve të tyre):

Në Mbrëmësore, Thirrtoret e shenjtoreve në 6. Lavdi i shenjtoreve. Tani [Lavdi] i së kremtes. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e shenjtoreve. Pasvargjet e shenjtoreve. Lavdi i shenjtoreve. Tani [Lavdi] i së kremtes. Përlëshoret: në javën e Miropurësive: Bujari Josif; Kur zbritte te vdekja. Lavdi i shenjtoreve, Tani Grave miropurëse; në javët e tjera: e së kremtes. Lavdi i shenjtoreve. Tani Hyjlindësore ngjallësore (Ti që linde për ne prej Virgjëreshës). Të hënën pas të Verbrit: ngjallësore (Fjalën e panisësme). Lavdi i shenjtoreve. Tani Hyjlindësore ngjallësore (Ti që linde për ne prej Virgjëreshës).

Në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Litia e shenjtoreve. Tani [Lavdi] i së kremtes. Trishenjtë. Përlëshorja e shenjtoreve. Në Mëngjesore, Ndenjësoret e shenjtoreve dhe, në vend të Hyjlindësoreve, Ndenjësoret e së kremtes. Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV. Proqimeni dhe Ungjilli i shenjtoreve. Ne që pamë ngjalljen. Psalmi 50 (hima) etj. të shenjtoreve. Kanunet: (i së kremtes ose) i Pashkës dhe i shenjtoreve. Pas Odes III, Ndenjësoret: e shenjtoreve dhe e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtoreve dhe Sinaksari. Zbritësoret e Pashkës. (Të hënën e të Verbrit: Shpëtimtar Perëndi). Më të nderuarën. Dërgimësoret: e shenjtoreve dhe e së kremtes. Lavdërimet e shenjtoreve. Tani [Lavdi] i së kremtes. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e shenjtoreve.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e së kremtes, e shenjtoreve dhe e kishës. Kontaqi i Pashkës. Apostulli dhe Ungjilli i shenjtoreve. Të meriton. Kungatore: Në gjithë dheun. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.

4. Nëse bie të shtunën (d.m.th. në Mbylljen) e Miropurësive ose të Samaritanes:

Në Mbrëmësore, Thirrtoret: 3 të së kremtes dhe 3 të shenjtoreve. Lavdi i shenjtoreve. Tani [Lavdi] i së kremtes. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e shenjtoreve. Pasvargjet: ngjallësorja e parë dhe të shenjtoreve. Lavdi i shenjtoreve. Tani [Lavdi] i së kremtes. Përlëshoret: në Mbylljen e Miropurësive: Bujari

Josif; Kur zbritë te vdekja. *Lavdi i shenjtoreve, Tani* Grave miropurëse; në *Mbylljen e Samaritanes: ngjallësore* (Lëçitjen gazmore). *Lavdi i shenjtoreve. Tani Hyjlindësore ngjallësore* (Ti që linde për ne prej Virgjërshës).

Në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmi 50, Litia e shenjtoreve. Tani [Lavdi] i së kremtes. Trishenjtë. Përlëshorja: në Mbylljen e Miropurësive: Bujari Josif; në Mbylljen e të Paralizuarit, Përlëshorja e shenjtoreve. Në Mëngjesore, Ndenjësoret e shenjtoreve dhe, në vend të Hyjlindësoreve, të së kremtes. Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV. Proqimeni dhe Ungjilli i shenjtoreve. Ne që pamë ngjalljen. Psalmi 50 (hima) etj. të shenjtoreve. Kanunet: i së kremtes dhe i shenjtoreve. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e së kremtes. Ndenjësoret: e shenjtoreve dhe e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtoreve dhe Sinaksari. Zbritësoret e Pashkës. Më të nderuarën. Dërgimësoret: e shenjtoreve dhe e së kremtes. Lavdërimet: 3 ngjallësore dhe 3 të shenjtoreve. Lavdi i shenjtoreve. Tani [Lavdi] i së kremtes. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e shenjtoreve.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: a) në Mbylljen e Miropurësive: Bujari Josif; Kur zbritë te vdekja; Grave miropurëse, e shenjtoreve dhe e kishës; b) në Mbylljen e Samaritanes: ngjallësore (Lëçitjen gazmore), e shenjtoreve dhe e kishës. Kontaqi: në Mbylljen e Miropurësive, Kontaqi i tyre; në Mbylljen e Samaritanes, Kontaqi i Pashkës. Apostulli dhe Ungjilli i shenjtoreve. Të meriton. Kungatore: Në gjithë dheun. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.

5. Nëse bie të Martën (d.m.th. në Mbylljen) e të Paralizuarit ose të të Verbrit:

Në Mbrëmësore, Thirrtoret: 3 të së kremtes dhe 3 të shenjtoreve. Lavdi i shenjtoreve. Tani [Lavdi] i së kremtes. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e shenjtoreve. Pasvargjet e shenjtoreve. Lavdi i shenjtoreve. Tani [Lavdi] i së kremtes. Përlëshoret: ngjallësore. Lavdi i shenjtoreve. Tani Hyjlindësore ngjallësore (Ti që linde për ne prej Virgjërshës).

Në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmi 50, Litia e shenjtoreve. Tani [Lavdi] i së kremtes. Trishenjtë. Përlëshorja e shenjtoreve. Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë, Ndenjësorja e parë e Stihologjisë së parë të së kremtes. Lavdi Ndenjësorja e parë e shenjtoreve. Tani Hyjlindësorja e Stihologjisë së parë të së kremtes. Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësorja e parë e Stihologjisë së dytë të së kremtes.

Lavdi Ndenjësorja e dytë e shenjtoreve. Tani Ndenjësorja e dytë e Stihologjisë së dytë të së kremtes. Pas Polieleit, Ndenjësorja e shenjtoreve dhe Ndenjësorja e tretë e Stihologjisë së dytë të së kremtes. Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV. Proqimeni dhe Ungjilli i shenjtoreve. Ne që pamë ngjalljen. Psalmi 50 (hima) etj. të shenjtoreve. Kanunet: i së kremtes dhe i shenjtoreve. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e së kremtes. Ndenjësoret: e shenjtoreve dhe një e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtoreve dhe Sinaksari. Zbritësoret: në Mbylljen e të Paralizuarit, të Pashkës; në Mbylljen e të Verbrit, Shpëtimtar Perëndi. Më të nderuarën. Dërgimësoret: e shenjtoreve dhe e së kremtes. Lavdërimet e shenjtoreve: Lavdi i shenjtoreve. Tani [Lavdi] i së kremtes. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e shenjtoreve.

Në Liturgji. Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e shenjtoreve dhe e kishës. Kontaqi i Pashkës. Apostulli dhe Ungjilli i shenjtoreve. Të meriton. Kungatore. Në gjithë dheun. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.

6. Nëse bie të mërkurën e Mespentikostisë:

Në Mbrëmësore, pas Qëndrimit të parë të Psaltirit (Lum ai njeri), Thirrtoret: 4 të së kremtes dhe 4 të shenjtoreve. Lavdi i shenjtoreve. Tani i së kremtes. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet: dy të së kremtes dhe një i shenjtoreve. Pasvargjet e së kremtes. (Ose një e së kremtes dhe të shenjtoreve, nëse kisha mban emrin e tyre). Lavdi i shenjtoreve. Tani i së kremtes. Përlëshoret: e së kremtes, e shenjtoreve dhe përsëri e së kremtes.

Në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmi 50, Litia e shenjtoreve. Tani një i së kremtes. Trishenjtë. Përlëshorja e së kremtes. Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë dhe të dytë, Ndenjësoret e shenjtoreve dhe, në vend të Hyjlindësoreve, Ndenjësoret e së kremtes. Pas Polieleit, Ndenjësoret: e shenjtoreve dhe një e së kremtes (Ndenjësorja e parë pas Odes III). Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV. Proqimeni dhe Ungjilli i shenjtoreve. Ne që pamë ngjalljen. Psalmi 50 (hima) etj. të shenjtoreve. Kanunet: të dy të së kremtes dhe e shenjtoreve. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtoreve, Ndenjësorja e shenjtoreve dhe e dyta e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e së kremtes. Sinaksari i ditës dhe i së kremtes. Zbritësoret e së kremtes (Detin e mpikse). Në vend të Më të nderuarën, Ode IX e Kanuneve. Dërgimësoret: e së kremtes, e shenjtoreve dhe përsëri e së

kremtes. Lavdërimet: 3 të së kremtes dhe 3 të shenjtorëve. Lavdi i shenjtorëve. Tani i së kremtes. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e së kremtes.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e së kremtes dhe e shenjtorëve. Kontaqi i së kremtes. Apostulli i shenjtorëve dhe Ungjilli i së kremtes. Në vend të Të meriton, Zbritësorja e Odes IX e së kremtes. Kungatore e së kremtes [dhe Në gjithë dheun]. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.

7. Nëse bie në ditët Paskremtore të Mespentikostisë
(përveç së shtunës pas së kremtes dhe të Dielës së Samaritanes):

Shërbesa kryhet sipas Mujorit së bashku me troparet Paskremtore. Në Mbrëmësore, vetëm Thirrtoret e shenjtorëve në 6. Kanunet: një i së kremtes dhe i shenjtorëve. Zbritësoret Detin e mpikse. Në Liturgji, Kontaqi i së kremtes. Kungatore: Në gjithë dheun. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.

8. Nëse bie të shtunën pas Mespentikostisë:

Në Mbrëmësore, Thirrtoret e shenjtorëve në 6. Lavdi i shenjtorëve. Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës që po kalon (Si të mos admirojmë). Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e shenjtorëve. Pasvargjet: Paskremtori i parë dhe të shenjtorëve. Lavdi i shenjtorëve. Tani i së kremtes. Përlëshoret: e së kremtes, e shenjtorëve dhe përsëri e së kremtes.

Në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmi 50, Litia e shenjtorëve, por Tani një i së kremtes. Trishenji. Përlëshorja e shenjtorëve. Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore Paskremtore (ngjallësore). Pas Stihologjisë së dytë dhe Polieleit, Ndenjësoret e shenjtorëve dhe, në vend të Hyjlindësoreve, Ndenjësoret e së kremtes. Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV. Proqimeni dhe Ungjilli i shenjtorëve. Ne që pamë ngjalljen. Psalmi 50 (hima) etj. Kanunet: i së kremtes dhe i shenjtorëve. Pas Odes III, Ndenjësoret: e shenjtorëve dhe një e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtorëve dhe Sinaksari. Zbritësoret e Pashkës. Më të nderuarën. Dërgimësoret: e shenjtorëve dhe e së kremtes. Lavdërimet: 3 Paskremtore (ngjallësore) dhe 3 të shenjtorëve. Lavdi i shenjtorëve. Tani i së kremtes. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e shenjtorëve.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e së kremtes, e shenjtorëve dhe e kishës. Kontaqi i së kremtes. Apostulli dhe Ungjilli i shenjtorëve. Kungatore: Në gjithë dheun. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.

9. Nëse bie në Mbylljen e Mespentikostisë:

Në Mbrëmësore, Thirrtoret: 4 të së kremtes dhe 4 të shenjtorëve. Lavdi i shenjtorëve. Tani i së kremtes. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e shenjtorëve. Pasvargjet e së kremtes (Ose një e së kremtes dhe të shenjtorëve, nëse kisha mban emrin e tyre). Lavdi i shenjtorëve. Tani i së kremtes. Përlëshoret: e së kremtes, e shenjtorëve dhe përsëri e së kremtes.

Në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Litia e shenjtorëve, por Tani një i së kremtes. Trishenjtë. Përlëshorja e së kremtes. Në Mëngjesore, Ndenjësoret e shenjtorëve dhe, në vend të Hyjlindësoreve, Ndenjësoret e së kremtes. (Në vend të Hyjlindësoreve pas Polieleit, Ndenjësoerja e parë e së kremtes pas Odes III). Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV. Proqimeni dhe Ungjilli i shenjtorëve. Ne që pamë ngjalljen. Psalmi 50 (hima) etj. të shenjtorëve. Kanunet: të dy të së kremtes dhe i shenjtorëve. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtorëve. Ndenjësoerja e shenjtorëve dhe (e dyta) e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e së kremtes dhe Sinaksari. Zbritësoret e së kremtes (Detin e mpikse). Në vend të Të meriton, Ode IX e Kanuneve. Dërgimësoret: e së kremtes, e shenjtorëve dhe përsëri e së kremtes. Lavdërimet: 3 të së kremtes dhe 3 të shenjtorëve. Lavdi i shenjtorëve. Tani i së kremtes. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e së kremtes.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e së kremtes dhe e shenjtorëve. Kontaqi i së kremtes. Apostulli dhe Ungjilli i shenjtorëve. Në vend të Të meriton, Zbritësorja e Odes IX. Kungarore e së kremtes [dhe Në gjithë dheun]. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.

10. Nëse bie të mërkurën e Mbylljes së Pashkës:

Në Mbrëmësore, pas Krishti u ngjall (10x) dhe Paqësoreve, Thirrtoret: 6 ngjallësore (Ting. I) dhe 4 të shenjtorëve. Lavdi i shenjtorëve. Tani Hyjlindësore dogmatike e Ting. I. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e shenjtorëve. Pasvargjet: ngjallësorja e parë (Ting. I) dhe të Pashkës (Le të ngrihet Perëndia; Pashka hierore etj.). Lavdi i shenjtorëve. Tani Dit' e ngjalljes. Krishti u ngjall (3x). Përlëshoret: Lavdi i shenjtorëve. Tani Hyjlindësore ngjallësore (Ti që linde për ne prej Virgjëreshës). Përlëshim dialogjikisht.

Në Shërbesën e Mesnatës, pas shërbesës paskale, Litia e shenjtorëve. Tani Hyjlindësore ngjallësore (Tempull dhe derë je; kërkoje në Lavdinë e Pasvargjeve të Ting. Tërth. I). Përlëshorja e shenjtorëve. Në Mëngjesore, pas Krishti u ngjall

(10x). *Përlëshoret: Lavdi i shenjtorëve. Tani Hyjlindësore ngjallësore. Paqësoret. [Polielei dhe Ndenjësorja pas Polieleit me Hyjlindësore ngjallësore (Josifi u çudit).] Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV. Proqimieni dhe Ungjilli i shenjtorëve. Ne që pamë ngjalljen (3x). Nuk thuhet Psalmi 50, por menjëherë Lavdi, Me ndërmjetimet e të hyjkurorëzuarve. Tani, Me ndërmjetimet e Hyjlindësës. Përdëllemë o Perëndi dhe Idhiomeli i shenjtorëve etj. Kamunet: i Pashkës dhe i shenjtorëve (në Lavdi dhe Tani i çdo Ode, Madhështimet e Pashkës). Pas çdo Ode, Zbritësorja e Pashkës. Krishti u ngjall (3x). Kur u ngrit Jisui. Përsëri dhe përsëri. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtorëve. Ndenjësorja e shenjtorëve. Lavdi dhe Tani Hyjlindësore ngjallësore, po sipas Tin sofian qe Logon: Malin e tërëshenjtë le ta himnojmë* dhe Parajsën mendore, kthimin e mirë* të Evës dhe arkën si* edhe portën e qiellshme,* të ndritshmen re dhe ferrën që digjej, por s'prishej dot,* thesarin, pasurinë e madhe të rruzullit;* falje e mëkateve të lashta na është,* shpëtimi nga krimi ynë* u punua përmes asaj.* I thërrasim* me përmallim:* Ndërmjeto te Zoti, yt Bir,* që ndjesë shkeljesh të jepet* me dorën plot,* për ata që i falen lindjes sate me bes'. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Pashkës dhe Sinaksari. Ne që pamë ngjalljen (3x). Kur u ngrit Jisui (3x). Në vend të Më të nderuarën, Ode IX e Kanuneve. Dërgimësoret: e Pashkës, e shenjtorëve dhe përsëri e Pashkës. Lavdërimet: 3 ngjallësore, 3 të shenjtorëve dhe të Pashkës (Le të ngrihet Perëndia; Pashka hierore etj.). Lavdi i shenjtorëve. Tani Ditë e ngjalljes. Krishti u ngjall (3x) dhe Përlëshorja e shenjtorëve.*

Në Liturgji. Antifonet dhe Hyrtorja të Pashkës. Pas Hyrjes, Krishti u ngjall. Ipakoia e Pashkës dhe Përlëshorja e shenjtorëve. Kontaqi i Pashkës. Sa u pagëzuat. Apostulli dhe Ungjilli i shenjtorëve. Në vend të Të meriton, Një engjëll i thërriste; Ndriçohu, ndriçohu. Kungatorja e Pashkës [dhe Në gjithë dheun]. Në vend të Pamë dritën, Krishti u ngjall. Në vend të Emri i Zotit, Krishti u ngjall (3x shpejt në Ting. II). Përlëshim dialogjikisht.

11. Nëse bie të Enjten e Analipsit (Ngjitja në Qiell):

Në Mbrëmësore, (pa Psaltirin) Thirrtoret: 6 të së kremtes dhe 4 të shenjtorëve. Lavdi i shenjtorëve. Tani i së kremtes. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimieni i ditës. Leximet: dy të së kremtes dhe një i shenjtorëve. Pasvargjet: e së kremtes. Lavdi i shenjtorëve. Tani i së kremtes. Përlëshoret: e së kremtes, e shenjtorëve dhe përsëri e së kremtes.

Në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmi 50, Litia e së kremtes dhe e shenjtoreve. Lavdi i shenjtoreve. Tani i së kremtes. Trishenjtë. Përlëshorja e së kremtes. Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë, Ndenjësorja e së kremtes (2x). Pas Stihologjisë së dytë dhe Polieleit, Ndenjësoret e shenjtoreve dhe të së kremtes. Shkallësat. Antifoni i parë i Ting. IV. Proqimeni dhe Ungjilli i së kremtes. Ne që pamë ngjalljen. Psalmi 50 (hima) dhe i gjithë rendi i së kremtes. Kanunet: të dy të së kremtes dhe i shenjtoreve. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtoreve. Ndenjësoret e shenjtoreve dhe e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e së kremtes. Sinaksari i ditës dhe i Pentikostarit. Zbritësoret e Pentikostisë (vetëm të Ting. IV, Mjegull e mbuloj). Në vend të Më të nderuarën, Ode IX e Kanuneve. Dërgimësoret: e së kremtes, e shenjtoreve dhe përsëri e së kremtes. Lavdërimet: 3 të së kremtes dhe 3 të shenjtoreve. Lavdi i shenjtoreve. Tani i së kremtes. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e së kremtes.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e së kremtes. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e së kremtes dhe e shenjtoreve. Kontaqi i së kremtes. Apostulli i shenjtoreve. Ungjilli i së kremtes. Në vend të Të meriton, Irmosi i Odes IX i së kremtes (Ti llambadhen e shkëlqyer). Kungatore e së kremtes [dhe Në gjithë dheun]. Në vend të Pamë dritën, Përlëshorja e së kremtes.

12. Nëse bie në ditët Paskremtore të Analipsit (Ngjitja në Qiell), përveç Mbylljes së tij:

Shërbesa kryhet sipas Mujorit së bashku me troparet Paskremtore. Në Mbrëmësore, Thirrtoret vetëm të shenjtoreve në 6. Pas Ungjillit të Mëngjesit, menjëherë Psalmi 50 etj. Zbritësoret e Pentikostisë (vetëm të Ting. IV, Mjegull e mbuloj). Më të nderuarën. Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e së kremtes. Kontaqi i së kremtes. Apostulli dhe Ungjilli i shenjtoreve. Kungatore: Në gjithë dheun. Në vend të Pamë dritën, Përlëshorja e së kremtes.

13. Nëse bie të Dielën e Etërve të shenjtë të Sinodit të Parë Ekumenik:

Në Mbrëmësore, Thirrtoret: 4 ngjallësore, 3 të Etërve dhe 3 të shenjtoreve. Lavdi i Etërve. Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet: dy të Etërve dhe një i shenjtoreve. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i shenjtoreve. Tani i Analipsit (kërkoje të enjten pas së Dielës

së Etërve, në fund të Mëngjesores). Përlëshoret: ngjallësore, e Etërve. Lavdi i shenjtoreve. Tani i Analipsit.

Në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanuni Triadik, Litia e shenjtoreve. Lavdi i shenjtoreve psalet si një Idhiomel i thjeshtë (pra, pa Lavdi). Lavdi i Etërve. Tani i Analipsit. Himne Triadike. Përlëshorja e Etërve. Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë dhe të dytë, Ndenjësoret e Pentikostarit. Pas Polieleit, Ndenjësoerja e shenjtoreve (Kujtimi yt krejt zyrtar). Lavdi dhe Tani i Analipsit (kërkoje në Tani i Etërve pas Odes III). Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimeni i Tingullit. Kanunet: ngjallësor, i Etërve dhe i shenjtoreve. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtoreve. Ndenjësoret: e Etërve (e dyta). Lavdi i shenjtoreve. Tani i Analipsit (kërkoje në të kremten e tij pas Odes III). Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Etërve dhe Sinaksari i ditës dhe i Pentikostarit. Zbritësoret e Pentikostisë (vetëm të Ting. IV, Mjegull e mbuloj); dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor të Tingullit. Më të nderuarën. Dërgimësoret: ngjallësore, e Etërve, e shenjtoreve dhe e Analipsit. Lavdërimet: 2 ngjallësore, 3 të Etërve dhe 3 të shenjtoreve. Lavdi i Etërve. Tani E përmbibekuar. Dhoksologjia e Madhe. Sot erdhi.

Në Liturgji, Antifonet e Analipsit (por me: ... që u ngjalle prej së vdekurish, vetëm këtu dhe jo në Hyrtoren). Hyrtorja e Analipsit. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e Analipsit, e Etërve, e shenjtoreve dhe e kishës. Kontaqi i Analipsit. Apostulli i shenjtoreve dhe Ungjilli i Etërve. Të meriton. Kungatore: [Lavdërojeni dhe] Në gjithë dheun.

14. Nëse bie të Premten e Mbylljes së Analipsit (Ngjitja në Qiell):

Në Mbrëmësore, pas Qëndrimit të parë të Psaltirit (Lum ai njeri), Thirrtoret: 6 të së kremtes dhe 4 të shenjtoreve. Lavdi i shenjtoreve. Tani i së kremtes. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e shenjtoreve. Pasvargjet e së kremtes. Lavdi i shenjtoreve. Tani i së kremtes. Përlëshoret: e së kremtes, e shenjtoreve dhe përsëri e së kremtes.

Në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Litia e shenjtoreve. Tani i së kremtes. Trishenjtji. Përlëshorja e së kremtes. Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë, Ndenjësoerja e së kremtes (2x). Pas Stihologjisë së dytë dhe Polieleit, Ndenjësoret e shenjtoreve dhe, në vend të Hyjlindësoreve, të së kremtes. Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV. Proqimeni dhe Ungjilli i shenjtoreve. Ne që pamë ngjalljen. Psalmi 50 (hima) etj. të shenjtoreve. Kanunet: Të dy të së kremtes dhe

i shenjtorëve. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtorëve. Ndenjësoret e tyre dhe e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e së kremtes dhe Sinaksari. Zbritësoret e Pentikostisë (vetëm të Ting. IV, Mjegull e mbuloj). Në vend të Më të nderuarën, Ode IX e Kanuneve. Dërgimësoret: e së kremtes, e shenjtorëve dhe përsëri e së kremtes. Lavdërimet: 3 të së kremtes dhe 3 të shenjtorëve. Lavdi i shenjtorëve. Tani i së kremtes. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e së kremtes.

Në Liturgji. Antifonet dhe Hyrtorja e së kremtes. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e së kremtes dhe e shenjtorëve. Kontaqi i së kremtes. Apostulli dhe Ungjilli i shenjtorëve. Në vend të Të meriton, Irmosi i Odes IX i Kanunit të parë të së kremtes (Ty, o nën' e Perëndisë). Kungatore e së kremtes [dhe Në gjithë dheun]. Në vend të Pamë dritën, Përlëshorja e së kremtes.



NË MBRËMËSORE

Thirrto

Ting. IV Édhokas simíosisin

Kryqin tënd të çmuar ia dhe porsia armë me plot fuqi* mbretit tonë, edhe me të* mbi dhë drejtësisht ai* mbretëroi ndritshëm,* besërisht përmes dhembshurisë sate, ndaj u bë* i denjë për mbretërin' në qiell¹ lart;* me të, ekonominë tënde njeridashëse e lëvdohm',* o i Tërëfuqishmi Krisht,* Shpëtimtari i shpirtrave.

Ti, o njeridashës, i dhe shërbëtorit tënd shpresëtar* butësin' e Davidit² tënd,* ndaj mori orthodhoksin'* e apostujve ky* dhe, si Solomonit, i dhe urti³ këtij, o Krisht;* je mbret i mbretërve, Zot i zotërve,*⁴ prandaj ekono-

minë tënde njeridashëse e lëvdohm',* o i Tërëfuqishmi ti,* Shpëtimtari i shpirtrave.

O mbret, je i pari që mantelin perandorak Krishtit* ia nënshtrove vullnetarisht,* kur njohe se është ky* tërëmbreti, Zoti,*⁵ fitimtari përmbi çdo kryesi edhe pushtet,*⁶ për gjithë ne mirëbërësi; prandaj,* krishtdashës që s'harrohesh, mbretërisë sate i dha sukses*⁷ njeridashësi Zoti yt,* Shpëtimtari i shpirtrave.

Lavdi

Ting. II I Bizantit

Kur more prej Perëndisë më të mirat nga dhuratat e pasura, o mbret shumë i fortë, Konstandin tepër i madh, u dallove mirë në to, sepse, pasi

shkëlqeve me rrezet e Shpirtit të Tërë-shenjtë përmes pagëzimit nga prifti Silvestër, u duke i pamposhtur mes mbretërve, dhe ia fale si prikë Ndërtuesit tënd kozmosin dhe qytetin besëmirë dhe mbretërues; prandaj, me që ke guxim, mos pusho së përgjëruari Krishtin Perëndi, që t'u dhurohet të gjithëve, sa kremtojnë kujtimin tënd, ndjesë mëkatesh dhe përdëllimi i madh.^{7a}

Tani *I së kremtes*

*Hyrje. O dritë gazmore.
Proqimeni i ditës dhe Leximet*

Këndimi i III Mbretërve
(8.22-23a, 27b-30)

U çua Solomoni para faqes së altarit të Zotit, përballë gjithë turmës së Izraelit dhe i ngriti duart e tij në qiell dhe tha: “O Zot, Perëndia i Izraelit, s’ka perëndi si ti në qiell lart dhe mbi dhenë poshtë; nëse qielli dhe qielli i qiellit nuk do të të mjaftojnë, por si do të mjaftojë dhe kjo shtëpi që ndërtova në emrin tënd? Dhe do të shikosh nga lart përgjërimin tim, o Zot, Perëndia i Izraelit, që ta dëgjosh lutjen me të cilën po të lutet shërbëtori yt përballë teje, drejt teje sot, që të jenë të hapur sytë e tu në këtë shtëpi ditë e natë, në vendin që the:

‘Do të jetë emri im atje’, që të dëgjosh lutjen me të cilën lutet shërbëtori yt në këtë vend ditë e natë; dhe do të dëgjosh përgjërimin e shërbëtorit tënd dhe të popullit tënd, ato për të cilat do të luten në këtë vend, dhe ti do dëgjosh në vendin e banimit tënd në qiell, dhe do të bësh dhe do të jesh i butë”.

Këndimi i profecisë së Isaia
(61.10b-62.5)

Le të ngazëllohet shpirti im më Zotin, se më veshi me veshje shpëtimi dhe me këmishë ngazëllimi, si ndonjë dhëndër më vuri përreth kokës një mitër dhe si nuse më stolisi me stoli; dhe si tokë që shumëfishon lulen e saj dhe si kopsht farat e tij, kështu do të lindë Zoti drejtësi dhe hare përballë gjithë kombeve. Për Sionin nuk do të hesht, dhe për Jerusalemin nuk do të neglizhoj, derisa të dalë si dritë drejtësia ime, ndërsa shpëtimi im si llambadhe do të digjet; dhe do të shohin kombet drejtësinë tënde dhe mbretër lavdinë tënde, dhe do të të thërrasë emrin tënd të ri, që Zoti do ta emërojë; dhe do të jesh kurorë bukurie në dorë Zoti dhe rreth mbretërie në dorën e Perëndisë tënd; dhe nuk do të quhesh më “I braktisur”, dhe toka jote nuk do të quhet më “Shkretëtirë”, sepse për ty do të quhet: “Vull-

neti im” dhe për tokën tënde “E banuar”, se deshi me mirësi Zoti në ty dhe toka jote do të banohet dendur; dhe sikurse banon tok një djalosh me një të virgjër, po ashtu do të banojnë bijtë e tu; dhe do të jetë me të *njëjtën* mënyrë si do të dëfrehet dhëndër në nu-se, kështu do të dëfrehet Zoti në ty.

Këndimi i profecisë së Isaia

(60.1-16)

Ndriçohu, ndriçohu, o Jerusalem, sepse erdhi drita jote dhe lavdia e Zotit mbi ty ka lindur; ja ku errësirë do të mbulojë tokë si stuhi mbi kombe, ndërsa mbi ty do të shfaqet Zot dhe lavdia e tij mbi ty do të shihet; dhe do të ecin mbretër në dritën tënde dhe kombe në shkëlqimin tënd; ngriji përrëth sytë e tu dhe shiko të mbledhur fëmijët e tu; ja ku erdhën të gjithë bijtë e tu nga larg, dhe bijat e tua mbi supe do të ngrihen; atëherë do të shikosh dhe do të frikësohesh, dhe do të shtangesh në zemër, sepse do të kthehet te ti pasuri deti, dhe kombesh, dhe popujsh; dhe do vijnë te ti kope gamilesh dhe do të të mbulojnë gamile Madhiami dhe Jefai; të gjithë nga Sava do të vijnë duke sjellë ar, dhe livan do të sjellin, dhe gur të çmuar, dhe shpëtimin e Zotit do ta ungjillëzojnë; dhe të gjitha delet e Kidharit do të të mblidhen, dhe desh Naveothi

do të të vijnë dhe do të sillen *si* të pranueshëm mbi altarin tënd, dhe shtëpia e lutjes sime do të lavdërohet. Cilët *janë* ata që si retë fluturojnë dhe si pëllumbesha me të vegjlit e tyre? Mua më pritën ishuj dhe anija e Tharsisë më parë, që t’i udhëheqin bijtë e tu nga larg, dhe argjendin, dhe arin e tyre tok me ta për emrin e shenjtë të Zotit, dhe sepse i shenjtë i Izraelit është i lavdishëm; dhe do t’i ndërtojnë të huajt muret e tua dhe mbretërit e tyre do qëndrojnë te ti; sepse për inatin tim të godita, dhe për mëshirë të desha; dhe do të hapen portat e tua përgjithmonë, ditë e natë nuk do të mbyllet, që të futen drejt teje fuqi kombesh dhe mbretërit e tyre, të cilët do të udhëhiqen; sepse kombet dhe mbretërit që nuk do të të shërbejnë *si skllave*, do të humbasin, dhe kombet me shkretim do të shkretohen; dhe lavdia e Libanit drejt teje do vijë në qiparis dhe pishë, dhe kedër së bashku, që të lavdërojë vendin tim të shenjtë, dhe vendin e kombeve të mia do ta lavdëroj; dhe do të ecin drejt teje të frikësuar bijtë e atyre që të përlulën dhe të acaruan, dhe do të quhesh “Qytet Zoti, Sion i të shenjtit Izrael”; meqë u bërë i braktisur dhe i urryer, dhe s’kishte njeri të të ndihmonte, dhe do të të vendos *si* ngazëllim të përjetshëm, hare gjeneratash në

gjenerata; dhe do të thithësh qymësht kombesh, dhe pasuri mbretërisht do të hash; dhe do të njohësh se unë *jam* Zoti që të shpëtoj dhe të çliroj, Perëndia i Izraelit.

Në Liti Idhiomele

Ting. I

Detyrimisht kremtojmë kujtimin tënd, o Konstandin i barabartë me apostujt, baza dhe krenaria e gjithë mbretërve; sepse, kur u ndriçove me rrezet e Shpirtit, hijeshove mbarë Kishën e Krishtit, pasi mblodhe nga gjithkund tërësitë e besnikëve në qytetin e shkëlqyer të nikeasve, ku tërbimi i të pabesëve u shua dhe gjuhët e heretikëve u dobësuan dhe u marrosën, ndërsa turma e orthodhoksëve u lartësua, pasi u shfaq besimi; prandaj prej tyre u lavdërove si tepër orthodhoks, dhe u shpalle atë i të gjithë mbretërve, meqë more i pari nga Perëndia mantelin mbretëror; prandaj të përgjërohemi ty, ne që kryejmë kujtimin tënd besërisht, kërko zbutje për mëkatet për hir të shpirtave tanë.

I njëjti

Nuk e more thirrjen prej njerëzish, por më saktë, si Pavli i mrekullueshëm, e pate prej së larti, nga Krishti Perëndi,⁸ o Konstandin i barabartë me

apostujt; sepse, kur pe shenjën e Kryqit në qiell dhe u kape përmes tij si gjah tepër i mirë, me të u dallove dhe si fitimtar i pamposhtur kundër armiqsh të dukshëm dhe të padukshëm; prandaj të përgjërohemi ty si ndërmjetuesit fort të nxehtë, ne të dhëlindurit që respektojmë denjësisht kujtimin tënd, që me guxim të kërkojmë për ne ndriçim, zbutje dhe përdëllimin e madh.^{7a}

Ting. II I Bizantit

Kujtimi i mbretit shpresëplotë Konstandin lindi sot si miro që zbrazet,⁹ sepse ai aspiroi Krishtin, përbuzi idhujt dhe ndërtoi mbi dhé kishë për atë që u kryqëzua për ne, dhe në qiej u shpërblye me kurorën e shpresës.

Ting. III

Në moshë të re, porsi Pavli i mrekullueshëm, pranove nga të lartat karizmën hyjnore,⁸ dhe me armatimin e Kryqit nënshtrove arrogancat e armikut të tmerrshëm, o krenaria e perandorëve, Konstandin i barabartë me apostujt; përgjëroju Zotit për ne që të shpëtohen shpirtat tanë.

Ting. IV

Nga buzë të balta i këndohet himnim Perëndisë me rastin e kujtimit tënd

të hyjshëm, o Konstandin i tërëfamshëm, sepse ti u duke ushtar i pastër i fjalës së besimit,¹⁰ duke diskriminuar në arenë fytyrat e idhujve; dhe tani u mbështete në dritën e Trinisë, duke i shkëlqyer si pishtar mendjet tona me anën e ndërmjetimeve të tua.

Lavdi *Ting. Tërth. I*

Sot Kisha, pasi u stolis me pushtetin tënd, o monark, dëfren mistikisht, dhe mburr me lavdërime, siç është e vyer, kujtimin tënd të tërëlavdishëm, duke thirrur: Gëzohu ti, që e pate zili Pavlin,⁸ dhe e ngrite Kryqin e Krishtit,¹¹ dhe dërmonte kurthet e kundërshtarit; gëzohu, o i tërëshkëlqyer i perandorëve dhe i barasvlefshëm me apostujt; gëzohu, o mbështetja e shpresëtarëve¹² dhe pargfronti i mbretërve; o Konstandin i lumur, mos e ndërpre ndërmjetimin tënd për ne pranë Zotit, sepse ke guxim, o bukuri mbretëresh.

Tani

I së kremtes

Pasvargjet

Ting. II Ote ek tu ksilu

More* skeptër prej Jisuit Krisht,* Konstandin, si mbreti i parë i të krishterëve,* ty simboli shpëtimtar që fshehur ish nën dhé,* t'u shfaq hapur;

nën këmbët e romakëve shtrove* gjithë kombet, Kryqi jetëbërës armë është*,* kurrë, o i lum, nuk luftohet;* me të Perëndisë iu solle,* Zotit njeri-dashësit, me çdo lavdi.

Varg: Lartësova një të zgjedhur nga populli im.

Mitra,* barku që të mbajti ty,* ish i lumur¹³ edhe i shenjtë, mbret sundimtar, që të do* bota mbarë, o i hykurorëzuari* Konstandin; lavd për mbretër, pasuri, përluftar, ndihm'* për jetimët dhe vejushat, çlirim robëresh,* strehë për të varfrit, si edhe* të parëndësishmit¹⁴ vërtet je,* rimëkëmbje për të hidhëruarit.

Varg: Për këtë të krezmoi Perëndia, Perëndia yt.

Meqë* po nxitohej me përmall,* dashuri për Krishtin Jisu, nëna e lastarit zëmadh,* fort të ëmbël, shpejt arriti në Sionin shenjt,* pra në vendin e hyjshëm,¹⁵ ku për ne Çlirimtari,* për shpëtimin ton' u kryqëzua; kjo atje* ngriti Kryqin, ndaj po thërriste* me gaz: Lavde ty, o dhurues,* që më dhe atë që po shpresoja fort.

Lavdi *Ting. Tërth. IV*

Si dritë tepër e shkëlqyer, kometë pasditeje, që u përçove nga pabesimi në besim te Hyjnia, u solle që të shenjtëroje qytetin dhe popullin; dhe sapa

pe shenjë Kryqi në qiell, dëgjove që andej: “Me të fito mbi armiqtë e tu”. Prandaj, pasi pranove dijen e Shpirtit dhe u krezmove me vaj si prift dhe mbret,¹⁶ e mbështete Kishën e Perëndisë, o atë mbretërisht orthodhoksë; madje sarkofagu me lipsanin tënd buron shërime; o Konstandin i barabartë me apostujt, ndërmjeto për shpirtrat tanë.

Tani

I së kremtes

Përlëshore

Ting. Tërth. IV

Sapo pa në qiell shenjën e Kryqit tënd dhe sikurse Pavli pranoi ftesën jo prej njerëzish,⁸ apostulli yt ndër mbretërisht, o Zot, besoi në dorën tënde qytet mbretërues; atë shpëtoje gjithnjë në paqe, me ndërmjetimet e Perëndilindëses, o i vetmi njeridashës.

Dhe e së kremtes



NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjëso

Ting. III Thias písteos

Si David i ri* me sjelljen tënde*² ti u bëre krejt,* kur prite çmimin* nga

lart, sipër kokës vajin e mbretëris’;*¹⁷ se të krezmoi në Shpirt Krishti, Fjala Zot* e përmbiqenshme, prandaj more, o i lum,* i lavdishëm, skeptër mbretërisht, dhe kërkon për ne* mëshir’ të madhe,^{7a} ndjesë shkeljesh si dhe hir.

Dhe e së kremtes

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjëso

Ting. Tërth. II

Bërësi i qiellit dhe i Krijesës, duke u zvarritur për në Kryq, përmes yjeve nga qielli të hoqi ty si yll të ndritshëm, dhe të parin ty ta ngarkoi pushtetin mbretëror; prandaj të lavdërojmë, o Konstandin, mbret tejet shpresëplotë, së bashku me Elenën, nënën hyjmenëse.

Dhe e së kremtes

Pas Polieleit, Ndenjëso

Ting. IV Tahi prokatálave

Kujtimi yt krejt zyrtar u shfaq te ne me lavdi;* shkëlqen anembanë me ndriçim hyjdiqe,¹⁸ Konstandin, me hyjfrymëzim;* se besnik u dallove* ti mes mbretërisht, meqë* ligjet e Tërëmbretit qiellor¹⁹ i ke mbajtur;* nga ngasjet me përgjërimet pra që bën, na çliro.

Dhe e së kremtes

*Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV.
Proqimeni Ting. IV*

Lartësova një të zgjedhur nga populli im, gjeta Davidin, shërbëtorin tim, me vajin tim të shenjtë e krezmova.

Varg: Për këtë të krezmoi Perëndia, Perëndia yt, me vaj ngazëllimi.

Ungjilli. Psalmi 50.

Lavdi. Me ndërmjetimet e të hyjkurorë-zuarve.

Tani. Me ndërmjetimet e Hyjlindëses. Përdëllemë, o Perëndi. *Dhe Idhiomeli.*

Ting. II I Bizantit

Kujtimi i mbretit shpresëplotë Konstandin lindi sot si miro që zbrazet,⁹ sepse ai aspiroi Krishtin, përbuzi idhujt dhe ndërtoi mbi dhé kishë për atë që u kryqëzua për ne, dhe në qiej u shpërblye me kurorën e shpresës.

*Kanunet: i së kremtes dhe
i shenjtoreve
Zbritësoret e së kremtes*

*Kanuni i shenjtoreve
Ting. Tërth. IV
Ode I
Igrán dhiodhefsas*

Çliro, o i vetmi Mbret qiellor,^{*19} shpirtin tim të shkretë prej mëkatit që e

sundon* tashmë, duke pritur përgjërimet* e dyshes së shërbëtorëve pra të tu.

Meqë mbretërinë supreme ti,* Konstandin i lumur, deshe, Mbretin e Gjithësis',* Zotin,²⁰ adhurove me një mendje* tepër të pastër, që kur i besove krejt.

Vërtet le padijen e errët terr,* pra kur u ndriçove nur prej dritës hyjnore ti,* o hyjmendëse Elena, Mbretit* të jetës²¹ me pastërti i shërbeve drejt.

Hyjlindësore

O portë e lindjes hyjnore ti,* çel për mua dyert²² e pendimit, dhe më çliro* përmes ndërmjetimit tënd nga portat* e vdekjeprurësit, pra të mëkatit, Zonj'.

Ode III

Uranias apsidhos

Si nxitove të merrje shpërblim në qiell²³ si çmim,* o hyjmendës, e ndoqe pas atë që të ftonte ty,* le errësirë, mashtrim,* që nga stërgjyshi na erdhi;* në të Hyjshmin Shpirt ti u bëre ndriçues, shenjt.

Si u ngjite pas Krishtit²⁴ edhe mbi të vure ti* gjithë shpresën,²⁵ vendet e tij të shenjta i pe me sy* kur shkove, e tërëthjesht';* atje pësoi pësimin* e pacen i Miri, si u mishërua pra.

Oe hyjлумëruar, trofeun që s'thyhet dot,* armën shpëtimtare dhe shpresën e të krishterëve* pra Kryqin e çmuar fort,* që ishte fshehur nga smira,* e zbulove duke u djegur me mall hyjnor.

Hyjlindësore

Unë rashë nga jeta e hyjshme, o e pacen,* dhe u krahasova me kafshët,²⁶ ndaj i dënuar jam* i tëri, pra më çliro* dhe nga ndëshkimi shpëtomë,* ti që e ke lindur Gjykatësin, Zotin Krisht.

Ndenjëso

Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon

Shtrive shqisat në qiej, kuptove pra* bukurinë e yjeve²⁷ mistikisht,* mësove Sunduesin* e gjithçkaje; në shesh të shndrit* si armë Kryqi që kish mbi-shkrimin "Me të fito* dhe fuqizohu"; ndaj hape syrin e shpirtit tënd,*²⁸ gërmat i lexove dhe mësove për jetën,* o shën Konstandin i madh,* o i tërënderuari* mbret i parë* dhe shpresëtar;* ndërmjeto te Zoti yt Krisht,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tënd fort të shenjt' me mall.

Lavdi *dhe* Tani

I së kremtes

Ode IV

Isakikoa Kírie

Krishti Zot të rrjeton nga qielli si qëmoti Pavlin,⁸ o Konstandin, duke të mësuar që të adhurosh vetëm atë si mbret.

Oi lumur, Krishti diell nëpërmjet yjeve të shkëlqen me shenjë tepër të ndritshme dhe të tregon ndriçues të të errësuarve.

Oe lumur, ke qenë edhe perëndidashëse nga sjelljet, edhe e admirueshme me anën e punëve të hyjshme, prandaj të lavdërojmë me besë.

Ti e shfaq tani trofeun hyjnor të Kryqit, i cili fshihej për shumë vjet; përmes tij shpëtuam dhe u çliuam nga mashtrimi i demonëve.

Hyjlindësore

Oe Gjithmonëvirgjër, që kishe në bark Diellin e drejtësisë,²⁹ ndrite shpirtin tim të errësuar nga paligjësitë.

Ode V

Orthrizontes voomen si

Pasi mëngove drejt Zotit, Diellit të paperëndueshëm, o mbret i hyjurtë, u mbushe me dritë plotpërplot.

Eveshur me dashuri dhe dhembshuri të përsosur si me porfir, banon tani në mbretëritë e sipërme.

U bashkove me kore të patrupësh, o Elenë, sepse i shërbeve Perëndisë me veprat e tua të virtytshme.

Hyjlindësore

O Virgjëreshë, pastroje shpirtin tim që u ndot nga kënaqësitë e trupit për shkak të ndikimit të gjarprit.³⁰

Ode VI

Tin dhéisin ekheó

Mbështete fort* zemrat e të gjithëve,* që lëkundeshin, prandaj po lëvdojmë* Fjalën si Zot* të njëfronshëm me Atin,* të njënderuar; i bëre, o Konstandin,* këto përmes korit të lum* atëror, që e mblodhe çuditërisht.

Besove thell'* Zotin që jeton,³¹ dhe jep* ekzistencë te të gjithë, dhe flake* të kotën fe,* vdekjeprurësit idhuj* me neveri, edhe more me gaz, hare,* Elenë, o e thjeshtë krejt,* mbretëri qiellore¹ me birin tënd.

Braktisën krejt* errësir' padijeje,* çdo stuhi të ateizmit të tmerrshëm,* Fjalë, ata* që në ty mbretëronin,* që i drejtoje me dorë,³² me krahun tënd;* u sollën pra me ngazëllim* te limanet e qeta³³ të besës son'.

Hyjlindësore

Shëro, Vajzë,* zemrën time plot mëkat,* të sëmure, aq sa s'gjenet kurim

dot;* se u plagos* me kafshim nga i ligu,* më denjëso për shërimin tënd, më shpëto* me ndërmjetimin që ndër-merr,* se besim ty të pata, o e pacen.

Kontaqi

Ting. III I Parthenos símeron

Shën Elena nëna sot* dhe Konstandini zbulojnë,* shfaqin Kryqin, drurin pra* të fortnderuar që është* turp i madh* për gjith' judenjtë, por edhe armë* mbretërisht* besnikë kundër çdo kundërshtari;* u duk shenjë madhështore,* e frikshme gjatë betejash për gjithë ne.

Shtëpia

O besimtarë, le ta nderojmë Konstandinin së bashku me të ëmën, sepse, kur dëgjuan fjalët e profetit, kuptuan Kryqin e bërë me tri elemente: me kedër, pishë dhe qiparis,³⁴ nëpërmjet të cilit vijoi pësimi shpëtimtar; dhe i bënë të gjithë judenjtë të përgatiten për t'u treguar popujve një të drejtë të madhe, të fshehur për shkak të xhelozisë dhe smirës së tyre; dhe, sapo ata e gjetën, e treguan, dhe prandaj u shquan te të gjithë si fitimtarë, duke mbajtur armë të pamposhtur, që u duk shenjë madhështore, e frikshme gjatë betejash për gjithë ne.

Sinaksari

Më 21 të të njëjtit muaj, kujtimi i mbretërve të mëdhenj, të shenjtë, të lavdëruar, të hyjkurorëzuar dhe të barabartë me apostujt Konstanini dhe Elena.

Vargje: Si mbretër, e kishin të përbashkët kurorën e tokës,/ të përbashkët e kanë edhe kurorën e qiellit.

Më njëzet e një Konstandini vdiq bashkë me të ëmën.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i neomartirit të shenjtë oshënar Pahom ukrainasi.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

*Ode VII**Pedhes Evreon*

Duke mbajtur urdhrat e tu, Konstandini u përkul te ligji yt, prandaj rrëzoi rreshtime të paudhësh, duke të thirrur: O Zot Perëndi, je i bekuar.

Na e zbulon, o e admirueshme, drurin që na nxori të gjithëve nga gropa e humbjes, të cilin e zhytën nga smira, dhe që mbyt demonë shkatërrimtarë në jetë.

Me punë të hyjshme e ndërtove zemrën tënde si tempull Perëndie, o Elenë; dhe për atë ngrite kisha të shenjta atje ku hoqi në mish për ne pësimet e pacenuara.

Hyjlindësore

Duke mëkatuar me paramendim dhe duke u skllavëruar në zakone të pavend, vrapoj tani te dhembshuria jote e zakonshme; shpëtomë mua të dëshpëruarin, o Perëndilindëse e Tërëshenjtë.

*Ode VIII**Eptaplasios káminon*

Kur u stolise me butësinë si me mantel perandorak, o i lavdishëm, dhe me dhembshurinë e mirë si me petk, u zbukurove me kurorën e virtyteve, nëpërmjet mendjes së përsosur; dhe, pasi u zhvendose nga mbretëritë e tokës drejt atyre të sipërme, thërret: O priftërinj, bekojeni; popull, përmbilartësojeni Krishtin në jetë.

Duke të parë, o Elenë e lavdëruar, të dëfresh në mbretëri Perëndie, bashkë me birin hyjmendës, e madhërojmë Krishtin që na tregoi festën tuaj të respektuar, e cila na ndriçon më tepër se rrezet e diellit ne që këndojmë besërisht: O popull, përmbilartësojeni Krishtin në jetë.

Sa i çuditshëm është malli yt dhe e perëndishme sjellja jote, o Elenë e lavdëruar, mburrja e grave! Sepse, kur arrite në vendet që pranuan pësimet e nderuara të Zotit të të gjithave,²⁰ i stolisje me kisha shumë të bukura,

duke thirrur: O popull, përmbilartësojeni Krishtin në jetë.

Hyjlindësore

Ndriçoji, o Hyjlindëse, sytë e shpirtit tim, të cilët u verbuan për shkak të shkeljeve të shumta; lyp, paqësoje mendjen dhe zemrën time, që trazohet nga kënaqësi të shumëllojshme, dhe shpëtomë mua që thërras: O priftërinj, bekojeni; popull, përmbilartësojeni Krishtin në jetë.

Ode IX

Eksesti epí tuto o uranós

Ndriçon, shkëlqen me dritë pa perëndim,* sa të mburrin, dhe flak terrin varri yt ku është shtrir'* trupi yt i hyjshëm, i çmuar fort,* dhe rreze, Konstandin, lëshon,* llamburitje plot me ndriçim hyjnor,* buron shumë shërimë* te sa me besë vijnë* gjithmonë pranë tij me përmallim.

Meqë e shkove jetën me shenjtërim,* ke fushuar tani me shenjtorët tok, se me ndriçim* ishe shenjtëruar e tëra ti;* kështu gufon, buron gjithnjë* ti lumenj shërimesh edhe i mbyt* pasionet, shën Elenë,* kudo vadit, e lumur,* me hir, bekime shpirtat tanë pra.

I parapafillim je, o Mbret që s'vdes,* denjësove ti për mbretëri qiellore¹

ata* që i drejtësove për mbretërim* mbi dhé qëmoti besërisht,* meqë sinqerisht ty të deshën fort,* shenjtoreshen pra Elenën,* të madhin Konstandin tok;* siç ndërmjetojn', na dhembshuro të gjith'.

Hyjlindësore

Ti mbretin e të gjithave,²⁰ Bërësin* o e Virgjër, e zure, e kishe në bark; dhe tani,* ja ku po qëndron, e dëlirë krejt,* si mbretëreshë pranë tij* në të djathtë;³⁵ ndaj lyp të më çlirosh* në kohën e ndëshkimit,* rrëmbemë nga e majta,* rreshtomë djathtas tok me delet ti.³⁶

Dërgimësore

Tis mathitēs sinéltōmen

S'e mori që nga njerëzit* fuqinë mbretërore,* por përmes Hirit zotëror* me nënën prej së larti,* prej qiellit, Konstandini* i Madh, dhe pa të shndriste* trofe i hyjshëm, Kryqi pra;* me këtë theu keqdashësit; mashtrim,* idhujt i shkretot, ndërsa në botë* edhe besimin orthodhoks* ky fort e siguroi.

Dhe e së kremtes

Lavdërime

Ting. Tërth. IV O tu paradhoksu thávmatos

O shenjt i tërurtë Konstandin, gëzohu ti, o burim* orthodhoks, që vadit gjithnjë* duke nginjur me rrëke* fort të ëmbla Krijesën mbar’; *³⁷ ki gaz, o rrënjë nga mbiu fryt i madh, * që po ushqen Kishën e Jisuit Zot; * ki gaz, o krenari* për planetin; pra i lavdëruar je, * mbret i parë i krishterë, gazi yn’, gëzo.

Duke paraparë mbreti i Krijesës²⁰ bindjen që kish* zemra jote, të kap si gjah* me arsye, o i urt’, * kur shkllavishe në marrëzi; * pasi me njohje shpresëtarie ky* të ka shkëlqyer dhe të tregoi ty* diell të ndritshëm fort, * që planetin e ndriçon me rrezatim, * o i lavdëruari* me vepra të hyjshme.

O e famshme, prite mësimdhëniet zotërore në shpirt* si një arë e zgjedhur krejt; * çele vepra në virtyt, * që na ngijn’ mendjet pra si frut, *³⁸ o e tërurta ti, shën Elenë pra, * kur imitojmë ne sjelljen tënde drejt; * ndaj po kremtojmë sot* plot gëzim, me panair kujtimin tënd, * duke brohoritur fort: Lavd Krishtit, Mbretit tënd.

O Krisht, Konstandinin dhe Elenën, miqtë, shokët e tu, * me vaj gazi i leve ti* paradoksalisht, o Zot, *³⁹ se urren mashtrimin fort, * për bukurinë tënde pra patën mall; *⁴⁰ i denjësove për mbretërin’ tënde, * Fjalë, në qiell¹ lart, * pasi më përpara besërisht mbi dhé*

mbretëruan me bekim dhe aprovim nga ti.

Lavdi *Ting. Tërth. IV*
I Metodit patriarch

Mbreti i mbretërve⁴ dhe Perëndia që stolis të vyerit me dhurata të pasura, ai nga qielli përmes shenjës së Kryqit të kapi, o Konstandin, si gjah për jetë, porsi Pavlin⁸ e kënduar, pasi tha: “Në të fito mbi armiqtë e tu”. Këtë Kryq kur e kërkove së bashku me nënën tënde hyjmendëse dhe e gjete siç aspiroje, i mposhte ata me triumf; ndaj tok me atë që të lindi, përgjëroju të vetmit njeridashës për mbretërit orthodhoksë, për ushtrinë krishtdashëse dhe për të gjithë që festojnë me besë kujtimin tënd, që të çlirohen nga çdo zemërim.

Tani *I së kremtes*

Dhoksologjia e Madhe

Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanuni, Ode III dhe VI. Apostulli dhe Ungjilli i shenjtorëve. Kungatore: Në gjithë dheun.

CITIME

¹ Matth. 3.2 etj.

² Ps. 131(132).2 etj.

³ III [I] Mbret. 2.35a; Matth. 12.42 etj.

⁴ I Tim. 6.15; Apok. 17.14; 19.16

⁵ Ef. 4.13; II Petr. 1.8; 2.20

⁶ Matth. 28.18; Ef. 1.21

⁷ II Kron. 17.5

^{7a} Num. 14.19 etj.

⁸ Vep. 9.3-6; 26.13-18

⁹ Kënga 1.3

¹⁰ Rom. 10.8; I Tim. 4.6

¹¹ Matth. 16.24; Mark. 8.34; 10.21;

Lluk. 9.23

¹² Sirak 49.15; Lluk. 22.32

¹³ Lluk. 11.27

¹⁴ Jov 29.12-13; 31.16-20

¹⁵ Ps. 23(24).3 etj.

¹⁶ Eks. 19.6; 23.22; I Petr. 2.5,9;

Apok. 1.6; 5.10

¹⁷ I Mbret. [Sam.] 16.13; Ps. 88(89).20-21

¹⁸ II Kor. 4.6

¹⁹ Tobit 13.11

²⁰ I Kron. 29.11; I Esdra 4.3; Ps. 102(103).19;

Urt. Sol. 12.16

²¹ I Tim. 1.17; Ps. 144(145).13

²² Jez. 44.1-2

²³ Matth. 5.12; Lluk. 6.23,35

²⁴ I Kor. 6.17

²⁵ Vep. 24.15; I Petr. 1.21

²⁶ Ps. 48(49).13,21

²⁷ Sirak 43.9

²⁸ Vep. 9.17-18; 26.18

²⁹ Mal. 4.2(3.20)

³⁰ Apok. 12.9; 20.2

³¹ Jis. N. 3.10 etj.

³² Urt. Sol. 14.6

³³ Ps. 106(107).25-30

³⁴ Is. 60.13

³⁵ Ps. 44(45).10

³⁶ Matth. 25.31-33

³⁷ Gjen. 2.6

³⁸ Matth. 13.8; Mark. 4.8; Lluk. 8.8

³⁹ Ps. 44(45).8

⁴⁰ Ps. 44(45).12



MË 22 TË TË NJËTIT MUAJ

Kujtimi i martirit të shenjtë
Joan Vladimiri.*

Tipikon

Kur bie brenda Pentikostarit, shiko analogjikisht Tipikonin e shën Joan Theologut (8 Maj) ose të shën Konstandinit (21 Maj) me varësi nga KaleNDARËT, i Vjetër ose i Ri.



NË MBRËMËSORE

*Pas Qëndrimit të parë të Psaltirit
(Lum ai njeri)*

Thirrto

Ting. IV Os jeneon en mártisin

Porsi trim mes martirëve* lavdërohes, Joan i madh;* nuk u frikësove përpara vdekjes ti,* dije drejt çfarë tha Krishti, se nuk ka rëndësi aspak* vdekja jonë trupërisht,* ndaj nuk duhet të trembemi,*¹ por kujdes kërkon* që të mos vdesim shpirtërisht me ndarjen nga Krijuesi i dashur, i dhe-mbshur, që shpirtin dha për ne.²

Para se të të vrisnin ty,* o Joan Vladimir me nam,* o shenjtor, martir ishe

me vullnetin tënd* edhe kështu tejkaloje porosinë e Krishtit Zot* që na flet ne për largim,* pra kur tha që të ikim tej,* kur na ndjekin ne;*³ dhe jo vetëm që s'ike, por me dashje ecje drejt martirizimit me burrëri që habit çdokënd.

Vërtetoi apostulli* se njeriu me shumë zor* për ndonjë të drejtë, për mik jep jetën pra,* por Krishti dha për ne jetën edhe pse ishim krejt armiq;*⁴ imitove ti atë,* me dëshirë armikut tënd* jetën ia dhe,* sikur ishte mik, meqë ish kunat ky, por u shfaq dhe u zbulua tradhtari yt, tinëzar, dinak.

Të tjera

I njëjti Édhokas simiosin

Si ta madhështojmë, Vladimir, virtutin që na mahnit,* butësinë, durimin tënd;* me to triumfove fort,* yll në Kishën tonë* u tregove, ndaj për Ballkanin mbarë nder je ti,* të kanë kombe të ndryshme mburrje ty;* kremtojmë panairin tënd me mallëngjim dhe me gaz të madh,* o i shenjtë Joan me nam,* ndërmjeto për të gjithë ne.

Nder edhe hare na mbush, sepse të kemi në Shqipëri* si thesar krejt të çmuar ty,* si dhe manastirin tënd,* që ty të kushtoi* bashkëshortja jote besnike, me devotshmëri* dhe dashuri për Jisunë Perëndi;* së bashku është

* Poezi e përkthyesit

dhe ajo, me ty shijon mbretërinë tok,* o Joan Vladimir i lum;* ndërmjeto për të gjithë ne.

Ejani, afrohuni të gjithë tok dhe bashkohuni,* cilido popull mblidhuni;* këtu është para nesh* shenjt i përba-shkët,* na dhuron pra hirin e tij, gëzim dhe qetësi* me përgjërimit e tij te Zoti Krisht,* që kishte dashur pa ku-fi sikundër na urdhëroi ne,*⁵ domethënë zbatoi drejt* porosinë e tij me zell.⁶

Lavdi *Ting. Tërth. II*

O mbret shën Joan, kishe para syve përherë Mbretin⁷ e mbretërve dhe Zotin e zotërve,⁸ Krishtin me pushtet shpirtëror; prandaj nuk i shtypje nënshitetasit e tu, siç veprojnë zakonisht qeveritarët e botës, ndonëse quhen bamirës;⁹ nuk drejtoje me shpatë, por me dashuri; kështu mos resht së luturi për ne, o i dhembshur.

Tani *I Pentikosarit*

*[në periudhën e Pentikostarit;
ndryshe, Hyjlindësore:]*

Cili s'do të të lumërojë, o Hyjlindëse Virgjëreshë? Cili s'do të përhimnojë lindjen tënde të kulluar? Se biri yt i vetëmlindur që shkëlqeu prej Atit¹⁰ pa mot, gjith' ai lindi prej teje së pastres i mishëruar pa tregim; duke qenë prej

natyre Perëndi dhe duke u bërë për ne njeri prej natyre, i pandarë në dy fytyra, por i njohur me dy natyra pa përzier. Atij lutju, o Zonj' e lumur, të mëshirohen shpirtrat tanë.*]

Hyrje. O dritë gazmore.

Proqimeni i ditës dhe Leximet

Këndimi i profecisë së Isaia

(43.9-14)

Këto thotë Zoti: "Gjithë kombet u mblodhën së bashku dhe do të mbli-dhen arkondë nga ato. Kush do t'i njoftojë këto? Ose gjërat që nga fillimi kush do t'ju njoftojë? Le t'i sjellin dëshmitarët e tyre, dhe le të drejtohen, dhe le të dëgjojnë, dhe le të thonë të vërteta. Bëhuni dëshmitarët e mi dhe unë dëshmitar", thotë Zoti Perëndia, "dhe fëmija im që zgjodha; që të njihni dhe të besoni, dhe të kuptoni se unë jam. Përpara meje nuk u bë Perëndi tjetër dhe pas meje nuk do të jetë. Unë, Perëndia, dhe veç meje nuk është ndonjë që shpëton. Unë lajmërova dhe shpëtova, talla dhe nuk ishte në mes jush i huaj. Ju dëshmitarë për mua dhe unë Zoti jam Perëndia, ende nga fillimi dhe nuk ka njeri që të shpëtojë nga duart e mia. Do të bëj, dhe kush do ta kthejë mbrapsht këtë?". Kështu thotë Zoti, Perëndia, që ju çliron, i Shenjt i Izraelit.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit

(3.1-9)

Shpirtrat e të drejtëve janë në dorën e Perëndisë dhe nuk do t'i prekë mundim. U dukën në sytë e të pamendëve se vdiqën dhe u konsiderua keqtrajtim dalja e tyre dhe dërmim ecja nga ne, por ata janë në paqe; sepse edhe nëse ndëshkohen para faqes së njerëzve, shpresa e tyre është plot pavdekësi; dhe pasi do të ndëshkohen me pak *mundime*, do të fitojnë mirëbërje të mëdha, sepse Perëndia i provoi dhe i gjeti të denjë për veten. Si ar në shkritore i provoi ata dhe si holokaust flijimi i pranoi ata; dhe në kohën e shqyrtimit të tyre do të ndriçojnë dhe si shkëndija në kallam do të vrapojnë. Do të gjykojnë kombe dhe do të sundojnë popuj, dhe do të mbretërojnë në ata Zoti ndër shekuj. Ata që kanë besim në të do të kuptojnë të vërtetën dhe besimtarët me dashuri do të qëndrojnë pranë tij, sepse *ka* hir dhe mëshirë ndër oshënarët e tij dhe mbikëqyrje mbi të zgjedhurit e tij.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit

(5.15-23; 6.1-3)

Të drejtët jetojnë përjetë dhe paga e tyre është në Zotin, dhe përkujdesja

e tyre pranë të Shumëlartit. Për këtë do ta marrin mbretërinë e hijeshisë dhe kurorën e bukurisë nga dorë Zoti, sepse me të djathtën do t'i mbulojë dhe me krahun do t'i mbrojë. Do të marrë *si* armatim zellin e tij dhe do të mobilizojë me armë krijesën për mbrojtje armiqsh. *Si* korracë do të veshë drejtësi, dhe *si* helmetë do të veshë gjykim pa hipokrizi. Do të marrë *si* mburojë të pamposhtur oshënarë dhe do të mprehë zemërim të prerë për shpatë; dhe do të bashkëluftojë me atë bota kundër të marrëve. Pre-dha rrufesh do të ecin suksesshëm te qëllimi, dhe si nga një hark i plotë rrethi nga retë do të hidhen në shënjestër, dhe nga zemërimi që hedh gurë do të hidhen breshëri të plota. Do të indinjohej kundër tyre ujë deti, ndërsa lumenj do të përmbysin papritur. Do t'u kundërvihet atyre erë fuqie dhe si stuhi do t'i ajrojë ata si grurë dhe paligësi do të shkretojë gjithë dheun, dhe keqbërje do të përmbysë frone dinastish. Dëgjoni, pra, o mbretër, dhe bëhuni të mençur, mësoni, o gjykatës të anëve të dheut. Vëreni veshin, ju që sundoni shumicë dhe që jeni mburrur mbi turma kom-besh, se ju dha nga Zoti sundimi dhe dinasti nga i Shumëlarti.

Në Liti Idhiomele
Ting. I

O martir i kurorëzuar në tokë dhe në qiell me kurorë nga Trinia e Tërë-shenjtë, aksioma jote u zgjat duke u stabilizuar në përjetësi, sipas Shkri-mit që flet për mbretër dhe priftërinj te Perëndia ynë;¹¹ me dhimbje hyre në gëzimin e Zotit tënd,¹² duke harruar çdo mundim, se atje lumturia nuk soset kurrë; të nderojmë me shpirt.

Lipsanet e tua të shenjta që burojnë hir, i kemi si ngushëllim, i puthim me shumë mall dhe nxjerrim bekim me bollëk. O! Çfarë pasurie! Nëpërmjet bashkimit me shpirtin tënd të hyjni-zuar fituan shenjtërim; këtë e shpër-ndajnë tek ata që të psalin dhe për-piqen të të imitojnë të paktën në be-sim dhe në virtyt.

Shpëtimtari yt Krishti porositi të kthej-më edhe faqen tjetër kur na japin shu-plakë,¹³ por ti e dhe kokën tënde vull-netarisht, të cilën, tepër të frikshme, e more më pas në duart e tua; tregues i madh që ajo për majën e shenjtërim-it ku arrite, o çudibërës famëmadh.

Lavdi *Ting. Tërth. I*

Ejani, o krishtdashës, të shohim çfa-rë bëri shkelësi i betimit: Vrau i pa-besi njeriun e Perëndisë,¹⁴ shembullin

e mbretërve, majën e vetëmohimit. Nuk u frenua dinakëria e tij, nuk u vra ai nga shpata e vet e shfuqizuar me mrekulli. Le të pikëllohem nga ngur-tësia e zemrës së tinëzarit, ndërsa martirin, që çuditi edhe dëshmorët, le ta lavdërojmë duke thirrur: Lavdi, më ty, o Zot.

Tani *i Pentikostarit*
[në periudhën e Pentikostarit;
ndryshe, Hyjlindësore

Ty të lumërojmë, o Hyjlindëse e vir-gjër dhe të lavdërojmë ne besnikët siç të ka hije ty, qytetin e patundshëm dhe murin që s'çahet dot, mbrojtjen e pa-thyeshme dhe strehën e shpirtrave tanë.]

Pasvargje
Ting. Tërth. I Heris askitikon

G'zohu, o mbret Joan Vladimir,* që je dhuratë Perëndie, siç quheshe;* së-rish ti pra sipas emrit të dytë ishe ar-kond,* kryetar i paqes;* imitove drejt* në emër dhe në veprim* princin su-prem të paqes son',* sipas profetit* që ashtu e kish quajtur* Zotin Shpë-timtar,*¹⁵ tërëmbretin, Çliruesin;* meqë fitove denjësisht kurorë, rreth të dyfisht',* porsi i drejtë edhe si mar-tir me dashje, në qiell je;* ndaj lyp Krishtin tonë* që të japë përdëllimin e madh^{15a} te shpirtrat tan'.

Varg: I çuditshëm është Perëndia në shenjtorët e tij.

G'zohu, i tërëpastër vërtet,* në besën orthodhokse s'bëje aspak lëshim,* se dije që heretikët kanë dështuar mjerisht,* sado vetëquhen të krishterë kot;* por janë si ujë këta,* siç apostulli korife* na ka theksuar,* edhe pse te ne vijnë pra* butësisht si dhen;*¹⁶ ndaj edhe urdhrin më në fund* që dhe tek oborrtarët ishte ky: Të kujdese-shin* ta mbronin besën e saktë, autentike, të çmuar fort;* dhe lyp Krishtin tonë* që të japë përdëllimin e madh^{15a} te shpirtrat tan'.

Varg: Te shenjtorët që janë në tokën e tij, bëri mrekulli Zoti.

G'zohu, se s'humbje kurrë, aspak* durimin, paqen, mirësinë që Shpirti Shenjt* dhuron, kur e çelim zemrën dhe e gatitim për to;* mbaje frytin e karizmës që na jep,*¹⁷ dhe s'mbajte mëri, inat* kundër vrasësit besëkeq;* kështu porsi çmim* për virtytin tënd që habit* more plot dhunti,* çudibërës u shfaqe ti;* si të të mburrim ty ne të pavyerit që s'durojm'* as më të voglën pra fjalë nga njerëzit, asnjë ofendim;* ndaj lut Krishtin tonë* që të japë përdëllimin e madh^{15a} te shpirtrat tan'.

Lavdi *Ting. Tërth. IV*

Sikurse mbreti i parë i madh i të krishterëve u thirr nga qielli nëpërmjet një kryqi që pa, kështu dhe mbreti, shenjt i ynë i kënduar, mori kryqin që lartazi me anën e një engjëlli me pamje shqiponje, këtu në vendin e shqiponjave. Me ndërmjetimet e dy shenjtorëve, o Krisht, mëshirona.

Tani *I Pentikostarit*

*[në periudhën e Pentikostarit;
ndryshe, Hyjlindësore*

Virgjëresh' e panusëuar që zure trupërisht Perëndinë pa tregim, nën' e Perëndisë së lartë, prit lutjet e shërbëtorëve të tu, o e gjith'panjollëshme, ti që u fal të gjith've paqësim mëkatesh, prit lutjet tona tani dhe lutu që të shpëtohen shpirtrat tanë.*]

Përlëshore

Ting. IV Tahí prokatálave

Kurorë lavdie që s'fishket,¹⁸ por shndrit plot shkëlqim,* e more në qiell prej Jisuit mbretit të Gjithësisë që jep dhunti,* o shën Joani ynë;* të nderojmë me mall ty,* kemi thesar lipsanin tënd, burimin e Hirit;* të falënderojmë dhe kërkojm' ndërmjetimin tënd.

Tani *I Pentikostarit*

*[në periudhën e Pentikostarit;
ndryshe, Hyjlindësore*

Misteri i fshehur prej jete¹⁹ dhe i panjohur ndër engjëjtë²⁰ u shfaq²¹ ndër të dheshmit me anën tënde, o Hyjlindëse, Perëndia që u mishërua me bashkim të papërzier dhe denjoi kryq për ne duke dashur, me të cilin ngjalli të parëgatuarin dhe shpëtoi prej vdekjes shpirtat tona.*]



NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë, Ndenjëso
Ting. I Ton tafon su Sotir*

E kishe ti zili* butësinë e mbretit,* Davidit famëmadh, që mëri s'mbante fare;* ai, midis të tjerash pra, i dha faljen kur Semei* e kish fyer rënd',*²² por o Joan Vladimir ti,* dhe parapra kisht,* dhurove ndjesë nga zemra* te vrasësi yt mizor.

Lavdi dhe Tani I Pentikostarit
[në periudhën e Pentikostarit;
ndryshe, Hyjlindëso

Na ngri, se ramë ne* në humner' dëshpërimi,* në tmerre, në trishtime dhe shkelle, o Vajzë;* shpëtim për mëkatarë je, ndihmë, mbrojtje me plot fuqi;* ndaj dhe na shpëton* ne shërbëtorët e tu ti,* Zonjë shën Mari,* o enë e respektuar* e Zotit Krisht Perëndi.]

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjëso
Ting. Tërth. I Ton sinánarhon Logon*

Nuk ke marrë në dorë porsi medalje, çmim* ndonjë kurorë të thjeshtë sipas zakonit, Joan,* por e prite vetë kokën tënde si trofe.* O mrekulli, çudi dhe tmerr!* Do të ish e pabesueshme, nëse s'kish vepruar* kështu dhe shën Dionisi, njeri zyrtar, me famë gjithashtu.

Lavdi dhe Tani I Pentikostarit
[në periudhën e Pentikostarit;
ndryshe, Hyjlindëso

Ki gaz, mal²³ krejt i shenjtë,²⁴ ku eci Zoti Krisht;*²⁵ gëzohu, ferrë e gjallë dhe e padjegur aspak;*²⁶ ti gëzohu, je e vetmja urë për botën* drejt Perëndisë, që na sjell* ne të vdekshmit për në jetën lart edhe të përjetshme,* ki gaz, Vajzë e gjithëpastër, shpëtim për ne, pa burrë linde ti.]

*Pas Polieleit Ndenjëso
Ting. Tërth. IV To prostahthén*

O besimtarë, me zë edhe nga zemra* me himne, këngë* shpirtërore²⁷ ta lëvdojmë* mburjen tonë të madhe,* shenjtin e bekuar,* pra shembullin e durimit të patëkeq,* sunduesin fort të dashur,* përdëllimtar,* me kujdes për nënshtetasit e tij; ai ndërmjeton për ne që duam qiellin* si qytetin ton' permanent.²⁸

Lavdi *dhe* Tani *I Pentikostarit*
[*në periudhën e Pentikostarit;*
ndryshe, Hyjlindësore

Si mori vesh porosin' e perëndi-
shme* engjëlli zbriti* në banesën e
Josifit* dhe ja pruri Marisë* menjë-
herë lajmin: * Anoi me bashkëzbritjen
q'ellin²⁹ mbi dhé* kur hyri i pandryshu-
ar* në gjirin tënd* dhe atë kur e shoh
me sy të mishëruar si rob³⁰ çuditem
dhe thërres me zë: * Gëzohu, nuse e
panusëruar.³¹ *]

Shkallesa. Antifoni i parë i Ting. IV
Proqimeni Ting. IV

I çuditshëm është Perëndia në shenjt-
orët e tij.

Varg: Te shenjtorët që janë në tokën
e tij, bëri mrekulli Zoti.

Ungjilli [Kërkoje në Mëngjesoren e
shën Dhimitrit, 26 tetor: Joan 15.17-
16.2]. Psalmi 50.

Lavdi. Me ndërmjetimet e athloforit.
Tani. Me ndërmjetimet e Hyjlindësës.
Përdëllemë, o Perëndi, *Dhe Idhiomeli.*

Ting. II

Je model për autoritetet, o hero i vir-
tytit, përderisa ishe i dëlirë në moralin
e jetës, i përpiktë në besimin unik të
saktë të Orthodhoksisë dhe i drejtë, i
mençur në qeverisjen e popullit tënd;

përgjëroju të tërëpushtetshmit Krisht
për ne, ushtarët e tij,³² në Kishën mili-
tante.

*Kanunet: I Pentikostarit [ose i Hyjli-
ndësës: Pasi kish kaluar, shih Shtojcën,
fq. 382] dhe i shenjtorit që ka Akrosti-
hidhë: “Admiroj zemërgjerësinë tënde,
o Joan. Ju.”. Zbritësoret e Pentikostarit*
[ose Ja gojën e çel tani, shih fq. 325]

Kanuni i shenjtit
Ting. Tërth. IV
Ode I
Igrân dhiodhefsas

Arkond, po filloj që të të himnoj* plot
me mallëngjim që nuk përshkruhet,
nuk shprehet dot;* më jep hirin tënd
tani, se ndihem i pafuqishëm, i pa-
denjë plotësisht.

Davidi e fali birin e tij,*³³ është e vë-
shtirë që të mbajë mëri një prind,*
por e tolerove ti kunatin* që kishte me-
ndje edhe shpirt të mbrapshtë tmerr.

Me zë pa u ndier dhe me psherë-
tim',* brenda teje sillje Psalmin ti, që
me hidhërim* thotë se, “të njohurit
dhe miqtë* qëndruan kundër dhe larg
meje³⁴ si armiq.”

Hyjlindësore

I miri, i dhembshuri që inat* s'mban
aspak³⁵ dhe nuk hakmerret, qiejt i uli

posht'²⁹* edhe zbriti brenda mitrës sate* dhe të tregoi Hyjlindëse të pacen.

Ode III
Uranias apsidhos

Reagimi s'të munda kur ligësinë e pe* që dinaku shfaqti se s'kishte frikë nga Zoti Krisht,*³⁶ kur poshtëronte pa turp* si kryqin edhe betimin* para tij me prapamendim djallëzor, pa shpirt.

O Joan Vladimir, shenjt i kënduar kudo,* që kujtimi yt ngazëllon të gjithë besnikët fort,* se udhëzon në virtyt,* përulësi, dashuri pra,* ndaj shijojmë lavdin e ndritshëm që të stolis.

Je si yll shpirtëror që shkëlqen me hir Kishën ti,* fluturove pasi shqiponja, engjëlli, zbriti posht',* këtu, prej qiellit lart* dhe kryqin e tërëshenjtë* të dhuroi pors thesar të paçmuar dot.

Hyjlindësore

Zure, e Tërëshenjtë, këtë që na këshillon* që të duam edhe armikun tonë,³⁷ si shembull pra* dha veten, kur lindi ky* prej teje dhe na pajtoi* ne me Atin;⁴ me mirënjohje të psalim ty.

Ndenjësores
Ting. III Thias písteos

Imitove drejt* mbretin e parë* të besnikëve* që ngriti kisha,* ndaj ndër-

tove me hir kishën e bukur ti,* të imitoi më pas bashkëshortja ty,* kur ngriti rreth kishës sate një manastir;* psalet që nga atëherë në të Jisui Krisht,* dhuruesi i jetës³⁸ dhe karizmeve.

I Pentikostarit
*[në periudhën e Pentikostarit;
ndryshe, Hyjlindësore]*

Virgjëreshë je,* tendë e hyjshme*³⁹ krejt për Fjalën Zot,* e vetmja pacen;* epërsi në qashtërsi ti ke mbi engjëjt;* i ndyrë jam më shumë se gjithë njerëzit,* plot me mëkate mishore,⁴⁰ pastromë pra,* me rrëqe të ndërmjetimeve pranë Birit tënd;* më jep ti përdëllimin e madh,^{15a} o e thjeshtë'.]

Ode IV
Si mu iskís Kirie

Epsalim kujtimin tënd të hijshëm, o i tërëlumur, meqenëse shkove pas gjurmëve⁴¹ të Mbretit të mbretërve⁸ dhe u sakrifikove vullnetarisht si ai;² kështu je bashkë me të në mbretërinë e tij.⁴²

Me zemërgjerësi⁴³ pengove oficerët e tu të hakmerren për vrasjen tënde të padrejtë, sepse dhe pas vdekjes e kurseje gjakun qoftë dhe të armiqve, sikurse Shpëtimtari që erdhi për shpëtim dhe jo për shkatërrim.⁴⁴

Është mirë të himnojmë me zell Joannin, të cilit iu pre koka padrejtësisht. Hyri në harenë e Zotit⁴⁵ dhe atje rri tok me Pagëzorin, emrin e të cilit ai mbante. Si ofrim te Krishti mbajnë kokat e tyre.

Hyjlindësore

Rimëkëmbe me lindjen tënde gjini-në tonë të rënë në greminën e mosbindjes,⁴⁶ o e Tërëshenjtë, kur the: “Ja shërbëtorja e Zotit, le të bëhet vullneti i tij”.⁴⁷ Ndërmjeto për ne pranë Birit tënd.

Ode V

Ina ti me aposo

Gjete, o sundimtar martir, për grua atë që ngjante me gruan e shenjtë, Elenën, të ëmën e mbretit të madh Konstandin; e kishe bashkëpunëtore në devotshmëri dhe në virtyt; e lumërojmë së bashku me ty.

E kishe si model gjatë gjithë jetës sate, Zotin e zotërve,⁸ Perëndinë mbi të gjitha,⁴⁸ mbretin e lavdisë,⁴⁹ prandaj the në fundin tënd thënien e tij: Askush nuk e rrëmben shpirtin tim, unë e jap atë me dëshirë.²

Rendim nën hijen e hirit tënd ne të pavyerit dhe të kërkojmë, o martiri ynë i hyjlavdëruar: Përgjëroju Krish-tit Shpëtimtar në qiell ku je tani, në

shkëlqimet e shenjtoreve,⁵⁰ të shpëtojë shpirtrat tanë.

Hyjlindësore

Ëmbëlsi pikuan malet⁵¹ dhe kodrat u ngjeshën me ngazëllim⁵² në lindjen tënde, o e tërëpacenuar, Vajzë e papikëluar, e kulluar, dhe pushoi thatësira e zymtë e vdekjes shpirtërore; si të të përhimnojmë?

Ode VI

Ilásthiti mi Sotír

Sipas proverbit që tha* i urti, nuk ishe mbret tiran, jo si të tjerët dhe ti,* se nuk zemëroheshe; tha: Kush veten qeveris* është më i mirë* se ai që një qytet zaptón.⁵³

I rritur me çdo virtyt* nuk humbje gjakftohtësinë dhe vetëkontrollin aspak,* edhe pse mes zhurmës shtetërore me turbullim;* kishe para syve* Zotin, o Joan, prezent gjithnjë.⁷

Në vendin tënd, o martir,* këndohet arritja jote, madhështia që mrekullon;* fitove mbi djallin që kurdisi një dorë pra* për krim krejt të turpshëm,* vrasjen tënde pa justifikim.

Hyjlindësore

Ëndje kam të të lëvdoj* gjithnjë, mbretëreshë Vajzë, nënë; në të dja-

thtë qëndron*⁵⁴ të Birit tënd të Tërë-fuqishëm, pas teje vjen* mbretëresha grua* shpresëplote e Joanit mbret.

Kontaqi

Ting. Tërth. IV Ti ipermaho

Të gjithë bashkë* le të psalim për sunduesin;* tok me pranverën* që aroma lulesh na lëshon,* ra kujtimi, panairi i lum i shenjtit,* por nderimi më i mirë është për atë* imitimi i virtytit që e kish ai;* i thërrasim ne:* Ki gaz, o shën Joan i madh.

Shtëpia

Kaini qëmoti e nxori dinakërisht vëllanë, Abelin, në fushë dhe e vrau pa mëshirë,⁵⁵ duke u bërë pikënisja e kriminelëve. Tani krushku keqbërës thirri me intrigë në qytetin e tij të afërmin dhe, pasi shkeli betimin, duke përdhosur kryqin jetëdhënës, e theri. Nuk u tremb nga shfuqizimi i shpatës, nuk u përkul nga zemërgjerësia e viktimitës trofeprurëse, së cilës i thërrasim ne: Ki gaz, o shën Joan i madh.

Sinaksari

Më 22 të të njëjtit muaj, kujtimi i martirit të shenjtë e të lavdëruar Joan Vladimiri, mbret mrekullibërës.

Vargje: Mospasja e mërisë, o i hyjkurorëzuar,/ të shkakttoi rreth në kokën e prerë.

Në të njëzet e dytën Joani mbajti kokën si trofe.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të shenjtë Vasilisku.

Vargje: Vasilisku, duke dhënë kokën në prerje,/ shkel kokën e gjarprit të lashtë.⁵⁶

Martiri i shenjtë Markelli mbaron, pasi e ujitën me plumb që vlonte.

Martiri i shenjtë Kodhri mbaron duke u zvarritur prej kuajsh.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martires së shenjtë Sofia mjeke.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i neomartirit oshënar Zaharia nga Bursa e Azisë së Vogël.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i neomartirit Pavli nga Tripoli i Peloponezit.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII

Theú singatávasin

Tani dhe përherë të këndojmë ty me zë të lartë, se e përsërite sjelljen e Çliruesit nga mëkatet tona, për të cilin tha profeti: Si qengj te therja u soll dhe si dele para atij që e qeth, duke mos e hapur gojën e tij.⁵⁷

Ëndërr e parealizueshme duket qëndrimi yt para bishës së egër, kunatit

tënd, o i fortë; jo vetëm se nuk çele gojën për ankesë, por e tejkalove profecinë,⁵⁷ duke folur dhe nxitur për vrasjen tënde; na mahnit toleranca jote.

Në altarin e besimit, o i tërëlumur i famshëm, u ofrove si fli pa cen,⁵⁸ si fruti i parë në kohën e prodhimeve të reja,⁵⁹ si zbutje pranë Krijuesit për paudhësitë tona, o Joan Vladimir, mbreti i paqes.

Hyjlindësore

Duke të përhimnuar, kërkojmë lutjen tënde para Birit tënd, o Hyjlindëse, froni keruvik i Krijuesit të gjithëpushtetshëm të Gjithësisë,⁶⁰ porta profetike⁶¹ e shpëtimit, dera dhe shkalla e qiellit,⁶² gëzohu!

Ode VIII

Eptaplasios káminon

Engrite kryqin tënd vullnetarisht⁶³ dhe jo detyrimisht, i lavdëruari Joan, dhe u bërë për ne pikërisht dhuratë nga Perëndia sipas emrin tënd; për çudinë që kreve, pra që mbajte kokën tënde, u shtang qielli.⁶⁴

O krenaria jonë më Krishtin, therorja jote lëshon aromë mendore; duke qenë mbret i krezmuar nga qielli, deshe Trininë e Tërëshenjtë dhe njeriun, ikonën e Perëndisë,⁶⁵ edhe kur ajo errësohet prej pasioneve.

Joani emërmadh nuk u trazua, nuk u befasua kur komploti u zbardh. Kishte në zemër Krishtin, paqen e botës,⁶⁶ Perëndinë e gjallë,⁶⁷ dhënësin e jetës³⁸ tokësore dhe qiellore, dhuruesin e drurit të jetës në Parajsë.⁶⁸ I themeluar në gurin e besës,⁶⁹ nuk u trondit.⁷⁰

Hyjlindësore

Ora e pranverës të këndon, o e hijshme midis grave,⁷¹ zambaku në livadhin⁷² e dëlirësisë, që solle në mish foshnjë, Perëndinjeriun, lulen e pavyshkur, dhe nuk u dogje nga zjarri i Hyjnisë; gjithë brezat të lumërojmë, sikurse parathe.⁷³

Ode IX

Eksesti epí tuto

A ka ndonjë guxim, forcë të tregoj'?* Le të vijë ai të rrëfejë, të thotë me hir* madhështinë mbi mendje, pa tregim,* të sjelljes së Joanit mbret,* si sakrifikim me vetëmohim* dhe ne të tjerët bashkë* t'i pleksim një kurorë* me lule pranverore shpirtërisht.

Na ka çuditur bindja, besimi yt* absolut tek ajo që tha Krishti Zot se s'duhet pra* që t'u kemi frikë të vdekshmëve* që vrasin trupin, por pastaj* s'munden të na bëjnë neve tjetër gjë,* se shpirti i njeriut* nuk vdes¹, por rron përherë* në Hadh - larg qoftë! - ose në Parajs'.

Je brenda lumërisë në qiell lart* dhe shijon ti frytdhënien e jetës që kreve në dhé,* se ti meriton çmim, o punëtor,* pra rrogën⁷⁴ e moralit tënd;* na kujto gjithmonë në përgjërime* tani që të kremtojmë* me ngazëllim të hyjshëm* dhe të këndojmë ne melodikisht.

Hyjlindësore

Umbushëm me hare për kujtimin tënd* të shkëlqyer, që na frymëzon gjithnjë dhe na ngushëllon,* kur ne përballojmë vështirësi,* prandaj të mburrim dhe lëvdojmë* Perëndinë Zot që të dha fuqi* të triumfosh lavdishëm;* me Vajzën, mbretëreshën,* pra nënën e atij për ne lyp ti.

Dërgimësore

Jinekes akutisthite

Elusim plot me hijeshi* Joani, Vladimirin sot,* se shprehjen e përmbushi ky,* që tha Psalmisti i shenjtë,* se ishte gati përherë* që të vdiste çdo ditë,*⁷⁵ kështu s'u tremb aspak, kur pa* të ngrihet shpatë armiku,* nuk humbi mendjen, durimin.

Dhe e Pentikostarit

*[në periudhën e Pentikostarit;
ndryshe, Hyjlindësore*

Profetë parashpallën fort,* apostuj na mësuan drejt,* dëshmorë tok përëndishëm,* Hyjlindëse, Birin tënd pra;* e deklaruan Perëndi* të kozmosit, e pastër krejt;* të madhështojmë ne me ta,* se nga dënimi i lashtë*⁷⁶ me hirin tënd u çliuam.]

Lavdërime

Ting. I Ton uranion tagmaton

Erdhëm nga vendet e ndryshme, u mblodhëm me besim,* me ngazëllim, hare, gaz,* me pranverë në zemër.* Mbreti i lavdishëm, margaritar* dashurie që s'tundej dot,* shndriti virtytin e tij më fort se një rreth* mbretëror, ndaj feks në qiell lart.

Vullnetarisht u flijove për hir të Krishtit tënd,* shkëmbeve pra kurorën* mbretërore në tokë* me atë që s'vysket në qiell dot;*¹⁸ siç të tha tërëmbreti Zot* disi përmes një shqiponje, Kryqin e tij* ti e ngrite,⁶³ të himnoj më pra.

Orthodhoksia shkëlqente në shtetin tënd, martir,* megjithëse luftohej* nga mjaft ujqër të egër,*⁷⁷ ti e mbroje meqë ekskluzivisht* e vërteta është vetëm kjo,* larg Kishës që është një, heretikët jan',* pra nuk luaje me shpirtin tënd.

Ke imituar arkondin e paqes, Zotin¹⁵ mbret,* nuk humbe paqen tënde,* por ke thënë: “Me dashje* shpirtin tim e lë,² edhe pse, kunat* intrigues, nuk mundesh dot* ta marrësh ti”;² ndaj lipsanet e tua ne,* o martir, i kemi si thesar.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

Të trumbetojmë me borinë e Psalmit, të kërcejmë dhe të duartrokasim me ngazëllim pa masë, duke kremtuar shenjtin tonë Joan Vladimir; sipas emrit të tij u shfaq zot i paqes;¹⁵ i padjallëzuar, i drejtë, i pastër në etikë dhe në besë, na tregon udhën e mbretërisë qiellore. Përgjëroju, o i urtë, Krijuesit dhe Sundimtarit të Gjithësisë, të na forcojë dhe ne të të ngjasim sadopak.

Tani *I Pentikostarit*
[në periudhën e Pentikostarit;
ndryshe, Hyjlindësore

Ty të lumërojmë, o Hyjlind'se e virgjër dhe të lavdërojmë ne besnikët siç të ka hije ty, qytetin e patundshëm dhe murin që s'çahet dot, mbrojtjen e pa thyeshme dhe strehën e shpirttrave tanë.]

Dhoksologjia e Madhe

Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanuni i shenjtit, Ode III dhe VI. Kontaqi i Pentikostarit [ose Mbrojtje e paturpëruar] Kungatore [e Pentikostarit ose]: Në gjithë dheun.

CITIME

¹ Matth. 10.28; Lluk. 12.4

² Joan 11.15-18

³ Matth. 10.23

⁴ Rom. 5.7-10

⁵ Ligji i Dytë 6.5; Mark. 12.30; Lluk. 10.27

⁶ Joan 14.15

⁷ Ps. 15(16).8

⁸ I Tim. 6.15; Apok. 17.14; 19.16

⁹ Lluk. 22.25

¹⁰ Joan 1.14; 3.16,18; I Joan 4.9

¹¹ Eks. 19.6; 23.22; I Petr. 2.9; Apok. 1.6; 5.10

¹² Matth. 25.21,23

¹³ Matth. 5.39; Lluk. 6.29

¹⁴ I Mbret. [Sam.] 2.27 etj.

¹⁵ Is. 9.6

^{15a} Num.14.19 etj.

¹⁶ Matth. 7.15

¹⁷ Gal. 5.22; Ef. 5.9

¹⁸ I Petr. 5.4

¹⁹ Ef. 3.9

²⁰ I Petr. 1.12

²¹ Kol. 1.26

²² II Mbret. [Sam.] 16.5-13; 19.18-23

²³ Abak. 3.3; Dan. 2.34-35

²⁴ Ps. 2.6 etj.; II Petr. 1.18

²⁵ Eks. 19.11,20; II Petr. 1.18

²⁶ Eks. 3.2

²⁷ Ef. 5.19; Kol. 3.16

²⁸ Fil. 3.20; Hebr. 13.14

²⁹ II Mbret. [Sam.] 22.10; Ps. 17(18).10; 143(144).5

- ³⁰ Fil. 2.7
³¹ Lluk. 1.28
³² II Tim. 2.3
³³ II Mbret. [Sam.] 18.5-33
³⁴ Ps. 37(38).12
³⁵ Ps. 102(103).8-9; Jer. 3.12
³⁶ Ps. 13(14).3; Rom. 3.18; II Kor. 5.11
³⁷ Matth. 5.44; Lluk. 6.27,35
³⁸ Joan 6.33; 10.28; 17.2; Vep. 17.25
³⁹ Ps. 131(132).5; Hebr. 9.1-2
⁴⁰ Juda 23
⁴¹ I Petr. 2.21
⁴² Lluk. 23.43
⁴³ Fja. Urt. 7.3; 22.20
⁴⁴ Lluk. 9.56
⁴⁵ Matth. 25.21,23
⁴⁶ Gjen. 3.2-6
⁴⁷ Lluk. 1.38
⁴⁸ Rom. 9.5
⁴⁹ Ps. 23(24).7 etj.
⁵⁰ Ps. 109(110).3
⁵¹ Amos 9.13; Joel 4(3).18
⁵² Ps. 64(65).13
⁵³ Fja. Urt. 16.32
⁵⁴ Ps. 44(45).10
⁵⁵ Gjen. 4.8; I Joan 3.12
⁵⁶ Gjen. 3.15
⁵⁷ Is. 53.7
⁵⁸ Lev. 1.3
⁵⁹ Eks. 22.29
⁶⁰ Jez. 10.1
⁶¹ Jez. 44.1-4
⁶² Gjen. 28.12-17
⁶³ Matth. 16.24; Mark. 8.34; 10.21;
Lluk. 9.23
⁶⁴ Jer. 2.12
⁶⁵ Gjen. 1.26-27; 5.1; 9.6; Urt. Sol. 2.23;
Sirak 17.3
⁶⁶ Ef. 2.14
⁶⁷ Jis. N. 3.10; I Tim. 3.15 etj.
⁶⁸ Gjen. 2.9; 3.22; Apok. 2.7; 22.2,14
⁶⁹ Matth. 16.18
⁷⁰ Matth. 7.24-25; Lluk. 6.48
⁷¹ Kënga 1.8; 5.9; 6.1(5.17)
⁷² Kënga 2.1
⁷³ Lluk. 1.48
⁷⁴ Matth. 10.10; Lluk. 10.7; I Tim. 5.18
⁷⁵ Ps. 43(44)23; Rom. 8.36
⁷⁶ Gjen. 3.16-19
⁷⁷ Vep. 20.29



MË 25 TË TË NJËTIT MUAJ

Gjetja e Tretë e kokës së shenjtë të Pararendësit.

Tipikon

1. Nëse bie në javën pas Miropurëseve ose të të Paralizuarit, ose të Samaritanes, ose të të Verbrit (përveç Mbylljeve të tyre):

Shërbesa bëhet sipas Mujorit. Përlëshoret: në javën e Miropurëseve: Bujari Josif; Kur zbritte te vdekja. Lavdi i Pagëzorit, Tani Grave miropurëse; në javët e tjera: ngjallësore, Lavdi i Pagëzorit, Tani Hyjlindësore ngjallësore (Misteri i fshehur). Në Mëngjesore, Ndenjësoret e Pagëzorit dhe nga një e së kremtes. Zbritësoret e Pashkës, por të hënë pas të Verbrit, Zbritësoret e Analipsit (Shpëtimtar Perëndi). Kontaqi: në javën pas Miropurëseve, Kontaqi i tyre; në javët e tjera, i Pashkës. Apostulli, Ungjilli dhe Kungatore, të Pagëzorit.

2. Nëse bie të shtunën (d.m.th. në Mbylljen) e Miropurëseve ose të Samaritanes:

Në Mbrëmësore, Thirrtoret: 3 të së kremtes dhe 3 të Pagëzorit. Lavdi i Pagëzorit. Tani [Lavdi] i së kremtes. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Pasvargjet: ngjallësorja e parë dhe të Pagëzorit. Lavdi i Pagëzorit. Tani [Lavdi] i së kremtes. Përlëshoret: në Mbylljen e Miropurëseve: Bujari Josif; Kur zbritte te vdekja. Lavdi i Pagëzorit, Tani Grave miropurëse; në Mbylljen e Samaritanes: ngjallësore (Lëçitjen gazmore). Lavdi i Pagëzorit, Tani Hyjlindësore ngjallësore (Misteri i fshehur).

Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë, Ndenjësoret ngjallësore. Pas Stihologjisë së dytë dhe Polieleit, Ndenjësoret e Pagëzorit dhe, në vend të Hyjlindësoreve, të së kremtes. Shkallesat. Antifoni i parë Tëng. IV. Proqimeni. Ungjilli i Pagëzorit. Ne që pamë ngjalljen. Psalmi 50 (hima) etj. të Pagëzorit. Kanunet: i së kremtes dhe i Pagëzorit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e së kremtes. Ndenjësoret: e Pagëzorit dhe e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Pagëzorit dhe Sinaksari. Zbritësoret e Pashkës. Më të nderuarën. Dërgimësoret: e Pagëzorit dhe e së kremtes. Lavdërimet: 3 ngjallësore dhe 3 të Pagëzorit. Lavdi i Pagëzorit, Tani [Lavdi] i së kremtes. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e Pagëzorit.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: a) në Mbylljen e Miropurëseve: Bujari Josif; Kur zbritte te vdekja; Grave miropurëse; e

Pagëzorit dhe e kishës; b) në Mbylljen e Samaritanes: ngjallësore (Lëçitjen gazmore), e Pagëzorit dhe e kishës. Kontaqi: në Mbylljen e Miropurësive, Kontaqi i tyre; në Mbylljen e Samaritanes, Kontaqi i Pashkës. Apostulli dhe Ungjilli i Pagëzorit. Të meriton. Kungatore: Në kujtim të përjetshëm.

3. Nëse bie të dielën e të Paralizuarit ose të Samaritanes, ose të të Verbrit:

Të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 4 ngjallësore, 3 të së kremtes dhe 3 të Pagëzorit. Lavdi i së kremtes. Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Pasvargjet: ngjallësore e para dhe të Pashkës (Le të ngrihet Perëndia; Pashka hierore etj.). [Nëse kisha mban emrin e Pagëzorit: ngjallësorja e parë dhe Pasvargjet e Pagëzorit]. Lavdi i Pagëzorit. Tani i së kremtes. Përlëshoret: a) të Dielën e të Paralizuarit: ngjallësore (Le të dëfrenjë qielloret), Lavdi i Pagëzorit, Tani Hyjlindësore ngjallësore (Misteri i fshehur); b) të Dielën e Samaritanes: ngjallësore (Lëçitjen gazmore), Lavdi i Pagëzorit, Tani Përlëshorja e Mespentikostisë; c) të Dielën e të Verbrit: ngjallësore (Fjalën e panisëshme), Lavdi i Pagëzorit, Tani Hyjlindësore ngjallësore (Misteri i fshehur).

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmi 50, Kanuni Triadik, Litia e së kremtes: Idhiomeli i shenjtorit të kishës, Lavdi si dhe Tani i së kremtes. Himne triadike. Trishenjtë. Përlëshorja e së kremtes. Në Mëngjesor, pas Stihologjisë së parë, Ndenjësorja e parë e Stihologjisë së parë të së kremtes; Lavdi Ndenjësorja e parë e Pagëzorit. Tani Hyjlindësorja e Stihologjisë së parë të së kremtes. Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësorja e parë e Stihologjisë së dytë të së kremtes; Lavdi Ndenjësorja e dytë e Pagëzorit; Tani Ndenjësorja e dytë e Stihologjisë së dytë të së kremtes. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimeni i Tingullit. Kanunet: i Pashkës [të Pentikostarit në 4] dhe i Pagëzorit në 4. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e Pagëzorit dhe Ndenjësoret: e Pagëzorit dhe e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e së kremtes. Sinaksari i ditës dhe i së kremtes. Zbritësoret e Pashkës, por të Dielën e të Verbrit, Zbritësoret e Analipsit (Shpëtimtar Perëndi); dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Në vend të Më të nderuarën, Ode IX e Kanuneve. Dërgimësoret: e Pashkës, e Pagëzorit dhe e së kremtes. Lavdërimet: 4 ngjallësore, 4 të Pagëzorit dhe të Pashkës (Le të ngrihet Perëndia; Pashka hierore etj.). Lavdi i së kremtes. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore (të Dielën e Samaritanes, e Mespentikostisë), e Pagëzorit dhe e kishës.

Kontaqi i Pashkës. Apostulli i Pagëzorit. Ungjilli i së kremtes. Në vend të Të meriton, Irmosi i Odes IX i Pashkës (ose i së kremtes, siç përcakton Pentikostari). Kungatore e Pashkës [dhe Në kujtim të përjetshëm]. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.

4. Nëse bie të martën (d.m.th. në Mbylljen) e të Paralizuarit ose të të Verbrit:

Në Mbrëmësore, Thirrtoret: 3 të së kremtes dhe 3 të Pagëzorit. Lavdi i Pagëzorit. Tani [Lavdi] i së kremtes. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Pasvargjet e Pagëzorit. Lavdi i Pagëzorit. Tani [Lavdi] i së kremtes. Përlëshoret: ngjallësore. Lavdi i Pagëzorit. Tani Hyjlindësore ngjallësore (Misteri i fshehur).

Në Mëngjesore, Ndenjësoret e Pagëzorit dhe, në vend të Hyjlindësoreve, e së kremtes. Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV. Proqimeni dhe Ungjilli i Pagëzorit. Ne që pamë ngjalljen. Psalmi 50 (hima) etj. të Pagëzorit. Kanunet: i së kremtes dhe i Pagëzorit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e së kremtes. Ndenjësoret: e Pagëzorit dhe e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Pagëzorit dhe Sinaksari. Zbritësoret: në Mbylljen e të Paralizuarit, të Pashkës; në Mbylljen e të Verbrit, e Analipsit (Shpëtimtar Perëndi). Më të nderuarën. Dërgimësoret: e Pagëzorit dhe e së kremtes. Lavdërimet e Pagëzorit. Lavdi i Pagëzorit. Tani [Lavdi] i së kremtes. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e Pagëzorit.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e Pagëzorit dhe e kishës. Kontaqi i Pashkës. Apostulli dhe Ungjilli i Pagëzorit. Të meriton. Kungatore: Në kujtim të përjetshëm. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.

5. Nëse bie të mërkurën e Mespentikostisë:

Në Mbrëmësore, pas Qëndrimit të parë të Psaltirit (Lum ai njeri), Thirrtoret: 3 të së kremtes dhe 3 të Pagëzorit. Lavdi i Pagëzorit. Tani i së kremtes. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e së kremtes. Pasvargjet e së kremtes. (Ose një e së kremtes dhe të Pagëzorit, nëse kisha mban emrin e tij). Lavdi i Pagëzorit. Tani i së kremtes. Përlëshoret: e së kremtes, e Pagëzorit dhe përsëri e së kremtes.

Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë dhe të dytë, Ndenjësoret e Pagëzorit dhe, në vend të Hyjlindësoreve, Ndenjësoret e së kremtes. Pas Polieleit, Ndenjësoret e Pagëzorit dhe një e së kremtes (Ndenjësoerja e parë pas Odes III). Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV. Proqimeni dhe Ungjilli i Pagëzorit. Ne që pamë ngjalljen. Psalmi 50 (hima) etj. të Pagëzorit. Kanunet: të dy të së kremtes dhe i

Pagëzorit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e Pagëzorit, Ndenjësoja e Pagëzorit dhe e dyta e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e së kremtes. Sinaksari i ditës dhe i së kremtes. Zbritësoret e së kremtes (Detin e mpikse). Në vend të Më të nderuarën, Ode IX e Kanuneve. Dërgimësoret: e së kremtes, e Pagëzorit dhe përsëri e së kremtes. Lavdërimet: 3 të së kremtes dhe 3 të Pagëzorit. Lavdi i Pagëzorit. Tani i së kremtes. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e së kremtes.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e së kremtes dhe e Pagëzorit. Kontaqi i së kremtes. Apostulli i Pagëzorit dhe Ungjilli i së kremtes. Në vend të Të meriton, Zbritësoja e Odes IX e së kremtes. Kungatore e së kremtes [dhe Në kujtim të përhjetshëm]. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.

6. Nëse bie në ditët Paskremtore të Mespentikostisë

(përveç së shtunës pas së kremtes dhe të Dielës së Samaritanes):

Shërbesa kryhet sipas Mujorit së bashku me troparet Paskremtore. Zbritësoret Detin e mpikse. Në Liturgji, Kontaqi i së kremtes. Apostulli, Ungjilli dhe Kungatore (Në kujtim të përhjetshëm) të Pagëzorit.

7. Nëse bie të shtunën pas Mespentikostisë:

Në Mbrëmësore, Thirrtoret e Pagëzorit në 6. Lavdi i Pagëzorit. Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës që po kalon (Si të mos admirojmë). Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Pasvargjet: Paskremtori i parë dhe të Pagëzorit. Lavdi i Pagëzorit. Tani i së kremtes. Përlëshoret: e së kremtes, e Pagëzorit dhe përsëri e së kremtes.

Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë, Ndenjësoje Paskremtore (ngjallësore). Pas Stihologjisë së dytë dhe Polieleit, Ndenjësoret e Pagëzorit dhe, në vend të Hyjlindësoreve, të dyja Ndenjësoret e së kremtes. Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV. Proqimeni dhe Ungjilli i Pagëzorit. Ne që pamë ngjalljen. Psalmi 50 (hima) etj. të Pagëzorit. Kanunet: i së kremtes dhe i Pagëzorit. Pas Odes III, Ndenjësoret: e Pagëzorit dhe një e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Pagëzorit dhe Sinaksari. Zbritësoret e Pashkës. Më të nderuarën. Dërgimësoret: e Pagëzorit dhe e së kremtes. Lavdërimet: 3 Paskremtore (ngjallësore) dhe 3 të Pagëzorit. Lavdi i Pagëzorit. Tani i së kremtes. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e Pagëzorit.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e së kremtes, e Pagëzorit dhe e kishës. Kontaqi i së kremtes. Apostulli dhe Ungjilli i Pagëzorit. Kungatore: Në kujtim të përjetshëm. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.

8. Nëse bie të mërkurën e Mbylljes së Mespentikostisë:

Në Mbrëmësore, Thirrtoret: 3 të së kremtes dhe 3 të Pagëzorit. Lavdi i Pagëzorit. Tani i së kremtes. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Pasvargjet e së kremtes. Lavdi i Pagëzorit. Tani i së kremtes. Përlëshoret: e së kremtes, e Pagëzorit dhe përsëri e së kremtes.

Në Mëngjesore, Ndenjësoret e Pagëzorit dhe, në vend të Hyjlindësoreve, Ndenjësoret e së kremtes. (Në vend të Hyjlindësoreve pas Polieleit, Ndenjësoresja e parë e së kremtes pas Odes III). Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV. Proqimeni dhe Ungjilli i Pagëzorit. Ne që pamë ngjalljen. Psalmi 50 (hima) etj. të Pagëzorit. Kanunet: të dy të së kremtes dhe i Pagëzorit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e Pagëzorit. Ndenjësoresja e Pagëzorit dhe (e dyta) e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e së kremtes dhe Sinaksari. Zbritësoret e së kremtes (Detin e mpikse). Në vend të Të meriton, Ode IX e Kanuneve. Dërgimësoret: e së kremtes, e Pagëzorit dhe përsëri e së kremtes. Lavdërimet: 3 të së kremtes dhe 3 të Pagëzorit. Lavdi i Pagëzorit. Tani i së kremtes. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e së kremtes.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e së kremtes dhe e Pagëzorit. Kontaqi i së kremtes. Apostulli dhe Ungjilli i Pagëzorit. Në vend të Të meriton, Zbritësorja e Odes IX. Kungatore e së kremtes [dhe Në kujtim të përjetshëm]. Krishti u ngjall. Emri i Zotit.

9. Nëse bie të mërkurën e Mbylljes së Pashkës:

Në Mbrëmësore, Pas Krishti u ngjall (10x) dhe Paqësoreve, Thirrtoret: 6 ngjallësore (Ting. I) dhe 3 të Pagëzorit (në 4). Lavdi i Pagëzorit. Tani Hyjlindësore dogmatike (Ting. I). Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Pasvargjet: ngjallësore e para (Ting. I) dhe të Pashkës (Le të ngrihet Perëndia; Pashka hierore etj.). Lavdi i Pagëzorit. Tani Dit' e ngjalljes. Krishti u ngjall (3x), Përlëshorja e Pagëzorit, Lavdi dhe Tani Hyjlindësore ngjallësore (Misteri i fshehur). Përlëshim dialogjikisht.

Në Mëngjesore, pas Krishti u ngjall (10x), Përlëshorja e Pagëzorit, Lavdi dhe Tani Hyjlindësore ngjallësore (Misteri i fshehur). Pas Paqësoreve menjëherë (Polielei dhe) Ndenjësorja pas Polieleit. Lavdi dhe Tani Hyjlindësore ngjallësore (Josifi u çudit). Shkallesat dhe i gjithë rendi i Ungjillit të Pagëzorit (që lexohet nga Dera e Bukur). Ne që pamë ngjalljen (3x), (nuk lexohet Psalmi 50) dhe menjëherë Lavdi Me ndërmjetimet e Pagëzorit. Tani Me ndërmjetimet e Hyjlindëses. Përdëllemë, o Perëndi dhe Idhiomeli. O Perëndi, shpëto popullin tënd dhe beko trashëgimin tënd, vështroje. Kanunet: i Pashkës dhe i Pagëzorit. Në fundin e çdo Ode, Zbritësorja e Pashkës, Krishti u ngjall (3x), Kur u ngrit Jisui, dhe Përsëri dhe përsëri. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e Pagëzorit dhe Ndenjësorja e tij, Lavdi dhe Tani Hyjlindësore [e ngjashme]: Zure të bashk'fronshmin Bir, të bashkëqenshmin,* me prind Atin, e dëlir',* kur erdhi Shpirt i Tërshenjt'* nga lart me zë engjëllor,⁵⁰ o nën'* e Zotit Krisht, për Adamin rithirrje je. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Pashkës dhe Sinaksari. Në vend të Më të nderuarën, Ode IX e Kanuneve (në dy troparet e fundit, Lavdi dhe Tani me Madhështimet e Pashkës). Dërgimësoret: e Pashkës, e Pagëzorit dhe përsëri e Pashkës. Lavdërimet: 4 ngjallësore, 3 të Pagëzorit (në 4) dhe të Pashkës (Le të ngrihet Perëndia; Pashka hie-rore etj.). Lavdi i Pagëzorit. Tani Dit' e ngjalljes, Krishti u ngjall (3x) dhe Përlëshorja e Pagëzorit.*

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Krishti u ngjall, Ipakoia, Përlëshorja e Pagëzorit. Kontaqi i Pashkës. Sa u pagëzuat. Apostulli dhe Ungjilli i Pagëzorit. Në vend të Të meriton, Një engjëll i thërriste; Ndriçohu, ndriçohu. Kungatore e Pashkës [dhe Në kujtim të përjetshëm]. Në vend të Pamë dritën, Krishti u ngjall. Në vend të Emri i Zotit, Krishti u ngjall (3x shpejt në Ting. II). Përlëshim dialogjikisht.

10. Nëse bie të enjten e Analipsit (Ngjitjes në Qiej):

Shërbesa e Pagëzorit transferohet dhe psalet të nesërmen (shih §11).

11. Nëse bie në ditët Paskremtore të Analipsit (Ngjitjes në Qiej) ose të Pentikostisë

(përveç Mbylljeve të tyre dhe të së Hënës së Shpirtit të Shenjtë):

Shërbesa bëhet sipas Mujorit. Zbritësoret (e dyta) e Pentikostisë (Mjegull e mbuloj). Më të nderuarën. Në Liturgji Antifonet, Hyrtorja dhe Kontaqi i së kremtes.

Apostulli dhe Ungjilli i Pagëzorit. Të meriton. Kungatore Në kujtim të përjetshëm. Në vend të Pamë dritën, Përlëshorja e Analipsit; por pas Pentikostisë, Pamë dritën.

12. Nëse bie të Dielën e Etërve të shenjtë të Sinodit të Parë Ekumenik:

Në Mbrëmësore, Thirrtoret: 4 ngjallësore, 3 të Etërve dhe 3 të Pagëzorit. Lavdi i Etërve. Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e Etërve. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i Pagëzorit. Tani i Analipsit (Kërkoje të enjten pas së Dielës së Etërve, në fund të Mëngjesores). Përlëshoret: ngjallësore, e Etërve, Lavdi i Pagëzorit, Tani i Analipsit.

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmi 50, Kanuni Triadik, Litia e Etërve: Idhiomeli i shenjtori të kishës, Lavdi si dhe Tani i Etërve. Himne Triadike. Trishenjtë. Përlëshorja e Etërve. Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë dhe të dytë, Ndenjësoret e Pentikostarit. Pas Polieleit, Ndenjësoja (Pas Polieleit) e Pagëzorit (Pagëzor, Irodhi mbret). Lavdi dhe Tani i Analipsit (kërkoje në Tani i Etërve pas Odes III). Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimeni i Tingullit. Kanunet: ngjallësor, i Etërve dhe i Pagëzorit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e Pagëzorit. Ndenjësoret: e Etërve (e dyta). Lavdi i Pagëzorit. Tani i Analipsit (kërkoje në të kremten e tij pas Odes III). Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Etërve dhe Sinaksari i ditës dhe i Pentikostarit. Zbritësoret e Pentikostisë (vetëm të Ting. IV, Mjegull e mbuloj); dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor të Tingullit. Më të nderuarën. Dërgimësoret: ngjallësore, e Etërve, e Pagëzorit dhe e Analipsit. Lavdërimet: 2 ngjallësore, 3 të Etërve dhe 3 të Pagëzorit. Lavdi i Etërve. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Antifonet e Analipsit (por me: ... që u ngjalle prej së vdekurish, vetëm këtu dhe jo në Hyrtoren). Hyrtorja e Analipsit. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e Analipsit, e Etërve, e Pagëzorit dhe e kishës. Kontaqi i Analipsit. Apostulli i Pagëzorit dhe Ungjilli i Etërve. Të meriton. Kungatore: [Lavdërojeni dhe] Në kujtim të përjetshëm.

13. Nëse bie të premten e Mbylljes së Analipsit (Ngjijtes në Qiej):

Në Mbrëmësore, pas Qëndrimit të parë të Psaltirit, Thirrtoret: 6 të së kremtes dhe 3 të Pagëzorit në 4. Lavdi i Pagëzorit. Tani i së kremtes. Hyrje. O dritë gaz-

more. Proqimeni i ditës. Pasvargjet e së kremtes. Lavdi i Pagëzorit. Tani i së kremtes. Përlëshoret: e së kremtes, e Pagëzorit dhe përsëri e së kremtes.

Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë, Ndenjësorja e së kremtes (2x). Pas Stihologjisë së dytë dhe Polieleit, Ndenjësoret e Pagëzorit dhe, në vend të Hyjlindësoreve, të së kremtes. Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV. Proqimeni dhe Ungjilli i Pagëzorit. Ne që pamë Ngjalljen. Psalmi 50 (hima) etj. të Pagëzorit. Kanunet: të dy të së kremtes dhe i Pagëzorit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e Pagëzorit. Ndenjësorja e tij dhe e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e së kremtes dhe Sinaksari. Zbritësoret e Pentikostisë (vetëm të Ting. IV, Mjegull e mbuloj). Në vend të Më të nderuarën, Ode IX e Kanuneve. Dërgimësoret: e së kremtes, e Pagëzorit dhe përsëri e së kremtes. Lavdërimet: 3 të së kremtes dhe 3 të Pagëzorit. Lavdi i Pagëzorit. Tani i së kremtes. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e së kremtes.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e së kremtes. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e së kremtes dhe e Pagëzorit. Kontaqi i së kremtes. Apostulli dhe Ungjilli i Pagëzorit. Në vend të Të meriton, Irmosi i Odes IX i Kanunit të parë të së kremtes (Ty, o nën' e Perëndisë). Kungatore e së kremtes [dhe Në kujtim të përjetshëm]. Në vend të Pamë dritën, Përlëshorja e së kremtes.

14. Nëse bie të shtunën e Shpirtrave:

Shërbesa transferohet dhe psalet një ditë më parë, të Premten (shih §13).

15. Nëse bie të dielën e Pentikostisë:

Shërbesa transferohet dhe psalet të nesërmen (shih §16).

16. Nëse bie të hënën e Shpirtit të Shenjtë:

Në Mbrëmësoren (e Gjunjzimit), Thirrtoret: 3 të Pentikostarit dhe 3 të Pagëzorit. Lavdi i Pagëzorit. Tani i Pentikostarit. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i Madh. Uratat e gjunjzimit. Pasvargjet e Pentikostarit. Lavdi i Pagëzorit. Tani i Pentikostarit. Përlëshoret: e së kremtes, e Pagëzorit dhe përsëri e së kremtes.

Në Mëngjesore, Ndenjësoret e Pagëzorit dhe, në vend të Hyjlindësoreve, Ndenjësoret e Pentikostarit (pas Ndenjësores së Polieleit, Ndenjësorja e tretë e së kremtes, të Pentikostarit). Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV. Proqimeni dhe Ungjilli i Pagëzorit etj. të tij. Kanunet: të dy të Pentikostarit dhe i Pagëzorit. Pas

Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e Pagëzorit. Ndenjësorja e Pagëzorit dhe e Pentikostarit. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Pentikostarit. Sinaksari i ditës dhe i Pentikostarit. Zbritësoret dublikate të së kremtes. Në vend të Më të nderuarën, Ode IX e Kanuneve. Dërgimësoret: e para e Pentikostarit, e Pagëzorit dhe e dyta e Pentikostarit. Lavdërimet: 3 të Pentikostarit dhe 3 të Pagëzorit. Lavdi i Pagëzorit. Tani i Pentikostarit. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e së kremtes.

Në Liturgji. Antifonet dhe Hyrtorja e së kremtes. Përlëshoret: e Pentikostarit dhe e Pagëzorit. Kontaqi i Pentikostarit. Sa u pagëzuat. Apostulli i Pagëzorit dhe Ungjilli i Pentikostarit. Në vend të Të meriton, Zbritësorja e dytë e Odes IX e së kremtes (O Hyjlindëse Virgjëreshë). Kungatore e Pentikostarit [dhe Në kujtim të përjetshëm]. Pamë dritën.



NË MBRËMËSORE

*Pas Qëndrimit të parë të Psaltirit
(Lum ai njeri)*

Thirrtoret:

3 të Pentikostarit dhe 3 të Pagëzorit:

Ting. Tërth. IV

O tu paradhoksu thávmatos

Më fort se ndriçimi diellor feksi, i lumi Joan,* o Prodhrom, koka jote pra,* kur nga toka lindi kjo,* dhe shndrit tërë besnikët krejt;* duke e pasur porsi thesar hyjnor,* nxjerrim ne hir pa kursim edhe kështu* po shenjtërohemi* dhe në shpirt, në trup si dhe në mendje tok;* duke bërë pa-nair të lumërojmë ty.

O i lumi Pagëzor, prifti hyjmenës pa dijeni,* lajmërohet për kryen tënd* që buron hir pa pushim,* sepse është i hyjshëm krejt;* me hir nxiton edhe me besim arrin* qartë ta gjejë edhe kështu ai* të shenjtërohet tok* dhe me mbretin që forcon me zell e zjarr* besën orthodhokse dhe me popullin besnik.

O Prodhrom i Zotit, kokën tënde të nderuar me lavd,* që nga zelli hyjnor u pre,*¹ e kurorëzoi pra* Shën Trinia; kremtojmë ne* shfaqjen e tretë, në të gëzohen tok* rendet e engjëjve dhe martirëve,* grupi apostolik* i hyjnueshëm dhe çdo profet, sepse* na u gjet; me ta gjithnjë kujtona, o zëmadh.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

Si thesar dhuratash hyjnore lindi kryeja jote, që ruhet nga Perëndia, nga barku i dheut, o Prodhrom; pasi e nxorëm ne me besim dhe i falemi, pasurohemi falë teje, o Pagëzor i lavdëruar i Krishtit, me çuditë paradoksale dhe ndjesën e fajeve.

Tani *I Pentikostarit*

Hyrje. O dritë gazmore.

Proqimeni i ditës.

Pasvargje

Ting. II Ote ek tu ksilu se

Gjithë* besimtarët ejani,* ta lëvdojmë kokën e çmuar të Pagëzorit Joan,* që u pre me shpatë¹ dhe le ta mikpresim sot* me këndime, me mall ta mburrim, se na u shfaq kjo,* na derdh hir shërimesh²; pra Hirodhi mbret i marr'* pa mend, e ka prerë qëmoti* kur nga epshi ish shtyrë pa fre* me Hirodhia-dhën të bashkohej ky.³

Varg: Atje do të lind bri për Davidin.

Siç shndrit* ari përmbi çdo metal,* koka e Prodhromit shkëlqen fort nga dheu, mbi enë feks,* flet fuqishëm dhe qorton kurorëshkeljen³ drejt* si dhe vrasjen që kreu mbreti pa turp, Hirodhi,*¹ por ne na ndriçon me rreze mendjen; ndaj këtë* me besim ta

puthim, me himne* ta nderojmë sot, se për ne kjo* ndërmjeton te Perëndia ynë Zot.

Varg: Përgatita kandil për të lyerin tim.

Koka* e Prodhromit fshehur ish* në një enë prej shumë kohësh brenda në dhé, por që sot* po zbulohet anembanë dhe derdh pasuri,* si burim mjaft i madh shërimesh edhe sëmundjet* kjo na i shëron,⁴ ndriçon dhe shpirtrat, ndaj shijojm'* çdo hir lehtësimi të gjithë,* rrjedhimisht le ta përhimnoj-më,* le ta mburrim me devotshmëri e zell.

Lavdi *Ting. II*

Koka jote, kjo enë e tërënderuar e kuptimeve hyjnore, që parashikoi fuqishëm misterin e esencës së parrëfyeshme,⁵ lindi sot nga arkat e tokës si nga barku nënor, o Joan i tërëfamshëm, dhe aromatizoi planetin mbarë, duke derdhur miro shenjtërimi, duke predikuar mendërisht udhë⁶ pendimi⁷ dhe duke ndërmjetuar pranë Shpëtimtarit të të gjithave për shpirtrat tanë.

Tani *I Pentikostarit**Përlëshore*

Ting. IV Tahí prokatálave

Profet pararendës, si thesar të çmuar hyjnor* të fshehur në dhé, na e zbu-

loi Krishti yt kokën tënde; të mbledhur tok* gjithë për gjetjen e saj* me psalmim, himn hyjfolës* e përhimnojmë Zotin Shpëtimtar që nga prishja* gjithnjë na shpëton me ndërmjetimin tënd, Pagëzor.

Dhe e Pentikostarit



NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë, Ndenjëso
Ting. IV Tahi prokatálave*

Pasi na ka lindur që nga dheu koka e shenjt* e shën Pararendësit, te besimtarët lëshon plot reze që s'prishen dot* edhe shërime; lart mbledh* tërësi engjëjlore,* poshtë gjininë tonë njerëzore e fton tok* me një zë lavd Krishtit Perëndi t'i drejtojmë ne.

Dhe e Pentikostarit

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjëso
Ting. IV O ipsothís en to stavró*

Çuditërisht si prej* minierës sërish del* si ari kryeja* e shenjtë nga poshtë,* prej tokës, pasuron të gjith' sa rendin me mall* gjatë gjetjes së asaj edhe* madhështojnë Ndërtuesin,* Shpëtimtarin, që u jep përmes teje

atyre,* o Pagëzor i lum i Krishtit Zot,* ndjesë mëkatesh,* mëshirë të pasur fort.

Dhe e Pentikostarit

*Pas Polieleit, Ndenjëso
Ting. IV Epefanis símeron*

Pagëzor, Hirodhi mbret* paligjësisht jep* kokën tënde që ka nder* te grua,^s por thërrasim ne* me zë: Në gjetjen e saj kërko,* që t'u dhurohet mëshirë të gjithëve.

Dhe e Pentikostarit

*Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV
Proqimeni Ting. IV*

Atje do të lind bri për Davidin, përgatita kandil për të lyerin tim.

Varg: Kujto, o Zot, Davidin dhe gjithë butësinë e tij.

Ungjilli. Psalmi 50.

Lavdi. Me ndërmjetimet e Pagëzorit tënd.

Tani. Me ndërmjetimet e Hyjlindëses. Përdëllemë, o Perëndi. *Dhe Idhiomeli.*

Ting. II

Koka jote, kjo enë e tërënderuar e kuptimeve hyjnore, që parashikoi fuqishëm misterin e esencës së parrëfye-

shme,⁵ lindi sot nga arkat e tokës si nga barku nënor, o Joan i tërëfamshëm, dhe aromatizoi planetin mbarë, duke derdhur miro shenjtërimi, duke predikuar mendërisht udhë⁶ pendimi⁷ dhe duke ndërmjetuar pranë Shpëtimtarit të të gjithave për shpirtat tanë.

Kanunet: i Pentikostarit dhe i Pagëzorit. Zbritësoret e Pentikostarit.

Kanuni i Pagëzorit:

Poezi e Tarasit

Ting. Tërth. IV

Ode I

Armatilatin Faraó

Meqë u bëre zë i Fjalës,⁶ zgjidhma gjuhën, sepse pa gojë jam,* si çlirove atin* që më parë,⁹ të të lavdëroj me ngazëllim, me zë*¹⁰ gjatë gjetjes së kryes sate tani, Pararendës shenjt,* o i lum, njeri qiellor, Joan.

Ti që e vure dorën përmbi kryen e Jisuit Krisht Shpëtimtar,*¹¹ mbi kreun e Kishës,*¹² kryen tënd të hyjshëm që kuptoi shfaqjen e Trinis'*⁵ shfaq për herën e tretë, dhe shenjtëron dukshëm, haptazi* mbarë orthodhoksët, o shën Joan.

O Pararendësi i Zotit, nuk duroje që të fshiheshe më,* për më shumë kohë,* rregullon sërish të shfaqesh jo i

mbyllur sot në shtamb',* por i vënë në enë argjendi në vend të shenjtë pra,* veten tënde priftit ia lajmëron.

Hyjlindësore

Imbirë¹³ nga një bark shterp i gatitje udhët, o i famshëm me lavd,* Bërësit Zot,⁶ Fjalës,*¹⁴ që pashprehshëm lindi prej së Tërëshenjtës Vajzë pra,* që si Perëndilindëse gjithë brezat e njohin qart'* dhe e lumërojnë¹⁵ gjithnjë mbi dhé.

Ode III

Uranias apsidhos

Kreu yt fort i shenjtë për vallëzim imoral*¹⁶ kur u dha çmim, sillej prej dore gruaje,⁸ por tani* po transferohet me nder* pra për në kishën e shenjtë,* e mban dorë prifti të mençur me përkushtim.

O Prodhrom i lëvduar, ty të mikpret populli,* turma edhe mbreti me kryepriftin, këndon me gaz,* dhe me hare paraprin* qyteti i përmalluar,* me praninë tënde me bes' shenjtërohet pra.

Koka jote e shenjtë, profet i Krishtit Jisu,* nga një vend i hyjshëm që s'depërtohet na lindi ne,* si diell plot me shkëlqim* e feksi botën e tërë* me ndriçim të hyjshëm, Joan Pararendës pra.

Hyjlindësore

Nga një mitër që ish shterpë shndri-te ti, o profet,*¹³ si yll i shkëlqyer që prijë përpara Diellit* që nga një re¹⁷ virgjërisht* ka lindur, edhe shpërbëri* nat' politeizmi, o shën Pagëzor Joan.

*Ndenjësore**Ting. IV Epefānis simeron*

Sot u shfaq prej gjirit posht',* nga toka, koka* e Prodhromit si flori* që nga metalet kjo u dha* te besimtarët edhe po lyp* Jisunë Krisht të shpëtojmë të gjithë ne.

*Dhe e Pentikostarit**Ode IV**Isakikoa Kírie*

Si më i madhi ndër profetët, o Pararendës i lumur,¹⁸ paraprive Ilian, dhe me fuqinë e tij¹⁹ u vlerësove të shikosh të profetizuarin.

Na shfaqje tashmë për herën e tretë kokën tënde të kënduar, që buron mira shërimesh dhe dëbon pasione erërenda.

Si të mblidheni të gjithë, nxirrni shërime që nuk zbrazen, të cilat gufojnë nga burimi²⁰ i kokës së çmuar të Pararendësit të Krishtit.

Hyjlindësore

Pasi të më bësh të përlur, shpëtomë mua që sillem me kryeneçësi ti që linde atë që lartësoi natyrën e poshtëruar, o e Tërëkulluar.

*Ode V**Ina ti me aposo*

Meqenëse u bërë ndërmjetës mes dy Dhiatave hyjnore, për të Vjetrën dhe të Renë, përtërije vjetërsinë që kemi ne,²¹ që ripërtërisim të kremten e kokës sate, e cila sapo u rishfaq, o Pararendës i lumur, tepër i hyjshëm.

O Prodhrom, nga Komana e sjell sot të banojë në qytet mbretëror kokën tënde të pasur me hir shërimesh, me rikthimin e së cilës duartrokašin turmat e besimtarëve, duke u mbushur me ndriçim pa zvetënim.

Mbreti me hyrjen e kokës sate ngazëllohet më shumë se me mantelin mbretëror, ndërsa prifti i hyjshëm, që ka emrin e një hyjprurësi, duke e mbajtur në pëllëmbë, bekohet bashkë me të, dhe bekon shpresëtarët tepër përsosmërisht.

Hyjlindësore

Kur linde Zotin, u duke më e lartë se Fuqitë supreme, dhe e hyjnzove na-

tyrën e vdekatarëve, o Vajzë e tërë-paqortueshme; prandaj, o e Virgjër, ne besimtarët të lavdërojmë me shpirt të tërëvërtetë dhe me gjuhë si Perëndi-lindëse.

*Ode VI
Ilásthiti mi Sotír*

Kur e vërteta, o Krisht,* pra koka e Pagëzorit tënd, nga dheu lindi²² me nur,* dëboi gënjeshtërën, prishi dimër të hidhur fort* herezish, dhe botën* e shkëlqeu me hare dhe lavd.

Mëshirë nxirrni, shkëlqim,* me Hirin e Perëndis', me besë shenjtërohuni krejt* në shpirt dhe në kokë, duke prekur ju kryen pra* që në ujë preku* kokën tejet të hyjnueshme.¹¹

O Pararendës, lut ti,* që kokat e kundërshtarëve nën këmbët e mbretit ton'* të thyhen, se ky me mall nderon kryet tënd me nder,* që i çmuar ësh-të,* se qortoi rrept' Hirodhin mbret.³

Hyjlindësore

Te shpirtrat brenda në Hadh,* i lum, predikove se do vinte dritë, pasi ajo* e veshur me mish nga gjak i virgjër, do bëhej trup* për të mirën²³ tonë,* pra të njerëzve, o shën Prodhrom.

*Kontaqi
Ting. Tërth. II Tin ipér imón*

Shtylla që u shfaq plot dritë me hyjshmëri pra,*²⁴ Dielli mendor e kish kandil²⁵ paraprijës,* pasi kryet e tij dritëprurës, të çmuar krejt* dhe të hyjshëm e tregoi qart'* anembanë; shenjtëron ata* që i falen me besim e zë:* Të gjith' shpëtoji, i urt'* Pagëzor i Krishtit.

Shtëpia

Koka hyjdashëse e Prodhromit porsi burimi i Parajsës buron nga dheu rrëke Hiri dhe u shpërndan rrjedhjet²⁶ e çudive atyre që kanë nevojë; prandaj, le të shkojmë të gjithë dhe le të nxjerrim²⁰ me gatishmëri prej saj rrymat e hyjshme të shërimeve, sepse ujit shpirtrat me dhurata të përhershme, dhe mbyt dhimbje të trupave, dhe heq suksesshëm çdo sëmundje; atë le ta këndojmë me mallëngjim, le ta puthim, duke e përqaftuar me thjeshtësi, dhe le ta kurorëzojmë me psalme si me rrethe, o shpresëtarë; le të pas-trojmë më parë njollat tona shpirtërore, dhe me virtyte të perëndishme le t'i stolisim shpirtrat, dhe le të thërrasim me fuqi: Të gjith' shpëtoji, i urt', Pagëzor i Krishtit.

Sinaksari

Më 25 të të njëjtit muaj, kujtimi i gjetjes së tretë të kokës së çmuar të

profetit të shenjtë e të lavdëruar Joan Pararendësi dhe Pagëzori.

Vargje: Zëri i fshehur në thellësi të tokës i dikujt që thërret,^{6/} u dëgjua te të gjithë në mënyrë të huaj, kur toka u plasarit.²⁷

Më njëzet e pesë gjetën kokën e Prodhromit.

Në të njëjtën ditë, martiri i shenjtë Qelestini mbaron i shpuar në thembër.

Në të njëjtën ditë, oshënar Olviani mbaron në paqe.

Me ndërmjetimet e Pararendësit tënd, o Krisht Perëndia ynë, mëshirona. Amin.

Ode VII

I ek tis Iudheas

U bëre, o Pararendës, kandil²⁵ tepër i ndritshëm i Diellit të lavdisë, duke dëbuar renë e mashtrimit dhe duke feksur ata që me besë thërrasin: O Perëndi i etërve tanë, je i bekuar.²⁸

Kisha e nderuar të kryen shkëlqyeshëm edhe këtë festë të përvitshme, o Pararendës, duke nderuar kokën tënde dhe duke thirrur si zakonisht: O Perëndi i etërve tanë, je i bekuar.²⁸

Pasi paralajmërove me kërcime të hyjshme praninë e frikshme të Fjalës,²⁹ i lajmëron me gojë të pagënjeshtërt gjetjen e kokës sate bariut

prift, që të dëshiron nxehtësisht, o profet.

Hyjlindësore

U bashkuan në ty, mbi natyrë dhe mendje, virgjëri dhe lindje, sepse kishe në bark, o Hyjlindëse, Perëndi të mishëruar parrëfyeshëm, të cilit i psalim: O Perëndi i etërve tanë, je i bekuar.²⁸

Ode VIII

Eptaplasios káminon

Pagëzori, Pararendësi, engjëlli i dhe-shëm,³⁰ paditësi i saktë i paligjësisë,³ që pa qartë më parë në Jordan shfaqjen e Trinisë,⁵ u zbulon për herën e tretë kokën e tij të gjithëve që me mall këndojnë: O priftërinj, bekojeni; o popull, përmbilartësojeni Krishtin në jetë.

Të mikpret krahëhapur mbreti shumë i butë së bashku me popullin krishtdashës, o i tërëfamshëm, ndërsa i pari i barinjve tendos duart dhe, kur të pushton në krahërorin e tij, hidhet për-pjetë me ngazëllim dhe thërret me hare: O popull, përmbilartësojeni Krishtin në jetë.

Koka jote, o Prodhrom, duke shkëlqyer më shumë se ari, e ruajtur si thesar dhe pasuri e çmuar brenda ene argjendi, iu dha qytetit mbretëror dhe

me dhurata të hyjshme e pasuron atë që këndon melodikisht dhe me gati-shmëri: O priftërinj, bekojeni; o popull përmbilartësojeni Krishtin në jetë.

Hyjlindësore

Atij që mban Gjithësinë,³¹ kur mbahej në bark, iu fale²⁹ me gëzim, o Joan i lumur e i tërëfamshëm, duke u fshehur në mitrën shterpë; pasi lindi nga një virgjëreshë e shenjtë, duke e predikuar qengj atë,³² thërrisje besërisht: O popull, përmbilartësojeni Krishtin në jetë.

Ode IX

Ëfrikse pasa akoi

Ne, më të madhin ndër ata* pra që kanë lindur gratë,¹⁸ ta mburrim fort* me melodi të shenjt*,* filizi oshënar ky nga shterpa ish*¹³ edhe ushtar i Krishtit³³ mbret,³⁴ Prodhromi i madh, më par'* na shpalli Qengjin Zot* që mëkatet botërore i heq, i fal.³²

O Pararendës predikon,* shpall me zë kështu dhe Kishën e Krishtit fton,* si mbushe kanë ti* me mbushulli, për gjetjen e kreut tënd,* thërret pra: Eja-ni dhe nga të këndshmet që përgatis* ju merrni, ngopuni;*³⁵ mburmi Zotin që u fal jetën njerëzve.

Mbreti me emër engjëllor* te pallati mbretëror të pranon me gaz,* ti en-

gjëll Zoti³⁰ je;* në të Kryebariu shërbën fort mir'* me besë dhe krenohet qartësisht si për emër dhe* për hir, se është ky* i hyjnueshëm, hyjprurës, hyjmentës krejt.

Hyjlindësore

O Shpëtimtar, kursemë ti*³⁶ që ke lindur dhe pas lindjes le lindësen* pa prishje, kur do rrish* që t'i gjykosh pra veprat³⁷ e mia drejt,* mos e vër re paligjësinë time, mëkatet, se* ti je i dhembshur fort,* përdëllyes, njeri-dashës, i miri Zot.

Dërgimësore

Tis mathitës sinélthomen

Kur koka jote fort e shtrenjt'* u gjet, Prodhrom, dha gaz, hir,* te mbreti që do Krishtin fort* dhe që gëzon më tepër* se me mantelin e tij pra;* fali atij fitore* nga lart me forcë si shpërblim,*³⁸ na mbulo dhe ne, mbrona, o Pagëzor* famëmadh, me lutjet e tua, se ne* kremtojmë panairin tënd* dhe me mall të nderojmë.

Dhe e Pentikostarit

Lavdërimë

Ting. Tërth. I Heris askitikón

G'zohu, o kokë që dritë sjell,* e shenjtë je dhe e nderuar prej engjëjve;*

qëmoti të preu shpatë,¹ por me qortimin e prer'* ke ndërprerë turpe, imoralitet;*³ burim je që me çudi* i vadit besimtarët krejt* dhe shpallë ardhjen* shpëtimtare të Zotit Krisht,*³⁹ dhe e njohe qart'* fluturimin e Shpirtit Shenjt* që mbi atë qëndroi,⁵ ndërsa ti ishe pikërisht* mes Hirit pra të së Vjetrës dhe të së Re-së;⁴⁰ Jisunë lyp* që shpitrave tanë* t'iu dhurohet përdëllimi i madh^{40a} me dhembshuri.

(2x)

Koka e Pagëzorit Joan,* e fshehur brenda në një enë argjendi, del* nga barku i dheut haptas edhe buron si rrëke* plot shërime, meqë brenda ujit krejt* i ka larë kryet kjo* të atij që strehon tani* shtresat e larta* përmes ujit⁴¹ dhe hedh si shi* përmbi njerëzit* ndjesën, faljen hyjnore pra;* ta lumërojmë kokën, se vërtet e kënduar është'* dhe të kremtojmë për gjetjen e saj me gaz, se te Krishti Zot* lyp dhe përgjërohet* të dhurohet përdëllimi i madh^{40a} te rruzulli.

Lindi si diell koka mbi ne,* e cila shpalli se u shfaq si njeri me mish,*⁴² pra Qengji i Perëndisë',³² te të gjith' pendesën si udh'* shpëtimtare na e siguroi drejt* me fjalë të hyjshme krejt,*⁷ më përpara qortoi fort* paligjësinë* e Hirodhit,³ prandaj iu pre*¹

koka dhe mjaft koh'* fshehjes thell' iu nënshtrua kjo;* si diell lindi me ndriçim të plotë dhe na thërret:* Shkoni te Zoti dhe shtohuni⁴³ me pendim⁷ dhe me kataniks* në shpirt; dhe te bota* po dhuron dhe përdëllimin e madh^{40a} me dhembshuri.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

O Zot njeridashës, pasi e nxorëm me zë himnimi⁴⁴ besërisht kokën e tërënderuar të Pagëzorit tënd, e cila u shfaq sot nga dheu, ne shërbëtorët e tu fajtorë, duke e sjellë për ndërmjetim, kërkojmë që nëpërmjet saj të arrijmë në ditën e gjykimit⁴⁵ zbutjen tënde dhe përdëllimin e madh.^{40a}

Dhoksologjia e Madhe

Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanuni i Pagëzorit, Ode III dhe VI. Kungatore: Në kujtim të përhershëm.

CITIME

¹ Matth. 14.10; Mark. 6.16,28; Lluk. 9.9

² I Kor. 12.9,28,30

³ Matth. 14.3-4; Mark. 6.17-18; Lluk. 3.19

⁴ Matth. 4.23; 9.35; 10.1

⁵ Matth. 3.16; Mark. 1.9-10; Lluk. 3.22

⁶ Is. 40.3-4; Matth. 3.3; Mark. 1.2-3;

Lluk. 3.4; Joan 1.23

⁷ Matth. 3.2; Mark. 1.4; Lluk. 3.3

⁸ Matth. 14.11; Mark. 6.28

⁹ Lluk. 1.64

- ¹⁰ Ps. 41(42).5
¹¹ Matth. 3.16; Mark. 1.9; Lluk. 3.21
¹² Ef. 1.22; 5.23; Kol. 1.18
¹³ Lluk. 1.7
¹⁴ Joan 1.3
¹⁵ Lluk. 1.48
¹⁶ Matth. 14.6; Mark. 6.22
¹⁷ Is. 19.1
¹⁸ Matth. 11.9; Lluk. 7.26
¹⁹ Lluk. 1.17
²⁰ Is. 12.3
²¹ Ps. 6.8; 31(32).3; Rom. 6.6; Ef. 4.22; Kol. 3.9
²² Ps. 84(85).12
²³ Vep. 10.38
²⁴ Eks. 13.21-22; Urt. Sol. 18.3
²⁵ Joan 5.35
²⁶ Gjen. 2.6
²⁷ Ps. 140(141).6-7
²⁸ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,28
²⁹ Lluk. 1.44
³⁰ Mal. 3.1; Matth. 11.10; Mark. 1.2; Lluk. 7.27
³¹ Hebr. 1.3
³² Is. 53.7; Joan 1.29,36; Vep. 8.32; I Petr. 1.19
³³ II Tim. 2.3
³⁴ Lluk. 23.3; Joan 12.13,15
³⁵ Fja. Urt. 9.2-5
³⁶ Nehemia 13.22
³⁷ Dan. 7.9-10; Matth. 25.31-46
³⁸ Lluk. 24.49
³⁹ Matth. 3.11; Mark. 1.7; Lluk. 3.16
⁴⁰ Joan 1.16-17
^{40a} Num. 14.19 etj.
⁴¹ Ps. 103(104).3
⁴² I Tim. 3.16
⁴³ Jov 32.13; Vep. 11.24
⁴⁴ Ps. 25(26).7; 65(66).8
⁴⁵ Matth. 10.15; 11.22,24; 12.36; II Petr. 2.9; 3.7; I Joan 4.17





MË 1 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i martirit të shenjtë Justin
Filozofi dhe i një Justini tjetër,
si dhe i atyre që ishin me të.

NË MBRËMËSORE

Thirrto

Ting. II Ote ek tu ksilu se

Teksa* injorancë si acar* dominonte
gjithë Krijesën krejt me ndikim sata-
nik* edhe adhurohej çdo hordhi e
idhujve,* me një zemër që digjej¹ nga
besimi i hyjshëm,* me gatishmëri,
martirë të lavdishëm fort,* duke der-
dhur gjakun nga malli* për atë që
derdhi vet' gjakun* qartë përmbi kryq,
ndaluar dimrin ju.

Rrinë* pranë Krishtit tërëmbret,*
Zotit² të gjithçkaje, në qiej, me en-
gjëjt³ Peoni trim* dhe atlet, Haritoni
dhe Haritoja me ta* dhe Justini i hyj-
shëm, Evelpisti, Jeraksi* fort i lavdë-
ruar, kur u veshën me stoli,* pasi e
ngjyrosën me gjak pra* dhe e bënë
tepër të hyjshëm* edhe ndërmjetoj-
në për të gjithë ne.

Morët* aprovim hyjnor nga lart,*
ndaj në gara mbi çdo natyrë ecët me
vetëmohim* trupi, se ky priset; të
forcuar me fuqi* nga Jisui mbret, nuk
u frikësuat prej zjarrit,* as nga shpata
mprehëse, e ulët qafën pra* para Pe-
rëndisë dhe pritët* fundin fort të lu-
mur për Zotin* plot me ngazëllim të
thellë e të madh.

Lavdi *dhe* Tani

I së kremtes

[*në periudhën e Pentikostarit;*

ndryshe, Hyjlindësore:

E ngjashme

Ti je* shpresa e besnikëve* edhe lavdërimi i njerëzve dhe për engjëjt hare,* Zonj' e tërëpaqortueshme, me besë ne* si përikim te ti, o mbrojtja jonë, thërrasim:* O Hyjnuse, na shpëtoftë ndërmjetimi yt* gjithë ne që të lavdërojmë,* nga çdo shigjetim i armikut,* nga trishtim shpirtprishës dhe nga çdo shtrëngim.

ose Kryqhyjlindësore

Vajzë,* po lotoje me vajtim* dhe pësoje dhimbje të shumta, rënkoje thellë në shpirt,* kur po kryqëzohej Biri yt dhe Perëndi,* fort e shenjtë e pacen, thoshe: "Mjer', Bir i ëmbël,* si padrejtësisht po vuan, varesh përmbi dru,* ti që dheun mbarë e mbush plot*".⁴ Ndaj të lypim, Zonjë, me besë* zbutë ti atë me dhembshuri për ne.]

Përlëshore

Ting. IV O ipsothis en to stavró

I shndritur, o Justin,* me filozofinë* që rrezatonte fort,* u duke mësues* hyjditurie dhe luftove me urtësi* ndaj armiqve dhe pohove drejt* njohjen e

së vërtetës⁵ pra* dhe me atletizmin tënd* na u shfaqe banues* në tenda me martirët tok në q'ell;* lyp me ta Krishtin* përherë për shpirttrat tan'.

Lavdi *dhe* Tani

I së kremtes

[*në periudhën e Pentikostarit;*

ndryshe, Hyjlindësorja e ditës]



NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së zakonshme,
Kanunet: i së kremtes [në periudhën
e Pentikostarit; ndryshme,
i Oktoihut] dhe i shenjtoreve:*

Ting. II

Ode I

Dhefte laí

Me hijeshi* martirizimi shkëlqeni, me lavd,* martirë, rrini pranë podiumit të kulluar të Zotit të botës* dhe zgjidhjen nga mëkatet na jepni si dhurim.

Luftuan fort* në podium tiranik dhe mizor,* dhe me një zë vithisën me fuqi nga Shenjti Shpirt⁶ çdo mashtrim të beljarit* martirët shpresëplotë të së vërtetës⁷ pra.

Me torturim,* me fshikullime dhe me keqtrajtim,* martirët e mëdhenj dhe shpresëplotë blenë tok mbretërinë e Krishtit*⁸ dhe, të kurorëzuar, janë atje tani.

Hyjlindësore

Të erdhi keq* ty për gatimin që bëre me dor',*⁹ se je i pasur fort në mirësi,¹⁰ në mitër Vajze që nuk njohu burrë* banove dhe e shfaqe mbrojtësen tonë ti.

Ode III

Steréoson imás

Në zemër kishe Krishtin Zot, si fuqi,*¹¹ ndaj me trimëri, o Justin, martir shenjt,* kundërshtove ti gjykatësit* që urdhëronte të bëje paligjësi.¹²

Një kor që shndrit hyjnisht tani, një ushtri* martirësh të shenjtë dhe të hyjzgjedhur* kur u mbloodhën mundën plotësisht* armiq pa trup, edhe pse kishin trup këta.

Edhanë në tortura trupin me gaz* të fortët në shpirt, se parashikonin* në të ardhmen lavd¹³ edhe shkëlqim,* si dhe shijim të përhershëm në qiell lart.

Hyjlindësore

Pa farë Perëndi ti zure në bark;* e lind pa shpjegim pra të mishëruar;*

nuk guxojnë ta shikojnë dot* gjithnjë fuqitë e qiejve,¹⁴ Virgjërësh'.

Irmosi: Steréoson imás

»**F**orcona, sigurona, o Zot, në ty,*¹⁵
»pra ti që ke vrarë me dru mëkatin,*¹⁶
»edhe frikën tënde na e mbill* në zemrat tona, që të lavdërojnë ty.

Ndenjëso

Ting. Tërth. I Ton sinánarhon Logon

Evelpistin, Justinin, Valerianin tok* me Haritonin, Peonin, Jeraksin dhe Hariton'* t'i lëvdojmë, si ndriçues plot me hijeshi,* feksin çdo anë përmbi dhé;*¹⁷ për shkëlqimet në luftim, për çmimet që morën, rrokën,* le t'i mburrim me zë, te Krishti po ndërmjetojnë të shpëtohemi ne.

Lavdi dhe Tani

I së kremtes

[në periudhën e Pentikostarit;

ndryshe, Hyjlindësore

E ngjashme

O Hyjlindëse, mbrojtje e paluftueshme,* e flaktë, shpresë e sigurt që s'turpëron kurrë je,* strehë, mur, li-man për sa përikin pra te ti;* Birit tënd Krishtit Perëndi* përgjëroju tok me engjëjt paqen t'i japë botës,*¹⁸ përdëllimin e madh,^{18a} shpëtimin, ti, o e pastra Virgjërëshë gjithnjë.

ose Kryqhy lindësore

Kur të shihte mbi kryq nëna jote, o Krisht Zot,* që me dëshirë^{18b} po varreshe mes kusarësh me trup,* keq në shpirt si nënë po vajtonte, thoshte pra:* Si u mbërtheve përmbi kryq,* Bir i pamëkatshëm, si keqbërës padrejtësisht ti,* duke dashur, si i Mbi-mirë, ta gjallërosh gjinin' e njerëzve krejt?]

*Ode IV
Isakioa Kírie*

U habitën rreshtimet e engjëjve me arritjet e Justinit, Haritonit, Haritosë dhe Peonit.

Trupat, duke u dërmuar në tortura, u shkaktonin trimave të mëdhenj lumturi hyjnore.

U frikësuan kryetarët e errësirës¹⁹ nga trimëria e Evelpistit dhe Jeraksit, martirëve të palëkundshëm.

Hyjlindësore

Oe pacenuar, të përgjërohemi ty, që e zure pa farë Perëndinë, që të ndërmjetosh përgjithmonë për shërbëtorët e tu.

*Ode V
O tu fotós horigós*

O Justin i lumur, meqenëse u mbu-

she me Shpirt Hyjnor,²⁰ në rrjedhjet e gjakrave të tua, mbyte frymët e tmerrshme të ligësisë,²¹ kur atletizove tepër fuqishëm.

Ajo që kishte emër hiri, u bë e plotë me Hir²² Perëndie dhe, pasi harroi qartë dobësinë femërore, atletizoi ligjërisht²³ dhe u denjësuua për lavdi.²⁴

O Hariton atlet, bukuria e respektuar e athloforëve të hyjshëm, meqë u hirësive në shpirt, me pohime të shenjta e çmprehe ligësinë e armikut të lashtë.²⁵

Hyjlindësore

Të thërrasim ty që linde Krishtin, Krijuesin e gjithçkaje:²⁶ Gëzohu, o e kulluar, gëzohu që na linde dritën, gëzohu ti që mbajte Perëndinë e pacen.

*Ode VI
En aviso ptesmaton*

Oi hyjurtë, prite nga qielli* ftesën porsi Pavli²⁷ i mahnitshëm edhe drejt* marshove krejt shkëlqyeshëm,* stadium martirik pra përshkove ti.

Pa u epur përshkuat, martirë ju,* det torturash, por, kur me drejtim e krah hyjnor* arritët në liman të qet',* hytë në mbretërinë e Krishtit Zot.²⁸

Bukur si yje të palëvizshme pra* po shkëlqeni botën mbarë¹⁷ me çdo dritë-

sim* me çmimet që fituat ju,* pra në qiell kishtar, të nderuar lart.

Hyjlindësore

Në bark ngjize pa burrë, e Virgjër krejt,* virgjëreshë mbete përgjithnjë, kështu tregon* vërtet simbolet e Hyjnīs* së fëmijës edhe Perëndisë tënd.

Irmosi: En aviso ptesmaton

»Një avushë mëkatesh po më rre-
»thon,* ndaj thërras un' mirësinë të-
»nde që s'ka fund,* e cila s'gjurmeso-
»het dot;* lutem, nxirrmë nga prishja,
»o Zoti im.²⁹

Kontaqi

I së kremtes

*[në periudhën e Pentikostarit;
ndryshe*

Ting. II Tus asfalís qe theofthogus

Ta mburrim me lëvdata predikue-
sin* autentik të besës, filozofin pra*
shën Justinin, orator misteresh, se,
përmes fuqisë së urtis'* dhe Hirit,³⁰
shpalli fjalën e besimit drejt* dhe
faljen e hyjnueshme na e kërkon,*
martiri i madh, i mrekullueshëm.]

Sinaksari

Muaji qershor, që ka 30 ditë. Dita ka 15 orë dhe nata 9 orë.

Më 1 të të njëjtit muaj, kujtimi i martirit të shenjtë Justin Filozofi.

Vargje: Helmi e mori Justinin nga je-
ta,/ së paku ta kishin pirë më parë
dhënësit.

Në të parën e qershorit, o Justin u shë-
rove.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirëve
të shenjtë Justini, Haritoni, Haritoja,
Evelpisti, Jeraksi, Peoni dhe Valeri-
ani.

Vargje

Për Justinin: S'kishte arritur akoma
shpata ta frikësonte,/ kur Justini për-
kuli kokën.

Për Haritonin dhe Haritonë: Haritoni
i hyjshëm dhe virgjëresha Harito,/ pa-
si u prenë, shijojnë karizma hyjnore.

Për Evelpistin: Evelpisti, natyrisht, ka
shpresa të mira,/ se, kur do t'ia presin
kokën, do të ketë Perëndinë si tra-
shëgimi.

Për Jeraksin: Sulet Jeraksi me trimëri
si skifter/ dhe, si u pre, kap si gjah
shpëtim shpirtëror.

Për Peonin: Peoni, duke goditur me
fjalë keqbesimin,/ goditet në qafë
prej dore me shpatë.

Për Valerianin: Do t'i tregosh Perëndi-
së edhe ti ndonjë gjymtyrë të prerë:/
atë më të mirën, kokën, o Valerian.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të
shenjtë Firmi.

Vargje: Përderisa Firmi duroi shumë tortura,/ gjeti dhe shumë shpërblime në qiell.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të shenjtë Thespesi.

Vargje: Vërtet u shfaqe i mrekullueshëm nga punët,/ o Thespes, që u bëre martir me anën e shpatës.

Hieromartiri i shenjtë dhe episkop Piri i virgjër mbaron në paqe.

Vargje: Piri themeloi pirg të madh dëlirësie,/ nga i cili sheh Perëndinë, pasi vuri poshtë pluhur.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Agapiti i Shpellave të Kievit.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII

Ikonos hrisís

O martirë, kur e thatë fundin e mashtrimit me lumin e gjakrave, buruat rryma çudish, që fikën qymyret e pësimeve të tmerrshme të atyre që thërrasin ngaherë: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.³¹

Justini i urtë, i stolisur me urtësi Perëndie, e diskreditoi në Hir filozofinë e grekëve, kur i bindi t'i faleshin orthodhoksisht Trinisë dhe të thërrisnin: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.³¹

O të urtë, me zjarrin e perëndishëm të dashurisë shkrumbuat me trimëri maja ligësie dhe, pasi shkëlqyet si pishtarë, ndriçuat zemrat e tërë atyre që besërisht brohorasin: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.³¹

Hyjlindësore

Moisiu në malin Sina të parapa si ferrë që digjej ty, që mbajte pa u djegur³² lavdinë e pakufizueshme të esencës së parrëfyeshme, kur u bashkua me majmëri mishi një nga hipostazat e shenjta që janë në të.

Ode VIII

Ton en kamino tu pirós

O athloforë të Zotit, kur u sprovuat me durim në zjarrin e torturave si brenda furrës,³³ shkëlqyet vërtet më tepër se ari, duke thirrur perëndishëm: Të përmbilavdërojmë, o Krisht, në jetë.

Le të përhimnohen së bashku me Justinin e urtë Haritoja, Peoni, Haritoni, Jeraksi i madh tok me Valerianin, që me atletizmin e pakësuan mashtrimin dhe u bashkuan me koret e engjëjve.

Duke shpejtuar drejt jetës së amshuar³⁴ me trimëri, o martirë të urtë, ia përkulët qafën, ju të gjithë shpa-

tës me një shpirt, kur u sollët si fliji-me te Perëndia.

Hyjlindësore

O Perëndilindëse, duke pasur në bark Krishtin, si miro që zbrazej³⁵ mbi ne, lëshove erë të këndshme në botë me kundërmime që fryu Hyjnia;³⁶ prandaj të thërrasim: “Gëzohu”,³⁷ dhe të përmbilartësojmë në gjithë jetët.

Irmosi: Ton en kamino tu pirós

»**A**të që zbriti në kamin’, * që të ishte
»tok me Djemtë e hebrenjve, * Perë-
»ndinë që ktheu në vesë flakë dhe
»zjarr,*³⁸ himnojeni, vepra, se është
»Zot,* përmbilartësojeni pra në gji-
»thë jetët.³⁹

Ode IX

Ton ek Theú Theón Logon

Me lavd të hyjshëm ndriçuat, o martirë, o trima,* thyet ju dimrin e mashtrimit pra,* kur u kunguat me dhimbje, pësim,* kaq të shenjtë të Krishtit⁴⁰ që mori mish për ne me mirësi;* ndaj me të ju gjithnjë ngazë-lloheni në qiejt lart.

Guximin me të vërtetë të Peonit, luftimet* dhe trimëritë e Jeraksit shenjt,* tok me durimin e shumë që kish* Valeriani përballë të frikshme-

ve, si edhe urtësin’* e Justin it gjith’ engjëjt pa trup i admiruan fort.

Kur hipët si në karrocë të hyjnueshme⁴¹ ju tok,* pra përmbi gjakun tu-aj lavdërisht,* rendët në qiej me gaz, o të urt’,* dhe kurora fitoreje dora jetëprurëse ju dha,*⁴² ndaj për ne pa pushim ndërmjetoni, të shpëtohemi.

Hyjlindësore

Nga gjaku yt i dëlirë, nënë fort e ku-l-luar* dhe e panusëruar, pa shpjegim* u mishërua ai që pra ish* para jetëve Biri, i bashkëparapafillimi Zot* tok me Atin, edhe shndrit si diell botën, terrin heq.

Irmosi: Ton ek Theú Theón Logon

»**T**a madhështojmë me një zë, o be-
»snikë, me himne* Fjalën e Perëndi-
»së, Zotin⁴³ Krisht,* që pa rrëfyer ka
»marrë për ne* mish nga Nëna e vir-
»gjër, e shenjtë; vjen të rinovojë pra*
»krejt Adamin që, kur hëngri,⁴⁴ ra në
»prishje mizorisht.

Dhe të tjera si zakonisht.

CITIME

¹ Vep. 18.25; Rom. 12.11

² III [I] Mbret. 17.1; 18.15;

IV [II] Mbret. 3.14; 5.16

- ³ II Kron. 18.18; Dan. 7.10
⁴ I Tim. 2.4
⁵ Joan 8.32; I Tim. 2.4; II Tim. 2.25; 3.7;
 Tit. 1.1; Hebr. 10.26
⁶ Lluk. 4.14; Rom. 15.13,19
⁷ Sirak 4.28
⁸ Ef. 5.5; II Tim. 4.1
⁹ Ps. 118(119).73; Jov 10.8
¹⁰ Ef. 2.4
¹¹ Ps. 17(18).3
¹² Vep. 23.3
¹³ Rom. 8.18; I Petr. 5.1
¹⁴ Is. 6.2
¹⁵ Ps. 17(18).3; 70(71).3
¹⁶ I Petr. 2.24
¹⁷ Fil. 2.15
¹⁸ Joan 14.27
^{18a} Num. 14.19 etj.
^{18b} Joan 10.15,17-18
¹⁹ Ef. 6.12
²⁰ Lluk. 1.41,67;
 Vep. 2.4; 4.8,31; 9.17; 13.9
²¹ Lluk. 7.21; 8.2; Vep. 19.12-16; Ef. 6.12
²² Joan 1.14
²³ II Tim. 2.5
²⁴ Hebr. 3.3
²⁵ Joan 8.44
²⁶ Joan 1.3; Kol. 1.16
²⁷ Vep. 9.5-6; 22.8-10; 26.14-18
²⁸ Ps. 106(107).26-30
²⁹ Jona 2.7
³⁰ I Tim. 1.12; II Tim. 2.1
³¹ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2, 28
³² Eks. 3.2-5
³³ Urt. Sol. 3.6
³⁴ Matth. 19.16 etj.
³⁵ Kënga 1.3
³⁶ II Kor. 2.15
³⁷ Lluk. 1.28
³⁸ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 25-26
³⁹ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
⁴⁰ II Kor. 1.7
⁴¹ IV [II] Mbret. 2.11
⁴² Urt. Sol. 5.16; Is. 62.3
⁴³ Joan 1.1-2
⁴⁴ Gjen. 3.1-6



MË 17 TË TË NJËTIT MUAJ

Kujtimi i martirëve të shenjtë Isavri,
Vasili, Inokenti, Ermiu, Feliksi dhe
Peregrini, si dhe i martirëve të
shenjtë Manueli, Saveli dhe Ismaili.

NË MBRËMËSORE

Thirrtores

Të shën Isavrit

dhe të atyre që ishin me të

Ting. IV Édhokas simíosin

Dhimbe ju dërrmonin, ju shtrëngonin vuajtje dhe mundim,* në burg mbyllur ju priste shpat',* me vdekje të dhunshme fort* u ekzekutuat,* por s'mohuat Krishtin, statujtë s'adhuruat, jo,* u denjësuat kështu pra për shkëlqim* të lartë, qiellor, ndaj Shpëtimtarit Zot përgjërojeni,* o të lumur, për gjithë ne,* jeni nder për Apollonin'.

Shën Feliksi i çuditshëm dhe Isavri me plot lavdi,* Inokenti i fortë krejt,* Vasili i hyjshëm tok* dhe Ermiu zëmadh,* edhe Peregrini me mrekulli hyjnore krejt* shkëlqyen, tokën e bënë qiell pra;* kështu të lumërohen porsi shërbëtorë të Zotit Krisht,* se gjithmonë dëbojnë larg* veset nga shpirtrat tanë k'ta.

Krua që buron karizmat e shërimeve¹ duken qart'* trupat tuaj dhe nxjerrin pra,* shpërndajnë kurim, shëndet,* në pësime çlodhje* dhe çlirim të plot' në sëmundje, ndaj ju lavdërojm'* me nder gjithnjë, o martirë të mëdhenj,* të barabartë me të pastrup, shërbëtorët e Perëndis';* ndërmjetoni për shpirtrat tan'* pranë Zotit Krisht Shpëtimtar.

Të shën Manuelit

dhe të atyre që ishin me të.

I njëjti: Os jeneon en mártisin

Athloforë me nam të madh,* porsi yje të ndritshme fort* me shkëlqim hyjnor ndritët botën anemban'* dhe na çlironi nga terri i demonëve me mani,* nga rreziqe, shkatërrim* nga pësime; të mbledhur pra* sot ju bëjmë ne* panairin e shenjtë, dritëprurës, ngazëllyes, o martirë të lavdëruar kudo mbi dhé.

Të gjithurtin shën Ismail* dhe Savelin e lumur tok* edhe Manuelin e mrekullueshëm,* le t'i nderojmë me melodi të tërëhyjnueshme,* sepse hyjshëm shpallën fort* tek armiqtë Trininë Shën,* që nuk ka krijim;* dhe mashtrimin, politeizmin, shuan përmes derdhjeve të gjakut, morën kështu lavd që s'vyshket pra.

Manuel, Ismail, Savel* nammëdhenj, turpëruat keq* urtësisht të paligjshmin mbret që pa dekret* ju urdhëronte në perëndi pa shpirt të nënshtroheshit,* pra t'i adhuronit ju;* dhe garuat me plot durim* ligjërisht,² kështu* thurët bukur kurorat e fitores dhe për botën ndërmjetoni në lumturinë e qiejve.

Lavdi

Ting. Tërth. IV I Anatoliut

Meqë të dëshiruan sinqerisht ty, o Fjalë e Perëndisë, martirët e lavdishëm, pasi lanë adhurimin e zjarrit dhe braktisën edhe dheun e kaldenjve, shkëlqyen me anën e dritës sate; dhe, kur u fortifikuan me armët e besimit Manueli famëmadh, Saveli i gjithëkujtuar dhe Ismaili tri herë i pasur, e turpëruan Julianin tiran, duke të himnuar ty bashkë me Atin dhe Shpirtin, dhe ndërmjetojnë që të shpëtojnë shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

O tu paradhoksu thávmatos

Ki gaz, mburrje e planetit; ki gaz, tempull i Zotit Krisht;* ki gaz, mal hijeplot';³ ki gaz,* o e thjeshtë, strehë je;* ki gaz, llambë e artë⁴ krejt;* gëzo, lavdia e orthodhoksëve,* o nënë e Perëndisë pra Mari;* ki gaz,

Parajsë ti,* tendë⁵ dhe tryez⁶ hyjnore, fort gëzo;* ki gaz, gaz për çdo njeri, ti, e tërarta shtamb'.⁷

ose Kryqhyjlindësore

Ç'është pamja që po shfaqet, o Zot, para syve të mi? Ti që mbarë Krijesën mban,* si u vare mbi një dru,* vritesh ti që kudo jep jet'?.^{*8} Me vaj kështu thoshte duke qarë keq* Perëndilindësja, kur e pa* njeriun Perëndi* që prej saj shkëlqeu krejt pashprehimisht,* ndërsa qe mbërthyer ky në kryq si kriminel.

Përlëshore

Ting. III Tin oreótita

Fituan me triumf* mbi çdo armik, rreshtim* i lumi Ismail,* i lavdëruar fort* Saveli, Inokenti dhe Feliksi si dhe Ermiu,* Manueli, dhe me ta* Peregrini, Vasili pra* dhe Isavri, nënt' këta,* kor i Fjalës, ndaj morën tok* dhe çmimet e fitores, se janë* shenjtë, martirët e Jisuit.



NË MËNGJESORE

Stihologjia e zakonshme dhe Kanunet e Oktoihut dhe i shenjtorëve që ka Akrostihidhë: "O martir Isavër, tregohu

dashamirës me mua.” Dhe në Hyjlindësoret: “I Grigorit”.

Ting. Tërth. IV

Ode I

Igrán dhiodhefsas

Martir, zbutë Zotin Krisht Shpëtimtar,* pra të mirin, të më mëshirojë, shenjtor i lum,* dhe të më çlirojë nga e keqja,* nga tmerri, se me bes' nën strehën tënde vij.

Gjith' fajet e rënda keq më shtrëngojnë,* më shtyp, kërcënon çdo sulm, rrezik, ndaj po të thërras:* Mbromë dhe çliromë nga nevoja* që më përndjek, o hyjmendës Isavër shenjt.

Garove ti ligjshëm² për Krishtin Zot,* u dhe si dhuratë te qyteti yt, rojë pra* i pafjetur; bëhu strehë, mbrojtje* për sa përikin te ti, o Isavër shenjt.

Hyjlindësore

Më gjeti të zhveshur nga çdo virtyt,* me shigjetë epshesh më plagosi djalli i lig;* ti që linde Perëndinë, mjekun,* shëroji traumat, plagët e shpirtit tim.

Ode III

Si i to steréoma

Dhuro ndihmën tënde ti* te shërbëtorët e tu nga lart* dhe na shpëto*

nga çdo keqtrajtim pra,* nga rreziqet dhe çdo shtrëngim.

Buron sarkofagu yt* dhe derdh shërim të ndryshme pra,* Isavër shenjt,* dhe pushon sëmundjet* dhe pasionet e njerëzve.

Ti emrin e Krishtit Zot* e ke nderuar, ndaj rroke nder,* pra po thërras:* Duke ndërmjetuar,* më çliro nga çdo turp, çnderim.

Hyjlindësore

Ndërtuesi im, o Zonj',* përmbinatyrshëm u zu në ty;* me mirësi* donte të më bënte* përmes teje të ri të tër'.

Irmosi: Si i to steréoma

»**T**i je përforcim për ne* që po përikim te ti, o Zot;*⁹ je drit' për sa* janë »errësuar,*¹⁰ ndaj dhe shpirti im të »himnon.

Ndenjëso

Ting. III Thías písteos

Ju moral, qëndrim* hyjnor treguat,* nder për Durrësin,* rojat e tij pra* jeni, luftëtarët trima të Krishtit¹¹ Zot;* Tripontin, besën e tij, turpëruat keq,* vithisët dhe Apollonin aq arrogant,* ndaj me gaz prej Zotit pritët çmime fitoreje,* shërim dhuroni te besnikët e sëmur'.

Hyjlindësore

Virgjëreshë je,* tendë e hyjshme*⁵ krejt për Fjalën Zot,* e vetmja pa cen;* epërsin' në qashtërsi e ke mbi engjëjt;* i ndyrë jam më shumë' se gjithë njerëzit,* plot me mëkate mi-shore,¹² pastromë pra,* me rrëke të ndërmjetimeve pranë Birit tënd;* më jep ti përdëllimin e madh,^{12a} o e thjesht'.

ose Kryqhyjlindësore

Shqerra e panjoll'* e Fjalës, Zotit,* Virgjërnëna krejt* e pacenuar,* duke parë që të varej mbi kryq ai,* të cilin, pa dhimbje fare, e lindi kjo,* siç bëjnë nënat, thërriste me klithm' e vaj:* Mjer', o Biri im, si vuan, se do që të shpëtosh* njeriun nga pasione shumë' të turpshme¹³ ti.

*Ode IV**Isakioa Kírie*

Kur u lartësova për shkak të pamen-dësisë sime, rrëshqita nga pasionet; më ngri mua që dergjem në fund dë-shpërimi, o hyjmendës.

Ty, o i tërëlavdëruar, të kam mbrojtësin tim të sigurt dhe përikje; mbromë, mos më shpërfill në ditë shtrëngimi dhe shpëtomë.¹⁴

Me vuajtjen e zemrës sime të përgjë-

rohem ty, ruajtësit tim tepër të flaktë: Mos më braktis mua që po humb nën ndikimin e armiqve.

Hyjlindësore

O Virgjëreshë, strehë e paturpëruar dhe përkrahje e të dhelindurve, më mbro dhe më rrëmbe nga çdo fat-keqësi mua, shërbëtorin tënd.

*Ode V**Ina ti me aposo*

U duke bir dite,¹⁵ duke pasur në zemrën tënde dritë të paperënduar që shkëlqen, me anën e së cilës paqësohet stuhia e errët e mashtrimit, dhe feks si me pishtar mbi të gjithë njohja e dritës hyjnore; prandaj të thërras: Llamburitmë mua të verbuarin vullnetarisht.

Mos më shpërfill, o martir i shenjtë, se po përik te ti besërisht, mos më kthe mbrapa, sepse me gjuhë dinake flasin kundër meje ata që më urrejnë dhe kot luftojnë,¹⁶ që të humbasë shërbëtori yt; por arri dhe shpëtomë.

Ditë-natë të thërras ty, mbrojtësit tim të madh; o shenjtor, në çdo vend dhe kohë ruajmë nga çdo dëm dhe përndjekje e kundërshtarëve mua, që te ti e vura shpresën time.

Hyjlindësore

Perëndia, Gatuesi im, më formon prej teje mua të tërin; atij lutju përherë që të dhembshurojë një popull që ra në mëkat,¹⁷ dhe të shpëtojë nga çdo dëm demoniak botën që shpreson te ti, o Hyjlindëse, që s'njohe dasmë.

Ode VI
Tin dhéisin ektheó

Hymendës shenjt, * korrigjo çdo devijim* të mendimit tim, pësimet e zemrës* dhe më çliro* ti nga dhimbjet e trupit,* nga çdo shtrëngim kundërshtar, çdo ndikim dhe dert;* me lutjen tënde më trego* më të lartë se kurthi armiqësor.

Garove drejt* dhe i Tërëshenjt Zot,* o martir, të shenjtëroi; atë lyp* që shenjtërim* ne shërbyesve të tu,* të na dërgojë dhe faljen e fajeve* me dritë, sepse Zoti Krisht* na dha mbrojtje të paturpëruar ty.

Plot mall un' kam,* o martir, pra që me ty* tok të jem, o shenjt i fort-dëshiruar,* këtë të lyp;* të kam mbrojtës të mirë* dhe të thërras, o Isavër, me bes' në shpirt:* M'u bëj ti ndihmës, më çliro* nga nevojat e shumta, të ndryshme krejt.

Hyjlindësore

Zjarr shuaj shpejt* të pasionit tim përmes* pikave të ndërmjetimit

shpëtues* që disponon;* marrëzinë e mendjes* ti ma shëro, Virgjëreshë e Tërëshenjt',* o e dëlirë krejt, ndërhyr,* dallgët, frikën e veseve paqëso.

Irmosi: Tin dhéisin ekheó

»**D**o derdh lutjen* para Zotit Perëndi* dhe atij do t'ia tregoj hidhëri-
»met* që kam,¹⁸ sepse* shpirti im
»është mbushur* me çdo të keqe dhe
»jeta po shkon në Hadh;*¹⁹ pra si Jo-
»nai lutem un':* Jetën time nga pri-
»shja, ti ngrije, Zot.²⁰

Kontaqi
Ting. IV Epefanis símeron

U formuat si një kor* i thurur hyjshëm,* nënt' martirë me lavdi* çudi po bëni dhe me zë* thërrisni unanimisht: O Krisht,* je për dëshmorët pushtet edhe forcë ti.

Sinaksari

Më 17 të këtij muaji, kujtimi i martirit të shenjtë Isavri dhe i atyre që ishin me të: Vasili, Inokenti, Feliksi, Ermiu dhe Peregrini.

Vargje: Kur u pre Isavri tok me pesëshen e bashkatletëve,/ preu në mes zemrën e zvarranikut mendor.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirëve të shenjtë Manueli, Saveli dhe Ismaili.

Vargje: Saveli, Manueli, Ismaili ishin persianë në origjinë./ por në gradë janë martirë përmes shpatës.

Në të shtatëmbëdhjetën tre vëllezër i preu bronzi.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Ipati që ishte në Rufiani.

Vargje: Ipati dergjet pranë detit,/ ai na dëgjon së bashku me miq Perëndie lart.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i hiero-martirit të shenjtë Filonidhi, episkop i Kuriut në Qipro.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Piori.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Josif anakoreti.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Krisht Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VIII

Theú sigatávasin

O Isavër i lavdishëm, Inokent i hyjnueshëm, Feliks, Ermi, Peregrin i urtë së bashku me Vasilin, duke shkëlqyer me dritën tridiellore, feksni me shkëlqime çudish ata që ju mburrin.

U dukët, o athloforët e Zotit, yje të shumëndritshme, duke pakësuar terrin e mashtrimit; prandaj ndriçojeni me shkëlqim hyjdijeje shpirtin tim që

u verbua vullnetarisht, duke shpërndarë mjegullën e paditurisë.

Shëroni shpirtin tim të varfër e të sëmurë pa shërim, dhe zhdukni pasionet e trupit, o martirë të hyjshëm, Peregrin, Isavër, Vasil, Feliks, Ermi famëmadh dhe Inokent.

Hyjlindësore

Fuqia, himnimi dhe shpëtimi im është Krishti Zot²¹ që lindi prej teje nga mirëdashja, o nënë virgjëreshë, duke na çliruar nga kërcënimi dhe vendimi i lashtë stërgjyshor.²²

Ode VIII

Eptaplasios káminon

O i hyjzënë, i shkëlqyer me bukuri martirizimi dhe i stolisur me shenja plagësh nga trimëritë, i veshur me purpur prej gjakrave të therjes sate, dhe i hirshëm me lavdi priftërie, qëndrove pranë Zotit,²³ të cilit përgjëroju përherë të na stolisë me rrobë shpëtimi.

I vrarë unë mjerani nga rrëzimi i kënaqësive, katandisa përposhtë, me pamje të denjë për qarje; o Isavër i tërëlavdëruar, hidh syrin mbi mua tani, tregoje tek unë hirin e mrekullive të tua; le të shohë gjinia e vdekatarëve se ti je mbrojtësi im dhe i shpëton nga vdekja shërbyesit e tu të pavlefshëm.

Më përpara u stolise me priftëri dhe celebrove, o tepër i hyjshëm, dhe më vonë u bëre duke dashur fli i patëmetë, duke u shenjtëruar si therore për Krishtin nëpërmjet martirizimit; prandaj ofro te Ndërtuesi himnin tim si temjan, dhe më shpëto me përgjërimit e tua, o martir.

Hyjlindësore

Perëndia që e stolisi qiellin me bukuritë e ndriçuesve,²⁴ të tregoi, o Virgjëreshë, si tjetër qiell, sepse, kur lindi prej teje si diell, e shkëlqeu tërë dheun me dritën e hydijes; prandaj askush që përik drejt teje nuk largohet i turpëruar, pa marrë dhuratat e tua të hyjnueshme.

Irmosi: Eptaplasios káminon

»**E** dogji furrën shtatë her’* në Kal-
»de një tiran i saj* me mani për Djem-
»të* që nderonin Perëndi;*²⁵ por, kur
»të shpëtuar krejt* i pa nga një fuqi
»më e fort’,* thirri ky kështu:* Po Çli-
»rimtarin Ndërtues,* o Djem, ju e be-
»koni;*²⁶ priftërinj, e himnoni;* ju po-
»pull, lartësoni atë për gjithë jetët.

Ode IX

Eksesti epí tuto

U denjësove ti për karizma mjaft* të mëdha, o Isavër i lumur fort, prej

Perëndis’;* vdekje, çdo sëmundje, demonë zmbraps;* dhurata te të gjithë jep,* plotëson kërkesat e tyre; fal* edhe tek unë paqe,* shëndetin dhe çlirimin* nga fajet që më torturojnë keq.

E hyjshmja kisha jote plot me nderim* e mban trupin tënd fort të çmuar, të shenjt’; e ka porsi thesar* që nuk vidhet, ndaj pasuron gjithnjë* me ndarjen e karizmave* shpresëplotët; le të arrij dhe un’* të marr dhuntit’ e tua,* se gjithashtu përiki* në varrin tënd të hyjshëm dhe të lum.

Martir i Zotit me lodhje e mundim,* ja ku more shpërblimin për lodhjet që bëre pra;²⁷ mbroje gjithnjë* popullin dhe ruaje vendin tënd* hyjmendës dhe sa besërisht* te ti po përikin shpëtoji shpejt,* dhuroji botës paqen;*²⁸ kujtomë edhe mua,* se shërbëtori yt jam, shenjti im.

Hyjlindësore

O nën’ e Zotit, re e mbindritshme je,*²⁹ ndaj sa po na luftojnë, luftoju fort ti me fuqin’* e së djalhtës sate, e Virgjër krejt,* dhe nevojtarët mbro gjithnjë,* dhe ndihmo ata që padrejtësi* pësuan, dhe nga shkeljet* çliro me lutjen tënde,* sepse sa do, ke mundësi t’i bësh.

Irmosi: Eksesti epi tuto

»**U** shtang dhe u shastis qielli me
 »të,*³⁰ u habitën dhe anët e botës
 »mbar', se Perëndi* trupërisht u duk³¹
 »te të vdekshmit ne* dhe, Zonjë, bar-
 »ku yt u bë* më i gjerë se qiejt, se
 »çdo vend;* Hyjlindëse e Virgjër,*
 »rreshtimi engjëllor si* dhe njerëzor
 »të madhështojnë ty.

*Dhe të tjera si zakonisht**CITIMET*¹ I Kor. 12.9,28² II Tim. 2.5³ Abak. 3.3⁴ Eks. 25.30-37; 35.16; 38.13; 40.22;
Num. 4.9; 8.2; Hebr. 9.2⁵ Eks. 25.8; 26.30; Hebr. 9.2⁶ Eks. 25.22-29; 39.18; 40.20; Lev. 24.6;
Hebr. 9.2⁷ Eks. 16.33; Hebr. 9.4⁸ Joan 10.28; 17.2⁹ Ps. 70(71).3¹⁰ Ps. 111(112).4; Lluk. 1.79; Rom. 2.19¹¹ II Tim. 2.3¹² Juda 23^{12a} Num.14.19 etj.¹³ Rom. 1.26¹⁴ Gjen. 35.3 etj.¹⁵ I Thes. 5.5¹⁶ Ps. 108(109).2-3¹⁷ II Kron. 6.39¹⁸ I Mbret. [Sam.] 1.15; Ps. 141(142).3¹⁹ Ps. 87(88).4²⁰ Jona 2.6-7²¹ Ps. 117(118).14; Vep. 4.12; 13.47;
Hebr. 2.10; 5.9²² Gjen. 3.16-19²³ III [I] Mbret. 17.1; 18.15;

IV [II] Mbret. 3.14; 5.16

²⁴ Sirak 43.9²⁵ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 22-25²⁶ Dan. 3.25-26²⁷ Urt. Sol. 10.17²⁸ Kol. 3.15²⁹ Eks. 13.21-22 etj.³⁰ Jer. 2.12³¹ Kol. 2.9; I Tim. 3.16

MË 24 TË TË NJËJTIT MUAJ

Lindja e profetit të çmuar e të lavdishëm Joan Pararendësi dhe Pagëzori.

Tipikon

1. Nëse bie të premten, në Mbylljen e Analipsit:

Në Mbrëmësore, pas Qëndrimit të parë të Psaltirit, në Thirrtores: 5 të së kremtes dhe 5 të Pagëzorit. Lavdi i Pagëzorit. Tani i së kremtes. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e Pagëzorit. Pasvargjet e së kremtes. Lavdi i Pagëzorit. Tani i së kremtes. Përlëshoret: e së kremtes, e Pagëzorit dhe përsëri e së kremtes.

Në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Litia e Pagëzorit. Tani i së kremtes (kërkoje në Lavdi dhe Tani i Pasvargjeve të Lavdërimeve të së premtës pas Analipsit). Trishenji dhe Përlëshorja e së kremtes. Në Mëngjesore, Ndenjësoret e Pagëzorit dhe, në vend të Hyjlindësoreve, të së kremtes. Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV, Proqimeni dhe Ungjilli i Pagëzorit etj. të Pagëzorit. Kanunet: të dy të së kremtes dhe një i Pagëzorit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e së kremtes. Ndenjësoret: e Pagëzorit dhe e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Pagëzorit dhe Sinaksari. Zbritësoret e Pentikostisë (vetëm e Ting. IV, Mjegull' e mbuloj). Në vend të Më të nderuarën, Ode IX e Kanuneve. Dërgimësoret e së kremtes, e Pagëzorit dhe përsëri e së kremtes. Lavdërimet: 3 të së kremtes dhe 3 të Pagëzorit. Lavdi i Pagëzorit. Tani i së kremtes. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e së kremtes.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e së kremtes. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e së kremtes, e Pagëzorit dhe e kishës. Kontaqi i së kremtes. Apostulli dhe Ungjilli i Pagëzorit. Në vend të Të meriton, Irmosi i Odes IX i Kanunit të së kremtes (Ti llambadhen e shkëlqyer). Kungatore e së kremtes. Në vend të Pamë dritën, Përlëshorja e së kremtes.

2. Nëse bie të Shtunën e Shpirtrave:

Shërbesa e Pagëzorit psalet një ditë më parë (shih §1).

3. Nëse bie të Dielën e Pentikostisë:

Në Mbrëmësore, pas Kathizmës së parë të Psaltirit, Thirrtores: 6 të së kremtes dhe 4 të Pagëzorit. Lavdi i Pagëzorit. Tani i së kremtes. Hyrje. O dritë gazmore.

Proqimeni i ditës. Leximet dy të së kremtes dhe një i Pagëzorit. Pasvargjet e së kremtes. Lavdi i Pagëzorit. Tani i së kremtes. Përlëshoret: e së kremtes, e Pagëzorit dhe përsëri e së kremtes.

Në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Litia e së kremtes dhe e Pagëzorit. Tani i së kremtes. Trishenjtë dhe Përlëshorja e së kremtes. Në Mëngjesore, Ndenjësoret e Pagëzorit dhe, në vend të Hyjlindësoreve, të së kremtes. Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV, Proqimeni dhe Ungjilli i Pagëzorit (i Liturgjisë së tij) etj. të Pagëzorit. Kanunet: të dy të së kremtes dhe një i Pagëzorit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e Pagëzorit. Ndenjësoret: e Pagëzorit dhe e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e së kremtes. Sinaksari i ditës dhe i Pentikostarit. Zbritësoret dublikate të së kremtes. Në vend të Më të nderuarën, Ode IX e Kanuneve. Dërgimësoret e para e së kremtes, e Pagëzorit dhe e dyta e së kremtes. Lavdërimet: 3 të së kremtes dhe 3 të Pagëzorit. Lavdi i Pagëzorit. Tani i së kremtes. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e së kremtes.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e së kremtes. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e së kremtes dhe e Pagëzorit. Kontaqi i së kremtes. Sa u pagëzuat. Apostulli dhe Ungjilli i së kremtes. Në vend të Të meriton, Zbritësorja e parë e Odes IX të së kremtes (Ting. i Rëndë, Ti që na linde). Kungatore e së kremtes [dhe Në kujtim të përjetshëm]. Në vend të Pamë dritën, Përlëshorja e së kremtes. Emri i Zotit.

Mbrëmësorja (e Gjunjëzimit) kryhet si zakonisht.

4. Nëse bie të Hënën e Shpirtit të Shenjtë:

Në Mbrëmësoren (e Gjunjëzimit), Thirrtoret: 3 të Pentikostarit dhe 5 të Pagëzorit. Lavdi i Pagëzorit. Tani i Pentikostarit. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i Madh. Uratat e Gjunjëzimit. Pasvargjet e Pentikostarit. Lavdi i Pagëzorit. Tani i Pentikostarit. Përlëshoret: e së kremtes, e Pagëzorit dhe përsëri e së kremtes.

Në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Litia e Pagëzorit. Tani i së kremtes. Trishenjtë dhe Përlëshorja e Pagëzorit. Në Mëngjesore, Ndenjësoret e Pagëzorit dhe, në vend të Hyjlindësoreve, Ndenjësoret e Pentikostarit (pas Ndenjësores së Polieleit, Ndenjësorja e tretë e së kremtes, e Pentikostisë). Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV. Proqimeni dhe Ungjilli i Pagëzorit etj. të tij. Kanunet: të dy të Pentikostarit dhe një i Pagëzorit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e Pagëzorit. Ndenjësorja e Pagëzorit dhe e Pentikostarit. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia

e Pentikostarit. Sinaksari i ditës dhe i Pentikostarit. Zbritësoret (vetëm e Ting. IV, Mjegull' e mbuloj). Në vend të Më të nderuarën, Ode IX e Kanuneve. Dërgimësoret: e para e Pentikostarit, e Pagëzorit dhe e dyta e Pentikostarit. Lavdërimet: 3 të Pentikostarit dhe 3 të Pagëzorit. Lavdi i Pagëzorit. Tani i Pentikostarit. Dhokso-logjia e Madhe. Përlëshorja e së kremtes.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e së kremtes. Përlëshoret: e Pentikostarit dhe e Pagëzorit. Kontaqi i Pentikostarit. Sa u pagëzuat. Apostulli i Pentikostarit dhe Ungjilli i Pagëzorit. Në vend të Të meriton, Zbritësorja e dytë e Odes IX të së kremtes (O Hyjlindëse Virgjëreshë). Kungatore e Pentikostarit [dhe Në kujtim të përjetshëm]. Pamë dritën. Emri i Zotit.

5. Nëse bie të martën ose të mërkurën, ose të enjten, ose të premten pas Pentikostisë:

Në Mbrëmësore, Thirrtoret: 7 të Pagëzorit në 8. Lavdi të Pagëzorit. Tani i së kremtes (kërkoje në Pasvargjet e së kremtes, Idhiomeli i dytë). Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e Pagëzorit. Pasvargjet e Pagëzorit. Lavdi i Pagëzorit. Tani i së kremtes. Përlëshoret: e së kremtes, e Pagëzorit dhe përsëri e së kremtes.

Në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Litia e Pagëzorit. Tani i së kremtes (kërkoje në Thirrtoret e Mbrëmësore, Idhiomeli i parë). Trishenjtë dhe Përlëshorja e Pagëzorit. Në Mëngjesore, Ndenjësoret e Pagëzorit dhe, në vend të Hyjlindësoreve, dy të së kremtes (të parën dhe të tretën) dhe një të ditës (kërkoje pas Odes III). Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV, Proqimeni dhe Ungjilli i Pagëzorit etj. të Pagëzorit. Kanunet: një i së kremtes (të martën dhe të enjten i pari, të mërkurën dhe të premten i dyti) dhe të Pagëzorit. Pas Odes III, Ndenjësorja e Pagëzorit dhe e së kremtes (ajo pas Stihologjisë së dytë). Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Pagëzorit dhe Sinaksari. Zbritësoret e së kremtes (vetëm e Ting. IV, Mjegull' e mbuloj). Më të nderuarën. Dërgimësoret: e Pagëzorit dhe një e së kremtes. Lavdërimet: 4 të Pagëzorit. Lavdi i Pagëzorit. Tani i së kremtes. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e Pagëzorit.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e së kremtes. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e së kremtes, e Pagëzorit dhe e kishës. Kontaqi i së kremtes. Apostulli dhe Ungjilli i Pagëzorit. Të meriton. Kungatore Në kujtim të përjetshëm.

6. Nëse bie në Mbylljen e Pentikostisë:

Në Mbrëmësore, pas Qëndrimit të parë të Psaltirit, Thirrtoret: 5 të së kremtes dhe 5 të Pagëzorit. Lavdi i Pagëzorit. Tani i së kremtes. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e Pagëzorit. Pasvargjet e së kremtes. Lavdi i Pagëzorit. Tani i së kremtes. Përlëshoret: e së kremtes, e Pagëzorit dhe përsëri e së kremtes.

Në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmi 50, Litia e Pagëzorit. Tani i së kremtes. Trishenji dhe Përlëshorja e së kremtes. Në Mëngjesore, Ndenjësoret e Pagëzorit dhe, në vend të Hyjlindësoreve, të së kremtes. Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV, Proqimeni dhe Ungjilli i Pagëzorit etj. të Pagëzorit. Kanunet: të dy të së kremtes dhe një i Pagëzorit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e së kremtes. Ndenjësoret: e Pagëzorit dhe e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Pagëzorit dhe Sinaksari. Zbritësoret dublikate të së kremtes. Në vend të Më të nderuarën, Ode IX e Kanuneve. Dërgimësoret: e së kremtes, e Pagëzorit dhe përsëri e së kremtes. Lavdërimet: 3 të së kremtes dhe 3 të Pagëzorit. Lavdi i Pagëzorit. Tani i së kremtes. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e së kremtes.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e së kremtes. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e së kremtes, e Pagëzorit dhe e kishës. Kontaqi i së kremtes. Apostulli dhe Ungjilli i Pagëzorit. Në vend të Të meriton, Zbritësorja e dytë e Odes IX të së kremtes (O Hyjlindëse Virgjëreshë). Kungatore e së kremtes [dhe Në kujtim të përjetshëm]. Pamë dritën.

7. Nëse bie të Dielën e Gjithë Shenjtorëve:

Në Mbrëmësore, Thirrtoret: 3 ngjallësore, 4 të Pagëzorit dhe 3 të Shenjtorëve. Lavdi i Pagëzorit. Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet: dy të Pagëzorit dhe një i Shenjtorëve. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i Shenjtorëve. Tani i Pagëzorit (kërkoje në Tani i Thirrtoreve të Mbrëmësorës së Madhe: Elisabeta zuri Pararendësin). Përlëshoret: ngjallësore, e Pagëzorit, e Shenjtorëve dhe Hyjlindësore ngjallësore (Misteri i fshehur).

Në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmi 50, Kanuni Triadik. Litia e Pagëzorit (psalet dhe Idhiomeli i Lavdisë pa thënë Lavdi) dhe Litia e Shenjtorëve. Lavdi i Shenjtorëve. Tani i Pagëzorit (kërkoje në Tani e Pasvargjeve: Shih Elisabetën). Himne Triadike. Trishenji dhe Përlëshorja e Pagëzorit. Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë dhe të dytë, të Pentikostarit. Pas Polieleit, Ndenjësoret (pas

Polieleit) e Pagëzorit. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimeni i Tingullit. Kanunet: ngjallësor, një i Pagëzorit dhe i Shenjtorëve. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e Shenjtorëve. Ndenjësorja e Pagëzorit, e Shenjtorëve dhe Hyjlindësorja e tyre. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Pagëzorit. Sinaksari i ditës dhe i Pentikostarit. Zbritësoret Ja gojën e çel tani; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Më të nderuarën. Dërgimësoret: ngjallësore, e Pagëzorit, e Shenjtorëve dhe Hyjlindësorja e tyre. Lavdërimet: 2 ngjallësore, 3 të Pagëzorit dhe 3 të Shenjtorëve. Lavdi i Pagëzorit. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të Tingullit, 4 nga Ode III të Pagëzorit dhe 4 nga Ode VI të Shenjtorëve. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e Pagëzorit, e Shenjtorëve dhe e kishës. Kontaqi i Shenjtorëve (kërkoje para Shtëpisë). Apostulli i Shenjtorëve. Ungjilli i Pagëzorit. Të meriton. Kungatore Në kujtim të përjetshëm [dhe e Shenjtorëve].

8. Nëse bie në një nga të dielat jashtë Pentikostarit:

Në Mbrëmësore, Thirrtoret: 4 ngjallësore dhe 6 të Pagëzorit. Lavdi i Pagëzorit. Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e Pagëzorit. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi si dhe Tani i Pagëzorit. Përlëshoret: ngjallësore, e Pagëzorit dhe Hyjlindësore ngjallësore (Misteri i fshehur).

Në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanuni Triadik. Litia e Pagëzorit. Himne Triadike. Trishenjtë dhe Përlëshorja e Pagëzorit. Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë dhe të dytë, Ndenjësoret ngjallësore. Pas Polieleit, Ndenjësoret (pas Polieleit) e Pagëzorit. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimeni i Tingullit. Kanunet: ngjallësor dhe të Pagëzorit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore. Ndenjësoret e Pagëzorit. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Pagëzorit dhe Sinaksari. Zbritësoret Ja gojën e çel tani; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Më të nderuarën. Dërgimësoret: ngjallësore dhe të Pagëzorit. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të Pagëzorit. Lavdi i Pagëzorit. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të Tingullit dhe 4 nga Ode VI e Kanunit të dytë të Pagëzorit. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e Pagëzorit dhe e kishës. Kontaqi Mbrojtje e paturpëruar. Apostulli dhe Ungjilli i Pagëzorit. Të meriton. Kungatore [Lavdëroni dhe] Në kujtim të përjetshëm.



NË MBRËMËSOREN E VOGËL

Thirrtores

Ting. IV O eks ipsistu klithís

Lindi nga mitra shterpë ai që zgjidhi shterpësinë e zemrave tona dhe u dhuron shpitrave të pafrytshëm¹ arsye, lindje të mirë në besim dhe në të vërtetë, Pararendësi i lavdëruar i pranisë së Krishtit,² zëri kuptimplotë i Fjalës,³ parasinjalizuesi me zë të lartë i pendimit,⁴ i cili njihet qartazi ndërmjetës i hyjshëm mes së Vjetrës dhe të Resë.⁵ Lindjen e tij le ta kremtojmë të ngazëlluar me mallëngjim.

(2x)

Viçi i ushqyer⁶ i vetëpërmbajtjes tani nga sterilja ka lindur, duke na treguar disi qengjin që lindi prej së resë Virgjëreshë dhe ngre shkeljet e botës;⁷ turtullit që i pëlqen shkretëtira u shfaq qartas, duke na lajmëruar pranverën hyjnore, përmes saj pushoi dimri⁸ tepër i rëndë i ateizmit; dhe erdhi madhërisht miku i sinqertë i dhëndrit,⁹ Joani, i cili ndërmjeton që të shpëtojnë shpirtrat tanë.

Ti ke lindur sipas premtimit hyjnor, kur kryeengjëlli i hyjshëm, i tërëmadh i ungjillëzoi në Tempull lindjen tënde

lindësit tënd që lutej; atëherë, meqë prifti nuk besoi dhe kundërshtoi, siç është shkruar, Gabrieli i mori gojën dhe e la shurdh deri në lindje; mirëpo ti, o Pararendës i lumur, sapo linde, çlirove atin nga prangat e gjuhës dhe ndërmjeton për të gjithë ne.

Lavdi *Ting. Tërth. IV*

Ika hije Joanit era e këndshme, i përket Pagëzorit hijeshia e këngëve, sepse ai shpalli fillimin e shpëtimit tonë, ai që kërcente në bark¹⁰ dhe thërriste në shkretëtirë «Pendohuni»,⁴ ushtari i mbretit, pararendësi i Hirit, që paralajmëronte qengjin⁷ dhe Shpëtimtarin, dhe ndërmjeton për shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

O Zonjë, pritni lutjet e shërbëtorëve të tu edhe çlirona ne nga çdo nevojë dhe pikëllim.

Pasvargje

Ting. II Ikos tu Efrathá

Fuqizojë shkëlqyeshëm gjuhën tënde, o Zaharia, duke thënë se fëmia do të jetë profet i të Tërëllartit¹¹ dhe Pararendës i Fjalës Perëndi.^{11a}

Varg: I bekuar është Zoti, Perëndia i Izraelit.¹²

O Joan, u duke që nga mitra nënore i shenjtëruar¹³ për Perëndinë, sepse askush prej vdekatarëve nuk u ngrit ndonjëherë deri tani më i madh se ti.¹⁴

Varg: Edhe ti, o fëmijë, profet i të Tërë-lartit do të quhesh.¹¹

Po zgjidhe, o i tërëlumur, memecë-rinë e atit, siç zbërtheve çelësat e pa-fëmijësisë së lindëses, kur linde nga Hiri hyjnor.

Lavdi *dhe* Tani

O e Dëlrë, e vetmja shpresë dhe mbrojtëse e të krishterëve, përgjëroju bashkë me Pararendësin Birit tënd për shërbëtorët e tu.

Përlëshore

Ting. IV

O profet dhe Pararendës

Lavdi *dhe* Tani

Hyjlindësore



NË MBRËMËSOREN E MADHE

*Pas Qëndrimit të parë të Psaltirit
(Lum ai njeri)*

*Thirrtores Idhiomele
Ting. IV I Joan Monakut*

Pasi lindi, Joani zgjidh heshtjen e Zaharias, sepse nuk duhej të heshte ati kur doli zëri;³ por sikundër lidhi më parë gjuhën meqë nuk e besoi, kështu duhej, kur u zbulua, t'ia jepte atit lirinë. Atij iu ungjillëzua dhe u bë zëri i Fjalës³ dhe pararendësi i dritës,¹⁵ edhe ndërmjeton për shpirtrat tanë.

I njëjti

Sot zëri i Fjalës³ zgjidh zërin atëror që mbahej për shkak të pabesisë dhe, duke zgjidhur prangat e shterpësisë nënore, shfaq se Kisha bëhet me fëmijë të mirë.¹⁶ Del kandili¹⁷ i dritës.¹⁵ Agimi lajmëron ardhjen e Diellit të drejtësisë,¹⁸ për rigatimin e të gjithëve dhe shpëtimin e shpirtrave tanë.

I njëjti I Anatoliut

Meqë ka për të lindur nga një Virgjëreshë Fjala Perëndi,^{11a} del nga dhimbjet e lindjes sterile engjëll,¹⁹ i madhi mes të lindurve prej grave¹⁴ dhe më tepër se profet,²⁰ sepse duhej që fillimet e gjërave hyjnore të ishin paradoksale: pjelloria jashtë moshës dhe zënia pa mbjellje.²¹ Ti që bën të çuditshme²² për shpëtimin tonë, lavdi ty.

I njëjti I Andreas së Kretës

U shfaq sot, pasi doli nga mitra jo-

pjellore e Elisabetës, Pararendësi i madh, profeti më i madh se të gjithë profetët,²⁰ që s'ka e as u ngrit tjetër si ai,¹⁴ sepse pas kandilit¹⁷ pararendës vjen drita e përmbishkëlqyer,¹⁵ pas zërit³ Fjala, pas prezantuesit dhëndri⁹ që bën për Zotin një popull të zgjedhur²³ dhe parapastron me ujë për Shpirtin,²⁴ lastari i Zaharias dhe biri më i mirë i shkretëtirës,²⁵ predikuesi i pendimit,⁴ pastrimi i fajeve, ai që u ungjillëzon atyre që janë në Hadh ngjalljen prej së vdekurish, dhe ndër-mjeton për shpirtrat tanë.

I njëjti

O Joan, u tregove që nga barku¹³ profeti dhe Pararendësi i Krishtit duke kërcyer dhe ngazëlluar në barkun e nënës,¹⁰ duke parë mbretëreshën që erdhi drejt shërbëtores,²⁶ duke sjellë të pamotshmin që nga Ati është pa nënë, te ti që linde prej shterpës dhe plakut sipas premtimit; atij lypi që të shpëtohen shpirtrat tanë.

I njëjti

O çudi paradoksale! Sot sheh të lindet ai që u premtua, e sheh atë ai që nuk iu bind fjalës së engjëllit që thoshte se «Do të mbarset Elisabeta dhe do të lindë bir», ai që thoshte «Si do lindë ajo, sepse edhe unë jam i

kaluar në moshë edhe gjymtyrët e saj kanë mbaruar», ai që u dënua të heshtë për shkak të pabesisë; dhe, pasi u zgjidh nga heshtja, mikpret ngazëllim, dhe thërret: I bekuar është Zoti, Perëndia i Izraelit, sepse vizitoi popullin e vet dhe i bëri çlirim atij, ai që i jep botës përdëllimin e madh.^{26a}

I njëjti

O Joan i tërëfamshëm dhe apostull ekumenik, ungjillëzimi i Gabrielit, lastari i shterpës, filizi më i mirë i shkretëtirës²⁵ dhe miku autentik i Krishtit dhëndër,⁹ lutju atij të mëshirohen shpirtrat tanë.

Lavdi

Ting. Tërth. II I Bizantit

Sot, si yll i ndritshëm, kandili¹⁷ i dritës¹⁵ parapërgatit udhën për ardhjen e Fjalës Perëndi.^{11a} Sot Zaharia fuqizoi gjuhën, pasi ushtroi heshtjen, kur urdhëroi engjëll; sepse duhej kështu, të mos ruante heshtjen ati, kur zëri doli nga barku shterpë³ dhe ungjillëzonte shumë haptazi çlirimin e tërë botës.⁷

Tani *I njëjti*

Elisabeta zuri Pararendësin e Hirit, ndërsa Virgjëresha Zotin e lavdisë.²⁷ Puthën njëra-tjetrën nënat²⁸ dhe

foshnja kërceu,¹⁰ sepse përbrenda shërbëtori himnonte Zotin. Si u çudit nëna e Pararendësit, zuri të thërriste: «Nga më ngjau kjo, të vijë tek unë nëna e Zotit tim,²⁶ që të shpëtojë një popull të dëshpëruar?». Ti që ke përdëllimin e madh,^{26a} lavdi më ty.

Hyrje. O dritë gazmore.

Proqimeni i ditës dhe Leximet

Këndimi i Gjenezës

(17.15-17,19; 18,11-14; 21.1-2,4-8)

I tha Zoti Perëndia Abrahamit: «Sara, gruaja jote, nuk do quhet emri i saj Sara, por Sarra do të jetë emri i saj. Dhe do ta bekoj dhe do të të jap prej saj fëmijë dhe do ta bekoj dhe do të jetë në kombe dhe mbretër kombesh do të dalin prej tij». Dhe ra përmbys Abrahami dhe qeshi dhe tha në mendjen e tij, duke thënë: «A do të bëhet bir te njëqindvjeçari? Dhe a Sarra, duke qenë nëntëdhjetë vjeçe, do të lindë?» Dhe i tha Perëndia Abrahamit: «Po. Ja ku Sarra, gruaja jote, do të të lindë bir, dhe do ta quash emrin e tij Isaak; dhe do ta vendos dhiatën time tek ai në dhiatë të përjetshme». Dhe Abrahami dhe Sarra *ishin* pleq, të ecur në ditë. Dhe qeshi Sarra me veten e saj duke thënë: «Nuk m'u bë deri tani, ndërsa zotëria im është i

moshuar». Dhe i tha Zoti Perëndia Abrahamit: «Pse qeshi Sarra me veten e saj duke thënë: "Mos vallë do të lind me të vërtetë? Dhe unë u plaka". Mos do të jetë e pamundur për Perëndinë çdo fjalë?». Dhe Zoti i erdhi Sarrës, siç foli dhe pasi ajo u ngjiz, i lindi Abrahamit një bir në pleqëri, në kohën siç i foli Zoti. Dhe e rrethpriste në ditën e tetë, siç i porositi Zoti Perëndia. Dhe Abrahami ishte njëqind vjeç kur iu bë Isaaku, biri i tij. Dhe tha Sarra: «Më solli qeshje Zoti, sepse çdokush që do dëgjojë, do të gëzohet me mua». Dhe tha: «Kush do t'i lajmërojë Abrahamit se Sarra i jep gjë fëmijës, sepse linda bir në pleqërinë time?» Dhe u rrit fëmija dhe pushoi të pijë gjë; dhe bëri Abrahami një gosti të madhe në ditën kur pushoi të pijë gjë Isaaku, biri i tij.

Këndimi i Gjykatësve

(13.2-8,13-14,17-18,21)

Në ato ditë u bë një burrë nga fisi i Dhanit dhe emri i tij, Manoe; dhe gruaja e tij *ishite* shterpë dhe nuk linte. Dhe u shfaq engjëll Zoti te gruaja dhe i tha: «Ja që ti je shterpë dhe nuk ke lindur; dhe do të zësh bir. Dhe tani ruhu pra, dhe të mos pish verë dhe siqera, dhe të mos hash asgjë të papastër; sepse ja ku do të kesh në bark

dhe do të lindësh bir, dhe hekur nuk do të ngjitet mbi kokën e tij, sepse fëmija do të jetë që nga barku nazirë për Perëndinë”. Dhe erdhi gruaja dhe i tha burrit të vet, duke thënë: «Një njeri i Perëndisë erdhi drejt meje, dhe pamja e tij si pamja e engjëllit të Perëndisë, tejet e shquar; dhe tha: “Ja që ti do të zësh në bark dhe do të lindësh bir; dhe tani ruhu dhe të mos pish verë dhe siqera, dhe të mos hash asgjë të papastër, sepse nazireu i Perëndisë do të jetë fëmija që nga barku deri në ditën e vdekjes së tij». Dhe iu lut Manoe Zotit dhe tha: «Në mua, o Zot, njeriu i Perëndisë që e dërgove, le të vijë pra përsëri drejt nesh dhe le të na ndriçojë se çfarë do t’i bëjmë fëmijës që lindet». Dhe erdhi engjëlli drejt Manoes dhe tha: «Nga të gjitha që i thashë gruas sate, le të ruhet; nga çdo gjë që del nga vreshti nuk do hajë, dhe verë dhe siqera le të mos pijë». Dhe i tha Manoe engjëllit: «Si e ke emrin? që kur të vijë fjala jote të të lavdërojmë?». Dhe i tha engjëlli i Zotit: «Pse pyet për emrin tim? dhe ky është i çuditshëm». Dhe nuk shtoi më engjëlli i Zotit të duket drejt Manoes dhe drejt gruas së tij.

Këndimi i profecisë së Isaia
 (40.1-5,9; 41.17-18; 45.8;
 48.20-21; 54.1)

Këto thotë Zoti: «Ngushëlloni, ngushëlloni popullin tim», thotë Perëndia. «Priftërinj, flisni në zemrën e Jerusalemit. Ngushëllojeni sepse u mbush përulja e tij, sepse u zgjidh mëkati i tij, sepse pranoi nga dora e Zotit dyfish mëkatet e tij». Zë i dikujt që thërrret në shkretëtirë: «Përgatisni udhën e Zotit, të drejta bëni rrugët e Perëndisë tonë. Çdo grykë e thellë do të mbushet, dhe çdo mal e kodër do të ulet; dhe do të jenë tërë të shtrembra në të drejta, dhe të ashpra në udhë të buta; dhe do ta shikojë çdo mish shpëtimin e Perëndisë». Mbi mal të lartë ngrihu ti që ungjillëzon Sionin, lartësoje me fuqi zërin tënd ti që ungjillëzon Jerusalemin; lartësoni, mos kini frikë. «Unë jam Zoti Perëndia, unë do të dëgjoj, Perëndia i Izraelit, dhe nuk do t’i braktis ata; por do të hap mbi malet lumenj dhe mes fushave, burime; do ta bëj shkretinë, në kënetë ujërash, dhe dhenë e etur, në ujësjellëse». Le të dëfresë qielli lart dhe retë le të spërkasin drejtësi, le të lindë toka dhe le të nxjerrë mëshirë, dhe drejtësi le të lindë së bashku. Njoftoni zë ngazëllimi deri në fundin e dheut dhe le të bëhet e dëgjuar kjo. Thoni: «Çliroi Zoti shërbëtorin e tij, Jakovin». Dhe nëse do të kenë etje mes shkretëtire, do t’i udhëzojë ata, do t’iu nxjerrë ujë prej guri. Dëfre, o shterpë

që nuk lind, shpërthe dhe bërtit ti që nuk ke dhimbje lindjeje, sepse shumë *do të jenë* fëmijët e së shkretës, më shumë se të asaj që ka burrin.

Në Liti Idhiomele

Ting. I

Pikoni, o male, ëmbëlsi²⁹ dhe, kodra, si qengja kërceni,³⁰ sepse lindi prej Elisabetës ai që ka për të jetuar mbi ju,²⁵ Pararendësi i Zotit, ai që gjatë lindjes zgjidhi gojën memece të atit; prandaj dhe ne i thërrasim: O Pagëzor i Krishtit, ndërmjeto të shpëtojnë shpirtrat tanë.

I njëjti

O zë i hyjshënuar,³ kandili¹⁷ i dritës,¹⁵ Pararendësi i Zotit, i pari i profetëve siç u dëshmove prej Krishtit,²⁰ duke ndërmjetuar për botën, lyp veçanërisht që të shpëtojë pa plagë grigja jote.

I njëjti

U bëre predikues i qengjit të Perëndisë⁷ dhe Fjalës, o Joan profet dhe Pararendës; profetizon të ardhmet dhe parathua anëmbanë: Ja qengji i Perëndisë që ngre mëkatën e botës⁷ dhe u jep të gjithëve përdëllimin e madh.^{26a}

Lavdi

Ting. Tërth. I I Andreas së Kretës

Skajin e profetëve²⁰ dhe fillimin e apostujve, engjëllin¹⁹ tokësor dhe njeriun qiellor, zërin³ e Fjalës, ushtarin³¹ dhe Pararendësin e Krishtit, i cili parakërceu¹⁰ nga premtimi dhe parapredikoi para lindjes diellin e drejtësisë,¹⁸ sot Elisabeta e lind dhe gëzohet; dhe admirohet Zaharia nga pleqtë, duke hedhur heshtjen poshtë si pranga, dhe si lindësi i zërit³ profetizon tepër qartë: «Sepse ti, o fëmijë, do të quhesh profeti i të Tërëllartit dhe do të ecësh para që t'i përgatitësh udhë».¹¹ Prandaj, o engjëll,¹⁹ profet, apostull, ushtar,³¹ Prodhrom, Pagëzor, predikuesi i pendimit⁴ dhe udhëzuesi³² i dritës,¹⁵ si zëri³ i Fjalës, ndërmjeto pareshtur për ne, që besërisht kremtojmë kujtimin tënd.

Tani *Hyjlindësore*

Ty të lumërojmë, o Hyjlindëse e virgjër, dhe të lavdërojmë ne besnikët siç të ka hije ty, qytetin e patundshëm dhe murin që s'çahet dot, mbrojtjen e pathyeshme dhe strehën e shpirtrave tanë.

Pasvargjet Idhiomele

Ting. II

Profetin prej profeti dhe lastarin e shterpës, më të lartin se të gjithë të lindurit nga gratë,¹⁴ qytetarin e shkretëtirës,²⁵ Joanin e lavdishëm, le ta mburrim me psalme, himne dhe ode shpirtërore,³³ duke i thirrur: O Pagëzor dhe Pararendës i Shpëtimtarit, duke pasur guxim, në lindjen tënde të respektuar lyp Krishtin që t'i dhurohet paqe botës dhe shpirtrave tanë përdëllimi i madh.^{26a}

Varg: I bekuar është Zoti, Perëndia i Izraelit.¹²

Erdhi zëri³ i hirit të Fjalës, predikuesi i diellit, pasi lindi nga premtimi sot prej shterpës papjellore Joan Prodhromi. O popuj, ngazëllohuni. Erdhi që të na hijesojë udhën³ e shpëtimit.³⁴ Pasi kërceu kur ishte në barkun e nënës,¹⁰ iu fal atij, pra qengjit që ngre mëkatën e botës⁷ dhe na jep përdëllimin e madh.^{26a}

Varg: Edhe ti, o fëmijë, profet i të Tërë-lartit do të quhesh.¹¹

Ishenjtëruar që nga barku i nënës,¹³ ai që pranoi plotësimin e profecisë,²⁰ sot nga shterpa ka lindur, duke predikuar fuqishëm ardhjen e Zotit: Pëndohuni, se u afrua mbretëria e qiejve.⁴

Lavdi

Ting. Tërth. IV I Kasiani Murgeshës

Tani zëri i Isaias u përmbush në ngjizjen e sotme të Joanit, më të madhit të profetëve, sepse thotë: «Ja tek dërgoj engjëllin tim para faqes sate,¹⁹ i cili do ta përgatisë udhën tënde».³ Ai pra, ushtari i mbretit qiellor, si pararendi, vërtet i bënte të drejta rrugët e Perëndisë tonë,³ duke qenë njeri në natyrë, por engjëll¹⁹ në jetë, se, pasi përqafoi dëlirësi absolute dhe mençuri, e kishte të natyrshmen, dhe u shmang nga ajo që është jashtë natyrës, si luftoi përmbinatyrshëm. Gjithë besimtarët, duke e imituar në virtyte, le t'i përgjërohemi të ndërmjetojë për ne, që të shpëtojnë shpirtat tanë.

Tani *Injëjti*

Shih Elisabetën që po bisedon me Virgjëreshën Mariam: Përse erdhe tek unë ti, nëna e Zotit tim?²⁶ Ti mban mbret dhe unë ushtar, ti ligjdhënësin dhe unë ligjvënësin, ti Fjalën dhe unë zërin³ që shpalli mbretërinë e qiejve.⁴

Përlëshore Ting. IV

O profet dhe Pararendës i pranisë së Krishtit, nuk gjejmë mënyrën që të të mburrim denjësisht ne, që të nderojmë me përmallim, sepse shterpësia e nënës dhe humbja e zërit të atit u zgjidhën me lindjen tënde të lavdëru-

ar dhe të nderuar, dhe i shpallet botës mishërimi i Birit të Perëndisë.

Lavdi *dhe* Tani
Hyjlindësore

Misteri i fshehur prej jete³⁵ dhe i panjohur ndër engjëjtë³⁶ u shfaq³⁷ ndër të dheshmit me anën tënde o Hyjlindëse, Perëndia që u mishërua me bashkim të papërzier dhe denjoi kryq për ne duke dashur, me të cilin ngjalli të parëgatuarin dhe shpëtoi prej vdekjes shpirtat tona.*



NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë, Ndenjëso
Ting. V Kateplaji Iosif*

Zaharia nxjerr tani* për ne filizin që dëfren* besimtarët mendërisht,* shndrit Pagëzori çdo mendim.* Stoli shkretie²⁵ dhe bazë profetësh është,*²⁰ ndaj u shfaq Prodhromi i Krishtit Zot* dhe pranin' e tij pa gënjeshtër tha,* dëshmoi; pra me këngë shpirtërore*³³ le t'i thërrasim me një zë ne:* Profet dhe shpallës* i së vërtetës,* ndërmjeto të shpëtojmë.

Lavdi *dhe* Tani
Hyjlindësore

Josifi u çudit, që përmbi natyrën kur pa, dhe at'herë mernte vesh k'të shiu përmbi lëmsh³⁸ në zënien tënde të pafarshme, o Hyjlindëse, ferrën që në zjarr ish e padjegshme,³⁹ shkopin e Aaronit që zu rrënj' e lulëzoj;⁴⁰ i fejuari yt ruajtës dëshmoj e u thërriste prift-rinjve: Virgjëresha lind dhe pas lindjes mbetet prapë e virgjër.*

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjëso
Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon*

Kryetari mbi gjithë profetët je,*²⁰ Pagëzor dhe apostull me plot lavdi;* prania e Krishtit tënd* të kish nisje, o shën Joan,* çuditërisht vërtet linde, zëri³ i Fjalës Zot* ke qenë, ndaj thërrisje: «Pendohuni, se afron,* po vjen Mbretëria qiellore»;⁴ pra udhën* e Zotit e kreve drejt,*³ Pararendës i Hirit ti* u tregove* në çdo anë,* ndërmjeto te Zoti yt Krisht,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tënd fort të shenjt' me mall.

Lavdi *dhe* Tani
Hyjlindësore

Oe virgjër dhe nënë e Perëndisë,* ti pasionet e egra, e Tërëshenjt',* të shpirtit tim m'i shëro,* lutem, dhe falje më dhuro* për shkeljet që kam bërë i marri, se ndota keq* si shpirtin, edhe trupin, mjerani un'. Oh, ç'do bëj* po në atë orë, ndërsa engjëjt do ndaj-

në* nga trupi im shpirtin tim* të pandreqshëm që ra përdhé;* atëherë,* o Zonja jon',* forca, ndihma ime m'u bëj* dhe mbrojtëse mjaft e flaktë* me plot fuqi,* sepse unë shërbyesi yt të kam shpresë.

*Pas Polieleit, Ndenjësores
Ting. Tërth. IV To prostathén
mistikós*

O atë, ki gaz, o nënë, sot dëfre tok,* se mbi dhé linde* të hyjftuarin, profetin* Pararendës që mbiu* me premtim; kështu pra* i jep foshnjës Pa-gëzor shterpa gjë, gëzon* për lindjen shën Zaharia,* thotë: U zgjidh* gjuha ime kur erdhe mbi dhé, o kandil, llamb'¹⁷ e dritës fort të madhe,¹⁵ o çudi,* paradoks, por realitet.

*Lavdi dhe Tani
Hyjlindësore*

Si mori vesh porosin' e perëndi-shme* engjëlli zbriti* në banesën e Josifit* dhe ia pruri Marisë* menjëherë lajmin:* Anoi me bashkëzbritjen q'ellin⁴¹ mbi dhé,* kur hyri i pandryshuar* në gjirin tënd* dhe atë kur e shoh me sy të mishëruar si rob⁴² çuditë dhe thërres me zë:* Gëzohu, nuse e panusëruar.^{43*}

*Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV
Proqimeni Ting. IV*

Dhe ti, o fëmijë, profet i të Tërëllartit do të quhesh, sepse do të ecësh para fytyrë Zotit, që të bësh gati udhët e tij.¹¹

Varg: I bekuar është Zoti, Perëndia i Izraelit.¹²

Ungjilli. Psalmi 50.

Lavdi. Me ndërmjetimet e Prodhromit tënd.

Tani. Me ndërmjetimet e Hyjlindësës. Përdëllemë, o Perëndi. *Dhe Idhiomeli.*

Ting. II

I shenjtëruar që nga barku i nënës,¹³ ai që pranoi plotësimin e profecisë,²⁰ sot nga shterpa ka lindur, duke predikuar fuqishëm ardhjen e Zotit: Pendohuni, se u afrua mbretëria e qiejve.⁴

*Kanunet
Ode I*

*Ky kanun është poezi e Joan
Damaskinoit, dhe ka Akrostihidhë:
"Gëzohem tani në lindjen
e Pararendësit".*

Ting. IV

Irmosi: Tristatas kráteús

»**K**arroc' me tre të fort',* pra tri pjesët e shpirtit,* lutem, mbyti krejt në »fund*⁴⁴ pa vese, ti që lind* nga e »Virgjra, që të të psal * meloditë tri- »umfale* përmes vrasjes së trupit

»tim* të mëkatshëm, porsì me tim-
»ban⁴⁵ mendor.

Filiz prej shterpës lind,* para Diellit
po rend* si agim me hijeshi,* dhe
sheshit shpall me zë,* se tani Biri
virgjëror* feks në tërë botën* dhe
shkëlqen anembanë nur* dritë
shpresëtarie edhe hir tok.

«**V**ërtet do quhesh ti* pra profet i të
Lartit,* para Krishtit do të shkosh,*¹¹
Joan, o famëmadh»,* i thërret birit
qartësisht* Zaharia, «do bësh gati*
për Ndërtuesin udhën³ shesh,* për-
mes nxitjes së Shpirtit të Tërë-
shenjt'». ⁴⁶

I bindur nuk u duk* Zaharia te fja-
lët,* tek ai hyjnori lajm* që Gabrieli
tha,* e lë goja pra si dënim;* por nga
ky papritur zgjidhet* sapo zëri,³ Joa-
ni lind,* Pararendës i hyjshëm i Fja-
lës Zot.

Hyjlindësore

Thesar me plot nderim* dhe hyjpri-
tës i mirë,* o Hyjlindëse pa cen* dhe
pa qortim aspak,* je qyteti i Perë-
ndis'*⁴⁷ tërëmbret; trashëgiminë* që
ke, ruaje, se gjithnjë* të lëvdon dhe
me besë mburr Birin tënd.

*Kanuni tjetër që ka Akrostihidhë:
"Pararendësin, gëzimim
e përbashkët, e mburr me mall",*

ndërsa në Hyjlindësoret:

"I Gjergjit".

Ting. i njëjti

Anikso to stoma mu

Tani zbukurohet Kisha përmes Hirit
të Shenjtit Shpirt,* stoliset dhe hije-
shohet duke kryer me gaz* ditëlind-
jen kjo,* që ka shën Pagëzori* dhe
këngë i thur e i psal me hare dhe gaz.

I hirshmi më shumë se ylli që lind në
mëngjes, agim* dhe shpallës i Hirit
lajmëron sot Diellin Zot* të lavdisë
pra,* po parathotë shndritjen* që ka
për të feksur në çdo skaj të rruzullit.

Dëbohet, o Pararendës, nata e atei-
zmit larg* nga toka me lindjen tënde
dhe përhapet kudo* në planetin ton'*
plot rreze që nga Hiri* burojnë, se Di-
ellin pa perëndim ti shpall.

Hyjlindësore

E shpallte të mundshme, o krejt e
pacen, zënien tënde pra* sterilja që
ish shtatzënë, parashpallte kështu*
paralajmërim*²⁶ për lindjen tënde pa
far',* se solli pra fryt nga një mitër
pa pjellori.

Zbritësore: Anikso to stoma mu

»**J**a gojën e çel tani, i frymëzuar prej
»Shpirtit⁴⁸ Shenjt* dhe këngë do t'i
»këndoq nënës së madhe mbi fron;*⁴⁹

»dhe do ta kremtoj* me valle buzë-
»qeshur,* me zë do t'i shpall kudo
»gjithë çudit' e saj.*

Ode III

Irmosi: Uk en sofia

»**S'**mburremi fare* për fuqi, urtësi,
»as për pasuri,* por për ty,⁵⁰ o urtësi*
»enipostate e Atit, o Krisht*⁵¹ njeri-
»dashës, se, përveç teje, s'ka tjetër
»shenjt.⁵²

Po kryhet lindje* zotërore nga nënë
e virgjër krejt,* por e moçmjia nënë
shterp'* na lind shërbyes të dashur,
të shtrenjt';* natyrisht çudia shkon
para çudisë pra.

Beronj' e rrudhur* puth të virgjërën
dhe nënën,²⁸ se njohu drejt,* pa ma-
shtrim, se kjo u zgjidh* përmes vull-
netit hyjnor nga zinxhir* shterpësie,
falë atij që prej saj u lind.

Hyjlindësore

Pa njohur burrë* ti që kishe në bark
Perëndi në mish,* më forco, se tun-
dem keq* nga veset që më sulmojnë
me vrull,* se s'ka ndihmë tjetër veç
teje, o e pacen.

Tjetri: Tus sus imnologus

Jehona e lindjes sate prej shterpës
prangat e zërit atëror* i zgjidh edhe

shkëlqyeshëm shpall paralajmërim
hyjnor* për bashkëzbritjen mbi me-
ndim të Krishtit, o i lavdishëm fort.

Si mbive prej shterpës, jopjellores,
kumtar frytëzimi je në Krisht,* preve
me kazmën,⁵³ pra me predikim, mos-
mirënjohjen ti,* jopjellorinë, shterpë-
sin' e Izraelit, të keqit komb.

Shkëlqyen me lindjen tënde, o Para-
rendës, sot rrezet e Hirit* të ri me hije-
shi; simbole,⁵⁴ germa⁵⁵ brenda hijes⁵⁶
pra* filluan të largohen dhe me to
enigma⁵⁷ të lashta⁵⁵ tok.

Hyjlindësore

Yt Bir e ka zgjidhur, o e Virgjër, nga
prangat, dënimi njerëzin',* na lidhi
përmes Hirit ne me veten, dhe bekoi
ky* të gjithë sa të mburrin ty porsì
Hyjlindësen pa qortim.

Zbritësore: Tus sus imnologus

»**O** Zonjë dhe nën' e Perëndisë, bu-
»rim i pasosur jetësor,* ti siguroji
»gjith' ata që të këndojnë plot me
»zell;* dhe lart në q'ell ku mbretëron
»kuronëzoji me çdo lavdi.*

Ndenjësores

Ting. IV Kateplaji Iosif

Si një diell hijesisht* për Zahari-
an lindi bir,* kish Elisabetën nën',*

barku i saj na lindi k'të,* që zgjidhi gjuhën e atit dhe na thërret fort,* fton të gjithë popujt me plot guxim:* «Përgatisni udhët për Zotin drejt,*³ sepse do vijë ky dhe do shpëtojë* sa tek ai kthehen».⁵⁸ O Joan,* e parashpalle* atë, ndaj lypi* të shpëtojnë shpirtrat tanë.

Lavdi *dhe* Tani

Hyjlindësore

Koret mbar' të engjëjve* ndjenë çudi, o e dëlir',* për misterin plot me tmerr* të shtatzënisë sate pra,* se si ai që me shenjë thjesht mban të gjitha* si njeri e mban kraharori yt* dhe i parajetshmi pranon fillim,* thith qumësht ky, ushqyesi i botës* dhe i çdo fryme nga mirësi,* edhe të mburrin* me lavdërime* si Hyjlindësen vërtet.

Ode IV

Irmosi: O kathímenos en dhoksi

»**T**i që rri midis lavdisë* përmbi fro-
»nin⁵⁹ e hijeshëm,* nga një re e leh-
»të*⁶⁰ erdhe, o Jisu i përjetëshëm*
»dhe na shpëtove me dorën jetë-
»dhënëse;* të thërresim pra,* nder
»dhe lavdi gjithënjë mbi ty.*

Përpara mistereve të parrëfyeshme paraprin një mister me risinë e legjislacionit të natyrës, zgjidhja e

sëmundjes, e cila paralajmëron korrigjimin dhe hyjnizimin e saj, o Krisht.

Isaia që nga larg e profetizoi engjëll¹⁹ njerëzor, të barabartë me engjëjt, për Birin që do të mishërohej: Ja ku unë dërgoj para faqes sate dikë që parathërret³ «Lavdi, o Krisht, fuqisë sate».

Kam lindur që t'i shërbej si shërbëtor Zotit, sepse për këtë erdha, që të lajmëroj sheshit ardhjen e tij, se do ta bëjë më parë të besueshme lindjen e Virgjëreshës një plakë shterpë që nxori lastar paradoksalisht.

Hyjlindësore

Nuk u prish në mitër, nuk kishte dhimbje lindjeje Hyjlindësja e shenjtë, në të cilën banoi me mirësi si në shtëpi erëkëndshme Fjala e përmbiperëndishme e Atit, sepse lindi Emanuelin⁶¹ Perëndinjeri.

Tjetri: Tin aneksihniaston

Lumenjtë përgatisin rrjedhat dhe Jordani hijeson që më parë rrymat për Zotin e tij, duke e parë Pagëzorin të lindet tani nga një shterpë.

Dhuratat e mirësisë së Bërësit përkulen nga lart,⁶² meqenëse ylli i mëngjesit përhapet në tokë, dhe predikon ardhjen dhe shkëlqimin e tij.

Sot del nga shterpa mbi tokë trumbetë me zë të lartë,⁶³ Joani, dhe u lajmëron vdekatarëve Mbretin Zot⁶⁴ që do të lindet pashprehshëm nga e Dëlira.

Hyjlindësore

O e Tërëpacenuar, meqë je përmbushja e ikonave dhe e simboleve⁵⁴ në hije,⁵⁶ të gjithë profetët të përhimnuan me zëra që u paralajmëronin të gjithëve madhështimet dhe çuditë e tua.

Zbritësore: Tin aneksihniáston

»Të pagjurmësuarin plan perëndor,*
»që po mishërohet i larti Zot* prej
»Virgjëreshës,* Abakumi si profet e
»pa dhe tha me zë të madh:* O Zot i
»fuqishëm, lavdi më ty.*

Ode V

Irmosi: Nin anastísome profitikós

»«Tani do të ngrihem», tha profeti-
»kisht Perëndia,⁶⁵ «tani do të lartë-
»sohem, tani do të lavdërohem,⁶⁶ pa-
»si mora nga Virgjëresha të rënin, të
»cilin do ta lartësoj drejt dritës së
»mrekullueshme të Hyjnisë sime».

Dheu lindi shpallës të tërëvërtetë, zë që u predikon³ të gjithëve me gjuhën e Shpirtit Birin e së Virgjërës, drejtësi që nga qiejt përkulet⁶⁷ mbi ne me lëndë trupore.

Të vuri Zoti si kandil¹⁷ të tërëvërtetë të Krishtit, që i ndriçon të gjithë⁶⁸ dhe i vesh me turp si me mantel⁶⁹ vetëm armiqtë e tij, duke predikuar pa gënjeshërë Fjalën, Birin e Perëndisë.

E tërë Krijesa ngazëllohet perëndishëm në lindjen tënde, sepse ti, o Pararendës, do të tregohesh engjëll¹⁹ tokësor dhe vdekatar qiellor, duke na paralajmëruar Perëndinë qiellor që do të mishërohet.

Hyjlindësore

Të çuditshmet e tua i thanë zëra profetikë duke të quajtur mal,⁷⁰ portë⁷¹ dhe kandil⁷² të ndritshëm, nga i cili shkëlqimi i mahnitshëm me të vërtetë feks botën e tërë, o e Dëlitë e pacenuar.

Tjetri: Eksesti ta símpanta

Natyra që më parë u dobësua, forcohet për frytdhënien e të mirave, pasi linde prej mitrës jopjellore dhe jetë u shpalle të vdekshmëve, në lindjen tënde, o Prodhrom i tërëkënduar.

Kandili¹⁷ i pashuar, duke dalë nga shterpa, lajmëron Diellin e lavdisë të lindet prej së Virgjërës dhe të shkëlqejë në Hir të gjithë njerëzit me dritën e bashkëzbritjes.

Lidhen gjuhë shumëfolëse të ateizmit dhe buzë zgjerohen⁷³ për lavdinë e pranisë së Perëndisë të të gjithave, meqenëse kjo paralajmërohet dhe fuqishëm parashpallet mbi dhë sot nga Pararendësi.

Hyllindësore

O e Pacenuar, Elisabeta, duke thurur dhoksologji me fjalë profetike për lavdinë tënde e duke u ngazëlluar, i predikonte fuqishëm madhështimet e Birit tënd hyjnor,²⁶ sepse ti je hareja dhe mburrja e të gjithëve.

Zbritësore: Eksesti ta simpanta

»Të gjith' i habite ti me një çudi dhe
»një lavdi,* ti, o Virgjëresh' e pa-
»martuar;* Zotin e jetës që mbretë-
»ron lart⁷⁴ në q'ell si një bir e mbajte
»në pëqi,* dhe shpëtim që lartazi*
»u dhurove besnikëve.*

Ode VI

Irmosi: Ilthon is ta vathi

»Një stuhi më zhyti edhe rashë në
»thellësi të detit,* një stuhi mëka-
»tesh që s'njeh masë,* por, Perëndi,*
»si Zot krejt përdëllimtar,* ma ngri
»jetën të fundosur keq.⁷⁵

Fjalën Perëndi^{11a} e njohe ti, si profet në bark nënor pra* dhe theologon në

dhom' të errët,*¹⁰ se dritë sheh* që nuk ka afrim,⁷⁶ prandaj* dhe përdor gjuhën e lindëses.

O Prodhrom, si zëri i atij që thërret³ pareshtur, lype* Çlirimtarin pa pushtim të zgjidhë* çdo shterpësi* shpirtërore për ata* që himnojnë lindjen tënde pra.

Hyllindësore

Vendi i Hyjnisë që s'ngushtohet në strehë, u tregua,* Vajzë, mitra jote e dëlirë,* nuk mundën dot* ta shikojnë pa frikë* as ushtritë qiellore lart.

Tjetri: Tin thian taftin

O Pararendës, armiku u godit nga shpat' me dy presa, pra me lindjen tënde, meqë ti* shpalle ringjalljen e njerëzve* dhe humbjen e armikut, të kundërshtarit pra.

Nga lartësia hyjnore u përkul⁶⁷ te ne e gjith' pasuria e Hyjnisë haptazi,* pra birësimi i njerëzve*⁷⁷ dhe hiri, se po lind predikuesi i tij.

Derdh shkretëtira aroma mendërisht dhe miro, o famëmadh, në lindjen tënde nga një shterp',* e cila priti pra lajmërim* për Krishtin tonë, miron që s'zbrazet⁷⁸ asnjëher'.

Hyllindësore

Prodhomi njohu se vetëm ti ke qenë Zonja, nëna e Perëndisë, ndaj i hyjshmi pra* parakërceu në bark nënor*¹⁰ dhe madhështit' e tua, e qashtër, shpalli fort.

Zbritësore: Tin thian taftin

»**K**ëtë të kremte e lusim sot, për Zo-
»njën edhe nënën Hyjlindëse, gjithë
»hyjmendësit,* eni trokisni pra duar-
»të*⁷⁹ dhe lavdëroni Zotin që lindi prej
»asaj.*

Kontaqi

Ting. III I Pathenos símeron

Gruaja që shterpë ish* sot lind Prodhromin e Krishtit.* Është ky në profeci* përmbushja,²⁰ se mbi Jisunë,* që e kan'* profetizuar më par' profetët,* vuri dor'* brenda Jordanit, ndaj u tregua* Pararendës, predikues* i Fjalës Zot,^{11a} dhe profet edhe shpallës tok.

Shtëpia

Le ta mburrim tani Prodhromin e Zotit, të cilin Elisabeta i lindi priftit nga mitra pa fryt, por jo pa farë, sepse vetëm Krishti përshkoi vend të pashkelshëm, të pafarshëm. Joanin e lindi shterpë, por jo pa burrë; ndërsa Jisunë e lindi një Virgjëreshë e dëlirë me përmbihjeshim Ati dhe Shpirti Hyjnor,⁸⁰ por biri i shterpës u shfaq për

atë të së Virgjërës Pararendës, profet edhe shpallës tok.

Sinaksari

Më 24 të të njëjtit muaj, kremtojmë ditëlindjen e profetit të lavdëruar dhe të çmuar Joan Pararendësi dhe Pagëzori.

Vargje: O Zaharia, kërce tok me bashkëshorten,/ meqë linde jo shumë, por një dhe të madh.

Pararendësin e lindi nënë rreth njëzet e katrës.

Në të njëjtën ditë, Mbledhja e prindërve të tij, Zaharia dhe Elisabeta.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i neomartirit të shenjtë Panajoti.

Me ndërmjetimet e shenjta të Pararendësit, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII

Irmosi: Nei tris en Vaviloni

»**T**re Djem në Babiloni, si* lllomotitje
»urdhri kot* i mbretit u dukej pra,*⁸¹
»prandaj dhe thërrisnin mes flakës:*
»Je i bekuar ti, o Zot,* Perëndia i etër-
»ve tan'.⁸²

Natyra e tërë e të dhelindurve ishte më përpara e errësuar, o Pararendës, por u duke si agim duke thirrur: Je i bekuar ti, o Zot, Perëndia i etërve tanë.⁸²

Lindja jote e lavdishme nga një shterpë, o Prodhrom, shëroi tërë natyrën e sëmure dhe e mësoi të këndoje: Je i bekuar ti, o Zot, Perëndia i etërve tanë.⁸²

Ke lindur, o Pararendës, prej një shterpe, se, meqë Ligji kishte shterpësi, krejt vërtet erdhi Hiri, duke i kënduar Krishtit: Je i bekuar ti, o Zot, Perëndia i etërve tanë.⁸²

Hyjlindësore

O Virgjëreshë e kulluar, e bekuar, ndërmjeto për ne që të përgjërohemi, se në ty shpresojmë të gjithë dhe ty të thërrasim: O Zonjë, mos shpërfill shërbëtorët e tu.

Tjetri: Uk elátrefsan

Ai që i bën të gjitha në Shpirtin si Zot dhe Bërësi i gjithçkaje, nxori nga një shterpë sot si fryt Pararendësin, që paralajmëron se natyra e pafrytshme e të mortshmëve do t'i sjellë si fryt hyjnoret.

Ashtu si Krishti jetëdhënës me lindjen tënde i dha jetë mitrës së vdekur nënore, me anën e predikimit tënd ringjalli dhe shëndoshi shpresat e vdekura të njerëzve, o Pararendës.

O i tërëfamshëm, shkretëtira, duke të pranuar hijshëm ty më shumë se

diellin e hyjshëm, përmes teje bëhet e hirshme dhe zbukurohet,²⁵ dhe tok me të gjitha përhimnon Zotin dhe Perëndinë në jetë.

Hyjlindësore

Të drejtët kërkuan qëmoti të shihnin lavdinë tënde që e soditim ne, o e Pacenuar, dhe që besërisht të mburrim dhe thërresim: O e përmbilavdëruara Zonjë, është i bekuar fryti i barut tënd.

Zbritësore: Uq elátrefsan

»**N**uk u faleshin krijesave hyjme-
»ndësit⁸¹, por Kryetarit⁸³ lart* dhe
»kërcënimin me zjarr* e shkelën me
»trimëri, psalnin me brohori:* Zot,
»lavdi më ty, o Perëndi i etërve,* ti je
»vetëm i bekuar.^{82*}

Ode VIII

Irmosi: Everjeta Hristé

»**O** mirëbërës Krisht⁸⁴ i tërëfuqishëm,
»me bashkëzbritjen tënde freskove
»ata që mbanin shpresëtarinë në mes
»të flakës, dhe i mësove të këndo-
»nin:⁸² Të gjitha ju, o vepra, bekojeni,
»himnojeni Zotin.⁸⁵

Moisiu ishte shërbëtor ligjvënës,⁸⁶ ndërsa Jisui, Perëndi i Dhiatës së Re.⁸⁷ Dhe tani Pararendësi si ndërmjetës⁵

këndon për të dyja: Të gjitha ju, o vepra, bekojeni, himnojeni Zotin.⁸⁵

Nga barku i shkretë erdhi turtull, të cilin ia solli Kishës tani një pyll i hyjmbjellë, shterpa: Prodhromi i Krishtit, që këndon: Të gjitha ju, o vepra, bekojeni, himnojeni Zotin.⁸⁵

O popull hyjpritës, komb i shenjtë,⁸⁸ imitojeni turtullin e Krishtit dhe këndon mjalte ëmbël, duke jetuar me mençuri: Të gjitha ju, o vepra, bekojeni, himnojeni Zotin.⁸⁵

Hyjlindësore

Le ta nderojmë të dëlirën dhe Virgjëreshën që Fjalën e pafillim dhe të pandërtuar kishte në bark përmbi mendje për shpëtimin tonë, për të cilën thërrasim: Bekojeni, o vepra, Zotin.

Tjetri: Pedhas evajís

Duke qenë mik⁹ dhe apostull i Ndërtuesit, predikues, Pagëzor, Pararendës i hyjnueshëm, dëshmitar, mësuës, ndërmjetues, engjëll,¹⁹ celebrues dhe ambasador për ne, o i tërëfamshëm, dole prej shterpës, duke i paralajmëruar të mirat me fjalë dhe me vepra.⁸⁹

U hapën arkat e hireve të Dhiatës së Re të Krishtit, o Prodhrom, dhe në lindjen tënde zakone flijimesh të vjetra

u mbyllën dhe pushuan, ndërsa populli i ri këndon dhe përmbilartëson Krishtin në jetë.

Me të thurur lulet e hijshme të fjalës hyjnore, të sjellim ty sot kurorën e lavdërimeve, o Pararendës i tërëfamshëm, dhe me gëzim thërrasim për hir të Krishtit kurorëdhënës: Zotin himnojeni, o vepra, dhe përmbilartësojeni atë në jetë.⁸⁵

Hyjlindësore

Vargoi i mëparshëm i gojës së lidhur u zgjidh me shtatzëninë tënde, o Virgjëreshë, dhe menjëherë u hapën për himnimin e Birit tënd buzët e atyre që kanë mall për ty dhe thërrasin për hir të atij: Zotin himnojeni, o vepra, dhe përmbilartësojeni atë në jetë.⁸⁵

Zbritësore: Pedhas evajís

»**D**jemat* e dënuar për t'u djegur, »prej zjarrit i ka shpëtuar lindj' e Zotit »Krisht, si simbol në lashtësi;*⁹⁰ dhe »si një veprim tani,* dhe tërë botën »po e mbledh për këng' e lavdërim:* »Himnojeni ju veprat e Zotit* dhe e »lartësoni përmbi të gjitha jetët.^{85*}

Ode IX

Irmosi: Logu Theú áfraston

»**O** Virgjëreshë e pacenuar, kryhet në »ty qartazi mister i parrëfyeshëm i

»Fjalës Perëndi, sepse Perëndi u tru-
»pëzua prej teje nga dhembshuria,
»prandaj të madhërojmë si Hyjlindëse.

Ja ku del zëri pararendës për zemrat
shterpa dhe të shkreta, i cili psal: «Bë-
ni gati tani udhën e Krishtit,³ sepse
vjen me lavdi». Duke iu bindur, e ma-
dhërojmë.

O Pararendës, sikurse qëmoti pre-
dikove qartas në Shpirtin e Tërë-
shenjtë⁹¹ Birin si qengjin e Perëndi-
së që ngre mëkatën e botës,⁷ kërko
zgjidhjen e shkeljeve për grigjën të-
nde.

Hyjlindësore

Ti që dominon mbi gjithë krijimet,
dhuroji popullit tënd trofetë e fitores,
duke bërë që keqdashësi t'i nënshtro-
het Kishës, që të të madhështojmë si
Perëndilindëse.

Tjetri: Apas jijenís

Parashpallet se sot nisën të çelen
portat e shkëlqimit dhe* dritës së
hyjnueshme,* ndaj mbyllen arka te-
rri, se shpallësi* Prodhrom i Krishtit
sapo doli përmbi dhé, këtu* dhe sheh
dritën,* me zë atëror këto* na i shpa-
lli dhe i vërtetoi fort.⁹²

Sapo doli Pararendësi si një shi me-
ndor nga re e lehtë,* pra pa lagështi

aspak,* të gjithëve u shpalli se vinte
shpejt* pra rrjedha⁹³ qiellore, paqja
që sjell rinovim* për natyrën* njerë-
zore, që në Shpirt* fryte Hiri i shumë-
fishon⁹⁴ me gaz.

Kisha shndrit, stoliset sot porsi qielli
me yjet,⁹⁵ dhe ajo* zbukurohet me çdo
hir* hyjnor të Pararendësit; e lëvdon*
dhe lartëson pra lindjen e tij dhe hi-
mnon Zotin* e gjithçkaje,* se shkak-
tari është ky* për dhunti të mëdha e
të sipërme.

Hyjlindësore

Kur nga ti buroi ujin e jetës,⁹⁶ Zoti na
pastroi ne* që e pritëm me besim,*
na shenjtëroi dhe na tregoi krejt* tra-
shëgimtarë, o Hyjnuse, lart në Mbretë-
tëri,*⁹⁷ se himnojmë* mirësin' e tij
dhe ty* me mall të madhërojmë plot
ngrohtësi.

Zbritësore: Apas jijenís

»**G**jithë njerëzit, kërceni me ngazë-
»llim tek drit' e Shpirtit Shenjt',* eni
»lavdërojeni;* engjëjt e q'ellit eni kre-
»mtojeni* këtë të shenjtë panair të
»kryezonjës Mari* dhe thërrisni:* Ti
»je më e lumura,* Virgjëresh' e kullu-
»ar Hyjlindëse.*

Dërgimësore

Jinekes akutishite

Sot dita ngazëlluese* e lindjes së Prodhromit shenjt* shpërbën zymtinë e atit* shkak kjo i gojës së lidhur,* zgjidh shterpësi nënore tok,* lajmëron se do vijë gaz* edhe hare, ndaj çdo krijim* fort e kremton me gëzim, hir* pra ditëlindjen e shenjtit.

Hyjlindësore

Profetë parashpallën fort,* apostuj na mësuan drejt,* dëshmorë tok përrëndishëm,* Hyjlindëse, Birin tënd pra,* e deklaruan Perëndi* të kozmosit, e pastër krejt,* të madhështojmë ne me ta,* se nga dënimi i lashtë*⁹⁸ me hirin tënd u çliruam.

Lavdërime

Ting. Tërth. IV O tu paradhoksu thávmatos

O çudi paradoksale krejt, prej nëne shterpë nxiton* që të lindë Joani sot,* porsi paralajmëtar*¹⁹ Fjale, i Perëndisë^{11a} Krisht,* bën përmes lindjes të flasë qartazi* gjuha e lidhur fuqishëm. O Jisu,* sa mirësi që ke* aq sa s'shprehet, përmes saj, o Krisht, shpëto* shpirtrat tanë si i vetëmdhembshur plot me hir.

O çudi paradoksale krejt, zhduk dhe shpërbën shterpësi,* që për nënat si një krim ish,* më i madhi se çdokush* që kish lindur nga gratë¹⁴ dhe* se çdo

profet;²⁰ udhën zotërore hap,*³ kur me fuqin', shpirtin e Ilias⁹⁹ vjen.* Sa dhembshuri që ke* të pashprehshme, përmes saj, o Krisht, shpëto* shpirtrat tanë si i vetëmdhembshur plot me hir.

O çudi paradoksale krejt, më sipër se çdo njeri*¹⁴ falë zërit³ të tij u shfaq* parashpallësi që tha* se do zbrazej Jisui Zot.*⁴² Zgjidh shterpësinë e nënës me fuqi* hyjnore, zërin e Zaharias tok.* Sa të mëdha këto* mrekulli që kryen, pra me to, o Krisht,* sa nderojn' Prodhromin tënd të madh, shpëtoji ti.

O çudi paradoksale krejt, më sipër se çdo njeri,* që prej grave u lind,¹⁴ u shfaq* Pararendësi profet* më i madhi se çdo profet.*²⁰ Parakërceu në bark nënor¹⁰ ai,* paratha ardhjen,¹⁹ pranin' e Krishtit Zot.* Sa të mëdha janë,* njeridashës Krisht, dhu-ratat që na jep,* i tërëfuqishëm, përmes tyre na shpëto.

Lavdi

Ting. Tërth. II I Anatoliut

Joani i hyjdëshiruar, Pararendës, yll yjesh, lind mbi tokë sot nga mitra sterile dhe shfaq agimin e Krishtit, lindjen nga lart⁹² për kalimin e drejtë të shpresëplotëve.

Tani *Hyjlindësore*

O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë,¹⁰⁰ që nxore frytin e jetës; të lypim ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me Pararendësin dhe me gjithë shenjtoret, që të mëshirohen shpirtrat tanë.

Dhoksologjia e Madhe.

U jepet dhe vaj i shenjtë vëllezërve. Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanuni i parë, Ode III dhe nga Kanuni i dytë, Ode VI. Kungatore: Në kujtim të përjetshëm.



*Tipikoni i Mbylljes të së kremtes
së Pagëzorit*

(d.m.th. të nesërmen e së kremtes).

Nëse Mbyllja bie të dielën, të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 6 ngjallësore dhe 4 të Pagëzorit (ato të Mbrëmësore të tij të Vogël Lindi nga mitra). Lavdi Paskremtor i Pagëzorit (Elisabeta zuri Pararendësin). Tani Hyjlindësore Dogmatike e Tingullit të javës. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi dhe Tani Paskremtor (Shih Elisabetën). Përlëshoret: ngjallësore, e Pagëzorit dhe Hyjlindësore ngjallësore (Misteri i fshehur). Këtu mbaron Mbyllja e së kremtes. Në Mëngjesore psalet vetëm shërbesa ngjallësore, ndërsa lihet shërbesa e shën Fevronisë.

*Kur Mbyllja kryhet në ditët
e zakonshme:*

NË MBRËMËSORE

*Idhiomelet e Pagëzorit
3 të parat e Mbrëmësore të Madhe
të tij (Pasi lindi Joani)*

*Dhe 3 Thirrtores të shenjtore:
Ting. IV Édhookas simíosin*

Ke duruar atletizëm sipas asketizimit tënd,* Fevroni e lavdishme fort;* këtë gjak, martirizim* ia bashkove djerësës* së ushtrimit, ndaj të dhuroi Mirëbërësi* kurorë, rreth të dyfishtë; drejt atij* u ngjite e stolisur me shkëlqim¹⁰¹ si vajzë e virgjër krejt* pa aspak njollë dhe qortim,* si martire që s'mposhteshe.

Ish bashkuar bukuria shpirtërore që kishe ti* perëndishëm me hijeshin'* e trupit, se si zambak* brenda manastirit* oshënar shkëlqeve e bardhë,¹⁰¹ nuse pa qortim,* e skuqur përmes derdhjes së gjakut tënd,* ndaj dhomë qiellore, nusërore lart e përjetshme pra,* plot gëzim të ka pritur ty,* si martire e virgjër krejt.

Kish fushuar engjëlli, e tërëfamsh-mja shën Fevroni,* përreth teje, si çlirimtar,*¹⁰² sepse që në foshnjëri* dhe e shtrirë ende* dukeshë dhuratë e ruajtur me hijeshi* për Perëndin' e

gjithëfuqishëm Zot;* ndaj shkele marrëzinë e Selinit, edhe u ngjite lart* pra drejt Dhëndrit tënd Krishtit Zot,* pasi rroke kurorë¹⁰¹ ti.

Lavdi *dhe* Tani

Ting. Tërth. II

Elisabeta zuri Pararendësin e Hirit, ndërsa Virgjëresha Zotin e lavdisë.²⁷ Puthën njëra-tjetrën nënat²⁸ dhe foshnja kërceu,¹⁰ sepse nga brenda shërbëtori himnonte Zotin. Si u çudit nëna e Pararendësit, zuri të thërriste: “Nga më ngjau kjo, të vijë tek unë nëna e Zotit tim,²⁶ që të shpëtojë një popull të dëshpëruar?”. Ti që ke përdëllimin e madh,^{26a} lavdi më ty.

Pasvargjet e Oktoihut

Lavdi *dhe* Tani

Ting. Tërth. IV

Shih Elisabetën që po bisedon me Virgjëreshën Mariam: Përse erdhe tek unë ti, nëna e Zotit tim?²⁶ Ti mban mbret dhe unë ushtar, ti ligjdhënësin dhe unë ligjvënësin, ti Fjalën dhe unë zërin,³ që shpalli mbretërinë e qiejve.⁴

*Përlëshoret e Pagëzorit
dhe e shenjtore:*

Shqerra jote

ose

*Ting. i njëjti Tahi prokatálave
(Poezi e përkthyesit)*

Kurorën e pleksur prej tri lulesh plot hijeshi* e vure në kokë, si martire dhe oshënare dhe virgjëreshë tok,* o Fevroni e famshme;* shndrit si diell i pastër* përbrenda nusërores ti me vajzat e urta,* ndaj lypim t'i lutesh dhëndrit¹⁰³ tënd për të gjithë ne.

Tani *i së kremtes*

[ose Hyjlindësore: Misteri i fshehur.]



NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së zakonshme,
Kanunet: një i Pagëzorit dhe
i shenjtore. Dërgimësoret e
Pagëzorit. Pasvargjet e Oktoihut,
por:*

Lavdi i Pagëzorit Ting. Tërth. IV

I ka hije Joanit era e këndshme, i përket Pagëzorit hijeshia e këngëve, sepse ai shpalli fillimin e shpëtimit tonë, ai që kërcente në bark¹⁰ dhe thërriste në shkretëtirë “Pendohuni”,⁴ ushtari i mbretit, pararendësi i Hirit, që paralajmëron qengjin⁷ dhe Shpëtimtarin, dhe ndërmjeton për shpirtat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

O Zonjë, priti lutjet e shërbëtorëve të tu edhe çlirona ne nga çdo nevojë dhe pikëllim.

CITIME

- ¹ I Kor. 14.14
- ² Lluk. 1.24-26
- ³ Is. 40.3-4; Matth. 3.3; Mark. 1.2-3; Lluk. 3.4; Joan 1.23
- ⁴ Matth. 3.2; Mark. 1.4; Lluk. 3.3
- ⁵ Matth. 11.13
- ⁶ Lluk. 15.23,30
- ⁷ Is. 53.7,11; Joan 1.29,36; Vep. 8.32; I Petr. 1.19
- ⁸ Kënga 2.11-12
- ⁹ Joan 3.29
- ¹⁰ Lluk. 1.41-44
- ¹¹ Lluk. 1.76
- ^{11a} Joan 1.1
- ¹² Lluk. 1.68
- ¹³ Gjyq. 16.17; Jer. 1.5
- ¹⁴ Matth. 11.11; Lluk. 7.28
- ¹⁵ Joan 1.4,9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46
- ¹⁶ Gal. 4.27
- ¹⁷ Joan 5.35
- ¹⁸ Mal. 4.2 (3.20)
- ¹⁹ Mal. 3.1; Matth. 11.10; Mark. 1.2; Lluk. 7.27
- ²⁰ Matth. 11.9; Lluk. 7.26
- ²¹ Matth. 1.18; Lluk. 1.34
- ²² Ps. 71(72).18; 85(86).10; Sirak 31(34).9; Jer. 21.2
- ²³ Eks. 19.5; 23.22; Ligji i Dytë 7.6; 14.2; 26.18; Tit. 2.14; I Petr. 2.9
- ²⁴ Matth. 3.6; Mark. 1.5; 6.14; Lluk. 3.12,21; 7.29; Joan 1.26,28; 3.23,26; 4.1; 10.40; Vep. 1.5; 11.16; 19.3-4

²⁵ Matth. 11.7-9; Lluk. 1.80; 7.24-26

²⁶ Lluk. 1.43

^{26a} Num. 14.19 etj.

²⁷ I Kor. 2.8

²⁸ Lluk. 1.40

²⁹ Amos 9.13

³⁰ Ps. 113(114). 4,6

³¹ II Tim. 2.3

³² Joan 1.35-42

³³ Ef. 5.19; Kol. 3.16

³⁴ Vep. 16.17

³⁵ Ef. 3.9

³⁶ I Petr. 1.12

³⁷ Kol. 1.26

³⁸ Gjyq. 6.37-38; Ps. 72(73).6

³⁹ Eks. 3.2-5

⁴⁰ Num. 17.23; Hebr. 9.4

⁴¹ II Mbret. [Sam.] 22.10;

Ps. 17(18).10; 143(144).5

⁴² Fil. 2.7

⁴³ Lluk. 1.28

⁴⁴ Eks. 15.4

⁴⁵ Eks. 15.20

⁴⁶ II Petr. 1.21

⁴⁷ Ps. 45(46).5; 47.1,9; 86(87).3;

Hebr. 12.22; Apok. 3.12

⁴⁸ Ps. 44(45).2; 118(119).131; Jez. 3.27

⁴⁹ Ps. 44(45).10

⁵⁰ I Mbret. [Sam.] 2.10; Jer. 9.23(22)

⁵¹ I Kor. 1.24,30

⁵² I Mbret. [Sam.] 2.2

⁵³ Matth. 3.10; Lluk. 3.9

⁵⁴ I Kor. 10.6,11

⁵⁵ Rom. 7.6; II Kor. 3.6-7

⁵⁶ Kol. 2.17; Hebr. 8.5; 10.1

⁵⁷ Fja. Urt. 1.6

⁵⁸ Vepr. 11.21; 14.15; 15.19; 26.20;

II Kor. 3.16; I Petr. 2.25

⁵⁹ II Kron. 18.18; Is. 6.1; Dan. 7.10

⁶⁰ Is. 19.1

⁶¹ Is. 7.14; Matth. 1.23

⁶² Jak. 1.17

- ⁶³ Matth. 24.31
⁶⁴ Is. 6.5
⁶⁵ Ps. 11(12).6
⁶⁶ Is. 33.10
⁶⁷ Ps. 84(85).12
⁶⁸ Matth. 5.15
⁶⁹ Ps. 108(109).29
⁷⁰ Abak. 3.3; Dan. 2.34-35
⁷¹ Jez. 44.1-4
⁷² Eks. 25.30-37; 35.16; 38.13;40.22;
Num. 4.9; 8.2; Hebr. 9.2
⁷³ I Mbret. [Sam.] 2.1; Fja. Urt. 24.43(28)
⁷⁴ Rom. 9.5
⁷⁵ Jona 2.4-7
⁷⁶ I Tim. 6.16
⁷⁷ Rom. 8.15,23; Gal. 4.5; Ef. 1.5
⁷⁸ Kënga 1.3
⁷⁹ Ps. 46(47).2
⁸⁰ Lluk. 1.35
⁸¹ Dan. 3.18
⁸² Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 26-28
⁸³ Rom. 1.25
- ⁸⁴ Vep. 10.38
⁸⁵ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
⁸⁶ Joan 1.17 etj.
⁸⁷ Hebr. 12.24
⁸⁸ Eks. 19.6; I Petr. 2.9
⁸⁹ Vep. 7.22; Rom. 15.18; Kol. 3.17;
II Thes. 2.17
⁹⁰ Dan. 3.25
⁹¹ II Petr. 1.21
⁹² Lluk. 1.78-79
⁹³ Abak. 3.9; Ps. 104(105).41
⁹⁴ Matth. 3.8; Lluk. 3.8
⁹⁵ Sirak 43.9
⁹⁶ Joan 4.10
⁹⁷ Jak. 2.5
⁹⁸ Gjen. 3.16-19
⁹⁹ Lluk. 1.17
¹⁰⁰ Joan 15.1
¹⁰¹ Kënga 8.5
¹⁰² Ps. 33.8
¹⁰³ Matth. 25.10



MË 29 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i apostujve të shenjtë, të lavdëruar dhe të tërëfamshëm
protokorifenj Petro dhe Pavël.

*Tipikon***1. Nëse bie të mërkurën ose të enjten, ose të premten pas Pentikostisë:**

Në Mbrëmësore, pas Qëndrimit të parë të Psaltirit, Thirrtoret e apostujve. Lavdi i tyre. Tani i së kremtes. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e apostujve. Pasvargjet e tyre. Lavdi i tyre. Tani i së kremtes. Përlëshoret: e së kremtes, e apostujve dhe përsëri e së kremtes.

Në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Litia e apostujve. Tani i së kremtes. Trishenjtë dhe Përlëshorja e apostujve. Në Mëngjesore, Ndenjësoret e apostujve dhe, në vend të Hyjlindësoreve, të së kremtes në të njëjtin Tingull me Ndenjësoret e apostujve: në Stihologjinë e parë, Ndenjësorja e së kremtes pas Polieleit; në Stihologjinë e dytë, Ndenjësorja e së kremtes pas Odes III; pas Polieleit, Ndenjësorja pas Odes III të Hënën pas Pentikostisë. Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV, Proqimeni dhe Ungjilli i apostujve etj. të tyre. Kanunet: një i së kremtes (të mërkurën dhe të premten i dyti, të enjten i pari) dhe të apostujve. Pas Odes III, Ipakoia e apostujve. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e apostujve dhe Sinaksari. Zbritësoret e së kremtes (vetëm i Ting. IV Mjegull' e mbuloj). Më të nderuarën. Dërgimësoret e apostujve dhe të së kremtes. Lavdërimet e apostujve. Lavdi i apostujve. Tani i së kremtes. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e apostujve.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e së kremtes. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e së kremtes, e apostujve dhe e kishës. Kontaqi i së kremtes. Apostulli dhe Ungjilli i apostujve. Të meriton. Kungatore: Në gjithë dheun. Pamë dritën.

2. Nëse bie në Mbylljen e Pentikostisë:

Në Mbrëmësore, pas Qëndrimit të parë të Psaltirit, Thirrtoret: 6 të së kremtes dhe 3 të apostujve në 4. Lavdi i apostujve. Tani i së kremtes. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e apostujve. Pasvargjet e së kremtes. Lavdi i apostujve. Tani i së kremtes. Përlëshoret: e së kremtes, e apostujve dhe përsëri e së kremtes.

Në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Litia e apostujve. Tani i së kremtes. Trishenjtë dhe Përlëshorja e apostujve. Në Mëngjesore, Ndenjësoret e apostujve dhe, në vend të Hyjlindësoreve, të së kremtes. Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV, Proqimeni dhe Ungjilli i apostujve etj. të tyre. Kanunet: të dy të së kremtes (në 6) dhe të dy të apostujve (në 8). Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e së kremtes dhe Ipakoia e apostujve. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e apostujve dhe Sinaksari. Zbritësoret dublikate të së kremtes. Në vend të Më të nderuarën, Ode IX e Kanuneve. Dërgimësoret: e para e së kremtes, e apostujve dhe e dyta e së kremtes. Lavdërimet: 3 të së kremtes dhe 3 të apostujve. Lavdi i apostujve. Tani i së kremtes. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e së kremtes.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e së kremtes. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e së kremtes, e apostujve dhe e kishës. Kontaqi i së kremtes. Apostulli dhe Ungjilli i apostujve. Në vend të Të meriton, Irmosi i Odes IX të së kremtes (Ting. IV). Kungatore e së kremtes [dhe Në gjithë dheun]. Pamë dritën.

3. Nëse bie të Dielën e Gjithë Shenjtorëve:

Në Mbrëmësore, Thirrtoret: 3 ngjallësore, 4 të apostujve dhe 3 të Gjithë Shenjtorëve. Lavdi i apostujve (kërkoje në Lavdi i Pasvargjeve: Një festë gazmore shkëlqeu). Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet: dy të apostujve dhe një i Gjithë Shenjtorëve. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi dhe Tani i Gjithë Shenjtorëve. Përlëshoret: ngjallësore, e apostujve, e Gjithë Shenjtorëve dhe Hyjlindësore ngjallësore (Misteri i fshehur).

Në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Litia e apostujve (psalet dhe Idhiomeli i Lavdi-së pa thënë Lavdi) dhe Litia e Shenjtorëve. Lavdi dhe Tani i Gjithë Shenjtorëve. Himne Triadike. Trishenjtë dhe Përlëshorja e apostujve. Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë dhe të dytë, Ndenjësoret e Pentikostarit. Pas Polieleit, Ndenjësoret (pas Polieleit) e apostujve. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimeni i Tingullit. Kanunet: ngjallësor (në 4), i shën Petros (në 2), i shën Pavlit (në 2) dhe i Gjithë Shenjtorëve (në 4). Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e Gjithë Shenjtorëve dhe Ipakoia e apostujve. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e apostujve. Sinaksari i ditës dhe i Pentikostarit. Zbritësoret Ja gojën e çel tani; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Më të nderuarën. Dërgimësoret: ngjallësore, e apostujve, e Gjithë Shenjtorëve dhe Hyjlindësorja

e tyre. Lavdërimet: 2 ngjallësore, 3 të apostujve dhe 3 të Gjithë Shenjtorëve. Lavdi i apostujve. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të Tingullit, 2 nga Ode III e shën Petros, 2 nga Ode III e shën Pavlit dhe 4 nga Ode VI e Gjithë Shenjtorëve. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e apostujve, e Gjithë Shenjtorëve dhe e kishës. Kontaqi i Gjithë Shenjtorëve (kërkoje para Shtëpisë). Apostulli dhe Ungjilli i apostujve. Të meriton. Kungatore Në gjithë dheun [dhe e Gjithë Shenjtorëve].

4. Nëse bie në një nga të dielat jashtë Pentikostarit:

Në Mbrëmësore, Thirrtoret: 4 ngjallësore dhe 6 të apostujve. Lavdi i apostujve. Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimieni i ditës. Leximet e apostujve. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i apostujve. Tani Hyjlindësore ngjallësore (Zoti Krisht bërësi). Përlëshoret: ngjallësore dhe e apostujve bashkë me Hyjlindësoren e tyre.

Në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanunit Triadik dhe Litia e apostujve. Himne Triadike. Trishenji dhe Përlëshorja e apostujve. Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë dhe të dytë, Ndenjësoret ngjallësore. Pas Polieleit, Ndenjësoret (pas Polieleit) e apostujve. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimieni i Tingullit. Kanunet: ngjallësor dhe të apostujve. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore dhe Ipakoia e apostujve. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e apostujve dhe Sinaksari. Zbritësoret Ja gojën e çel tani; dhe i gjithë re-ndi i Ungjillit Mëngjesor. Më të nderuarën. Dërgimësoret: ngjallësore dhe të apostujve. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të apostujve. Lavdi i apostujve. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të Tingullit, 4 nga Ode III e Kanunit të shën Petros dhe 4 nga Ode VI e Kanunit të shën Pavlit. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e apostujve dhe e kishës. Kontaqi Mbrojtje e paturpëruar. Apostulli dhe Ungjilli i apostujve. Të meriton. Kungatore [Lavdëroni dhe] Në gjithë dheun.



NË MBRËMËSOREN E VOGËL

*Thirrtore**Ting. IV Édhokas simíosin*

Kishës i dhe krenari apostujt aq të nderuar, Krisht* njeridashës, ndriçuesit*¹ shën Petron dhe Pavlin tok,* në të llamburisin* porsi yj mendorë, shkëlqejnë tërë sferën,¹ dhen’;* me ta shpërndave dhe shove zyrtësi* dhe terr perëndimor, mashtrim të errët, prishje, o Krisht Jisu,* o i tërëfuqishmi Zot,* Shpëtimtari i shpirtrave.

(2x)

Kishës i dhe si mbështjette² fortësinë e Petros pra,* mençurinë³ dhe urtësin’* e Pavlit,⁴ apostullit;* që të dy karizmë,* predikim të hyjshëm dhe të vërtetë kishin tok* dhe çdo mashtrim ateizmi flakën tej;* meqë mësojmë nga të dy mistere, ty të himnojm’ Jisu,* o i tërëfuqishmi Zot,* Shpëtimtari i shpirtrave.

Ti si shembull kthimi për sa mëkatojnë dy apostujt dhe:* Njëri gjatë pësimi tënd* të kishte mohuar ty,* veçse u pendua;*⁵ tjetri predikimin tënd kish përndjekur egërsisht,* kish reaguar,⁶ por që të dy këta* në krye janë para korit, para miqve të tu, Jisu,* o i tërëfuqishmi Zot,* Shpëtimtari i shpirtrave.

Lavdi

Ting. II I Gjermanoit

O Petro, korifeu i apostujve të lavdëruar, guri i besës⁷ dhe ti, o Pavël i mrekullueshëm, oratori⁸ dhe ndriçuesi i Kishave të shenjta, duke qëndruar pranë fronit hyjnor,⁹ ndërmjetoni për ne te Krishti.

Tani *Hyjlindësore*

Gjith’ shpresën time e besoj te ti, o nën’ e Perëndisë, ruajmë nën strehën tënde.

*Pasvargje**Ting. Tërth. II Triimeros anestis*

O apostuj, nxënës të Krishtit dhe predikues të tërëlavdëruar, që kryet mbi tokë udhën¹⁰ e mirë, mos pushoni së ndërmjetuari për ata që ju përhimnojnë.

Varg: Në gjithë dheun doli zëri i tyre dhe në skajet e botës fjalët e tyre.

Duke dimëruar pa pushim në tallazin e jetës, thërrasim: Shpëtona ne të gjithë, i dhembshur, me ndërmjetimet e apostujve të tu të urtë,⁴ të hyjshëm dhe të korifenjve, o i Përmbimirë.

Varg: Qiejt tregojnë lavdi Perëndie.

O dishepuj të hyjnueshëm dhe të respektueshëm, miste dhe mësues, Petro dhe Pavël, baza e apostujve,

ndërmjetoni për ne përherë te Ndërtuesi i të gjithave¹¹ dhe Zoti i lavdisë.¹²

Lavdi *dhe* Tani

Hyjlindësore

O e virgjër e dëlirë Perëndilindëse, përgjëroju Zotit që me ndërmjetimet e tua t'iu dhurojë të gjithëve falje shkëlqesh dhe t'i shpëtojë si përdëlljes dhe njeridashës, o e kulluar.

Përlëshore

Ting. IV

O të parëfronshmit e apostujve.

Lavdi *dhe* Tani

Hyjlindësore



NË MBRËMËSOREN E MADHE

*Pas Qëndrimit të parë të Psaltirit
(Lum ai njeri)*

Thirrtoe Idhiomele

Ting. II Piis efimión stémasin

I Andrea Pirit

Me çfar' * kurora mburrjeje, lavd, * Petron, Pavlin t'i kurorëzojmë? * Qen' të ndar' për sa i përket trupit, * veçse

në Shpirt ishin të bashkuar, * kryesi për çdo hyjpredikues, * flas për * Petron pra të parin e apostujve, * ndërsa * Pavlin që më fort lodhej se të tjerët. *¹³ Krishti me rrethe lavdie * që s'vdes,¹⁴ denjësisht krejt * i kurorezoj vërtet, * Perëndia ynë Zot * që ka përdëllimin mjaft të madh.^{14a}

(2x)

Me çfar' * himnim të bukur dhe gaz * të himnojmë ne Petron dhe Pavlin, * krahët e hyjdijes që u hapën * në çdo skaj e cep? U lartësuan * për në qiej lart përmes doktrinë. * I kish * pra ata Ungjilli i Hirit¹⁵ duar * edhe * këmbë për vërtetësi në predikim. *¹⁶ Ishin lumenjt' e urtisë, * i kish kryqi skaje, * me ta ka vithisur Zoti * Krisht vetulla¹⁷ demonësh, * se ka përdëllimin mjaft të madh.^{14a}

(2x)

Me çfar' * himn, këngë shpirtërore * të lëvdojmë ne Petron dhe Pavlin * presat që nuk çmprihen, fort të frikshme * të thikës së Shpirtit¹⁸ të Shenjtë? * Këto pabesinë therin, zhdukin. * Stoli * e dëgjuar janë për Romën, shije, * gëzim * për gjithë planetin, pllaka mendore * Dhiate të Re, që i shkroi * Perëndia,¹⁹ Zoti; * në Sion i shpalli Krishti * Shpëtues, bamirësi * që ka përdëllimin mjaft të madh.^{14a}

(2x)

Lavdi

Ting. IV I Joan Monakut

Me pyetjen e trefishtë, “O Petro, a më do?”, Krishti korrigjoi mohimin e trefishtë,⁵ ndaj Simoni i tha njohësit të të fshehtave: “O Zot, ti i di të gjitha, i njeh mirë të gjitha, ti e di se të dua ty”. Ndaj i tha atij Shpëtimtari: “Kullot delet e mia, kullot zgjedhjen time, kullot qengjat e mi,²⁰ që nëpërmjet vetë gjakut tim i fitova²¹ për shpëtim”. Atij lypi, o apostull i hyjлумëruar,²² që të na dhurohet përdëllimi i madh.^{14a}

Tani *Hyjlindësore*

Profeti David që u bë hyjprind me anën tënde, i parathirri melodikërisht atij që të madhështoi.²³ Qëndroi mbretëresha në të djathtë tënde.²⁴ Se ty Perëndia që denjoi të bëhet njeri prej teje pa atë, të rrëfeu nënë shkak-tare jete që të gatojë përsëri ikonën e tij²⁵ të prishur prej pasioneve. Dhe duke gjetur delen e arratisur nëpër male ta marrë mbi supe²⁶ e t’ia shpie-rë Atit.²⁷ Dhe me dëshirën e tij ta bashkojë me fuqitë qiellore dhe ta shpëtojë botën, o Hyjlindëse, Krishti që ka përdëllimin e madh^{14a} e të pa-sur.*

*Hyrje. O dritë gazmore.**Proqimeni i ditës dhe Leximet*Këndimi i Letrës së parë katolike
të Petros*(1.3-9)*

Vëllezër, qoftë i bekuar Perëndia dhe Ati i Zotit tonë Jisu Krisht, i cili sipas përdëllimit të tij të shumtë na lindi përsëri në një shpresë të gjallë me anë të ngjalljes së Jisu Krishtit prej së vdekurish, për një trashëgim të pa-prishur dhe të papërlyer dhe të pa-fishkur, që është ruajtur në qiejt për ne, të cilët me fuqinë e Perëndisë ru-hemi me anë të besimit, për shpë-timin që është i gatshëm të zbulohet në kohë të fundme. Për këtë gëzo-huni, ndonëse tani pakëz, po të jetë nevoja, hidhëroheni në çdo lloj nga-sjesh, që provimi i besimit tuaj të gjendet shumë më i çmueshëm se ari, që, ndonëse provohet me anë zjarri, priset; të bëhet kështu për lavdërim dhe për nder e lavdi, kur të zbulohet Jisu Krishti, të cilin, edhe pse s’e keni parë, e doni, tek i cili, edhe pse tani nuk e shihni, besoni dhe ngazëlloheni me gëzim të parrëfyeshëm e të lavdë-rueshëm, duke marrë fundin e besimit tuaj, shpëtimin e shpirtave.

Këndimi i Letrës së parë katolike
të Petros*(1.13-19)*

Të dashur, si të ngjishni meset e me-

ndjes suaj, duke pasur gatishmëri, shpresoni plotësisht në hirin që vjen mbi ju, në zbulimin e Jisuit Krisht, si bij bindjeje, duke mos u përshtatur me dëshirimet e mëparshme në padijen tuaj; por, sipas shenjtërisë që ju thirri, edhe ju bëhuni shenjtorë në çdo sjellje; sepse është shkruar: “Bëhuni të shenjtë, sepse unë jam i shenjtë”. Edhe nëse quani Atë atë që gjykon pa mbajtur anë sipas punës së gjithsecilit, silluni me frikë në kohën e qëndrimit tuaj të përkohshëm *mbi tokë*, duke ditur se nga jetesa juaj e kotë që ju kanë lënë etërit, nuk u shpërblyet me gjëra të prishshme, me argjend ose me ar, por me gjakun e çmueshëm të Krishtit, si të një qengji pa të metë e të panjollë.

Këndimi i Letrës së parë katolike
të Petros
(2.11-24)

Të dashur, ju lutem *juve* si të huaj dhe banues të përkohshëm, të largoheni nga dëshirimet mishore, të cilat janë në luftë kundër shpirtit, duke pasur të mirë sjelljen tuaj në kombe, që, aty ku ju përflasin për keqbërës, kur të shohin veprat tuaja të mira, të lavdërojnë Perëndinë në ditën e ardhjes së tij. Bindjuni pra për Zotin çdo strukture njerëzore, qoftë mbretit si epror,

qoftë qeveritarëve si të dërguar prej tij për dënim keqbërësish, dhe nga ana tjetër për lavdërimin e atyre që bëjnë mirë. Sepse kështu është vullneti i Perëndisë, që duke bërë mirë të mbyllni gojën e paditurisë së njerëzve pa mend; si të lirë, e jo si *njerëz* që kanë lirinë për mbulesë të ligësisë, por si shërbëtorë të Perëndisë, nderoni të gjithë; të doni vëllazërinë, kini frikë Perëndinë, nderoni mbretin. *Ju* shërbëtorë, bindjuni zotërinjve *tuaj* me çdo frikë, jo vetëm të mirëve e të butëve, po edhe të shtrembërve; sepse ky është hir, të durojë njeriu hidhërime për ndërgjegje Perëndie, duke pësuar padrejtësisht. Sepse çfarë lavdie është, në durofshit kur mëkatoni dhe rriheni? Po në durofshit duke bërë mirë e duke pësuar, ky është hir para Perëndisë. Sepse për këtë u thirrët, se edhe Krishti pësoi për ju, duke ju lënë shembull që të ecni pas gjurmëve të tij; ai nuk bëri mëkat, as nuk u gjet tinëzari në gojën e tij, që kur përqueshej nuk kundërpërqueshte, kur pësonte nuk kërcëronte, por i jepte veten atij që gjykon me drejtësi; që mbajti vetë mëkatet tona në trupin e tij mbi dru, që, si të bëhemi të huaj për mëkatet, të rrojmë në drejtësi.

*Në Liti Idhiomele
Ting. II I Andrea Jerusalemasit*

O hyjpëlqimi i besëmirëve, në gazin tim eja sot me ngazëllim; duke formuluar bashkërisht kor, le t'i kurorëzojmë me mburrje të përshtatshme endësit e zgjedhur të Hirit, Petron dhe Pavlin, sepse, pasi u mbollën fjalën pa kursim të gjithëve,²⁸ ata i pasuruan tejet edhe me Hirin e Shpirtit; dhe duke qenë dega e hardhisë së vërtetë,²⁹ na poqën bistak të pjekur që dëfren zemrat³⁰ tona; atyre le t'u thërrasim fytyrëzbuluar³¹ dhe me ndërgjegje të pastër,³² duke thënë: "Gëzohuni, o timonierë të të pamendëve dhe shërbyes të të logjikshmëve; gëzohuni, o të zgjedhur³³ të hyjshëm të Bërësit dhe kujdestarit të gjithçkaje;¹¹ gëzohuni, shkaktarët e të mirave dhe dëbuesit e tinëzarëve". Atyre le t'u përgjërohemi, që të ndërmjetojnë gjithmonë te Ndërtuesi¹¹ dhe Mësuesi, që t'i dhurohet botës paqe e qëndrueshme³⁴ dhe shpirtrave tanë përdëllimi i madh.^{14a}

I njëjti I Arsenit

E gjithë bota le t'i lavdërojë si mbrojtës nxënësit e Krishtit, themelet e Kishës,³⁵ shtyllat² e vërteta dhe bazat, trumbetat e perëndishme të dogma-

ve dhe pësimeve të Krishtit, korifentë Petron dhe Pavlin; sepse ata, duke vrapuar dhe përshkuar hapësirën e tërë të dheut, si me parmendë mbollën besimin,²⁸ dhe u buruan të gjithëve hyjdijen, duke treguar fjalën e Trinitë. "O Petro, gur⁷ dhe bazament dhe ti, o Pavël, enë e zgjedhur".³³ Ata, si qenë nën zgjedhën e Krishtit, i tërhoqën të gjithë, kombe, qytete dhe ishuj drejt hyjnohjes. Gjithashtu kthyhen hebrenj te Krishti³⁶ dhe ndërmjetojnë që të shpëtojnë shpirtrat tanë.

I njëjti I Gjermanoit

O Petro, korifeu i apostujve të lavdëruar, guri i besës⁷ dhe ti, o Pavël i mrekullueshëm, oratori⁸ dhe ndriçuesi i Kishave të shenjta, duke qëndruar pranë fronit hyjnor,⁹ ndërmjetoni për ne te Krishti.

I njëjti

O Pavël, je goja e Zotit,³⁷ bazamenti i dogmave, përndjekësi i dikurshëm⁶ i Jisuit Shpëtimtar, por tani u bërë edhe i parëfronshmi i apostujve, o i lumur; prandaj pe gjëra të parrëfyeshme, kur u ngjite deri në qiellin e tretë,³⁸ o i urtë, dhe thërrisje: Ejani me mua dhe le të mos shteremi nga të mirat.

Ting. III I Joan Monakut

Qytetarët³⁹ e Jerusalemit të sipërm,⁴⁰ guri i besës,⁷ oratori⁸ i Kishës së Krishtit, dyshja e Trinisë, peshkatarët e botës, pasi i lanë sot tokësoret, ecën përmes atletizmit drejt Perëndisë, dhe ndërmjetojnë tek ai me guxim që të shpëtojnë shpirtat tanë.

Lavdi

Ting. Tërth. I I Bizantit

Urtësia e Perëndisë,⁴¹ Fjala e bashkëpërjetshme e Atit, siç parathanë Ungjijtë, hardhitë pjellore ju jeni, o apostuj²⁹ të tërëfamshëm, që në degët tuaja keni bistakun e pjekur dhe të hijshëm, prej të cilit duke ngrënë ne besimtarët, ecim në shijim ngazëllues; o Petro, guri i besimit⁷ dhe Pavël, mburra e kozmosit, mbështeteni grigjën që fituat me mësimdhëniet tuaja.

Tani *Hyjlindësore*

Ty të lumërojmë o Hyjlindëse e virgjër dhe të lavdërojmë ne besnikët siç të ka hije ty, qytetin e patundshëm dhe murin që s'çahet dot, mbrojtjen e pa thyeshme dhe strehën e shpirtave tanë.

*Pasvargje Idhiomele**Ting. I I Andreas së Kretës*

Pragat⁴² dhe shtrëngimet e tua⁴³ nga qyteti në qytet⁴² kush do t'i rrëfejë, o i lavdishmi apostull Pavël? A kush do prezantojë luftërat dhe lodhjet që hoqe⁴² për Ungjillin e Krishtit, ^{42a} që të fitosh të gjithë⁴⁴ dhe t'i sjellësh Krishtit Kishën? Kërko që kjo ta ruajë pohimin tënd të mirë⁴⁵ deri në frymëmarrjen e fundit, o Pavël apostull dhe mësues i Kishave.

Varg: Në gjithë dheun doli zëri i tij dhe në skajet e botës fjalët e tij.

Prangat⁴² dhe shtrëngimet e tua⁴³ nga qyteti në qytet⁴² kush do t'i rrëfejë, o i lavdishmi apostull Pavël? Lodhjet, mundimet, pagjumësitë, keqtrajtimet në uri, etje, të ftohtë dhe lakuriqësi, rrjetën, goditjet me shkop, me gurë, udhëtimet qarkore, thellësinë e detit dhe mbytjet?⁴³ U bërë teatër për engjëj dhe njerëz;⁴⁶ të gjitha i durove⁴⁷ në Krishtin që të forconte,⁴⁸ që të fitosh botën⁴⁴ në Krishtin Jisu, Zotin tënd; ndaj të lypim ne që kremtojmë kujtimin tënd besërisht, përgjërohu pandërprerë⁴⁹ të shpëtohen shpirtat tanë.

Varg: Qiejt tregojnë lavdi Perëndie.

Ndriçuesit e mëdhenj të Kishës,¹ Petron dhe Pavlin, le t'i mburrim, sepse shkëlqyen më shumë se dielli në hapësirën qiellore të besimit, dhe kombet, me anën e rrezeve të predi-

kimit, i kthyen nga padituri në njohjen hyjnore. Njëri si u ngul në kryq, kreu ecjen drejt qiellit, ku mori në dorëzim prej Krishtit çelësat e mbretërisë,⁵⁰ ndërsa tjetri, si iu pre koka me shpatë dhe u shpërngul drejt Shpëtimtarit, lumërohet siç i ka hije; dhe të dy e denoncojnë Izraelin se shtriu duart padrejtësisht te vetë Zoti; prandaj me uratat e tyre, o Krisht Perëndia ynë, rrëzoji kundërshtarët tanë dhe forcoje besimin orthodhoks si njeridashës.

Lavdi

Ting. Tërth. II I Efremi të Karies

Një festë gazmore shkëlqeu anëmbanë botës sot, kujtimi i tërëndëruar i apostujve korife të gjithurtë, Petro dhe Pavël, prandaj dhe Roma bashkëgëzohet duke kërcyer. Me këngë dhe himne⁵¹ le të kremtojmë edhe ne, o vëllezër, këtë ditë të gjithërespektuar, duke u thënë atyre: Gëzohu, o Petro apostull dhe mik⁵² i sinqertë i mësuesit tënd, Krishtit Perëndisë tonë. Gëzohu, o Pavël i tërëdashur, predikues i besimit dhe mësues⁵³ i rruzullit. O çift i hyzgjedhur, meqë keni guxim, përgjërohuni te Krishti Perëndia ynë të shpëtojnë shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë,^{53a} që nxore frytin e jetës; të lypim ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me apostujt dhe me gjithë shenjtorët, që të mëshirohen shpirtrat tanë.

Përlëshore

Ting. IV

O të parëfronshmit e apostujve dhe mësuesit⁵³ e kozmosit, lypni Zotin e të gjithave që t'i dhurojë botës paqe³⁴ dhe shpirtrave tanë përdëllimin e madh.^{14a}

Hyjlindësore

Misteri i fshehur prej jete dhe i panjohur ndër ëngjëjt, u shfaq ndër të dheshmit me anën tënde, o Hyjlindëse, Perëndia, që u mishërua me bashkim të papërzierë dhe dënjoji kryq për ne duke dashur, me të cilin ngjalli të parëgatuarin dhe shpëtoi prej vdekjes shpirtrat tanë.*



NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë,

Ndenjësores së shën Petros

Ting. Tërth. IV Tin sofian që Logon

E le detin e thellë, peshkimin ti*⁵⁴ dhe prej qiellit prite nga Ati lart* zbulësën hyjnore²² krejt,* se u bë Fjala mish⁵⁵ për ne,* dhe me guxim përpara të gjithëve thoshe fort,* thërrisje te Ndërtuesi: “Bir i njëqenshëm je* tok me Zotin ty të di”,²² vërtet denjësisht pra* për besën u shfaqe gur,*⁷ ke dhe çelësa⁵⁰ Hiri ti,* o shën Petro,* apostulli,* ndërmjeto te Zoti yt Krisht,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tënd fort të shenjt’ me mall.

Lavdi *dhe* Tani
Hyjlindësore

Më kujtohet Gjykimi dhe dridhem tmerr,* e kam frikë hetimin e ashpër fort,* vendimi krejt po më tremb,* edhe druhem nga Ferr i zi,* nga vuajtja e zjarrit, nga terri në thellësi,*⁵⁶ nga krimbi që s’fle⁵⁷ dhe kërcëllitja e dhëmbëve.*⁵⁶ Mjer’! Ç’të bëj kur frone do vendosen dhe libra* do hapen,⁵⁸ dhe çdo veprim* do shqyrtohet dhe çdo sekret* do të dalë* në pah, o Zonj’?* Bëhu ndihmë në atë çast* dhe mbrojtja ime e ngrohtë,* se ty të kam* shpresë un’ shërbëtori yt i pavlefshëm krejt.

*Pas Stihologjisë së dytë,
Ndenjësore e Pavlit
Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon*

More thirrjen nga Krishti në qiell lart,*⁵⁹ predikues i dritës u shfaqe ti,* na shndrite të gjithëve* me mësimet e Shenjtit Hir,* e rrope adhurimin e Ligjit të germës⁶⁰ krejt,* u ndrite besimtarëve dijen e Shpirtit Zot;* ndaj dhe denjësisht qartas në ajër u ngri-te,* në qiell të tretë³⁸ pra,* në Parajsë arrite drejt,* o shën Pavël,* apostulli;* ndërmjeto te Zoti yt Krisht,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tënd fort të shenjt’ me mall.

Lavdi *dhe* Tani
Hyjlindësore

Të ofroj si vejusha detyrimisht,* Zonjë, si dy të hollat⁶¹ falënderim,* himnimin e hireve,* që na bëre me mbushulli,* meqë u shfaqe strehë dhe ndihmë, sepse gjithnjë* nga ngasjet dhe shtrëngimet më nxjerr, kur shpëtova pra* unë si nga mesi i kaminës me flakë,*⁶² nga ankth e trishtim, me shpirt* të thërres, o Hyjlindëse:* Më përkrah ti* dhe ndërmjeto* pranë Birit tënd Perëndi,* t’u japë falje mëkatesh* sa besërisht* po i falen fëmijës sate, o e pacen.

*Pas Polieleit, Ndenjësore e të dyve
Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon
Le t’i mburrim ndriçuesit e mëdhenj,*¹ të tërurtin pra Pavlin plot me*

shkëlqim* dhe Petron; u shfaqën qart'* korifenj mes dishepujve,* se shndritën përmes zjarrit të Shpirtit Hyjnor,⁶³ kështu* shpërndanë tërë terrin mashtrues dhe mjegullën;* lart për Mbretërinë denjesisht u treguan* këta qytetarë³⁹ tok* në një fron pranë Shenjtit Hir;* të thërrasim:* Prej Perëndis'* lypni falje shkeljesh për sa* kujtimin tuaj të shenjtë* me mallëngjim,* o apostuj të Krishtit Zot, e kremtojnë drejt.

Lavdi *dhe* Tani
Hyjlindësore

Urtësinë⁴¹ dhe Fjalën e zure ti* brenda barkut pa farë, pa djegie krejt;* e linde për rruzullin* sundimtarin e Gjithësis';* mban në pëqi atë që në dorë çdo gjë e mban,*^{63a} pra Krijimtarin⁶⁴ si dhe ushqyesin botëror;*⁶⁵ ndaj, e Tërëshenjta Virgjëreshë, të lutem,* kur unë do rri kundrejt* faqes së Krijimtarit⁶⁶ tim,* të shpëtohem* nga çdo mëkat;* Zonj' e pastër dhe virgjëresh'* atëher' ndihmë dhe mbrojtje* ti më dhuro,* sepse, o e himnuar, mundesh të bësh sa do.⁶⁷

Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV
Proqimeni Ting. IV

Në gjithë dheun doli zëri i tyre dhe në skajet e botës fjalët e tyre.

Varg: Qiejt tregojnë lavdi Perëndie.

Ungjilli. Psalmi 50.

Lavdi. Me ndërmjetimet e apostujve. Tani. Me ndërmjetimet e Hyjlindësës. Përdëllemë, o Perëndi. *Dhe Idhiomeli.*

Ting. II

O Petro, korifeu i apostujve të lavdëruar, guri i besës⁷ dhe Pavël i mrekullueshëm, oratori⁸ dhe ndriçuesi i Kishave të shenjta, duke qëndruar pranë fronit hyjnor,⁹ ndërmjetoni për ne te Krishti.

Kanunet, Poezi e Joan Monakut

Ode I

Kanuni i shën Petros

Ting. IV

Irmosi: Uk esti si ómios

»Nuk është askush i ngjashëm me »ty, Zot⁶⁸ me lavd të madh,* njerida- »shës, se me krah* fuqiplo⁶⁹ çlirove »krejt* popullin që fitove ti.

Me hyjfrymëzim, me këngë të himnojmë denjesisht* korifeun më të madh* të apostujve, vëllan'*⁷⁰ e të parit që u hyjthirr.⁷¹

Kur Zoti i parajetshëm, o shën Petro fort i lum,* të kish paranjohur ty,* të caktoi kryetar,* si dhe mbrojtës të Kishës² son'.

As mish dhe as gjak s'të frymëzoi, veçse Ati lart,* Krishtin ta theologosh* Fjalën Bir të Perëndis'*²² të vërtetë, apostull ti.

Hyjlindësore

Vërtet Virgjëreshën dhe pas lindjes ta himnojmë ne,* ishte qerre mbi mendim* edhe mal i shenjtë⁷² kjo,* si dhe nëna e Perëndis'.

Kanuni i shën Pavlit

Ting. Tërth. IV I qekomeni

Krishti thërret të paqena porsi të qena,⁷³ përmes hyjn Johuris',* ky, o Pavël fort i lum,* kur ishe brenda barku nëne ty të zgjodhi⁷⁴ që të mbash përpara kombeve emrin* e tij³³ të hyjshëm, është ky* më i lart' se çdo emër⁷⁵ se u lëvdua lavdërisht.⁷⁶

O Pavël, Krishti t'u shfaq ty me pamje si rrufe⁷⁷ në mal dhe kështu* ty të lajmëroi ky* ndriçimin e shpresëtarisë që do vinte dhe vithisjen e mashtrimit, errëson* sy mishi,⁷⁸ por e urtëson* shpirtin tënd në njohjen e Trinisë që ka plot lavdi.⁷⁶

Të tetën ditë u rrethpreve ti, zelltar⁷⁹ në çdo zakon atëror* të hebrenjve, dhe në Ligj* u shfaqe Farise prej farës dhe prej fisit beniamin, por i konsiderove ti* të gjitha porsi plehra,

kasht',* të fitoje Krishtin⁷⁹ Zot, se u lëvdua lavdërisht.⁷⁶

Hyjlindësore

O nënë e pacenuar e Zotit, me pushtet, fuqi të përplot',* ti nga fisi mbretëror,* o Zonjë, mbive;⁸⁰ dhe në mish e linde vetëm ti, mbi mendje, mbretin Zot mbi çdo krijim,*³ shpëtomë pra nga çdo rrezik* mua që i psal Birit tënd; u lëvdua lavdërisht.⁷⁶

Zbritësore: Anikso to stoma mu

Ja gojën e çel tani (shih fq. 325)

(ose e së kremtes)

Ode III

Kanuni i shën Petros

Irmosi: Uk en sofia

»**S**'mburremi fare* për fuqi, urtësi, »as për pasuri,* por për ty,⁸¹ o urtësi* »enipostate e Atit, o Krisht*⁴¹ njeri- »dashës, se përveç teje s'ka tjetër »shenjt.⁸²

O Petro, goja* aq e ëmbël e Krishtit Zot Perëndi* të tregoi ty të lum,*²² apostull, dhe arkëtar të sigurt,* lart në Mbretëri,⁵⁰ kështu të përhimnoj- më ne.

Forcoi Kishën* e patundur Jisui Zot Perëndi* mbi theologjin' që the,* si mbi një gur,⁷ në të, o Petro shenjt,* ty

të lavdërojmë, apostull me zë të madh.

Qe më i lartë* në mish Petroja se engjëjt, sepse tha* Krishti Zot pra do të jet',* kur do të vijë me nder e lavdi,* dhe i bashkëfronshëm si edhe gjykatës ky.⁸³

Hyjlindësore

Pa njohur burrë* ti që mbajte në bark Perëndi në mish,* më forco, se tundem keq* nga veset që më sulmojnë me vrull,* se s'ka ndihmë tjetër përveç teje, e pacen.

Kanuni i shën Pavlit Si i to steréoma

Ti vure gur themeltar* shumë të çmuar, për qoshen pra* brenda në shpirt* të çdo besëmiri,* është ky Zoti Shpëtimtar.⁸⁴

E sillje me vete ti* gjithmonë dhe singërisht në mish,* Pavël me nam,* vdekjen e Jisuit;* denjësisht gjete jetën⁸⁵ lart.

O Pavël i tërëlum,* ti ndërmjeto, mbi themelin tënd* plot me virtyt,* të përmbindëtohet*⁸⁶ shndritja e besimtarëve.

Hyjlindësore

Ty të lavdëron tani,* sikundër the

pra profetikisht,* çdo gjenerat'* njerëzore, Zonjë,*⁸⁷ se shpëtojnë tani me ty.

Zbritësore: Tus sus imnologus

O Zonjë dhe nën' e Perëndisë

Ipakoia Ting. Tërth. IV

Cili burg nuk të pati në pranga?⁴² Cila Kishë nuk të ka orator?⁸ Damsku mburret me ty, o Pavël, sepse të pa të mposhtesh nga drita;⁷⁸ Roma, meqenëse priti gjakun tënd, krenohet edhe ajo; por ngazëllohet më shumë Tarsosi,⁸⁸ dhe me mallëngjim puth shpërgënjtë e tu; po, o Pavël apostull, krenaria e kozmosit, arri dhe mbështetna.

Duhet ditur se kur thuhet Ipakoia, nuk thuhet Ndenjësore.

Ode IV

Kanuni i shën Petros Irmosi: Utos o Theós imón

»**K**y është Perëndia ynë,⁸⁹ që u mi-
»shërua prej Virgjëreshe dhe e hyjni-
»zoi natyrën, drejt të cilit thërrasim du-
»ke himnuar: Lavdi fuqisë sate, o Zot.

Sikundër premtoi Krishti, të bëri peshkatar të hyjnueshëm njerëzish,⁵⁴ duke të dorëzuar ty, të parit, timonin e Kishës së tij.

Lype Jisunë jetëdhënës, që të dha përgjegjësi të lidhësh e të zgjidhësh, o Petro,⁵⁰ që të jetë i butë me mua.

Përgjërohu bujarisht, o Petro, që të hapen mbretëritë e Krishtit⁹⁰ për ata që lavdërojnë me besë pa dyshim kujtimin tënd të hyjshëm.

Hyjlindësore

O Zonjë e tërëhimnuar, hyjshtatzënë, nënë e Perëndisë të të gjithave, pasi t'i pastrosh mendimet e mia me anën e ndërmjetimeve të tua, tregomë fryt-dhënës.

Kanuni i shën Pavlit Epevis ef ipus

Sauli dikur shkeli si luan Kishën e Krishtit duke e dëmtuar egërsisht,⁶ por pasi u zbut me zërin hyjnor⁷⁷ të qengjit të Perëndisë,⁹¹ merr përsipër pors barë grigjën²⁰ që përndiqte.⁶

Ai që kishte për të ndriçuar rruzullin u errësua,⁷⁸ dhe Anania u dërgua dhe i dha shndritjen e shpirtit dhe të trupit, pasi e mësoi atë me fanitje hyjnore si enë të zgjedhur.⁹²

Për Pavlin denjësisht mburret Damasku,⁵⁹ se po nga ky, sikurse nga Parajsa dikur, ai doli si burim tepër i madh rrjedhjesh të hyjnueshme, dhe dehu pa kursim tërë dheun⁹³ me hyj-dije.

Hyjlindësore

Vithisi të fuqishëm prej froneve Zoti, siç tha Virgjëresha dhe nëna, ndërsa të uriturit i mbushi me të mira⁹⁴ të hyjshme, ata që psalin me besim: Lavdi fuqisë sate, o Zot.

Zbritësore: Tin aneksihniaston

Të pagjurmësuarin

Ode V

Kanuni i shën Petros

Irmosi: O ktisámenos imás

»**O** Zot, ti që me gjakun tënd na fitove²¹ ne, si popull të zgjedhur,⁹⁵ na »jep paqen tënde,³⁴ duke e ruajtur në »një mendje tufën tënde.

Peshkatari i pashkolluar, pasi mori guxim para Perëndisë nga malli që kishte për të, në mënyrë të vyer admirohej,⁹⁶ duke bërë mrekulli çuditërisht⁹⁷ me anën e Hirit.

Për hirin tënd, o Krisht, apostulli yt i hyjshëm, duke mos përfituar as ar, as argjend, por virtyt, u pasurua me fuqinë e çudive.⁹⁷

Përsoseshin kyçet dhe shputat e të çalëve me fjalën tënde vepruese,⁹⁷ sepse përmes Shpirtit Hyjnor kryeshin gjëra të habitshme.⁹⁸

Hyjlindësore

Oe Dëlrirë, përmes teje duke u bashkuar me mish, Perëndia u trupëzua në hipostazë, duke mbetur jo më pak i patrup sipas esencës hyjnore.

Kanuni i shën Pavlit

Fótison imás

Ti zgjodhe, o apostull Pavël, krenarinë e vërtetë,⁹⁹ duke mbajtur përgjithmonë Kryqin e Krishtit¹⁰⁰ mbret si trofe.

Për ty jeta ishte Krishti, ndërsa vdekja fitim¹⁰¹ i shkëlqyer, sepse, o Pavël i lavdishëm, nga malli u kryqëzove së bashku me të kryqëzuarin¹⁰² për ne.

Gëzohu vërtet më Zotin, o Pavël i çmuar, pasi u largove nga trupi dhe u shpërngule drejt Krishtit,¹⁰³ Perëndisë jetëdhënës.

Hyjlindësore

Gëzohu vërtet, o thesari i virgjërisë, rithirrja e stërnënës dhe zgjidhja e mallkimit të stëratit.¹⁰⁴

Zbritësore: Eksesti ta símpanta

Të gjith' i habite ti

Ode VI

Kanuni i shën Petros

Irmosi: En kiti Hristé

»**S**i mbeti tri ditë brenda peshkut*

»të madh Jonai,¹⁰⁵ Krisht, të para-
»shkroi ty që s'vdes,* si të vdekur me
»dashje,* të mbetur tri ditë brenda
»barkut tokësor.¹⁰⁶

Si Petron shpëtove me të djathtë* qëmoti, o Krisht, kur mbi det ky ec-te,¹⁰⁷ po kështu* nxirrme mua që mbytem* pra mes shtrëngatës me ngasje të tmerrueshme.

Ile të paqenat dhe arrite* të qenat si tregtar edhe peshkove qartësisht,* Petro, margaritarin* e çmuar,¹⁰⁸ Krishtin e pasur mbushullisht me Hir.

Ke vrarë, o Petro, sa menduan* pa mend dhe marrëzisht që të sprovonin Shenjtin Shpirt,* që ti theologove* i pari si Zot fuqishëm, o i tërëlum.¹⁰⁹

Hyjlindësore

Ti Fjalën e Perëndisë linde* e cila është' përtej gjithë esencave; me shpirt* dhe me buzë të shpallim* pra si Hyjlindëse, se na mishërove Zot.⁵⁵

Kanuni i shën Pavlit

Tin dhéisin ekheó

Shpërfille krejt* gjithë të pëlqyerat,*⁷⁹ të qëlloi dashuria e Zotit;* dhe të dështosh* nga shpëtim i përbashkët*¹¹⁰ ti preferove¹¹¹ prej mallit të tij, o shenjt,* i lumi Pavël, dhe tani* përgjërohu për rruzullin mbarë pra.

Krejt denjesisht* të dhuroi Krishti Zot,* o apostull Pavël, qytetarinë* në qiej³⁹ lart,* sepse nuk dëshirove* këtu qytet të qëndrueshëm,¹¹² o i lum;* u bërë shërbëtor besnik,* në misteret e tij administrator.¹¹³

U bë çdo gjë* për të gjithë sinqerisht,* pra që t'i fitojë Pavli të gjithë,*⁴⁴ kombet ai* t'i shpëtojë, se veshi* Jisunë.¹¹⁴ Ish imitues i tij¹¹⁵ zëmadh;* vërtet shpëtoi ky çdo skaj,* pasi pra i rrjetoi për Krishtin Zot.

Hyllindësore

Siç the, mbi ty,* o Hyjnënë, shtiu syt'*⁸⁷ dhe esencën time e rinovoi,* dhe madhështi* si i fortë ka bërë,*²³ dhe më shpëtoi nga prishja,¹¹⁶ Hyllindëse* e tërëpaqortueshme,* si i dhembshuri Zot, Perëndia im.

Zbritësore: Tin thian taftin

Këtë të kremte e lusim sot

Kontaqi

Ting. II Tus asfalís ke theofthongus

Zot, more për shijimin e të mirave,* për prehjen tënde predikuesit e tu* të sigurt edhe hyjfolësit, që ishin maja midis nxënësve,* sepse më shumë se çdo holokaust, fli,* pranove lodhjet, vdekjen që i hoqën keq,* i vetmi që njeh ato që zemra ka.^{116a}

Shtëpia

Ma fuqizo gjuhën, o Shpëtimtari im, më zgjero gojën dhe, si ta mbushësh atë,¹¹⁷ jepi pendim zemrës sime, që të shkoj pas atyre që them, dhe të zbatoj i pari ato që mësoj, sepse është thënë: “Çdokush që bën dhe jep mësim, ky është i madh”,¹¹⁸ se “në thënça dhe nuk e zbatoj, do të llogaritem si bakër që kumton”,¹¹⁹ prandaj më dhuro që të flas të duhurat dhe të bëj të dobi-shmet, i vetmi që njeh ato që zemra ka.^{116a}

Sinaksari

Më 29 të të njëjtin muaj, kujtimi i apostujve të shenjtë, të tërëfamshëm dhe protokorifenj Petro dhe Pavël.

Vargje: Kryqëzimi vrau Petron, predikuesin e Krishtit,/ ndërsa prerja Pavlin, që preu mashtrimin.

Në të njëzetënëntën pëson Petroja kryq, ndërsa Pavli shpatë.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Petroja në Rostov.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII

Kanuni i shën Petros

Irmosi: O en arhí ánarhos

»**T**i, o Fjalë e pafillim që në fillim, së

»bashku me Atin¹²⁰ dhe Shpirtin, Bir
»i vetëmlindur,¹²¹ je i bekuar dhe i
»përmblartësuar, Perëndia i etërve
»tanë.¹²²

Duke u edukuar me providencë hyjnore të imitosh dhembshurinë e Krishtit, lëshohesh të pësosh shtrëngatën e mohimit para Pësimit, o Petro.⁵

Ty lavdishëm si kryetarit të apostujve, të thirrurit të parë,⁵⁴ që deshe fort Krishtin,²⁰ të shfaqet më parë ai kur u ngjall prej varrit.¹²³

Zoti, duke shlyer mohimin tënd të trefishtë para Pësimit,⁵ e vërteton dashurinë me anën e pyetjes së trefishtë²⁰ të hyjthënë.

O Petro, si dëshmitar i dashurisë për Krishtin, vure para Fjalën që i di të gjitha si Perëndi; prandaj të dorëzon grigjën tepër të dashur.²⁰

Hyjlindësore

Le ta lumërojmë të gjithë si nënën e Perëndisë⁸⁷ të të gjithave atë që zuri në bark me mish Fjalën Perëndi,¹²⁰ i cili lindi nga Ati para jetëve.

Kanuni i shën Pavlit En pedhío Dheirá

O Krisht, u bë vula dhe kurora e apostujve të tu ai që u thirr në kohë të

fundme, por që i tejkalonte të gjithë për sa i përket zellit,¹³ bashkë me të populli i Kishës të psal: O Perëndi i etërve tanë, je i bekuar.¹²²

Ndonëse Pavli i burgosur⁴² përndoqi më parë Kishën⁶ tënde, kapërceu guximin e vjetër me anën e zellit të mëpasshëm për ty,¹³ sepse i mbledhi kombet, të cilat thërrasin, o Krisht: O Perëndi i etërve tanë, je i bekuar.¹²²

Pasi predikove te të gjithë Ungjillin nga Jerusalemi dhe rrethove përqark tërë dheun deri në skajet e Ilirikut, o Pavël,¹²⁴ duke mësuar thërrisje: O Perëndi i etërve tanë, je i bekuar.¹²²

Kur u more lart në ekstazë, arrite qiellin e tretë, o i tërëpasur, dhe, meqenëse dëgjove fjalë të parrëfyeshme,³⁸ thërret: Lavdi Atit më të lartë dhe Birit, shkëlqimi¹²⁵ i bashkëfronshëm, dhe Shpirtit që heton qartë thellësitë e Perëndisë.¹²⁶

Hyjlindësore

Si shi mbi shtëllungë zbriti¹²⁷ në ty Krishti Perëndia, o Virgjëreshë, dhe doli nga ti mishprurës duke bashkuar ato që më parë ishin të kundërta, dhe duke dhuruar në tokë dhe në qiell paqe,³⁴ Perëndia i bekuar i etërve tanë.¹²²

Zbritësore: Uk elátrefsan

Nuk u faleshin

Ode VIII

Kanuni i shën Petros

Irmosi: O ta simpanta feron

»**O** Krisht, që mban Gjithësinë^{63a}
»me fuqinë tënde të parrëfyeshme,
»vesove në flakë Djemtë e tu oshë-
»narë⁶² që thërrisin: Bekojeni, vep-
»rat e Zotit, Zotin.¹²⁸

O Petro, Zoti që profetizoi kështu:
“Do t’i tendosin duart e tua dhe do
të të ngjeshin në kryq”, urdhëron t’i
shkosh pas ti¹²⁹ duke thirrur: Beko-
jeni, veprat e Zotit, Zotin.¹²⁸

Nga një anë Enean e paralizuar frik-
shëm,¹³⁰ nga ana tjetër Tavithanë e
vdekur,¹³¹ me fjalën e Hirit¹³² i ngrite
kur thërrisin: Bekojeni, veprat e Zo-
tit, Zotin.¹²⁸

O Krisht, që i deklarove Petros se ja-
në të pastruara kombet¹³³ me shkëlqi-
min e Shpirtit, pastro dhe mendjen ti-
me që thërras: Bekojeni, veprat e Zo-
tit, Zotin.¹²⁸

Hyjlindësore

O Virgjëreshë, duke fushuar në ty
Hyjnia me një nga hipostazat e saj të
shenjta, u bashkua e tëra me mua të

tërin, ndaj të lumërojmë ty si nënën e
Perëndisë tonë.

Kanuni i shën Pavlit

Ton en ori ajio

U përzje me mallin tënd Pavli dhe u
marros me ndryshimin e mirë, sepse
nuk jetonte për veten i kënduari, por
të kishte ty, o i dhembshur, të gjallë
brenda vetes¹⁰² në gjithë jetët.

Ti rregullove që t’i paraqesësh Kri-
shtit dhëndër Kishën si nuse, se u
tregove si mbles i saj,¹³⁴ o Pavël hyj-
prurës, ndaj siç e ka për detyrë mburr
kujtimin tënd.

Garove ndeshjen më të mirë dhe,
pasi kreve udhën¹⁰ tënde ligjërisht,¹³⁵
iu afrove Krishtit i ngazëlluar, o i tërë-
kënduar; prandaj u denjësove për ku-
rorat e drejtësisë,¹³⁶ o Pavël.

Hyjlindësore

Gëzohu, o fron i Zotit me pamje zja-
rri;¹³⁷ gëzohu, o nuse e panusëruar, o
e Virgjër; gëzohu, o re që shkëlqeve
diellin e drejtësisë,¹³⁸ të cilin e për-
mbilartësojmë në jetë.

Zbritësore: Pedhas evajis

Djemat e dënuar

*Ode IX**Kanuni i shën Petros**Irmosi: Se tin iperëndhokson*

»Ty të Tërëshenjtën, Hyjlindësen, nu-
 »sen e përmbilavdishme* me himn
 »të madhështojmë;* ke lindur ti Ndër-
 »tuesin e të gjithave, pra sa duken
 »dhe s'duken.¹³⁹

Publikohet denjesisht Hiri hiperbo-
 lik që ke, o Petro;* hija jote dëbon
 larg* pësimet nga sa jan' të sëmu-
 rrë,¹⁴⁰ ndaj me hare të madhërojmë ne.

Magjistari Simon luftues i Perëndisë
 ishte ngritur* me fantazma në ajër.*
 Me forc' të hyjshme që s'shprihet e
 vithisi shën Petroja.¹⁴¹ E lumërojm'.

Përmes përgjërimit tënd jep zgjidh-
 jen e mëkateve dhe dritën* brenda
 zemrës,¹⁴² harenë* në shpirtin e atyre
 që e himnojnë kujtimin tënd, apostull
 shenjt.

Hyjlindësore

Quhesh lindëse zotërore, se Perëndi,
 o Virgjëreshë,* zure, ndaj besimtarët*
 me një zë denjesisht ty të madhë-
 shtojmë, me himne të lëvdojmë ty.

*Kanuni i shën Pavlit**Orus parilthes tis fiseos*

Ifalemi zinxhirit tënd që e veshe¹⁴³
 si kriminel¹⁴⁴ për Krishtin, dhe për-

qafojmë shenjat e plagëve, që i mban
 në trupin tënd¹⁴⁵ të lavdishëm dhe
 fitimtar, o Pavël.

Tani që ike drejt atij që pareshtur dë-
 shiroje dhe me të cilin rri bashkë¹⁴⁶ si
 shërbyes, o apostull, me përgjërime
 pa pushim hiqi drejt teje lutësit e tu.

Tani plotësisht, jo në enigma as në
 pasqyrë të shfaqet Krishti, por madje
 fytyrë më fytyrë,¹⁴⁷ duke të zbuluar të
 përsosur njohjen e Hyjnisë.

Hyjlindësore

Pranove Fjalën pa mish që donte të
 rigatuante natyrën time dhe e linde
 të mishëruar,⁵⁵ o Virgjëreshë; prandaj,
 o Perëndilindëse, të madhërojmë pa
 pushim.

*Zbritësore: Apas jijenís***G**jithë njerëzit*Dërgimësore**Jinekes akutísthite*

Të gjithë të himnojmë ne* ty, ma-
 jën e apostujve,* Petron, dhe Pavlin
 e hyjshëm,* ndriçues të botës¹ mba-
 rrë* dhe predikues bese pra,*³ bo-
 ri thelogjie,* shpallës, shpjegues
 dogmash drejt,* që janë shtyllat e
 Kishës*² edhe e shembën mashtri-
 min.

Hyllindësore

O Vajzë e hyjhirshme fort,* Hyjnënë Virgjëreshë, tok* e parashpallën profetë,* na e mësuan apostuj,* engjëj e përhimnojnë lart,* e pohuan martirë drejt,* ne njerëzit i falemi* misterit krejt të çuditshëm,* të madh të lindjes që bëre.

*Lavdërimë**Ting. IV O eks ipsistu klithís*

Ti jo nga njerëzit, por nga lart u ftove,*⁵⁹ kur t'i errësoi ty terri i dheshëm syt'* e trupit,⁷⁸ ndaj edhe zymtësin'* e ateizmit* e publikoi, dhe tok me syrin tënd,* mendjen tënde, drita e qiellit plot fuqi* i shndriti dhe bukurin' që ka* shpresëtaria* kjo e zbuloi, pra njohe Krishtin Zot*⁷⁷ që nxjerr nga terri* dritën; lype atë që të na shpëtojë, të shndrisë krejt* shpirtrat tanë, t'u japë* ndjesën, faljen e mëkateve.

Ai që Hirin prej qiellit pranoi,* sapo korit të dymbëdhjetë apostujve* i tha, e pyeti Zoti Krisht* dhe Shpëtimtari:* "Kush thonë njerëzit, pra se cili jam?,"* Petroja atëher' i pari i nxënësve* të Mjeshtrit, shpalli thelogji* me zë të fortë:* "Je Krishti Biri i Perëndis' që rron".* Ndaj lumërohet* denjësisht, se nga lart ka marrë zbulësë dhe përgjegjësi* që të lidhë e

zgjidhë* çdo paudhësi të shpirtrave.¹⁴⁸

Ty me të drejtë të quajti gur Krishti,* ku forcoi besën e Kishës pa tundje dot,*⁷ duke të bërë kryebari* për dëlet, qengjat* mendorë²⁰ dhe të vendosi rojë ty,* kur të dha dhe kyçet e portës së qiejve,*⁵⁰ të hapësh pra për të gjithë sa* frekuentojnë* dhe me besim vijnë, se ka mirësi;* ndaj si i vyer* denjësisht ti u kryqëzove si Zoti yt Perëndi;* lyp atë të shpëtojë,* të ndriçojë shpirtrat tanë krejt.

Si predikues i Krishtit, Kryqin mbaje* mburrje;⁹⁹ me sinqeritet pra doje mbi çdo gjë* ti dashurinë hyjnore krejt,* që është shumë* e dëshirueshme, se të dashurin* e bashkon me sa fort e duan, u quajte* pra i burgosur i Krishtit tënd,*⁴² se preferove* mbi çdo shijim tjetër ëmbëlsinë ti* pra në mundime;* dhe për ikjen e vyer u denjësove, me Zotin rri,*¹⁴⁶ lyp atë të shpëtojë, të ndriçojë shpirtrat tanë krejt.

*Lavdi**Ting. Tërth. II I Kozma Monakut*

Ekremtja e tërënderuar e apostujve i erdhi Kishës së Krishtit, duke na shkaktuar shpëtim; ndaj me duartrokite mistikisht, le t'u themi: Gëzhohuni, o ndriçues të atyre që janë në

errësirë,¹⁴⁹ duke qenë se jeni rrezet e diellit; gëzohuni, o Petro dhe Pavël, themelet³⁵ e pathyeshme të dogmave hyjnore, miqtë e Krishtit,⁵² enë të çmuara;³³ jeni mes nesh padukurisht, duke i bërë të denjë për dhurata jo-lëndore ata që mburrin me këngë festën tuaj.

Tani *Hyjlindësore*

O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë,^{53a} që nxore frytin e jetës; të lypim, ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me apostujt dhe me gjithë shenjtoret, që të mëshirohen shpirtat tanë.

Dhoksologjia e Madhe

Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanuni i apostullit Petro Ode III dhe nga Kanuni i apostullit Pavël Ode VI. Kontaqi i Pentikostarit, por nëse bie jashtë këtij, Mbrojtje e paturpëruar. Kungatore: Në gjithë dheun.



Idhiomelet e apostujve që psalen gjatë shpërndarjes së vajit të shenjtë.

Ting. IV

O i shquari i apostujve, Krishti guri, me anën tënde themeloi Kishën në veten e tij, kundër së cilës nuk do sundojnë portat e Hadhit,⁷ gjepurat e

heretikëve, as nuk do ta pushtojnë tërbime barbarësh; çliroje pra atë nga ngasjet dhe rreziqet me përgjërimet e tua, o i tërëlumur.

I njëjti I Joan Monakut

O Petro, bazamenti i besimit,⁷ Krishti të kurorëzoi të parin ndër të zgjedhurit,⁵⁴ ty të paratha Zoti i çdo gjëje: “I lumur je, Simon, bir i Jonait, sepse të bëri për hirin tim hyjpredikues jo mish e gjak, a gjë tjetër, por Ati im në qiej”.²² Atij lypi, o apostull i hyjlumëruar, që të na dhurohet përdëllimi i madh.^{14a}

Ting. Tërth. II I Theofanit

Me himne lavdërimesh le t'i nderojmë predikuesit⁵³ e vërtetë të shpërsëtarisë dhe yjet përmbimendore të Kishës, Petron, gurin e besës⁷ dhe Pavlin, mësuesin⁵³ autentik dhe mistin e Krishtit Shpëtimtar; sepse ata, pasi mbollën fjalën e së vërtetës²⁸ në zemrat e besimtarëve, u shpërndanë të gjithëve frytshmëri, dhe ndërmjetojnë te Krishti që të shpëtojnë shpirtat tanë.

Lavdi

Ting. Tërth. IV I Joan Monakut

O Pavël i tërëlumëruar,⁶ sharës dhe përndjekës i Kishës ishe, por, kur u

thirre prej qiellit,⁵⁹ e mbrojte atë para-doksalisht; lyp që të çlirohet ajo nga rreziqet dhe të shpëtojnë shpirtrat tanë.

Tani *I së kremtes*

*[por nëse bie jashtë Pentikostarit,
Hyjlindësore:]*

O Zonjë, priti lutjet e shërbëtorëve të tu edhe çlirona ne nga çdo nevojë dhe pikëllim.]

CITIME

¹ Fil. 2.15

² Gal. 2.9

³ Ef. 3.4

⁴ I Kor. 2.6-7; II Petr. 3.15

⁵ Matth. 26.69-75; Mark. 14.66-72; Lluk. 22.55-62; Joan 18.25-27

⁶ Vep. 9.1-2; 22.4-5; 26.9-11; I Kor. 15.9; Gal. 1.13,23; Fil. 3.6

⁷ Matth. 16.18; Joan 1.43

⁸ Vep. 14.12

⁹ III[I] Mbret. 17.1; 18.15;
IV [II] Mbret. 3.14; 5.16

¹⁰ II Tim. 4.7

¹¹ Sirak 24.8; Joan 1.3; Kol. 1.16

¹² I Kor. 2.8; Jak. 2.1

¹³ I Kor. 15.10

¹⁴ I Petr. 5.4

^{14a} Num. 14.19 etj.

¹⁵ Vep. 20.24

¹⁶ Is. 52.7; Rom. 10.15

¹⁷ Fja. Urt. 24.36 (Mas. 30.13); Is. 10.12

¹⁸ Ef. 6.17

¹⁹ Eks. 31.18; 34.1-4,28; Ligji i Dytë 4.13; 5.22(19); 9.9-11; 10.1-4

²⁰ Joan 21.15-17

²¹ Vep. 20.28

²² Matth. 16.17-18

²³ Lluk. 1.49

²⁴ Ps. 44(45).10

²⁵ Gjen. 1.26-27; 5.1; 9.6; Urt. Sol. 2.23; Sirak. 17.3

²⁶ Matth. 18.12; Lluk. 15.4-5

²⁷ Ef. 2.18; 3.12

²⁸ Matth. 13.3-23; Mark. 4.3-20; Lluk. 8.5-15

²⁹ Joan 15.1,5

³⁰ Ps. 103(104).15

³¹ II Kor. 3.18

³² I Tim. 3.9; II Tim. 1.3

³³ Vep. 9.15

³⁴ Joan 14.27

³⁵ Ef. 2.20; Apok. 21.14

³⁶ Vep. 2.41; 4.4 etj.

³⁷ Jer. 15.19

³⁸ II Kor. 12.2-4

³⁹ Fil. 3.20

⁴⁰ Gal. 4.26

⁴¹ I Kor. 1.24,30

⁴² Vep. 20.23; II Kor. 11.23; II Tim. 2.9

^{42a} Rom. 15.19 etj.

⁴³ Vep. 14.19; 27.41-43; II Kor. 6.4-6; 11.23-27,33; I Thes. 2.9; II Thes. 3.8

⁴⁴ I Kor. 9.19-23

⁴⁵ I Tim. 6.12-13

⁴⁶ I Kor. 4.9

⁴⁷ II Tim. 2.9

⁴⁸ Fil. 4.13

⁴⁹ Rom. 1.10; II Tim. 1.3

⁵⁰ Matth. 16.19

⁵¹ Ef. 5.19; Kol. 3.16

⁵² Joan 15.15

⁵³ I Tim. 2.7; II Tim. 1.11

^{53a} Joan 15.1

⁵⁴ Matth. 4.18-20; Mark. 1.16-18; Lluk. 5.10-11

⁵⁵ Joan 1.13

- ⁵⁶ Matth. 8.12; 13.42, 50; 22.13, 51; 25.30; Lluk. 13.28
- ⁵⁷ Matth. 5.22; 18.9; Mark. 9.43-48; Jak. 3.6
- ⁵⁸ Dan. 7.9-11
- ⁵⁹ Vep. 9.6; 22.10; 26.16,19
- ⁶⁰ Rom. 3.27; 7.6; II Kor. 3.6-7
- ⁶¹ Mark. 12.42; Lluk. 21.2
- ⁶² Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 26
- ⁶³ Vep. 2.3-4
- ^{63a} Est. 4.17^b
- ⁶⁴ Hebr. 1.2
- ⁶⁵ Ps. 110(111).5 etj.
- ⁶⁶ Rom. 14.10
- ⁶⁷ Urt. Sol. 12.18; Mark. 1.40
- ⁶⁸ I Kron. 17.20; II Kron. 6.14; Ps. 85(86).8; 88(89).9; Joel 2.2
- ⁶⁹ Eks. 6.1 etj.
- ⁷⁰ Matth. 4.18; 10.2; Mark. 1.16; Lluk. 6.14; Joan 1.42
- ⁷¹ Joan 1.41
- ⁷² Ps. 2.6 etj.; II Petr. 1.18
- ⁷³ Rom. 4.17
- ⁷⁴ Gjyq. 16.17; Jer. 1.5
- ⁷⁵ Fil. 2.9
- ⁷⁶ Eks. 15.1,21
- ⁷⁷ Vep. 9.3-5; 22.6-8; 26.13-15
- ⁷⁸ Vep. 9.8; 22.11
- ⁷⁹ Fil. 3.5-8
- ⁸⁰ Gjen. 49.10
- ⁸¹ I Mbret. [Sam.] 2.10; Jer. 9.23(22)
- ⁸² I Mbret. [Sam.] 2.2; II Mbret. [Sam.] 7.22
- ⁸³ Matth. 19.27-28; Lluk. 22.30
- ⁸⁴ Ps. 117(118).22; Is. 28.16; Ef. 2.20; I Petr. 2.6
- ⁸⁵ II Kor. 4.10
- ⁸⁶ I Kor. 3.10; Ef. 2.20
- ⁸⁷ Lluk. 1.48
- ⁸⁸ Vep. 22.3
- ⁸⁹ Varuk 3.36
- ⁹⁰ Ef. 5.5
- ⁹¹ Is. 53.7,11; Joan 1.29,36; Vep. 8.32; I Petr. 1.19
- ⁹² Vep. 9.10-18; 22.12-16
- ⁹³ Gjen. 2.6
- ⁹⁴ Lluk. 1.52-53
- ⁹⁵ Tit. 2.14
- ⁹⁶ Vep. 4.5-13
- ⁹⁷ Vep. 3.6-7
- ⁹⁸ Lluk. 5.26
- ⁹⁹ Gal. 6.14
- ¹⁰⁰ Matth. 16.24; Mark. 8.34; 10.21; Lluk. 9.23; 14.27
- ¹⁰¹ Fil. 1.21
- ¹⁰² Gal. 2.20
- ¹⁰³ II Kor. 5.6-9
- ¹⁰⁴ Gjen. 3.16-19
- ¹⁰⁵ Jona 2.1
- ¹⁰⁶ Matth. 12.40
- ¹⁰⁷ Matth. 14.29-31
- ¹⁰⁸ Matth. 13.45-46
- ¹⁰⁹ Vep. 5.1-10
- ¹¹⁰ Juda 3
- ¹¹¹ Rom. 9.3
- ¹¹² Hebr. 13.14
- ¹¹³ Lluk. 12.42; I Kor. 4.1
- ¹¹⁴ Rom. 13.14; Gal. 3.27
- ¹¹⁵ I Kor. 11.1
- ¹¹⁶ Jona 2.7
- ^{116a} Fja. Urt. 24.12
- ¹¹⁷ Ps. 80(81).11
- ¹¹⁸ Matth. 5.19
- ¹¹⁹ I Kor. 13.1
- ¹²⁰ Joan 1.1
- ¹²¹ Joan 1.14,18; 3.16,18; I Joan 4.9
- ¹²² Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 28
- ¹²³ Lluk. 24.34
- ¹²⁴ Rom. 15.19
- ¹²⁵ Urt. Sol. 7.26; Hebr. 1.3
- ¹²⁶ I Kor. 2.10
- ¹²⁷ Gjyq. 6.37-38; Ps. 71(72).6
- ¹²⁸ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34

- ¹²⁹ Joan 21.18-19
¹³⁰ Vep. 9.32-34
¹³¹ Vep. 9.40
¹³² Vep. 19.4; 20.32
¹³³ Vep. 10.9-16
¹³⁴ II Kor. 11.2
¹³⁵ II Tim. 2.5
¹³⁶ II Tim. 4.8
¹³⁷ IV[II] Mbret. 19.15; II Kron. 18.18;
Is. 6.1; Jez. 1.13-26
¹³⁸ Mal. 4.2 (3.20)
¹³⁹ Sirak 24.8; Joan 1.3; Kol. 1.16
- ¹⁴⁰ Vep. 5.15
¹⁴¹ Vep. 8.9-24
¹⁴² II Kor. 4.6
¹⁴³ Vep. 12.6-7; 21.33; 28.20;
Ef. 6.20; II Tim. 1.16
¹⁴⁴ II Tim. 2.9
¹⁴⁵ Gal. 6.17
¹⁴⁶ Fil. 1.23
¹⁴⁷ I Kor. 13.12
¹⁴⁸ Matth. 16.13-19
¹⁴⁹ Rom. 2.19



MË 30 TË TË NJËJTIT MUAJ

**Mbledhja e Dymbëdhjetë Apostujve të shenjtë,
të lavdëruar dhe të tërëfamshëm.**

Tipikon

1. Nëse bie të enjten ose të premten pas Pentikostisë:

Në Mbrëmësore, pas Qëndrimit të parë të Psaltirit, Thirrtoret: 6 të Mujorit. Lavdi i Mujorit. Tani i së kremtes. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Pasvargjet e Mujorit. Lavdi i tij. Tani i së kremtes. Përlëshoret: e korifenjve, e të Dymbëdhjetëve dhe e së kremtes.

Në Mëngjesore, Ndenjësoret e korifenjve dhe, në vend të Hyjlindësoreve, të së kremtes. Kanunet: një i së kremtes (të enjten i pari dhe të premten i dyti), i korifenjve dhe i të Dymbëdhjetëve. Pas Odes III, Ndenjësoret: e Mujorit dhe, në vend të Hyjlindësoreve, e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Mujorit dhe Sinaksari. Zbritësoret e së kremtes (vetëm e Ting. IV Mjegull' e mbuloj). Më të nderuarën. Dërgimësoret e Mujorit dhe të së kremtes. Lavdërimet e Mujorit. Lavdi i Mujorit. Tani i së kremtes (kërkoje në Lavdi dhe Tani i Pasvargjeve). Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e të Dymbëdhjetëve.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e së kremtes. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e së kremtes, e korifenjve, e të Dymbëdhjetëve dhe e kishës. Kontaqi i së kremtes. Apostulli dhe Ungjilli i të Dymbëdhjetëve. Të meriton. Kungatore: Në gjithë dheun. Pamë dritën.

2. Nëse bie të shtunën (në Mbylljen) e Pentikostisë

(Lihet shërbesa e korifenjve)

Në Mbrëmësore, pas Qëndrimit të parë të Psaltirit, Thirrtoret: 6 të së kremtes dhe 3 të të Dymbëdhjetëve (Lumëroheni, nxënës ju) në 4. Lavdi i Mujorit. Tani i së kremtes. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Pasvargjet e së kremtes. Lavdi i Mujorit. Tani i së kremtes. Përlëshoret: e së kremtes, e të Dymbëdhjetëve dhe përsëri e së kremtes.

Në Mëngjesore, Ndenjësoret e korifenjve dhe, në vend të Hyjlindësoreve, të së kremtes. Kanunet: të dy të së kremtes dhe i të Dymbëdhjetëve. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e së kremtes. Ndenjësoerja e të Dymbëdhjetëve dhe e së

kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e të Dymbëdhjetëve dhe Sinaksari. Zbritësoret publikate të së kremtes. Në vend të Më të nderuarën, Ode IX e Kanuneve. Dërgimësoret: e para e së kremtes, e të Dymbëdhjetëve dhe e dyta e së kremtes. Lavdërimet: 3 të së kremtes dhe 3 të të Dymbëdhjetëve. Lavdi i të Dymbëdhjetëve. Tani i së kremtes. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e së kremtes.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e së kremtes. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e së kremtes, e të Dymbëdhjetëve dhe e kishës. Kontaqi i së kremtes. Apostulli dhe Ungjilli i të Dymbëdhjetëve. Në vend të Të meriton, Irmosi i Odes IX të së kremtes (Ting. IV). Kungatore e së kremtes [dhe Në gjithë dheun]. Pamë dritën.

3. Nëse bie të Dielën e Gjithë Shenjtorëve

(Lihet shërbesa e korifënjve)

Në Mbrëmësore, Thirrtoret: 3 ngjallësore, 4 të të Dymbëdhjetëve dhe 3 të Gjithë Shenjtorëve. Lavdi i të Dymbëdhjetëve. Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Leximet e Gjithë Shenjtorëve. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i Gjithë Shenjtorëve. Tani Hyjlindësore ngjallësore (Zoti Krisht bërësi). Përlëshoret: ngjallësore, e të Dymbëdhjetëve, e Gjithë Shenjtorëve dhe Hyjlindësore ngjallësore (Misteri i fshehur).

Në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Litia e Gjithë Shenjtorëve. Himne Triadike. Trishenji dhe Përlëshorja e Gjithë Shenjtorëve. Në Mëngjesore, Ndenjësoret e Pentikostarit. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimeni i Tingullit. Kanunet: ngjallësor, i të Dymbëdhjetëve dhe i Gjithë Shenjtorëve. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e Gjithë Shenjtorëve. Ndenjësorja e të Dymbëdhjetëve, e Gjithë Shenjtorëve dhe Hyjlindësorja e tyre. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e të Dymbëdhjetëve. Sinaksari i ditës dhe i Pentikostarit. Zbritësoret Ja gojën e çel tani; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Më të nderuarën. Dërgimësoret: ngjallësore, e të Dymbëdhjetëve, e Gjithë Shenjtorëve dhe Hyjlindësorja e tyre. Lavdërimet: 2 ngjallësore, 3 të të Dymbëdhjetëve dhe 3 të Gjithë Shenjtorëve. Lavdi i të Dymbëdhjetëve. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të Tingullit, 4 nga Ode III e të Dymbëdhjetëve dhe 4 nga Ode VI e Gjithë Shenjtorëve. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e të Dymbëdhjetëve, e Gjithë Shenjtorëve dhe e kishës. Kontaqi i Gjithë Shenjtorëve (kërkoje para Shtëpisë së tyre). Apostulli i Gjithë Shenjtorëve. Ungjilli i

të Dymbëdhjetëve. Të meriton. *Kungatore*: Në gjithë dheun [dhe e Gjithë Shenjtorëve].

4. Nëse bie në një nga të dielat jashtë Pentikostarit:

Në Mbrëmësore, Thirrtoret: 4 ngjallësore, 3 të korifenjve dhe 3 të të Dymbëdhjetëve. Lavdi i apostujve. Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i apostujve. Tani Hyjlindësore ngjallësore (Zoti Krisht bërësi). Përlëshoret: ngjallësore, e korifenjve dhe e të Dymbëdhjetëve bashkë me Hyjlindësoren e tyre.

Në Mëngjesore, Ndenjësoret ngjallësore. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimeni i Tingullit. Kanunet: ngjallësor, i korifenjve dhe i të Dymbëdhjetëve. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore dhe Ndenjësoret e apostujve. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e apostujve dhe Sinaksari. Zbritësoret Ja gojën e çel tani; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Më të nderuarën. Dërgimësoret: ngjallësore dhe e apostujve bashkë me Hyjlindësoren e tyre. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të apostujve. Lavdi i apostujve. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të Tingullit dhe 4 nga Ode VI e Kanunit të të Dymbëdhjetëve. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e korifenjve, e të Dymbëdhjetëve dhe e kishës. Kontaqi Mbrojtje e paturpëruar. Apostulli dhe Ungjilli i apostujve. Të meriton. *Kungatore* [Lavdëroni dhe] Në gjithë dheun.



NË MBRËMËSORE

Thirrtores të korifenjve
Ting. IV Édhokas simíōsin

Kishës i dhe krenari apostujt aq të nderuar, Krisht* njeridashës, ndriçuesit*¹ shën Petron dhe Pavlin tok,* në të llamburisin* pors i yj mendorë, shkëlqejnë tërë sferën,¹ dhen’;* me ta shpërndave dhe shove zyrtësi*

dhe terr perëndimor, mashtrim të errët, prishje, o Krisht Jisu,* o i tërë-fuqishmi Zot,* Shpëtimtari i shpirtave.

Kishës i dhe si mbështjetje² fortësinë e Petros pra,* mençurinë³ dhe urtësin’* e Pavlit,⁴ apostullit;* që të dy karizmë,* predikim të hyjshëm dhe të vërtetë kishin tok* dhe çdo mashtrim ateizmi flakën tej;* meqë më-

sojmë nga të dy mistere, ty të himnojm' Jisu,* o i tërëfuqishmi Zot,* Shpëtimtari i shpirtrave.

Ti si shembull kthimi për sa mëkatojn' dy apostujt dhe:* Njëri gjatë pësimit tënd* të kishte mohuar ty,* veçse u pendua;*⁵ tjetri predikimin tënd kish përndjekur egërsisht,* kish reaguar,⁶ por që të dy këta* në krye janë para korit, para miqve të tu, Jisu,* o i tërëfuqishmi Zot,* Shpëtimtari i shpirtrave.

*Thirrtoje të të Dymbëdhjetëve
I njëjti Os jeneon en mártisin*

Lumërohëni, nxënës ju* fort të pasur, se kishit qen'* dëshmitarë sy-pamës, njohët Fjalën Zot* të mishëruar,⁷ u shfaqët si rrufe plot ndriçim në bot'*⁸ dhe pikuat ëmbëlsi* porsi male⁹ mendore pra;* me burim hyjnor,* si lumenj të Parajsës që shpërndahen,¹⁰ i vadisni përgjithmonë pa-reshtur Kishat e kombeve.

Porsi predha me flakërim,* që nga rrezet¹¹ e Shenjtisë Shpirt* ju dërguat botës së tërë dhe i dhat'* me mbushulli energjinë e çudivë, u bëtë pra* celebruesit hyjnor'* për misteret e Krishtit¹² Zot,* o hyjmistë ju* krejt të pasur; dhe pllaka të hyjshkruara¹³ të Hirit ishit, ligjin e Perëndisë na mësuat drejt.¹⁴

Rymat e oratorëve,* fryrja e filozofëve* humbën me kallamin e peshkatarëve,* pena që shkroi, vijosi mësimdhënie hyjdijeje* edhe dogmën që shpalos* qart' Ungjillin me plot dobi* si edhe kungim* për shijim të përjetshëm në dëfrime engjëjllore dhe lavdi që gjithmonë mbetet dhe nuk kalon.

Lavdi

Ting. Tërth. II I Kozma Monakut

Ekremtja e tërënderuar e apostujve i erdhi Kishës së Krishtit, duke na shkaktuar shpëtim; ndaj, pasi të duratrokasim mistikisht, le t'u themi: Gëzohuni, o ndriçues të atyre që janë në errësirë,¹⁵ meqë jeni rrezet e die-llit. Gëzohuni, o Petro dhe Pavël, themelet¹⁶ e pathyeshme të dogmave hyjnore, miqtë e Krishtit,¹⁷ enë të çmuara;¹⁸ jeni mes nesh padukurisht duke i bërë të denjë për dhurata jo-lëndore ata që mburrin me këngë festën tuaj.

Tani *Hyjlindësore*

Cili s'do të të lumërojë, o Hyjlindëse Virgjëreshë, cili s'do të përhimnojë lindjen tënde të kulluar? Se biri yt i vetëmlindur që shkëlqeu prej Atit¹⁹ pa mot, gjith' ai lindi prej teje së pa-strës i mishëruar pa tregim, duke

qenë prej natyre Perëndi dhe duke u bërë për ne njeri prej natyre, i pandarë në dy fytyra, por i njohur me dy natyra pa përzier; atij lutju, o Zonj' e lumur, të mëshirohen shpirtrat tanë.*

Hyrje. O dritë gazmore.

Proqimeni i ditës.

Pasvargje

Ting. IV O eks ipsistu klithís

Ai që Hirin prej qiellit pranoi,* sapo korit të dymbëdhjetë apostujve* i tha, e pyeti Zoti Krisht* dhe Shpëtimtari:* “Kush thonë njerëzit, pra se cili jam?,”* Petroja atëher' i pari i nxënësve* të Mjeshtrit, shpalli theologji* me zë të fortë:* “Je Krishti Biri i Perëndis' që rron”.* Ndaj lumërohet* denjësisht, se nga lart ka marrë zbulësë dhe përgjegjësi,* që të lidhë e zgjidhë* çdo paudhësi të shpirtrave.²⁰

Varg: Në gjithë dheun doli zëri i tyre dhe në skajet e botës fjalët e tyre.

Ti jo nga njerëzit, por nga lart u ftove,*²¹ kur t'i errësoi ty terri i dheshëm syt'* e trupit,²² ndaj edhe zymtësin'* e ateizmit* e publikoi, dhe tok me syrin tënd,* mendjen tënde, drita e qiellit plot fuqi* i shndriti dhe bukurin' që ka* shpresëtaria* kjo e zbuloi, pra njohe Krishtin Zot*²³ që nxjerr nga terri* dritën; lype atë që të na

shpëtojë, të shndrisë krejt* shpirtrat tanë, t'u japë* ndjesën, faljen e mëkateve.

Varg: Qiejt tregojnë lavdi Perëndie.

Ty me të drejtë të quajti gur Krishti,* ku forcoi besën e Kishës pa tundje dot,*²⁴ duke të bërë kryebari* për delet, qengjat* mendorë²⁵ dhe të vendosi rojë ty,* kur të dha dhe kyçet e portës së qiejve,*²⁶ të hapësh pra për të gjithë sa* frekuentojnë* dhe me besim vijnë, se ka mirësi;* ndaj si i vyer* denjësisht ti u kryqëzove si Zoti yt Perëndi;* lyp atë të shpëtojë,* të ndriçojë shpirtrat tanë krejt.

Lavdi

Ting. Tërth. II I Efremi të Karies

Ekremte gazmore shkëlqeu anembanë botës sot, kujtimi i tërënderuar i apostujve korifenj, Petro dhe Pavël, prandaj dhe Roma bashkëgëzohet duke kërcyer. Me këngë dhe himne²⁷ le të kremtojmë edhe ne, o vëllezër, këtë ditë të gjithënderuar, duke u thënë atyre: Gëzohu, o Petro apostull dhe mik¹⁷ i sinqertë i mësuesit tënd, Krishtit Perëndisë tonë; gëzohu, o Pavël i tërëdashur, predikues i besimit dhe mësues²⁸ i rruzullit. O çift i hyjzgjedhur, përgjërojuni Krishtit Perëndisë tonë të shpëtohen shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë,^{28a} që nxore frytin e jetës; të lypim, ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me apostujt dhe me gjithë shenjtorët, që të mëshirohen shpirtrat tanë.

*Përlëshore
Ting. IV*

O të parëfronshmit e apostujve dhe mësuesit²⁸ e kozmosit, lypni Zotin e të gjithëve që t'i dhurojë botës paqe²⁹ dhe shpirtrave tanë përdëllimin e madh.^{29a}

Lavdi *Ting. III*

Apostuj të shenjtë, lutjuni Zotit tonë Jisu Krisht, t'u falë shpirtrave tanë ndjesën e mëkateve.*

Tani *Hyjlindësore*

Ti që ndërmjetove për shpëtimin e gjindjes son' të përhimnojmë, o Hyjlindëse Virgjëreshë, se duke denjuar pësimin e Kryqit me trupin që mori prej teje Biri yt dhe Perëndia ynë, na çliroi prej prishjes si njeri-dashës.*



NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë e të dytë, Ndenjësoret e djeshme. Psalmi 50 dhe Kanunet [e Pentikostarit nëse është ende periudha e tij dhe] të apostujve. Zbritësoret Ja gojën e çel tani [ose të Pentikostarit, nëse është ende periudha e tij; meqë atëherë psalet më parë Kanuni i tij, nuk thuhen Irmoset në fillimin e Odeve të apostujve.]

*Ode I
Kanuni i korifenjve
Ting. IV*

Irmosi: Anikso to stoma mu

»Ja gojën e çel tani i frymëzuar prej
»Shpirtit³⁰ Shenjt'* dhe këngë do t'i
»këndoju nënës së madhe mbi fron;*³¹
»dhe do ta kremtoj* me valle buzë-
»qeshur;* me zë do t'i shpall kudo
»gjithë çudit' e saj.*

Një pikë karizme më dhuro nga Shpirti yt krejt Hyjnor,*³² o Zot, pra një fjalë të përshtatshme dhe do dëfrej,* teksa besërisht* do lavdëroj arritjet* që patën protokorifenjtë e tu, o Krisht.

Çdo gjë të përkohshme me gati-shmëri, Petro famëmadh,* e le³³ dhe pas gjurmëve të Krishtit shkove³⁴ me zell,* ndërsa, Pavël ti,* e le mosbi-

ndjen tënde,* u ngjite te Zoti që të kishte ftuar ty.²¹

O Petro dhe Pavël, e pranuat Hirin e Shenjtit Shpirt* që erdhi krejt thelbësisht për ne dhe mbeti këtu;* e shpërndatë ju,* apostuj, anembanë* edhe e mësuar në çdo skaj të kozmosit.

Hyjlindësore

As gjuhë e ëmbël shumë muzikantësh dhe po kështu* as goj' oratorësh shumëfolës nuk munden dot* të nderojnë ty,* të psalin, e dëlirë;* misteri që ndodhi në ty, është' mbi-njerezor.

*Kanuni i të Dymbëdhjetëve
që ka Akrostihidhë: "Mburr apostujt
e urtë të Krishtit". I Theofanit.*

Ting. i njëjti Thalasis to erithreon

Jam gati* t'i psal me mallëngjim, Krisht, korit të apostujve;* si Perëndi dhuromë rrezatim* që ka Shpirti i Tërëshenjt';* me lutjet e atyre, jepma pra llambadhen e urtis' sate.

Fuqitë* armiqësore, kundërshtare i dërrmuan fort* apostujt e nderuar, kur me hir* dhe pushtet i forcove, o Krisht,* të shihnin ty gjithnjë, kështu fituan pamje të hyjnueshme.

Apostujt* me emrin tënd shërime

plot vepruan,³⁵ ndaj, o Zot,* në njohjen tënde kombet, popujt tok* i rrjetuan për jetë pa fund,* dhe i ndriçuan brenda dritës sate nxënësit me nam të madh.

Mësuar* me urtësi hyjnore, ndaj dhe e marrosët pra* çdo urtësi të marrësh³⁶ qartësisht,* kotësi në fjalimet që than',* apostuj të lavdishëm të Jisuit Krisht, me predikim madhor.

Hyjlindësore

Ke lindur* ti njërin e Trinisë mbi-hyjnore që u shfaq* nga ti në mish³⁷ si ne pra me pëlqim* që kish Lindësi, o Virgjëresh'* dhe nën' e pastër, me bashkëpunim me Shpirtin Zot të Tërëshenjt'.³⁸

Zbritësore: Anikso to stoma mu

Ja gojën e çel tani

Ode III

Kanuni i korifenjve

Irmosi: Tus sus immologus

»**O** Zonjë dhe nën' e Perëndisë, burim
»i pasosur jetësor,* ti siguroji gjith'
»ata që të këndojnë plot me zell* dhe
»lart në q'ell ku mbretëron kurorëzoi
»me çdo lavdi.^{39*}

Andrea, vëllai yt, o Petro, i pari të

shfaq Mesian Krisht,* që t'i afroresh besërisht,⁴⁰ dhe ti, i mrekullueshmi* shën Pavël, shndrit me pagëzim hyj-bërës nga Anania⁴¹ pra.

Te drita e Hirit solli Petroja njerëz izraelitë, pra* dembelët që pengoheshin prej germave të Ligjit⁴² keq,* dhe Pavli i çliroi nga mashtrimi grigjat e kombeve.

Te kombet dërgove, o Krisht, nxënësit pa veshje dhe pa armatim,* në vend të armës mbanin emrin tënd¹⁸ të shenjtë dhe kështu* shpërbënë përmes besës luftën e mashtrimit demoniak.

Hyjlindësore

Umbush mbarë dheu, o apostuj, me dijen e Zotit⁴³ që u shfaq,* shndriti nga një e Virgjër, feksi botën, o të famshëm fort,* me predikimin tuaj krejt të hyjshëm, Petro dhe Pavël tok.

Kanuni i të Dymbëdhjetëve:

Efrënete epi si

Mbi dhë keni dhënë ju,* pra predikuesit e Krishtit, besim,* dogma qiellore krejt,* kur me gjuhë zjarri hyjflisni drejt.⁴⁴

Si qiej mendorë, Zot,* dëfteve nxënësit e tu që rrëfejn'* lavdin tënd⁴⁵ të madh me nder* në të gjitha anët e rruzullit.

U shkruat në qiej lart,*⁴⁶ u shfaqët në një tendë tok me Jisun';* ne që ju nderojm' tani* me zell, o të gjithurtë, mbronani.

Hyjlindësore

Fushoi mes nesh¹⁹ ai* që në të lartat, o e pastër, banon,* se u duk te gjithë ne,* kur pa farë mori prej teje mish.

Zbritësore: Tus sus immologus

O Zonjë dhe nën' e Perëndisë

Ndenjësore

Ting. IV O ipsothis en to stavro

Banesë drite pra* ju ishit, në dritë* që nuk afrohet dot* qëndroni dhe shndrisni* gjithnjë shtëpinë tuaj me praninë e shenjt',* ndaj thërrasim me besim te ju:* Na dhuroni në çdo rrezik,* terr, shpëtim nga çdo hordhi* që ngrej'n' kombet e liga,* me lutjet te Ndërtuesi Jisu,* që për ne bëni,* apostuj me nam të madh.

Hyjlindësore

Nuk do pushojmë, pra* Hyjlindëse, kurrë* ne të pavyerit* të flasim për forcat* që ke, se, po të mos qëndroje para nesh ti* duke ndërmjetuar, kush nga ne* do shpëtonte nga çdo dëmtim? Cili na ka ruajtur* gjer tani pra të lirë?* Ndaj s'do largohemi aspak

nga ti,* se shërbëtorët* e tu i shpëton gjithnjë.

Ode IV

Kanuni i korifenjve

Irmosi: Tin aneksihnlaston

»**T**ë pagjurmësuarin plan perëndor
»që po mishërohet i larti Zot prej Vir-
»gjërëshës, Abakumi si profet e pa
»dhe tha me zë të madh: Zot i fuqi-
»shëm lavdi më ty.*

Të pafuqishmit fituan kur u ndeshën me besë me më të fortët, dhe të thjeshtët⁴⁷ me njerëz tepër oratorikë, Petroja dhe Pavli, apostujt e Krishtit.

Petroja i hyjshëm e qortoi si tepër argjenddashës magjistarin e keq, Simonin e paudhë,⁴⁸ ndërsa Pavli i urtë e la sakat Eliman, i cili i shtrembëronte udhët e Krishtit.⁴⁹

Peshkatari⁵⁰ dhe bërësi i tendave,⁵¹ edhe pse e kishin fjalën tepër të thjeshtë,⁴⁷ por të hijesuar me kripë hyjnore,⁵² shpitrave të filozofëve u dhanë shije dhe i sollën në besimin e Krishtit.

Hyjlindësore

Abakumi i hyjshëm, duke folur me fjalë të hyj frymëzuara, të quajti ty mal të dendur dhe plot me hije, duke laj-

mëruar shumë qartësisht atë që erdhi nga Themani,⁵³ dhe u bë njeri me anën tënde, o Zonjë.

Kanuni i të Dymbëdhjetëve:

Eparhenta se idhusa

Zëri i fjalëve hyjnore të apostujve përshkoi si pishtar gjithë rruzullin⁵⁴ duke djegur lëndën e mashtimit dhe duke ndriçuar me Hir sistemin e besëmirëve.

Meqë nxënësit u shfaqën ndriçues¹ të hyjfeksur, botën e errësuar nga terrin e ateizmit e shkëlqyen me rrezet e Hirit dhe llamburitjet e predikimit.

O të tërëpasur, të feksur me llambadhe tepër të hyjnueshme të diellit mendor, shkëlqeni botën¹ si yje me dritën e Hyjnisë, duke shpërndarë mjegullën e mashtimit.

O Fjalë, dëshmitarët e tu okularë,⁷ duke pasur si shkop fuqie⁵⁵ Kryqin tënd, e ndanë detin e kripur të jetës si kuaj që trazonin dallgët⁵⁶ e politeizmit.

Hyjlindësore

Tani lavdërohet si Perëndilindëse Virgjëresha e pacenuar, qielli yt i gjallë, i stolitur me larmi dritëderdhjeje, o Krisht, mbret i mbretërve.⁵⁷

Zbritësore: Tin aneksihniaston

Të pagjurmësuarin

Ode V

Kanuni i korifenjve

Irmosi: Eksesti ta simpanta

»**T**ë gjith' i habite ti me një çudi dhe
»një lavdi, ti, o Virgjëreshë e pamar-
»tuar, Zotin e jetës që mbretëron⁵⁸
»lart në q'ell si një bir e mbajte në
»pëqi dhe shpëtim që lartazi u dhu-
»rove besnikëve.*

Meqenëse ishte shumë i qëndrue-
shëm, o Petro, Krishti të quajti gur,
dhe në ty mbështeti Kishën, kundër
së cilës nuk do mbizotërojnë portat e
Hadhit;²⁴ ndërsa, o Pavël, enë e zgje-
dhur, për ty tha se do mbash emrin e
tij para kombesh.¹⁸

Petroja që mohoi tri herë mësuesin,⁵
u familjarizua me pohimin e trefish-
të të dashurisë;²⁵ ndërsa Pavli që më
parë blasfemonte dhe i shtypte serio-
zisht besimtarët,⁶ më vonë predikoi
atë të cilin më përpara e përndiqte.⁵⁹

Famën e pacenuar dhe lavdinë e për-
jetshme prej Krishtit e gjete, o Petro,
së bashku me Pavlin, ti nga njëra anë
kur t'u besuan çelësat e qiejve,²⁶ ai
nga ana tjetër kur u çua në Parajsë
dhe mësoi fjalë të parrëfyeshme për-
mbi njeri.⁶⁰

Hyjlindësore

I mbushur me Shpirt Hyjnor Isaia pa-
ratha lindjen pa burrë, kur prej teje,
së Virgjërës, lindi Emanueli, domethë-
në "Perëndia me ne";⁶¹ atë e mbajte
në bark përmbi logjikë dhe mendim,
o e dëlirë.

Kanuni i të Dymbëdhjetëve:

Si Kirié mu fos

O Krisht, shërbyesit e tu të hyjshëm
dhe të tërurtë ia tregove botës si dri-
të,¹ që të të shpallnin te të gjithë ty,
dritën e paperënduar.

O apostuj që u ushtruat haptazi në
çdo virtyt, shpërthyet leqet e ligësisë
shumëformëshe të demonëve.

Na e sinjalizuan shkëlqimin e Trini-
së në Njësi Hyjnie apostujt që flisnin
në gjuhë të zjarra.⁴⁴

Hyjlindësore

Arm' e pathyeshme je, ndaj kundër
armiqsh të vëm'; të kemi ty, o Hyjnuse,
si spirancë dhe shpresë⁶² shpëtimi ne
të gjithë pra.

Zbritësore: Eksesti ta simpanta

Të gjith' i habite ti

*Ode VI**Kanuni i korifenjve**Irmosi: Tin thian taftin*

»Këtë të kremte e lusim sot për Zo-
 »njën edhe nënën Hyjlindëse, gjithë
 »hyjmendësit, eni trokisni pra duar-
 »të dhe lavdëroni Zotin që lindi prej
 »asaj.*

Çudit' e Petros u shfaqën të shkël-
 qyera, ndërsa mrekullit' e Pavlit, të
 nderuara.* Hijet, shamitë e tyre pra*
 shërojnë çdo sëmundje të të sëmu-
 rëve.⁶³

Vërtet je, Petro, i lavdëruar, Pavël i
 mahnitshëm vërtet je, dyshja e hyjnu-
 eshme;* ne na kujtoni të gjithë ju*
 banesat e Trinisë që është jeta vet'.

Shëroi shpirta dhe trupa të sëmu-
 rësh porsi mjek i hyjnueshëm, plot me
 shkëlqim të madh* Petroja;³⁵ dhe Pa-
 vli feksi krejt* dhe me ndriçim prej
 Krishtit shënoi⁶⁴ kombe pra.

Hyjlindësore

Si borxh e kemi psalmimin tënd,
 por siç e meriton s'kemi dot fuqi të
 të himnojme ne,* o Virgjëreshë, me
 heshtje pra* nderojm' misterin që
 s'shprehet, që u bë në ty.

*Kanuni i të Dymbëdhjetëve:**Thiso si metá fonís*

Shpëtimtar,* mbështete me urti, me
 hir nxënësit,* i bëre ti më të fortë*
 nga mani e kotë që thanë grekët,* o
 Çlirues,* dhe u pushove dogmat ma-
 shtruese.

Me urti* shpëtuese u mbushën lu-
 menj hyjnor',* me rrjedhje⁶⁵ u pasu-
 ruan* nëpërmjet burimeve shpëtim-
 tare;*⁶⁶ i vaditën* kudo livadhet, arat
 e Kishës son'.

Si yje* me jetë ju u shfaqët, shpër-
 bëtë pra,* të tërëpasur, çdo mjegull*
 dhe terr nga mashtrimi, me rreza-
 timin* dritëdhënës,* të feksur me
 shkëlqime hyjdijeje.

Hyjlindësore

Tërë ty* të afërmen, të gjeti të bukur
 krejt* pa cen,⁶⁷ zambakun e pastër,*
 në lëndina lule⁶⁸ ty, o Hyjnënë,* Kri-
 shti dhëndri* mendor edhe fushoi në
 barkun tënd.

*Zbritësore: Tin thian taftin***Këtë të kremte***Kontaqi**Ting. II Tus asfalís ke theofthogus*

Zot, more për shijimin e të mirave,*
 për prehjen tënde predikuesit e tu*
 të sigurt edhe hyjfolësit, që ishin maja
 midis nxënësve,* sepse më shumë se

çdo holokaust, fli,* pranove lodhjet, vdekjen që i hoqën keq,* i vetmi që njeh ato që zemra ka.^{68a}

Shtëpia

Ma fuqizo gjuhën, o Shpëtimtari im, më zgjero gojën dhe, si ta mbushësh atë,⁶⁹ jepi pendim zemrës si me që të shkoj pas atyre që them, dhe të zbatoj i pari ato që mësoj, sepse është thënë: “Çdokush që bën dhe jep mësim, ky është i madh”,⁷⁰ se “në thënça dhe nuk e zbatoj, do të llogaritem si bakër që kumton;”⁷¹ prandaj më dhuro që të flas të duhurat dhe të bëj të dobishmet, i vetmi që njeh ato që zemra ka.^{68a}

Sinaksari

Më 30 të të njëjtit muaj, Mbledhja e Dymbëdhjetë Apostujve të shenjtë, të lavdëruar dhe të tërëfamshëm, si dhe shpallja se si dhe ku predikoi dhe mbaroi secili prej tyre.

Vargje: Nderoj dymbëdhjetë miq okularë të Krishtit,⁷ burra heronj dhe perëndi, guxoj t'i quaj.

E tridhjeta mbledh dymbëdhjetë mistë të lavdishëm.

Me ndërmjetimet e apostujve të shenjtë dhe të tërëfamshëm, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII

Kanuni i korifenjve

Irmosi: Uk elátrefsan

»**N**uk u faleshin krijesave hyjme-
»ndësit, por Krijetarit^{71a} lart,* dhe kër-
»cënimin me zjarr* e shkelën me tri-
»mëri, psalnin me brohori:* Zot lavdi
»më ty;* o Perëndi i etërve,* ti je ve-
»tëm i bekuar.^{72*}

U lumërua Petroja nga Krishti, sepse e shpalli Birin e Perëndisë²⁰ së gjallë,⁷³ ndërkohë që Pavli u nderua si enë e vlefshme.¹⁸ Dhe të dy, duke kënduar bashkë, psalnin: O Perëndi, je i bekuar.

Nga njëra anë Petroja urtësonte adhuresit e Ligjit siç u urdhërua; nga ana tjetër Pavli kombet.⁷⁴ Ia sillnin ata Hirit të Krishtit duke thirrur: O Zoti i etërve dhe Perëndi, je i bekuar.⁷²

Petroja e mori grigjën si barí i tërëshkëlqyer i Krishtit,²⁵ ndërsa Pavli u bë mësuesi i perëndishëm i Kishës²⁸ së tij. Të dy thërrisnin: O Zot i etërve dhe Perëndi, je i bekuar.⁷²

Hyjlindësore

O Virgjëreshë e tërëpacenuar dhe e pakrahasueshme në shenjtërim, që e kishe në bark mishërisht në mënyrë të pathënë Perëndinë dhe i dhe gji,

pranë tij ndërmjeto të çlirohemi nga çdo lloj ngasjeje dhe skandali.

*Kanuni i të Dymbëdhjetëve:
En ti kamino*

O i Përbimiri, Bir më parë nga natyra, pasi birësive dishepujt e tu, i tregove në gjendje trashëgimie brenda trashëgimisë atërore, dhe me mirësi doje të rrinin bashkë me ty, Perëndinë dhe Zotin.

Pasi u dhe nxënësve të tu, o Fjalë, derdhje urtësie,⁷⁵ gjerësi zemre⁷⁶ dhe gjuhë oratorike, i dërgove që t'u predikonin të gjitha kombeve⁷⁷ ungjillin e mbretërisë.⁷⁸

Të shfaqur si re të mbushura me dritë hyjnore, apostujt u hedhin të gjithëve si shi ujë jetëbërës, duke thirrur: I bekuar je në tempullin e lavdisë sate, o Zot.⁷⁹

Hyjlindësore

U duke e stolisur me lavdinë⁸⁰ hyjnore, o Hyjnënë e pacenuar, e vetmja që nga gjithë jetët, e cila pranove Fjalën e Atit; e bekuar je ti mes grave,⁸¹ o e tërëpacenuar.

Zbritësore: Uq elátrefsan

Nuk u faleshin

Ode VIII

*Kanuni i korifenjve
Irmosi: Pedhas evajís*

»**D**jemtë e dënuar për t'u djegur
»prej zjarrit i ka shpëtuar lindje e Zo-
»tit Krisht,⁸² si simbol në lashtësi dhe
»si një veprim tani, dhe tërë botën po
»e mbledh për këng' e lavdërim; him-
»nojeni ju veprat e Zotit dhe e lartëso-
»ni përmbi të gjitha jetët.^{83*}

I forcuar me fuqinë hyjnore, Petroja, në saje të lutjes, ngjalli Tavithanë e vdekur,⁸⁴ ndërsa Pavli ngjalli Eftihun që ra nga lartësia dhe vdiq.⁸⁵ Të dy thërrisnin: Zotin himnojeni, o vepra, dhe përmbilartësojeni në jetë.⁸³

Me vizion të frikshëm dhe me mrekulli Petroja e ndriçoi Kornelin,⁸⁶ kurse Pavli e pagëzoi Gain, Krispin, Panestin dhe Stefanain.⁸⁷ Të dy thërrisnin: Zotin himnojeni o vepra, dhe përmbilartësojeni në jetë.⁸³

Me paraqitje engjëlli Krishti zgjidhi Petron që ruhej i lidhur,⁸⁸ ndërsa, pasi tronditi burgun, lëshoi po ashtu Pavlin, që qe me Silan, i cili po lutej me këmbë të tendosura mizorisht në dru- rin torturues,⁸⁹ prandaj duke u ngazëlluar e lavdëronin.

Hyjlindësore

Çlirona nga pasionet shkatërrimtare,

thyej vargonjtë e mëkateve tona prej të cilave çdokush shtrëngohet,⁹⁰ sepse të gjithë mëkatuam,⁹¹ dhe si përgjegjës për këto kërkojmë zbutje; këtë jepua, me përgjërimit e tua, o Hyjlindëse, atyre që përmbilartësojnë Krishtin në jetë.

*Kanuni i të Dymbëdhjetëve:
Hiras ektopetasas Dhanil*

Kori i hyjshëm dhe i tërurtë i apostujve të Krishtit si lëndë që digjet lehtë dogji me zjarrin e Shpirtit⁴⁴ statujat e demonëve, dhe ndriçoi zemrat e shpresëplotëve që thërrasin: Të gjitha ju o vepra, himnojeni Zotin.⁸³

Me një zë le t'i nderojmë me himne nxënësit e hyjnueshëm, apostujt e Krishtit të cilët na gjëmuar⁹² dogmat qiellore, livadhet e besimit, mirëbërësit e përbashkët të njerëzimit, shërbëtorët e Shpëtimtarit.

Le t'i mburrim enët e tërërespektuara që mbajnë dritën, aparkat⁹³ e vdekatarëve, trumbetat e predikimit, përrënjtë e jetës së paprishshme, vetëtimat hyjprurëse, burimet e shërimëve, këmbët mendore të Ungjillit.⁹⁴

Hyjlindësore

I ploti zbrazet për ne,⁹⁵ që të kungojmë plotësinë e tij,⁹⁶ sepse, kur u fut i

panxënshmi në mitrën tënde të tërëpacenuar, u mishërua duke mos u larguar nga gjiri atëror; prandaj të gjithë të bekojmë, o Mari hyjnuse.

Zbritësore: Pedhas evajís

Djemtë e dënuar

Ode IX

Kanuni i korifënjve

Irmosi: Apas jijenís

»Gjithë njerëzit kërceni me ngazë-
»Ilim tek drit' e Shpirtit Shenjt* eni
»lavdërojeni,* engjëjt e q'ellit eni
»kremtojeni* këtë të shenjtë pana-
»ir të Kryezonjës Mari* dhe thërrisni:
»Ti je më e lumura,* Virgjëresh' e ku-
»lluar Hyjlindëse.*

Tërë botën e përshkuat porsi me krahë, predikuat ju* pra Ungjillin⁹⁷ zotëror,* të Krishtit Zot te çdo gjuhë, fis dhe komb;* kështu tërhoqët në besim të gjithë, o Petro* i fortlumur* dhe apostull Pavël tok* i mahnitshëm dhe i mrekullueshëm.

Si u dobësove, Petro, në pleqëri të thyer shleve ti* borxhin e natyrës son',* pësove kryq, sepse imitove krejt* Jisunë Krisht; o Pavël, kur ta prenë kokën ty* - ç'mrekulli, tmerr! -* rrjedha qumështi, jo gjak* ke buruar dhe ktheve ti të pafe.

O apostuj korifenj të Jisuit Krisht, o dyshe krejt e shenjt',* ju besua juve pra* shpëtim për tërë botën, ndaj kthyet ju* nga ateizmi në besim; dhe ende pas vdekjes* po shpëtoni* shpirtrat e besnikëve;* na kujtoni tani dhe na mbron ne.

Hyjlindësore

O i mirë, Shpëtimtar njeridashës nga natyra dhembshurisht,* përmes lutjes së hyjshme* të Virgjëreshës nënë që përhimnojm',* me ndërmjetimet e apostullit tënd shën Petros* dhe shën Pavlit,* na dërgo prej qiellit* ndihmën dhe përdëllimet e tua, Zot.

Kanuni i të Dymbëdhjetëve:

Lithos ahirótmitos

Nxënës hyjshikues,⁷ pushtetin të zgjidhni prangat e mëkatit*⁹⁰ morët nga Jisui Zot,⁹⁸ ndaj dhembshurisht* na shlyeni fajet dhe na bëni* të denjë për shpëtim, çlirim,* meqë ne po ju përhimnojmë ju.

Pritët tërë dritën e Shpirtit që ju u shfaq esencialisht pra,* gjithë të tërurtët, kur ishit në dhom'* të sipërme⁴⁴ dhe misteret njohët,* mësimet prej së lartazi;* tani siç duhet lumëroheni.

Tani si te miqtë¹⁷ u preh te ju Krishti

dhe jep çmim kurora* që nuk vyshken,³⁹ me teori të shenjt'* ju mbush; përgjërojuni atij pra* tani që të shpëtojnë krejt* Kishat e hyjshme, të nderuara.

Hyjlindësore

Deshi që të vinte në mish Fjala që të gjitha i stolisi,* dhe të gjeti t' vetmen të shenjtë më shumë* se tërë krijesat, ndaj fushoi* në ty, Hyjnuse, ky vërtet* dhe të dëfteu ty Hyjlindëse.

Zbritësore: Apas jijenís

Gjithë njerëzit

Dërgimësore

Ton mathitón oronton se

Me ngazëllim të mblidhemi të lëvdojmë* të dymbëdhjetë nxënësit e lavdishëm.* Ecët mbi dhé rreth e rrotull, kini gaz,* zutë për jetë ju kope* prej kombeve të pabesa* dhe u mësuat hyjnoret.

Hyjlindësore

Hyjlindëse, krenohemi fort në ty ne* dhe pranë Perëndisë të kemi mbrojtje;* shtrijs dorën tënde që s'luftohet dot,* dërrmoji pra armiqtë krejt;* nga Shenjtërorja dërgoju* ndihmë shërbyesve të tu.*⁹⁹

*Lavdërimë**Ting. IV O eks ipsistu klithís*

Themel dhe maja e nxënësve, apostull,* si le çdo gjë, shkove pas Zotit,³³ Mësuesit* thërrisje: “Unë me ty do vdes*¹⁰⁰ që të jetoj¹⁰¹ prap’* jetën e lumur”; u lumërove pra*²⁰ edhe u tregove lavdia dhe mburrja tok* ti për qytetin e tërëmadh* si dhe mbështetja* e Kishës; nuk do mbizotërojnë dot* dyert e Hadhit* kundër saj, siç profetizoi vërtet Krishti Perëndi;*²⁴ lyp atë të shpëtojë,* të ndriçojë shpirtrat tanë krejt.

Ti që prej barkut të nënës u veçove,*¹⁰² ike nga çdo vargua e shfaqjes lëndore larg,* vërtet u ngrite me krahë lart* drejt lartësimit* të perëndishëm me dashuri të shenjt’;*¹⁰³ siç nuk kishe mish, atje hyre në terr, furtun’*^{103a} drite hyjnore mbi çdo shkëlqim,* u pasurove* duke mësuar gjëra që s’shprehen dot,*⁶⁰ dhe u dërgove* te sa rrinin në terr dhe u lajmërove drit’,*¹⁰⁴ Krishtin¹⁰⁵ Zot;* lyp atë të shpëtojë,* të ndriçojë shpirtrat tanë krejt.

Je dritë para çdo jete, Krishti ynë;*¹⁰⁵ kur nga njeridashja që s’njeh shpjegim prite ti* të vish tek unë, njeriu pra,* prej mirësisë* të bëhesh mish, qartë i tregove ti* nxënësit, apostujt

e tu, Shpëtimtar dhe Zot,* dritat e dyta të lavdit tënd* dhe të shkëlqimit,* që vetëtimë lëshonin dhe këta* kur u dërguan,* ndritën tërë Krijesën me dritësimin tënd krejt hyjnor,* duke lypur t’i shndritësh* shpirtrat tanë, t’i shpëtosh ata.

Petro dhe Pavël, lëvruesit e Fjalës,* Juda dhe Andrea, Jakov dhe Joan i urt’,* Vartholome, dhe Thoma, Matthe,* Jakov i hyjshëm,* Simon, Filip, dymbëdhjetëshja me nder* mbarëbotërore e nxënësve, shpallët ju* në tërë botën Trininë Zot* të Tërëshenjtë,* që nga natyra Hyjni përjetë është’;* shtylla¹⁰⁶ që s’tunden* edhe pirgje të palatuara, Zotit të gjithçkaje* përgjërojuni, lypni* të shpëtohem i të gjithë ne.

Lavdi*Ting. Tërth. IV I Kozma Monakut*

O nxënësit e Shpëtimtarit, e shpëtuat Krijesën, të cilën e përshkuat⁹⁷ duke e ndriçuar, pasi shkrumbuat si mbeturinë, me anën e mësimeve tuaja, mashtrimin e idhujve, dhe me rrjeta peshkuat kombet nga fundi i paditurisë drejt njohjes hyjnore; dhe tani ndërmjetoni te Krishti që të bëhet i butë me ne në ditën e gjykimit.

Tani

Hyjlindësore

O Zonjë, priti lutjet e shërbëtorëve të tu edhe çlirona ne nga çdo nevojë dhe pikëllim.

Dhoksologjia e Madhe

Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanuni i korifenjve Ode III dhe nga Kanuni i të Dymbëdhjetëve Ode VI. Kontaqi i Pentikostarit [por nëse bie jashtë këtij, Mbrojtje e paturpëruar]. Kungatore: Në gjithë dheun.

CITIME

¹ Fil. 2.15

² Gal. 2.9

³ Ef. 3.4

⁴ I Kor. 2.6-7; II Petr. 3.15

⁵ Matth. 26.69-75; Mark. 14.66-72; Lluk. 22.55-62; Joan 18.25-27

⁶ Vep. 9.1-2; 22.4-5; 26.9-11; I Kor. 15.9; Gal. 1.13,23; Fil. 3.6

⁷ Joan 1.14

⁸ Ps. 76(77).19

⁹ Amos 9.13; Joel 4(3).18

¹⁰ Gjen. 2.10

¹¹ Urtësia Sol. 5.21; Abak. 3.11; Zah. 9.14

¹² Rom. 15.16

¹³ Eks. 31.18; 34.1-4,28; Ligji i Dytë 4.13; 5.22(19); 9. 9-11; 10.1-4

¹⁴ Is. 54.13; Joan 6.45; I Kor. 2.13

¹⁵ Rom. 2.19

¹⁶ Ef. 2.20; Apok. 21.14

¹⁷ Joan 15.15

¹⁸ Vep. 9.15

¹⁹ Joan 1.14,18; 3.16,18; I Joan 4.9

²⁰ Matth. 16.13-19

²¹ Vep. 9.6; 22.10; 26.16,19

²² Vep. 9.8; 22.11

²³ Vep. 9.3-5; 22.6-8; 26.13-15

²⁴ Matth. 16.18; Joan 1.43

²⁵ Joan 21.15-17

²⁶ Matth. 16.19

²⁷ Ef. 5.19; Kol. 3.16

²⁸ I Tim. 2.7; II Tim. 1.11

^{28a} Joan 15.1

²⁹ Joan 14.27

^{29a} Num. 14.19 etj.

³⁰ Ps. 118(119).131

³¹ Ps. 44(45).2,10

³² Rom. 12.6-8

³³ Matth. 4.20; Mark. 1.18; Lluk. 5.11

³⁴ I Petr. 2.21

³⁵ Vep. 3.6-7 etj.

³⁶ Rom. 1.22; I Kor. 1.20

³⁷ I Tim. 3.16

³⁸ Lluk. 1.35

³⁹ I Petr. 5.4

⁴⁰ Joan 1.42-43

⁴¹ Vep. 9.10-18; 22.12-16

⁴² Rom. 2.27,29; 7.6; II Kor. 3.6

⁴³ Abak. 2.14

⁴⁴ Vep. 2.3-4

⁴⁵ Ps. 18(19).2

⁴⁶ Lluk. 10.20

⁴⁷ Vep. 4.13; II Kor. 11.6

⁴⁸ Vep. 8.9-24

⁴⁹ Vep. 13.8-11

⁵⁰ Matth. 4.18; Mark. 1.16-17; Lluk. 5.2-3

⁵¹ Vep. 18.3

⁵² Kol. 4.6

⁵³ Abak. 3.3

⁵⁴ Ps. 18(19).5

⁵⁵ Ps. 109(110).2

⁵⁶ Abak. 3.15

⁵⁷ I Tim. 6.15; Apok. 17.14; 19.16

- ⁵⁸ Rom. 9.5
⁵⁹ I Kor. 1.23; II Kor. 1.19
⁶⁰ II Kor. 12.2-4
⁶¹ Is. 7.14; Matth. 1.23
⁶² Hebr. 6.19
⁶³ Vep. 19.12
⁶⁴ Ps. 4.7
⁶⁵ Ps. 64(65).10
⁶⁶ Is. 12.3
⁶⁷ Kënga 1.15; 4.1,7; 6.4
⁶⁸ Kënga 2.1
^{68a} Fja. Urt. 24.12
⁶⁹ Ps. 80(81).11
⁷⁰ Matth. 5.19
⁷¹ I Kor. 13.1
^{71a} Rom.1.25
⁷² Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,28
⁷³ Jisu N. 3.10; I Tim. 3.15 etj.
⁷⁴ Gal. 2.7
⁷⁵ III [I] Mbret. 5.9 (4.29)
⁷⁶ Fja. Urt. 7.3; 22.20
⁷⁷ Matth. 28.19; Mark. 16.15
⁷⁸ Matth. 4.23; 9.35; 24.14; Mark. 1.14
⁷⁹ Dan. kap. 3. Lutja e Azarias 30
⁸⁰ Ps. 44(45).10
⁸¹ Lluk. 1.29
⁸² III Makk. 6.6; Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 25-26
⁸³ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
⁸⁴ Vep. 9.36-40
⁸⁵ Vep. 20.9-12
⁸⁶ Vep. 10.9-48
⁸⁷ I Kor. 1.14-16
⁸⁸ Vep. 12.6-7
⁸⁹ Vep. 16.24-26
⁹⁰ Fjala Urta 5.22
⁹¹ Rom. 3.23; 5.12
⁹² Mark. 3.17
⁹³ Eks. 22.29(28); 35.5
⁹⁴ Is. 52.7; Rom. 10.15
⁹⁵ Fil. 2.7
⁹⁶ II Kor. 8.9
⁹⁷ Kol. 1.23
⁹⁸ Matth. 16.19; 18.18
⁹⁹ Ps. 19(20).3
¹⁰⁰ Lluk. 22.33
¹⁰¹ Rom. 6.8; II Tim. 2.11
¹⁰² Gjyq. 16.17; Jer. 1.5; Gal. 1.15
¹⁰³ Rom. 8.35-39
^{103a} Eks. 20.21; Ligji i Dytë 5.22; Sirak 45.5
¹⁰⁴ Is. 9.2; Matth. 4.16; Lluk. 1.79
¹⁰⁵ Joan 1.4,9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46
¹⁰⁶ Gal. 2.9



SHTOJCË

Kanuni i Hyjlindëses

Ting. Tërth. IV

Ode I

Irmosi: Igrán dhiodhefsas

»Pasi kish kaluar det si steré* edhe
»u shpëtua nga inati egiptian,* me
»zë Izraeli po thërriste:* Le t'i kë-
»ndojm' Perëndis', Çlirimtarit ton'.

I mbytur prej ngasjeve si në det,*
më ty po përikij dhe prej teje kërkoj
shpëtim,* o nënë dhe Zonjë Virgjëreshë,*
prej çdo rreziku dhe zie shpëto-
më ti.*

Pësimet më mbushën me turbullim*
dhe shpirtin ma mbytën me mërzitje
dhe dëshpërim,* po ti qetësomë, Vir-
gjëreshë,* me ngushëllimin dhe pa-
qen e Birit tënd.*

Të lutem o Zonjë, o Shën Mari,* që
linde Jisuin, ti shpëtomë nga çdo rre-
zik,* më ty po përikij dhe të lutem,*
me tërë forcën e zemrës dhe shpirtit
tim.*

Se shpirti dhe trupi keq m'u sëmur,*
pra ti mëshiromë, edhe syrin mbi mua
hidh,* kujdesu për mua Virgjëreshë,*
e mirë vetë dhe nën' e të mirit Bir.*

Ode III

Irmosi: Uranias apsidhos

»Perëndi që apsidë bëre në q'ell
»si çati,* ti që je ndërtues i Kishës,
»mirë më siguro* në dashurinë që
»ke;* je maja e çdo dëshire,* njeri-
»dashës, edhe mbështetja për çdo
»besnik.

Si përkrahje dhe mbrojtje të jetës
sime të kam,* ty o Virgjëresh' e ku-
lluar, ti pra më qeveris,* dhe në liman
të më çosh, se ti na fal çdo të mirë,*
ti besnikët përgjithmon' i mbron,
Hyjlindëse.*

Po të lutem, o Zonjë, ma qetëso shpir-
tin tim* dhe pushoma shqotën e ze-
mrës, se më bie zali,* se ti o Zonjë
Mari, ke lindur Mbretin e Pages,*
Shpëtimtarin, Zotin Krisht, ti o Hyj-
lindëse.*

Mirëbërësin linde, që bëri çdo mirë-
si,* pasurisht të gjitha të mirat jep-
na të gjithëve,* se ti në dorë e ke, se
ti ke lindur të fortin,* Shpëtimtarin,
Zotin Krisht, ti o Hyjlindëse.*

Me sëmundje të liga dhe çfarëdo pasion,* dergjem un' i mjeri, o Zonjë, eja shëromë ti,* se s'të mungon asnjë gjë, i ke të gjitha të mirat,* je thesar për çdo shërim, ti o Hyjlindëse.*

Ode IV

Irmosi: Isakíkoa Kírie

»**K**am dëgjuar misterin qart'* të
»ekonomis' sate dhe kuptova krejt*
»vepra që ke bërë dhe prandaj* la-
»vdërova un' hyjninë tënde, Zot.

Shën Mari o Hyjlindëse,* ti që linde Zotin, kapitenin ton',* zbutë shqotën e pësimeve,* qetësoi valët e mëkateve.*

Ne të gjithë të lutemi,* dhembshurinë tënde tregona pa vones',* ti që linde njeridashësin,* Krishtin Shpëtimtarin e besnikëve.*

Për shumicën e dhuratave,* të falënderojmë ne mirënjohësit,* me këndime lavdëruese,* nënë virgjëreshë dhe Hyjlindëse.*

Ty të kemi përkrahëse* dhe fortesë të patundur dhe mbrojtëse,* Virgjëreshë dhe Hyjlindëse,* na shpëto përherë prej rreziqeve.*

Ode V

Irmosi: Fótison imás

»**N**dritna ti, o Zot,* përmes urdhrave
»të tu pra ne,* si dhe me krahun tënd
»fuqiplot, të lart',* o njeridashës, na
»jep paqen tënde përgjithnë.

Zemrën na e çel* me gëzim dhe ngazëllim, o Zonj',* falna gazin e pasosur tani,* sepse ke lindur ti shkaktarin e gëzimeve.*

Zonjë na shpëto,* Virgjëreshë dhe Hyjlindëse,* prej helmeve si dhe rreziqeve,* se ti ke lindur Shpëtimtarin, paqëprurësin.*

Mjegullën largo* të mëkateve Hyjlindëse* me dritën tënde jetëdhënëse,* sepse ke lindur diellin e parajetëshëm.*

Zonjë na shëro,* nga pësimet e sëmundjeve,* na mëshiro edhe na vizito,* edhe shëndetin na dhuro me ndërmjetimin tënd.*

Ode VI

Irmosi: Tin dhéisin ekheó

»**D**o derdh lutjen* para Zotit Perë-
»ndi* dhe atij do t'i tregoj hidhëri-
»met* që kam, sepse* shpirti im është
»mbushur* me çdo të keqe dhe jeta
»po shkon në Hadh;* pra si Jonai lu-
»tem un':* Jetën time nga prishja ti
»ngrije, Zot.

Atij iu lut,* se prej vdekjes na shpëtoi,* si u dha nën thonjt' e vdekjes dhe vetë,* prapë tani* shpirtin tim ta shpëtojë,* nga shkatërrimi i vdekjes dërrmonjëse* dhe nga armiku zemërlig,* Biri yt, Zoti yt, o Hyjlindëse.*

Si mbrojtëse* ty të di dhe rojtëse,* të sigurt, o Virgjëreshë, për jetën,* ti i shpërndan,* gjithë ngasjet e liga* edhe veprime demonësh na i dëbon,* pra ty të lutem si gjithnjë:* Ti shpëto më prej gjithë pësimeve.*

Fortes' e mur,* ty të kemi Zonja jon',* dhe shpëtim për shpirtrat tanë të plotë,* dhe ngushëllim* në mjerimet, o Zonjë,* dhe n' errësirën me dritë na ngazëllon;* pra ti, o Zonjë, dhe tani,* nga pësimet, rreziqet ti na shpëto.*

Në shtrat tani* i sëmurë shtrirë jam* dhe për trupin tim shërim dot nuk gjendet,* vetëm pra ti,* që ke lindur për botën* një Shpëtimtar dhe një mjek të sëmundjeve,* pra ty të lutem dhe tani:* Ti më ngri nga lëngatat Hyjlindëse.*

Ode VII

Irmosi: I ek tis Iudheas

»**T**re Djem që nga Judea* përfunduan si robër në Babilonë dikur,* me besën e Triadhës kan' shkelur flakë

»furre duke psalur me gaz e hir:* O »Perëndi atëror,* o Zot je i bekuar.

Për shpëtimin e botës,* në pëqi virgjëror ke banuar ti, o Jisu,* dhe nënën Virgjëreshë, e cila të ka lindur, na e bërë ne mbrojtëse.* O Perëndi i etërve,* o Zot je i bekuar.*

Birit plot me mëshirë,* që ke lindur, o nën' e kulluar, lutju për ne,* të na i ndjejë fajet dhe njollat shpirtërore, se thërresim me zë të madh:* O Perëndi i etërve,* o Zot je i bekuar.*

Thesarin e shpëtimit* dhe burimin e paprishjes ty Hyjlindësen pra,* kështjellën e përikjes dhe derën e pendimit ua shfaqe besnikëve.* O Perëndi i etërve,* o Zot je i bekuar.*

Sa po vijnë me shumë mall* edhe nën hijen tënde të gjith'sigurtë, o Zonj',* denjo që të shërohen si shpirtrat e sëmurë k'shtu dhe trupat në vuajtje,* se Krishtin ton' shpëtimtar,* për ne ti e ke lindur.*

Ode VIII

Irmosi: Ton Vasilea ton uranón

»**M**bretin në qiejt,* që gjith' ushtrit' »engjëllore* e himnojnë edhe ju himnoni,* dhe e lartësoni gjithnjë në »gjithë jetët.

Mos i harro kurr',* o Virgjëresh', sa

të luten,* të himnojnë me bes' e me shpresë,* dhe të lartësojnë me zë për gjithë jetët.*

Ti i shëron krejt,* përher' e pa u kursyer,* gjith' ata që të luten, o Zonjë,* dhe të lartësojnë që linde Zotin tonë.*

Ti më shëron krejt* nga gjith' sëmundjet e shpirtit* dhe nga dhembjet e trupit, o Zonjë,* të të lartësoj pra, o Virgjëresh' hirplote.*

Ti i largon krejt* sulmet dhe ngasjet e liga,* dhe pësimet, o Zonjë e virgjër,* pra të lartësojmë me zë për gjithë jetët.*

Ode IX

Irmosi: Kirios Theotokon

»**H**yllindëse të themi,* të pohojmë
»ne që* shpëtuam, o e kulluar e vir-
»gjër me ty,* me koret e të patrup-
»ve të madhështojmë tok.

Shiko si qaj me lotë,* edhe mëshir-
romë,* se ti ke fshirë çdo lot prej fy-
tyrave,* o Virgjëreshë dhe Zonjë që
linde Zotin Krisht.*

Gëzoje zemrën time,* Zonjë Virgjë-
reshë,* se ti ke lindur gëzimin për
njerëzit,* dhe zhduke çdo helm me
ndjesën e gjith' mëkateve.*

Liman dhe mbrojtje bëhu,* Zonjë
Virgjëreshë,* kështjell' e mur i patu-
ndur, Hyllindëse,* përikje, ndihmë
dhe mbrojtje e gjithë njerëzve.*

Me rrezet dhe me dritë* ndritna Vir-
gjëreshë,* edhe largo errësirën e
mendjeve* t' atyre që të lëçitin Zonjë
Hyllindëse.*

Shëromë Virgjëreshë,* se jam i për-
mbysur,* edhe po dergjem në shtratin
e vuajtjes,* po eja ngremë dhe falmë
shëndet edhe shpëtim.*



Përmbajtja

Rreth nevojës së këtij përkthimi	3
--	---

MUAJI MARS

9 Mars

Kujtimi i Dyzet Martirëve të mëdhenj e të shenjtë, që u martirizuan në liqenin e Sevastisë	7
---	---

17 Mars

Kujtimi i shën Aleksit, njeriu i Perëndisë	32
--	----

24 Mars

E Parakremtja e Ungjillëzimit (Evangjelizmoi) të Perëndilindëses së Tërëshenjtë	40
--	----

25 Mars

Ungjillëzimi (Evangjelizmoi) i së Tërëshenjtës, Perëndilindëses dhe Gjithmonëvirgjrës Mari	48
---	----

26 Mars

Mbledhja e Kryeengjellit Gabriel	98
--	----

MUAJI PRILL

23 Prill

Kujtimi i martirit të madh, të shenjtë e të lavdëruar Gjergj Trofeprurësi	107
---	-----

24 Prill

Kujtimi i nënës sonë oshënare Elisabeta çudibërëse 133

25 Prill

Kujtimi i apostullit dhe Ungjillorit të shenjtë Marku 141

MUAJI MAJ**1 Maj**

Kujtimi i profetit të shenjtë Jeremia dhe i oshënares Isidora,
e marrë për Krishtin 162

2 Maj

Kujtimi i transferimit të lipsanit të atit tonë ndër shenjtore
Athanasi i Madh, patriark i Aleksandrisë 173

5 Maj

Kujtimi i martires së madhe e të shenjtë Irini e lavdëruar 190

8 Maj

Kujtimi i apostullit dhe ungjillorit të shenjtë Joan Theologu;
dhe i atit tonë oshënar Arseni i Madh 197

9 Maj

Kujtimi i profetit të shenjtë Isaia dhe i martirit të shenjtë Kristofori 224

15 Maj

Kujtimi i atit tonë oshënar Pahomi i Madh 233

21 Maj

Kujtimi i mbretërve të mëdhenj, të shenjtë, të lavdëruar, të hyjkurorëzuar
dhe të barabartë me apostujt, Konstandini dhe Elena 240

22 Maj

Kujtimi i martirit të shenjtë Joan Vladimiri	263
--	-----

25 Maj

Gjetja e Tretë e Kokës së shenjtë të Pararendësit	277
---	-----

MUAJI QERSHOR**1 Qershor**

Kujtimi i martirit të shenjtë Justin Filozofi dhe i një Justini tjetër, si dhe i atyre që ishin me të	295
--	-----

17 Qershor

Kujtimi i martirëve të shenjtë Isavri, Vasili, Inokenti, Ermiu, Feliksi dhe Peregrini, si dhe i martirëve të shenjtë, Manueli, Saveli dhe Ismaili	303
--	-----

24 Qershor

Lindja e profetit të çmuar e të lavdishëm Joan Pararendësi dhe Pagëzori	311
---	-----

25 Qershor

Mbyllja e Lindjes së profetit të çmuar e të lavdishëm Joan Pararendësi dhe Pagëzori	335
--	-----

29 Qershor

Kujtimi i apostujve të shenjtë, të lavdëruar dhe të tërëfamshëm protokorifenj Petro dhe Pavël	339
--	-----

30 Qershor

Mbledhja e Dymbëdhjetë Apostujve të lavdëruar dhe të tërëfamshëm	364
--	-----

<u>Shtojcë</u>	382
---------------------------------	-----